REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI
I PRAKTIKËS GJYQËSORE
korrik- dhjetor

Vëllimi II

Botues:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Bordi redaktues:

Znj. Arta Rama-Hajrizi, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës
Prof. Dr. Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës
Z. Almiro Rodrigues, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës
Prof.Dr. Snezhana Botusharova, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës
Z. Milot Vokshi, Sekretar i Përgjithshme e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës
Njësia Ligjore, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Kontribuesit:

Z. Malte Kirchner , Menaxher i projektit, GIZ
Znj. Pranvera Ejupi- Hajzeraj, Kordinatore e projektit, GIZ
Z. Lavdim Krasniqi, Ekspert Ligjor
Premium Consulting

© 2016 Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Të drejtat e autorit:

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetesh, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përjashtim i përgjegjësisë:

Sipas nenit 116.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila është burim primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mbizotëron versioni i botuar në Gazetën Zyrtare.

Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Përmbledhja e vendimeve dhe aktgjykimeve është përpiluar nga "Projekti për Reformë Juridike dhe Administrative" implementuar nga Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ), dhe si i tillë, nuk zëvendëson vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe nuk përfaqësojnë formulimin e vërtetë të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Published by giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

korrik- dhjetor 2015

I GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ky Buletin është publikuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me "Projekti për Reformë Juridike dhe Administrative" implementuar nga Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, nën mbështetjen e Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

Tabela e përmbajtjes

Parathënie 13

Nr.1. KI146/14, Parashtrues Bekim Cakolli - Vlerësim i kushtetutshmërisë se Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 160/2013, të 8 tetorit 2013 15

Nr.2. KI09/15, Parashtrues, Ramë Dauti – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit PML. nr. 205/2014 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 19 nëntorit 2014 20

Nr.3. KI132/14, Parashtrues Rrok Nikollprenkaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë, P. nr. 389/12, të 21 gushtit 2012 28

Nr.4. KI165/14, Parashtrues Bajram Ahmeti - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 25/2012, të 10 majit 2013 34

Nr.5. KI174/14, Parashtrues Rrahim Pacolli - Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14 të Ligjit, Nr. 03/L-179, për Kryqin e Kuq të Kosovës 40

Nr.6. KI139/14, Parashtrues Mile Milosavljević - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 124/2014, i 13 majit 2014 47

Nr.7. KI04/15, Parashtrues Elvira Reçica - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 264/14, të 4 nëntorit 2014 55

Nr.8. KI 144/14 dhe KI 156/14, Parashtrues Vilijamin Hajduković dhe Stanka Tus, Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të dy vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, përkatësisht Vendimit nr. HPCC/REC/91/2007, të 19 janarit 2007, dhe Vendimit HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006 64

Nr.9. KI61/14, Parashtrues Faik Tërnava - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 195/2013, i 10 janarit 2014 86

Nr.10. KI69/14, Bajram Zogiani - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 276/2013, i 18 nëntorit 2013 96

Nr.11. KI180/14, Parashtrues Fehmi Pajaziti - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit CPP. nr. 5/2014, të Gjykatës Supreme të Kosovës, i 9 shtatorit 2014 107

Nr.12. KI20/15, Parashtrues Organizata joqeveritare FINCA Kosovë - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 205/2014, i 14 tetorit 2014 115

Nr.13. KI55/14, Parashtrues Baton Morina - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Zyrës së Prokurorit të Shtetit, KMLP. I. nr. 1/14 i 7 marsit 2014 123

Nr.14. KI152/14 dhe KI153/14, Parashtrues Fatmir Pajaziti-Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 194/2013, i 2 prillit 2014, të Aktvendimit PLK. nr. 4/14, të Panelit të Lirimit me Kusht, PLK. nr. 4/14, të 28 prillit 2014, dhe të Aktvendimit, të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 84/2014, i 5 gushtit 2014 135

Nr.15. KI172/14, Parashtrues Afrim Gela - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 189/2014, i 8 korrikut 2014 146

Nr.16. KI179/14, Parashtrues Bejtullah Sogojeva - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 396/2012, i 11 shtatorit 2013 154

Nr.17. KI57/15, Parashtrues Rasim Rama - Vlerësim i kushtetutshmërisë sëAktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 61/2015, i 26 marsit 2015..... 160

Nr.18. KI187/14, Parashtrues Met Gashi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 192/2014, i 20 tetorit 2014..... 169

Nr.19. KI167/14, Parashtrues NTP Unio Commerce, Zelqif Berisha, pronar - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0045-A0001, të 26 qershorit 2014 177

Nr.20. KI168/14, Parashtrues Mabco Constructions dhe Eurokoha-Reisen - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës se Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0045-A0001, të 26 qershorit 2014 197

Nr.21. KI142/14, Parashtrues Bajram Bajgora - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1429/2014, i 7 korrikut 2014 209

Nr.22. KI170/14, Parashtrues Adem Bajqinca - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. 533/2008, i 9 shkurtit 2010 214

Nr.23. KI184/14, Parashtrues Maliq Demiri - Vlerësim i kushtetutshmërisë së listës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit të punëtorëve të kualifikuar për 20% nga të ardhurat e shitjes së Ndërmarrjes Shoqërore "Ramiz Sadiku" 220

Nr.24. KI16/15, Parashtrues Dragomir Eraković - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit AC-I-14-0044 të Kolegjit të Ankesave të Gjykatës Supreme, i 5 shtatorit 2014 227

Nr.25. KI49/15, Parashtrues Veli Kuçi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 65/2015, i 26 marsit 2015 237

Nr.26. KI11/15, Parashtrues Ymer Bardhi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit AC-I.-14-0233 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, i 1 dhjetorit 2014 244

Nr.27. KI14/15, Parashtrues Milić Krstić - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit GSK-KPA-A-284/13 të Gjykatës Supreme të Kosovës – Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, i 2 dhjetorit 2014 252

Nr.28. KI32/15, Parashtrues Shemdi Nishevci - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 188/2014, i 17 nëntorit 2014 259

Nr.29. KI15/15, Parashtrues Hysni Hoxha kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit – Kërkesë për interpretimin ligjor të nenit 100 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës 266

Nr.30. KI75/15, Parashtrues Hatixhe Cana-Kurti - Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0218-A0001-A0004, të 14 majit 2015 272

Nr.31. KI98/14, Parashtrues Rasim Rashica - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, PPC. nr. 39/2011, i 5 gushtit 2011 281

Nr.32. KI17/15, Parashtrues Ibrahim Bajrami - Vlerësim i kushtetutshmërisë së kërkesës për përfshirje në procedurën e privatizimit 289

Nr.33. KI24/15, Parashtrues Enver Basholli - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, GSP-KPA-A-158/13, të 19 marsit 2014 295

Nr.34. KI36/15, Parashtrues Sahit Ninaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 378/2014, i 29 dhjetorit 2014 303

Nr.35. KO107/15, Parashtrues Albulena Haxhiu dhe 23 deputetë të tjerë - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 05-V-139 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Amendamentit XXIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, miratuar me 3 gusht 2015 312

Nr.36. KI05/15, Parashtrues Reshat Osmani - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0061, të 5 shtatorit 2014 333

Nr.37. KI18/15, Parashtrues "Iming" D.O.O. pronar Rrustem Zogaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0357-A0001, të 5 shkurtit 2015 341

Nr.38. KI19/15, Arif Kryeziu - Vlerësim i kushtetutshmërisë së kërkesës për përfshirje në procedurën e privatizimit 354

Nr.39. KI31/15, Parashtrues Tomislav Ilić - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ka. nr. 2/111/ 2015, i 4 shkurtit 2015 360

Nr.40. KI39/15, Parashtrues Fetije Haliti - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP. nr. 4/2015, i 27 shkurtit 2015 367

Nr.41. KI08/15, Parashtrues Haki Hajdari - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, PAKR 966/2012, të 11 shtatorit 2013 376

Nr.42. KI33/15, Parashtrues Mihane Ismajli - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-ll-0065-C0068, i 13 majit 2014 384

Nr.43. KI185/14, Parashtrues Zoran Kolić - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PML 125/14, i 8 korrikut 2014 392

Nr.44. KI46/15, Parashtrues Zejna Qosaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 17/2015, i 4 shkurtit 2015 401

Nr.45. KI29/15, Parashtrues Bardhyl Kameri - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 9/2015, i 12 shkurtit 2015 408

Nr.46. KI38/15, Parashtrues Kolë Puka - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PML.-KZZ. nr. 170/2014, i 19 shkurtit 2015 415

Nr.47. KI47/15 dhe KI48/15, Parashtrues Beqir Koskoviku dhe Mustafë Lutolli - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I1-14-0057, i 12 marsit 2015 424

Nr.48. KI79/15, Parashtruese Loresa Fetahu - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Pml. nr. 83/2015 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës i 30 prillit 2015 432

Nr.49. KI44/15, Parashtrues Hava Bajgora, Alban Bajgora dhe Sylejman Bajgora - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit nr. 356-65493 të Drejtorisë së Inspekcionit, Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, i 20 marsit 2015 440

Nr.50. KI53/15, Heset Neziri- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 223/2014, i 26 nëntorit 2014 447

Nr.51. KI61/15, Islam Krasniqi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, A. A. nr. 2/2014, i 21 shkurtit 2014 457

Nr.52. KO130/15, Presidentja e Republikës së Kosovës - Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, neni 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. 465

Nr.53. KI121/14, Valdet Nikçi dhe të tjerët- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 21/14, i 3 prillit 2014 475

Nr.54. KI35/15, Parashtrues Sami Omura - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 341/2014, i 6 janarit 2015 483

Nr.55. KI28/15, Parashtrues Naser Dragusha dhe 4 punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës – Kërkesë për rivlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 25/2012, i 10 majit 2013 493

Nr.56. KI56/15, Parashtrues Qamil Haxhibeqiri - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 367/2014, i 20 shkurtit 2015 499

Nr.57. KI86/15, Parashtrues Armond Morina - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 57/2014, i 17 nëntorit 2014 507

Nr.58. KI25/15, Parashtrues Faik Azemi - Kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme të Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese në Rastin nr. KI129/14, i 25 nëntorit 2014 515

Nr.59. KI77/15, Parashtrues Naser Foniqi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK/nr. 18/2015, i 11 marsit 2015 522

Nr.60. KI132/15, Parashtrues Manastiri i Deçanit - Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit 527

Nr.61. KI21/15, Parashtrues Halim Ibrahimi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 179/2014, i 8 tetorit 2014 536

Nr.62. KI34/15, Parashtrues Avdullah Kurti - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1066/13, i 24 nëntorit 2014 544

Nr.63. KI37/15, Parashtrues Rrahim Zeka - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 306/2014, i 16 dhjetorit 2014 554

Nr.64. KI69/15, Parashtrues Enver Krasniqi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 305/2014, i 8 dhjetorit 2014 562

Nr.65. KI78/15, Parashtrues Fatime Tosuni - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 318/2014, i 19 janarit 2015 571

Nr.66. KI99/15, Parashtrues Axhi Thaçi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit (SCEL- 09-0009) të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i 12 nëntorit 2013 579

Nr.67. KI131/14, Parashtrues Agron Alaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 115/2014, i 16 qershorit 2014 585

Nr.68. KI173/14, Parashtrues Staja Savić - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit KPCC/D/C/264/2014, të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, i 21 tetorit 2014 594

Nr.69. KI177/14, Parashtrues Miodrag Janković - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, U. ZH- A. A. Dr. 6/2014, i 21 korrikut 2014 604

Nr.70. KI83/15, Parashtrues Shefqet Mehmetukaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 49/2014, i 23 dhjetorit 2014 613

Nr.71. KO130/15, Presidentja e Republikës së Kosovës – Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar *"Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore"* me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës 622

Nr.72. Mendim mospajtues i gjyqtarit Bekim Sejdiu në rastin KO130/15 672

Nr.73. KI134/14, Parashtrues Sadik Thaqi Ankesë në lidhje me mungesën e hetimit të vdekjes së djalit 690

Nr.74. KI58/15, Parashtrues Islam Çerkini - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 210/2014, i 19 shkurtit 2015 702

Nr.75. KI64/15, Parashtrues Sanija Bajrami - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 297/2014, i 16 dhjetorit 2014 710

Nr.76. KI71/15, Parashtrues Miftar Ahmetaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, CML nr. 5/2014, i 23 dhjetorit 2014 715

Nr.77. KI94/15, Parashtrues Lulzim Ramaj dhe Shahe Ramaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së një vendimi të paidentifikuar të një autoriteti të paidentifikuar 722

Indeksi i Shprehjeve Ligjore 729

Indeksi i Neneve të Kushtetutës.....746

Shkelje e Neneve 31, 54 dhe 46 e Kushtetutës .....**Error! Bookmark not defined.**

Parathënie

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që, në cilësinë e Kryetares së Gjykatës, të shkruaj këtë parathënie për Buletinin e 5-të të Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Buletini është bërë pikë referimi i dobishëm dhe i cituar shpesh nga ata që punojnë në fushën e sëdrejtës kushtetuese. Edhe këtë herë jemi përkushtuar të tregojmë disa nga rezultatet kryesore të punës sonë të palodhshme.

Ky edicion i Buletinit përmban një numër të rasteve mëtë veçuara dhe më të rëndësishme, duke përfshirë kërkesën për kontrollin kushtetues preventiv të vlerësimit të përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "*Asociacioni/Bashkësia i komunave serbe në Kosovë – Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore*" me frymën e Kushtetutës, neni 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me KapitullinII [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nga Gjykata është kërkuar që tëjapëvlerësim kushtetues nëse parimet dhe elementet e Asociacionit me shumicë serbe në Kosovë janë në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës, neni 3, paragrafi 1 (Natyra shumetnike), me Kapitullin II (Të Drejtat dhe Liritë Themelore) dhe me Kapitullin III (Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata po ashtu ka nxjerrë dhe një vendim tjetër të rëndësishëm që ndërlidhet me kërkesat individuale ku, nga pikëpamja e gjyqësisë kushtetuese, janë trajtuar çështje pronësore dheçështje të përmbarimit të titujve pronësorë.

Nuk është e tepërt të theksohet se sa është e rëndësishme që parashtruesit e ardhshëm dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, të cilët synojnë të dorëzojnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke përdorur këtë Buletin, si dhe buletinet e mëparshëm,të konsultojnë me vëmendje vendimet e Gjykatës në rastet e ngjashme dhetë marrin parasysh nëse rasti i tyre mund të ketë ndonjë mundësi suksesi në dritën e rasteve të ngjashme. Duhet kuptuar qartë që, parimisht, e drejta e ankesës nuk mund t'i mohohet asnjë parashtruesi, por do të ishte më mirë që paraprakisht të njoftoheshin me jurisprudencën e Gjykatës dhe të kenë vlerësim objektiv për suksesin e kërkesës së tyre.

Qëllimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës në Buletin është t'i tregohet opinionit të gjerëse gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese i marrin vendimet e tyre në mënyrë të pavarur dhe plotësisht transparente, duke zbatuar standardet më të larta të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë kushtetuese.

Këtë vit publikimi i këtij buletini është bërë nga Gjykata derisa Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), ka vazhduar me asistencën e tyre rreth përgatitjeve për botimin e Buletinit, për çka Gjykata u është mirënjohëse.

Në fund, dëshiroj të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen time të veçantë për gjithë stafin e Gjykatës, me punën dhe me përkrahjen e të cilëve është bërë i mundur publikimi edhe i këtij edicioni të Buletinit të Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Arta Rama-Hajrizi
Kryetare e Gjykatës Kushtetuese

KI146/14, Parashtrues Bekim Cakolli - Vlerësim i kushtetutshmërisë se Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 160/2013, të 8 tetorit 2013

KI146/14, Aktvendim për papranueshmëri i 28 majit 2015, publikuar më 6 korrik 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dënim me burg, cilësim i veprës penale, kërkesë e paafatshme.*

Gjykata e Qarkut në Prishtinë,e kishte shpallur fajtor parashtruesin e kërkesës dhe i kishte caktuar dënimin me burg. Gjykata Supreme e Kosovës kishte refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të pabazuar. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese, për shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme, për shkak se nuk ishte dorëzuar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI146/14
Parashtrues
Bekim Cakolli
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
PML. nr. 160/2013, të 8 tetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtrues i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Bekim Cakolli nga Prishtina, i cili momentalisht gjendet në vuajtje të dënimit me burg në Burgun e Dubravës, i përfaqësuar nga z. Bajram Tmava, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme PML. nr. 160/2013, të 8 tetorit 2013, me të cilin Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

3. Ky aktgjykim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 nëntor 2013.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin, siç pretendohet, është cenuar neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 (7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 2 tetor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI146/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI146/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

8. Më 23 janar 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës. Me këtë njoftim, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës dhe Gjykata Komunale në Prishtinë që të dorëzojnë kopjen e fletëkthesës me datën e pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 160/2013.

9. Më 18 shkurt 2015, Gjykata Komunale dorëzoi kopjen e fletëkthesës, e cila tregon se aktgjykimi kontestues i Gjykatës Supreme të Kosovës është pranuar nga parashtruesi i kërkesës më 10 nëntor 2013.

10. Më 25 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi informata shtesë në Gjykatë me ç'rast ai pretendon se avokati i tij B.T. nuk e ka mbrojtur atë ligjërisht, sepse gjatë seancave ai nuk e lejoi atë të flasë.

11. Më 15 prill 2015, pas shqyrtimit tëraportit tëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues,i rekomandoiGjykatësnë përbërje të plotë,papranueshmërinë ekërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 31 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë [Aktgjykimi P. nr. 412/2010], e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprat penale dhe e dënoi atë me burg.

13. Më 26 shtator 2012, Gjykata Supreme e Kosovës [Aktgjykimin AP. nr. 378/2012], duke vendosur përkitazi me ankesat e parashtruesit të kërkesës (të akuzuarit) dhe Prokurorit Publik të Qarkut, miratoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë [P. nr. 412/2010], përkitazi me cilësimin juridik.

14. Pas kësaj, parashtruesi paraqiti kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke pretenduar shkeljen thelbësore të ligjit penal dhe duke kërkuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet.

15. Më 8 tetor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës [Aktgjykimi, Pml. nr. 160/2013] refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Ky aktgjykim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 nëntor 2013.

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe janë bërë shkelje esenciale të KPPK-së.

17. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

- *ANULIMIN e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, 412/2010 të datës 31.05.2012, aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr.122/2012 të datës 07.06.2012 dhe PML.nr.160/2013 të datës 08.10.2013.*

- *Kthimin e çështjes penale të të akuzuarit Bekim Cakolli në rigjykim dhe rivendosje Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda.*

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje të gjykojë ankesën e parashtruesit, para së gjithash duhet të vlerësojë nëse ai i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

19. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]".*

20. Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi; ose*
>
> *[...]."*

21. Aktgjykimi përfundimtar i Gjykatës Supreme të Kosovës [Pml. nr. 160/2013], është nxjerrë më 8 tetor 2013, dhe i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 nëntor 2013, ndërsa parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 2 tetor 2014, që është më shumë se 4 (katër) muaj nga dita kur i është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës. Prandaj, kërkesa është dorëzuar pas afatit.

22. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 maj 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI09/15, Parashtrues, Ramë Dauti – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit PML. nr. 205/2014 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 19 nëntorit 2014

KI09/15, Aktvendim për papranueshmëri i 28 majit 2015, publikuar më 6 korrik 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, dënim me burg, vepër penale, shpërdorim i detyrës zyrtare, Masë e përkohshme, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të drejtat e të akuzuarit, kallëzim penal, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Themelore në Gjilan kishte shqiptuar ndaj parashtruesit të kërkesës dënim me burgim prej 40 ditësh për shkak të veprës penale, kallëzim penal i rrejshëm. Vendimi i Gjykatës Themelore ishte vërtetuar edhe nga gjykatat e instancave më të larta. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të të drejtave të akuzuarit dhe për gjykim të drejtë, siç garantohet me nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së.

Gjykata Kushtetuese arsyetoi se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar që të ketë mbrojtësin, që të paraqesë mbrojtjen e tij, të marrë pjesë në procedurë, të ndjekë rrjedhën e procedurës, të shtjerë mjetet juridike dhe të ndërmarrëveprime të tjera ligjërisht të lejuara dhe se procedurat në tërësi kishin qenë të rregullta. Gjykata shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, sepse parashtruesi nuk kishte arritur t'i mbështes pretendimet e tij. Gjykata, po ashtu, refuzoi kërkesën për Masë të përkohshme për shkak se nuk kishte rast *prima facie*.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI09/15
Parashtrues
Ramë Dauti
Kërkesëpër vlerësimine kushtetutshmërisë së AktgjykimittëGjykatës Supreme të Kosovës PML. nr.205/2014,të19 nëntorit2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama- Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesaështë dorëzuar nga z. RamëDautime vendbanimnë Viti(në tekstin e mëtejmë:parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokatiz. RifatAbdullahi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesëskërkonvlerësimine kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr.205/2014,të19 nëntorit2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi ikushtetutshmërisë së AktgjykimittëGjykatës Supreme të Kosovës [PML. nr.205/2014] të 19 nëntorit2014, me të cilin pretendohet se janëshkelur të drejtatdhe liritë e parashtruesit të kërkesëstë garantuarame Kushtetutë, dhe atë: neni30[Të Drejtat etë Akuzuarit], neni31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutëssë Republikës sëKosovës, si dhe dispozitat e nenit6dheneneve2dhe 4 tëProtokollit7të

KonventësEvropiane për tëDrejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Të njëjtën ditë, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) tëvendosë Masën epërkohshmedhe të nxjerrë vendimtë veçantëme të cilin do tështyhej përmbarimii aktgjykimittë formës së prerëderisa të vlerësohet kushtetutshmëria e aktgjykimit të kontestuar.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin113.7të Kushtetutëssë Republikës sëKosovës(në tekstin e mëtejmë:Kushtetuta), nenet 27dhe47tëLigjit përGjykatënKushtetuese të Republikëssë Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji)dhe në rregullat54, 55dhe56tëRregullores së punës të GjykatësKushtetuese të RepublikëssëKosovës(në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 29 janar 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 9 shkurt2015,KryetariiGjykatës, me Vendimin nr.GJR. KI09/15, caktoigjyqtarin Altay Suroygjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarii Gjykatës, me Vendiminnr.KSH. KI09/15,caktoiKolegjin shqyrtues,të përbërënga gjyqtarët: RobertCarolan(kryesues),Ivan ČukalovićdheEnver Hasani.

8. Më 25 shkurt2015,Gjykatae njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supremenë lidhje me regjistrimin e kërkesës.

9. Më 16 prill2015,pas shqyrtimit tëraportit tëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtuesi rekomandoiGjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë ekërkesës, dherefuzimin ekërkesës përMasë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 26 gusht 2010, parashtruesi i kërkesës ushtroi kallëzim penal kundër gjyqtarit të Gjykatës Komunale në Kamenicë, për veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit.

11. Më 28 mars 2011, Prokuroria Publike Komunale në Gjilan e refuzoi këtë kallëzim penal, njëkohësisht ngriti aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës për veprën penale lajmërimet e rrejshme nga neni 306, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK).

12. Më 28 prill2014,Gjykata Themelore nëGjilan, Dega në Kamenicë, nxori Aktgjykimin[P. nr. 462/2013] me të cilin e dënoi parashtruesin ekërkesësmeburgimprej40ditësh.

13. Parashtruesi i kërkesës në afatin ligjor ushtroi ankesë në GjykatëneApelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale nëGjilan - Dega në Kamenicë [P. nr. 462/2013], për shkak të shkeljeve tëdispozitave tëKPKdhe vërtetimit të gabuartë gjendjes faktike.

14. Më 21 gusht2014,GjykataeApelit me Aktgjykimin[PA1. nr.802/14] e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesëssitë pabazuar me arsyetimin se: *„Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet e larte cekura nuk janë të bazuara. Aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1.12 dhe par. 2 lidhur me nenin 370 par. 7 të KPP-së për të cilat pretendohet në ankese dhe as shkelje tjera të cilat kjo gjykate i vëren çdo here sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 394 të KPP-së. Aktgjykimi është konkret dhe i qartë,...“*.

15. Parashtruesi në afatin ligjor dorëzoikërkesënpërmbrojtjen e ligjshmërisënë Gjykatën Supremekundër Aktgjykimit të Gjykatës ThemelorenëGjilan– Dega nëKamenicë[P. nr.462/2013], të25 prillit 2014,dhe Aktgjykimit të Gjykatës se ApelitnëPrishtinë [PA1.nr.802/2014], të21 gushtit 2014.

16. Më 19 nëntor2014,Gjykata SupremenxoriAktgjykimin[PML. nr. 205/2014], me të cilinrefuzoikërkesën e parashtruesit përmbrojtjen e ligjshmërisë sitë pabazuarme arsyetimin se: *“Lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga nenit 384 par. 1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 par. 7 të KPPK si dhe nenit 361 par. 2 të KPPK, në kërkesë nuk është precizuar se ku dhe në çfarë manifestohen këto shkelje. Megjithatë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë të qarta dhe konkrete, në arsyetimet e tyre janë dhënë arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante*”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *„se me vendimet e Gjyakatave të rregullta ndaj tani te dënuarit jane shkelur te drejtat kushtetuese (te drejtat e te akuzuarit nga neni 30 dhe e drejta per Gjykim te drete dhe te paaneshem nga neni 31 i Kushtetutes se Republikes se Kosoves dhe dispoztat e nenit 6 dhe nenet 2-4 te protokolit 7 te Konventes Evropjane mbi te drejtat Themelore te njeriut*”.

18. Parashtruesi kërkon nga Gjykata:

”I. TË SHPALL, Kerkesen të pranueshme.

II. KONSTATON se ka patur shkelje te nenit 30 (te drejtat e te akuzuarit) dhe nenit 31 (E drejta per gjykim te drejte dhe te paaneshem);

III. ANULOHEN aktgjykimet e Gjykates Supreme te Kosoves PML. nr. 205/2014 dt. 19.11.2014, Aktgjykimi i Gjyaktes se Apelit te Kosoves PA1. nr. 802/14 dt. 21.08.2014 dhe aktjgykimi i Gjykates Themelore ne Gjilan - Dega ne Kamenice P. nr. 461/2013 dt. 25.04.2014;

IV. Lenda i kthehet Gjykates se shkalles se pare ne riprocedure, por duke e deleguar kompetcen reale ne nje Gjykate tjeter Themelore“.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Nëmënyrë që të jetënë gjendje tëshqyrtojë kërkesën eparashtruesit, Gjykata së pari duhet tëvlerësojë nëseparashtruesii kapërmbushurkushtet epranueshmërisë,të përcaktuarame Kushtetutë dhetë specifikuaramë tejnëLigj dhe në Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, neni 113. paragrafi 7 i Kushtetutës përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

21. Neni 48 i Ligjit përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

22. Gjykata gjithashtui referohetrregullave36(1) (d), 36(2) (b) dhe (d) tëRregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...], ose

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të jaftueshme pretendimin e tij".

23. Në rastin konkret, parashtruesi në kërkesë theksoiqë meAktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [PML. nr. 205/2014] të 19 nëntorit 2014, janë shkelur të drejtatdhe liritëkushtetuesenga neni30[Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe neni31[E Drejtapër Gjykim të Drejtëdhe të Paanshëm] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhedispozitat e nenit6dhe të neneve2dhe4tëProtokollit7të KEDNJ-së.

24. Në lidhje me këtë,Gjykata e ka shikuar tërë procedurën paragjykatave të rregullta sinjë tërësi, dhekonsideronse procedura është kryernë atë mënyrë qëparashtruesit i është dhënëe drejta përgjykim të drejtë, gjë qëGjykata Supreme në Aktgjykimin e saj[PML. nr.205/2014] konkludoi: *„[...]aktgjykimi i gjykatës se shkalles se pare dhe ai i shkalles se dyte janë të qarta dhe konkrete, në arsyetimet e tyre janë dhënë arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante".*

25. Gjykata gjithashtuvërense parashtruesit të kërkesës i është mundësuarqë të ketëmbrojtësinqë të paraqesëmbrojtjen e tij, të marrë pjesënë procedurë, të ndjekrrjedhën eprocedurës, të shterë mjetet juridikedhe të ndërmarrë veprime të tjeraligjërishttë lejuaraprocedurale, si dhe nga arsyetimii Aktgjykimit të Gjykatës Supreme[PML. nr.205/2014] rezultonse të gjithakundërshtimet e tijishin tëpabazuara, dhesenuk kanë ndikuar nëligjshmërinë evendimeve të marrambipërgjegjësinë penale. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, në ankesënkushtetuesenukka specifikuar asnjëarsyenë bazë të cilësdo të mundtë vërtetohejsenuk ka pasur kohë të mjaftueshme dhe mundësi për përgatitjen e mbrojtjes.

26. Nga se u tha më lart, Gjykata konsideronse pretendimete parashtruesit të kërkesëspër shkeljen e nenit30[Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe nenit31[E Drejta përGjykim të Drejtëdhe të Paanshëm] të Kushtetutës,

dhe të nenit6dhe neneve2dhe4tëProtokollit7të KEDNJ-së, janë të pabazuara.

27. Gjykata rikujton se neni 53 i Kushtetutës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] parasheh që: *"të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut"*.

28. Gjykata rithekson që nuk është detyrë e sajsipasKushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimetqë merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i këtyre të fundit që tëinterpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhematerialе (Shih, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr.30544/96, GJEDNJ Aktgjykimi i 21 janarit 1999;shih edhe Aktvendimi për papranueshmëri në Rastin nr. 70/11, parashtruesit*Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, të 16 dhjetorit 2011).

29. Gjykata Kushtetuese mundvetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur nëmënyrë të drejtë dhe nëse proceduratnë përgjithësi, të shikuara në tërësinë etyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia,* Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, *Edwards kundër Mbretërisë se Bashkuar*, App. Nr. 13071/87, 10 korrik 1991).

30. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk i ka mbështeturpretendimet e tij, si dhe nuk kaparaqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që dotë tregonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (Shih, Rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla,* Gjykata Kushtetuese e Republikës Kosovës, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

Vlerësimii kërkesëspërMasë të përkohshme

31. Gjykata vëren separashtruesi në kërkesëkërkonqë Gjykata tëvendosë Masën epërkohshmedhetë nxjerrë një vendimtë veçantëme të cilin do të shtyhetpërmbarimi iaktgjykimit tëformës së prerë,derisa tëvlerësohet kushtetutshmëria e aktgjykimit të kontestuar.

32. Për të aprovuarMasën e përkohshme, në pajtim me rregullin55(4) të Rregullores sëpunës, Gjykata duhet të përcaktojë:

"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme.

[...]"

33. Siç u konkludua më lart, kërkesaështë e papranueshme, prandajnuk ka rastprimafaciepërvendosjen eMasës së përkohshme. Për këto arsye,kërkesa përMasë të përkohshmeduhettë refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2), 55 (4) (a) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 maj 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëvedhe ta publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI132/14, Parashtrues Rrok Nikollprenkaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë, P. nr. 389/12, të 21 gushtit 2012

KI132/14, Aktvendim për papranueshmëri i 1 qershorit 2015, publikuar më 9 korrik 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kallëzim penal, vepër penale, lëndim i rëndë trupor, privim i kundërligjshëm i lirisë, kërkesë e paafatshme*

Gjykata Komunale në Gjakovë, kishte hedhur poshtë të palejueshme padinë e parashtruesit të paraqitur kundër disa zyrtarëve policor. Parashtruesi dorëzoi ankesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës me pretendimin se kishte pësuar lëndime të rënda nga rrahjet e zyrtarëve policor.

Gjykata Kushtetuese e shpalli kërkesën të papranueshme, për shkak se ishte dorëzuar pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI132/14
Parashtrues
Rrok Nikollprenkaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë, P. nr. 389/12, të 21 gushtit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Rrok Nikollprenkaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në fshatin Novosellë e Epërme, komuna e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, P. nr. 389/12, të 21 gushtit 2012, i cili i ishte dorëzuar atij më 21 qershor 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar cilat dispozita kushtetuese pretendohen të jenë shkelur me vendimin e kontestuar. Në kërkesën e tij parashtruesi deklaron se "*I kërkoj të drejtat e mija ku tallen gati prej 5 viteve nga ana 4 persona ne fjal dhe gjyqësis*." Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se ka pasur "*shkelja e autoritetit Prekuroria deri te gjyqtarija pas rastit 25.04.2010; 26 26.04.2010 qillimisht ishin shmangur rastit gjat paraburgimit duke me akuzuar per tme burgos qe të mbyllet rasti*".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 28 gusht 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata)

6. Më 5 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

7. Më 15 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 16 prill 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 25 prill 2010, 4 (katër) policët në fjalë arrestuan parashtruesin e kërkesës.

10. Sipas parashtruesit të kërkesës, gjatë arrestimit ai ishte rrahur nga këta policë dhe si pasojë ai ka pësuar dëmtime të rënda të trurit.

11. Më 26 prill 2010, Gjykata Komunale në Gjakovë nxori Aktvendimin (Hp. nr. 32/2010) kundër parashtruesit të kërkesës për veprën penale sulm ndaj personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (neni. 317.2 i Kodit të Përkohshëm Penal, KPPK). Me atë Aktvendim parashtruesit të kërkesës i ishte caktuar masa e paraqitjes në stacionin policor. Statusi i mëtejshëm i këtij rasti është i panjohur.

12. Më 5 tetor 2010, Prokuroria Publike Komunale në Gjakovë, e njoftoi parashtruesin e kërkesës se kishte pushuar hetimin kundër 4 (katër) policëve për veprat penale: 1) lëndim i rëndë trupor, 2) privim të kundërligjshëm nga liria, dhe 3) keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave.

Parashtruesi ishte njoftuar se ai mund të ndërmarrë ndjekje penale sipas padisë private, në pajtim me nenin 62.2 të KPPK-së.

13. Më 22 mars 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi private në Gjykatën Komunale në Gjakovë, kundër 4 (katër) oficerëve të policisë për 4 (katër) vepra penale: 1) lëndim i rëndë trupor, 2) privim të kundërligjshëm nga liria, 3) keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave, dhe 4) torturë.

14. Kjo padi u hodh poshtë më 15 korrik 2011 me Aktvendimin (P nr. 275/11) të Gjykatës së Qarkut në Pejë. Arsyetimi ishte se parashtruesi i kërkesës nuk është prokuror i autorizuar për këto katër vepra penale, ndjekja e të cilave është nën autoritetin e Prokurorit të Shtetit.

15. Parashtruesi i kërkesës nuk parashtroi ankesë ndaj Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

16. Më 16 gusht 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi private në Gjykatën Komunale në Gjakovë kundër katër oficerëve të policisë për veprat penale: 1) lëndim i rëndë trupor, 2) privim të kundërligjshëm nga liria, dhe 3) keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave.

17. Më 21 gusht 2012, padia e tij private ishte refuzuar dhe ishte pushuar procedura penale nga Gjykata Komunale në Gjakovë, me Aktvendimin, P. nr. 389/12. Në arsyetimin e saj, Gjykata theksoi se parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur propozimin e tij ku "*pas 1 viti, 10 muajve dhe 8 ditëve, Gjykata refuzoi padinë private dhe pushoi procedurën penale ..., dhe në bazë të nenit 62 par 1 dhe 2, dhe nenit 316 par. 2 të KPPK-së*". Parashtruesi i kërkesës nuk e kontestoi këtë Aktvendim.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjatë arrestimit ai ishte rrahur nga 4 (katër) oficerë të policisë dhe si pasojë, ai kishte pësuar lëndime të rënda të trurit. Ai gjithashtu deklaroi: "*Unë Rrok Nikoll Penkaj, sipas mundësive kam vazhdue me kallxim penal, por Gjykata kishte pushue rastin dhe per arsye shendetsore se kisha kuptue...*".

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh se:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

21. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)".*

22. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> ...
>
> *(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi...".*

23. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata gjen se parashtruesi parashtroi kërkesën e tij më 28 gusht 2014, ndërsa vendimi i fundit i Gjykatës Komunale të Gjakovës (P. nr. 389/12) ishte nxjerrë më 21 gusht 2012, dhe i është dorëzuar atij më 21 qershor 2013.

24. Prandaj, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) Rregullores së punës.

25. Gjykata përkujton që qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit si dhe rregullit 36 (1), (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë
sigurinë juridike duke siguruar që rastet të cilat paraqesin çështje kushtetuese
të shqyrtohen brenda afateve të arsyeshme, si dhe që vendimet e nxjerra më herët të mos jenë pafundësisht të hapura për kontestim (Shih, rastin *O'Loughlidhe të tjerët kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* Nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendimi
i 25 gushtit 2005).

26. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 1 qershor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI165/14, Parashtrues Bajram Ahmeti - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 25/2012, të 10 majit 2013

KI165/14, Aktvendim për papranueshmëri i 22 qershorit 2015, publikuar më 9 korrik 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, efekti juridik i vendimeve, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, kërkesë e papranueshme*

Në këtë rast, parashtruesi kishte dorëzuar një kërkesë ku pretendonte se gjykatat e rregullta kishin shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit. Mirëpo, Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi tashmë, kishte dorëzuar një kërkesë identike që ishte shpallur e papranueshme si qartazi e pabazuar. Gjykata vlerësoi se ajo tashmë ka nxjerrë një vendim për këtë çështje dhe se kjo kërkesë nuk përmban asnjë bazë për nxjerrjen e një vendimi të ri. Kërkesa u shpall e papranueshme në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës, me rregullin 63 (1) dhe me rregullin 36 (3) d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI165/14
Parashtrues
Bajram Ahmeti
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 25/2012, të 10 majit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan,gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama- Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Bajram Ahmeti, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati z. Ilaz Qerkinaj, nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 25/2012, të 10 majit 2013.

3. Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për këtë çështje në Rastin KI163/13, në të cilin parashtruesit e kërkesës kanë qenë *Naser Dragusha dhe 6 punëtorë të tjerë (në mesin e të cilëve edhe parashtruesi i kërkesës) të Korporatës Energjetike të Kosovës* (në tekstin e mëtejmë: KEK). Aktvendimi për papranueshmëri në Rastin KI163/13, është nxjerrë nga Gjykata më 23 qershor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev. nr. 25/2012] të Gjykatës Supreme, të 10 majit 2013, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 10 nëntor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 5 dhjetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI165/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI165/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

8. Më 17 dhjetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 6 shkurt2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhei rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 10 nëntor 2014, parashtruesi parashtroi kërkesën KI165/14, në të cilën si fakte dhe prova të reja në Gjykatë dorëzoi vetëm letrën e Misionit të EULEX-it, Ref: 2014-COS-1242, të 2 tetorit 2014.

11. Në letrën [Ref: 2014-COS-1242] e 2 tetorit 2014 të Misionit të EULEX-it, thuhet: "*Gjykata Kushtetuese tashmë e ka shqyrtuar rastin e parashtruesit dhe në lidhje me këtë, Gjykata, më datën 23 qershor 2014, e ka nxjerrë një vendim i cili është shënuar si Rasti KI163/13*".

12. Në të vërtetë, më 18 tetor 2013, parashtruesi i kërkesës së bashku me Naser Dragushën dhe 5 (pesë) punëtorë të tjerë të KEK-ut, parashtroi

një kërkesë në Gjykatë, të cilën Gjykata e regjistroi me numrin KI163/13. Në atë kërkesë, parashtruesit e kontestuan Aktgjykimin e njëjtë të Gjykatës Supreme [Rev. nr. 25/2012, të 10 majit 2013].

13. Në ndërkohë, më 23 qershor 2014, Gjykata e shpalli kërkesën KI163/13 të papranueshme, sepse ishte qartazi e pabazuar (Rasti KI163/13, Aktvendimi për papranueshmëri, i 23 qershorit 2014).

14. Faktet dhe vendimet e gjykatave të rregullta, të cilat janë paraqitur nga parashtruesi në kërkesën e re KI165/14, tashmë janë shqyrtuar në Rastin nr. KI163/13, siç është vendosur me Aktvendimin për papranueshmëri, të 23 qershorit 2014, dhe rrjedhimisht, vendimet të cilat tashmë kanë qenë objekt i shqyrtimit në Rastin KI163/13, Gjykata nuk do t'i merr në rishqyrtim.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Në kërkesën e re KI165/14, parashtruesi insiston në pretendimin se me aktgjykimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

16. Parashtruesi i kërkesës, në vazhdim, pretendon se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht të drejtën e tij për pagesën e të ardhurave personale.

17. Parashtruesi në përfundim të kërkesës së tij kërkon nga Gjykata që ajo t'ia mundësojë realizimin e të drejtës së tij për ndryshimin e pagave, në të cilat ai ka të drejtë.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.1 të Kushtetutës [Efekti Juridik i Vendimeve], i cili përcakton:

> *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.*

20. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 63 (1) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *Vendimet e Gjykatës janë të obligueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.*

21. Për më tepër, rregulli 36 (3) d) i Rregullores së punës, parasheh:

> *Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*
>
> > *(...)*
> >
> > *d) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri.*

22. Gjykata konsideron që faktet dhe pretendimet që parashtruesi i ka dhënë në kërkesën e re nuk paraqesin bazë dhe as arsye të mjaftueshme e relevante për vendim të ri (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI02/14, parashtrues i kërkesës *Hamdi Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 majit 2014).

23. Në fakt, Gjykata rikujton se ajo tashmë është marrë me çështjen e lartpërmendur në Rastin KI163/13, të parashtruesit të kërkesës *Naser Dragusha dhe të 6 punëtorëve të tjerë të KEK-ut*, Aktvendimi për papranueshmëri, i nxjerrë më 23 qershor 2014. Në aktvendimin e saj, Gjykata deklaroi kërkesën të papranueshme sepse ishte qartazi e pabazuar, duke konsideruar se faktet e paraqitura nga parashtruesit e atëhershëm të kërkesës në asnjë mënyrë nuk arsyetuan pretendimet e tyre për shkeljen e të drejtave kushtetuese, dhe se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme si dhe pse me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë.

24. Prandaj, Gjykata konsideron se ajo tashmë ka nxjerrë një vendim për këtë çështje, dhe se kjo kërkesë nuk përmban asnjë bazë për nxjerrjen e një vendimi të ri.

25. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës, me rregullin 63 (1) dhe me rregullin 36 (3) d) të Rregullores së punës, Gjykata përfundon se kjo kërkesë duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me nenin116.1të Kushtetutës, rregullin 63(1) dhe rregullin36(3) (d) tëRregullores së punës, në seancën e mbajturmë 22 qershor2015,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit, dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI174/14, Parashtrues Rrahim Pacolli - Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14 të Ligjit, Nr. 03/L-179, për Kryqin e Kuq të Kosovës

KI174/14, Aktvendim për papranueshmëri i 22 qershorit 2015, publikuar më 9 korrik 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e papranueshme, Masë e përkohshme, actio popularis, efektet juridike të vendimeve*

Në këtë rast, parashtruesi kërkoi nga Gjykata anulimin e nenit 14, pika 1.7., i Ligjit Nr. 03/L-179, për Kryqin e Kuq të Republikës se Kosovës si jokushtetuese. Parashtruesi, po ashtu, kërkoi vënien e masave të përkohshme.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh actio popularis, e cila ua mundëson individëve inicimin e vlerësimit abstrakt, pavarësisht nga interesi
i veçantë ligjor i tyre në këtë çështje. Gjykata, po ashtu, rikujtoi se ky rast përbënte çështje të gjykuar dhe se ishte vendosur më parë. Gjykata refuzoi Masën e përkohshme për shkak se nuk kishte rast *prima facie*.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI174/14
Parashtrues
Rrahim Pacolli
Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14 të Ligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës, Nr. 03/L-179

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Rrahim Pacolli me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili është drejtor i "Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës".

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 14 të Ligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës, Nr. 03/L-179, i cili është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 10 qershor 2010, i shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. DL-025-2010, më 2 korrik 2010, dhe i publikuar në Gazetën zyrtare më 20 korrik 2010.

3. Gjykata Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) vëren se tashmë kishte vendosur për objektin e njëjtë të çështjes në Rastin KI118/10, ku parashtrues i kërkesës ishte "Shoqata e Sigurimeve në Kosovë". Në atë rast, më 13 dhjetor 2010, Gjykata kishte refuzuar kërkesën për vendosjen e Masës së përkohshme dhe më 23 maj 2011, ajo kishte nxjerrë Aktvendim për papranueshmëri. Parashtruesi i tanishëm, z. Rrahim Pacolli, është drejtor i të njëjtës Shoqatë të Sigurimeve.

Objekti i çështjes

4. Parashtruesi i kërkesës pretendon se neni i kontestuar, pra neni 14 i Ligjit është në kundërshtim me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 10 [Ekonomia], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

5. Parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata të vendosë Masë të përkohshme për të ndaluar zbatimin e nenit 14 nga data e parashtrimit të kërkesës, e deri në marrjen e vendimit meritor nga Gjykata për këtë çështje.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 2 dhjetor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

8. Më 17 dhjetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI174/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI174/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

9. Më 23 dhjetor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 3 shkurt 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 2 dhjetor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën KI174/14 në Gjykatë, duke pretenduar shkelje të Kushtetutës.

12. Megjithatë, më 26 nëntor 2010, “Shoqata e Sigurimeve në Kosovë”, kishte dorëzuar një kërkesë identike në Gjykatë, duke e kontestuar të

njëjtin nen të Ligjit për Kryqin e Kuq (neni 14 i Ligjit), dhe duke kërkuar nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme që ta pezullojë nenin e kontestuar të Ligjit, derisa të merret vendimi për rastin.

13. Përveç kësaj, Shoqata e Sigurimeve pretendoi se neni i kontestuar i Ligjit kishte shkelur nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 10 [Ekonomia], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit].

14. Në atë rast, më 13 dhjetor 2010, Gjykata refuzoi kërkesën e Shoqatës së Sigurimeve për vendosjen e Masës së përkohshme me arsyetimin: "*Një nga kriteret për lejimin e Masës së përkohshme është nëse do të shkaktohen dëme të pariparueshme. Nëse Gjykata Kushtetuese në fund gjen që Neni 14 është jo kushtetues, atëherë çfarëdo dëmi i shkaktuar qoftë ndaj parashtruesit apo kompanive individuale të sigurimeve mund të llogaritet dhe nëse është e nevojshme mund të urdhërohet kthimi i këtyre fondeve nga gjykata përkatëse. Nuk ka asgjë të pariparueshme në dëmin e shkaktuar. Parashtruesi nuk e ka dëshmuar që kompanitë e sigurimeve Illyria, Siguria dhe Sigkos, apo ndonjë kompani tjetër e sigurimeve, do të falimentojë si rezultat i zbatimit të tarifës prej 1%. Prandaj, nga kjo bazë nuk mund të argumentohet caktimi i Masës së përkohshme të kërkuar*".

15. Më 23 maj 2011, Gjykata e hodhi poshtë kërkesën e Shoqatës së Sigurimeve në Rastin KI118/10 si të papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës. Gjithashtu hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për vendosjen e Masës së përkohshme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës konsideron se neni 14 i Ligjit për Kryqin e Kuq Nr. 03/L-179, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës është tërësisht jokushtetues dhe në kundërshtim me nenet 3, 24 dhe 49 të Kushtetutës.

17. Parashtruesi kërkon nga Gjykata të:

"[...]

a) "APROVOHET kërkesa për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë të Shoqatës së Kompanive të Sigurimeve të Kosovës.

b) ANULOHET neni 14 pika 1.7., i Ligjit Nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, si jokushtetues.

c) CAKTOHET masa e përkohshme e zbatimit të nenit 14 pika 1.7., të Ligjit Nr. 03/L-179 Për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, nga dita e parashtrimit të kërkesës e deri me marrjen e vendimit meritor nga ana e Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me këtë çështjeje që është objekt i procedurës".

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.1 të Kushtetutës [Efekti Juridik i Vendimeve], i cili përcakton:

"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës".

20. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 63 (1) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"Vendimet e Gjykatës janë të obligueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës".

21. Për më tepër, rregulli 36 (3) (d) i Rregullores së punës, përcakton:

"Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

[...],

(d) Gjykata *tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri"*

22. Gjykata rikujton se ajo tashmë e ka trajtuar objektin e çështjes së kërkesës së tanishme në Rastin KI118/10, në të cilin parashtrues i kërkesës ishte "Shoqata e Sigurimeve në Kosovë". Më 23 maj 2011, ajo e refuzoi atë rast si qartazi të pabazuar, sepse Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh *actio popularis,* e cila ua mundëson individëve inicimin e vlerësimit abstrakt, pavarësisht nga interesi i veçantë ligjor i tyre në këtë çështje.

23. Prandaj, Shoqata e Sigurimeve në Rastin KI118/10 nuk ka mundur të konsiderohet si palë e autorizuar, e cila mund të iniciojë çështje kushtetuese në abstrakt në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-179, duke kërkuar të merr një mjet juridik në emër të interesave kolektive.

24. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se ajo tashmë ka vendosur për objektin e çështjes të kërkesës së tanishme, i cili nuk përmban asnjë bazë për një vendim të ri.

25. Prandaj, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës, rregullin 63 (1) dhe 36 (3) (d) të Rregullores së punës, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme.

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

26. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë kërkon që Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, për ndalimin e zbatimit të nenit 14 të Ligjit për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-179, nga data e parashtrimit të kërkesës e deri në marrjen e vendimit meritor nga Gjykata Kushtetuese, lidhur me këtë çështje që është objekt i procedurës.

27. Për të aprovuar kërkesën për Masë të përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, Gjykata duhet të përcaktojë që:

    "(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës:

    (b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme;

    (c) Masa e përkohshme është me interes publik".

28. Siç është konkluduar më lart, kërkesa është e papranueshme, dhe prandaj nuk ka rast *prima facie* për vendosjen e Masës së përkohshme. Për këto arsye, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 55 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 22 qershor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI139/14, Parashtrues Mile Milosavljević - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 124/2014, i 13 majit 2014

KI132/14, Aktvendim për papranueshmëri i 3 korrikut 2015, publikuar më 14 korrik 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë, e drejta në pronë, kontratë për mbajtje të përjetshme, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Komunale në Ferizaj kishte refuzuar të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës përkitazi me anulimin e kontratës për mbajtje të përjetshme. Edhe gjykatat e instancave më të larta përvetësuan dhe vërtetuan qëndrimin juridiko-ligjor të gjykatës së faktit. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese, për shkelje të së drejtës në gjykim të dejtë dhe të drejtës në pronë.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi, se gjykatat e rregullta kishin arsyetuar vendimet e tyre e posaçërisht, çështjen e kontratës për mbajtje të përjetshme. Gjykata Kushtetuese, po ashtu, ritheksoi se çështjet e ligjshmërisë dhe të fakteve janë fushëveprim i gjykatave të rregullta. Gjykata Kushtetuese, shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (c) të Rregullores së punës

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI139/14
Parashtrues
Mile Milosavljević
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 124/2014, të 13 majit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Mile Milosavljević (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga z. Bekim Sylejmani, avokat nga Shtërpca.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 124/2014, të 13 majit 2014, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2777/2012, të 12 shkurtit 2014, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj-Dega në Shtërpcë, C. nr. 50/2010.

3. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 124/2014, i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 23 qershor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar që *"supozohet se është i padrejtë për shkak se parashtruesit i ka mohuar të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën në pronë"*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 shtator 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 7 tetor 2014, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI139/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI139/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović (anëtarë).

8. Më 22 tetor 2014, parashtruesi u njoftua për regjistrimin e kërkesës si dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme të Kosovës.

9. Më 2 shkurt 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

10. Më 26 qershor 2015, mandati i gjyqtarit raportues Kadri Kryeziu dhe Kryetarit të Gjykatës prof. dr. Enver Hasani përfundoi. Ky aktvendim është nënshkruar nga Kryetarja e Gjykatës dhe gjyqtari kryesues i Kolegjit shqyrtues në pajtim me rregullin 57 (7) të Rregullores së punës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 17 qershor 2010, i ati i parashtruesit të kërkesës B. M. kishte lidhur kontratë për mbajtje të përjetshme me palën e tretë S. M., dhe e njëjta ishte vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj-Dega në Shtërpcë.

12. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Ferizaj-Dega në Shtërpcë, duke kërkuar anulimin e kontratës për mbajtje të përjetshme të lidhur ndërmjet të atit të tij B. M. dhe palës së tretë S. M.

13. Më 30 shtator 2011, Gjykata Komunale në Ferizaj-Dega në Shtërpcë, me Aktgjykimin C. nr. 50/2010 përcaktoi:

    REFUZOHET si e PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit Mile Millosavleviq nga f. Jazhincë, komuna e Shtërpcës me vendbanim

ne Vërhnik të Sllovenisë kundër të paditurës Suzana Millosavleviq nga f. Jazhincë komuna e Shtërpcës dhe VËRTETOHET Kontrata për mbajtje të përjetshme në mes të Bogolub Millosavleviqit nga f. Jazhincë komuna e Shtërpcës dhe tani të paditurës Suzana Millosavleviq nga f. Jazhince, komuna e Shtërpcës e lidhur me dt. 30.10.2008 dhe e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj - dega në Shtërpcë Nd. nr. 120/10 e dt. 17.06.2010".

14. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

15. Më 12 shkurt 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ca. nr. 2777/2012 përcaktoi:

"REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Milleta Millosavleviqit nga fshati Jazhincë, komuna e Shtërpcës, kurse aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj, Dega në Shtërpcë, c. nr. 50/2010 i datës 30.09.2011, VËRTETOHET".

16. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

17. Më 13 maj 2014, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. nr. 124/2014 përcaktoi:

"Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë. AC. nr. 2777/2012 datë 12.2.2014".

18. Në aktgjykimin e lartpërmendur, Gjykata Supreme e Kosovës arsyetoi:

"Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, mbi bazën faktike të vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të gjykatës se shkallës së dytë përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Pretendimin e cekur në revizion se e paditura të gjitha të mirat të cilat i ka përfituar në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përjetshme, burojnë nga veprat penale sipas aktgjykimit penal P. nr. 86/12,(i cili aktgjykim është dorëzuar së bashku me revizionin) Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase palë në

kontratën për mbajtjen e përjetshme si ushqimmarrës dhe ushqimdhënës mund të jetë çdo person fizik i cili e ka zotësinë për të lidhur kontratën sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës civile dhe nuk është e kufizuar vetëm në personat në gjini ndërmjet tyre apo personat që kanë detyrim të ndërsjellë. Andaj, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate të revizionit fakti se është zhvilluar procedurë penale, lidhur me anulimin e martesës së ushqimmarrësit dhe këtu të paditurës si ushqimdhënëse (ngase të njëjtit martesën e kanë lidhur para organeve paralele), nuk është bazë juridike për anulimin e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme, sepse nuk është kusht ligjor që të njëjtit të jenë bashkëshort. Kjo Gjykatë shton se palët kontraktuese janë marrë vesh mbi pjesët përbërëse esenciale të kontratës (neni 26 i LMD), duke e deklaruar vullnetin e lyre lirisht dhe seriozisht, në atë mënyrë që kontratën e kanë legalizuar në Gjykatë, sipas procedurës së paraparë ligjore, andaj pretendimi i cekur në revizion se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar është i pabazuar".

Pretendimet e parashtruesittë kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës: *"... Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të konstaton se me Aktgjykimin përfundimtar të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 124/2014 të 13.05.2014 dhe aktgjykimeve të mëparshme që i kanë paraprirë të njëjtit ka shkelje të kushtetutës dhe të ligjit në aplikim, për të drejtën e pronës, barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në dëm të ankuesit, meqenëse të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra nga gjykata nuk kanë vërtetuar faktin se kjo çështje që nga fillimi ka rrjedhur si pasojë e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve (martesës) nga e cila kanë buruar të gjitha pasojat tjera juridike. Të cilat pasoja gjykatat e rregullta nuk i kanë vlerësuar drejtë dhe ligjërisht".*

20. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon nga Gjykata: *"Gjithashtu kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës si instancë e fundit të bëjë shfuqizimin e Aktgjykimit te Gjykatës Supreme të Kosovës, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë, dhe rasti te kthehet në Rigjykim për një gjykim te paanshëm, dhe në pajtim me provat që të vijë deri te anulimi i kontratës së mbajtjes së përjetshme".*

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje për të gjykuar kërkesën e parashtruesit, së pari është e nevojshme të shqyrtojë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me

Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

22. Përkitazi me kërkesën e parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

23. Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit që përcakton:

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

24. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 36 (2) c) të Rregullores së punës që përcakton:

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

...

c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë;

25. Përkitazi me pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme e Kosovës ka shtjelluar dhe arsyetuar mirë se: i) kush janë subjektet që kanë zotësi për lidhje të kontratës për mbajtje të përjetshme, ii) raporti që krijohet ndërmjet subjekteve që lidhin kontratën për mbajtje të përjetshme, iii) mënyrën e legalizimit të raportit të krijuar nga kontrata për mbajtje të përjetshme, dhe iv) shkaqet se përse pretendimi i parashtruesit përkitazi me paligjshmërinë e kontratës për mbajtje të përjetshme është i pabazuar.

26. Për më tepër, përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se *"gjykatat e rregullta nuk kanë vlerësuar drejtë dhe ligjërisht"*, Gjykata konsideron se nuk është detyrë e saj që t'i vlerësojë faktet në bazë të të cilave gjykatat e rregullta kanë nxjerrë një vendim në vend të tjetrit, sepse po të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e shkallës së katërt çka do të nënkuptonte shpërfillje të kufizimit të

juridiksionit të saj (Shih rastin *Kemmache kundër Francës,* Nr. 17621/91, GJEDNJ, Aktgjykim i 24 nëntorit 1994, para. 44).

27. Gjykata po ashtu konsideron, se pretendimet e parashtruesit të kërkesës ngrenë çështje të ligjshmërisë dhe vlerësimit të fakteve, çka në të vërtetë është fushëveprim dhe prerogativë, që gjykatave të rregullta iu është akorduar me Kushtetutë.

28. Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Dhe se në rastin konkret, pretendimet e parashtruesit të kërkesës nuk ngrenë çështje të kushtetutshmërisë.

29. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve, dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë, dhe instrumente të tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, dhe, po ashtu, shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

30. Përveç kësaj, kërkesa nuk arrin të dëshmojë që gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

31. Fakti që parashtruesi nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës], të Kushtetutës (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

32. Në këto rrethana, parashtruesi nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ai nuk tregojnë në asnjë mënyrë që gjykatat e rregullta i kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

33. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në përputhje me rregullin 36 (2) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe
rregullin 36 (2) (c) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2015 , njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI04/15, Parashtrues Elvira Reçica - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 264/14, të 4 nëntorit 2014

KI04/15, Aktvendim për papranueshmëri i 2 korrikut 2015, publikuar më 29 korrik 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, arsimi fillor dhe i mesëm, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Komunale në Lipjan kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës, që të sistemohet si arsimtare e historisë. Gjykatat e instancave të larta përvetësuan dhe vërtetuan qëndrimin e gjykatës së faktit. Parashtruesja u ankua në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe barazisë para ligjit.

Gjykata Kushtetuese vërejti se parashtruesja e kërkesës nuk është e kënaqur kryesisht me kualifikimin juridik të fakteve dhe të ligjit të aplikuar nga gjykatat e rregullta dhe se ato, po ashtu, kishin dhënë përgjigje të arsyetuar në të gjitha çështjet qendore të kërkesëpadisë së parashtrueses. Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI04/15
Parashtrues
Elvira Reçica
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 264/14, të4 nëntorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Elvira Reçica nga fshati Llugagji, komuna e Lipjanit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja),.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 264/14, të 4 nëntorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme. Parashtruesja e kërkesës konsideron se asaj, në procedurën para gjykatave të rregullta, i është mohuar e drejta për procedurë administrative dhe e drejta për punë, dhe në këtë mënyrë janë shkelur nenet 4, 24 dhe 34 të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 janar 2015, parashtruesja dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 9 shkurt 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI04/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari me Vendimin KSH. KI04/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

7. Më 25 shkurt 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 26 qershor 2015, me Vendimin GJR. KI04/15, Kryetarja e Gjykatës emëroi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi për anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit më 26 qershor 2015, i përfundoi mandati në Gjykatën Kushtetuese.

9. Më 2 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesja e kërkesës në periudhën kohore prej vitit 2001 deri në vitin 2006, ka qenë në marrëdhënie të punës në cilësinë e arsimtares së historisë në shkollën fillore „Emin Duraku“ në fshatin Banullë, komuna e Lipjanit.

11. Më 18 korrik 2006, Komuna e Lipjanit publikoi një konkurs në gazetën e përditshme „Zëri“, në të cilin ka kërkuar 3 (tre) arsimtarë të gjuhës angleze për 11 orë mësimore, një arsimtar të edukatës fizike dhe një arsimtar të historisë për 10 orë.

12. Drejtoria Komunale e Arsimit (në tekstin e mëtejmë: DKA), në konkursin për vendin e arsimtarit të historisë zgjodhi një person të tretë, i cili gjithashtu i kishte plotësuar kushtet e konkursit.

13. Njëkohësisht, DKA e zgjodhi parashtruesen e kërkesës për arsimtare të gjuhës angleze dhe me të njëjtën lidhi një kontratë të re të punës për periudhën kohore, prej 1 shtatorit 2006 e deri më 31 gusht 2007.

14. Ndaj vendimit të tillë të DKA-së për zgjedhjen e kandidatëve, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Inspeksionin e Arsimit, pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (në tekstin e mëtejmë: MASHT).

15. Më 8 shtator 2006, inspektori i arsimit i MASHT-it nxori Vendimin nr. 76/2006, me të cilin urdhëroi që parashtruesja e kërkesës të sistemohet në vendin e punës së arsimtarit të historisë me 14 orë mësimore, dhe me plotësim të orëve mësimore të gjuhës angleze për klasën e tretë të shkollës fillore „Emin Duraku“ në Banullë.

16. Më 30 shtator 2006, inspektori i arsimit i MASHT-it nxori Konkluzionin nr. 108/2006, me të cilin drejtori i DKA-së në Komunën e Lipjanit detyrohet që të përmbarojë Vendimin nr. 76/2006. Në të kundërtën, propozimi për përmbarim do t'i dorëzohet Gjykatës Komunale në Lipjan.

17. Më 10 nëntor 2006, kryeinspektori i arsimit i MASHT-it nxori Konkluzionin për lejimin e përmbarimit nr. 274/02-5, me të cilin konstatoi se Vendimi nr. 76/2006, i 8 shtatorit 2006, dhe Konkluzioni, nr. 108/2006, i 30 shtatorit 2006, janë të formës së prerë dhe udhëzoi parashtruesen e kërkesës që *"...në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij konkluzioni t'i drejtohet Gjykatës Komunale në Lipjan për përmbarimin e vendimit në kuptimin e dispozitivit të tij"*.

18. Më 12 dhjetor 2006, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatën Komunale në Lipjan propozimin për përmbarimin e Vendimit të MASHT-it, nr. 76/2006, të 8 shtatorit 2006 dhe Konkluzionit të MASHT-it, nr. 108/2006, të 30 shtatorit 2006.

19. Më 2 mars 2007, Gjykata Komunale në Lipjan e ndërpreu procedurën përmbarimore dhe e udhëzoi parashtruesen e kërkesës që t'i shterojë të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative para Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK).

20. Më 15 gusht 2007, KPMK me Vendimin nr. 1685/2007 e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës, me arsyetimin se autoriteti punëdhënës ka vepruar në bazë të kontratës së punës, duke i përmbushur obligimet e veta kontraktuese ndaj saj, meqenëse kontrata e saj e punës ka qenë e vlefshme deri më 31 gusht 2007.

21. Më 16 tetor 2007, Gjykata Komunale në Lipjan, me Aktvendimin, C. nr. 522/06 e hodhi padinë e parashtrueses së kërkesës me arsyetimin se kjo çështje është gjykuar në formë të prerë në procedurën administrative me Vendimin e KPMK-së, nr. 1685/2007, të 15 gushtit 2007.

22. Parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Lipjan.

23. Më 29 prill 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin Ac. nr. 394/2008 e prishi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Lipjan, C. nr. 522/06, të 16 tetorit 2007, me konstatimin se arsyetimi është i paqartë, dhe e ktheu lëndën në Gjykatën Komunale në Lipjan për rigjykim.

24. Më 8 dhjetor 2009, Gjykata Komunale në Lipjan me Aktgjykimin, C. nr. 152/09 e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës, me të cilën ka kërkuar që të sistemohet si arsimtare e historisë me 14 orë të historisë dhe plotësim orësh nga gjuha angleze, me arsyetimin se *"...e drejtë e autoritetit punëdhënës është se cilin kandidat ta zgjedh me kualifikim të njëjtë"*.

25. Më 25 janar 2010, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan.

26. Më 16 qershor 2014, Gjykata e Apelit në Prishtinë, me Aktgjykimin, Ac. nr. 1545/2012 e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Lipjan, C. nr. 152/09, të 8 dhjetorit 2009.

27. Parashtruesja e kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac. nr. 1545/2012, të 16 qershorit 2014.

28. Më 4 nëntor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin, Rev. nr. 264/2014 e refuzoi, si të pabazuar kërkesën e parashtrueses për revizion, me këtë arsyetim:

> *"... Gjykata Supreme e Kosovës, pranon në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses, pasi që aktgjykimet e goditura nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as me shkelje të tjera thelbësore në të cilat paditësja thirret në revizion..."*.

Pretendimet e parashtruesit

29. Parashtruesja e kërkesës në rend të parë thekson një varg të shkeljeve të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm dhe Ligjit të punës.

30. Parashtruesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta nuk kishin të drejtë t'i rishqyrtojnë vendimet e MASHT-it dhe se me dërgimin e parashtrueses në procedurë gjyqësore janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës.

31. Parashtruesja e kërkesës konsideron se me vendimet e gjykatave të rregullta asaj i është *"...mohuar një e drejtë e cila në procedurën administrative të përfunduar në të gjitha fazat e saj...si një e drejtë për punë"*.

32. Parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të aprovojë "*kërkesën për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe t'i anulojë si kundërkushtetuese":*

    I. Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Lipjan, me numër C. nr. 152/2009, të 8 dhjetorit 2009,

    II. Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, me numër Ac. nr. 1545/2012, të 16 qershorit 2014 dhe

    III. Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me numër Rev. nr. 264/14, të 4 nëntorit 2014.

33. Njëkohësisht, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që t'ia njeh të drejtën sipas Vendimit të MASHT-it, me numër 76/2006, në atë mënyrë që Gjykata do të obligonte organin komunal që ta ekzekutojë këtë vendim.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

35. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

36. Gjykata thekson edhe nenin 48 të Ligjit, i cili përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendohet se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

37. Për më tepër, Gjykata rikujton rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

„(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

...

(b) aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

38. Gjykata vëren se parashtruesi e ka bazuar kërkesën në shkeljen e Ligjit për procedurën kontestimore, të Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm dhe të Ligjit të punës. Prandaj, Gjykata gjen se çështjet që ngre parashtruesi në kërkesën e tij janë çështje të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë.

39. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës i ka paraqitur pretendimet e njëjta edhe në procedurën sipas revizionit para Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila me Aktgjykimin Rev. nr. 264/14, të 4 nëntorit 2014, e kishte dhënë një përgjigje të arsyetuar në të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës lidhur me arsyet e zbatimit të rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.

40. Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu Rastin, nr. KI70/11, parashtruesit e kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

41. Më tej, Gjykata i ka shqyrtuar pretendimet e parashtrueses së kërkesës që "*vendimet e MASHT-it janë përfundimtare*" dhe se gjykatat e rregullta, duke mos i zbatuar vendimet e MASHT-it, ia kanë mohuar parashtrueses "*... të drejtën në procedurë administrative*" si dhe *"... të drejtën për punë"*.

42. Lidhur me pretendimet e lartpërmendura të parashtrueses së kërkesës, Gjykata konstaton se këto pretendime nuk janë të sakta dhe se janë në kundërshtim me dokumentacionin të cilin parashtruesja e ka dorëzuar në Gjykatë.

43. Nga dokumentacioni të cilin parashtruesja e kërkesës e kishte dorëzuar në Gjykatë, rrjedh se procedura administrative nuk është përfunduar me vendimin e MASHT-it, me numër 76/2006, siç pretendon parashtruesja e kërkesës, por me vendimin e KPMK-së, nr. 1685/2007, me të cilin ankesa e parashtrueses së kërkesës është refuzuar me arsyetimin se *"autoriteti punëdhënës ka vepruar në bazë të Kontratës së Punës duke i përmbushur obligimet kontraktuese ndaj saj..."*.

44. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk është e kënaqur kryesisht me kualifikimin juridik të fakteve dhe të ligjit të aplikuar nga gjykatat e rregullta. Kualifikimi juridik i fakteve dhe ligji i aplikueshëm janë çështje të ligjshmërisë.

45. Parashtruesja e kërkesës nuk paraqiti ndonjë dëshmi *prima facie* për shkeljen e të drejtave të saj kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr.* 53363/99, të 31 majit 2005).

46. Edhe pse parashtruesja e kërkesës pretendon se të drejtat e saj janë shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe zbatimin e gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, ajo nuk ka treguar se si këto vendime i kanë shkelur të drejtat e saj kushtetuese.

47. Gjykata më tej thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesja e kërkesës është e pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'i shërbejë asaj si e drejtë të ngrejë kërkesë të argumentuar për shkeljen e Kushtetutës (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, kërkesa nr. 5503/02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).*

48. Parashtrueses së kërkesës i është ofruar mundësia që të paraqesë rastin e saj dhe të kontestojë interpretimin e ligjit si të interpretuar gabimisht para KPMK-së në procedurën administrative, si dhe para Gjykatës Komunale në Prishtinë, Gjykatës së Apelit të Kosovës në

Prishtinë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës në procedurën e rregullt gjyqësore.

49. Gjykata, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

50. Gjykata konsideron se kriteret e pranueshmërisë nuk janë përmbushur. Parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të paraqesë dhe të mbështesë pretendimet se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e saj kushtetuese.

51. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI 144/14 dhe KI 156/14, Parashtrues Vilijamin Hajduković dhe Stanka Tus, Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të dy vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, përkatësisht Vendimit nr. HPCC/REC/91/2007, të 19 janarit 2007, dhe Vendimit HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006

KI 144/14 dhe KI 156/14, Aktgjykim i 4 gushtit 2015, të publikuar më 7 gusht 2015

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, procedurë civile, kërkesë e pranueshme, forma e prerë dhe zbatimi i vendimeve, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, mbrojtja e pronës*

Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore kishte nxjerrë dy Aktgjykime të formës së prerë në lidhje me të drejtat e parashtruesit mbi pronat e paluajtshme. Këto vendime ishin nxjerrë në favor të të dy parashtruesve të kërkesës duke ua njohur të drejtat e tyre të pronësisë mbi pronat e paluajtshme të kontestuara. Megjithatë, për më shumë se 14 vjet vendimet në fjalë nuk u ekzekutuan nga Agjencia Kosovare e Pronës - organi - përgjegjës për mbikëqyrjen e përmbarimit të vendimeve të nxjerra nga Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.

Parashtruesit pretenduan *inter alia* se për shkak të mospërmbarimit të vendimeve të formës së prerë dhe të detyrueshme në favor të tyre u janë shkelur të drejtat për gjykim të drejtë dhe gëzimin e pronës të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën për të Drejta të Njeriut.

Gjykata së pari vlerësoi se kërkesa e parashtruesve i plotëson të gjitha kriteret procedurale dhe për këtë arsye është e pranueshme. Sa i përket meritave të kërkesës, Gjykata konstatoi se mospërmbarimi i vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore nga ana e Agjencisë Kosovare të Pronës dhe dështimi i autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për të siguruar mekanizma efikas, për përmbarimin e vendimit të formës së prerë, është në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit dhe përbën shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Prandaj, Gjykata konstatoi se ka shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë në lidhje me të drejtën për gëzim paqësor të pronës. Gjykata mbështeti konstatimin e saj duke u bazuar në praktikën e vet gjyqësore për çështje të ngjashme dhe praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut.

AKTGJYKIM
në
Rastin nr. KI144/14 dhe nr. KI156/14
Parashtrues
Vilijamin Hajduković dhe Stanka Tus
Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të dy vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, përkatësisht Vendimit nr. HPCC/REC/91/2007, të 19 janarit 2007, dhe Vendimit HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesat janë parashtruar nga z. Vilijamin Hajduković, me vendbanim në Beograd, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i parë i kërkesës) dhe znj. Stanka Tus, me vendbanim në Novi Sad, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e dytë e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Të dy parashtruesite kërkesës kontestojnë mospërmbarimin e vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore(në tekstin e mëtejmë: KKPB). Parashtruesi i parë e konteston mospërmbarimin e Vendimit HPCC/REC/91/2007 të 19 janarit 2007. Parashtruesi i dytë e konteston Vendimin HPCC/REC/81-2006, të 11 dhjetorit 2006.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së këtyre kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë, në lidhje me mospërmbarimin e dy vendimeve të

KKPB-së, Vendimit HPCC/REC/91/2007, të 19 janarit 2007, dhe Vendimit HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006.

4. Të dy parashtruesit e kërkesës pretendojnë se atyre, si pasojë e mospërmbarimit të vendimeve të lartpërmendura, u janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], si dhe me nenet relevante të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) neni 6 paragrafi 1 [E drejta për një proces të rregullt], neni 13 [E drejta për zgjidhje efektive], neni 14 [Ndalimi i diskriminimit], neni 1 i Protokollit 1 [Mbrojtja e pronës] të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullat 37 (1) dhe 56 (1) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 24 shtator 2014, parashtruesi i parë dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 7 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI144/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI144/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Enver Hasani (anëtar).

8. Më 10 tetor 2014, parashtruesja e dytë dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

9. Më 23 tetor 2014, Kryetari, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës urdhëroi që kërkesa e parashtrueses së dytë, e cila është regjistruar me nr. KI156/14, të bashkohet me kërkesën e parashtruesit të parë, të regjistruar me nr. KI144/14.

10. Më 1 dhjetor 2014, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës dhe Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejmë: AKP-ja), e cila është pasardhëse juridike e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe

Banesore (në tekstin e mëtejmë: DÇPB), për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave.

11. Më 26 qershor2015,Kryetarjame Vendimin nr. KSH. KI144/14&KI156/14caktoi gjyqtarenArta Rama-Hajrizi anëtare tëKolegjit shqyrtuesnë vend tëgjyqtaritEnver Hasani, mandati i të cilitsigjyqtariGjykatësKushtetueseka përfunduarmë 26 qershor2015.

12. Më 3 korrik2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatëspranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën e parashtruesit të parë

13. Në vitin 1992, parashtruesit të parë i është dhënë e drejta e banimit të banesës në pronësi shoqërore, e cila gjendet në adresën Fidanishte, rr. Petra Prlje G 2/5, në Komunën e Pejës. Pas kësaj, në fund të vitit 1992, parashtruesi i parë lidhi kontratë për blerjen e banesës nga Ndërmarrja Shoqërore (NSH) "Boris Kidrič". Parashtruesi i parë e vërtetoi blerjen në Gjykatën Komunale në Pejë, më 29 dhjetor 1992, me numër rendor 8535/92.

14. Pas luftës në vitin 1999, parashtruesi i parë u largua nga Kosova dhe mori qëndrim të përkohshëm në Beograd. Banesa e tij në Pejë më pas ishte zënë nga një palë e tretë, B. B.

15. Më 8 shkurt 2002, parashtruesi parashtroi kërkesë [DS304087] në DÇPB, me të cilën kërkoi vërtetimin e të drejtës mbi banesën e cila ishte në posedim të tij deri në vitin 1999.

16. Në një datë të pacaktuar, pala e tretë B. B. parashtroi kërkesë [DS501273] në DÇPB, në të cilën, gjithashtu, kërkoi vërtetimin e të drejtës mbi banesën e njëjtë, të përmendur më lart.

17. DÇPB-ja i drejtoi të dy kërkesat te Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB).

18. Më 18 qershor 2005, KKPB -ja nxori Vendimin kolektiv HPCC/D/197-2005 –A & C, i cili përfshinte të dy kërkesat e lartpërmendura [DS3014087 dhe DS501273].

19. Në vendimin e tij, KKPB -ja, ia ka njohur parashtruesit të kërkesës DS501273 (gjegj. palës së tretë B. B.) të drejtën e posedimit të banesës, me të cilin ai i fitoi të gjitha të drejtat si parashtrues i kërkesës së kategorisë A, sipas nenit 4.2 të REG/UNMIK/2000/60.

20. Me vendimin e njëjtë, parashtruesi i kërkesës në kërkesën DS304087 (gjegj. parashtruesi i parë) është privuar nga e drejta e posedimit të banesës së kontestuar, dhe në pajtim me këtë, atij i është njohur e drejta e kompensimit, si parashtrues i kërkesës së kategorisë C, sipas nenit 4.2 të REG/UNMIK/2000/60.

21. Më 10 tetor 2005, parashtruesi i parë dorëzoi kërkesën për rishqyrtimin e Vendimit HPCC/D/197/2005/A&C, të 18 qershorit 2005. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga KKPB -ja, më 19 janar 2007, me vendimin HPCC/REC/91/2007.

22. Më 23 prill 2007, parashtruesi i parë sërish iu drejtua KKPB-së, duke kërkuar anulimin e vendimit HPCC/REC/91/2007, të 19 janarit 2007. Parashtruesi i parë pretendoi se ky vendim ishte vendim kolektiv në lidhje me një numër të kërkesave për rishqyrtim, por se, kërkesë e tij për rishqyrtim nuk ishte përfshirë.

23. Më 8 qershor 2007, KKPB-ja e informoi parashtruesin e parë se kërkesa për rishqyrtim tashmë ishte vendosur dhe kërkesa e tij shtesë ishte refuzuar. KKPB -ja theksoi se *"sipas nenit 14.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, çdo palë në kërkesë ka të drejtë ta paraqesë ankesën për rishqyrtimin e vendimit, ju i keni shteruar të gjitha mjetet juridike, dhe nuk mund të procedohen kërkesa shtesë"*.

24. Më 12 janar 2012, parashtruesi i parë i kërkesës i dërgoi një letër AKP-së duke kërkuar përmbarimin e Vendimit të KKPB -së, HPCC /D/197/2005 /A&C, të 18 qershorit 2005, me të cilin ai ishte njohur si parashtrues i kategorisë C, dhe iu pranua e drejta për kompensim, në bazë të nenit 4 të REG/UNMIK/2000/60.

25. Më 7 mars 2012, AKP-ja u përgjigj në kërkesën e parashtruesit të parë. AKP-ja theksoi *inter alia*, se:

> *"Agjencia Kosovare e Pronës (Agjencia), e cila ka trashëguar një pjesë të përgjegjësisë nga Drejtorati i mëhershëm për Çështje Pronësore Banesore (Drejtorati), dëshiron të ju informon se e kemi pranuar letrën tuaj [...], me të cilën kërkoni kompensimin e vlerës së banesës në lidhje me kërkesën lidhur me pronën e cila gjendet në Pejë, rruga "Fidanishte" G-2, kati 1, banesa nr. 5.*
>
> *Siç tashmë e dini, Drejtorati ka pranuar dy kërkesa në lidhje me pronën e lartpërmendur, siç janë: kërkesa e kategorisë C, DS304087 të cilën e keni dorëzuar ju dhe kërkesa e kategorisë A, DS501273 të cilën e ka dorëzuar z. B. B.*

Komisioni për kërkesa pronësore dhe banesore (KKPB) mori vendimin nr. HPCC/D/197/2005/A&C të 18 qershorit 2005 me të cilin parashtruesit të kërkesës të kategorisë A ia ka njohur e drejta mbi pronën me pagesën e shumës të paraparë me nenin 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Nëse parashtruesi i kërkesës të kategorisë A e shfrytëzon këtë të drejtë ju do të merrni kompensim adekuat si parashtruesi i kërkesës të kategorisë C në pajtim me dispozitat e nenit 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.
[...]
Agjencia Kosovare e Pronës ka aprovuar kriteret dhe procedurën e kompensimit si dhe ka bërë përpjekje për të siguruar fondet adekuate për zbatimin e dispozitave të nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 dhe vendimeve të Komisionit lidhur me këtë lloj të kërkesës, por deri më tani nuk kanë arritur të sigurojnë fondet e nevojshme. Agjencia do të vazhdojë të këmbëngulë për sigurimin e fondeve të nevojshme për zbatimin e programit të kompensimit. Sa më shpejt që kjo të arrihet, Agjencia do të ju kontaktoj në lidhje me zbatimin e vendimit të Komisionit".

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën e parashtrueses së dytë

26. Më 6 nëntor 2012, me vdekjen e burrit të saj, znj. Stanka Tus, u bë e veja e Nikola Tus, e referuar në të gjitha dokumentet ligjore në lidhje me këtë kërkesë. Për qëllime të kësaj kërkese, ajo do të referohet si parashtruesja e dytë.

27. Duke filluar nga 1 prilli 1968, parashtrueses së dytë i ishte ndarë e drejta e banimit në një banesë në pronësi shoqërore që gjendet në rrugën Muharrem Bekteshi, nr. 4, hyrja II, në Pejë.

28. Parashtruesja e dytë kishte banuar në këtë banesë deri më 23 mars 1991, kur ajo si duket ishte dëbuar dhe banesa e saj ishte zënë nga një palë e tretë, S.D. Parashtruesja e dytë pretendon se ajo ndërmori procedura të ndryshme ligjore në mënyrë që të kthejë të drejtat e saj të banimit, deri në qershor të vitit 1999, kur ajo u detyrua të largohej nga Kosova.

29. Pala e tretë, S. D., me sa duket kishte blerë banesën në një periudhë të papërcaktuar ndërmjet vitit 1991 dhe 1999 sipas Ligjit për banim. Për më tepër, në një kohë të papërcaktuar pas vitit 2000, S.D. pretendohet se ia kishte shitur banesën një pale tjetër, A.G.

30. Një kohë pas vitit 2000, parashtruesja e dytë e kërkesës parashtroi kërkesë në DÇPB, duke kërkuar konfirmimin e të drejtave të saj për ta

shfrytëzuar banesën. Kërkesa e saj ishte regjistruar nën numrin DS603997.

31. Më 31 mars 2006, KKPB nxori Vendimin (HPCC/D/252/2006/A&C), me të cilin ishte vërtetuar se parashtruesja e dytë është bartëse e ligjshme e të drejtës së shfrytëzimit të banesës. Rrjedhimisht, parashtrueses së dytë i është njohur e drejta e parashtruesit të kërkesës së kategorisë A.

32. Pala e tretë (S.D.) i cili kishte zënë banesën që nga viti 1991, ishte regjistruar në DÇPBnën numrin DS500011. Kjo palë ishte referuar nga KKPB-ja si "pronari i parë", dhe i ishin njohur të drejtat e parashtruesit të kategorisë C. Lidhur me shitjen e pretenduar të banesës nga ana e këtij "pronari të parë", KKPB -ja theksoi në paragrafët 12 dhe 13 të Vendimit se:

"12. Siç është treguar më lart, neni 4 i REG/UNMIK/2000/60 nuk është i aplikueshëm atje ku ka ekzistuar një shitje e mëtejshme e vlefshme nga ana e pronarit të parë pronarit të mëtejshëm. Kjo, megjithatë, është një shembull i përjashtimit. Në kuptim të nenit 5.1 dhe 5.2 të REG/UNMIK/2000/60, pronari i parë e ka të ndaluar shitjen e banesës së tij deri në skadimin e afatit për parashtrimin e kërkesës të caktuar në nenin 3.2 ose deri në zgjidhjen e ndonjë kërkese sipas REG/UNMIK/2000/60 e cila ka të bëjë me atë banesë, cilado që të jetë e fundit. Neni 5.2 urdhëron në mënyrë eksplicite:

"Çdo kontratë për shitje, këmbim ose dhurim, e bërë në kundërshtim me këtë nen, është e pavlefshme dhe nuk ka forcë ligjore". 13.

Në kërkesat [...] DS6033997, "pronari i parë" ka pretenduar se ai ia kishte shitur pronën pronarit të mëtejmë. Shitja ka ndodhur pas hyrjes në fuqi të REG/UNMIK/2000/60 dhe para zgjidhjes së kësaj kërkese sipas Rregullores së cekur. Si pasojë, secila prej këtyre shitjeve është lidhur në shkelje të neneve 5.1 dhe 5.2 të REG/UNMIK/2000/60 dhe është e pavlefshme. Si rrjedhojë, banesat lëndore mbeten në pronësinë e "pronarit të parë". Neni 4 kështu bëhet i aplikueshëm në këtë kërkesë".

33. Në një datë të papërcaktuar, banuesi faktik i banesës, A.G., parashtroi kërkesë për rishqyrtim të vendimit të KKPB -së, të 31 marsit 2006, si një e ashtuquajtur "palë e interesuar".

34. Më 11 dhjetor 2006, KKPB -ja nxori vendimin grupor HPCC/REC/81/2006, me të cilin ishte refuzuar kërkesa për rishqyrtim

dhe ishte vërtetuar vendimi i shkallës së parë. Në paragrafin 50 të vendimit, KKPB -ja adresoi pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtat e parashtrueses së dytë (të referuar si "palë e paditur" në citatin e mëposhtëm) dhe deklaroi, *inter alia*, se:

> *"50. Në kërkesat nr. DS603997 & DS500011, paraqitësi i kërkesës është palë e interesuar e cila nuk ka marrë pjesë në procedurën e shkallës së parë. Në atë procedurë, paraqitësit të kërkesës së kategorisë A i është miratuar riposedimi, ndërsa kërkesa konkurrente e kategorisë C është refuzuar. Paraqitësi i ankesës pretendon se ai e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi pronën në fjalë në bazë të kontratës së shitblerjes të cilën e ka lidhur me paraqitësin e kërkesës së kategorisë C. Paraqitësi i ankesës gjithashtu pretendon, pa dëshmi, se i padituri respektivisht paraqitësi i suksesshëm i kërkesës së kategorisë A nga procedura e shkallës së parë, nuk e ka humbur të drejtën e tij të pronësisë për shkak të diskriminimit por për shkak se është pushuar nga puna sepse nuk ka pasur kualifikime për inxhinier të makinerisë. Komisioni i shqyrtoi provat e prezantuara nga ty dyja palët dhe konkludon se prona në fjalë i është ndarë paraqitësit të kërkesës së kategorisë C edhe pse procedura administrative për ndarjen e pronës ende nuk është përfunduar. Për këtë arsye, paraqitësi i kërkesës së kategorisë C është vendosur në banesë në mënyrë të paligjshme sepse nuk e ka poseduar aktvendimin e kërkuar mbi ndarjen dhe kontratën e shfrytëzimit. Këto dokumente janë lëshuar pas vendosjes së tij në pronë. Rrethanat e dhëna gjithashtu tregojnë për diskriminimin e bërë kundër paraqitësit të kërkesës së kategorisë A. Rrjedhimisht, Komisioni konfirmon gjetjen e tij se i padituri e ka humbur pronën në fjalë për shkak të diskriminimit".*

35. Më 14 gusht 2008, parashtruesja e dytë dorëzoi një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës, si pasardhëse juridike e DÇPB-së, duke kërkuar përmbarimin e vendimeve të KKPB-së, me të cilat vërtetohet statusi i saj i kategorisë A dhe kthimin e të drejtës së shfrytëzimit të banesës.

36. Më 4 shtator 2008, AKP-ja me shkresën (Ref:02044/08/bi) iu përgjigj parashtrueses së dytë të kërkesës, si në vijim:

> *"Dëshirojmë të vërtetojmë pranimin e kërkesës tuaj për rikthimin e posedimit të 14 gushtit 2008, në lidhje me pronën e cila është objekt në kërkesë (HPCC/D/252/2006, të 31 marsit 2006). Me këtë ju njoftojmë se në procedurën e shkallës së parë Komisioni lëshoi një urdhër duke ju rikthyer posedimin e pronës kontestuese (HPCC/D/252/2006, të 31 marsit 2006). Por, pala tjetër ka paraqitur kërkesë pranë Komisionit të Drejtorisë për Çështje*

Pronësore dhe Banesore (në tekstin e mëtejmë: DÇPB) duke kërkuar rishqyrtimin e vendimit të shkallës së parë. KKPB-ja refuzoi këtë kërkesë për rishqyrtim dhe vërtetoi vendimin e saj të shkallës së parë. Gjithashtu, ju kemi njoftuar se urdhri i Komisionit hyn në fuqi nga data kur DÇPB-ja përcakton shumën e cila duhet të paguhet për banesat nga ana e parashtruesit të kërkesës, në përputhje me nenin 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

Megjithatë, ende nuk është përcaktuar procedura apo përqindja e kompensimit për këtë lloj të kërkesave që hyjnë në grupin e kompensimit të ndërsjellë. AKP-ja e cila ka trashëguar përgjegjësitë e DÇPB-së do t'ju informojë me kohë në lidhje me procedurën e kompensimit dhe më pastaj prona do të ju kthehet në posedim [...]".

37. Më 23 shkurt 2012, parashtruesja e dytë iu drejtua përsëri me një shkresë të re AKP-së, duke kërkuar përmbarimin e Vendimit HPCC/REC/81/2006 të 11 dhjetorit 2006.

38. Më 5 mars 2012, AKP-ja me një shkresë të re (Ref. 00327/12/fk/II) iu përgjigj parashtrueses së dytë në mënyrë pothuajse identike si në shkresën e parë të saj (Ref. 02044/08/bi), të 4 shtatorit 2008. Lidhur me mënyrën e përcaktimit të kompensimit që duhet të bëhet, AKP-ja theksoi se:

"AKP-ja ka aprovuar kriteret dhe procedurën e kompensimit si dhe ka bërë përpjekje për të siguruar fondet adekuate për zbatimin e dispozitave të nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 dhe vendimeve të KKPB-së lidhur me këtë lloj të kërkesës, por deri më tani nuk kanë arritur të sigurojnë fondet e nevojshme. AKP-ja do të vazhdojë të këmbëngulë për sigurimin e fondeve të nevojshme për zbatimin e programit të kompensimit. Sa më shpejt që kjo të arrihet, Agjencia do të ju kontaktojë në lidhje me zbatimin e vendimit të Komisionit".

39. Më 28 gusht 2012, parashtruesja e dytë e kërkesës iu drejtua me një shkresë koordinatorit të Misionit të EULEX-it për çështje pronësore, në të cilën kërkoi që EULEX-i t'i shfrytëzojë kompetencat e veta dhe ta përshpejtojë procedurën në AKP, me qëllim që të përmbarohet Vendimi HPCC/REC/81/2006, i 11 dhjetorit 2006.

40. Më 20 shtator 2012, koordinatori i Misionit të EULEX-it për çështje pronësore iu përgjigj parashtrueses së dytë të kërkesës. Në përgjigje thuhet:

"[...] Në lidhje me ankesën tuaj, dëshirojmë të theksojmë se me nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës është parashikuar se Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj (KEDNJ) janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.
[...]

Përveç kësaj, ju këshillojmë që me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është vërtetuar se ekzekutimi i ndonjë vendimi të marrë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e së drejtës për shqyrtim të drejtë publik.

Prandaj, nëse ju konsideroni se e drejta juaj kushtetuese për shqyrtim të drejtë publik, duke përfshirë edhe ekzekutimin e vendimit të marrë në dobinë tuaj, është shkelur për shkak të lëshimeve të institucioneve relevante të sundimit të ligjit në Kosovë për të ekzekutuar vendimin e lartpërmendur, atëherë ju këshillojmë që ju keni të drejtë të parashtroni ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me qëllim të mbrojtjes të së drejtave tuaja pronësore".

41. Më 13 shtator 2012, parashtruesja e dytë dorëzoi një kërkesë tek Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të saj dhe të përshpejtimit të procedurës së përmbarimit të vendimeve të KKPB-së. Kjo kërkesë ishte regjistruar nën numrin 388/2012, dhe më 21 shtator 2012, ajo u deklarua e pranueshme nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

42. Më 22 korrik 2013, parashtruesja e dytë iu drejtua përsëri AKP-së, me qëllim të njoftimit të tyre për vdekjen e burrit të saj dhe për të përsëritur kërkesën e saj për ekzekutimin e vendimeve të KKPB-së, duke i njohur asaj statusin e kategorisë A dhe të drejtën e kthimit të banesës në Pejë. Nuk ka asnjë shënim në shkresa për ndonjë përgjigje nga AKP-ja në këtë letër.

43. Më 24 korrik 2013, Institucioni i Avokatit të Popullit informoi parashtruesen e dytë lidhur me rezultatet e hetimit. Institucioni i Avokatit të Popullit thekson, *inter alia,* se*:*

"Më 31 janar 2013, Avokati i Popullit ka pranuar një përgjigje nga AKP-ja, ku theksohet se kërkesa e z. Tus është duke pritur ekzekutimin nga ana e AKP-së, si dhe që Agjencia së bashku me Qeverinë e Kosovës dhe donatorët bën përpjekje për krijimin e fondeve për zbatimin e këtyre vendimeve, por që ata aktualisht

nuk janë në gjendje të përcaktojnë datën kur vendimi në lidhje me kërkesën e z. Tus do të ekzekutohet.

[...]

Duke pasur parasysh se rasti i z. Tus është zgjidhur në përputhje me nenin 20 pika 1.3 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, Avokati i Popullit ka vendosur të ndërpresë hetimin në këtë rast."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

44. Si parashtruesi i parë ashtu edhe parashtruesja e dytë e kërkesës pretendojnë që në sistemin ekzistues ligjor të Kosovës, nuk ekziston mjeti efektiv juridik mbi bazën e të cilit do të ishte e mundur të parandalohet shkelja e mëtutjeshme e të drejtave të garantuara me Kushtetutë në rastet në fjalë (përveçse t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese të Kosovës), dhe i cili do të kishte ofruar zhdëmtim të drejtë për zvarritjen e pabazuar të procedurës së përmbarimit të vendimeve të KKPB -së, në pajtim me nenin 1.4. të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

45. Ty dy parashtruesit e kërkesës i drejtohen Gjykatës me kërkesën:

I. Që Gjykata t'i deklarojë kërkesat të pranueshme.

II. Që Gjykata të vërtetojë shkeljet e lartpërmendura të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të bëra në dëm të të dy parashtruesve:

- *Neni* 24 *[Barazia para Ligjit]*
- *Neni* 31 *[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]*
- *Neni* 32 *[E Drejta për Mjete Juridike]*
- *Neni* 46 *[Mbrojtja e Pronës]*
- *Neni* 54 *[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]*

46. Si dhe shkeljet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet e saj:

a) E drejta për një proces të rregullt nga neni 6 paragrafi 1 i Konventës, b) E drejta për zgjidhje efektive nga neni 13 i Konventës, c) E drejta e gëzimit paqësor të pasurisë nga neni 1 i Protokollit I të Konventës, d) E

drejta e gëzimit të së drejtave dhe lirive nga Konventa pa diskriminim mbi çfarëdo baze nga neni 14 i Konventës, e) E drejta për shtëpi dhe jetë familjare nga neni 8 i Konventës.

47. Parashtruesi i parë gjithashtu kërkon: *"Që në bazë të shkeljeve të vërtetuara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me ligjet të më kompensohet dëmi material dhe jo-material"*.

48. Parashtruesja e dytë,gjithashtu kërkon *"që Gjykata të urdhërojë AKP-në që URGJENTISHT të mundësojë zbatimin e vendimit të saj – dëbimin e shfrytëzuesit të paligjshëm dhe mundësimin e hyrjes në posedim të banesës për bartësin ligjor të së drejtës së shfrytëzimit – parashtruesin e kësaj kërkese"*.

Dispozita relevante ligjore

49. RREGULLORJA E UNMIK-UT NR. 2000/60, e 31 tetorit 2000, MBI KËRKESAT PRONËSORE DHE BANESORE DHE RREGULLAT E PROCEDURËS DHE TË PROVAVE TË DREJTORISË PËR ÇËSHTJE PRONËSORE DHE BANESORE SI DHE TË KOMISIONIT PËR KËRKESA PRONËSORE DHE BANESORE

Neni 4
RIKTHIMI I TË DREJTËS SË BANIMIT NË BANESA SHOQËRORE TË HUMBURA SI PASOJË E DISKRIMINIMIT

4.1 Ky nen vlen për çfarëdo të drejte banimi në banesat shoqërore, të cilat janë anuluar si pasojë e diskriminimit.

4.2 Si përjashtim nga neni 3.3, përkitazi me një banesë shoqërore të cilën pastaj e ka blerë pronari aktual nga dhënësi i banesës në shfrytëzim, sipas Ligjit për banim (më tej: "pronari i parë"), do të vlejnë rregullat e mëposhtme:

(a) Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë pronësie mbi banesën pasi t'ia ketë paguar Drejtorisë:

(i) Çmimin e blerjes së banesës, i cili figuron në kontratën e shitjes të bërë nga pronari i parë, ose

(ii) Çmimin me të cilin paraqitësi i kërkesës do të kishte pasur të drejtë ta blinte banesën, sipas Ligjit mbi banesat, sikur të mos kishte diskriminim (çfarëdo çmimi të cilin Drejtoria e vlerëson si më të vogël), plus një përqindje të vlerës aktuale të banesës në treg, të përcaktuar nga Drejtoria, si dhe koston e çdo përmirësimi që ka bërë në banesë pronari i parë.

(b) Për ta gëzuar të drejtën e kthimit në lloj, paraqitësi i kërkesës duhet t'ia paguajë Drejtorisë shumën nga paragrafi 4.2(a) në afat prej 120 ditësh pas vendimit të Komisionit për të drejtën e kthimit. Me kërkesë të paraqitësit të kërkesës, Drejtoria mund ta zgjasë afatin deri në 120 ditë të tjera, nëse paraqitësit të kërkesës kjo do t'i shkaktonte vështirësi financiare. Me të paguar të kësaj shume, Komisioni lëshon vendimin me anë të të cilit paraqitësi i kërkesës shpallet pronar i banesës.

(c) Paratë e paguara në pajtim me paragrafin 4.2 (b) i mban Drejtoria në një fond të besuar. Pronarit të parë, i cili shpronësohet nga banesa, pas parashtrimit të kërkesës në bazë të këtij neni Drejtoria ia kompenson shumën nga fondi i besuar, të cilën ai/ajo e ka paguar për blerjen e banesës dhe një përqindje nga vlera aktuale e banesës në treg, të përcaktuar nga Drejtoria, si dhe shpenzimet e çfarëdo përmirësimi që ai/ajo e ka bërë në banesë. Çdo detyrim i mbetur i pronarit të parë sipas Ligjit mbi banesat anulohet.

4.3 Përjashtimisht nga dispozitat e nenit të mësipërm, asnjë person, të drejtat e të cilit janë shkelur nga vendimi i Komisionit që përcakton kthimin në lloj nuk ka të drejtë në kurrfarë kompensimi.

4.4 Çdo paraqitës i kërkesës për të cilin Komisioni vlerëson se ka të drejtë në rikthimin e banesës shoqërore, por të cilit nuk i është caktuar kthimi në lloj në pajtim me nenin 4.2, i lëshohet një certifikatë nga Drejtoria në të cilën shënohet vlera aktuale e banesës në treg dhe gjendja e saj aktuale, duke zbritur këtu shumën të cilën paraqitësi i kërkesës do të duhej ta paguante për blerjen e banesës sipas Ligjit mbi banesat. Drejtoria i cakton rregullat për përcaktimin e këtyre shumave dhe të shumave të theksuara në nenin 4.2 (a) dhe (c).

4.5 Çdo person me certifikatë të lëshuar sipas nenit 4.4 të mësipërm ka të drejtë në kompensim të arsyeshëm, të barabartë me shumën e shënuar në certifikatë, e cila paguhet nga fondet që mund të grumbullohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës ose në çdo fond të krijuar për këtë qëllim prej kësaj rregulloreje. Mënyra e llogaritjes dhe e pagesës do të përcaktohen me akt të veçantë juridik.

Pranueshmëria e kërkesës

50. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesve, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesit e

kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

51. Në lidhje me kërkesat e parashtruesve, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton: *„Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.

52. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike, të parapara me ligj dhe në mungesë të ndonjë mjeti tjetër efektiv në dispozicion, ata iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për përmbarimin e Vendimeve të tyre përkatëse të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, përkatësisht Vendimit nr. HPCC/REC/91/2007, të 19 janarit 2007, dhe Vendimit nr. HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006.

53. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton se: *„Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të llogaritet në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht”*.

54. Gjykata në këtë rast dëshiron të theksojë se kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit prej 4 (katër) muajve nuk vlen në rastin e mospërmbarimit të vendimeve nga autoriteti publik (Shih, *mutatis mutandis,Iatridis kundër Greqisë, nr. 59493/00, GJEDNJ, Aktgjykimi i 19 tetorit 2000)*. GJEDNJ-ja thekson në mënyrë eksplicite se në një situatë të ngjashme, që paraqitet në rastin e *Iatridis* kundër *Greqisë*, rregulli i afatit kohor nuk vlen në rastin kur ekziston refuzimi i ekzekutivit që të pajtohet me vendimin konkret.

55. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton se: *„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij/saj të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar, dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”*.

56. Sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë treguar saktësisht se cilat të drejta kushtetuese pretendojnë se u janë shkelur me mospërmbarimin e vendimeve të KKPB-së në rastet e tyre.

57. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë në mënyrë legjitime të jenë viktima të mospërmbarimit të vendimeve të KKPB-së.

58. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuara; i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike; e kanë përmbushur kërkesën e dorëzimit të kërkesës brenda afatit si rezultat i situatës së vazhdueshme dhe se i kanë sqaruar me saktësi shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive, si dhe i janë referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje me realizimin e të drejtave të tyre për gëzimin dhe posedimin e pronës.

59. Pasi që parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret procedurale sipas Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës, Gjykata konsideron se kërkesa është e pranueshme për shqyrtim meritor.

Meritat e kërkesës

60. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të të drejtave kushtetuese të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe me nenet relevante të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenin 6 paragrafi 1 [E Drejta për një proces të rregullt], nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive], nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit], nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së [Mbrojtja e pronës].

61. Gjykata në këto raste do të shqyrtojë meritat e kërkesës në bazë të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe të nenit 54 të Kushtetutës [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

Sa i përket shkeljes së pretenduar të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

62. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kryesisht pretendojnë se zvarritja dhe mospërmbarimi i Vendimit nr. HPCC/REC/91/2007, të 19 janarit 2007, dhe Vendimit HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006, shkelin të drejtat e tyre për gjykim të drejtë.

63. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës, i cili përcakton:

1. *„Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike".*

2. *„Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".*

64. Përveç kësaj, neni 6.1 [E Drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së, parasheh:

„Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj".

65. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 54 të Kushtetutës, i cili parasheh:

„Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".

66. Në rastet konkrete, sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079 të Republikës së Kosovës, Gjykata konstaton se AKP-ja është organ i vetëm përgjegjës dhe kompetent për përmbarimin e vendimeve të KKPB-së dhe vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës të AKP-së. Ky fakt është konfirmuar edhe nga përfaqësuesit e AKP-së, të cilët morën pjesë si palë në dëgjimin publik, të mbajtur më 10 mars 2014, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në Rastin nr. KI187/13.

67. Sa i përket parashtruesit të parë, Gjykata vëren që me Vendimin e KKPB -së, nr. HPCC/REC/91/2007 të 19 janarit 2007, atij i është njohur e drejta e parashtruesit të kategorisë C dhe, rrjedhimisht, atij i takojnë të gjitha të drejtat e parapara me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60, nenin 4.2, nën c, ku, *inter alia,* thuhet:

„[...] Parashtruesi i kërkesës së kategorisë C që humbi të drejtën e pronësisë mbi banesën, sipas dispozitave të këtij neni ka të drejtë të kërkojë nga Drejtoria që ti paguhet si kompensim një sasi të cilën ai ose ajo e ka paguar për blerjen e banesës, përqindjen e

vlerës së banesës në treg, siç është përcaktuar nga Drejtoria, si dhe shpenzimet e rinovimeve të mundshme që ai ose ajo ka investuar në banesë [...]".

68. Prandaj, Gjykata vërtetoi në mënyrë të pakontestueshme se parashtruesit të parë, me Vendimin e KKPB -së, nr. HPCC/REC/91/2007 të 19 janarit 2007, i është njohur e drejta e kompensimit, të cilën ai ende nuk e ka realizuar përkundër skadimit të të gjitha afateve të arsyeshme, të lidhura me të drejtën për gjykim të drejtë.

69. Sa i përket parashtrueses së dytë, Gjykata vëren se me Vendimin e KKPB -së nr. HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006, asaj i është njohur e drejta e parashtruesit të kategorisë A dhe rrjedhimisht asaj i takuan të gjitha të drejtat të cilat i ka fituar mbi këtë bazë, e të cilat parashihen me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60, nenin 4.2, nën a.

70. Prandaj, Gjykata pas shqyrtimit të Vendimit HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006, vërtetoi në mënyrë të pakontestueshme se parashtrueses së dytë i është njohur e drejta e shfrytëzimit të banesës në fjalë, të cilën ajo mund ta realizojë pasi që ta paguajë shumën e përcaktuar nga DÇPB (tani AKP), të gjitha këto në afat prej 120 ditësh, siç parashihet me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60, nenin 4.2, nën a, ku thuhet:

> *"(a) Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë pronësie mbi banesën mbasi t'ia ketë paguar Drejtorisë:*
>
> *(i) Çmimin e blerjes së banesës, i cili figuron në kontratën e shitjes të bërë nga pronari i parë, ose*
>
> *(ii) Çmimin me të cilin paraqitësi i kërkesës do të kishte pasur të drejtë ta blente banesën, sipas Ligjit mbi banesat, sikur të mos kishte diskriminim (çfarëdo çmimi të cilin Drejtoria e vlerëson si më të vogël), plus një përqindje të vlerës aktuale të banesës në treg, të përcaktuar nga Drejtoria, si dhe koston e çdo përmirësimi që ka bërë në banesë pronari i parë.*
> *...."*

71. Duke kërkuar përmbarimin e këtyre vendimeve, parashtruesit e kërkesës iu drejtuan disa herë me shkrim AKP-së, si pasardhëses juridike të DÇPB -së, me kërkesë për përmbarimin e vendimeve të lartpërmendura. Përveç kësaj, parashtruesi i dytë iu drejtua edhe institucioneve të tjera të Republikës së Kosovës. Parashtruesit e kërkesës janë përpjekur vazhdimisht që të drejtën e tyre ta realizojnë

në rrugë institucionale, por këtë as pas më shumë se 7 (shtatë) vitesh nuk e kanë arritur.

72. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi ligjor i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim gjyqësor i formës së prerë, të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Interpretimi i neneve të lartpërmendura në mënyrë ekskluzive ka të bëjë me qasjen ndaj Gjykatës. Prandaj, joefektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte të cilat na sjellin para situatave që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit (neni 7 i Kushtetutës), parim të cilin autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë (Shih, *Vendimin e GJEDNJ-së në rastin Romoshov kundër Ukrainës, parashtresa nr. 67534/01, Aktgjykimi i 25 korrikut 2004*).

73. Gjykata konsideron se përmbarimi i një vendimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar me nenet e lartpërmendura (Shih, rastin *Hornsby kundër Greqisë,* Aktgjykimi i GJEDNJ i 19 marsit 1997, raportet 1997-11, f. 510, para. 40). Në rastin konkret, parashtruesit e kërkesës nuk do të duhej të ishin privuar nga përfitimi i vendimeve të formës së prerë, që ishin marrë në favor të tyre.

74. Asnjë autoritet nuk mund të arsyetojë moszbatimin e vendimeve me qëllim të fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit (Shih: *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës,* nr. 48553, § 72, ECHR 2002-VII, si dhe Ryabykh kundër Rusisë, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003-IX).

75. Autoritetet kompetente e kanë për obligim që të organizojnë një sistem efikas për zbatimin e vendimeve, që janë efektive në kuptimin ligjor dhe atë praktik, si dhe duhet të sigurojnë zbatimin e tyre në kohë të arsyeshme, pa vonesa të panevojshme (Shih, *Pecevi kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008,Martinovska kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 22731/02, 25 shtator 2006*).

76. Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të përcaktojë se cila është mënyra më e përshtatshme që AKP-ja, në kuadër të kompetencave që ka, t'i gjejë mekanizmat efikas të natyrës ekzekutive, në kuptim të përmbushjes së plotë të detyrimeve që përcaktohen me ligj dhe me Kushtetutë. Megjithatë, çdo individ gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj (Shih, nenin 54 të Kushtetutës). Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 në nenin 4.2 nën c, kishte paraparë krijimin e një fondi (Shih,

paragrafin 63 pika 5) si një prej mekanizmave të mundshëm për përmbarimin e vendimeve të veta (c) *"Paratë e paguara në pajtim me paragrafin 4.2 (b) i mban Drejtoria në një fond të besuar [...]"*.

77. Gjykata në bazë të shqyrtimit të Raportit vjetor për punën e Agjencisë Kosovare të Pronës të vitit 2013, në faqen 24, në kapitullin 5.B. *Zbatimi i Skemës së Kompensimit*, ku thuhet "*[...]se me qëllim të financimit të pagesës është krijuar një fond i posaçëm në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës*".

78. Gjykata dëshiron të theksojë se në Rastin KI187/13, tashmë është marrë me vlerësimin e kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të vendimeve të KKPB-së dhe se më 1 prill 2014, nxori aktgjykimin në të cilin konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe nenit 54 të Kushtetutës, si dhe shkelje të së drejtës së parashtruesve të kërkesës për gëzimin paqësor të pronës së tyre, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të GJEDNJ-së (*Shih, Rastin KI187/13 N. Jovanović, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të Vendimit të Kolegjit të ankesave të Gjykatës Supreme, GSK-KPA-A-001/12, të 8 majit 2012, dhe të Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. HPCC/D/A/114/2011, të 22 qershorit 2011*).

79. Gjykata konsideron se kompleksiteti i krijimit të një sistemi të akteve nënligjore dhe fondeve për përmbarimin e vendimeve në përputhje me nenin 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 ka mundur të arrihet në një periudhë prej 14 (katërmbëdhjetë) vitesh, dhe me shtyrjen e mëtutjeshme nuk mund të gjendet një arsye e vlefshme me të cilën do të arsyetohej moszbatimi i masave ligjore të cilat janë vendosur me mandatin, së pari të DÇPB-së, dhe më vonë të AKP-së.

80. Prandaj, barra e mospërmbarimit dhe mosgjetjes së mekanizmave përkatës për përmbarimin e këtyre dy vendimeve të formës së prerë, Vendimit nr. HPCC/REC/91/2007 të 19 janarit 2007, dhe Vendimit HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006, bie vetëm mbi AKP-në. Mungesa e mekanizmave implementues të këtij institucioni, në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë arsye për mohimin e të drejtës së parashtruesve të kërkesës për gëzimin e pronës.

81. Prandaj, Gjykata është e mendimit se AKP-ja, si pasardhëse juridike e DÇPB-së, në aspektin e të drejtave dhe obligimeve të marra përsipër, e ka edhe obligimin që t'i përmbarojë vendimet e KKPB -së, si dhe të gjitha pretendimet e trashëguara që janë krijuar gjatë mandatit të DÇPB-së, dhe të cilat në pajtim me ligjin kanë kaluar si obligim në AKP.

Sa i përket shkeljes së pretenduar të së drejtës për mbrojtje të pronës

82. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ka pasur edhe shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës parasheh:

1) "E drejta e pronës është e garantuar.

2) Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3) Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona (...)"

[...]

Neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, parasheh:

„Çdo preson fizik apo juridik ka të drejtën të gëzojë në mënyrë paqësore zotërimet e tij. Askush nuk do të privohet nga zotërimet e veta përveçse në interes të publikut dhe kur është subjekt i kushteve të përcaktuara me ligj e sipas parimeve të përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare.

Dispozitat e mësipërme, sidoqoftë, nuk do të cenojnë në asnjë mënyrë të drejtën e një Shteti për të zbatuar ligjet, të cilat i vlerëson si të nevojshme për kontrollin e përdorimit të pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm apo për të siguruar pagesën e taksave e kontributeve apo gjobave të tjera".

83. Sa i përket shkeljes së pretenduar e cila ka të bëjë me mbrojtjen e pronës, Gjykata konstaton se vendimi i KKPB-së përbën pritje legjitime për parashtruesit e kërkesës, se të njëjtit e kanë të drejtën mbi atë pronë. Prandaj, parashtruesit e kërkesës kanë të drejtë ta gëzojnë në mënyrë paqësore atë pronë, ashtu siç garantohet me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane. Në këto rrethana, atyre iu është mohuar e drejta e gëzimit dhe posedimit të pronës (Shih, *mutatis mutandis, Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke* (dec.), nr. 39794/98, para. 73, GJEDNJ 2002-VII).

84. Prandaj, Gjykata konstaton se si pasojë e mospërmbarimit të vendimeve të HPCC/REC/91/2007 dhe HPCC/REC/81/2006, parashtruesve të kërkesës u është mohuar e drejta për gëzimin paqësor

të pronës së tyre, duke shkelur nenin 46 të Kushtetutës, dhe nenin 1, Protokollit 1, të KEDNJ-së.

PËRFUNDIM

85. Si përfundim, mospërmbarimi i vendimeve të KKPB-së nga AKP-ja dhe dështimi i autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për të siguruar mekanizma efikas për përmbarimin e vendimit të formës së prerë, është në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit dhe përbën shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

86. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se mospërmbarimi i vendimeve të formës së prerë, Vendimit nr. HPCC/REC/91/2007 të 19 janarit 2007, dhe Vendimit nr. HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006, përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe të nenit 54 të Kushtetutës.

87. Për më tepër, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës, nga zvarritja dhe mospërmbarimi i Vendimitnr. HPCC/REC/91/2007 të 19 janarit 2007, dhe Vendimit HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006, janë privuar pa të drejtë nga e drejta në pronën e tyre. Në këtë mënyrë janë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës për të gëzuar në mënyrë paqësore pronën e tyre, të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së;

III. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 54 të Kushtetutës;

IV. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së;

V. DEKLARON se Vendimi nr. HPCC/REC/91/2007 i 19 janarit 2007, dhe Vendimi nr. HPCC/REC/81/2006, i 11 dhjetorit 2006 duhet të përmbarohen nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP);

VI. URDHËRON Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) që në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës të Gjykatës, ta njoftojë Gjykatën Kushtetuese sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj, lidhur me masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;

VIII. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IX. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI61/14, Parashtrues Faik Tërnava - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 195/2013, i 10 janarit 2014

KI61/14, Aktvendim për papranueshmëri i 2 korrikut 2015, publikuar më 19 gusht 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, kompensim monetar, procedurë civile, legjitimiteti aktiv dhe pasiv, gjykim i drejtë dhe i paanshëm, pasurimi i pabazë*

Gjykata Supreme e Kosovës kishte nxjerrë vendim që detyronte parashtruesin e kërkesës t'i kthente mjetet financiare Komunës së Vushtrrisë. Parashtruesi u ankua në Gjykatën kushtetuese – pa iu referuar ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti – për shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të drejtës në pronë.

Gjykata Kushtetuese vërejti se procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta nuk kishin qenë të padrejta dhe se në disa raste, ato kishin nxjerrë vendime të favorshme për parashtruesin. Gjykata, po ashtu, vërejti se parashtruesi nuk kishte precizuar kërkesën e tij mjaftueshëm, dhe për më tepër, nuk kishte arritur që pretendimet e tij t'i mbështesë me prova konkrete. Gjykata shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI61/14
Parashtrues
Faik Tërnava
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 195/2013,
të 10 janarit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Faik Tërnava nga Vushtrria (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), i cili përfaqësohet nga z. Nexhat Beqiri, avokat nga Vushtrria.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin (Rev. nr. 195/2013, të 10 janarit 2014) e Gjykatës Supreme i cili i ishte dorëzuar atij më 13 shkurt 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa e parashtruesit për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, nëpërmjet të cilit Gjykata Supreme kishte refuzuar pjesërisht kërkesën e tij për revizion lidhur me *"pasurim të pabazë"*.

4. Parashtruesi në kërkesën e tij nuk i referohet ndonjë të drejte apo lirie të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) që mund t'i jetë shkelur.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 31 mars 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 3 prill 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI61/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI61/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 16 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi atij që të dorëzojë autorizimin për përfaqësim për z. Nexhat Beqiri, të cilin ai e kishte deklaruar si përfaqësues të tij. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.

9. Më 22 maj 2014, parashtruesi e dorëzoi në Gjykatë dokumentin e kërkuar.

10. Më 2 korrik 2015, Kolegjishqyrtuesshqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Nga viti 1999 deri në vitin 2000, parashtruesi pohon se ka punuar në Komunën e Vushtrrisë respektivisht, Komisionin për hetimin e krimeve të luftës dhe personave të humbur (në tekstin e mëtejmë: Komisioni).

12. Ky Komision, sipas parashtruesit ishte formuar nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës, me Vendimin [pa numër] e 5 korrikut 1999. Në bazë të këtij vendimi, kryetari i Këshillit Komunal të Vushtrrisë kishte autorizuar parashtruesin që të punojë në Komisionin përkatës.

13. Meqë, Komuna e Vushtrrisë nuk i ishte përgjigjur kërkesave të parashtruesit për kompensim me të holla, ai, së bashku me disa persona të tjerë, ushtruan padi në Gjykatën Komunale në Vushtrri me

kërkesën që t'u bëhet pagesa për punën e kryer si pjesëtarë të Komisionit.

14. Më 5 korrik 2002, Gjykata Komunale në Vushtrri (Aktgjykimin C. nr. 13/2001) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit dhe të paditësve të tjerë, dhe urdhëroi Komunën e Vushtrrisë që t'ua paguajë shumën e kërkuar të vlerës monetare, duke përfshirë kamatën ligjore, të gjithë paditësve përfshirë parashtruesit, për punën e kryer si pjesëtarë të Komisionit.

15. Komuna e Vushtrrisë, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

16. Më 11 dhjetor 2002, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë (Aktgjykimi Ac. nr. 93/2002), refuzoi si të pabazuar ankesën e ushtruar nga Komuna e Vushtrrisë dhe vërtetoi Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

17. Komuna e Vushtrrisë, kundërAktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, ushtroi revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve procedurale të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe të aplikimit të gabuar të ligjit material.

18. Në ndërkohë, përderisa kërkesa për revizion e Komunës së Vushtrrisë akoma po shqyrtohej nga Gjykata Supreme, parashtruesi kishte parashtruar kërkesë për përmbarim të Aktgjykimit (C. nr. 13/2001, të 5 korrikut 2002) të Gjykatës Komunale të Vushtrrisë, pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Kjo e fundit kishte vërtetuar si të drejtë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Vushtrrisë.

19. Më 5 mars 2003, Gjykata Komunale në Vushtrri (Vendimi E. nr. 59/2003) lejoi propozimin për përmbarim, me të cilin ishte aprovuar kërkesëpadia e parashtruesit dhe e paditësve të tjerë për pagesë të një shume të caktuar të mjeteve financiare nga Komuna e Vushtrrisë.

20. Më 11 shtator 2003, pra disa muaj më vonë, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 48/2003) aprovoi si të bazuar revizionin e ushtruar nga Komuna e Vushtrrisë, duke vendosur kështu për ndryshimin e Aktgjykimit (C. nr. 13/2001, të 5 korrikut 2002) të Gjykatës Komunale të Vushtrrisë dhe Aktgjykimit (Ac. nr. 93/2002, të 11 dhjetorit 2002) të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Gjykata Supreme kishte arsyetuar vendimin e saj me sa vijon:

"Gjykata Supreme e Kosovës nuk mund të pranojë një qëndrim të tille të gjykatave të instancës me të ulët, nga se sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimet e goditura janë marr me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Në bazë të Rezolutës së Kombeve të

Bashkuara 1244 dhe rregullores së UNMIK-ut të 1999/01 dhe 1999/24, pas luftës është krijuar një realitet i ri në Kosovë. [...] Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/45 [...] janë përcaktuar organet e vetëqeverisjes së komunave dhe shërbimi civil komunal. Për faktin se paditësit nuk posedojnë kontrata për krijimin e detyrimeve, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, në rastin konkrete gabimisht është zbatuar e drejta materiale, prandaj aktgjykimet e dy gjykatave u ndryshuan, ashtu qe kërkesëpadia e paditësve u refuzuar si e pabazuar. [...] Sipas vlerësimit të Gjykatës së revizionit, mungesa e legjitimitetit real pasiv të komunës së paditur, del nga gjendja e cila ekziston në shkresat e lendes dhe gjykata, sipas detyrës zyrtare, porsa ta vërtetoje mungesën e legjitimitetit aktiv ose pasiv të palës ndërgjyqëse, do ta refuzoje me aktgjykim si te pabazuar kërkesëpadinë e paditësve".

21. Pas kësaj, Komuna e Vushtrrisë ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Vushtrri, me kërkesë për kthimin e mjeteve financiare të paguara parashtruesit, nga xhirollogaria e tij, sipas Vendimit (E. nr. 59/2003, të 5 marsit 2003) të Gjykatës Komunale të Vushtrrisë.

22. Më 11 korrik 2005, Gjykata Komunale në Vushtrri (Aktgjykimi C. nr. 18/2004) aprovoi kërkesëpadinë e Komunës së Vushtrrisë, tani paditësja, duke obliguar parashtruesin që në emër të pasurimit të pabazë t'ia paguajë Komunës së Vushtrrisë shumën e pranuar të mjeteve financiare, në xhirollogarinë zyrtare të saj, me kamatë përkatëse vjetore, duke filluar nga 10 shkurti 2004, deri në pagesën definitive.

23. Parashtruesi parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar që i njëjti është nxjerrë me *"shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale"*.

24. Më 7 mars 2013, Gjykata e Apelit në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 678/2012) refuzoi ankesën e ushtruar nga parashtruesi duke konstatuar që *"gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore e as aplikim të gabuar të së drejtës materiale [...]"*.

25. Parashtruesi, parashtroi revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme duke kërkuar prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe kthimin e çështjes në rigjykim.

26. Më 10 janar 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 195/2013) refuzoi revizionin e parashtruesit si të pabazuar në pjesën që kishte të

bëjë me detyrimin e tij për të paguar shumën e caktuar të mjeteve financiare, në emër të pasurimit të pabazë, duke konfirmuar kështu obligimin e tij për të kthyer mjetet e pranuara.

27. Gjykata Supreme, nëpërmjet vendimit të lartpërmendur, pranoi si të bazuar revizionin e parashtruesit vetëm përkitazi me lartësinë e kamatës së vendosur nga ana e Gjykatës Komunale në Vushtrri (Aktgjykimi C. nr. 18/2004, të 11 korrikut 2005), duke e ndryshuar kështu këtë Aktgjykim vetëm për sa i përket lartësisë së kamatës që parashtruesi duhet të paguaj. Në arsyetimin e saj, Gjykata Supreme theksoi me sa vijon:

> *"Gjykata Supreme e Kosovës, i ka vlerësuar si të pabazuara thëniet e të padituri*t [parashtruesit] *në revizion, se të hollat i ka marrë nga Komuna e Vushtrrisë, në bazë të aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët, dhe se për ato të holla ka kryer punën në komisionin e komunës, se të hollat i ka pranuar me mirëbesim dhe se nuk është në obligim që ato ti kthej. Këto thënie të revizionit janë të pa bazuara nga se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët në bazë të cilave të padituri iu ka bërë pagesa në procedurën e përmbarimit janë ndryshuar, ashtu që është refuzuar kërkesëpadia [...]. Andaj, me të drejtë gjykatat e instancës më të ulët kanë konkluduar se i padituri është pasuruar pa bazë juridike në kuptim të nenit 210 par.1 e 2 të LMD, ndërsa sipas paragrafit 4 të këtij neni, detyrimi i kthimit të hollave krijohet edhe kur diçka pranon duke pasur parasysh bazë juridike e cila më vonë është shuar.*
>
> *Mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës, gjen se me vendimin përkitazi me kamatën e pranuar, është zbatuar në mënyrë jo të drejt dispozita e nenit 277 të LMD, nga se kjo kamatë nuk është caktuar në përputhshmëri me dispozitat ligjore [...]. Andaj, duke u nisur nga fakti se lidhur me kamatën e pranuar, aktgjykimi i shkallës së parë është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale [...] i njëjti aktgjykim në këtë pjesë u ndryshua në bazë të nenit 224 par.1 të LPK ".*

Pretendimet e parashtruesit

28. Siç u përmend më lart, parashtruesi nuk i referohet ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë e cila mund t'i jetë shkelur.

29. Parashtruesi, në mënyrë të përgjithshme, pretendon se *"[...] gjykatat kanë qenë të njëanshme dhe se procedurat e zhvilluara pas aktgjykimit Rev. nr 48/2003 kanë qenë të padrejta, meqenëse kanë shkelur të drejtën time që për punën time të marrë shpërblim*

monetar dhe [gjykatat] *kanë aplikuar gabimisht rregulloret e UNMIK-ut për kompetencat e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, pra edhe të Këshillit Komunal të Vushtrrisë".*

30. Në kërkesën e tij parashtruesi thekson: "*Konsideroj se kem punuar në bazë të Vendimit të Këshillit Komunal dhe autorizimit të tij, ku të njëjtat komisione kan funksionuar në tërë Kosovën jan paguar në bazë të vendimit të Qeverisë së Përkohshme e formuar sipas Rregulloreve të UNMIK-ut".*

31. Më tutje, parashtruesi thekson se "*[...]dispozitat ligjore kanë lejuar punën e kryer nga une dhe anëtarët e tjerë të komisionit kështu që nuk ka baza ligjore që ato veprime të ndërmarra të mos aprovohen si punë [...]*".

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrtonnëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton se:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

34. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi ka specifikuar aktin konkret të autoritetit publik që konteston, respektivisht Aktgjykimin (Rev. no. 195/2013, të 10 janarit 2014) e Gjykatës Supreme, ashtu siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka përmendur ndonjë të drejtë apo liri të garantuar me Kushtetutë e cila mund të pretendohet se i është shkelur nga ana e Gjykatës Supreme.

35. Gjykata po ashtu vëren separashtruesi, në kërkesën e tij, nuk ka deklaruar asgjë lidhur me atë se çfarë kërkon nga Gjykata Kushtetuese apo çfarë është pasqyra e zgjidhjes që kërkon nëpërmjet kërkesës së tij.

36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij;

[...]

37. Siç u përmend më lart, parashtruesi konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit (Rev. nr. 195/2013, të 10 janarit 2014) të Gjykatës Supreme nëpërmjet të cilit ishte refuzuar, pjesërisht, kërkesa e tij për revizion dhe, rrjedhimisht, ishin konfirmuar Aktgjykimi (Ac. nr. 678/2012, i 7 marsit 2013) i Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimi (C. nr. 18/2004, i 11 korrikut 2005) i Gjykatës Komunale në Vushtrri për sa i përket pasurimit të pabazëtë parashtruesit.

38. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi përveç pretendimeve të përgjithshme se "*gjykatat kanë qenë të njëanshme*", ai nuk ka paraqitur asnjë arsyetim procedural apo substantiv në kërkesën e tij. Ai nuk i është referuar asnjë të drejte të garantuar me Kushtetutë duke mos dëshmuar kështu në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij se gjykatat kanë qenë të njëanshme.

39. Gjykata rikujton se, fillimisht, gjykatat e rregullta kishin miratuar kërkesëpadinë e parashtruesit duke obliguar kështu Komunën e Vushtrrisë që t'ia paguajë parashtruesit shumën e kërkuar të mjeteve financiare për punën që kishte kryer si anëtar i Komisionit. Gjykatat e rregullta po ashtu kishin miratuar kërkesën e parashtruesit për përmbarim dhe, si rezultat, ai kishte pranuar mjetet financiare në xhirollogarinë e tij.

40. Megjithatë, Gjykata gjithashtu rikujton se, më vonë, pas kërkesës për revizion të parashtruar nga Komuna e Vushtrrisë, Gjykata Supreme kishte ndryshuar vendimet e gjykatave të instancës më të ulët, si dhe kishte anuluar Vendimin për lejim të përmbarimit. Pas këtij vendimi, Komuna e Vushtrrisë kishte paditur parashtruesin për pasurim të pabazë, duke kërkuar kthimin e mjeteve të pranuara nga ai.

41. Më tutje, Gjykata vëren se Gjykata Komunale kishte miratuar kërkesëpadinë e Komunës së Vushtrrisë për *"pasurim të pabazë"* të parashtruesit dhe e kishte detyruar këtë të fundit që të kthejë gjithë shumën e të hollave që kishte pranuar në xhirollogarinë e tij, së bashku me kamatën e përcaktuar nga Gjykata. Këtë vendim të Gjykatës Komunale e kishte konfirmuar më pas Gjykata e Apelit.

42. Në vazhdim, Gjykatapo ashtu vëren se edhe Gjykata Supreme kishte konfirmuar vendimin e Gjykatës Komunale dhe asaj të Apelit për sa i përket *"pasurimit të pabazë"* të parashtruesit, duke i ndryshuar ato, vetëm për sa i përket mënyrës së përllogaritjes së kamatës ligjore. Në vendimin e saj, Gjykata Supreme kishte theksuar se:

> *"[...] me të drejtë gjykatat e instancës më të ulët kanë konkluduar se i padituri është pasuruar pa bazë juridike në kuptim të nenit 210 par.1 e 2 të LMD, ndërsa sipas paragrafit 4 të këtij neni, detyrimi i kthimit të hollave krijohet edhe kur diçka pranon duke pasur parasysh bazë juridike e cila më vonë është shuar. [...]"*

43. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kishin arsyetuar vendimet e tyre në bazë të dispozitave ligjore, dhe i ishin përgjigjur kërkesave të parashtruesit që kishin të bëjnë me pretendime për *"shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit të procedurës kontestimore", "vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike"* si dhe *"aplikimit të gabuar të së drejtës materiale"*.

44. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson që nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmëria) që pretendohen të jenë
bërë nga autoritetet publike, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të
drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

45. Gjykata Kushtetuese gjithashtu rithekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta ose nga autoritetet tjera publike. Roli i gjykatave të rregullta është, në rastet kur është e aplikueshme, t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, paragrafi 28; shih, gjithashtu Gjykata Kushtetuese në Rastin Kl70/11, të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima,* Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

46. Gjykata Kushtetuesemundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi dhe, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë, sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, 10 korrik 1991).

47. Gjykata konsideron se procedurat në Gjykatën Komunale, Gjykatën e Apelit dhe refuzimi i pjesshëm i kërkesës së parashtruesit për revizion nga Gjykata Supreme kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, KEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

48. Si rrjedhojë, Gjykata konsideron se pretendimet e përgjithshme të parashtruesit se gjykatat e rregullta kanë qenë të anshme pa iu referuar asnjë të drejte apo lirie të garantuar sipas Kushtetutës, janë të paargumentuara dhe të padëshmuara, prandaj janë qartazi të pabazuara.

49. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d), kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, më 10 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI69/14, Bajram Zogiani - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 276/2013, i 18 nëntorit 2013

KI69/14, Aktvendim për papranueshmëri i 3 korrikut 2015, publikuar më 19 gusht 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, barazia para ligjit, e drejtat në punë, e drejtat në gjykim të drejtë, legjitimiteti pasiv, suksedimi juridiko-ligjor, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit përkitazi me dëmin, që ai kishte pësuar nga ndërprerja e marrëdhënies së punës. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të së drejtës në punë, gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe barazi para ligjit.

Gjykata Kushtetuese vërejti se parashtruesi vetëm sa i përmend parimet kushtetuese përgjithësisht, por pa i mbështetur ato me prova konkrete. Gjykata Kushtetuese ritheksoi, se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit që pretendohen të jenë kryer nga autoritetet publike, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë. Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën si qartazi të pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI69/14
Parashtrues
Bajram Zogiani
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 276/2013, të 18 nëntorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Bajram Zogiani, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit (Rev. nr. 276/2013 të 18 nëntorit 2013) të Gjykatës Supreme me të cilin, u refuzua, si e pabazuar kërkesa e parashtruesit për revizion.

3. Vendimi i kontestuar iu dorëzua parashtruesit më 28 janar 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht me *"nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] si dhe të drejtat e tij të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), përkatësisht me*

nenin 6 [E Drejta për Gjykim të Drejtë] dhe nenin 13 [E Drejta për Zgjidhje Efektive]".

5. Parashtruesi po ashtu i referohet Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, si dhe Kartës Sociale Evropiane pa cituar ndonjë nen të veçantë të këtyre dy dokumenteve. Ai vetëm i referohet *"të drejtave të punëtorit për kompensim"* në përgjithësi.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 14 prill 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 6 maj 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI69/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI69/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

9. Më 26 maj 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që të dorëzojë një kopje të fletëkthesës që dëshmon datën kur i është dorëzuar Aktgjykimi (Rev. nr. 276/2013, të 18 nëntorit 2013) i Gjykatës Supreme. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

10. Më 29 maj 2014, parashtruesi dorëzoi dokumentin e kërkuar nga Gjykata.

11. Më 12 shtator 2014, parashtruesi me vetiniciativën e tij dorëzoi informata shtesë në Gjykatë.

12. Më 26 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI69/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović si gjyqtar raportues në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu të cilit mandati si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese i mbaroi më 26 qershor 2015. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin nr. KSH. KI69/14, e caktoi veten si anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Ivan Čukalović.

13. Më 3 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Parashtruesi, para vitit 1999, ishte në marrëdhënie pune në ndërmarrjen publike Elektroekonomia e Kosovës. Ai ishte në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në cilësinë e Sekretarit të repartit "Montimi Kosova".

15. Më 6 shator 1990, Elektroekonomia e Kosovës (Aktvendimi nr. 1448) e pezulloi parashtruesin nga puna për shkak të shkeljeve të obligimeve të punës, deri sa të përfundonte procedura për përcaktimin e shkeljeve të supozuara.

16. Më 14 shtator 1990, kundër vendimit të lartpërmendur, parashtruesi parashtroi kundërshtim në organet gjegjëse pranë Elektroekonomisë së Kosovës.

17. Më 1 tetor 1990, Elektroekonomia e Kosovës (Vendimi nr. 1776) refuzoi si të pabazuar kundërshtimin e parashtruesit dhe vërtetoi aktvendimin e marrë për pezullimin e tij nga puna. Të njëjtën ditë, Elektroekonomia e Kosovës nxori edhe një Vendim tjetër (nr. 1769) nëpërmjet të cilit e largoi parashtruesin nga puna.

18. Në vitin 1991, parashtruesi e paditi Elektroekonominë e Kosovës në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar [gjykata kompetente për çështje pune] duke kërkuar anulimin e vendimit për largimin e tij nga puna. Nga shkresat e lëndës, duket që parashtruesi nuk arriti të marrë vendim përfundimtar lidhur me padinë e iniciuar.

19. Më 1 korrik 1999, Elektroekonomia e Kosovës u rikonstituua në Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK). Parashtruesi mori një pozitë pune në KEK, ekuivalente me vendin e tij të mëparshëm të punës në Elektroekonominë e Kosovës.

20. Më pas, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë për përtëritjen e shkresave të lëndës, që kishte mbetur pa u vendosur nga gjykatat e mëparshme kompetente.

21. Më 10 prill 2006, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktvendimi C1. nr. 440/93) miratoi kërkesën e parashtruesit për përtëritjen e shkresave të lëndës.

22. Pas marrjes së vendimit për përtëritjen e shkresave të lëndës, parashtruesi parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër KEK-ut. Ai kërkoi anulimin e Vendimit (Nr. 1769, të 1 tetorit 1990) të Elektroekonomisë së Kosovës nëpërmjet të cilit ishte larguar nga puna dhe pagesën e pagave mujore nga 1 tetori 1990, data kur ishte larguar nga puna, deri më 1 korrik 1999, data kur ishte kthyer sërish në punë.

23. Më 14 maj 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimin C1. nr. 124/2006) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të bazuar dhe anuloi si të kundërligjshëm Vendimin (nr. 1769, të 1 tetorit 1990) e Elektroekonomisë së Kosovës për largim nga puna të parashtruesit. Me atë rast, Gjykata Komunale e obligoi KEK-un që parashtruesit t'ia paguajë pagat mujore në vonesë, sipas kërkesëpadisë së tij, duke përfshirë shpenzimet e procedurës.

24. KEK-u parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale *"për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale"*. Nëpërmjet kësaj ankese, KEK kërkoi nga Gjykata e Apelit që ta ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe ta refuzojë padinë e parashtruesit si të pabazuar.

25. Më 14 qershor 2013, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ac. nr. 5140/2012) aprovoi ankesën e KEK-ut dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale me arsyetimin në vijim:

> *"[...] Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë mbi aprovimin e kërkesë padisë së paditësit si të rregullt dhe të ligjshëm nuk e aprovon edhe Gjykata e apelit [...].*
> *[...] Gjykata e apelit gjen se tani e paditura* [*KEK*] *nuk është pjesëmarrëse në raportin juridik detyrimor në këtë çështje juridike, nuk janë subjekt në raportin materialo juridik nga i cili për paditësin derivon e drejta e tij dhe mbi këtë bazë, nuk ekziston sukcesioni juridik në mes të ish Kosova Mont Elektroekonomia e Kosovës [...] me tani të padituren Korporatën Energjetike të Kosovës në Prishtinë. Pra të padituës i mungon legjitimiteti real pasiv në çështje juridike dhe për këtë arsye kërkesëpadia ndaj të padituës është e pabazuar. [...] Në të vërtetë e paditura nuk ka cilësinë e punëdhënësit në raportin me paditësin përkatësisht organi i të padituës nuk ka ndërmarr veprime të kundërligjshme me të cilat është dëmtuar paditësi për shkak të mos realizimit të ardhurave personale për periudhën lëndore, por ky dëm i është shkaktuar me veprimet e paligjshme të ish organeve të Kosova Mont Elektroekonomia e Kosovës i cili e kishte cilësinë e*

punëdhënësit dhe i cili e ka kompensuar para periudhës kontestuese të ardhurat personale paditësit. […]".

26. Parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit *"për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale".*

27. Më 18 nëntor 2013, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 276/2013) refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të paraqitur nga parashtruesi, me arsyetimin si në vijim:

> *"[…] Gjykata e shkallëssë dytëdrejtë ka zbatuar dispozitën e nenit 201 al 1 pika (d) të LPK-së* [Ligji për Procedurën Kontestimore] *kur ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si pabazuar pasi që pas luftës është krijuar një realitet i ri në Kosovë, tani e paditura nuk mund të jetë palë në procedurë, pasi që paditësi është larguar nga puna me vendimet e Elektroekonomisë të Serbisë, vendim ky i RS të Serbisë, të publikuar në (Gazetën Zyrtare të RS të Serbisë", nr. 19.7.1990) në kohë kur është bërë ndërrimi i strukturës udhëheqëse dhe është caktuar organ i dhunshëm.*
> *[…]*
> *Thëniet në revizion se, vet fakti se pas luftës paditësit i është vazhduar marrëdhënia e punës tek e paditura në të njëjtin vend të punës, qëndron detyrimi i të paditurës për kompensimin e dëmit të cilin e ka pësuar paditësi për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë të kundërligjshme, është e papranueshme, për faktin se e paditura nuk ka përgjegjësi, respektivisht nuk ka detyrim për kompensimin e të ardhurave personale të parealizuara, i cili dëm i është shkaktuar nga veprimet e kundërligjshme të "Kosova Mont" Elektroekonomia e Kosovës […]".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme, me rastin e refuzimit të kërkesës së tij për revizion, i ka *"shkelur të drejtat dhe interesat nga marrëdhënia e punës, të mbrojtura me Kushtetutë dhe ligje".*

29. Si rrjedhojë, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ për sa i përket *"parimeve të përgjithshme, barazisë para ligjit, të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtës për mjete juridike, të drejtës në punë dhe ushtrim të profesionit".*

30. Lidhur me këto pretendime, parashtruesi thekson se: *"Kërkesën time e mbështes edhe në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë Nr. C1. Nr. 124/2006, të dt: 14.05.2010 me të cilin [...] është konstatuar se KEK është trashigimatare dhe suksesore e të gjitha aseteve por edhe të drejtave dhe obligimeve të Elektroekonomisë së Kosovës."* Në lidhje me këtë, ai kërkon nga Gjykata që *"duke u bazuar në këtë Aktgjykim të drejtë të Gjykatës Komunale kërkoj që të më bëhet pagesa e pagave [...]"*.

31. Parashtruesi pretendon se rasti i tij është i ngjashëm me rastin KI08/09 (Shih KI08/09, *Sindikata e pavarur e punonjësve të Fabrikës sëÇelikut* – IMK Ferizaj, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2010). Lidhur me këtë rast, parashtruesi i referohet paragrafëve 19, 20, 21, 48, 51, 60 dhe 66 të këtij aktgjykimi.

32. Më tutje, parashtruesi ka paraqitur në Gjykatë disa vendime të gjykatave të rregullta në Kosovë të cilat, sipas tij, janë të ngjashme ose identike me rastin e tij dhe për të njëjtat padi gjykatat e rregullta kanë vendosur "*në favor të paditësve*". Duke u bazuar në këto vendime, ai kërkon nga Gjykata që "*të aplikohet praktika gjyqësore në mënyrë që "rastet e njëjta të vendosen njëjtë" dhe të mos bëhet diskriminim në këtë rast ndaj meje"*.

33. Përfundimisht, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën në vijim:

> *"[...]*
>
> *a) të shpallë kërkesën time të pranueshme, dhe*
> *b) të veprohet sipas Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C1 Nr. 124/2006 të dt: 14.05.2010, me të cilin është aprovuar kërkesëpadia ime dhe për këtë kërkoj: pagesën e pagave mujore duke filluar nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës me dt: 01.10.1990 deri në ditën e kthimit tim në punë më 01.07.1999 [...]"*.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë*

cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

36. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:

[...]

(b) aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose [...]
(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

37. Siç u cek më lart, parashtruesi konteston Aktgjykimin (Rev. nr. 276/2013, të 18 nëntorit 2013) e Gjykatës Supreme duke pretenduar shkelje të drejtave të tij që kanë të bëjnë me parimet e përgjithshme, barazinë para ligjit, të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për mjete juridike, të drejtën për punë dhe ushtrim të profesionitsiç garantohen me Kushtetutë, respektivisht me KEDNJ.

38. Gjykata në rastin konkret vëren se, në thelb, kërkesa kryesore e parashtruesit është që të lihet në fuqi Aktgjykimi (C1. nr. 124/2006, i 14 majit 2010) i Gjykatës Komunale në Prishtinë, i cili ishte në favor të tij, dhe i cili sipas parashtruesit *"është aktgjykimi i drejtë"*.

39. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit arsyetoi vendimin e saj, kur ajo ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të pabazuar, duke iu referuar dispozitave të ligjit. Për më tepër, Gjykata, gjithashtu vëren se në procedurën e vlerësimit të kërkesës së parashtruesit për revizion, Gjykata Supreme e arsyetoi vendimin e saj lidhur me pretendimet e veçanta të parashtruesit të ngritura kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

40. Përkitazi me këtë, Gjykata rikujton edhe arsyetimin e Gjykatës Supreme në përgjigjen ndaj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, që pretendohet të jetë kryer nga Gjykata e Apelit. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme theksoi:

"[...] në rastin konkret [pretendimi se] *ekziston kontinuitet i marrëdhënies së punës së paditësit tek e paditura dhe se e paditura* [KEK-u] *ka legjitimitetin pasiv të palëve në kontest pasi*

që është trashëgimtare juridike e ish ndërmarrjes ku ka punuar paditësi është i papranueshëm, për faktin se, pala ka legjitimitet lëndor vetëm nëse është pjesëmarrëse e marrëdhënies materialo-juridike nga e cila ka lindur kontesti. E paditura në këtë rast nuk ka legjitimitet pasiv pasi që ajo paditësit nuk i ka ndërprerë marrëdhënien e punës dhe nuk është palë e marrëdhënies materialo-juridike, kështu që paditësi nuk ka të drejtë të kërkojë mbrojtje ligjore të drejtës subjektive të cenuar. […]".

41. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson që nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmëria) që pretendohen të jenë bërë nga autoritetet publike, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

42. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta ose nga autoritetet tjera publike. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, paragrafi 28; shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese në rastin Kl70/11, të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima and Bestar Hima,* Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

43. Gjykata Kushtetuese mund vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë ashtu që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, 10 korrik 1991).

44. Gjykata gjen se procedurat në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, KEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

45. Veç kësaj, Gjykata vëren separashtruesi pretendon se rasti i tij është i ngjashëm me rastin nr. KI08/09 (Shih rastin KI08/09, *Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut – IMK Ferizaj*, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2010). Megjithatë, ai nuk jep asnjë argument apo sqarim shtesë lidhur me këtë pretendim.

46. Duke u bazuar në dokumentet e dorëzuara dhe të procedurave të zhvilluara, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit ndryshon nga aktgjykimi i lartpërmendur duke pasur parasysh që ky i fundit kishte të bënte me mosekzekutimin e një vendimi i cili kishte marrë

formën e prerë dhe si i tillë ishte bërë *res judicata*; ndërsa, rasti i parashtruesit nuk lidhet me mosekzekutimin e një vendimi të formës së prerë, por me vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin, parashtruesi është i pakënaqur.

47. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit se rasti i tij është i ngjashëm me rastin nr. KI08/09 është i pabazuar.

48. Në fund, Gjykata vëren se parashtruesi po ashtu ka paraqitur në Gjykatë disa vendime të gjykatave të rregullta në Kosovë të cilat i ka cilësuar si *"shembuj"* në bazë të të cilëve pretendohet se do duhej të veprojë edhe kjo Gjykatë në mënyrë që "*të aplikohet praktika gjyqësore [...]"*.

49. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata thekson se *"[...] përveç në rast të arbitraritetit të dukshëm, nuk është roli i Gjykatës që të vërë në pikëpyetje interpretimin e të drejtës vendore nga gjykatat shtetërore (shih, për shembull Ādamsons kundër Letonisë, nr. 3669/03, para. 118, 10 maj 2007). Ngjashëm, në këtë kuptim, parimisht nuk është funksioni i saj që të krahasojë vendimet e ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse janë nxjerrë në procedura dukshëm të ngjashme; gjykatat duhet të respektojë pavarësinë e atyre gjykatave (shih Engel dhe të tjerët kundër Holandës, 8 qershor 1976, para. 103, Seria A nr. 22; Gregório de Andrade kundër Portugalisë, nr. 41537/02, para. 36, 14 nëntor 2006; dhe Ādamsons, cituar si më lart, para. 118)."*

50. Më tutje, Gjykata vëren se vendimet e dorëzuara të gjykatave të rregullta u përkasin procedurave të ndryshme para gjykatave të rregullta dhe nuk paraqesin në mënyrë të domosdoshme vendime përfundimtare, dhe si të tilla nuk janë relevante për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar.

51. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se pretendimi i parashtruesit se rasti i tij është i ngjashëm me vendimet e dorëzuara të gjykatave të rregullta është i pabazuar.

52. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtavedhe lirive të tij të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ janë të pabazuara dhe të padëshmuara, dhe si të tilla janë qartazi të pabazuara.

53. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata gjen se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës nuk e arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin për shkelje të të drejtave kushtetuese dhe se parashtruesi nuk i ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 10 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI180/14, Parashtrues Fehmi Pajaziti - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit CPP. nr. 5/2014, të Gjykatës Supreme të Kosovës, i 9 shtatorit 2014

KI180/14, Aktvendim për papranueshmëri i 8 korrikut 2015, publikuar më 19 gusht 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, e drejta në pronë, pension invalidor, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës kishte miratuar kërkesën për revizion të punëdhënësit (KEK) të parashtruesit të kërkesës, për moskompensimin e disa pagesave ndaj parashtruesit përkitazi me pensionimin e parakohshëm invalidor. Parashtruesi i kërkesës pretendon, se Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe të drejtën në mbrojtje të pronës siç garantohen me Kushtetutë, pa iu referuar ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Gjykata Kushtetuese vërejti se parashtruesi nuk ka dhënë asnjë arsyetim procedural ose material dhe se ai vetëm pohon shkeljet kushtetuese, pa shpjeguar me tej se si kanë ndodhur ato shkelje. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese konstatoi se procedurat e zhvilluar në gjykatat e rregullta i kishin ofruar parashtruesit gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI180/14
Parashtrues
Fehmi Pajaziti
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CPP. nr. 5/2014, të 9 shtatorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Fehmi Pajaziti, nga fshati Hajvali, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin (CPP. nr. 5/2014, të 9 shtatorit 2014) e Gjykatës Supreme të Kosovës, nëpërmjet të cilit ishte refuzuar kërkesa e tij për përsëritje të procedurës lidhur me padinë që kishte iniciuar për kompensimin e një shume të caktuar të mjeteve financiare.

3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 31 tetor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e tij të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht *"nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojta e Pronës] në lidhje*

nenin 1 të Protokolloit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeritu (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ)".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 15 dhjetor 2014, parashtruesi parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI180/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI180/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 20 janar 2015, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 8 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Nga shkresat e lëndës vërehet se parashtruesi ishte i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK), pa u përmendur se në çfarë pozicioni ishte i punësuar.

11. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi paraqiti kërkesë për pension të parakohshëm invalidor pranë KEK-ut.

12. Më 1 nëntor 2008, KEK-u (Vendimi nr. 171/133) miratoi kërkesën e parashtruesit për pension të parakohshëm invalidor, si dhe pranoi që në emër të këtij pensioni t'ia paguajë parashtruesit një shumë të caktuar të mjeteve financiare në muaj, duke filluar nga 1 nëntori 2003 deri më 1 dhjetor 2008.

13. Pas 1 dhjetorit 2008, KEK-u ndaloi së paguari shumën e caktuar të mjeteve financiare.

14. Si rrjedhojë e këtij veprimi të KEK-ut, parashtruesi parashtroi padi kundër kësaj të fundit në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Ai kërkoi kompensim të pagesave mujore për vazhdimin e pensionimit invalidor, nga 1 dhjetori 2008 deri më 30 tetor 2009, respektivisht, deri në ditën kur parashtruesi hyn në kategorinë e pensionit të pleqërisë.

15. Më 2 nëntor 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C1. nr. 423/2008) miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të bazuar, dhe detyroi KEK-un që t'ia paguajë parashtruesit shumën e kërkuar të mjeteve financiare me kamatë ligjore përkatëse. Sipas Gjykatës Komunale, KEK-u kishte ndërprerë pagesën mujore në mënyrë të kundërligjshme.

16. KEK-u parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

17. Me 22 prill 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi Ac. nr. 618/2010), e refuzoi ankesën e KEK-ut si të pabazuar dhe konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale.

18. Kundër këtij aktgjykimi, KEK-u parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme *"për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale",* me propozimin që të ndryshohen dy vendimet e gjykatave më të ulëta, dhe që kërkesëpadia e parashtruesit të refuzohet si e pabazuar.

19. Më 26 shtator 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 262/12) pranoi, si të bazuar kërkesën për revizion të KEK-ut, dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe atë të Gjykatës Komunale, si dhe refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e saj, Gjykata Supreme theksoi:

> "*[...] një qëndrim i tillë juridik i gjykatave të instancës më të ulët nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm, sepse vlersimi i kësaj gjykate mbi gjendjen e tillë të vërtetuar faktike, gabimisht është zbatuar e drejta materiale.*
> *Nga Vendimi nr. 171/133, datë 23.10.2003, rrjedh se paditësi* [parashtruesi] *vetë ka aplikuar për fitimin e pensionit-invalid kategoria 1, dhe sipas këtij vendimi pagesa e pensionit ka filluar nga data 01.11.2003 dhe përfundon me 01.12.2008.*
> *Gjykata Supreme vlerëson se pas pagesës së kësaj page në kohëzgjatje prej 60 muaj, e padituara* [KEK-u] *më tutje nuk ka asnjë obligim, ngase ka përmbushë obligimin ligjor i cili rrjedh nga vendimi i cekur. [...]".*

20. Më 20 shkurt 2013, parashtruesi parashtroi kërkesë për përsëritjen e procedurës në Gjykatën Supreme.

21. Më 9 shtator 2014, Gjykata Supreme (Aktvendim CPP. nr.5/2014) refuzoi, si të pabazuar kërkesën e paditësit, për përsëritje të procedurës, me arsyetimin se:

> *"[...] Paditësi kërkesën (propozimin) për përsëritjen e procedurës e ka paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar e jo të drejtë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljes së të drejtës të ndërprerjes së pensionit invalidor, të cilat si bazë ligjore nuk janë paraparë me asnjë dispozitë ligjore për mjetin e jashtëzakonshëm të përsëritjes së procedurës.*
> *Neni 232 i LPK-së* [Ligji për Procedurën Kontestimore] *parasheh se procedura e përfunduar me aktgjykim dhe aktvendim të formës së prerë të Gjykatës mund të përsëritet sipas propozimit të palës sipas pikave a, b, c, d, e, f dhe g, të nenit të cekur, dhe sipas kësaj kërkese të parashtruesit për përsëritjen e procedurës nuk është plotësuar asnjëri prej kushteve ligjoretë parapara me nenin e cekur".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe të drejtën në mbrojtje të pronës, siç garantohen me Kushtetutë, respektivisht KEDNJ.

23. Parashtruesi nuk jep ndonjë sqarim shtesë lidhur me këto pretendime. Ai vetëm paraqet një përshkrim të fakteve në kërkesën e tij, dhe më pas i drejtohet Gjykatës me kërkesën si në vijim:

> *"[...] të aprovohet kërkesa dhe të anulohet Aktvendimi i Gjykatës Supreme CPP nr. 5/2014 dhe Aktgjykimi Rev. nr. 262/12".*

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 të Rregullores së punës.

Neni 48 i Ligjit

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Rregulli 36 i Rregullores së punës

"[...] (1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: [...] (d) kërkesa arsyetohet prima facie *ose nuk është qartazi e pabazuar. (2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

26. Gjykata rikujton se parashtruesi konteston Aktvendimin (CPP. nr. 5/2014, të 9 shtatorit 2014) e GjykatësSupreme, me pretendimin se me anë të tij i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe e drejta për mbrojte të pronës, të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

27. Në të vërtetë, parashtruesi vetëm thekson në mënyrë të përgjithshme se i janë shkelur këto të drejta dhe kërkon që të anulohet vendimi i kontestuar, si dhe Aktgjykimi (Rev. nr. 262/2012, i 26 shtatorit 2012) i Gjykatës Supreme.

28. Gjykata vëren se në kërkesën e tij, parashtruesi nuk ka dhënë asnjë arsyetim procedural ose material; ai vetëm pohon pretendimet e lartpërmendura, pa shpjeguar më tej se si kanë ndodhur ato shkelje.

29. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se fillimisht, Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut kishin miratuar kërkesëpadinë e parashtruesit dhe kishin urdhëruar KEK-un që të bëjë pagesat për muajt që ishin kontestues, përkatësisht nga 1 dhjetori 2008 deri më 30 tetor 2009.

30. Megjithatë, Gjykata po ashtu vëren se Gjykata Supreme (Rev. nr. 262/2012, i 26 shtatorit 2012) kishtepranuar kërkesën për revizion të parashtruar nga KEK-u, në cilësinë e të paditurës, si dhe kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit. Me atë rast, Gjykata Supreme kishte konsideruar se gjykatat e instancës më të ulët kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe se KEK-u kishte përmbushur çdo obligim ndaj parashtruesit në datën kur kishte ndaluar së paguari pagesat në emër të pensionit invalidor. Gjykata Supreme i kishte arsyetuar gjetjet e veta, duke u bazuar në Vendimin (nr. 171/133, të 23 tetorit 2003) e KEK-ut sipas të cilit "*pagesa e pensionit ka filluar nga data 01.11.2003 dhe përfundon me 01.12.2008*".

31. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e ka hedhur poshtë si të pabazë kërkesën e parashtruesit për përsëritje të procedurës në rastin e tij, me arsyetimin se "*[...]nuk është plotësuar asnjëri prej kushteve ligjore të parapara me nenin 232 të LPK-së [...]*".

32. Gjykata vlerëson se procedurat në Gjykatën Supreme, kanë qenë të drejta dhe se të dyja vendimet janë të arsyetuara dhe të argumentuara.

33. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstaton se procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesit i është ofruar gjykim i drejtë. (Shih, *inter alia*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 13071/87, i 10 korrikut 1991; dhe, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

34. Për më tepër, parashtruesi nuk e ka treguar me qartësi si dhe pse vendimet e kontestuara, me të cilat është hedhur poshtë kërkesa e tij për përsëritje të procedurës, përbënin shkelje të të drejtave dhe lirive të tij individuale të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, si dhe nuk ka paraqitur prova të cilat arsyetojnë pretendimin për një shkelje të tillë.

35. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabime të fakteve apo të Ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga autoritetet publike, përveç nëse, dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

36. Gjykata Kushtetuese përsëritë se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt për sa i përket vendimeve të gjykatave të rregullta, apo autoriteteve të tjera publike. Është detyrë e gjykatave të rregullta ose autoriteteve të tjera publike, aty ku është e mundshme, t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ], Aktvendim i 21 janarit 1999. *S*hih, gjithashtu, Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin nr. KI70/11, i 16 dhjetorit 2011, *Parashtrues*: *Faik Hima, Magbule Hima, dhe Bestar Hima*).

37. Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie*, e cila dëshmon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, Vendim i GJEDNJ-së, Nr. 53363/99, i 31 majit 2005) dhe nuk ka treguar se si nenet e Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, të cilëve u

referohet, e mbështesin pretendimin e tij, ashtu siç kërkohet nga neni 113.7 i Kushtetutës dhe neni 48 i Ligjit.

38. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mbrojtje të pasurisë janë të paargumentuara dhe të padëshmuara, dhe për këtë arsye janë qartazi të pabazuara.

39. Mbështetur në arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, më 10 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI20/15, Parashtrues Organizata joqeveritare FINCA Kosovë - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 205/2014, i 14 tetorit 2014

KI20/15, Aktvendim për papranueshmëri i 31 korrikut 2015, publikuar më 19 gusht 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, Masë e përkohshme, kontest pune, kompensim i pagave, kthim në vend të punës, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm*

Gjykata Supreme e Kosovës kishte nxjerrë vendim që detyronte parashtruesin, që ish punonjësen e tyre ta kthente në punë dhe t'ia kompensonte pagat e papaguara. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese kryesisht për shkelje të drejtës në punë dhe profesion, siç garantohet me nenin 49 të Kushtetutës dhe të drejtën për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 6 të Konventës. Parashtruesi, po ashtu, kërkoi vënien e Masës së përkohshme.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parashtruesi nuk kishte arritur që në mënyrë kushtetuese të argumentonte se si dhe pse, Gjykata Supreme kishte cenuar të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë. Gjykata Kushtetuese vërejti se pretendimet e parashtruesit ishin pretendime të natyrës ligjore dhe jo të nivelit kushtetues. Gjykata Kushtetuese, po ashtu, refuzoi kërkesën e parashtruesit për vënien e Masës së përkohshme. Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI20/15
Parashtrues
Organizata joqeveritare FINCA Kosovë
Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 205/2014, të 14 tetorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është organizata joqeveritare FINCA Kosovë, të cilën e përfaqëson z. Vigan Rogova, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 205/2014, të 14 tetorit 2014 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), të cilin e ka pranuar më 9 dhjetor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar Rev. nr. 205/2014, të 14 tetorit 2014, përkitazi me pretendimet e parashtruesit për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dheUshtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, përkitazi me pezullimin e procedurave përmbarimore.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22, 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 25 shkurt 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 10 prill 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e saj iu dërgua Gjykatës Supreme.

8. Më 12 prill 2015, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. GJR. KI20/15, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI20/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Ivan Čukalović (anëtar).

9. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI20/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues, në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, të cilit i ka përfunduar mandati i gjyqtarit më 26 qershor 2015 dhe, me Vendimin KSH. KI20/15, Kryetarja, zëvendësoi gjyqtarin Ivan Čukalović në përbërjen e Kolegjit shqyrtues.

10. Më 6 korrik 2015, Kolegjishqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 25 shtator 2000, parashtruesi lidhi kontratë pune me të punësuarën Sh. K. përkitazi me postin e punës analist i kredive.

12. Më 21 mars 2011, parashtruesi vendosi të punësuarës t'ia ndërpresë kontratën e punës, për shkak të vonesave të kthimit të kredive.

13. Më 18 maj 2011, e punësuara, kundër vendimit për ndërprerjen e kontratës së punës ushtroi padi në Gjykatën Komunale të Prizrenit, duke kërkuar anulimin e vendimit, si të paligjshëm, dhe kthimin e saj në vendin e punës.

14. Më 13 shtator 2012, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi, C. nr. 290/11) përkitazi me padinë e të punësuarës, vendosi si më poshtë: I. Aprovoi pjesërisht padinë e të punësuarës; II. Anuloi, si të paligjshëm

vendimin e parashtruesit të 21 marsit 2011, përkitazi me ndërprerjen e kontratës së punës së të punësuarës; III. Detyroi parashtruesin që t'ia paguajë paditëses 14 (katërmbëdhjetë) paga të papaguara, në shumë mujore prej 1,000.00 € dhe në shumë të përgjithshme prej 14,000.00 €; IV. Detyroi parashtruesin që t'ia paguajë paditëses shpenzimet e procedurës gjyqësore, në shumë prej 606.00 €; dhe V. Refuzoi kërkesëpadinë e të punësuarës për kthim në vendin e punës.

15. E punësuara, kundër këtij aktgjykimi, kishte ushtruar të drejtën e ankesës në gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), përkitazi me pikën III dhe V të dispozitivit të Aktgjykimit.

16. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prizrenit në afatin ligjor, ankesë kishte ushtruar edhe parashtruesi, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material.

17. Më 7 prill 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi, Ac. nr. 4342/2012), refuzoi, si të pabazuara, ankesat e ushtruara nga e punësuara si dhe nga parashtruesi, duke vërtetuar kështu Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prizrenit.

18. Parashtruesi, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, kishte ushtruar revizion në Gjykatën Supreme, me propozimin që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ose të prishet, dhe çështja të kthehet në rigjykim.

19. Po ashtu, edhe e punësuara, kishte ushtruar kërkesë për revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave kontestimore dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, duke kërkuar ndryshimin e pikës III dhe V të Aktgjykimit, përkitazi me kompensimin e të gjitha pagave të papaguara dhe kthimin e saj në vendin e punës.

20. Më 14 tetor 2014, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 205/2014 dhe vendosi: të refuzojë revizionin e ushtruar nga parashtruesi në pikën I dhe II të aktgjykimit; të aprovojë revizionin e parashtruesit në pikën III të aktgjykimit përkitazi me kompensimin e pagave të papaguara; të prishë aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët në pikën IV të dispozitivit dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së instancës së parë për rishqyrtim dhe rigjykim për këtë pikë; të aprovojë revizionin e të punësuarës përkitazi me pikën V të dispozitivit të aktgjykimit për kërkesën për kthim në vendin e punës.

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, shkeli të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, për shkak se *"... Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. Nr. 205/2014 të datës 9 Dhjetor 2014 e ka privuar parashtruesin e kërkesës nga të drejtat e tij Kushtetuese qe rrjedhin nga neni 49 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit".*

22. Parashtruesi gjithashtu i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, në Rastin KO131/12.

23. Parashtruesi pretendon se *"Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, me rastin e vendosjes për kthim në vendin e punës të paditëses është marr në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit të Punës, e qe ka të bëj me Vendosjen gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës".*

24. Për më tepër parashtruesi nga Gjykata kërkon: "*Të shpall kërkesën të pranueshme; Të konstatoj që ka pasur shkelje të nenit 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 205/2014 datë 14 Tetor 2014; Të kthejë këtë Aktgjykim të Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate; Të merr masën e përkohshme për pezullimin e të gjitha veprimeve përmbarimore dhe procedurave".*

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata Kushtetuese, para se ta shqyrtojë kërkesën e parashtruar, duhet së pari të vlerësojë nëse kërkesa e parashtruesit i ka përmbushur kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

26. Për këtë kërkesë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

27. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) (d) i Rregullores së punës parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".

28. Për më tepër, rregulli 36 (2) i Rregullores së punës parasheh:

"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

29. Gjykata, në këtë rast, vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, me Aktgjykimin e saj Rev. nr. 205/2014, ka shkelur të drejtat e parashtruesit, të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke aluduar se kthimi i paditëses në vendin e punës dhe kompensimi i saj ishte në kundërshtim me dispozitat e lartpërmendura, si dhe në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit të punës (Nr. 03/L-212) të Republikës së Kosovës.

30. Sa i përket pretendimit të parashtruesit për shkeljen e nenit 49 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata, konsideron se një pretendim i tillë nga ana e parashtruesit, nuk paraqet bazë kushtetuese të argumentuar dhe të arsyetuar, që kushtimisht do t'i lejonte Gjykatës që të lëshohej më tutje në vlerësimin e meritave të kërkesës. Parashtruesi nuk ka qartësuar, si dhe pse, Gjykata Supreme mori vendim, duke shkelur të drejtat e parashtruesit të garantuara me dispozitat e lartpërmendura të Kushtetutës, dhe të KEDNJ-së.

31. Gjykata thekson se, për të pasur një rast të argumentueshëm, që ngre shkelje kushtetuese, parashtruesi duhet të dëshmojë dhe provojë se procedurat në gjykatat e rregullta, përkatësisht në Gjykatën Supreme, shikuar në tërësinë e tyre, nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur dhe në pajtueshmëri me kërkesat e një gjykimi të drejtë, apo që shkeljet e tjera të të drejtave kushtetuese të jenë kryer nga ana e Gjykatës Supreme, gjatë procesit të gjykimit.

32. Ndërsa, sa i përket pretendimeve të parashtruesit përkitazi me shkeljen e dispozitave të ligjit material, Gjykata konsideron se një pretendim i tillë i përket fushës së ligjshmërisë dhe jo kushtetutshmërisë.

33. Gjykata, kujton se nuk është detyrë e saj të vlerësojë ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave të rregullta, siç është në rastin konkret interpretimi i ligjit, nëse urdhri për kompensim ose kthimin e paditëses në punë ishte i bazuar në ligj. Marrëdhëniet kontraktuale dhe ato të punës janë të rregulluara me ligj, dhe interpretimi i dispozitave të këtyre ligjeve është edhe juridiksion i gjykatave të rregullta, posaçërisht i Gjykatës Supreme si instancë më e lartë e gjyqësorit të rregullt.

34. Në këtë kontekst, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe të së drejtës materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz vs. Spain* [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

35. Gjykata konsideron se arsyetimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme është i gjerë, gjithëpërfshirës dhe përmban arsyetim të detajuar se përse është dashur që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, të vërtetohen, të prishen apo të ndryshohen në disa pika të dispozitivit të aktgjykimeve.

36. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë, dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur një gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

37. Prandaj, Gjykata në rastin konkret, nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub vs. Lithuania*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

38. Parashtruesi, gjithashtu kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, gjegjësisht të pezullojë të gjitha veprimet dhe procedurat e përmbarimit lidhur me çështjen e tij.

39. *Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, që përcakton:*

"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës".

[...]

40. *Gjykata më tutje konstaton se, pasi që kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar dhe shpallet e papranueshme, kërkesa për Masë të përkohshme nuk mund të jetë më objekt i shqyrtimit para Gjykatës, prandaj kërkesa për vendosjen e Masës së përkohshme duhet të refuzohet.*

41. Nga të gjitha arsyet e shtjelluara më lart, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar dhe duhet shpallur si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 27 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) (d), 36 (2) (d), 54, 55 dhe 56 (2, 3) të Rregullores së punës, më 31 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI55/14, Parashtrues Baton Morina - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Zyrës së Prokurorit të Shtetit, KMLP. I. nr. 1/14 i 7 marsit 2014

KI55/14, Aktvendim për papranueshmëri i 10 gushtit 2015, publikuar më 20 gusht 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, barazia para ligjit, çështje e gjykuar, e drejtapër gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë qartazi e pabazuar, paanshmëria e prokurorit publik, përsëritje e procedurës penale*

Parashtruesi ishte dënuar për kryerjen e një vepre penale me dënim, me burgim prej 12 (dymbëdhjetë) vitesh dhe ky dënim ishte vërtetuar nga Gjykata Supreme. Parashtruesi kishte kërkuar përsëritje të procedurës penale duke pretenduar paanshmërinë e prokurorit publik, por kërkesa e tij ishte refuzuar nga gjykatat e rregullta të të gjitha instancave. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të barazisë para ligjit, të garantuar me Kushtetutë.

Gjykata Kushtetuese konstatoi, se për një pjesë të pretendimeve të parashtruesit, tashmë kishte nxjerrë një vendim dhe se nuk kishte bazë për nxjerrjen e një vendimi të ri. Kurse, për pretendimet tjera Gjykata Kushtetuese konstatoi se, gjykatat e rregullta dhe prokurori publik kishin arsyetuar mirë vendimet e tyre për moslejimin e përsëritjes së procedurës penale dhe se pretendimet e parashtruesit, ngrenë çështje të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë. Kërkesa u shpall e papranueshme në pajtim me rregullat 36 (2) (d) dhe 36 (3) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI55/14
Parashtrues
Baton Morina
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Zyrës së Prokurorit të Shtetit, KMLP. I. nr. 1/14, të 7 marsit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Baton Morina nga Gjakova (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.\

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Njoftimin (KMLP. I. nr. 1/14, të 7 marsit 2014) e Zyrës së Prokurorit të Shtetit nëpërmjet të cilit, i ishte refuzuar kërkesa për mbrojte të ligjshmërisë në lidhje me kërkesën për përsëritje të procedurës penale në rastin e tij.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa e parashtruesit për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, të cilat, pretendohen të kenë shkelur të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht me *"nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 24 [Barazia Para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafi 1"*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 26 mars 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 3 prill 2014, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI55/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI55/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

7. Më 28 prill 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzojë autorizimin për përfaqësim për z. Teki Bokshi. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës së Apelit një kopje të kërkesës.

8. Më 4 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësim.

9. Më 24 shtator 2014, Gjykata kërkoi nga parashtruesi që të specifikojë vendimet e kontestuara, dhe të dorëzojë në Gjykatë kopjet e vendimeve që ndërlidhen me rastin.

10. Më 9 tetor 2014, parashtruesi iu përgjigj kërkesës së Gjykatës duke dhënë disa sqarime shtesë lidhur me kërkesën e parashtruar në Gjykatë. Mirëpo, nuk dorëzoi kopjet e vendimeve të kontestuara.

11. Më 20 janar 2015, Gjykata i dërgoi një letër tjetër parashtruesit, duke kërkuar në mënyrë specifike nga ai që të dorëzojë në Gjykatë të dy vendimet e referuara nga parashtruesi në kërkesën e tij, por të cilat ai nuk i kishte dorëzuar në Gjykatë, përkatësisht:

    a) Aktvendimin (PK. nr. 198/13, të 20 nëntorit 2013) të Gjykatës Themelore në Pejë; dhe

    b) Aktvendimin (PN. nr. 736/13, të 10 dhjetorit 2013) të Gjykatës së Apelit.

12. Më 2 shkurt 2015, parashtruesi iu drejtua Gjykatës me kërkesën si në vijim: *"Lusë Gjykatën e nderuar të titulluar që të këtë mirëkuptim dhe menjëherë pasi që të siguroj shkresat, menjëherë do të ia dërgoj Gjykatës"*.

13. Më 18 shkurt 2015, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Zyrës së Prokurorit të Shtetit.

14. Më 20 shkurt 2015, Gjykata i dërgoi një letër tjetër parashtruesit nëpërmjet së cilës e njoftoi atë, që Gjykata do të vazhdojë shqyrtimin e kërkesës në bazë të informatave dhe dokumenteve që ka në dispozicion, në rast se ai nuk dorëzon dokumentet e kërkuara nga Gjykata në një afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të shkresës.

15. Më 5 mars 2015, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.

16. Më 26 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI69/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović si gjyqtar raportues në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu të cilit mandati si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese i mbaroi më 26 qershor 2015. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin nr. KSH. KI69/14, e caktoi veten si anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Ivan Čukalović.

17. Më 2 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

18. Më 23 qershor 2006, Gjykata e Qarkut në Pejë (Aktgjykimi P. nr. 80/06) shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak të kryerjes së dy veprave penale. Parashtruesi i kërkesës u dënua me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh.

19. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të lartpërmendur, në Gjykatën Supreme, duke kërkuar *"anulimin e aktgjykimit të ankimuar, si dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallën e parë."* Prokurori Publik i Qarkut në Pejë, gjithashtu, parashtroi ankesë kundër të njëjtit Aktgjykim duke kërkuar që *"dënimi i parashtruesit prej 4 (katër) vitesh burgim të zëvendësohet me një dënim më të ashpër"*.

20. Më 19 prill 2007, Gjykata Supreme [Aktgjykimi Ap. nr. 582/2006] e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe aprovoi ankesën e

Prokurorit Publik të Qarkut. Me atë rast Gjykata Supreme ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë vetëm sa i përket vendimit për dënim, me ç'rast dënoi parashtruesin nga 4 (katër) vjet me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim.

21. Më 31 dhjetor 2007, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Pkl. nr. 78/2007) refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë duke vlerësuar se *"shkalla e parë dhe shkalla e dytë kishin konstatuar drejtë faktet, se nuk kishte pasur shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe se dispozitat e ligjit penal ishin zbatuar drejtë"*.

Kërkesa e parë e parashtruesit për përsëritje të procedurës penale pranë gjykatave të rregullta

22. Më 29 janar 2011, parashtruesi paraqiti kërkesën e parë në Gjykatën e Qarkut në Pejë, për përsëritje të procedurës penale duke pretenduar se *"në procedurën e vendosjes lidhur me ankesën pranë Gjykatës Supreme [...] është dashur të jetë përjashtuar prokurori i çështjes për shkak të mungesës së paanshmërisë dhe subjektivizmit"*.

23. Më 13 shtator 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë (Aktvendimi P. nr. 80/06) refuzoi kërkesën e parashtruesit për përsëritje të procedurës penale duke arsyetuar se*"[...] nuk është paraqitur baza ligjore për rishikimin e procedurës penale siç kërkohet me nenin 444 par. 2 të KPPK-së* [Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale] *[...]"*.

24. Parashtruesi paraqiti ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, në Gjykatën Supreme.

25. Më 13 tetor 2011, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pn. nr. 530/2011) refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe arsyetoi si në vijim:

> *"[...] drejt ka vepruar gjykata e shkallës së parë kur kërkesën për rishikim të procedurës penale e ka refuzuar [...]. [...] nga procesverbali i shqyrtimin kryesor nuk shihet se është paraqitur ndonjë kërkesë për përjashtimin e prokurorit apo cilitdo pjesëmarrës në proceduren e zhvilluar në këtë çështje penalo-juridike dhe nuk ka indikacione se lidhur me prokurorin në fjalë është iniciuar ndonjë procedurë disiplinore apo penale që ndërlidhet me rastin konkret, andaj për tu konsideruar bazë ligjore për rishikimin të procedurës penale në kuptim të nenit 442 par.1 pika 1 e KPPK sipas par. 2 të po të njëjtit nen duhet të provohet se aktgjykimi është pasoj e veprës penale të kryer nga përsoni që ka kryer hetimet apo prokurori"*.

Procedura pranë Gjykatës Kushtetuese në Rastin nr. KI159/11

26. Më 9 nëntor 2011, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese [Shih, Rastin nr. KI159/11, *Baton Morina,* Aktvendim për papranueshmëri i 16 korrikut 2012] dhe kërkoi vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit (Pn. nr. 530/2011, të 13 tetorit 2011) të Gjykatës Supreme.

27. Parashtruesi i kërkesës pranë Gjykatës kishte pretenduar shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtës për mjete juridike, si dhe të drejtës për respektim të parimit të legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale. Parashtruesi po ashtu, ndër të tjera, kishte pretenduar që veprimet e Prokurorit Publik të Qarkut në Pejë *"kishin ndikim esencial që çështja të gjykohet në dëm të të pandehurit"* dhe se Prokurori Publik i Qarkut *"kishte keqpërdorur pozitën e tij zyrtare"* në procedurën penale të zhvilluar ndaj tij.

28. Më 16 korrik 2012, Gjykata vendosi për Rastin nr. KI159/11, duke e refuzuar kërkesën e parashtruesit për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartpërmendur si qartazi të pabazuar. Ndër të tjera, Gjykata arsyetoi se: *"Nuk është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë ligjshmërinë dhe saktësinë e provave të vendimeve të nxjerra nga gjykatat e rregullta [...]"* dhe se *"nuk ka juridiksion për të përsëritur procedurat gjyqësore apo në ndonjë mënyrë të zëvendësojë aktgjykimin e Gjykatës Supreme me konstatimet e veta"*.

Kërkesa e dytë e parashtruesit për përsëritje të procedurës penale pranë gjykatave të rregullta

29. Pas nxjerrjes së Aktvendimit të lartpërmendur nga Gjykata në Rastin KI159/11, parashtruesi parashtroi kërkesën e dytë për përsëritje të procedurës penale, këtë herë në Gjykatën Themelore në Pejë.

30. Parashtruesi e arsyetoi kërkesën e tij të dytë, duke paraqitur pretendimet e njëjta për mungesën e paanshmërisë së Prokurorit Publik të Qarkut në Pejë. Ai gjithashtu pretendoi që *"[...] janë zbuluar fakte të reja, që ka gjasa ta arsyetojnë pafajësinë e personit te denuar* [parashtruesit] *ose dënimin e tij sipas një dispozite më të butë penale e si provë e re do të konsiderohej deklarata e dëshmitarit [...]"*.

31. Më 20 nëntor 2013, Gjykata Themelore në Pejë (Aktvendimi PK. nr. 198/13) refuzoi kërkesën e dytë të parashtruesit për përsëritje të procedurës penale si të pabazuar duke arsyetuar se:

"[...] në rastin konkret nuk janë përmbushur kushtet ligjore për përsëritjen e procedurës ndaj të gjykuarit Baton Morina [...], edhe po të ishte dëgjuar më herët dëshmitari në fjalë, edhe sikur po të dëgjohej tani nuk do ta ndryshoj rrjedhën e procedurës penale ndaj të dënuarit [...]. Sa i përket pretendimeve [...] se nuk është vendosur lidhur me kërkesën për përjashtimin e prokurorit të rastit kolegji shqyrtues i kësaj gjykate duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës e pikërisht procesverbalit të shqyrtimit kryesor, shihet se nuk është paraqitur ndonjë kërkesë për përjashtimin e prokurorit apo cilido pjesëmarrës në procedure gjyqësore, konstatohet se nuk ka indikacione se lidhur me prokurorin në fjalë është iniciuar ndonjë procedure disiplinore apo penale që ndërlidhet me rastin konkret, andaj për tu konsideruar bazë ligjore për rishikim të procedurës penale në kuptim të nenit 442 par 1. pika 1. të KPPK-së, sipas parag.2 të të njëjtit nen duhet të provohet se aktgjykimi është pasoj e veprës penale të kryer nga përsoni që ka kryer hetimet nga prokurori [...] çka në rastin konkret këto prova mungojnë".

32. Më 10 dhjetor 2013, Gjykata e Apelit (Aktvendimi PN. nr. 736/13) refuzoi ankesën e parashtruesit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë dhe arsyetoi si në vijim:

"[...] gjykata e shkallës së parë, drejt ka vlerësuar se kërkesa e mbrojtësit të të gjykuarit për rishikimin e procedurës penale është e pabazuar, meqë, në rastin konkret nuk janë përmbushur kushtet ligjore për rishikimin e procedures penale të parapara me nenin 423 par.1 pika 1.3. [...].
[...] dëshmia e dëshmitarit nuk sjell ndonjë provë të re të panjohur gjer më tani, që do të ishte arsye ligjore për lejimin e rishikimit të procedurës penale, e që do të mund të provonte pafajësinë e të dënuarit".

33. Më 7 mars 2014, Zyra e Prokurorit të Shtetit [Njoftimi KMLP. I. nr. 1/14], refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit dhe të Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, me arsyetimin se nuk kishte bazë ligjore për të ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta ia kanë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 24 [Barazia

Para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafi 1.

35. Lidhur me këto pretendime, parashtruesi thekson se *"[...] ai është diskriminuar pse është mbrojtur nga avokati S.D."* dhe Prokurori i Shtetit kishte *"problem personal"* me të.

36. Parashtruesi më tej, pohon se: *"[...] sipas ankesës së Prokurorit Publik është ndryshuar Aktgjykimi i shkallës së parë në dëmë të akuzuarit në aspektin e lartësis së dënimit nga 4 vite në 12, [...] nga e cila kuptohet se prokurori [...] përmes ushtrimit të autoritetit të prokurorit në të gjitha instancat ka ndikuar që i akuzuari Baton Morina të dënohet me dënim sa më të lartë".*

37. Në përfundim, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën në vijim:*"Anulimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë PK. nr. 198/13 të datës 20.11.2013 të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN. nr. 736/13 të datës 10.12.2013 dhe të Njoftimit të Prokurorisë së Shtetit të Kosovës KMLP. I. nr. 1/14 të datës 7.03.2014".*

Pranueshmëria e kërkesës

38. Para së gjithash, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kushtet e nevojshme të pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

Sa i përket pretendimeve të parashtruesit lidhur me kërkesën e tij të parë për përsëritje të procedurës penale

39. Siç u përmend më lart, parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 21, 22, 24 dhe 31 të Kushtetutës meqë, sipas tij, Prokurori Publik i Qarkut në Pejë kishte tejkaluar autorizimet e tij dhe nuk kishte vepruar në mënyrë të paanshme gjatë zhvillimit të procedurës penale në rastin e tij.

40. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se, parashtruesi, sikurse në kërkesën e tij të parë Rasti nr. KI159/11, të parashtruar në Gjykatë, i referohet argumenteve të njëjta, lidhur me mungesën e paanshmërisë së Prokurorit Publik të Qarkut në Pejë.

41. Gjykata gjithashtu vëren se, parashtruesi, edhe pse formalisht konteston Njoftimin (KMLP. I. nr. 1/14, të 7 marsit 2014) e Prokurorit të Shtetit, në substancë, ai konteston kushtetutshmërinë e vendimeve të mëhershme të gjykatave të rregullta, përkatësisht të Aktgjykimit P. nr. 80/06, të 23 qershorit 2006, të Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe Aktgjykimet (Ap. nr. 582/06, të 19 prillit 2007; Pkl. nr. 78/2007, të 31

dhjetorit 2007; Pn. nr. 530/2011, të 13 tetorit 2011) të Gjykatës Supreme.

42. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se këto pretendime të parashtruesit janë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën e tij të parë, të parashtruar në Gjykatën Kushtetuese, si dhe janë të adresuara kundër vendimeve të njëjta, kushtetutshmërinë e të cilave kjo Gjykatë tashmë e ka vlerësuar me rastin e nxjerrjes së Aktvendimit për papranueshmëri në Rastin nr. KI159/11.

43. Prandaj, për sa i përket këtyre pretendimeve të përsëritura të parashtruesit Gjykata i referohet rregullit 36 (3) (d) të Rregullores së punës i cili përcakton:

> *"Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*
>
> > *[...]*
> >
> > *(d) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri;*
> >
> > *[...]"*

44. Siç u përmend më lart, Gjykata vëren se tashmë ka shqyrtuar këto pretendime të parashtruesit në Rastin nr. KI159/11 dhe i kishte refuzuar si qartazi të pabazuara. Me atë rast, Gjykata, pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit (Pn. nr. 530/2011, të 13 tetorit 2011) të Gjykatës Supreme, kishte konstatuar se nuk kishte argumente bindëse dhe prova që mund të qonin në konkludim se ky Aktgjykim apo vendimet e tjera janë nxjerrë dukshëm në mënyrë të padrejtë apo arbitrare.

45. Si rrjedhojë, bazuar në rregullin 36 (3) (d) të Rregullores së punës, Gjykata konstaton se ajo tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë, dhe se kjo pjesë e kërkesës nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri.

Sa i përket pretendimeve të parashtruesit lidhur me kërkesën e tij të dytë për përsëritje të procedurës penale

46. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë nga Zyra e Prokurorit të Shtetit (Njoftimi KMLP. I. nr. 1/14, i 7 marsit 2014), Gjykata i referohet nenit

48 të Ligjit dhe rregullit 36 (2) (d) të Rregullores së punës, të cilat parashohin:

Neni 48 i Ligjit

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Rregulli 36 (2) (d) i Rregullores së punës

"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin tij.

[...]"

47. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij të dytë për përsëritje të procedurës penale, sërish kishte pretenduar se Prokurori Publik i Gjykatës së Qarkut në Pejë është dashur të përjashtohet dhe, si rrjedhojë e mos përjashtimit të tij ishte bërë shkelje e rëndë e dispozitave të procedurës penale dhe e nenit 31 të Kushtetutës. Përveç kësaj, parashtruesi kishte arsyetuar kërkesën e tij të dytë për përsëritje të procedurës penale duke theksuar që marrja në pyetje e dëshmitarit të ri do të ndryshonte gjendjen faktike, prandaj, kërkesa e tij për këtë çështje do të duhej të miratohej.

48. Më tutje, Gjykata vëren se me rastin e refuzimit të kërkesës së tij të dytë për përsëritje të procedurës penale, gjykatat e rregullta kanë adresuar pretendimet e parashtruesit dhe i janë përgjigjur kërkesave të tij.

49. Më konkretisht, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Pejë, me rastin e refuzimit të kërkesës së dytë të parashtruesit për përsëritje të procedurës penale, e arsyetoi vendimin e saj duke iu referuar dispozitave të ligjit në fuqi dhe u ishte përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të paraqitura në kërkesën e tij.

50. Në Aktvendimin e saj, Gjykata Themelore në Pejë konstatoi se "*[...] edhe po të ishte dëgjuar më heret dëshmitari në fjalë, edhe sikur po të dëgjohej tani nuk do ta ndryshoj rrjedhen e procedurës penale ndaj të*

dënuarit [...]. Më tutje, Gjykata Komunale theksoi që parashtruesi nukka paraqitur "*ndonjë kërkesë për përjashtimin e prokurorit"* dhe se rrjedhimisht nuk kishte "*bazë ligjore për rishikim të procedurës penale në kuptim të nenit 442 par 1. pika 1. të KPPK-së*".

51. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu vëren se edhe Gjykata e Apelit, me rastin e refuzimit të ankesës së parashtruesit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, e arsyetoi vendimin e saj duke iu referuar dispozitave të ligjit në fuqi, si dhe parashtresave të parashtruesit në ankesë. Gjykata e Apelit kishte mbështetur plotësisht Aktvendimin e Gjykatës Themelore duke konstatuar se "*gjykata e shkallës së parë, drejt ka vlerësuar se kërkesa e mbrojtësit të të gjykuarit për rishikimin e procedurës penale është e pabazuar, meqë, në rastin konkret nuk janë përmbushur kushtet ligjore për rishikimin e procedurës penale të parapara me nenin 423 par.1 pika 1.3".*

52. Gjykata më tutje vëren se edhe Zyra e Prokurorit të Shtetit kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, pasi që nuk kishte bazë ligjore për një kërkesë të tillë.

53. Për më tepër, Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar saktësisht si dhe pse vendimet e kontestuara, me të cilat ishte refuzuar kërkesa e tij e dytë për përsëritje të procedurës përbëjnë shkelje të të drejtave dhe lirive të tij individuale, të garantuara me Kushtetutë, dhe as nuk ka paraqitur prova për të arsyetuar pretendimin për një shkelje të tillë.

54. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese, që të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga ana e Gjykatës së Apelit apo nga Zyra e Prokurorit të Shtetit, përveç, nëse ato kanë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojturame Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

55. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta ose nga autoritetet tjera publike. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, paragrafi 28; shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese në Rastin Kl70/11, të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima,* Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

56. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në një mënyrë të tillë, dhe nëse procedurat në përgjithësi, të

shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, App. Nr. 13071/87, të aprovuar më 10 korrik 1991).

57. Gjykata konsideron se procedurat në Gjykatën Themelore dhe në Gjykatën e Apelit, si dhe refuzimi i kërkesës së parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, KEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

58. Prandaj, Gjykata konstaton se kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet si e papranueshme sepse parashtruesi nuk ka dështuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin tij.

59. Si përfundim, Gjykata, në pajtim me rregullin 36 (2) (d) dhe 36 (3) (d) të Rregullores së punës, konkludon që kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullat 36 (2) (d) dhe 36 (3) (d) të Rregullores së punës, më 10 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI152/14 dhe KI153/14, Parashtrues Fatmir Pajaziti-Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 194/2013, i 2 prillit 2014, të Aktvendimit PLK. nr. 4/14, të Panelit të Lirimit me Kusht, PLK. nr. 4/14, të 28 prillit 2014, dhe të Aktvendimit, të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 84/2014, i 5 gushtit 2014

KI152/14 dhe KI153/14, Aktvendim për papranueshmëri i 10 gushtit 2015 publikuar më 20 gusht 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme, kërkesë qartazi e pabazuar, krim i organizuar, kontrabandim me emigrantë, lirim me kusht, zbutje e jashtëzakonshme e dënimit, procedurë penale*

Në Rastin KI152/14, Gjykata Supreme kishte vërtetuar vendimin e gjykatës së instancës më të ulët ku parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor për veprën penale kontrabandim me emigrantë. Në Rastin KI153/14, Gjykata Supreme kishte vërtetuar vendimin e Panelit për Lirim me Kusht që kishte refuzuar lirimin me kusht të parashtruesit të kërkesës për shkak se nuk ishin përmbushur kushtet ligjore.

Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar shkelje të procedurës penale dhe ndërhyrje në gjyqësorin e rregullt për lirimin e tij me kusht pa specifikuar ndonjë dispozitë kushtetuese në veçanti. Gjykata Kushtetuese, në Rastin KI152/14, konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e paafatshme. Kurse në Rastin KI153/14, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parashtruesi i kërkesës kryesisht nuk është i kënaqur me kualifikimet juridike të fakteve dhe rezultatin e procedurës të përfunduar në Gjykatën Supreme dhe se, kualifikimi juridik i fakteve dhe ligjit të aplikueshëm janë çështje të ligjshmërisë. Kërkesat, u shpallën të papranueshme në pajtim me nenet 48 dhe 49 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (c) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastet nr. KI152/14 dhe KI153/14
Parashtrues
Fatmir Pajaziti
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 194/2013, të 2 prillit 2014, të Aktvendimit të Panelit të Lirimit me Kusht, PLK. nr. 4/14, të 28 prillit 2014, dhe të Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 84/2014, të 5 gushtit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Fatmir Pajaziti, me vendbanim në fshatin Smirë, komuna e Vitisë, momentalisht duke vuajtur dënimin në burgun e Dubravës.

Vendimi i kontestuar

2. Në kërkesën e tij KI152/14, parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (Pml. nr. 194/2013të 2 prillit 2014), me të cilin ishte refuzuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si e pabazuar. Aktgjykimi i lartpërmendur i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 26 maj 2014.

3. Në kërkesën e tij KI153/14, parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Panelit për Lirim me Kusht (PLK. nr. 4/14 të 28 prillit 2014), me të cilin ishte refuzuar kërkesa e parashtruesit për lirim me kusht për pjesën e mbetur të dënimit me burg. Ky Aktvendim i ishe dorëzuar parashtruesit të kërkesës, më 29 prill 2014.

4. Në kërkesën e njëjtë KI153/14, parashtruesi gjithashtu konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme (Pzd. nr. 84/2014 të 5 gushtit 2014). Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit të tij me burgim të shqiptuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (P. nr. 244/2010, të 17 qershorit 2011).

Objekti i çështjes

Kërkesa KI152/14

5. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. Nr. 194/2013, të 2 prillit 2014.

6. Në kërkesën e tij, parashtruesi nuk saktëson se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur, dhe as cilat dispozita kushtetuese në mënyrë të veçantë mbështesin kërkesën e tij. Megjithatë, ai pretendon shkelje të procedurave penale të kryera në gjykatat e rregullta, ku parashtruesi ishte dënuar me burgim për kryerjen e veprës penale të kontrabandimit të emigrantëve.

Kërkesa KI153/14

7. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht (PLK. nr. 4/14 të 28 prillit 2014) dhe Aktvendimit të Gjykatës Supreme (Pzd. nr. 84/2014të 5 gushtit 2014) lidhur me kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit me burgim.

8. Në kërkesën e tij, parashtruesi nuk specifikon se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur dhe as cila dispozitë kushtetuese në veçanti mbështetë kërkesën e tij.

Baza juridike

9. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 37 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

10. Më 8 tetor 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës(në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

11. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI152/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI152/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

12. Më 14 nëntor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që ta plotësojë formularin e kërkesës dhe të dorëzojë dokumente shtesë.

13. Më 1 dhjetor 2014, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetari urdhëroi bashkimin e kërkesës KI153/14 me kërkesën KI152/14. Me këtë urdhër, u vendos që gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të jetë e njëjtë, siç ishte vendosur me vendimet (GJR. KI152/14 dhe KSH. KI152/14) të Kryetarit për emërimin e gjyqtarit raportues dhe të Kolegjit shqyrtues më 6 dhjetor 2014.

14. Më 1 dhjetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për bashkimin e kërkesave. Të njëjtën ditë, Gjykata ua dërgoi nga një kopje të kërkesës dhe njoftimin për bashkimin e kërkesave Gjykatës Supreme dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

15. Më 22 dhjetor 2014, parashtruesi e dorëzoi formularin e plotësuar të kërkesës dhe dokumentet shtesë.

16. Më 6 shkurt 2015, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojë një kopje të fletëkthesës, e cila tregon se kur Aktgjykimi i Gjykatës Supreme (P.m.l. Nr. 194/2013,i 2 prillit 2014) i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës.

17. Më 2 mars 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi fletëkthesën në Gjykatë, e cila tregon se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (Pml. nr. 194/2013të 2 prillit 2014) më 26 maj 2014.

18. Më 3 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

A. Përmbledhja e fakteve lidhur me kërkesën KI152/14

19. Gjatë natës ndërmjet të 14 dhe 15 tetorit 2009, një grup prej 18 (tetëmbëdhjetë) shtetasve nga Kosova e kanë kaluar kufirin ndërmjet Serbisë dhe Hungarisë me një barkë në lumin Tisa, në afërsi të qytetit të Suboticës. Barka ishte fundosur gjatë rrugës dhe 15 (pesëmbëdhjetë) shtetas të Kosovës humbën jetën, ndërsa 3 (tre) prej tyre mbijetuan.

20. Më 13 shtator 2010, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PSRK) bazuar në aktin PPS. nr. 422/09, ngriti aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës dhe 6 (gjashtë) personave të tjerë, duke i akuzuar për veprën penale të krimit të organizuar, nga neni 274, paragrafi 4, në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK), dhe veprën penale të kontrabandimit me emigrantë, nga neni 138, paragrafi 6 i të njëjtit Kod.

21. Më 17 qershor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi, P. nr. 244/10) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale të kontrabandimit me emigrantë, nga neni 138, paragrafi 6 i KPK dhe e dënoi atë me 7 (shtatë) vjet burgim. Përveç kësaj, me të njëjtin Aktgjykim të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, 4 (katër) persona tjerë ishin shpallur fajtorë për kryerjen e veprës penale të krimit të organizuar në lidhje me veprën penale të kontrabandës me emigrantë, ndërsa 2 (dy) persona tjerë u shpallën fajtorë për kryerjen e veprës penale, të kontrabandës me emigrantëve dhe rrjedhimisht u dënuan me burg.

22. Më 1 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të Kodit penal dhe të Kodit të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

23. Më 2 tetor 2012, GjykataSupreme (Aktgjykimi, AP-Kz nr. 61/2012) e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar.

24. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi dorëzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, duke kontestuar aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (P. nr. 244/10 të 17 qershorit 2011) dhe të Gjykatës Supreme (AP-Kz nr. 61/2012, të 2 tetorit 2012), duke pretenduar se këto aktgjykime përmbajnë shkelje esenciale të Kodit penal dhe të Kodit të procedurës penale.

25. Më 2 prill 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Pml. nr. 194/2013) refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar, dhe konstatoi se nuk ka gjetur ndonjë shkelje procedurale.

26. Gjykata vërense një ngapersonatqë u shpallënfajtorëmeAktgjykimine lartpërmendurtë Gjykatës sëQarkut në Prishtinë(P. nr.244/10, të 17qershorit 2011)kishte parashtruarkërkesë në Gjykatë dukekërkuarshqyrtiminkushtetues të të njëjtit AktgjykimtëGjykatës Supreme, P. m. l.nr. 194/2013, të 2prillit 2014.Më 16janar 2015,Gjykatakishte vendosur tadeklarojëkërkesën të papranueshmesi qartazi tëpabazuar(Shih, Rastin KI137/14, Parashtruesi i kërkesës:ShpejtimAdemaj, Aktvendimpër papranueshmërii 16 janarit2015).

B. Përmbledhja e fakteve lidhur me kërkesën KI153/14

Sa i përket Aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht

27. Më 23 maj 2013, parashtruesi parashtroi kërkesë te Paneli për Lirim me Kusht, duke kërkuar lirimin e tij me kusht, për pjesën e mbetur të dënimit të tij me burgim.

28. Më 28 prill 2014, Paneli për Lirim me Kusht (Aktvendimi, PLK. nr. 4/14) refuzoi kërkesën e parashtruesit me mundësinë e shqyrtimit të rastit të tij pas 1 (një) viti.

29. Paneli për Lirim me Kusht vlerësoi se për shkak të natyrës dhe peshës së veprës penale dhe qëllimit të sanksionit penal, nuk janë përmbushur kushtet për lirimin e tij me kusht.

Sa i përket kërkesës së parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit

30. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Supreme duke kërkuar zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit me burgim, të shqiptuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (P. nr. 244/2010, të 17 qershorit 2011) dhe të vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (AP. nr. 61/2012, të 2 tetorit 2012).

31. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës thirret në atë se ai është baba i 4 (katër) fëmijëve dhe se bashkëshortja e tij është e sëmurë rëndë.

32. Më 5 gusht 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Pzd. nr. 84/2014) refuzoi kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit si të pabazuar.

33. Gjykata Supreme vlerësoi se zbutja e jashtëzakonshme e dënimit nuk është e lejuar, sepse rrethanat e reja të pretenduara, në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës nuk i përmbushin kriteret për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, të përcaktuara me ligj.

34. Në këtë drejtim, GjykataSupreme arsyetoi:

> *"Rrethanat e cekura në kërkesë se është baba i 4 fëmijëve kanë qenë të ditura dhe të vlerësuara nga gjykatat gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin. Gjithashtu duhet cekur se edhe pse i dënuari Fatmir Pajaziti thirret në rrethanën se bashkëshortja e tij është rënd e sëmurë me asgjë këtë rrethanë gjykata nuk e ka vërtetuar nga se kërkesës nuk i është bashkangjitur asnjë provë e cila do ta vërtetonte këtë rrethanë".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

A. Sa i përket kërkesës KI152/14

35. Siç u përmend më lart, parashtruesi i kërkesës nuk saktëson se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur dhe as cilat dispozita kushtetuese në veçanti mbështesin kërkesën e tij, por ai pretendon shkelje të procedurës penale të kryer në gjykatat e rregullta, ku parashtruesi ishte dënuar me 7 (shtatë) vjet burgim për kryerjen e veprës penale të kontrabandimit të emigrantëve.

B. Sa i përket kërkesës KI153/14

36. Në kërkesën e tij, parashtruesi konteston Aktvendimin e Panelit për Lirim me Kusht (PLK. nr. 14/04, të 28 prillit 2014) dhe Aktvendimin e Gjykatës Supreme (Pzd. nr. 84/2014, të 5 gushtit 2014) në lidhje me kërkesën e tij për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit me burgim.

37. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk saktëson se cilat të drejta dhe liri janë shkelur dhe cila dispozitë kushtetuese në veçanti mbështetë kërkesën e tij. Ai pohon se ka vuajtur 5 (pesë) vite të dënimit të tij me burgim dhe i drejtohet Gjykatës me kërkesën *"për të ndërhyrë në instancat gjyqësore të sipërpërmendura për ta miratuar kërkesën e tij për lirim me kusht apo zbutje të jashtëzakonshme të dënimit të tij me burgim".*

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur kriteret

e pranueshmerisë, të përcaktuara me Kushtetutëdhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

A. Sa i përket kërkesës KI152/14

39. Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".*

40. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi [...]".*

41. Për të përcaktuar nëse parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të paraparë kohor prej 4 (katër) muajsh, Gjykata i referohet ditës kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar vendimi përfundimtar dhe ditës në të cilën kërkesa është dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese.

42. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme (Pml. nr. 194/2013 i 2 prillit 2014) i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 26 maj 2014, ndërsa ai parashtroi kërkesën e tij në Gjykatë më 8 tetor 2014. Bazuar në këtë, rrjedh se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

43. Gjykata përkujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit si dhe sipas rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë sigurinë juridike duke siguruar që rastet të cilat paraqesin çështje kushtetuese të shqyrtohen brenda afateve të arsyeshme, si dhe që vendimet e nxjerra më herët të mos jenë pafundësisht të hapura për kontestim (Shih, rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* Nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendim i 25 gushtit 2005).

44. Prandaj, kërkesa është e papranueshme, sepse është e paafatshme.

B. Sa i përket kërkesës KI153/14

45. Gjykata rikujton se parashtruesi në këtë kërkesë konteston:

    a. Aktvendimin e Panelit për Lirim me Kusht (PLK. nr. 4/14, të 28 prillit 2014); dhe
    b. Aktvendimin e Gjykatës Supreme (Pzd. nr. 84/2014,të 5 gushtit 2014) lidhur me kërkesën e tij për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit me burgim.

46. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se të dy aktvendimet e kontestuara ishin nxjerrë në dy grupe të ndryshme të procedurave.

47. Sa i përket Aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht (PLK. nr. 4/14, të 28 prillit 2014), Gjykata vëren se ky Aktvendim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 29 prill 2014, ndërsa ai e ka dorëzuar kërkesën e tij më 8 tetor 2014.

48. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata konkludon se pjesa e kërkesës ku parashtruesi konteston Aktvendimin e Panelit për Lirim me Kusht është e paafatshme sepse kërkesa nuk ishte dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe Rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

49. Sa i përket Aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Pzd. nr. 84/2014,të 5 gushtit 2014), lidhur me kërkesën e tij për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit me burgim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

    "Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

50. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

    (2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

    [...]

    (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

51. Bazuar në sa u tha më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kryesisht nuk është i kënaqur me kualifikimet juridike të fakteve dhe rezultatin e procedurës të përfunduar në Gjykatën Supreme. Kualifikimi juridik i fakteve dhe ligjit të aplikueshëm janë çështje që bien brenda fushës së ligjshmërisë.

52. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmëria) që pretendohen të jenë bërë nga Gjykata Supreme, duke përfshirë gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

53. Për më tepër, lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme përkitazi me kërkesën e tij për zbutje të jashtëzakonshme, parashtruesi i kërkesës nuk specifikon se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur dhe cila dispozitë kushtetuese në veçanti mbështetë kërkesën e tij.

54. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë sa që procedurat në përgjithësi dhe të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë. (Shih, *inter alia*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

55. Përveç kësaj, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj në bazë të Kushtetutës të zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta, në lidhje me vendimet e tyre. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu Rastin KI70/11 parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

56. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

57. Prandaj, pjesa e kërkesës KI153/14 përkitazi me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme lidhur me kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme është qartazi e pabazuar.

58. Në fund, Gjykata konkludon se kërkesat KI152/14 dhe KI153/14 duhet të deklarohen të papranueshme.

59. Kërkesa KI152/14 është e papranueshme, sepse është e paafatshme.

60. KërkesaKI153/14:

A. Sa i përket pjesës që ka të bëjë me Aktvendimin e kontestuar të Panelit për Lirim me Kusht, është e papranueshme, sepse është e paafatshme.

B. Pjesa e kërkesës përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme në lidhje me kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, është e papranueshme si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 48 dhe 49 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (c) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, më 10 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. T'I DEKLAROJË kërkesat të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI172/14, Parashtrues Afrim Gela - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 189/2014, i 8 korrikut 2014

KI172/14, Aktvendim për papranueshmëri i 10 gushtit 2015, publikuar më 21 gusht 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, kontest pune, kompensim material dhe jomaterial, pension invalidor*

Gjykata Supreme kishte refuzuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës, përkitazi me detyrimin e punëdhënësit të tij për pagimin e pensionit invalidor ose kthim në vend të punës. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese me pretendimin se është shkelur e drejtat e tij e punës, por pa iu referuar ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e aktgjykimeve të gjykatave të rregullta në veçanti, me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe se kjo pakënaqësi nuk është e mjaftueshme që parashtruesi i kërkesës të ngre pretendime për shkelje kushtetuese. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI172/14
Parashtrues
Afrim Gela
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 189/2014, të 8 korrikut 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Afrim Gela, me vendbanim në fshatin Druar, komuna e Vushtrrisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 189/2014, të 8 korrikut 2014, me të cilin ishte refuzuar revizioni i parashtruesit të kërkesës si i pabazuar dhe ishte vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, AC. nr. 4112/2012, i 2 dhjetorit 2013.

3. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 27 tetor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së **a**ktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet të jetë shkelur e drejta e punës së parashtruesit të kërkesës. Pretendimi i parashtruesit të kërkesës në gjykatat e rregullta ka të bëjë me kërkesën e tij për kthim në vendin e tij të mëparshëm të punës ose kompensimin me një pagesë mujore në emër të pensionit invalidor.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 27 nëntor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 8 dhjetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI172/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI172/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

8. Më 18 dhjetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme. Të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të sigurojë një kopje të fletëkthesës, e cila tregon ditën kur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës Aktgjykimi i Gjykatës Supreme (Rev. nr. 189/2014, i 8 korrikut 2014).

9. Më 24 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi kopjen e fletëkthesës, e cila tregon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme (Rev. nr. 189/2014, i 8 korrikut 2014) i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 27 tetor 2014.

10. Më 26 qershor 2015, me Vendimin e Kryetares së Gjykatës, Arta Rama -Hajrizi është caktuar anëtare e Kolegjit shqyrtues, në vend të Enver Hasanit, mandati i të cilit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, ka përfunduar më 26 qershor 2015.

11. Më 2 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës kishte kontratë pune me KEK-un (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi) për një periudhë të pacaktuar kohore.

13. Më 21 prill 2004, parashtruesi i kërkesës kishte pësuar lëndime trupore, si pasojë e një aksidenti në vendin e tij të punës.

14. Prandaj, në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë pranë Fondit Pensional të punëdhënësit për t'i njohur atij të drejtën e një pagese mujore në emër të pensionit invalidor.

15. Më 27 prill 2005, punëdhënësi miratoi kërkesën e parashtruesit dhe vendosi (Vendimi nr. 67/11) ta dërgojë parashtruesin e kërkesës në pension të parakohshëm me marrëveshje për një pagesë mujore në emër të pensionit invalidor, duke filluar nga 1 qershori 2005 deri më 1 qershor 2010 (në tekstin e mëtejmë: Vendimi i punëdhënësit). Kjo pagesë mujore u ekzekutua nga Fondi Pensional i Punëdhënësit në pajtim me Statutin e Fondit Suplementar Pensional të Punëdhënësit.

16. Më 7 korrik 2010, pas përfundimit të periudhës prej 5 (pesë) vjetësh të përcaktuar në Vendimin e lartpërmendur të punëdhënësit, parashtruesi parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës kërkoi kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës, ose kompensim me një pagesë mujore në emër të pensionit invalidor në të njëjtën shumë siç parashihet me Vendimin e punëdhënësit (Nr. 67/11, të 27 prillit 2005), duke filluar nga 1 qershori 2010 deri në datën kur ai arrin moshën e pensionimit ligjor.

17. Më 24 prill 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 1513/10) e refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar.

18. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Komunale në Prishtinë konstatoi se marrëdhënia e punës në kuptimin e një marrëdhënie kontraktuese, u jep palëve të drejtën që lirisht të përcaktojnë të drejtat dhe detyrat që rrjedhin nga kjo marrëdhënie. Kështu, ajo konkludoi se marrëdhënia e punës dhe e drejta e parashtruesit për pagesë mujore ishte ndërprerë pas skadimit të periudhës së përcaktuar me Vendimin e punëdhënësit (Nr. 67/11, të 27 prillit 2005) dhe përmbushjes së detyrimeve financiare të punëdhënësit ndaj parashtruesit të kërkesës.

19. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të procedurës kontestimore, vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

20. Më 2 dhjetor 2013, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi, AC. nr. 4112/2012) refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë.

21. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata e Apelit vlerësoi se vetë parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Fondin Pensional të Punëdhënësit për t'i njohur atij të drejtën në një pagesë mujore në emër të pensionit invalidor për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Kështu, sipas Gjykatës së Apelit, marrëdhënia e punës ishte transformuar në një marrëdhënie kontraktuese, ku punëdhënësi ishte i obliguar ta përmbushë detyrimin e pagesës mujore për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Prandaj, sipas Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës nuk ka më të drejtë të kthehet në vendin e tij të mëparshëm të punës, për shkak se marrëdhënia e punës është përfunduar me përmbushjen e detyrimit të punëdhënësit ndaj parashtruesit të kërkesës.

22. Parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Në kërkesën e tij për revizion, ai pretendoi shkelje esenciale të procedurës kontestimore.

23. Më 8 korrik 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 189/2014) refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

24. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme vërtetoi se punëdhënësi kishte përmbushur obligimin e tij ndaj parashtruesit të kërkesës, për shkak se ai ka vepruar në përputhje me Vendimin e tij Nr. 67/11, të 27 prillit 2005, të cilin vendim parashtruesi nuk e kishte kontestuar. Përveç kësaj, Gjykata Supreme, duke iu referuar Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, konstatoi se kontrata e punës mund të shkëputet me një marrëveshje me shkrim ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit.

25. Për qëllim të një prezantimi të plotë të procedurave në gjykatat e rregullta, Gjykata vëren se, në vitin 2005, parashtruesi gjithashtu kishte iniciuar një procedurë civile lidhur me kompensimin për dëmin material dhe jomaterial për lëndimet e pësuara nga aksidenti. Kjo procedurë civile, e cila është ende në pritje në gjykatat e rregullta, nuk bie brenda fushës së objektit të çështjes së kërkesës, sepse parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike konteston procedurën e përfunduar lidhur me pretendimin e tij për kthim në vendin e tij të mëparshëm të punës ose kompensim me pagesë mujore në emër të pensionit invalidor.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është shkelur e drejta e tij e punës.

27. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata kthimin në vendin e tij të punës ose kompensim nëpërmjet pensionit invalidor për shkak të humbjes së aftësisë së punës.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Për të qenë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutëdhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

30. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> > *[...]*
> >
> > *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

31. Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme të Kosovës (Rev. nr. 189/2014, të 8 korrikut 2014) ishte shkelur e drejta e tij e punës.

32. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk shpjegon si dhe pse Aktgjykimi i Gjykatës Supreme pretendohet të ketë shkelur të drejtën e tij të punës dhe, as nuk pretendon ndonjë padrejtësi dhe arbitraritet në procedurë.

33. Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj konstatoi se punëdhënësi kishte përmbushur obligimin e tij ndaj parashtruesit të kërkesës në përputhje me Vendimin e tij (Nr. 67/11, të 27 prillit 2005), të cilin vendim parashtruesi nuk e ka kontestuar.

34. Gjykata konsideron se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, në veçanti me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, nuk është i mjaftueshëm që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese (Shih, *mutatis mutandis,*rastin *Mezőtúr-Tiszazugi Vízgazdálkodási Társulat kundërHungarisë,* Nr. 5503/02, KEDNJ,

Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21). Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës.

35. Përveç kësaj, Gjykata Supreme, duke iu referuar Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, konstatoi se kontrata e punës mund të shkëputet me një marrëveshje me shkrim ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, dhe konkludoi se gjykatat e shkallëve të ulëta kishin zbatuar drejt të drejtën materiale.

36. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Prandaj, Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011)

37. Për më tepër, siç u cek më lart, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata ka gjetur se procedurat e përfunduara në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).

38. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës së tij të punës, e cila është e garantuar me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme në asnjë mënyrë nuk e pengon parashtruesin e kërkesës të punojë ose të ushtrojë profesionin. Bazuar në këtë, nuk ka asgjë në pretendimin e parashtruesit të kërkesës që arsyeton përfundimin se atij i është cenuar e drejta kushtetuese e punës(Shih Rastin KI51/14, parashtrues i kërkesës *Radomir Radosavljević*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 janarit 2015, par. 32).

39. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

40. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d), më 10 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI179/14, Parashtrues Bejtullah Sogojeva - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 396/2012, i 11 shtatorit 2013

KI172/14, Vendim për hedhje poshtë të kërkesës i 6 korrikut 2015, publikuar më 21 gusht 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e vendosur, e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore e të drejtave*

Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese kishte vendosur më parë për kërkesën e parashtruesit duke e shpallur të papranueshme,si qartazi të pabazuar përkitazi me pretendimet për gjykim të drejtë dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

Gjykata ritheksoi se ajo tashmë e kishte gjykuar rastin e parashtruesit dhe në kërkesën e tanishme ai nuk ngre asnjë ankesë të re, dhe asnuk paraqet ndonjë fakt apo provë të re dhe se kërkesa e tanishmeështë tërësisht përsëritje e kërkesës së mëparshme. Kërkesa u shpall e papranueshme në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës.

VENDIM PËR HEDHJE POSHTË TË KËRKESËS
në
Rastin nr. KI179/14
Parashtrues
Bejtullah Sogojeva
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 396/2012, të 11 shtatorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Bejtullah Sogojeva, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 396/2012, të 11 shtatorit 2013, me të cilin ishte refuzuar revizioni i parashtruesit të kërkesës si i pabazuar dhe ishte vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AC. nr. 1356/2011, i 24 janarit 2012.

3. Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar një kërkesë, me të cilën i kishte kontestuar të njëjtat vendime, dhe të cilën Gjykata e kishte deklaruar të papranueshme si qartazi të pabazuar. (Shih, Rastin KI05/14, parashtrues i kërkesës *Bejtullah Sogojeva*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 korrikut 2014)

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë sëAktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, me të cilin, pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin

31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 32 (5) dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 15 dhjetor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 13 janar 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI179/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI179/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

8. Më 23 janar 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 26 qershor 2015, me Vendimin e Kryetarit të Gjykatës, Arta Rama -Hajrizi u caktua anëtare e Kolegjit shqyrtues, në vend të Enver Hasanit, mandati i të cilit ka përfunduar më 26 qershor 2015.

10. Më 6 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

11. Gjykata vëren se faktet në kërkesën e tanishme janë të njëjta me përmbledhjen e fakteve të përcaktuara në Rastin KI05/14.

12. Parashtruesi ishte i punësuar në Institutin e Mjekësisë së Punës në Obiliq (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi) deri më 15 gusht 2006. Të njëjtën ditë, marrëdhënia e tij e punës me punëdhënësin ishte ndërprerë, për shkak se ai pretendohet të ketë arritur moshën e plotë të pensionimit.

13. Sipas parashtruesit të kërkesës, në librezën e tij të punës gabimisht thuhej se ai ishte i lindur më 15 mars 1941, përderisa ai në të vërtetë ishte i lindur më 15 gusht 1942. Pra, siç pretendohet nga parashtruesi i kërkesës, punëdhënësi gabimisht kishte llogaritur moshën e tij të pensionimit dhe, si pasojë, ai ishte i detyruar të pensionohej para se të arrinte moshën e plotë të pensionimit.

14. Më 15 gusht 2006, parashtruesi kishte iniciuar procedurë civile në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

15. Pas kësaj, më 8 dhjetor 2008, Gjykata Komunale nxori Aktgjykimin (Cl. nr. 161/2007) dhe aprovoi kërkesën e parashtruesit. Punëdhënësi i parashtruesit të kërkesës, si i paditur në procedurë, ishte i obliguar t'ia kompensonte parashtruesit të kërkesës të ardhurat personale vjetore dhe shpenzimet e procedurës.

16. Pas ankesës së paraqitur nga punëdhënësi kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, më 15 shtator 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi Ac. nr. 569/2009) anuloi Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Komunale dhe e ktheu rastin për rigjykim.

17. Më 22 prill 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 2360/09) refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij Aktgjykimi.

18. Më 24 janar 2012, Gjykata e Qarkut (Aktgjykimi, Ac. nr. 1356/2011) vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë.

19. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 24 janarit 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke pretenduar se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë ishte nxjerrë me shkelje të Ligjit për procedurën kontestimore.

20. Më 11 shtator 2013, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Rev. nr. 396/2013) refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Në këtë aktgjykim, Gjykata Supreme konkludoi se marrëdhënia e punësimit ishte ndërprerë, sepse parashtruesi kishte arritur moshën e pensionimit dhe se kërkesa e parashtruesit për korrigjimin e datës së tij të lindjes është paraqitur 1 (një) vit pas vendimit për pensionimin e tij.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese në Rastin KI05/14

21. Më 17 janar 2014, parashtruesi e dorëzoi një kërkesë në Gjykatë, duke kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 396/2012, të 11 shtatorit 2013. Kjo kërkesë ishte regjistruar nën numrin KI05/14.

22. Më 7 korrik 2014, Gjykata nxori Aktvendimin për papranueshmëri, ku ajo deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar.

23. Aktvendimi për papranueshmëri është publikuar në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës. Fletëkthesa konfirmon se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës më 17 korrik 2014.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Siç ishte pretenduar në kërkesën e mëparshme KI05/14, parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 31 dhe 54 të Kushtetutës.

25. Në kërkesën e tanishme, parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë provë të re dhe as nuk ka ngritur ndonjë ankesë të re.

26. Parashtruesi i kërkesës përsëri kërkon nga Gjykata që ta anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 396/2012, të 11 shtatorit 2013 dhe ta kthejë rastin në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata vëren se kërkesa e tanishme, e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, është identike me kërkesën e tij të mëparshme KI05/14.

28. Sa i përket kërkesës së tij të mëparshme, KI05/14, Gjykata rikujton se ajo kishte nxjerrë një vendim (Aktvendim për papranueshmëri në rastin KI05/14, të 7 korrikut 2014), ku ajo e kishte deklaruar kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar. Aktvendimi lartpërmendur për papranueshmëri i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës dhe ishte publikuar në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.

29. Siç u cek më lart, në kërkesën e tanishme, parashtruesi përsëri konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 396/2012, të 11 shtatorit 2013, ngre të njëjtat pretendime dhe paraqet të njëjtat fakte dhe dëshmi si në kërkesën e mëparshme të tij, KI05/14.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 32 (5) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është e jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose ta qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkese të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze".

31. Gjykata rithekson se ajo tashmë e kishte gjykuar Rastin KI05/14 dhe në kërkesën e tanishme parashtruesi i kërkesës nuk ngre asnjë ankesë të re, dhe as nuk paraqet ndonjë fakt apo provë të re. Në këtë mënyrë, kërkesa e tanishme është tërësisht përsëritje e kërkesës së mëparshme, KI05/14.

32. Prandaj, në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, Gjykata konkludon se kërkesa e tanishme duhet të refuzohet për shkak se ajo është përsëritje e kërkesës së mëparshme KI05/14, të vendosur nga kjo Gjykatë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 116 të Kushtetutës dhe me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, më 13 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI57/15, Parashtrues Rasim Rama - Vlerësim i kushtetutshmërisë sëAktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 61/2015, i 26 marsit 2015

KI57/15, Aktvendim për papranueshmëri i 6 gushtit 2015, publikuar më 21 gusht 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, Masë e përkohshme, moszbulim i identitetit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, procedurë penale, dënim me burg, marrje e ryshfetit*

Gjykata Supreme e Kosovës kishte refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës kundër vendimeve të gjykatave të instancës së ulët që kishin dënuar atë me burgim për shkak të marrjes së ryshfetit. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese me pretendimin se janë shkelur të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe mjete efektive juridike. Parashtruesi, po ashtu, kërkoi vënien e masave të përkohshme.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se kërkesa e parashtruesit ngre çështje të ligjshmërisë dhe se procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta nuk kishin qenë të padrejta ose arbitrare. Gjykata Kushtetuese, po ashtu refuzoi kërkesat për Masë të përkohshme dhe moszbulim të identitetit për shkak, se nuk kishte rast *prima facie* respektivisht, kërkesat nuk ishin të argumentuara. Kërkesa u shpall e papranueshme në pajtim me nenet 27 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI57/15
Parashtrues
Rasim Rama
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 61/2015,
të 26 marsit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Rasim Rama (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me banim në fshatin Mushnikovë, komuna e Prizrenit. Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga z. Rexhep Hasani, avokat në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 61/2015, i 26 marsit 2015, metë cilin refuzohet, si e pabazuar, kërkesa e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P. nr. 341/2013, të 6 qershorit 2014 dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. Nr. 430/2014, të 8 janarit 2015.

3. Parashtruesi i kërkesës deklaron qëvendimin e kontestuar e ka pranuar më 20 prill 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin, sipas

pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

5. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht të ndalohet ekzekutimi i dënimit ndaj parashtruesit të kërkesës, i cili me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, P. nr. 341/2013, të 6 qershorit 2014, ishte dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh.

6. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata, që të mos zbulohet identiteti i tij.

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Më 7 maj 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

9. Më 13 maj 2015, Kryetari, me Vendimin GJR. KI57/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI57/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Arta Rama-Hajrizi.

10. Më 26 maj 2015, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të saj.

11. Më 17 qershor 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një dokument, me të cilin ka kërkuar shqyrtimin urgjent të rastit të tij.

12. Më 1 korrik 2015, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI57/15 caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Enver Hasani, mandati i të cilit si gjyqtar kushtetues kishte përfunduar më 26 qershor 2015.

13. Më 6 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

14. Parashtruesi i kërkesës është mësimdhënës i gjuhës boshnjake në gjimnazin "Gjon Buzuku" në Prizren.

15. Më 6 qershor 2014, Gjykata Themelore në Prizren (Aktgjykimi, P. nr. 341/13) duke vendosur në bazë të aktakuzës së Prokurorit të Shtetit në Prizren, PP. nr. 173/13, të 30 shtatorit 2013, shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale marrje e ryshfetit nga neni 428 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK).

16. Në një datë të paspecifikuar, Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës përkitazi me vendimin mbi dënimin. Po ashtu, kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Prizren, parashtruesi kishte paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Parashtruesi, në ankesën e tij, po ashtu ka kërkuar të thirren edhe disa dëshmitarë të tjerë, të cilët i ka konsideruar relevantë për rastin.

17. Më 8 janar 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktgjykimin PAKR. nr. 430/14, refuzoi si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda dhe atë të parashtruesit, si dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, P. nr. 341/13 , të 6 qershorit 2014.

18. Lidhur me kërkesën e parashtruesit për thirrjen e dëshmitarëve të tjerë, Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar vendimin e saj për mosmiratimin e propozimit të parashtruesit për marrjen e deklaratave të dëshmitarëve të tjerë me arsyetimin, se deklaratat e tyre ishin jorelevante për rastin në fjalë.

19. Më tej, Gjykata e Apelit konstatoi se *"dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe i kuptueshëm, dispozitivi nuk është kundërthënës me vetveten e as me përshkrimin faktik të dispozitivit të aktgjykimit [...]"*. Përkitazi meankesën e Prokurorit, Gjykata e Apelit aprovoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat i ka marrë për bazë Gjykata Themelore në Prizren, gjatë caktimit të dënimit.

20. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë në Gjykatën Themelore në Prizren për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit, me arsyetimin se ai është mësimdhënës dhe se vuajtja e dënimit duhet të shtyhet deri në përfundim të vitit shkollor.

21. Më 16 mars 2015, Gjykata Themelore në Prizren, me Aktvendimin PED. nr. 168/15, aprovoi pjesërisht kërkesën e parashtruesit, duke shtyrë vuajtjen e dënimit edhe për 3 (tre) muaj, përkatësisht deri më 31 qershor 2015.

22. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

23. Më 26 mars 2015, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Pml. nr. 61/2015, me të cilin refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P. nr. 431/2013, të 6 qershorit 2014, dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PAKR. nr. 430/2014, të 8 janarit 2015.

24. Lidhur me këtë, Gjykata Supremekonstatoi se gjykatat e instancave të ulëta i kanë bazuar vendimet e tyre në prova të administruara nga to.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 61/2015, të 26 marsit 2015, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

26. Parashtruesi i kërkesës përfundon, duke kërkuar që:

> *"Që Gjykata Kushtetuese e Republikes se Kosoves t'i ANULOJ të gjitha aktgjykimet, të bashkangjitur kësaj kërkese, dhe ate për te vetmin qellim qe t'i jepet e drejta Kushtetuese nga neni 31 parag 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nga neni 384 parag 2.2.2 të KPP për të drejtën e PARAQITJES SË DËSHMITARËVE, të cilën e konsideron të detyrueshme dhe të cilët mund t'i sqarojnë faktet vendimtare [...]".*

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse ai i ka përmbushur

kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7, të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

29. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion. Gjykata, gjithashtu vëren se vendimi i kontestuar ishte nxjerrë më 26 mars 2015, dhe se parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë më 7 maj 2015.

30. Megjithatë, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

31. Gjykata i referohet edhe rregullit36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> > *[...]*
> >
> > *d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...], ose*
>
> > *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese*
> >
> > *[...]*

(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

32. Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 61/2015, i 26 marsit 2015, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 430/14, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P. nr. 341/14, i 6 qershorit 2014, janë marrë me shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

33. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta i kanë arsyetuar vendimet e tyre duke iu referuar dispozitave të ligjit në fuqi. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se çështjet që parashtruesi ngre janë çështje të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë.

34. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

35. Gjykata Kushtetuese nuk mund të zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse tësë drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin*Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih edhe rastin nr. KI70/11, parashtrues*Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011). Fakti i thjeshtë se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e rastit, nuk do të thotë që ai nuk mund të ngrejë kërkesë të pranueshme duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë. Gjykata vëren se parashtruesit të kërkesës i janë dhënë shumë mundësi që ta paraqesë rastin e tij në gjykatat e rregullta.

36. Për më tepër, siç u përmend më lart, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 61/2015, të 26 marsit 2015, është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata ka gjetur se procedurat para gjykatave të rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

37. Për këtë arsye, sa i përketpretendimit të parashtruesit të kërkesës segjykatat e rregullta,dukerefuzuarkërkesën e tijpër të thirrur dëshmitarëtë cilët ai i konsideronte sitë rëndësishëm, kishinshkelurtë

drejtat e tijkushtetuese, Gjykatavëren sekjoçështje ishteadresuardhearsyetuarnë substancëmeAktgjykimin e Gjykatëssë Apelit.

38. Për shkak të arsyeve të lartpërmendura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të së drejtës kushtetuese, në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës dhe ai nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

39. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar.

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

40. Siç është theksuar më lart, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata *"Të vendos caktimin e Masës së Përkohshme kundër Gjykatë Themelore në Prizren me të cilin do ti ndalohet fillimi i ekzekutimit të dënimit ndaj të dënuarit Rasim Rama [...]"*.

41. Në mënyrë që Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) dhe (5) të Rregullores së punës, është e nevojshme që:

> *"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
>
> *(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të*
> *paripareueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; dhe*
>
> *(...) Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".*

42. Siç u theksua më lart, kërkesa e parashtruesit është e papranueshme dhe, për këtë arsye, nuk ka rast*prima facie* për vendosjen e Masës së përkohshme. Prandaj, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.

Kërkesa për moszbulim të identitetit

43. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për moszbulim të identitetit të tij, Gjykata e refuzoi kërkesën e tij si të pabazuar, pasi që ai nuk ka ofruar

dokumentacion dhe informacione përcjellëse që e arsyetojnë kërkesën e parashtruesit për moszbulim të identitetit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 27 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (2) (b) dhe (d), 55 (4) dhe (5) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 6 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. TA REFUZOJË kërkesën e parashtruesit për moszbulim të identitetit të tij;

IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

V. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI187/14, Parashtrues Met Gashi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 192/2014, i 20 tetorit 2014

KI187/14, Aktvendim i papranueshëm i 13 gushtit 2015 publikuar më 4 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, e drejtat për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dëgjimi i dëshmitarëve, dënim me burg, vepër penale*

Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi kundër vendimeve të gjykatave të instancës së ulët që kishin dënuar me burgim parashtruesin e kërkesës. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese për proces të parregullt gjyqësor sepse gjykatat e rregullta kishin refuzuar dëgjimin e dy dëshmitarëve të propozuar nga ai.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se është në diskrecionin e gjykatave të rregullta që të vendosin nëse do të dëgjojnë dëshmitarët e propozuar nga parashtruesi, sidomos në rastet kur ato konsiderojnë se ata dëshmitarë nuk mund të ndihmojnë në përcaktimin e të vërtetës. Gjykata Kushtetuese konstatoi se procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta nuk kishin qenë të padrejta ose arbitrare. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI187/14
Parashtrues
Met Gashi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 192/2014, të 20 tetorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Met Gashi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) nga Prizreni, i përfaqësuar nga z. Rexhep Kabashi, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme,Pml. nr. 192/2014, i 20 tetorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohen të jenë shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), sepse gjykatat e rregullta i kufizuan atij të drejtat për të paraqitur prova, dhe për të dëgjuar dëshmitarët.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 (b) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 31 dhjetor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR. KI187/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović, gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin KSH. KI187/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 20 janar 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 25 qershor 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë.

9. Më 2 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e mbështeti raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

10. Më 3 gusht 2015, Aktvendimi për papranueshmëri iu shpërnda gjyqtarëve të Gjykatës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 18 mars 2014, Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm (Aktgjykimi P. nr. 430/12) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe e dënoi atë me burgim. Nëprocesverbalin eshqyrtimit kryesor, është vërejturseparashtruesii kërkesës propozoi të dëgjohen dy dëshmitarëmeqëllim që tëkonfirmohetmarrëdhënia në mes të parashtruesit të kërkesës dhepalës së dëmtuar, se pseata ishin takuar dheçfarë ishtekonkluduarnëatë takim. Gjykatae shkallës së parëe refuzoipropozimine parashtruesitpër shkak sedëshmitarët e propozuarnukishin të pranishëmgjatë takimitdhe ata nukmund të dinëobjektivishtrrethanatnë të cilatparashtruesi i kërkesës veproi në raportme palëne dëmtuar.

12. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe dënimit të shqiptuar.

13. Më 22 korrik 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAI. nr. 709/2014) refuzoi ankesën, si të pabazuar, dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit vlerësoi se Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkeljet e pretenduara dhe se Aktgjykimi është i qartë dhe përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare, të cilat e karakterizojnë veprën penale.

14. Parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së Ligjit penal. Parashtruesi për herë të parë pohoi se gjykata e shkallës së parë kishte refuzuar të dëgjojë dy dëshmitarë të propozuar nga parashtruesi i kërkesës, dhe propozimin e parashtruesit për nxjerrjen e mesazheve të komunikimit në mes tij dhe të palës së dëmtuar.

15. Më 20 tetor 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 192/2014) refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata Supreme konstatoi se nga procesverbali i shqyrtimit kryesor është vërejtur se gjykata e shkallës së parë kishte dhënë arsye të bazuara mirë për refuzimin e propozimit të parashtruesit për t'u dëgjuar dy dëshmitarë dhe për nxjerrjen e mesazheve të komunikimit. *"[...] për faktin se sipas shkresave të çështjes vërtetohet se dëshmitari [...], ka qenë personi i cili e ka njoftuar të dënuarit dhe të dëmtuarin, dhe se në zyrën e tij është biseduar lidhur me zhvillimin e blegtorisë, plasimin e mishit në fabrikë, dhe me projektin zhvillimor që e ka pasur i dënuari dhe se ka pasë projekte të tilla, por ato projekte nuk i ka pa personalisht. Po ashtu, nga deklarata e dëshmitarit [...], është vërtetuar fakti se që qëllimi i takimit të dënuarit me të dëmtuarin ka qene gjoja programi nga Bashkësia Evropiane për zhvillimin e bujqësisë-blegtorisë, dhe se pas këtij takimi të cilin takim e vërteton edhe dëshmitari [...], ka ardhë deri tek marrëveshja që i dënuari dhe dëshmitari [...] do të sigurojnë blegtoret të cilët do t'i rrisin kafshët për të bërë përpunimin e mishit në fabrike në tokat e Erenikut që do t'i ndërtoje Bashkësia Ndërkombëtare e nëpërmjet të dënuarit. Po ashtu, nga fletëpagesat të cilat gjenden në shkresat e lendes vërtetohet se janë kryer transaksionet bankare nga data 12.3,2007 e deri në fund të muajit dhjetor 2008, nëpërmjet të cilave janë transferuar shumat prej 35.000 €, 75.000 €, e gjithësejt 162.000 € nga i dëmtuari në emër të*

dënuarit, shuma të cilat asnjëherë nuk janë kthyer. Poashtu nga shkresat e çështjes vërtetohet se pas që deri tek projektet e përfolura nuk ka pas asnjë shenje të realizimit,i dëmtuari ka lidhur me të dënuarin marrëveshje për kthimin e "borxhit". Nga të gjitha këto fakte të vërtetuara nga gjykata e shkalles se pare dhe dyte, rrjedhe se pretendimet nga kërkesa e të dënuarit dhe mbrojtësit te tij janë të pabazuara".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se janë shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës dhe neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ, sepse:

    a. gjykata e shkallës së parë kishte refuzuar propozimin e parashtruesit për dëgjimin e dy dëshmitarëve dhe për nxjerrjen e mesazheve komunikuese;

    b. gjykata e shkallës së parë kishte kufizuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës të marrë në pyetje dëshmitarët.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

    "Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

19. Përveç kësaj, rregullat36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, parashohin:

    "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

    [...]

    (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

20. Gjykata vëren se në rastin konkret parashtruesi i kërkesës ankohet se gjykatat e rregullta kishin hedhur poshtë propozimet e tij për të dëgjuar dy dëshmitarë, për të lexuar mesazhet e komunikimit në mes të parashtruesit të kërkesës dhe palës së dëmtuar, dhe se gjykata e shkallës së parë e kishte kufizuar të drejtën e tij për të marrë në pyetje dëshmitarët.

21. Në këtë drejtim, Gjykata vëren sesi rregull i përgjithshëm, i takon gjykatave të rregullta që të vlerësojnë provatpara tyre, si dhe rëndësinë edëshmivetë cilati akuzuarikërkon tësjellë(Shih rastin LaskadheLikakundër Shqipërisë, kërkesat nr.12315/04dhe17605/04, Aktgjykimi i 20prillit 2010). Sa i përketthirrjesdhe pyetjes së dëshmitarëve, kjonuk i jepnjë personi të akuzuartë drejtë të pakufizuartë kërkojë paraqitjene dëshmitarëvenë gjykatëdhei akuzuariduhet të sigurojëarsyet përthirrjendhe pyetjen e dëshmitarëve. Gjykatat e rregulltajanë të liratë refuzojnëqë të ftojnëdëshmitarët e propozuarnga mbrojtja,me arsyetimin segjykatakonsideron se nuk ka gjasa që dëshmitëe tyredo të ndihmojnë nëpërcaktimin e së vërtetës(Shih rastin Huseyndhe të tjerët kundërAzerbaijan, Kërkesanr. 35485/05, 45553/05, 35680/05dhe36085/05, Aktgjykim i 26korrikut 2011).

22. Gjykata rithekson që nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, duke përfshirë mënyrën se si janë marrë provat, kanë qenë të drejta (Shih rastin *Khan kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* Kërkesa Nr. 35394/97,Aktgjykim i 12 majit 2000).

23. Në lidhje me këtë, Gjykata vërenseparashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Themelore për t'i dëgjuar dy dëshmitarë dhe për t'i nxjerrë mesazhet e komunikimit. Kjo ishte refuzuar nga Gjykata Themelore për arsyet e lartpërmendura.

24. Parashtruesi i kërkesës ngritipërherë të parëpara GjykatësSupreme,dhejoparaGjykatës së Apelit,pretendiminsegjykata eshkallës së parëkishte refuzuartë dëgjojëdy dëshmitarëtë propozuarnga parashtruesi i kërkesësdhepropozimine tijpër të nxjerrëmesazhet e shkëmbyera në mes tëparashtruesit dhepalës së dëmtuar. Gjykata SupremenëAktgjykimin e sajkishte dhënëarsyetndaj pretendimeve tëparashtruesit duke deklaruar segjykata eshkallës së parë kishtearsyetuarrefuzimin epropozimittë parashtruesit të kërkesës.

25. Për më tepër, Gjykata Supreme vëren se parashtruesi i kërkesës kishte pasur mundësi të shumta që ta mbrojë veten gjatë procedurave të mbajtura në gjykatat e rregullta.

26. Në rastin konkret, Gjykata nuk gjen se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata gjen se parashtruesi nuk ka dëshmuar në mënyrë të qartë se si ndonjëri nga dëshmitarët, të cilët Gjykata Themelore kishte refuzuar t'i dëgjojë, mund të kishte ndihmuar mbrojtjen e tij lidhur me akuzat e ngritura kundër tij. Është detyrë e parashtruesit të kërkesës t'ia bashkëngjitë dokumentet e nevojshme kërkesës së tij, dhe nuk është detyrë e Gjykatës ta ndërtojë rastin, apo të kërkojë dokumente *ex officio,* të cilat eventualisht do të ishin në dobi të tij.

27. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d), 36 (2) (d) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 13 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI167/14, Parashtrues NTP Unio Commerce, Zelqif Berisha, pronar - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0045-A0001, të 26 qershorit 2014

KI167/14, Aktvendim për papranueshmëri i 28 gushtit 2018, publikuar më 8 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, person i paautorizuar, procesi i privatizimit*

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme kishte refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruesit, përkitazi me vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për tërheqjen e të gjitha aksioneve në Ndërmarrjen e Re Hoteli Grand SHPK, që ishin blerë nga parashtruesi i kërkesës. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese me pretendimet për shkelje të barazisë para ligjit, gjykimit të drejtë dhe të paanshëm dhe mbrojtje të pronës.

Përkitazi me përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, Gjykata vlerësoi se parashtruesi i kërkesës është palë e paautorizuar për çështje të tilla kushtetuese. Përkitazi me pretendimet për shkelje të së drejtës në pronë dhe të drejtës për gjykim të dejtë dhe të paanshëm, Gjykata konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar pretendimet e tij për shkelje të parimit të të drejtave të tij për barazi para ligjit, për mbrojtje të pronës dhe për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI167/14
Parashtrues
NTP Unio Commerce,
Zelqif Berisha,pronar
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0045-A0001, të 26 qershorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është NTP Unio Commerce, me seli në komunën e Hanit të Elezit, me pronar z. Zelqif Berisha. Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga z. Alexander Borg Olivier, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së), AC-I-13-0045-A0001, të 26 qershorit 2014, me të cilin vërtetohet Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së), C-I-12-0042, të 20 marsit 2013.

3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 14 korrik 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] në lidhje me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe të drejtave të tij të garantuara me nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut [në tekstin e më[tejmë: KEDNJ] dhe me nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës dhe në nenet 29 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 14 nëntor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 24 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

8. Më 26 nëntor 2014, Gjykata informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës DHPGJS-së dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

9. Më 8 dhjetor 2014, Gjykata vendosi ta refuzojë kërkesën për Masë të përkohshme (Shih Vendimin për Masë të përkohshme KI167/14, të publikuar më 17 dhjetor 2014).

10. Më 9 dhjetor 2014, Gjykata ua dërgoi nga një kopje të kësaj kërkese për informacion parashtruesve të kërkesës në rastin KI168/14, ku kontestohej Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-I-13-0045-A0001, i 26 qershorit 2014.

11. Më 2 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një kopje të kërkesës urgjente, të cilën ai e kishte dorëzuar në DHPGJS, duke kërkuar *"[...] të urdhërojë menjëherë pezullimin e të gjitha veprimeve në*

procedurën për likuidim derisa Gjykata Kushtetuese e Kosovës të nxjerrë Aktgjykimin e saj në rastin lidhur me Ndërmarrjen e Re Hoteli Grand Prishtinë".

12. Më 26 qershor2015,me VendimineKryetares së Gjykatës, gjyqtariIvan Čukaloviću caktua gjyqtar raportues në vend tëgjyqtaritKadri Kryeziu, mandati i të cilitsigjyqtariGjykatësKushtetueseka përfunduarmë 26 qershor2015.

13. Më 26 qershor2015,me VendimineKryetares së Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi u caktua anëtare e Kolegjit shqyrtues, në vend tëEnver Hasanit, mandati i të cilitsigjyqtariGjykatësKushtetueseka përfunduarmë 26 qershor2015.

14. Më 6 korrik2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

15. Në vitin 2005, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM), inicioi një "Spin Off Special" të shitjes, përmes privatizimit, të objekteve të Hotelit Grand në Prishtinë.

16. Pas përfundimit të procesit të ofertimit, kontrollit të historikut dhe çështjes gjyqësore në Dhomën e Posaçme, AKM-ja kishte shpallur parashtruesin e kërkesës si ofertuesin fitues.

17. Më 10 gusht 2006, AKM-ja lidhi kontratë me parashtruesin e kërkesës për t'i shitur këtij tërë kapitalin aksionar të Ndërmarrjes së Re Hoteli Grand SHPK (në tekstin e mëtejmë: Hoteli Grand). Si rrjedhojë, aksionet ishin regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në emër të NTP Unio Commerce.

18. Kontrata e lidhur ndërmjet AKM-së dhe parashtruesit të kërkesës detyronte parashtruesin që të përmbushë disa kushte të caktuara, të parapara në Marrëveshjen e zotimeve. Ndër ato kushte ishin zotimet për të realizuar investime të caktuara financiare në ndërtesën e Hotelit Grand dhe për të punësuar një numër të caktuar punëtorësh brenda një afati të caktuar kohor. Mospërmbushja e këtyre obligimeve mund të rezultonte në tërheqjen e aksioneve nga parashtruesi i kërkesës.

19. Më 31 maj 2012, Bordi i Drejtorëve të AKP-së, si pasardhëse ligjore e AKM-së, vërtetoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte vepruar në përputhje të plotë me zotimet për investime dhe punësim, që ishin përcaktuar në Marrëveshjen e zotimeve. Prandaj, AKP-ja njëzëri

vendosi ta ushtrojë tërheqjen e të gjitha aksioneve dhe kështu i tërhoqi të gjitha aksionet në Ndërmarrjen e Re Hoteli Grand SHPK që ishin blerë nga parashtruesi i kërkesës.

20. Si rezultat i këtij vendimitëBordit të Drejtorëve të AKP-së, aksionet dhe objektet e Hotelit Grand kanë kaluar në administrimin e AKP-së.

21. Më 8 qershor 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së. Parashtruesi po ashtu parashtroi kërkesë për Masë të përkohshme, duke kërkuar nga Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së ta ndalojë AKP-në nga tjetërsimi i aksioneve të Hotelit Grand te palët e treta deri në marrjen e vendimit përfundimtar përkitazi me meritat e padisë së tij.

22. Në padinë e tij, parashtruesi i kërkesës kontestoi vlefshmërinë e Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 majit 2012, për të ushtruar opsionin e tërheqjes së aksioneve të Hotelit Grand. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës konstatoi që *"konform nenit 6.2 të Marrëveshjes së Zotimeve, tërheqja e aksioneve ushtrohet vetëm me udhëzime me shkrim të Autoritetit Ushtrues dhe se konform nenit 1 të Marrëveshjes së Zotimeve, lidhur me definicionin 'Autoritet Ushtrues" në rast se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) më nuk ekziston, ai do të zëvendësohet me një tribunal arbitrar, i formuar në pajtim me procedurat e parashtruara në piken 9.3.2 (b) të Marrëveshjes".*

23. Më 29 qershor 2012, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së (Aktvendimi, C-I-12-0042), refuzoi kërkesën për Masë të përkohshme, duke arsyetuar se për rastin në fjalë nuk kishte asnjë indikacion se mund të shkaktohej ndonjë dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm dhe i cili nuk mund të zhdëmtohej në mënyrë të arsyeshme dhe me anë të një kompensimi financiar.

24. Si rezultat i ankesës së parashtruesit ndaj refuzimit të Masës së përkohshme, më 27 shtator 2012, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së (Aktvendimi, AC-I-12-0042), e pranoi ankesën e parashtruesit si pjesërisht të bazuar dhe vendosi: *"AKP-së i ndalohet tjetërsimi i aksioneve të New Co Hotel Grand tek palët e treta, deri në vendimin përfundimtar mbi meritat e padisë".*

25. Më 20 mars 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së (Aktgjykimi, C-I-12-0042, i 20 marsit 2013), refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, duke arsyetuar se shkeljet e Marrëveshjes për zotime nga parashtruesi i kërkesës ishin të rënda dhe se vendimi i AKP-së për të ushtruar tërheqjen e aksioneve të Hotelit Grand ishte i vlefshëm.

26. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së më tej konstatoi se AKP-ja, në bazë të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Ligji i AKP-së), me të drejtë ktheu mbrapsht shitjen, duke ushtruar opsionin e tërheqjes së aksioneve dhe se Ligji i AKP-së, i cili zëvendëson Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit me AKP-në, është ligj i vlefshëm i Kosovës.

27. Parashtruesi ushtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës, të vlerësimit të gabuar të fakteve dhe të interpretimit të gabuar të së drejtës materiale.

28. Parashtruesi i kërkesës në veçanti theksoi: *"[...] konform nenit 6.2 të Marrëveshjes së Zotimeve, tërheqja e aksioneve ushtrohet vetëm me udhëzime me shkrim të Autoritetit Ushtrues dhe se konform nenit 1 të Marrëveshjes së Zotimeve, lidhur me definicionin 'Autoritet Ushtrues" në rast se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) më nuk ekziston, ai do të zëvendësohet me një tribunal arbitrar, i formuar në pajtim me procedurat e parashtruara në piken 9.3.2 (b) të Marrëveshjes. Paditësi thekson se kontrata qartazi i referohet një tribunali të pavarur dhe të paanshëm, i cili do të vendose se nëse palet i kanë përmbushur obligimet e tyre kontraktuese. Paditësi, më tej thotë se Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) si pasardhëse ligjore e AKM-së ka të drejtë vetëm të kërkoj nga Autoriteti Ushtrues lejen për ta ushtruar tërheqjen e aksioneve dhe jo edhe tërheqjen e shitjes. me vendim të njëanshëm. I njëjti do të parashikohet edhe ne 'Letrën për autorizim të transferit të Pronësisë së Aksioneve", të nënshkruar nga paditësi".*

29. Më 26 qershor 2014, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së (C-I-12-0042, e 20 marsit 2013).

30. Në aktgjykimin e tij, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së konstatoi se të gjitha argumentet e paraqitura nëankesë ishin shqyrtuar mirë nga Kolegji i Specializuar dhe me të drejtë ishte refuzuar padia e parashtruesit të kërkesës.

31. Lidhur me pohimin e parashtruesit të kërkesës se "*në rast se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) më nuk ekziston, ai do të zëvendësohet me një tribunal arbitrar, i formuar në pajtim me procedurat e parashtruara në piken 9.3.2 (b) të Marrëveshjes",* Kolegji i Ankesave konstatoi si në vijim:

> *"Bordi i Drejtorëve të së padituës në mënyrë të vlefshme ka mundur që të lëshojë tërheqjen e aksioneve. Nuk ka pasur nevojë*

për udhëzim me shkrim paraprak nga ana e PSSP siç është e parashkruar me anë të nenit 6.2 të Marrëveshjes së Zotimeve dhe nuk ka pasur nevojë gjithashtu as për arbitrazh paraprak. Të dyja kushtet janë shfuqizuar me anë të nenit 31 të Ligjit mbi AKP-në. Autoriteti i PSSP-së është transferuar me anë të Ligjit tek Bordi i Drejtorëve i të paditurës. Është e vërtetë se me anë të nenit 31 të Ligjit mbi AKP-në detyrat dhe të drejtat kontraktuara të palëve, të cilat dalin nga Marrëveshja e Zotimit, kanë ndryshuar. Paditësi e humb rastin që PSSP të mos udhëzojë një tërheqje të aksioneve dhe gjithashtu e humb të drejtën që të hyjë në arbitrazh në lëndën, ku PSSP nuk ekziston më apo - siç doli të jetë, nuk ekziston më me kapacitetet ekzekutive të cilat i kishte në kohën e lidhjes së kësaj marrëveshje."

32. Rrjedhimisht, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së konkludoi si në vijim:

"[...] Kolegji i Ankesave konsideron se paditësi nuk i ka plotësuar substancialisht kushtet e përcaktuar me marrëveshjen e zotimeve, dhe mos plotësimi i tyre është e qartë së paraqet shkelje të madhe të obligimeve kontraktuale të marrëveshjes (që është parakusht për vendimin refuzues), dhe këtu nuk ka pasur asnjë kundërshtim të argumentuar, as të vetë paditësit. Nga shkresat e lëndës kolegji i Ankesave gjeti se kishte disa parashtresa nga e paditura qe ia dërgonte paditësit duke ia tërhequr vërejtjen për kalimin e afateve për përmbushje të obligimeve, madje kishte edhe penallti për këtë dështime, megjithatë, paditësi nuk ka arritur qe t'i plotësoj zotimet e marra me Marrëveshje".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së (AC-I-13-0045-A0001, i 26 qershorit), me të cilin vërtetohet Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS (C-I-12-0042, i 20 marsit 2013) ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] në lidhje me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], si dhe të drejtat të tij garantuara me nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] dhe me nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

34. Në këtë drejtim, pretendimet e parashtruesit të kërkesës duhet të ndahen si në vijim:

- Pretendimet lidhur me shkeljen e parimit të barazisë;

- Pretendimet lidhur me shkeljen e mbrojtjes së pronës; dhe
- Pretendimet lidhur me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë.

Pretendimet lidhur me shkeljen e parimit të barazisë

35. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

36. Në këtë drejtim, parashtruesi argumenton se parimi i barazisë ishte shkelur për shkak të trajtimit të pabarabartë të parashtruesit të kërkesës në procedurën në DHPGJS, gjykimit përtej fushëveprimit të padisë së parashtruesit nga ana e DHPGJS-së dhe aplikimit të Ligjit të AKP-së nga ana e DHPGJS-së.

37. Fillimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se DHPGJS-ja lejoi AKP-në, si të paditur në procedurë, që të paraqesë prova dhe argumente, në mënyrë që të arsyetojë vendimin e saj për të tërhequr pronësinë e parashtruesit mbi Hotelin Grand. Parashtruesi i kërkesës konsideron se, me këtë, DHPGJS-ja kishte dëmtuar pozitën e tij dhe në këtë mënyrë pretendohet se ai ishte vënë në pozitë të pafavorshme. Prandaj, parashtruesi i kërkesës konkludon se DHPGJS-ja kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 të Kushtetutës.

38. Së dyti, parashtruesi i kërkesës pretendon se DHPGJS-ja tejkaloi fushëveprimin e padisë së parashtruesit të kërkesës dhe i ishte përgjigjur pretendimeve të AKP-së si e paditur, që konkludonte se parashtruesi i kërkesës kishte bërë shkelje të rëndë të zotimeve. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendoi se DHPGJS-ja kishte gjykuar rastin pa i dhënë parashtruesit mundësi të barabartë që të adresojë faktet dhe pretendimet e bëra nga AKP-ja. Prandaj, parashtruesi i kërkesës konkludon se DHPGJS-ja kishte shkelur parimin e barazisë.

39. Së treti, parashtruesi i kërkesës pretendon se, me anë të Ligjit, AKP-ja kishte transformuar veten nga një palë në kontratë në Autoritetin Ushtrues, i cili autorizoi tërheqjen e pronësisë së Hotelit Grand. Parashtruesi i kërkesës pranon se zëvendësimi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (në tekstin e mëtejmë: PSSP) me Bordin e Drejtorëve të AKP-së është në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës, të mishëruar në Kushtetutë. Megjithatë, parashtruesi pretendon që, në qoftë se "*[...] zëvendësimi është aplikuar për kontratat e AKP-së, dhe zbatohet në mënyrë retroaktive në një mënyrë që i jep njërës palë kontraktuese fuqi të njëanshme të bëjë të pavlefshëm një element thelbësor të kontratës, atëherë kjo do të shkelte Kushtetutën*".

Pretendimet lidhur me shkeljen e mbrojtjes së pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

40. Parashtruesi i kërkesës gjerësisht citon praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) dhe argumenton se aktgjykimi i kontestuar përbën shkelje *"[...] të mbrojtjes që i jepet parashtruesit me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së dhe të nenit 46 të Kushtetutës së Kosovës [...]"*.

41. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës argumenton se AKP-ja, duke vepruar si agjenci e Qeverisë, *" [...]në mënyrë të paligjshme dhe pa një proces të rregullt ka marrë pronësinë dhe posedimin e kësaj prone nga pronari privat, me vetëm një kompensim nominal dhe pa asnjë procedurë gjyqësore"*.

Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së

42. Parashtruesi i kërkesës pretendon se trajtimi i pabarabartë nga DHPGJS-ja, gjykimi përtej fushëveprimit të padisë së parashtruesit, zbatimi dhe interpretimi i Ligjit të AKP-së dhe ndërhyrja e paligjshme në zotërimet e parashtruesit *"[...] kanë shkelur gjithashtu, në mënyra të ndryshme specifike, të drejtat e tij themelore siç parashikohen me dispozitat e nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës"*.

43. Parashtruesi i kërkesës pretendon se trajtimi i pabarabartë lidhet me trajtimin e padrejtë gjatë procedurës në DHPGJS dhe, si i tillë, *"pabarazia e armëve në vetvete krijon shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së pasi ajo krijon një paragjykim ndaj njërës prej palëve, në këtë rast, parashtruesit të kërkesës"*.

44. Parashtruesi i kërkesës pretendon se DHPGJS-ja ka detyrim ligjor për t'u dhënë palëve në procedurë mundësi të barabarta që të paraqesin të gjitha provat e tyre dhe të mbrojnë çështjen e tyre. Prandaj, sipas parashtruesit të kërkesës, atij nuk i është ofruar një proces i drejtë dhe i paanshëm, si dhe një mundësi për ta paraqitur rastin e tij.

45. Parashtruesi i kërkesës shpjegon se kërkesa e tij specifike për gjykim nga DHPGJS-ja, përtej padisë së parashtruesit të kërkesës, ishte si në vijim: *"Zelqif Berisha me biznes si NTP 'Unio Commerce' (Blerësi) konteston Vendimin e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), të 31 majit 2012 'për të ushtruar opsionin e tërheqjes së aksioneve' në stoqet e aksioneve të Ndërmarrjes së Re Hotelit Grand SHPK. Paditësi kërkon një Aktgjykim nga Dhoma e*

Posaçme, me të cilin do të shpallë se vendimi i Bordit është i paligjshëm si ultra vires".

46. Parashtruesi i kërkesës konsideron se fushëveprimi i padisë së tij ishte kufizuar dhe se DHPGJS-së i ishte kërkuar të përgjigjet në një çështje procedurale të një rëndësie themelore. Rrjedhimisht, parashtruesi argumenton se ka pasur shkelje të së drejtës së tij të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse DHPGJS-ja *"[...] adresoi çështjen e paraqitur vetëm shkarazi, dhe pastaj shkoi përtej çështjes para saj, që ta miratojë veprimin e AKP-së sikur AKP-ja të ishte Autoriteti Ushtrues".*

47. Parashtruesi më tej pretendon se Bordi i Drejtorëve i AKP-së, duke marrë rolin e Autoritetit Ushtrues në bazë të Ligjit të ri për AKP-në, ndryshoi në mënyrë të njëanshme parametrat e marrëveshjes duke e tërhequr pronësinë e Hotelit Grand.

48. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se janë shkelur parimet e drejtësisë dhe të paanshmërisë, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse *"veprimi i Trupit gjykues e ka privuar paditësin nga e drejta kontraktuale për të pasur një agjent të pavarur për vlerësimin e fakteve, objektivisht dhe në mënyrë të paanshme dhe pastaj të vendosë për shpronësimin (Opsioni i tërheqjes të aksioneve) para se të veprojë agjencia qeveritare (AKP-ja)".*

49. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës argumenton se shkelja e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në mënyrë implicite shkakton shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së, sepse ai *"[...] kurrë nuk i kishte pasur faktet për të cilat ishte ankuar, fakte që lidhen me pronën e tij që ishte hetuar me forcë, në mënyrë të njëanshme dhe gjyqësisht të paligjshme".*

50. Në fund, parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar që Gjykata t'i anulojë aktgjykimet e Dhomës së Specializuar të DHPGJS-së (CI-12-0042, të 20 marsit 2013) dhe atë të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së (AC-I-13-0045-A0001, të 26 qershorit 2014).

Dispozita përkatëse e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nr. 04/L-034

Neni 31 [Ligji në fuqi]

"1. Ky ligj mbisundon çdo dispozitë tjetër të së drejtës në Kosovë që është në kundërshtim me të. Pa paragjykim ndaj aplikimit të

përgjithshëm të fjalisë së mëparshme, parashihet në mënyrë specifike që Ligji për Procedurën Administrative nuk do të vlejë:

1.1. për çfarëdo veprimi të ndërmarrë nga Agjencia sipas autorizimeve të këtij ligji lidhur me privatizimin, likuidimin, shitjen, transferimin, restrukturimin, riorganizimin apo mënyrat tjera të zgjidhjes së një ndërmarrje, korporate apo aseti, dhe

1.2. për trajtimin dhe përcaktimin nga Agjencia të autoritetit të likuidimit të çfarëdo pretendimi apo interesi të bërë apo të pohuar nga cilido person si kreditor apo pronar i supozuar.

2. Me këtë ligj shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-067, "për Agjencinë Kosovare të Privatizimit".

3. Agjencia merr përsipër të gjitha asetet dhe detyrimet të cilat ajo ose paraardhësja e saj i ka mbajtur, fituar apo shkaktuar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12. Bordi dhe menaxhmenti i Agjencisë i përmbushin të gjitha përgjegjësitë e cilitdo Bordi ose menaxhmenti paraardhës të emëruar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12.

4. Pa paragjykim ndaj fushëveprimit të përgjithshëm të paragrafit të mëparshëm apo paragrafit 2. të nenit 3 të këtij ligji, parashihet në mënyrë specifike që Agjencia është trashëgimtarja ligjore dhe ekskluzive e cilësdo apo të gjitha të drejtave dhe obligimeve të AKM-së që janë specifikuar apo kanë dalë në lidhje me ndonjë kontratë që është ekzekutuar më parë nga AKM-ja dhe një apo më shumë palë të treta që si objekt kryesor të tyre kanë pasur menaxhimin, operimin, shitjen, transferimin, likuidimin apo ndonjë mënyrë tjetër të disponimit me ndërmarrjen, korporatën, asetin apo çfarëdo interesi në cilëndo nga këto. Çdo referim i kontratave të tilla në AKM do të interpretohet në mënyrë përfundimtare se nënkupton Agjencinë. Çdo referim i kontratave të tilla në Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm do të interpretohet në mënyrë përfundimtare se nënkupton Bordin e Agjencisë. Nëse kontrata përmban një apo më tepër dispozita që specifikojnë që kontrata bazohet në ndonjë ligj të ndonjë shteti të huaj:

4.1. as ajo dispozitë e as ai ligj i shtetit të huaj nuk përdoret, interpretohet apo zbatohet në mënyrë të tillë që të shmangë apo pakësojë kriteret e paraqitura më lart në këtë paragraf , dhe

4.2. ky paragraf nuk interpretohet si paragraf që e bën të vlefshëm apo të pavlefshëm, në tërësi apo pjesërisht, në çfarëdo mënyre, zgjedhjen e ligjit të specifikuar në atë dispozitë; vlefshmëria apo pavlefshmëria përcaktohet në pajtim me rregullat e aplikueshme të së drejtës ndërkombëtare private.

5. Drejtorët e Bordit të emëruar nga PCN sipas nenit 12, paragrafi 3. do të vazhdojnë të qëndrojnë në pozitat e tyre edhe pas përfundimit të mandatit të PCN dhe do të kompensohen nga të ardhurat e dedikuara të AKP-së përveç nëse vendoset ndryshe nga PCN para përfundimit të mandatit të tij.

Pranueshmëria e kërkesës

51. Së pari, Gjykata shqyrton nëseparashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

52. Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

53. Gjykata i referohet edhe rregullit36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

54. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së (AC-I-13-0045-A0001, i 26 qershorit 2014), me të cilin vërtetohet Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së (C-I-12-0042, i 20 marsit 2013) ka shkelur parimin e barazisë, të drejtën në pronë dhe të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Pretendimet lidhur me shkeljen e parimit të barazisë

55. Parashtruesi i kërkesës pohon se aktgjykimet e kontestuara të DHPGJS-së kanë shkelur parimin e barazisë, të garantuar me nenin 3 të Kushtetutës.

56. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se ai ishte trajtuar në mënyrë të pabarabartë, se DHPGJS-ja gjykoi përtej fushëveprimit të padisë së parashtruesit të kërkesës dhe aplikoi në mënyrë të gabueshme Ligjin për AKP-në.

57. Së pari, parashtruesi i kërkesës pretendon se ai ishte trajtuar në mënyrë të pabarabartë në procedurë nga DHPGJS-ja, sepse DHPGJS-ja lejoi AKP-në, si të paditur në procedurë, të paraqesë prova dhe argumente, në mënyrë që ta arsyetojë vendimin e saj për të tërhequr pronësinë e parashtruesit mbi Hotelin Grand. Prandaj, sipas parashtruesit të kërkesës, AKP-ja kishte dëmtuar pozitën e tij dhe në këtë mënyrë ai ishte vënë në pozitë të pafavorshme.

58. Gjykata vëren se Kolegji i Apelit të DHPGJS-në në aktgjykimin e tij konstatoi që:

> *"Ndryshimi i ligjit nuk nënkupton se e paditura, si palë në një marrëveshje zotimi dhe e paraparë për të qenë në cilësinë e një pale në një arbitrazh të mundshëm, ndryshon ne pozitën e një gjyqtari në lëndën e vetë. E paditura mbetet një palë qe ushtron të drejtën e saj për një tërheqje të re të aksioneve. Mbetet e ekspozuar ndaj vlerësimit të pavarur gjyqësor të Dhomës së Posaçme për te vendosur nëse ka vepruar ligjërisht ose jo kur ka vepruar në atë mënyrë".*

59. Së dyti, parashtruesi i kërkesës pretendon se DHPGJS-ja tejkaloi fushëveprimin e padisë së parashtruesit, sepse duke i shqyrtuar pretendimet e AKP-së, si e paditur, DHPGJS-ja konkludoi se parashtruesi i kërkesës kishte bërë shkelje të rëndë të zotimeve.

60. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së arsyetoi aktgjykimin e tij si në vijim:

> *"Nga kjo që është thënë në ankesë, Kolegji i Ankesave nuk gjen asnjë argument që gjykata të ketë tejkaluar limitet e përcaktuara me padi, sepse ajo ka vendosur vetëm me një pikë të dispozitivit- "Padia refuzohet si e pabazuar", dhe asgjë më tepër. Ankuesi kishte një padi në Dhomën e Posaçme andaj është vendosur konform asaj padie. Sa i përket vlerësimit të Kolegjit të Specializuar se, ' gjykata e vlerëson se shkeljet e paditësit janë të rënda", Kolegji i Ankesave vlerëson se Trupi Gjykues nuk i ka tejkaluar kufizimet e tij dhe nuk e ka dhe nuk e ka rënduar paditësin, sepse ai është dashur të vlerësojë nëse paditësi i ka dhënë arsye AKP-së për të nxjerrë tërheqjen e aksioneve për të qenë në gjendje që të gjykojë kërkesën e plotë të paditësit për shpalljen të pavlefshme të tërheqjes së aksioneve. Pasi që Trupi Gjykues ka ardhur te përfundimi i drejtë se ka qenë brenda kompetencave të AKP-së për të lëshuar tërheqjen e aksioneve pa e konsultuar PSSP-në apo një tribunal arbitrazhi, ai duhej të vendoste nëse performanca e paditësit e ka bërë të nevojshme tërheqjen e aksioneve. Në të kundërtën, ai nuk, do të mund të kishte mundësi të vendoste nëse tërheqja e aksioneve është lëshuar drejtë dhe në këtë mënyrë padia të jetë e pabazuar apo nëse do të duhej ta shpallte të pavlefshëm me rezultatin ku padia do të ishte e suksesshme".*

61. Lidhur me pretendimin e parashtruesit për shkelje të parimit të barazisë, Gjykata konsideron se parashtruesi kishte pasur mundësinë për t'u përballur me akuza në dy instancat e DHPGJS-së dhe, në të vërtetë, ai ushtroi të drejtën e tij, duke parashtruar padinë dhe ankesën e tij në DHPGJS. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së, në përgjigje ndaj pretendimeve të mësipërme në lidhje me parimin e barazisë, është i arsyetuar dhe i drejtë.

62. Gjykata Kushtetuese nuk mund ta zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih, gjithashtu, rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

63. Së treti, parashtruesi i kërkesës pohon se Bordi i Drejtorëve të AKP-së, në bazë të Ligjit për AKP-në, mori rolin e Autoritetit Ushtrues, duke autorizuar tërheqjen e pronësisë mbi Hotelin Grand.

64. Lidhur me këtë, Gjykata konsideron se parashtruesi ngre çështje të ligjshmërisë dhe prandaj ajo thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

65. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi gjithashtu ngre çështjen e përputhshmërisë së Ligjit të AKP-së me Kushtetutën.

66. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës nuk është një palë e autorizuar që të ngre çështje në Gjykatën Kushtetuese lidhur me përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, ose çështjet e përputhshmërisë kushtetuese të një ligji, kur ato ngrihen në një procedurë gjyqësore. Pajtueshmëria e ligjeve me Kushtetutën, apo çështjet kushtetuese të ngritura në procedurë gjyqësore, janë çështje të cilat janë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, por vetëm nëse ato janë të referuara nga palët e autorizuara, që në këtë rast janë vetëm Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria, Avokati i Popullit (neni 113. 2. 1), dhe gjykatat (neni 113.8). (Shih rastin KI118/14, parashtrues i kërkesës: *Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C,* Aktvendim për papranueshmëri, i 9 marsit 2015; shih rastin KO04/11, parashtrues i kërkesës: *Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës,* Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Nr. 03/L-139, Aktgjykim i 1 marsit 2012; shih rastin KO43/10, parashtrues i kërkesës *LDK-AAK-LDD, Prizren KK,* Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2011, paragrafët 19-21; dhe shih edhe rastin KI230/13, parashtrues i kërkesës *Tefik Ibrahimi,* Aktvendim për papranueshmëri, i 19 majit 2014, paragrafët 25-27).

67. Për arsyet e mësipërme, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkelje të së drejtës së tij për barazi para ligjit, siç garantohet me nenin 3 të Kushtetutës.

Pretendimet lidhur me shkeljen e mbrojtjes së pronës, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

68. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se aktgjykimet e kontestuara përbëjnë shkelje të mbrojtjes së pronës, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

69. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Kjo është një shkelje e qartë inter alia e nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, si dhe të neneve 22, 32, dhe 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përveç që përbën një shkelje të parimeve themelore të sundimit të ligjit [...] AKP-ja, duke vepruar si një agjenci e Qeverisë së Kosovës, në mënyrë të paligjshme dhe pa një proces të rregullt ka marrë pronësinë dhe posedimin e kësaj prone nga pronari privat, me vetëm një kompensim nominal dhe pa asnjë procedurë gjyqësore"*.

70. Lidhur me çështjen e kompensimit, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së në aktgjykimin e tij konstatoi që *"[...] çështja e problemeve gjatë realizimit të zotimeve sipas marrëveshjes, si dhe çështja e kompensimit-kthimit të mjeteve financiare të investuara, duhet të jetë objekt për një procedure tjetër gjyqësore"*.

71. Në lidhje me këtë, Gjykata pranon se parashtruesi i kërkesës kishte të drejtën në pronë, por humbja e asaj prone ishte legjitime, përkatësisht (a) në përputhje me ligjin; (b) i ka shërbyer një qëllimi legjitim (në interes të publikut); dhe (c) ishte e arsyeshme dhe proporcionale me synimin e kërkuar. Për më tepër, Gjykata vëren se tërheqja e pronësisë mbi aksionet e Hotelit Grand me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së është shqyrtuar dhe është vendosur nga DHPGJS-ja. Prandaj, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë në të dy vendimet e DHPGJS-së është i qartë dhe, pas shqyrtimit të procedurës, Gjykata gjithashtu ka gjetur se procedurat në DHPGJS nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).

72. Në përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë argument bindës për të dëshmuar se shkeljet e pretenduara paraqesin shkelje kushtetuese.

Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së

73. Siç u theksua më lart, parashtruesi pretendon se trajtimi i pabarabartë nga DHPGJS-ja, gjykimi përtej fushëveprimit të padisë së parashtruesit të kërkesës, zbatimit dhe interpretimit të Ligjit të AKP-së dhe ndërhyrjes së paligjshme në pronat e tij, kanë shkelur në mënyra të ndryshme të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

74. Së pari, parashtruesi i kërkesës pretendon se DHPGJS-ja kishte detyrim ligjor që t'u ofrojë palëve në procedurë mundësi të barabarta për të paraqitur dëshmi dhe për ta paraqitur rastin e tyre. Megjithatë,

sipas parashtruesit të kërkesës, atij nuk i ishte ofruar një gjykim i drejtë dhe i paanshëm dhe një mundësi për ta paraqitur rastin e tij.

75. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi apo argument se si dhe pse ai ishte trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe pse atij nuk i është ofruar një mundësi e arsyeshme për të paraqitur dëshmi dhe për ta paraqitur rastin e tij para DHPGJS-së.

76. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se pakënaqësia me vendimin nuk është e mjaftueshme që parashtruesi i kërkesës të ngre një pretendim bindës për shkelje kushtetuese të së drejtës për gjykim të drejtë. Kur pretendohen shkeljet kushtetuese, parashtruesi duhet të paraqesë argumente bindëse dhe të padiskutueshme për të mbështetur pretendimet e tij, në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar (Shih rastin Nr. KI198/13, parashtrues i kërkesës *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014).

77. Gjykata konsideron se edhe Kolegji i Specializuar, e edhe Kolegji i Apelit të DHPGJS-së, kanë kryer procedurat në mënyrë të drejtë dhe i kanë arsyetuar vendimet e tyre mbi bazën e padisë dhe të ankesës së parashtruesit të kërkesës.

78. Në lidhje me këtë, Gjykata gjithashtu vëren se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit të DHPGJS-së i kanë arsyetuar vendimet e tyre bazuar në prova edhe në arsyetimin e ofruar nga parashtruesi i kërkesës, në cilësi të paditësit dhe gjithashtu në bazë të provave dhe përgjigjeve ndaj padisë së parashtruar nga AKP-ja, në cilësinë e të paditurës. Bazuar në atë që u tha më sipër, fakti që edhe parashtruesit të kërkesës e edhe AKP-së, që të dyja palë në procedurë në DHPGJS, *"u është dhënë mundësia që të jenë në dijeni dhe të komentojnë të gjitha provat e sjella ose vrojtimet e paraqitura me qëllim të ndikimit në vendimin e gjykatës"* tregon se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së i kanë arsyetuar dhe i kanë nxjerrë vendimet e tyre në përputhje me parimet e garantuara me të drejtën për një gjykim kundërshtues (Shih rastin *Vermeulen kundër Belgjikës*, GJEDNJ, nr. 19075/91, Aktgjykim i 20 shkurtit 1996).

79. Së dyti, parashtruesi i kërkesës pretendon se DHPGJS-ja gjykoi përtej fushëveprimit të padisë së parashtruesit. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se fushëveprimi i padisë së tij ishte i kufizuar dhe se DHPGJS-së i është kërkuar të përgjigjet në një pyetje procedurale të një rëndësie themelore, përkatësisht që të përcaktojë se Vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së ishte i paligjshëm si *ultra vires*. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së,

sepse DHPGJS-ja *"[...] adresoi çështjen e paraqitur vetëm shkarazi, dhe pastaj shkoi përtej çështjes para saj, që ta miratojë veprimin e AKP-së sikur AKP-ja të ishte Autoriteti Ushtrues".*

80. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së konstatoi si në vijim:

> "*Nga kjo që është thënë në ankesë, Kolegji i Ankesave nuk gjen asnjë argument që gjykata të ketë tejkaluar limitet e përcaktuara me padi, sepse ajo ka vendosur vetëm me një pikë të dispozitivit - "Padia refuzohet si e pabazuar", dhe asgjë më tepër.*
>
> *[...]*
>
> *Kolegji i Ankesave vlerëson se Trupi Gjykues nuk i ka tejkaluar kufizimet e tij dhe nuk e ka rënduar paditësin, sepse ai është dashur të vlerësojë nëse paditësi i ka dhënë arsye AKP-së për të nxjerrë tërheqjen e aksioneve për të qenë në gjendje që të gjykojë kërkesën e plotë të paditësit për shpalljen të pavlefshme të tërheqjes së aksioneve. Pasi që Trupi Gjykues ka ardhur te përfundimi i drejtë se ka qenë brenda kompetencave të AKP-së për të lëshuar tërheqjen e aksioneve pa e konsultuar PSSP-në apo një tribunal arbitrazhi, ai duhej të vendoste nëse performanca e paditësit e ka bërë të nevojshme tërheqjen e aksioneve. Në të kundërtën, ai nuk, do të mund të kishte mundësi të vendoste nëse tërheqja e aksioneve është lëshuar drejtë dhe në këtë mënyrë padia të jetë e pabazuar apo nëse do të duhej ta shpallte të pavlefshëm me rezultatin ku padia do të ishte e suksesshme".*

81. Së treti, parashtruesi i kërkesës më tej argumenton se, në bazë të Ligjit të ri të AKP-së, Bordi i Drejtorëve i AKP-së mori rolin e Autoritetit Ushtrues dhe si rezultat në mënyrë të njëanshme ndryshoi parametrat e marrëveshjes, duke tërhequr pronësinë e tij mbi Hotelin Grand. Kështu, parashtruesi i kërkesës pretendon se e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së, ishin shkelur sepse *"ndërhyrja e ligjvënësit solli një pozicion që ndryshoi statusin e parashtruesit si subjekt të ligjit në marrëdhëniet e tij kontraktuale".*

82. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së, në Aktgjykimin e tij, u përgjigj si në vijim:

> *"Të dyja kushtet janë shfuqizuar me anë të nenit 31 të Ligjit mbi AKP-në. Autoriteti i PSSP-së është transferuar me anë të Ligjit tek Bordi i Drejtorëve i të paditurës .*

Është e vërtetë se me anë të nenit 31 të Ligjit mbi AKP-në detyrat dhe të drejtat kontraktuara të palëve, të cilat dalin nga Marrëveshja e Zotimit, kanë ndryshuar. Paditësi e humb rastin që PSSP të mos udhëzojë një tërheqje të aksioneve dhe gjithashtu e humb të drejtën që të hyjë në arbitrazh ne lëndën ku PSSP nuk ekziston me apo - siç doli të jetë, nuk ekziston më me kapacitetet ekzekutive te cilat i kishte në kohën e lidhjes së kësaj marrëveshje. Megjithatë, këto humbje nuk janë jo kushtetuese. Ligjvënësi mund të modifikojë marrëdhëniet kontraktuale dhe këtë e bënë shpesh […]"

83. Lidhur mezbatimin eLigjitpër AKP-nënga të dyinstancat eDHPGJS-së,Gjykata i referohetpraktikës së vet gjyqësore, ku konkludohet se, si pjesë eparimit të sundimit tëligjitdhe bazuar në nenin102[Parimet e PërgjithshmetëSistemitGjyqësor] të Kushtetutës, " […] *Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, si pjesë e Gjyqësorit të Kosovës, ka obligim kushtetues të zbatoj ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës"* (Shih rastin KI25/10, parashtrues i kërkesës *Agjencia Kosovare e Privatizimit,* Aktgjykim i 30 marsit 2011, paragrafi 56).

84. Për më tepër, edhe një herëparashtruesi i kërkesës ngre çështjen e ligjshmërisë dhe çështjen e përputhshmërisë së Ligjit të AKP-së me Kushtetutën.

85. Lidhur me çështjen e ligjshmërisë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

86. Në lidhje me çështjen e përputhshmërisë së Ligjit të AKP-së me Kushtetutën, parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar që të ngre në Gjykatë çështje të tilla që lidhen me përputhshmërinë e ligjeve, kur ato ngrihen në procedurë në një gjykatë.

87. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se shkelja e nenit 46 të Kushtetutës dhe e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në mënyrë implicite shkakton shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së, sepse *"[…] kurrë nuk i kishte pasur faktet për të cilat ishte ankuar, fakte që lidhen me pronën e tij që ishte hetuar me forcë, në mënyrë të njëanshme dhe gjyqësisht të paligjshme".*

88. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë fakt apo argument bindës se si dhe pse *" […] faktet që lidhen me pronën e tij ishin hetuar me forcë, në mënyrë të njëanshme dhe të paligjshme".*

89. Në përfundim, bazuar në atë që u tha më sipër, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar pretendimet e tij për shkelje të parimit të të drejtave të tij për barazi para ligjit, për mbrojtje të pronës dhe për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, prandaj kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) dhe (2), (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 28 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI168/14, Parashtrues Mabco Constructions dhe Eurokoha-Reisen - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës se Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0045-A0001, të 26 qershorit 2014

KI168/14, Aktvendim për papranueshmëri i 28 gushtit 2015, publikuar më 8 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, procesi i privatizimit, marrëveshjet ndërkombëtare, juridiksioni ratione materiae, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, statusi i ndërhyrësit*

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme kishte refuzuar kërkesën e parashtruesve për njohjen e statusit të tyre si ndërhyrës në procesin e privatizimit të Hotelit GRAND në Prishtinë. Parashtruesit, mes tjerash, u ankuan në Gjykatën Kushtetuese se mos njohja e statusit të tyre si ndërhyrës, ua cenon atyre të drejtën për mbrojte gjyqësore të interesave dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Parashtruesit, po ashtu, u ankuan se mosmiratimi i kërkesës së tyre përbënte edhe shkelje të marrëveshjeve ndërkombëtare që janë të detyrueshme për Republikën e Kosovës.

Përsa i përket pretendimeve për marrëveshjet ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese theksoi se nuk është brenda juridiksionit *ratione materiae* të Gjykatës të vlerësojë kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare. Përsa i përket pretendimit për njohjen e statusit të ndërhyrësit, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parashtruesit nuk e kanë arsyetuar pretendimin e shkeljes së të drejtave dhe lirive kushtetuese dhe nuk i kanë mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre. Kërkesa u shpall e papranueshme në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) (d) dhe 36 (3) (e) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI168/14
Parashtrues
Mabco Constructions dhe Eurokoha-Reisen
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0045-A0001, të 26 qershorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë Mabco Constructions, me seli në Llugano, Zvicër, dhe Eurokoha-Reisen, me seli në Frankfurt, Gjermani, e përfaqësuar me degën e saj në Prishtinë. Parashtruesit e kërkesës përfaqësohen nga z. Mr. Bajram Morina, avokat në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së), AC-I-13-0045-A0001, e 26 qershorit 2014, me të cilin ishte refuzuar parashtresa e parashtruesve të kërkesës për të qenë ndërhyrës në anën e paditësit.

3. Vendimi i kontestuar u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 14 korrik 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi ikushtetutshmërisë së Aktgjykimit (AC-I-13-0045-A0001, të 26 qershorit 2014), të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, ishin shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], me nenin 7 [Vlerat], me nenin 24 [Barazia para Ligjit], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe me nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, në nenin 47tëLigjit përGjykatënKushtetuese të Republikëssë Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji)dhe në rregullin56tëRregullores së punës të GjykatësKushtetuese të RepublikëssëKosovës(në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 14 nëntor 2014, parashtruesit e dorëzuan me postë kërkesën në Gjykatë. Gjykata e pranoi kërkesën më 17 nëntor 2014.

7. Më 24 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI168/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI168/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

8. Më 1 dhjetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS) dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

9. Më 5 dhjetor 2014, Gjykata i dërgoi një letër me një kopje të kësaj kërkese për informim NTP Unio Commerce, Zelqif Berisha, pronar, i cili e kishte parashtruar kërkesën KI167/14, e cila e konteston të njëjtin Aktgjykim të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së.

10. Më 9 dhjetor 2014, Gjykata kërkoi nga DHPGJS-ja që të sigurojë një kopje të fletëkthesës, e cila tregon se kur u është dorëzuar

parashtruesve të kërkesës Aktgjykimi i Kolegjit të Ankesave të DHPGJS (AC-I-13-0045-A0001, i 26 qershorit 2014).

11. Më 13 dhjetor 2014, DHPGJS-ja dorëzoi kopjen e fletëkthesës, e cila tregon se Aktgjykimi i Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së (AC-I-13-0045-A0001, i 26 qershorit 2014) u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 14 korrik 2014.

12. Më 17 dhjetor 2014, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës për Vendimin e Gjykatës për ta refuzuar kërkesën për Masë të përkohshme në rastin përkatës KI167/14, në pritje të rezultatit përfundimtar të kërkesës. (Shih Vendimin për Masë të përkohshme, të publikuar më 17 dhjetor 2014).

13. Më 26 qershor2015,Kryetarja e Gjykatëscaktoi gjyqtarin Ivan Čukalovićgjyqtar raportues, në vend tëArta Rama-Hajrizit. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetares së Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi u caktua anëtare e Kolegjit shqyrtues, në vend tëEnver Hasanit, mandati i të cilitsigjyqtariGjykatësKushtetueseka përfunduarmë 26 qershor2015.

14. Më 6 korrik2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

Sa i përket privatizimit të Hotelit Grand

15. Në vitin 2005, në kuadër të procesit të privatizimit, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM), inicioi një "Spin Off Special" të shitjes, nëpërmjet privatizimit të objekteve të Hotelit Grand në Prishtinë.

16. Në vitin 2006, pas përfundimit të procesit të ofertimit, kontrollit të historikut dhe çështjes gjyqësore në Dhomën e Posaçme, AKM-ja kishte shpallur si ofertues fitues Zelqif Berishën, pronarin e NTP Unio Commerce (parashtrues i kërkesës në rastin KI167/14).

17. Më 10 gusht 2006, AKM-ja lidhi kontratë me Zelqif Berishën, pronarin e NTP Unio Commerce për t'i shitur këtij tërë kapitalin aksionar të Ndërmarrjes së Re Grand Hotel SHPK (në tekstin e mëtejmë: Grand Hotel). Si rrjedhojë, kapitali aksionar ishte transferuar në mënyrë të plotë dhe aksionet e Hotelit Grand ishin regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në emër të NTP Unio Commerce.

18. Kontrata e lidhur ndërmjet AKM-së dhe Zelqif Berishës, detyronte atëpër të përmbushur disa kushte të përcaktuara në marrëveshjen e zotimeve. Në mesin e atyre kushteve ishin zotimet për të realizuar investime të caktuara financiare në ndërtesën e Hotelit Grand dhe për të ruajtur punësimin e një numri të caktuar të punëtorëve brenda një afati të caktuar kohor. Mospërmbushja e këtyre obligimeve mund të rezultonte në tërheqjen e aksioneve nga parashtruesi i kërkesës.

Sa i përket bashkëpronësisë së parashtruesve të kërkesës

19. Pas kësaj, në janar të vitit 2007, Zelqif Berisha lidhi Marrëveshje mirëkuptimi me parashtruesit e kërkesës nëpërmjet të cilës ai u shiti atyre 60% të aksioneve të Hotelit Grand.

20. Më 5 qershor 2007, parashtruesit e kërkesës iniciuan procedurë civile pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë në përpjekje për të konfirmuar bashkëpronësinë mbi aksionet e Hotelit Grand.

21. Më 28 maj 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 1429/2007) aprovoi padinë e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi bashkëpronësinë e parashtruesve mbi aksionet e Hotelit Grand.

Sa i përket tërheqjes së aksioneve nga Bordi i Drejtorëve i AKP-së

22. Më 31 maj 2012, Bordi i Drejtorëve i AKP-së, si pasardhëse ligjore e AKM-së, vërtetoi se ndërmarrja NTP Unio Commerce nuk kishte vepruar në përputhje të plotë me zotimet për investime dhe për punësim që ishin të përcaktuara në marrëveshjen e zotimeve. Prandaj, Bordi i AKP-së njëzëri mori vendim për kthimin e të gjitha aksioneve të blera nga NTP Unio Commerce.

23. Si rezultat i vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, aksionet dhe objektet e Hotelit Grand tani janë nën administrimin e AKP-së.

24. Më 8 qershor 2012, NTP Unio Commerce, Zelqif Berisha, pronar (parashtrues i kërkesës në rastin KI167/14), parashtroi padi në DHPGJS, duke kontestuar vlefshmërinë e Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 majit 2012, për të ushtruar tërheqjen e aksioneve të Hotelit Grand. Ai po ashtu paraqiti kërkesë për Masë të përkohshme, e cila kërkesë ishte refuzuar si e pabazuar nga Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së (Aktvendimi, C-I-12-0042, i 29 qershorit 2012). Pas ankesës kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, të paraqitur nga NTP Unio Commerce, Zelqif Berisha, pronar (në tekstin e mëtejmë: NTP Unio Commerce), Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së (Aktvendimi, AC-I-12-0042, i 27 shtatorit

2012), aprovoi ankesën si pjesërisht të bazuar dhe vendosi: *"AKP-së i ndalohet tjetërsimi i aksioneve të Ndër. ReHotel Grand tek palët e treta, deri në vendimin përfundimtar mbi meritat e padisë"*.

25. Më 20 mars 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së (Aktgjykimi, C-I-12-0042, i 20 marsit 2013), e refuzoi padinë e NTP Unio Commerce si të pabazuar me arsyetimin se shkeljet e marrëveshjes për zotime nga NTP Unio Commerce ishin të mëdha dhe se vendimi i AKP-së për të ushtruar tërheqjen e aksioneve të Hotelit Grand ishte i vlefshëm.

26. Pas ankesës së parashtruar nga NTP Unio Commerce pronar kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së (C-I-12-0042, të 20 marsit 2013), më 26 qershor 2014, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së refuzoi si të pabazuar ankesën dhe vërtetoi aktgjykimin e lartpërmendur të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së.

27. Siç u cek në paragrafin 9, NTP Unio Commerce parashtroi kërkesë në Gjykatë, duke kontestuar të njëjtin Aktgjykim të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, të 26 qershorit 2014. Prandaj, për qëllim të paraqitjes së plotë të procedurave të përfunduara në DHPGJS lidhur me kërkesën dhe ankesën e paraqitur nga NTP Unio Commerce, Gjykata dëshiron t'i referohet përmbledhjes së fakteve të paraqitura në rastin KI167/14.

Sa i përket parashtresës së parashtruesve të kërkesës për të qenë ndërhyrës në DHPGJS

28. Më 10 janar 2014, ndërkohë që ankesa e paditësit (NTP Unio Commerce, Zelqif Berisha, pronar dhe parashtrues i kërkesës në rastin KI167/14) ishte në pritje pranë Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, parashtruesit e kërkesës paraqitën një parashtresë për të ndërhyrë në anën e paditësit në procedurën pranë Kolegjit të ankesave të DHPGJS-së.

29. Në parashtresën e tyre, parashtruesit kërkuan që t'u njihet cilësia e ndërhyrësve në procedurën pranë Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së. Parashtruesit e kërkesës më tej pohuan se, në pajtim me nenin 271 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ata përmbushin kërkesat që t'u njihet cilësia si palë ndërhyrëse në këtë proces.

30. Më 14 shkurt 2014, AKP-ja, në cilësinë e të paditurës, parashtroi kundërshtim ndaj parashtresës së parashtruesve të kërkesës, me arsyetim se parashtruesit nuk kishin asnjë lidhje ligjore dhe materiale me AKP-në, por vetëm një Marrëveshje Mirëkuptimi të lidhur me Zelqif Berishën, pronarin e NTP Unio Commerce.

31. Më 31 shkurt 2014, NTP Unio Commerce, në procedurën pranë Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, gjithashtu parashtroi kundërshtim ndaj parashtresës së parashtruesve, duke deklaruar se parashtruesit janë duke kërkuar në mënyrë të paligjshme të drejtat e pronësisë mbi Hotelin Grand dhe në këtë mënyrë ata nuk kishin legjitimitet në këtë çështje.

32. Më 26 qershor 2014, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së (Aktgjykimi, AC-I-13-0045-A0001) e refuzoi parashtresën e parashtruesve të kërkesës.

33. Në Aktgjykimin e tij, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së vendosi që, në pajtim me nenin 270, paragrafi 1, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ta refuzojë kërkesën e parashtruesve që të pranohen si ndërhyrës në procedurën pranë DHPGJS-së pasi që të dy, edhe paditësi (NTP Unio Commerce, Zelqif Berisha, pronar) e edhe e paditura (AKP-ja) e kundërshtuan legjitimitetin e ndërhyrësve si palë në procedurë.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

34. Siç u cek më lart, parashtruesit pretendojnë se Aktgjykimi i Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së (AC-I-13-0045-A0001, i 26 qershorit 2014), me të cilin ishte refuzuar parashtresa e tyre për të qenë ndërhyrës në anën e paditësit në procedurën pranë DHPGJS-së, kishte shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], me nenin 7 [Vlerat], me nenin 24 [Barazia para Ligjit], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

35. Parashtruesit e kërkesës deklarojnë si në vijim: "*Per shkak te injorimit nga ana e AKP, per procedim me legjitimimin e aksionareve real, per shkak te nderrimit te ligjeve te AKM -AKP qe shkon ne kundershtim me Marreveshjen per mbrojtjen e investimeve te huaja, […],per shkak te refuzimit te pa bazuar te kerkeses te NDERHYRESVE per te qene pale ne proceduren kontestimore ne anen e paditesit ne Dhomen e Posaqme, per shkak te dyshimit te bazuar te interferimit me metoda te krimit te organizuar nga ana e institucioneve shteterore dhe per shkak te mosperfilljes se drejtes legjitime te njeriut dhe mosperfilljes gjegjesisht veprimit ne kundershtim te konditave te marreveshjeve ndershteterore per mbrojten e investimeve te huaja, […]*".

36. Parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë shkelje të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës. Në lidhje më këtë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se janë investitorë të huaj dhe se *"[…]Ndryshimi ne Ligjin per AKP i cili eshte pranuar si baza kryesore per te mohuar te drejten*

e NDERHYRESVE, eshte ne kundershtim me Marreveshjen per mbrojtjen e investimeve te huaja ne Kosove, gjegjesisht me marreveshjen per mbrojtjen e investimeve te huaja me Zvicren dhe Republiken Federale Gjermane. Ne fakt, kontrata per blerjen e aksioneve me paditesin (Zelqif Berisha) eshte lidhur ne kohen kur ka qene ne fuqi ligji i AKM 'se, kurse vendimi per terhekjen e aksioneve eshte bazuar ne ligjin pas riorganizimit te AKP i cili ne kete rast nuk duhej te kete efekt retroaktiv".

37. Në fund, parashtruesit e kërkesës përfundojnë duke kërkuar që Gjykata ta detyrojë DHPGJS-në që t'i pranojë parashtruesit e kërkesës si palë ndërhyrëse në procedurën në lidhje me tërheqjen e aksioneve në Hotelin Grand nga Bordi i Drejtorëve i AKP-së.

Pranueshmëria e kërkesës

38. Nëmënyrë që të jetënë gjendje tëshqyrtojë kërkesën eparashtruesve, Gjykata së pari duhet tëvlerësojë nëseparashtruesiti kanëpërmbushurkushtet epranueshmërisëtë përcaktuarame Kushtetutë dhe më tejtë specifikuaranëLigj dhe në Rregullore të punës të Gjykatës.

39. Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

40. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(2) "Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

41. Gjykata vëren se, në vitin 2007, parashtruesit kishin iniciuar procedurë civile për konfirmimin e bashkëpronësisë mbi aksionet e Hotelit Grand Prishtina në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

42. Megjithatë, Gjykata konsideron se këto procedura civile nuk bien në fushëveprimin e kërkesës dhe, për këtë arsye, Gjykata do të shqyrtojë vetëm procedurën në DHPGJS lidhur me objektin e çështjes së kërkesës.

43. Siç u cek më lart, parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], me nenin 7 [Vlerat], me nenin 24 [Barazia para Ligjit], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe me nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës.

44. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës vetëm kanë përmendur dhe kanë përshkruar përmbajtjen e dispozitave të lartpërmendura, por nuk kanë paraqitur ndonjë argument apo dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tyre.

45. Për më tepër, Gjykata rithekson se pakënaqësia me vendimin, ose thjesht përmendja e neneve dhe e dispozitave të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme që parashtruesit të ndërtojnë një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendon shkelje të Kushtetutës, parashtruesi duhet të ofrojë argumente bindëse dhe të pakontestueshme për pretendimet e tij, në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar (Shih rastin Nr. KI198/13,*Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014).

46. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë shpjeguar si dhe pse pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre përfundimi i Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së për refuzimin e kërkesës së tyre që të njihen si ndërhyrës në anën e paditësit në procedurën pranë DHPGJS-së.

47. Për më tepër, Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj, sipasKushtetutës, që të zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta në lidhje me vendimetqë merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregulltaqë tëinterpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhematerialе (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr.30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999;shih edhe rastin KI70/11, parashtrues*Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

48. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesit nuk janë kryesisht të kënaqur me kualifikimin ligjor të fakteve dhe të ligjit të zbatuar nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së. Kualifikimi ligjor i fakteve dhe i ligjit të aplikueshëm janë çështje që bien në fushëveprimin e ligjshmërisë.

49. Lidhur me këtë, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

50. Në fund, parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur asnjë argument bindës që do të vërtetonte se shkeljet e pretenduara, të përmendura në kërkesë, përbëjnë shkelje të të drejtave kushtetuese (Shih *Vanek kundër Republikës Sllovake*, Vendim i GJEDNJ-së për pranueshmëri, nr. 53363/99, i 31 majit 2005) dhe nuk kanë saktësuar se si janë shkelur nenet e përmendura të Kushtetutës, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 48 të Ligjit.

51. Bazuar në atë që u tha më lart, Gjykata konkludon se parashtruesit nuk e kanë arsyetuar pretendimin për shkelje të të drejtave dhe të lirive kushtetuese, në të cilat ata thirren, dhe parashtruesit nuk i kanë mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre.

52. Përveç kësaj, siç u cek më lart, parashtruesit e kërkesës ngrenë çështjen e përputhshmërisë së Ligjit të AKP-së me marrëveshjet bilaterale ndërkombëtare të lidhura dhe të ratifikuara nga Republika e Kosovës.

53. Siç u cek më lart, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që "*Ndryshimi ne Ligjin per AKP i cili eshte pranuar si baza kryesore per te mohuar te drejten e NDERHYRESVE, eshte ne kundershtim me Marreveshjen per mbrojtjen e investimeve te huaja ne Kosove, gjegjesisht me marreveshjen per mbrojtjen e investimeve te huaja me Zvicren dhe Republiken Federale Gjermane [...]*".

54. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] të Kushtetutës, i cili përcakton:

    1. *Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligj.*

2. *Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.*

55. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se nuk është e autorizuar të vlerësojë pajtueshmërinë e ligjeve me marrëveshjet ndërkombëtare. Gjykata, në praktikën e saj gjyqësore, gjithashtu ka ritheksuar se nuk është e autorizuar të vlerësojë nëse një marrëveshje ndërkombëtare është në përputhje me Kushtetutën (Shih Kërkesa KO95/13, *Parashtrues: Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë*, Aktgjykim i 2 shtatorit 2013, par. 100 dhe 101).

56. Prandaj, në lidhje me pretendimet e parashtruesve se Ligji i AKP-së nuk është në përputhje me marrëveshjet bilaterale ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, Gjykata konsideron se nuk është brenda jurisdiksionit të saj *ratione materiae* të vlerësojë kushtetutshmërinë e ligjeve me marrëveshjet ndërkombëtare.

57. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të deklarohet:

a) E papranueshme sepse nuk është brenda jurisdiksionit *ratione materiae* të Gjykatës të vlerësojë kushtetutshmërinë e ligjeve me marrëveshjet ndërkombëtare; dhe

b) E papranueshme pasi është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesit nuk e kanë arsyetuar pretendimin e shkeljes së të drejtave dhe të lirive kushtetuese në të cilat thirren ata dhe parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2), (b) dhe (d) dhe me rregullin 36 (3) (e) të Rregullores së punës, më 28 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI142/14, Parashtrues Bajram Bajgora - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1429/2014, i 7 korrikut 2014

KI142/14, Vendim për heqje të kërkesës nga lista i 6 gushtit 2015, publikuar më 9 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e papranueshme, çështja banesore, kontrata e shitblerjes, mbrojtja e pronës*

Gjykata e Apelit e Kosovës, refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit përkitazi me një kontratë shitblerjeje të lidhur ndërmjet Komunës se Podujevës dhe palëve të treta. Parashtruesi, u ankua në Gjykatën Kushtetuese përkitazi me të drejtat e tij banesore por pa iu referuar ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi, se parashtruesi i kërkesës nuk kishte plotësuar kërkesën e tij sipas mënyrës së paraparë me ligj edhe përkundër kërkesave të Gjykatës që ai ta përmirësoj kërkesën e tij. Kërkesa u refuzua me procedurë të shkurtër dhe u hoq nga lista bazuar në rregullin 32 (5) të Rregullores së punës.

VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA
në
Rastin nr. KI142/14
Parashtrues
Bajram Bajgora
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1429/2014, të 7 korrikut 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Bajram Bajgora nga Podujeva (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin (Ac. nr. 1429/2014, të 7 korrikut 2014) të Gjykatës së Apelit, i cili i është dorëzuar atij më 4 gusht 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me *"nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ)"*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në

tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 shtator 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën nëpërmjet postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës se Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 24 shtator 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin se e ka pranuar një kërkesë me emrin e tij dhese e njëjta nuk është e nënshkruar. Me atë rast, Gjykata kërkoi nga parashtruesi të paraqitet në Sekretariatin e Gjykatës brenda 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese për të nënshkruar kërkesën.

7. Më 7 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI142/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI142/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Më 21 janar 2015, Gjykata i dërgoi një shkresë të dytë parashtruesit të kërkesës me të cilën i përkujtoi atij se akoma nuk e ka nënshkruar kërkesën e tij, dhe se nënshkrimi i saj është parakusht procedural në mënyrë që Gjykata të shqyrtojë pretendimet e tij.

9. Deri më sot, parashtruesi nuk u është përgjigjur kërkesave të Gjykatës.

10. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KI142/14, e caktoi veten anëtare të Kolegjit shqyrtues në zëvendësim të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit mandati si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese i mbaroi më 26 qershor 2015.

11. Më 7 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar anulimin e kontratës së shitblerjes, e cila ishte e lidhur ndërmjet Komunës së Podujevës dhe palës së tretë në lidhje me një paluajtshmëri.

13. Më 24 shkurt 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 471/2010) refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar.

14. Më 7 korrik 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi C. nr. 471/2010) e refuzoi, si të pabazuar ankesën e parashtruesit, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit ka shkelur të drejtën e tij në pronë, të garantuar me Kushtetutë dhe me DUDNJ.

16. Në lidhje me këtë kërkesë, parashtruesi pretendon se *"[...] gjate tri dekadave të kaluara, nga ana e drejtësisë më është mohuar e drejta e sigurisë në çështjen banesore të përfituar para 50 viteve"*.

17. Parashtruesi kërkon nga Gjykata: *"[...] Të ma kthejnë banesën time ku kam jetuar për një kohë të gjatë së bashku me familjen time"*.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

19. Prandaj, Gjykata i referohet dispozitës së Ligjit, e cila përcakton:

Neni 22.4 [Procedimi i kërkesës]

> *"[...] 4. Nëse kërkesa [...] nuk është [...] e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të plotësuar kërkesën [...]"*.

20. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullave 29 (1) dhe 32 (5) të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

Rregulli 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve]

> *"(1) [...] Kërkesa [...] duhet të përfshijë datën e parashtrimit të saj dhe të jetë e nënshkruar nga personi që e parashtron atë. [...]"*

Rregulli 32 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës]

> *"(5) [...] Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është e jo e plotë [...]përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë [...] kërkesën [...]"*.

21. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi e dorëzoi kërkesën të panënshkruar nëpërmjet postës, më 19 shtator 2014.

22. Gjykata i ka dërguar dy letra parashtruesit të kërkesës, duke kërkuar nga ai që t'i përmbushë kërkesat procedurale të parapara me rregullin 29 (1) të Rregullores së punës, respektivisht të nënshkruajë kërkesën e dorëzuar në emrin e tij.

23. Megjithatë, Gjykatavëren se parashtruesi nuk i është përgjigjur asnjërës nga letrat e dërguara nga Gjykata dhe kështu nuk arriti të përmbushë këtë kërkesë procedurale.

24. Rrjedhimisht, Gjykatakonsideron se nuk mund të marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës, pa e përmbushur kërkesën e lartpërmendur procedurale.

25. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk është e kompletuar dhe duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër, si dhe të hiqet nga lista sipas rregullit 32 (5) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, më 6 gusht 2015 njëzëri

VENDOS

I. TA HEQË NGA LISTA kërkesën;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI170/14, Parashtrues Adem Bajqinca - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. 533/2008, i 9 shkurtit 2010

KI170/4, Aktvendim për papranueshmëri i 31 korrikut 2015, publikuar më 9 shtator 2015

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme, lëndim trupor, pension mujor, parashkrim ligjor, procedurë civile*

Gjykata Supreme kishte miratuar kërkesën për revizion të punëdhënësit të parashtruesit duke konstatuar se e drejta e parashtruesit për kompensim të dëmit të shkaktuar në punë është parashkruar. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese me pretendimin se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese por pa iu referuar ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesa ishte dorëzuar jashtë afatit ligjor prej 4 (katër) muajve. Kërkesa u shpall e papranueshme e paafatshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI170/14
Parashtrues
Adem Bajqinca
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Rev. 533/2008, të 9 shkurtit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Adem Bajqinca, me vendbanim në Bardh të Madh, komuna e Fushë-Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), Rev. 533/2008, të 9 shkurtit 2010, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 25 shkurt 2010.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 533/2008, të 9 shkurtit 2010. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, duke pranuar revizionin e palës së kundërt (punëdhënësit të parashtruesit), i ka shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), por pa specifikuar dispozitën kushtetuese.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 nëntor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 8 dhjetor 2014, Kryetari, me Vendimin GJR. KI170/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KI170/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

7. Më 23 janar 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën Supreme.

8. Më 5 mars 2015, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë fletëkthesën, për të dëshmuar datën e pranimit të vendimit të fundit nga parashtruesi.

9. Më 11 mars 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi dokumentin e kërkuar në Gjykatë, i cili dëshmon se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar aktgjykimin e kontestuar më 25 shkurt 2010.

10. Më26 qershor 2015, meVendimin Nr.K.SH.KI 170/14, Kryetarja e Gjykatëscaktoi gjyqtarenArta Rama-Hajrizi anëtare tëKolegjit shqyrtuesnë vend të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit i ka përfunduar mandati në Gjykatën Kushtetuesemë 26 qershor2015.

11. Më 7 korrik2015,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtuesi rekomandoinjëzëriGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës ka qenë në marrëdhënie pune në Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK).

13. Më 17 tetor 1999, parashtruesi ka pësuar lëndime trupore gjatë kryerjes së punëve në vendin e tij të punës. Si pasojë e kësaj, ka

humbur aftësitë e punës për çka edhe është pensionuar dhe realizon pension mujor në një shumë të caktuar parash.

14. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi dorëzoi një kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër KEK-ut, me të cilën kërkoi që të detyrohet KEK-u *"në emër të rentës së arritur për periudhën prej dt. 17.10.1999 e tutje t'ia paguajë diferencën në mes pensionit që e realizon dhe pagës qe do ta realizonte po te punonte"*.

15. Më 1 qershor 2006, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin, C1. nr. 267/05, refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit *"për shkak të parashkrimit të kërkesës"*.

16. Kundër këtij aktgjykimi, parashtruesi ushtroi ankesë në afat ligjor, duke kërkuar prishjen e tij dhe kthimin e lëndës në rigjykim.

17. Më27 gusht 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin Ac. nr. 859/2006, me të cilin ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, C1. nr. 267/05, ashtu që palën e paditur në këtë kontekst (KEK) e obligoi *"që paditësit Adem Bajqinca, nga fshati Bardh i Madh, në emër të rentës së arritur për periudhën prej 07.09.2002 deri më 07.09.2005 t'ia paguajë një shumë të caktuar dhe prej 07.09.2005 e tutje, shumën mujore deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për pagesë si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë"*.

18. Në një datë të paspecifikuar, KEK-u dorëzoi një kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, *"për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet, ashtu që të refuzohet kërkesëpadia si e pabazuar."*

19. Më 9 shkurt 2010, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. 533/2008, duke aprovuar kërkesën për revizion të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 859/2006.

20. Në arsyetimin e saj, Gjykata Supreme theksoi se, *"meqenëse dëmi është shkaktuar me datë 17.10.1999, afati prej 3 vitesh për paraqitjen e kërkesës për kompensim të demit llogaritet nga kjo datë, e jo nga data të cilën e gjen gjykata e shkallës së dytë. Duke pasur parasysh se padia për pagesën e rentës si pasojë e aksidentit të shkaktuar në punë është paraqitur me datë 07.09.2005, pretendimet nga revizioni se kërkesa e paditësit është parashkruar, janë të bazuara"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin, Rev. I. 533/2008, të 9 shkurtit 2010, duke ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për kompensim në emër të rentës për një periudhë të caktuar kohore, Gjykata Supreme ia ka shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë, por pa specifikuar dispozitat përkatëse kushtetuese.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, së pari duhet të shqyrtohet nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Kushtetutës, e cila në nenin 113.7 parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

24. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor…".*

25. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[…]*
>
> *c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi".*

26. Gjykata vëren se vendimi i fundit në procedurë në gjykatat e rregullta ishte ai i Gjykatës Supreme, i nxjerrë më 9 shkurt 2010, dhe i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 25 shkurt 2010, ndërsa parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 25 nëntor 2014,

d.m.th. më shumë se 4 muaj nga dita kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar vendimi i Gjykatës Supreme.

27. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme si e paafatshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me nenin113paragrafi7i Kushtetutës, nenet20dhe49të Ligjitdherregullin 36 (1) (c) tëRregullores së punës,më 31 korrik2015,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI184/14, Parashtrues Maliq Demiri - Vlerësim i kushtetutshmërisë së listës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit të punëtorëve të kualifikuar për 20% nga të ardhurat e shitjes së Ndërmarrjes Shoqërore "Ramiz Sadiku"

KI184/14, Aktvendim për papranueshmëri i 31 korrikut 2015, publikuar më 9 shtator 2015

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, kërkesë e papranueshme, agjencia kosovare e privatizimit, mosshterim i mjeteve juridike, parimi i subsidiaritetit*

Agjencia Kosovare e Privatizimit kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës, për të drejtën e tij, për t'u ankuar tek Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme përkitazi me realizimin e fitimit nga privatizimi i NSH Ramiz Sadiku në Prishtinë. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, por pa specifikuar ndonjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte vepruar sipas udhëzimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe se ai nuk kishte ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme për shterimin e mjeteve juridike në dispozicion. Kërkesa u shpall e papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI184/14
Parashtrues
Maliq Demiri
Vlerësim i kushtetutshmërisë
së listës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit të punëtorëve të kualifikuar për 20%-in nga të ardhurat e shitjes së Ndërmarrjes Shoqërore "Ramiz Sadiku"

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Maliq Demiri, nga fshati Syriganë, komuna e Skënderajt, me vendbanim në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), i cili në këtë rast përfaqëson edhe 3 (tre) individë të tjerë: z. Idriz Zhinipotoku; z. Rrahim Uka dhe z. Zoran Petrović.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi nuk konteston asnjë vendim specifik të ndonjë autoriteti publik, por vetëm kërkon përfshirjen e tij në listën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) të punëtorëve, që përfitojnë 20%-in nga të ardhurat e shitjes së Ndërmarrjes Shoqërore "Ramiz Sadiku" (në tekstin e mëtejmë: NSH "Ramiz Sadiku").

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së listës së AKP-së, të punëtorëve të kualifikuar për 20%-in nga të ardhurat e shitjes së NSH "Ramiz Sadiku".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47.1 i Ligjit, dhe rregullin 56 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 22 dhjetor 2014, parashtruesi dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së listës së AKP-së, për punëtorët e kualifikuar për 20%-in nga të ardhurat e shitjes së NSH "Ramiz Sadiku".

6. Më 13 janar 2015, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI184/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI184/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani (anëtarë).

7. Më 22 janar 2015, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës së tij me nr. KI184/14.

8. Më 24 shkurt 2015, Gjykata në bazë të nenit 21 të Ligjit dhe rregullit 29 (2) (c) të Rregullores së punës, kërkoi nga parashtruesi që të dorëzoi autorizimet e nënshkruara nga personat për të cilët ka pohuar se i përfaqëson. Gjithashtu, Gjykata kërkoi nga parashtruesi, që kërkesës t'ia bashkëngjit vendimin të cilin e konteston dhe dokumentet relevante për rastin e tyre.

9. Më 10 mars 2015, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë autorizimet e kërkuara dhe disa shkresa të AKP-së dhe të EULEX-it, por nuk dorëzoi asnjë vendim specifik të cilin e kontestojnë.

10. Më26 qershor 2015, meVendimin Nr.K.SH.KI 184/14, Kryetarja e Gjykatëscaktoi gjyqtarenArta Rama-Hajrizi anëtare tëKolegjit shqyrtuesnë vend të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit i ka përfunduar mandati në Gjykatën Kushtetuesemë 26 qershor2015.

11. Më 2 korrik2015,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtuesi rekomandoinjëzëriGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

12. Përkundër faktit, se parashtruesi në këtë rast i përfaqëson me autorizim edhe 3 (tre) individ të tjerë, pretendimet e ngritura nga ai lidhur me këtë Kërkesë, janë kryesisht pretendime personale të tij.

13. Parashtruesi ka qenë i punësuar në NSH "Ramiz Sadiku" si mjeshtër i kualifikuar për shtrirjen e pllakave të keramikës nga viti 1977 deri në vitin 1989, kur është larguar nga puna.

14. Me kërkesën e 19 dhjetorit 2014, parashtruesi ka kërkuar nga AKP-ja, si trashëgimtare e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM) përfshirjen e tij në listën përfundimtare të punëtorëve, të cilët përfitojnë nga 20%-i i shitjes së NSH "Ramiz Sadiku".

15. Më 24 dhjetor 2014, AKP-ja duke iu përgjigjur kërkesës së parashtruesit, *inter alia*, ka sqaruar se:

> *"Agjencia më 11 gusht 2007, ka publikuar listën fillestare të punëtorëve që përfitojnë 20%-in nga shitja e NSH-së. Parashtruesi ka pasur të drejtë ankese kundër kësaj liste në afat prej njëzet (20) ditëve nga publikimi, pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave në Agjenci.*
>
> *Më 7 mars 2009, Agjencia ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve që përfitojnë nga shitja e NSH-së. Kundër kësaj liste parashtruesi ka pasur të drejtë ankese në afat prej njëzet (20) ditëve nga publikimi, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "DHPGJS"). DHPGJS-ja ka vendosë lidhur me listën përfundimtare të punëtorëve që përfitojnë 20%-in, me Aktgjykimin e formës së prerë të 22 prillit 2013".*

16. Parashtruesi në dy letra të ndara të 10 qershorit 2014 dhe 5 janarit 2015, ka kërkuar nga EULEX-i ndihmë për përfshirjen e tij në listën e punëtorëve që përfitojnë 20%-in nga shitja e NSH "Ramiz Sadiku".

17. EULEX-i në dy letra të ndara të 17 qershorit 2014 dhe 13 janarit 2015, i është përgjigjur parashtruesit duke i sqaruar se EULEX-i nuk është kompetent për çështjen e tij, si dhe duke i sqaruar procedurat që është dashur t'i ndjek lidhur me realizimin e të drejtës së tij.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi pretendon se AKP-ja ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, pa specifikuar ndonjë dispozitë konkrete të Kushtetutës, për faktin se emri i tij nuk është përfshirë në listën e punëtorëve të cilët kanë përfituar 20%-in nga shitja e NSH "Ramiz Sadiku".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara me Ligj dhe me Rregulloren të punës.

20. Në këtë drejtim Gjykata i referohet nenit 113.7, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

21. Përveç kësaj, neni 47.2 i Ligjit përcakton se:

> *"Individi mund ta ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

22. Gjithashtu, Gjykata në këtë rast i referohet edhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *b) Janë shteruar të gjitha mjetet efektive juridike të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar.*
>
> *[...]".*

23. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se parashtruesi nuk e konteston asnjë vendim specifik të ndonjë autoriteti publik, lidhur me pretendimin për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese. Në fakt, parashtruesi nuk ka specifikuar se cila dispozitë e Kushtetutës është cenuar. Megjithatë, Gjykata *inter alia* ka kuptuar se bëhet fjalë për të

drejtat që derivojnë nga neni 46 [Mbrojtja e Pronës], i Kushtetutës dhe neni 1 [Mbrojtja e Pronës] i Protokollit 1 të KEDNJ-së, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e pronës.

24. Nga sqarimi të cilin AKP-ja ia ka dhënë parashtruesit lidhur me kërkesën e tij, Gjykata vëren se parashtruesi ka pasur të drejtën e ushtrimit të ankesës kundër listës paraprake të AKM-së, në afat prej 20(njëzet) ditëve nga data e publikimit pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave në AKM, si dhe ka pasur të drejtën e ushtrimit të ankesës kundër listës përfundimtare të AKP-së, në afat prej 20 (njëzet) ditëve nga publikimi pranë DHPGJS-së *[sipas nenit 10 (6) të Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2003/13, të 9 majit 2003].*

25. Gjykata vëren se parashtruesi edhe përkundër faktit se ka pasur mundësinë e ushtrimit të ankesës kundër listës paraprake të AKM-së, si dhe ka pasur mundësinë e ushtrimit të ankesës kundër listës përfundimtare të AKP-së, ai nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë, dhe nuk ka fakte që argumentojnë se në ndonjë formë, është penguar për ushtrimin e ankesës.

26. Me këtë rast, vërehet qartë se parashtruesi ka lëshuar afatet ligjore për të shterur mjetet efektive juridike kundër vendimeve të AKM-së dhe AKP-së, përkitazi me mospërfshirjen e emrit të tij në listën e punëtorëve që përfitojnë nga 20%-i i shitjes së NSH "Ramiz Sadiku". Në këtë kontekst, nuk mund të thuhet se ankuesi ka bërë gjithçka të arsyeshme që mund të pritej nga ai, për t'i shterur mjetet juridike në dispozicion (Shih, *mutatis mutandis,* ECHR, *Çështja D. H dhe të tjerë kundër Republikës Çeke,* no. 57 325/00, *§ 116*. Vendimi i 13 nëntorit 2007).

27. Prandaj, në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, ashtu siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, për faktin së ai ka dështuar të provojë se i ka shfrytëzuar mjetet juridike për kundërshtimin e listave të AKM-së dhe AKP-së.

28. Gjykata rithekson se, parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës, apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Ndryshe, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse ai, ose ajo dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta apo nëse dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Republikës së Kosovës, siguron mjete

efektive juridike për mbrojtje kundër shkeljeve të të drejtave kushtetuese (Shih, Aktvendimin për papranueshmëri KI41/09, të 21 janarit 2010, *AAB-RIINVEST L. L. C. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës,* dhe shih, *mutatis mutandis,* ECHR, *Selmouni vs. France,* nr. 25 803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

29. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri për shkak të mos shterimit të mjeteve juridike.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me nenin113paragrafi7i Kushtetutës, nenet20dhe47 paragrafi 2, të Ligjitdherregullin36 (1) (b) tëRregullores së punës,më 31 korrik2015,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI16/15, Parashtrues Dragomir Eraković - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit AC-I-14-0044 të Kolegjit të Ankesave të Gjykatës Supreme, i 5 shtatorit 2014

KI16/15, Aktvendim për papranueshmëri i 30 korrikut 2015, publikuar më 9 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, Masë e përkohshme, qasja në gjykatë, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, legjitimiteti aktiv, transformimi i pronës shoqërore*

Dhoma Posaçme e Gjykatës Supreme kishte refuzuar të pabazuar ankesën parashtruesit të kërkesës përkitazi me të drejtat e tij pronësore, ndaj një ndërmarrje shoqërore që ishte transformuar në procesin e privatizimit. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar në shkelje të gjykimit të drejtë dhe të drejtës në pronë. Parashtruesi, po ashtu, kërkoi vënien e masave të përkohshme.

Gjykata Kushtetuese vërejti se gjykatat e rregullta kishin arsyetuar në vendimet e tyre se përse parashtruesi i kërkesës nuk kishte legjitimitet aktiv dhe se procedurat në tërësi, nuk kishin qenë të padrejta apo arbitrare. Gjykata, po ashtu, refuzoi vënien e masave të përkohshme pasi nuk kishte rast *prima facie*. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) dhe 55 (5) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI16/15
Parashtrues
Dragomir Eraković
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-14-0044,
të 5 shtatorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Dragomir Eraković nga Mitrovica (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave DHPGJS), AC-I-14-0044, të 5 shtatorit 2014, i cili i është dorëzuar atij më 17 tetor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të lartpërmendur të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me këtë Aktvendim janë shkelur nenet 24, 31, 32, 46, 54, 159 dhe 160 të Kushtetutës, si dhe nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe pika 1 e Protokollit I të kësaj Konvente (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës njëkohësisht kërkon vendosjen e Masës së përkohshme, me të cilën Gjykata do të *"suspendojë procedurën e likuidimit në mënyrë që të shmanget shkaktimi i dëmit të paripareushëm"*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 shkurt 2015, parashtruesi përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 12 mars 2015, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR. KI16/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari me Vendimin KSH. KI16/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Më 29 prill 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Kolegjin e Ankesave të DHPGJS për regjistrimin e kërkesës.

9. Më1 korrik 2015, meVendimin GJR. KI16/15, Kryetarja e Gjykatëscaktoi gjyqtarenArta Rama-Hajrizi anëtare tëKolegjit shqyrtuesnë vend të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit i ka përfunduar mandati në Gjykatën Kushtetuesemë 26 qershor2015.

10. Më 6 korrik2015,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtuesi rekomandoinjëzëriGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 28 dhjetor 1992, ndërmarrja shoqërore "Bair" e ka kryer transformimin pronësor në shoqëri aksionare në pronësi të përzier dhe është regjistruar në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë si SH.A. "Tabak", ku si drejtor i ndërmarrjes dhe përfaqësues i autorizuar është emëruar Dragomir Eraković.

12. Me transformimin pronësor të ndërmarrjes shoqërore "Bair", të punësuarit në ndërmarrje kanë fituar pronësinë e përgjithshme mbi 8584 aksione, gjë që në kapitalin e tërësishëm përbën 49% të aksioneve. Pjesa e mbetur e aksioneve ishte në pronësi të SHA "Duvan" Ljubovija (40%) dhe Fondit për Zhvillim të Serbisë (11%).

13. Në periudhën 1999 – 2001, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut, kjo ndërmarrje kalon nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (tani Agjencia Kosovare e Privatizimit), dhe më 12 shtator 2001 regjistrohet ndërmarrja e re "N.P.G.P.D. BAIR".

14. Më 14 prill 2008, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) njoftimin për qëllimin e ushtrimit të padisë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS), për t'i mbrojtur të drejtat e fituara me transformimin pronësor, i cili është kryer më 28 dhjetor 1992.

15. Më 31 janar 2012, parashtruesi i kërkesës në cilësinë e drejtorit të "SH.P.K Tabak" parashtroi para DHPGJS-së padinë nr. SCC-12/048 kundër AKP-së për *"kompensimin e dëmit për shkak të drejtave pronësore të cenuara dhe kërkesave të pamundësuara"*.

16. Më 23 maj 2013, AKP-ja nxori aktvendimin me të cilin njofton të gjithë të interesuarit se ka filluar procedura e likuidimit të ndërmarrjes së porsaformuar "N.P.G.P.D. BAIR". Njëkohësisht, AKP-ja fton *"të gjithë kreditorët dhe pronarët, si dhe të gjithë personat që pretendojnë se kanë të drejtën e kërkesës apo interesit ndaj kësaj ndërmarrje apo aseti të ndërmarrjes, t'i paraqesin dëshmitë e kërkesës, duke filluar prej datës 17 qershor 2013 deri më datën 31 korrik 2013"*.

17. Më 30 shtator 2013, DHPGJS urdhëron parashtruesin e kërkesës që të *"prezantojë autorizimin me të cilin e autorizon përfaqësuesin e tij në procedurën para DHPGJS-së, si dhe dëshminë se autorizimi i tillë është lëshuar nga personi i cili është i autorizuar për këtë sipas ligjit të aplikueshëm"*.

18. Me të njëjtin urdhër, parashtruesi i kërkesës është njoftuar se në qoftë se ai nuk vepron sipas urdhrit të DHPGJS-së, padia e parashtruesit do të hidhet poshtë si e papranueshme.

19. Më 14 tetor 2013, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në DHPGJS-në autorizimin të cilin ia kishte dhënë z. Goran Milenković. Mirëpo, parashtruesi i kërkesës në autorizimin nuk është thirrur në statusin e

tij të drejtorit të "SH.P.K. Tabak", as nuk kishte dorëzuar ndonjë dëshmi me të cilën do të kishte dëshmuar se parashtruesi i kërkesës është person i autorizuar për të nënshkruar autorizimin në emër të "SH.P.K. Tabak".

20. Më 29 janar 2014, DHPGJS mori Aktvendimin (nr. C-I-12-0004), me të cilin hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë se posedon legjitimitetin aktiv në kontest, siç është kërkuar me urdhrin e DHPGJS-së, të 30 shtatorit 2013.

21. Më 14 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti një ankesë në Kolegjin e Ankesave të DHPGJS, me të cilën kërkoi përsëritjen e procedurës dhe anulimin e Aktvendimit të DHPGJS (nr. C-I-12-0004).

22. Më 5 shtator 2014, Kolegji i Ankesave të DHPGJS me Aktvendimin (nr. AC-I-14-0044) e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, me arsyetim:

> *"... se paditësi ka mundur lehtë t'i paraqesë këto dëshmi gjatë procedurës para gjykatës së shkallës së parë pasi ky aktvendim i vjetër i Gjykatës Ekonomike në Prishtinë i vitit 1992 ka qenë në dispozicion të paditësit. Por, ai nuk e kishte prezantuar atë dokument para Kolegjit të Specializuar edhe pse në urdhrin e 10 shtatorit 2013 është urdhëruar që të paraqitet ndonjë dëshmi e cila do të kishte dëshmuar se autorizimi është lëshuar në mënyrë të rregullt nga personi i autorizuar ashtu që të shërbejë për qëllimin e parashikuar me ligjin e aplikueshëm."*
>
> *"... Theksi i cili është vënë në cilësinë e drejtorit të ndërmarrjes, ndërkohë që kjo nuk është konfirmuar me dëshmi konkrete, nuk është i mjaftueshëm, prandaj, gjykata me të drejtë kërkoi që me prova konkrete të sqarohet nëse personi i cili e lëshon autorizimin ka qenë i autorizuar me dokument sipas ligjit të aplikueshëm...".*

Pretendimet e parashtruesit

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta, duke refuzuar kërkesëpadinë në të dyja shkallët e vendosjes për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv të paditësit, e kanë shkelur *"të drejtën për qasje në gjykatë"* dhe të drejtat e garantuara me nenet 24, 31, 32, 46, 54, 159 dhe 160 të Kushtetutës, si dhe nenet 6, 13 dhe 14 të KEDNJ-së dhe pikën 1 të Protokollit I të KEDNJ-së.

24. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të *"shpall kërkesën të pranueshme... dhe që në bazë të shkeljes së konstatuar të të drejtave*

të njeriut të urdhërojë AKP-në... të vërtetojë se janë shkelur të drejtat pronësore të paditësit dhe ta detyrojë AKP-në" t'ia kompensojë dëmin për shkak të drejtave pronësore të shkelura dhe t'ia caktojë dëmshpërblimin për pronën, siç është paraqitur në faqen 17, nënparagrafin III, të kërkesës së parashtruesit para Gjykatës Kushtetuese.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

26. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

27. Gjykata thekson edhe nenin 48 të Ligjit, i cili parashikon:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

28. Për më tepër, Gjykata rikujton rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *„(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi e pabazuar, nëse bindet se:*
>
> ...
>
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

29. Gjykata vëren se parashtruesi në thelb e ka bazuar kërkesën në *"shkeljen e së drejtës për qasje në gjykatë"* dhe se të gjitha shkeljet e tjera të Kushtetutës, të cilat parashtruesi i thekson në kërkesë, rrjedhin për shkak të vendimit të gjykatave të rregullta që të refuzojnë kërkesëpadinë për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv të paditësit.

30. Më tej, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës në procedurën para gjykatave të rregullta ka vepruar si drejtor i *"SH.P.K. Tabak"*,

duke tentuar të përfaqësojë personin juridik dhe interesat e 31 punëtorëve, si aksionarëve të kësaj ndërmarrje.

31. Derisa parashtruesi para Gjykatës Kushtetuese e ka paraqitur kërkesën si person fizik, duke theksuar se me profesion është pensionist, njëkohësisht ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese zgjidhjen e çështjeve pronësore që u përkasin personave të tretë (aksionarëve të tjerë).

32. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për *"shkeljen e së drejtës në qasje në gjykatë"*, ku ai si drejtor ka tentuar të përfaqësojë personin juridik *"SH.P.K. Tabak"* dhe interesat e 31 punëtorëve, si aksionarëve të kësaj ndërmarrje, nuk janë të sakta, sepse më 31 shtator 2013, DHPGJS urdhëroi parashtruesin e kërkesës të *"prezantojë autorizimin me të cilin e autorizon përfaqësuesin e tij në procedurën para DHPGJS-së, si dhe dëshminë se autorizimi i tillë është lëshuar nga personi i cili është i autorizuar për këtë sipas ligjit të aplikueshëm"*.

33. Parashtruesit të kërkesës i është dhënë mundësia që në procedurën para DHPGJS-së t'i paraqesë dëshmitë me të cilat do të kishte dëshmuar se ai ka autorizimin për të përfaqësuar personin juridik "SH.P.K. Tabak" dhe aksionarët e tjerë. Një gjendje e tillë faktike është konstatuar me Aktvendimin (nr. C-I-12-0004 të DHPGJS-së), të 29 janarit 2014.

34. Gjykata Kushtetuese konstaton se Aktvendimi i DHPGJS-së (nr. C-I-12-0004) dhe Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së (nr. AC-I-14-0044), japin një përgjigje të arsyetuar përse parashtruesi i kërkesës nuk posedon legjitimitetin aktiv për të përfaqësuar personin juridik "SH.P.K Tabak" dhe aksionarët e tjerë.

35. Më tej, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për *"shkeljen e së drejtës për qasje në gjykatë"* të tij, si personit fizik dhe pronarit të një numri të caktuar të aksioneve të cilat i ka fituar me transformimin pronësor gjithashtu nuk janë të sakta, sepse parashtruesi i kërkesës nuk i kishte bashkëngjitur dëshmitë se ai ka tentuar që këto të drejta t'i realizojë në procedurën para gjykatave të rregullta.

36. Parashtruesit të kërkesës, si dhe aksionarëve të tjerë, të cilët parashtruesi i ka përmendur në kërkesë, u është dhënë mundësia për t'i paraqitur këto kërkesa të tyre në procedurën para AKP-së, e cila me njoftimin e datës 23 maj 2013, *"ftoi të gjithë personat që pretendojnë se kanë të drejtën e kërkesës apo interesit ndaj kësaj ndërmarrje apo aseti të ndërmarrjes t'i paraqesin dëshmitë e kërkesës, duke filluar prej datës 17 qershor 2013 deri më datën 31 korrik 2013"*.

37. Më tej, Gjykata nuk është lëshuar në shqyrtimin e shkeljeve të tjera të Kushtetutës dhe KEDNJ-së të cilat i thekson parashtruesi, e të cilat në thelb rrjedhin nga shkelja e së drejtës për qasje në gjykatë sepse këto pretendime të parashtruesit të kërkesës nuk janë të sakta dhe janë në kundërshtim me dokumentacionin të cilin parashtruesi e dorëzoi në Gjykatë.

38. Gjykata rithekson që, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt sa i përket vendimeve të marra nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat ligjore përkatëse (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih, gjithashtu, Rastin nr. KI70/11, parashtruesit e kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

39. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur, kryesisht, me kualifikimin juridik të fakteve dhe të ligjit të aplikuar nga gjykatat e rregullta. Kualifikimi juridik i fakteve dhe ligji i aplikueshëm janë çështje të ligjshmërisë.

40. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës Sllovake,* vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, të 31 majit 2005).

41. Gjykata, në vazhdim theksoi se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e rastit nuk mund t'i jep të drejtë të ngrejë një pretendim të argumentuar për shkeljen e Kushtetutës (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykim i GJEDNJ-së, kërkesa nr. 5503/02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

42. Parashtruesit të kërkesës i është ofruar mundësia që të paraqes rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit, si gabimisht të interpretuar, para AKP-së, DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së në procedurën e rregullt gjyqësore.

43. Gjykata, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

44. Gjykata konsideron se nuk janë plotësuar kushtet për pranueshmëri. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të paraqesë dhe të mbështesë pretendimet se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.

45. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet si e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

Kërkesa për Masë të përkohshme

46. Siç është theksuar edhe më lart, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata *"Të lëshojë masën e përkohshme me të cilën Gjykata do të suspendojë procedurën e likuidimit në mënyrë që të shmanget shkaktimi i dëmit të pariparueshëm"*.

47. Në mënyrë që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) dhe (5) të Rregullores së punës, nevojitet që:

> *"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
>
> *(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; ose*
> *(...)*
>
> *Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës"*.

48. Siç u theksua më lart, kërkesa e parashtruesit është e papranueshme. Për këtë arsye, nuk ka rast *prima facie* për vendosjen e Masës së përkohshme. Prandaj, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të hidhet poshtë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me nenin113paragrafi7i Kushtetutës, nenet20dhe48të Ligjitdherregullat36(2) (b) dhe55(5) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 30 korrik2015,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI49/15, Parashtrues Veli Kuçi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 65/2015, i 26 marsit 2015

KI49/15, Aktvendim për papranueshmëri i 8 korrikut 2015, publikuar më 9 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, barazia para ligjit, e drejta e lirisë dhe sigurisë, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, vepra penale e mashtrimit, dënim unik me burgim*

Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës përkitazi me dënimin, me burgim unik për shkak të kryerjes së veprës penale të mashtrimit. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar se është gjykuar padrejtësisht dhe se vendimet e gjykatave të rregullta duhet anuluar.

Gjykata Kushtetuese vërejti se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese, dhe se procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta, nuk ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI49/15
Parashtrues
Veli Kuçi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
PML. nr. 65/2015, të 26 marsit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Veli Kuçi, nga fshati Shirokë, komuna e Suharekës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PML. nr. 65/2015, të 26 marsit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës konsideron se *"procedurat para gjykatave të rregullta ishin të padrejta"* dhe se janë shkelur nenet 24 [Barazia para Ligjit], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 prill 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 2 qershor 2015, me Vendimin GJR. KI49/15, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin KSH. KI49/15, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalovć dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 18 qershor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 8 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 21 dhjetor 2009, me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 1931/2009, parashtruesi i kërkesës u shpall fajtor për dhjetë vepra penale të mashtrimit nga neni 261, paragrafi 1, i Kodi Penal i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK) dhe u dënua me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e dy muaj.

10. Prokurori Publik Komunal në Prishtinë, në afatin ligjor, ka ushtruar ankesë kundër Aktgjykimit (P. nr. 1931/2009) për shkak të vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënimin më i lartë me burg.

11. Parashtruesi i kërkesës, në afatin ligjor, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit (P. nr. 1931/2009), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi të anulohet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

12. Më 12 mars 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin PA 1 nr. 441/12, i refuzoi si të pabazuara ankesat e Prokurorit Publik Komunal në Prishtinë dhe të parashtruesit të kërkesës, si dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë (P. nr. 1931/09).

13. Më 23 janar 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës (PA 1 nr. 441/12) dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë (P. nr. 1931/09).

14. Më 26 mars 2015, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin PML. nr. 65/2015, e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me arsyetimin si në vijim:

> *"... Në mbështetje të gjitha provave të administruara rezulton se përfundimet e gjykatave janë të drejta dhe të ligjshme, meqë në kuadër të veprimeve konkrete i dënuari në emër të Agjencisë për ndërmjetësim për punësim, nga të dëmtuarit ka kërkuar të holla për t'iu siguruar vizat e punës edhe për këtë destinim iu ka marrë shumën e caktuar të hollash edhe pse ka ditur se këtë nuk mund ta bëjë dhe kështu i ka vë në lajthim të dëmtuarit...".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Nuk e kam kryer këtë vepër penale dhe të gjitha palëve i janë kthyer paratë deri në centin e fundit*".

17. Parashtruesi i kërkesës konsideron: "*Pa të drejtë jam gjykuar dhe kërkojë që të lirohem nga ky dënim dhe të anulohen vendimet me të cilat jam dënuar*".

Pranueshmëria kërkesës

18. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

20. Gjykata thekson edhe nenin 48 të Ligjit, i cili përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

21. Për më tepër, Gjykata rikujton rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

„(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

...

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

22. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i përsërit të njëjtat pretendime edhe në procedurën lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila me Aktgjykimin PML. nr. 65/2015, të 26 marsit 2015, dha përgjigje të arsyeshme ndaj të gjitha pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me arsyet e aplikimit të rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.

23. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih, gjithashtu, rastin KI70/11, të parashtruesve të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

24. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë,* Vendim i GJEDNJ-së për pranushmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

25. Edhe pse parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat e tij janë shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe me zbatimin e gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, ai nuk ka treguar se si vendimet e përmendura kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.

26. Gjykata më tej vëren se vetë fakti që parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'i japë atij të drejtë të inicojë një kërkesë të argumentuar për shkeljen e Kushtetutës (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, kërkesa nr. 5503/02, *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

27. Parashtruesit të kërkesës i është dhënë mundësia për të paraqitur rastin e tij dhe të kundërshtojë interpretimin e ligjit, të cilin ai e konsideron si gabimisht të interpretuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës, në procedurën e rregullt gjyqësore.

28. Gjykata, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, nuk ka konstatuar që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendim i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

29. Gjykata konsideron se kriteret e pranueshmërisë nuk janë plotësuar. Parashtruesi i kërkesës nuk arriti të paraqesë dhe të dëshmojë pretendimet se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.

30. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet si e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me nenin113,paragrafi7, të Kushtetutës, në pajtim me nenet20dhe48të Ligjitdhe në pajtim me rregullin36(2) (b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 8 korrik2015,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI11/15, Parashtrues Ymer Bardhi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit AC-I.-14-0233 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, i 1 dhjetorit 2014

KI11/15, Aktvendim për papranueshmëri i 31 gushtit 2015, publikuar më 11 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Masë e përkohshme, procesi i privatizimit*

Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posaçme kishte miratuar ankesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për mos tjetërsimin e një prone shoqërore dhe kishte shfuqizuar masat e përkohshme përkitazi me atë pronë. Parashtruesi i kërkesës kishte pretendime pronësore ndaj pronës në fjalë. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar se vendimi i Dhomës së Posaçme ishte në kundërshtim me çdo normë dhe rregull juridik.

Gjykata Kushtetuese konsideroi se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se si dhe pse të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë, janë shkelur me vendimin e kontestuar për refuzimin e kërkesës dhe për vendosjen e Masës se përkohshme. Prandaj kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI11/15
Parashtrues
Ymer Bardhi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I.-14-0233,
të 1 dhjetorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Ymer Bardhi me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), AC-I.-14-0233, të 1 dhjetorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës nuk ka cekur në mënyrë specifike se cilat nene të Kushtetutës janë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit

për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 shkurt 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 mars 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI11/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI11/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

7. Më 28 prill 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit.

8. Më1 korrik 2015, meVendimin GJR. KI11/15, Kryetarja e Gjykatëscaktoi gjyqtarenArta Rama-Harjizi anëtare tëKolegjit shqyrtuesnë vend të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit i përfundoi mandati në Gjykatën Kushtetuesemë 26 qershor2015.

9. Më 7 korrik2015, pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtuesi rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, prona e patundshme në pronësi të paraardhësve të tij ishte marrë pa të drejtë në vitin 1946 dhe u ishte ndarë personave të tjerë. Personat e përmendur, në një datë të pacaktuar, ia shitën tokën kontestuese ndërmarrjes shoqërore „BUJQËSIA“ nga Peja.

11. Në shtator 2013, parashtruesi i kërkesës ka iniciuar procedurën para Trupit gjykues të DHPGJS-së, në të cilën kërkoi anulimin e kontratës së lartpërmendur të shitblerjes, me të cilën ndërmarrja shoqërore „BUJQËSIA“ nga Peja, tani nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), është bërë pronare e patundshmërisë kontestuese. Përveç kësaj, parashtruesi kërkoi nga Trupi gjykuesi DHPGJS-së edhe vendosjen e masës së përkohshme të ndalimit të tjetërsimit të patundshmërisë së përmendur nën administrimin e AKP-së.

12. Më 22 korrik 2014, Trupi gjykues i DHPGJS-së [me Vendimin C-III.-13-0462] aprovoi kërkesën e parashtruesit për vendosjen e masës së

përkohshme të ndalimit të tjetërsimit të patundshmërisë së përmendur nën administrimin e AKP-së, deri në marrjen e vendimit përfundimtar mbi bazueshmërinë e lëndës.

13. Më 31 korrik 2014, AKP-ja paraqiti ankesë ndaj Vendimit të Trupit gjykues të DHPGJS-së në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, duke pretenduar se parashtruesi i kërkesës që nga viti 1952 dhe këndej nuk ka qenë asnjëherë titullar juridik i patundshmërisë kontestuese. Sipas nenit 268 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, kthimi i pronësisë mund të kërkohet në afat prej 5 (pesë) vjetësh, duke filluar nga dita e marrjes në dijeni, e më së voni në afat prej 10 (dhjetë) vjetësh.

14. Më 25 nëntor 2014, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së [me Vendimin AC-I.-14-0233] aprovoi ankesën e AKP-së dhe anuloi Vendimin [C-III.-13-0462] e Trupit gjykues të DHPGJS-së, si dhe refuzoi kërkesën e parashtruesit për vendosjen e masës së përkohshme. Në arsyetimin e vendimit të tij, Kolegji i Apelit i DHPGJS, ndër të tjera, theksoi:

> *„Pretendimi i parashtruesit të kërkesës se ai e mban/shfrytëzon pronën me qëllim të mirë nuk është argument juridik për lëshimin e masës së përkohshme.*
> *Për arsyet e lartcekura, Kolegji i Apelit e anulon vendimin e kontestuar dhe refuzon kërkesën e parashtruesit për lëshimin e masës së përkohshme si të pabazuar.*
> Ky vendim nuk ka asnjë ndikim në zgjidhjen përfundimtare të kësaj kërkese, përkundrazi, parashtruesit e kërkesës inkurajohen që të ofrojnë dëshmi në procedurë për t'i mbështetur pretendimet e tyre ndaj pronës."

Dispozitat relevante ligjore
Ligji mbi Punën e Bashkuar
PR nr. 528
i 25 nëntorit 1976

Neni 268

> *Nëse patundshmëria është bërë mjet shoqëror pa bazë juridike, kthimi i së njëjtës mund të kërkohet në afat prej pesë vjetësh, duke filluar nga dita e marrjes në dijeni, e më së voni në afat prej dhjetë vjetësh.*

[...].

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, me Aktvendimin e tij AC-I.-14-0233-A0001, të 1 dhjetorit 2014, e ka anuluar Aktvendimin e Trupit gjykues të DHPGJS-së me arsyetim të paqëndrueshëm.

16. Parashtruesi i kërkesës më tej thekson:

> *„Se Kolegji i Apelit i DHOMËS SË POSAÇME të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në Prishtinë, me aktvendimin e tij, numër dhe datë apostrofuar më sipër, në kundërshtim me çdo normë dhe rregull juridik rrjedhimisht ka prejudikuar zgjidhjen përfundimtare të padisë së paditësve...".*

17. Parashtruesi kërkon nga Gjykata, si në vijim:

> *„Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të DHOMËS SË POSAÇME të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në Prishtinë, AC–I.-14-0233-A0001 dt. 01.12.2014,* ***anulohet****, ndërsa aktvendimi i Kolegjit të Specializuar të DHOMËS SË POSAÇME të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në Prishtinë, C-III.-13-0462 dt. 20 korrik 2014, lidhur me* ***CAKTIMIN E MASËS SË PËRKOHSHME TË SIGURISË*** *në barrë të patundshmërisë kontestuese evidentuar në Certifikatën Nr. 01-30-13, Zona Kadastrale LUTOGLLAVË, Komuna Kadastrale Pejë,* ***mbetet edhe më tej në fuqi deri në zgjidhjen meritore të padisë – datë 17 shtator 2013.****"*

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

20. Gjykata thekson se kërkesa e parashtruesit shqyrtohet nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe të lirive të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi, në kërkesën e tij, përveç bazës juridike për parashtrimin e kërkesës, nuk ka përmendur konkretisht se cilat të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë janë shkelur me vendimin të cilin ai e konteston, edhe pse me nenin 48 të Ligjit parashihet:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

21. Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

"(1) Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi e pabazuar, nëse bindet se:

(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose
(b) aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

22. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së është në kundërshtim me çdo normë dhe rregull juridik.

23. Në këtë kuptim, Gjykata konsideron se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, në vendimin e tij, ka ofruar arsye të vlefshme për gjetjet e tij (Shih paragrafin 12). Rrjedhimisht, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së e ka arsyetuar vendimin e vet dhe ka argumentuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin e kërkesës për lëshimin e masës së përkohshme, duke arsyetuar që *"pretendimi se ata kanë qenë shfrytëzues me mirëbesim të kësaj prone, nuk është argument ligjor për lëshimin e masës së përkohshme"*.

24. Për më tepër, Kolegji i Apelitmë tej theksoi:"*Ky aktvendim nuk prejudikon zgjidhjen përfundimtare të kësaj padie në asnjë mënyrë. Përkundrazi, inkurajohen paditësit që të ofrojnë prova në procedurë, që do të dëshmojnë pretendimet e tyre pronësore*".

25. Gjykata rithekson që nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, në lidhje me vendimet që merren nga DHPGJS. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih rastin *Edvards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr.* 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

26. Në këtë rast, Gjykata nukgjen se procedurat përkatëse para DHPGJS-së kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendim i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

27. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se si dhe pse të drejtat dhe liritë e tij, të garantuara me Kushtetutë, janë shkelur me vendimin e kontestuar për refuzimin e kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme.

28. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 31 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëvedhe ta publikojë këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI14/15, Parashtrues Milić Krstić - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit GSK-KPA-A-284/13 të Gjykatës Supreme të Kosovës – Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, i 2 dhjetorit 2014

KI14/15, Aktvendim për papranueshmëri i 31 gushtit 2015, publikuar më 11 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës*

Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pronësinë ndaj një objekti afarist. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtën materiale dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike për vërtetimin e së drejtës pronësore.

Gjykata Kushtetuese konsideroi se vetë fakti që parashtruesi i kërkesës e ka humbur kontestin në çështjen juridike të vërtetimit të së drejtës pronësore, nuk mjafton për t'u konstatuar shkelja e se drejtës së tij e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, nëse ai nuk provon që me vendim gjyqësor të jetë privuar në mënyrë arbitrare dhe të padrejtë nga prona. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI14/15
Parashtrues
Milić Krstić
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-284/13, të 2 dhjetorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Milić Krstić, me vendbanim në Mitrovicë të Sremit, Republika e Serbisë (në tekstin e më tejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga avokati z. Goran Belić.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i AKP-së), GSK-KPA-A-284/13, të 2 dhjetorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [GSK-KPA-A-284/13] të Kolegjit të Apelit të AKP-së, të 2 dhjetorit 2014, me të cilin pretendohet të jetë shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës nga neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës së Kosovës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës(në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 mars 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI14/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me Vendimin nr. KSH. KI14/15, Kryetari i Gjykatës caktoi edhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 27 mars 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Kolegjin e Apelit të AKP-së për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 26 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI14/15 caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues në vend të gjyqtares Arta Rama – Hajrizi. Me Vendim të njëjtë, Kryetarja caktoi gjyqtaren Arta Rama – Hajrizi anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, të cilit më 26 qershor 2015 i përfundoi mandati në Gjykatën Kushtetuese.

9. Më 6 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, më 8 shtator 1998, organi administrativ i Komunës së Istogut nxori aktvendimin për dhënien në shfrytëzim të ngastrës nr. 1800/2, në të cilën ai më vonë ndërtoi një objekt afarist, i cili është objekt i çështjes i kësaj ankese kushtetuese.

11. Më 6 korrik 2007, parashtruesi parashtroi kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejmë: AKP), me të cilën kërkoi vërtetimin e të drejtave pronësore mbi objektin afarist që gjendet në rrugën "Varoshi", komuna e Istogut, ngastra nr. 1800/2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 48 m².

12. Më 18 prill 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KKPK) nxori vendim [KPCC/D/C/200/2013], me të cilin refuzoi si të pabazuar kërkesën pronësore të parashtruesit. Në përfundimin e vendimit thuhet:

    "[...] Sekretariati Ekzekutiv i KKPK-së nuk e ka vërtetuar besueshmërinë e dokumenteve të dorëzuara nga paraqitësi i kërkesës. Komisioni gjen se paraqitësi i kërkesës nuk e ka dështuar asnjë të drejtë pronësore mbi pronën në kërkesë".

13. Më 6 shtator 2013, parashtruesi parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të AKP-së ndaj vendimit KPCC/D/C/200/2013 të KKPK, të 18 prillit 2013.

14. Më 2 dhjetor 2014, Kolegji i Apelit i AKP-së nxori Aktgjykim [GSK-KPA-A-284/13], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi në tërësi vendimin e KKPK-së [KPCC/D/C/200/2013], të 18 prillit 2013.

15. Në përfundimin e vendimit të Kolegjit të Apelit të AKP-së, të 2 dhjetorit 2014, thuhet:

    "[...] ankuesi (parashtruesi i kërkesës) nuk ka sjellë ndonjë vendim për ndarje ose provë e cila e vërteton të drejtën për përdorim ose të drejtën e pronësisë mbi hapësirën afariste pavarësisht nga fakti që komisioni ka kërkuar shpjegime dhe informata plotësuese, dhe në pajtim me këtë, Kolegji i Apelit i AKP-së gjen se KKPK-ja nxori vendim të saktë, të bazuar në procedurën e plotë dhe të saktë. Kolegji i Apelit i AKP-së mëtej gjen se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale ose vërtetim jo të plotë të fakteve, prandaj ankesa është e pabazuar".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi thekson në kërkesë se gjykatat kanë shkelur të drejtën materiale dhe kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike lidhur me kërkesën e tij për vërtetimin e së drejtës pronësore.

17. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me këtë kërkesë:

    „[...] Gjykata të vërtetojë se në procedurën në Gjykatën Supreme të Kosovës – Kolegjin e Apelit të AKP-së në lëndën me nr. GSK-KPA-A-284/13 është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës për mbrojtjen e pronës nga neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të përcaktojë mënyrën e shpërblimit të drejtë të

parashtruesit të ankesës kushtetuese, gjegjësisht, ta urdhërojë Gjykatën Supreme të Kosovës – Kolegjin e Apelit të AKP-së që përsëri të vendosë sipas ankesës.“

Pranueshmëria e kërkesës

18. Nëmënyrë që të jetënë gjendje tëshqyrtojë kërkesën eparashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëseparashtruesii kapërmbushurkushtet epranueshmërisë,të përcaktuarame Kushtetutë dhe të specifikuaramë tejnëLigj dhe në Rregullore të punëssë Gjykatës.

19. Në këtë kuptim, neni 113, par. 7, i Kushtetutës parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

20. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendohet se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

21. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit36 (1) (d)të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(1) “Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) nëse kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar”.

22. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit është e mbështetur posaçërisht në pretendimin për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës [Mbrojtja e Pronës]. Ky nen parasheh:

1. *“E drejta e pronës është e garantuar.*

2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*

3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së*

Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.

4. *Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*

5. *Prona intelektuale mbrohet me ligj".*

23. Gjykata vëren më tutje se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimit për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, të cilin e thekson në kërkesë, me asgjë tjetër nuk e arsyeton pretendimin e vet para Gjykatës.

24. Gjykata thekson se e drejta e pronës nga neni 46 i Kushtetutës është objekt i mbrojtjes në sistemin kushtetues të Kosovës dhe korrespondon në përmbajtje me të drejtën e pronës, të paraparë me nenin 1, të Protokollit nr. 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ). Këtë të drejtë e mbron Kushtetuta, duke ua ndaluar organeve të pushtetit shtetëror kufizimet ose heqjen e kësaj të drejte, përveç nëse kufizimi ose heqja e saj mbështetet në ligj.

25. Sipas mendimit të Gjykatës, vetë fakti që parashtruesi i kërkesës e ka humbur kontestin në çështjen juridike të vërtetimit të së drejtës pronësore nuk mjafton për t'u konstatuar shkelja e së drejtës së tij e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, nëse ai nuk provon që me vendim gjyqësor të jetë privuar në mënyrë arbitrare dhe të padrejtë nga prona (Shih, *mutatis mutandis,* rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

26. Gjykata përsërit më tej se, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt sa i përket vendimeve të marra nga ana e gjykatave të rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe të së drejtës materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih edhe rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

27. Si përmbledhje, Gjykata gjen se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka provuar që me aktvendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë ose me KEDNJ.

28. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me rregullin36(1) (d) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 31 gusht2015,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI32/15, Parashtrues Shemdi Nishevci - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 188/2014, i 17 nëntorit 2014

KI32/15, Aktvendim për papranueshmëri i 21 gushtit 2015, publikuar më 11 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit*

Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar kërkesën për revizion të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës kundër vendimeve të gjykatave të instancës me të ulët përkitazi me shkëputjen e kontratës së punës. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar në shkelje të të drejtave të tij kushtetuese për shkak se gjykatat e rregullta nuk kishin shqyrtuar drejtë provat materiale.

Gjykata Kushtetuese konsideroi se arsyetimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme është i gjerë dhe gjithëpërfshirës dhe përmban arsyetim të detajuar se përse është dashur që revizioni të refuzohet si i pabazuar dhe të vërtetohen aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI32/15
Parashtrues
Shemdi Nishevci
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 188/2014, të 17 nëntorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Shemdi Nishevci nga Podujeva, të cilin e përfaqëson z. Ndue Thaçi, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 188/2014, të 17 nëntorit 2014(në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), me të cilinu vërtetuanvendimet egjykatave të instancave më të ulëta, sipas të cilavenuk kishte bazë ligjore përanulimin evendimit tëpunëdhënësit. Aktgjykimi i kontestuari ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 15 janar 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës për barazi para ligjit, për gjykim të drejtëdhe të paanshëm, dhetë drejtën e punësdhe ushtrimin eprofesionit, siç garantohen me nenet 3 dhe 24.2, me nenin 31, me nenin 49 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenet 22 e 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 mars 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 13 maj 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kësaj kërkese ia dërgoi Gjykatës Supreme.

8. Më 1 korrik 2015, Kryetarja emëroi vetveten anëtare në Kolegjin shqyrtues në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, mandati i të cilit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka përfunduar më 26 qershor 2015.

9. Më 8 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 1 shkurt 2009, parashtruesi lidhi kontratë pune (nr. 2188/0) me Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi) në pozitën mbikëqyrës i rrjetit në Distriktin e Prishtinës.

11. Më 6 shtator 2010, punëdhënësi (Njoftimi nr. 118) informoi parashtruesin për shkëputjen e kontratës së tij të punës, për shkak të shkeljes serioze të detyrave të tij të punës.

12. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë te menaxheri i Distriktit të Prishtinës, duke kërkuar rishqyrtimin e njoftimit për shkëputjen e kontratës së punës.

13. Më 13 shtator 2010, punëdhënësi (Vendimi nr. 451), refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës.

14. Më 19 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, kundër vendimit të punëdhënësit për refuzimin e ankesës së parashtruesit.

15. Më 6 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi, C. nr. 2046/2010), refuzoi padinë e parashtruesit si të pabazuar, duke u arsyetuar se "*ky veprim i paditësit edhe pse nuk është shkaktuar në vendin e punës po është shkaktuar në shtëpinë e tij paraqet, si shkelje të rëndë të detyrave të punës*".

16. Më 6 nëntor 2012, parashtruesi kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, për shkak të *"cenimit tërëndë tëdispozitave tëprocedurës kontestimore, vërtetimit jotëplotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar tësë drejtës materiale"*.

17. Më 3 janar 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi, Ac. nr. 1572/2013) refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin (C. nr. 2046/10) e Gjykatës Komunale, duke arsyetuar ndërmjet të tjerave se "*kur punëmarrësi bën vjedhjen, shkatërrimin, dëmtimin, ose shfrytëzimin e po autorizuar te pasurisë te punëdhënësit, punëmarrësit mund t'i shkëputet kontrata e punës"*.

18. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme, për shkak të "*shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të ligjit material"*.

19. Më 17 nëntor 2014, GjykataSupreme (Aktgjykimi, Rev. nr. 188/2014) refuzoi revizionin si të pathemeltë.

20. Gjykata Supreme gjeti se "*...Shkëputja e kontratës se paditësit është bërë pas zhvillimit të procedurës paraprake ku më parë e paditura e ka njoftuar paditësin me shkrim për zhvillimin e procedurës ndaj tij, për shkelje të rëndë të detyrave të punës, prandaj pretendimet në revizion, për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, u refuzuan si të pabazuara"*.

21. Përveç kësaj, Gjykata Supreme gjithashtu konkludoi se "aktgjykimi ikontestuarnuk përbëngabime *që* do të kishinkontestuarligjshmërinë eAktgjykimit".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pohon se vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 3 dhe 24.2 [Barazia Para Ligjit], me nenin 22 [ZbatimiiDrejtpërdrejtëi MarrëveshjevedheInstrumenteveNdërkombëtare], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 49 [E Drejta e Punës dheUshtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, si dhe të drejtat e

garantuara me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar kishte shkelur të drejtat e tij kushtetuese, sepse gjykatat e rregullta nuk i shqyrtuan drejt provat materiale.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata Kushtetuese së pari vlerëson nëse kërkesa e parashtruesit i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

26. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) (d) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".*

27. Për më tepër, rregulli 36 (2) i Rregullores së punës, parasheh:

> *"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*
>
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

28. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pohon që vendimi i kontestuar kishte shkelur të drejtat e tij për barazi para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm dhe e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit.

29. Megjithatë, Gjykatakonsideronse parashtruesi i kërkesësthjeshtdeklaroi seka pasur shkelje tëtë drejtavetë tijkushtetuese, pashpjeguar qartë sesi dhe psefaktetqë aiparaqitipërbëjnë shkelje të të drejtave kushtetuesetë cilave ai u referohet.

30. Gjykata thekson se, për të pasur një rast që ngre shkelje kushtetuese, parashtruesi duhet të dëshmojë dhe të provojë se procedurat në gjykatat e rregullta, përfshirë Gjykatën Supreme, shikuar në tërësinë e tyre, nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur dhe në pajtueshmëri me kërkesat e një gjykimi të drejtë, apo që shkeljet e tjera të të drejtave kushtetuese të jenë kryer nga ana e Gjykatës Supreme, gjatë procedurave.

31. Gjykata konsideron se arsyetimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme është i gjerë dhe gjithëpërfshirës, dhe përmban arsyetim të detajuar se përse është dashur që revizioni të refuzohet si i pabazuar dhe të vërtetohen aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët; përkatësisht, për shkak se faktet ishin konstatuar në mënyrë të drejtë, nuk janë gjetur shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim i gabuar i të drejtës materiale.

32. Për më tepër, Gjykatakonsideron separashtruesi nukkadëshmuardhe nuk ka provuarpretendimin e tijnë bazakushtetuese; përkundrazi, ai vetëm ishte kufizuar në diskutimin për shkeljen edispozitave tëprocedurëskontestimore dhe të zbatimittë gabuartë së drejtës materiale, të cilat janë të natyrës së ligjshmërisë dhe bien nën juridiksionin e gjykatave të rregullta.

33. Në këtë kontekst, Gjykata nuk do të duhej të vepronte si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz vs. Spain* [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

34. Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë vetëm nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur një gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

35. Si përmbledhje, Gjykata, në rastin konkret nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih*, mutatis mutandis, Shub vs. Lithuania*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

36. Nga të gjitha arsyet e shtjelluara më lart, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1), (d) dhe 36 (2) (të Rregullores së punës, më 21 gusht 2015, njëzëri:

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI15/15, Parashtrues Hysni Hoxha kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit – Kërkesë për interpretimin ligjor të nenit 100 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës

KI15/15, Aktvendim për papranueshmëri i 7 korrikut 2015, publikuar më 15 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e papranueshme, ratione materiae*

Parashtruesi kërkoi nga Gjykata që t'i interpretojë kushtet të cilat parashihen me Ligjin për Prokurimin Publik dhe të vendosë, nëse imuniteti i anëtareve të emëruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit është i nivelit tënjëjtë me atë që iu garantohet gjyqtarëve në sistemin gjyqësor të Kosovës.

Gjykata Kushtetuese theksoi se është tërësisht e qartë se ajo interpreton Kushtetutën dhe vlerëson përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, por me asnjë dispozitë kushtetuese dhe në asnjë rrethanë, ajo nuk është e autorizuar të interpretojë dispozitat konkrete të ligjit, si një akt juridik unik.Kërkesa u shpall e papranueshme *ratione materia,*në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (3) (e) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI15/15
Parashtrues
Hysni Hoxha,
kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit
Kërkesë për interpretimin ligjor të nenit 100 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Hysni Hoxha, kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit (në tekstin e mëtejmë: OSHP). Parashtruesi nuk kishte sqaruar nëse kërkesën e parashtron si individ, apo në emër të OSHP-së. Megjithatë, ai në kërkesë ka potencuar funksionin e tij zyrtar dhe kërkesën e ka vulosur me vulën zyrtare të OSHP-së.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë vendim të autoriteteve publike.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për interpretimin e nenit 100 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), me të cilin parashihen kushtet dhe kualifikimet profesionale që duhet t'i plotësojnë kandidatët për t'u zgjedhur anëtarë të OSHP-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 shkurt 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 mars 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI15/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 1 korrik2015,Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, mandati i të cilit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka përfunduar më 26 qershor 2015.

8. Më 1 prill 2015, GjykataKushtetuese e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai plotësimin e formularit të kërkesës të Gjykatës në mënyrën e paraparë me rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës.

9. Më 16 prill 2015, Gjykata pranoi nga parashtruesi formularin e plotësuar të kërkesës.

10. Më 7 korrik2015,passhqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues,Kolegji shqyrtues i rekomandoiGjykatës që ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 19 mars 2014, Kuvendi i Kosovës kishte emëruar parashtruesin e kërkesës dhe 4 (katër) anëtarë të tjerë të OSHP-së me mandat 5 (pesë) vjeçar. Kuvendi gjithashtu caktoi parashtruesin e kërkesës Kryetar të OSHP-së.

12. Emërimi i Kryetarit dhe i anëtarëve të OSHP-së ishte bërë në përputhje me procedurat e parapara me nenin 100.4 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

13. Me nenin 100.5, nënpara. 5.4 të po këtij Ligji, përcaktohet se një prej kushteve vendimtare për emërimin e kandidatëve për anëtarë të OSHP-së është si në vijim:

"5.4. të plotësojë kriteret për tu emëruar si gjykatës;"

14. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që t'i interpretojë kushtet të cilat parashihen në këtë Ligj dhe të vendosë nëse imuniteti i anëtarëve të emëruar në OSHP është i nivelit të njëjtë me atë që iu garantohet gjyqtarëve në sistemin gjyqësor të Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi nuk saktëson ndonjë nen të Kushtetutës që mund të jetë shkelur apo që mund të interpretohet, por kërkon që Gjykata Kushtetuese të interpretojë çështjen ligjore të ngritur nga ai dhe të parashtruar në paragrafin 14.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Për të gjykuar lidhur me kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

17. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

18. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

19. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (3) (e) të Rregullores së punës, me të cilin është përcaktuar:

"Një kërkesë*mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*

e) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;

20. Lidhur me kërkesën, Gjykata thekson se me nenin 4.6 të Kushtetutës së Kosovës është përcaktuar se *"Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës",* ndërsa me nenin 112.1 po ashtu të Kushtetutës është përcaktuar se *"Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën".*

21. Nga sa u tha më lart, është tërësisht e qartë se Gjykata Kushtetuese bën interpretimin e Kushtetutës dhe vlerëson përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, por me asnjë dispozitë kushtetuese dhe në asnjë rrethanë ajo nuk është e autorizuar të bëjë interpretimin e dispozitave konkrete të ligjit si një akt juridik unik.

22. Gjykata, për më tepër, vë në dukje se në asnjërën nga pikat e nenit 113 (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara) të Kushtetutës, nuk është paraparë për asnjërën nga palët e autorizuara e drejta që palët të ngrenë çështje sikur janë ngritur në këtë rast, thjesht sepse ato çështje janë jashtë juridiksionit të Gjykatës.

23. Është evidente që për të vendosur lidhur me një kërkesë të parashtruar para saj, Gjykata duhet të ketë juridiksion material dhe e ka për detyrë të kujdeset lidhur me këtë juridiksion gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës. Në të njëjtën mënyrë, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut në rastin *X kundër Gjermanisë,* arsyetoi:

> "S*ipas nenit 25,* §1 të Konventës*,* vetëmshkelja epretenduarenjë prejtë drejtave dhe lirivetë përcaktuaranë Konventëmund të jetëobjekt injë kërkesetë paraqiturnganjë person*,* organizatëjoqeveritareosegrup individësh.*"* (Shih,XkundërGjermanisë,kërkesanr.7462/76*).*

24. Në rastin konkret, Gjykata nuk ka juridiksion material për vendimmarrje për çështjen e kërkuar dhe kërkesa është *ratione materie* e papajtueshme me Kushtetutën (Shih Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës në Rastin KI115/12, të parashtruesit *Fadil Salihu,* të 25 janarit 2013), dhe si e tillë kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (3) (e) të Rregullores së punës, më 7 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI75/15, Parashtrues Hatixhe Cana-Kurti - Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0218-A0001-A0004, të 14 majit 2015

KI75/15, Aktvendim për papranueshmëri i 21 korrikut 2015, publikuar më 15 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, diskriminim, Masë e përkohshme, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, procesi i privatizimit*

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme kishte miratuar ankesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për përjashtimin e parashtrueses nga lista e punëtorëve që përfitojnë nga 20% i privatizimit të një ndërmarrje shoqërore. Parashtruesja u ankua në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar në shkelje të të drejtës së saj që të përfitoj nga privatizimit i ndërmarrjes shoqërore. Parashtruesja, po ashtu, kërkoi vënien e masave të përkohshme.

Gjykata Kushtetuese konsideroi se shpjegimi i dhënë nga Dhoma e Posaçme është i qartë dhe ligjërisht i argumentuar dhe se, procedura nuk ka qenë e padrejtë apo arbitrare. Gjykata, po ashtu, refuzoi kërkesën për vënien e masave të përkohshme. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) (b) dhe 55 (5) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI75/15
Parashtrues
Hatixhe Cana-Kurti
Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
AC-I-14-0218-A0001-A0004, të 14 majit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Hatixhe Cana-Kurti me vendbanim në fshatin Livoç i Ulët, komuna e Gjilanit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-14-0218-A0001-A0004] të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave), të 14 majit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-14-0218-A0001-A0004] të Kolegjit të Ankesave, të 14 majit 2015, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtrueses së kërkesës, të garantuara me Kushtetutë, me nenin 24

[Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

4. Në të njëjtën kohë, parashtruesja e kërkesës kërkoi që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme, me të cilën do të ndalonte shpërndarjen e mëtejshme të 20%-shit të të ardhurave nga shitja të gjithë punëtorëve që kanë realizuar të drejtën e tyre në këto të ardhura nga privatizimi i ndërmarrjes shoqërore Agrokultura (në tekstin e mëtejmë: NSH Agrokultura) derisa Gjykata të vendosë për meritat e kërkesës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 15 qershor 2015, parashtruesja dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI75/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI75/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 1 korrik 2015, Gjykata e informoi parashtruesen e kërkesës dhe Kolegjin e Ankesave për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 21 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesja e kërkesës ishte e punësuar në Ndërmarrjen Shoqërore (në tekstin e mëtejmë: NSH) Agrokultura nga 15 maji 1985 e deri më 31 mars 1995.

11. Më 26 mars 2006, NSH Agrokultura ishte privatizuar.

12. Më 10 dhjetor 2010, Agjencia Kosovare për Privatizim (në tekstin e mëtejmë: AKP) publikoi listën përfundimtare të punëtorëve që kishin realizuar të drejtën në pjesën e 20%-shit të të ardhurave nga privatizimi i NSH Agrokultura, në të cilën nuk gjendej parashtruesja e kërkesës. Në arsyetimin e vendimit theksohet *„se të gjithë parashtruesit tjerë që nuk janë të kënaqur me vendimin e Agjencisë për Privatizim kanë të drejtë ankese në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme) deri më 31 dhjetor 2010“.*

13. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare e cila ishte publikuar më 10 dhjetor 2010 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Në ankesë, parashtruesja, përveç pretendimeve *"se në vitin 1995, për shkak të diskriminimit të regjimit të atëhershëm dhe menaxhmentit të ndërmarrjes marrëdhënia e saj e punës ishte ndërprerë"* parashtroi një vërtetim të lëshuar nga drejtori i ndërmarrjes si dëshmi për statusin e saj të mëparshëm të punësimit, të cilin ajo e ka pasur gjatë periudhës prej 15 majit 1985 e deri më 31 mars 1995.

14. Më 10 korrik 2014, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar) nxori Aktgjykimin e tij [SCEL- 10-0038] me të cilin aprovoi ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe urdhëroi Dhomën e Posaçme ta përfshijë në listën përfundimtare me punëtorët e tjerë të cilët kishin fituar të drejtën legjitime në një pjesë të 20%-shit të të ardhurave nga privatizimi i NSH Agrokultura.

15. Në një datë të pacaktuar, AKP-ja parashtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi [SCEL- 10-0038] të Kolegjit të Specializuar, sepse AKP-ja nuk kishte mundësi të përgjigjej ndaj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në Kolegjin e Specializuar.

16. Në ankesën e saj, Agjencia Kosovare e Privatizimit theksoi: *"Ankuesja (parashtruesja e kërkesës) nuk ka prezantuar fakte relevante në bazë të të cilave kishte për të vërtetuar faktin se nuk ishin të barabartë dhe arsyetimin për aplikimin e diskriminimit direkt apo indirekt ne pajtim me nenin 8.1 te Ligjit kundër Diskriminimit. Ankuesja nuk ka ofruar fakte për diskriminim, dhe e paditura (Agjencia për Privatizim) nuk ka mundur të paraqes kundër argumentet e saja lidhur me diskriminimin, në të cilat ankuesja [parashtruesja e kërkesës] e ka bazuar ankesën e saj".*

17. Më 14 maj 2015, Kolegji i Ankesave, pas shqyrtimit dhe pas vlerësimit të të gjitha pretendimeve dhe të dëshmive në shkresat e lëndës, të cilat

i kanë dorëzuar palët në procedurë, konstatoi se ankesa e Agjencisë për Privatizim ishte e bazuar dhe, me Aktgjykimin [AC-I-14-0218-A0001-A0004], ndryshoi Aktgjykimin [SCEL- 10-0038] e Kolegjit të Specializuar dhe refuzoi kërkesën e parashtrueses si të pabazuar.

18. Në arsyetimin e Aktgjykimit [AC-I-14-0218-A0001-A0004], Kolegji i Ankesave theksoi: "*Paditësja -C-0002-Hatixhe Cana e kishte librezën e punës të mbyllur me 1995, nuk ka ndonjë vendim për punësimin e saj para kësaj periudhe, nuk ka vendim për pushim nga puna dhe nuk ka ofruar dëshmi tjera për të dëshmuar se ka punuar deri në privatizimin e NSH-së, apo të ketë qenë në listën e pritjes, siç ka deklaruar në ankesë në Dhomën e Posaçme. Për këto arsye, ankuesja nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2003/13, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45, për të hyrë në listën përfundimtare, për të drejtën legjitime për 20%*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesja e kërkesës konsideron se Kolegji i Ankesave, me aktgjykimin e tij, ka shkelur parimin e barazisë para ligjit, në raport me palët e tjera.

20. Parashtruesja i drejtohet Gjykatës me kërkesë: *„Dëshiroj të më njihet e drejta e përfshirjes në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime për marrjen e 20 % nga të hyrat e privatizimit të NSH "Agrokultura" Gjilan."*

Pranueshmëria e kërkesës

21. Për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse ajo i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës, parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

23. Përveç kësaj, neni 48 i Ligjit, gjithashtu parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë*

cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

24. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin [AC-I-14-0218-A0001-A0004] e Kolegjit të Ankesave, me të cilin pretendohet se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

26. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk ka shpjeguar se si dhe pse Aktgjykimi [AC-I-14-0218-A0001-A0004] i Kolegjit të Ankesave ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë.

27. Gjykata, në bazë të kërkesës së parashtrueses, vërejti se parashtruesja është përpjekur ta arsyetojë shkeljen e pretenduar të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës ekskluzivisht me deklaratën: *„[...] Konsideroj se Kolegji i Ankesave me Aktgjykimin e tij kishte shkelur parimin e barazisë para ligjit në raport me palët tjera."*

28. Gjykata vëren se Kolegji i Ankesave kishte bazuar vendimin e tij në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/13, MBI TRANSFORMIMIN E SË DREJTËS PËR PËRDORIMIN E PRONËS SË PATUNDSHME NË PRONËSI SHOQËRORE, të 9 majit 2003, i cili *inter alia* parasheh:

„Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilit pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6".

29. Për më tepër, Gjykata vëren se, në bazë tëkëtij ligji, Kolegji i Ankesavekonkludoiseparashtruesi i kërkesës nukka qenëi punësuarnë

NSHAgrokulturagjatëperiudhës së kërkuar kohorepër tëpasurtë drejtë tëpërfitojë ngapjesa e 20%-shittë të ardhurave(shih par. 16).

30. Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj, sipasKushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin nr. KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011)

31. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e dispozitave të nenit 24 të Kushtetutës (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, kërkesa nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

32. Për më tepër, Gjykata vëren se Kolegji i Ankesave kishte nxjerrë Aktgjykimin e tij [AC-I-14-0218-A0001-A0004] të 14 majit 2015, vetëm pas shqyrtimit dhe pas vlerësimit të të gjitha pretendimeve dhe provave në shkresat e lëndës, të dorëzuara nga të dyja palët në procedurën ankimore.

33. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se shpjegimi i dhënë nga Kolegji i Ankesave në Aktgjykimin [AC-I-14-0218-A0001-A0004]është i qartë dhe ligjërisht i argumentuar dhe se procedura në Kolegjin e Ankesave nuk ka qenë e padrejtë dhe arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* nr. 17064/06, Vendim i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009*).*

34. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sepse parashtruesja nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi për të dëshmuar pretendimet e saj se vendimi i kontestuar në ndonjë mënyrë shkel të drejtat dhe liritë e saj, të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës.

35. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar pretendimin e saj dhe kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme, sepse është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) të Rregullores së punës.

Kërkesa për Masë të përkohshme

36. Siç thuhet në paragrafin 4, parashtruesja e kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, me të cilën do të

ndalohej shpërndarja e mëtejshme e 20%-shit të të ardhurave për të gjithë punëtorët që kishin fituar këtë të drejtë nga privatizimi i NSH Agrokultura, derisa Gjykata të vendosë për meritat e kësaj kërkese.

37. Në mënyrë që Gjykata të shqiptojë Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4 dhe 5) të Rregullores së punës, ajo duhet të konstatojë nëse:

"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin primafacie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të
pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; dhe

(...)

Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës."

38. Siç u theksua më lart, kërkesa e parashtrueses është e papranueshme, prandaj kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (2) (b) dhe 55 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 21 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI98/14, Parashtrues Rasim Rashica - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, PPC. nr. 39/2011, i 5 gushtit 2011

KI98/14, Aktvendim për papranueshmëri i 24 gushtit 2015, publikuar më 17 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, pensionim i parakohshëm*

Gjykata Supreme kishte miratuar kërkesën për revizion të Korporatës Energjetike të Kosovës përkitazi me ligjshmërinë e pensionimit të parakohshëmtë parashtruesit. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar në shkelje të të drejtës në gjykim të drejtë dhe mbrojtjes gjyqësore të të drejtave.

Gjykata Kushtetuese konsideroi, se Gjykata Supreme i ka arsyetuar vendimet e veta dhe ka argumentuar çdopretendim të parashtruesit të kërkesës, në lidhje me refuzimin e propozimit të tij dhe se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese,si dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se si dhe pse të drejtat dhe liritë e tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur me vendimin e kontestuar. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI98/14
Parashtrues
Rasim Rashica
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
PPC. nr. 39/2011, të 5 gushtit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Rasim Rashica nga fshati Bresje, komuna e Fushë-Kosovës, i përfaqësuar nga avokatja znj. Vahide Braha nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi [PPC. nr. 39/2011] i Gjykatës Supreme, i 5 gushtit 2011, me të cilin Gjykata Supreme refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës si të pabazuar dhe vërtetoi revizionin e Gjykatës Supreme të Kosovës.

3. Ky Aktvendim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 13 mars 2014.

Objekt i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar me të cilin, siç pretendohet, është shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së

Kosovës dhe janë bërë shkelje thelbësore të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës.

Baza juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 12 qershor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 4 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR. KI98/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KI98/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.

8. Më 23 janar 2015, Gjykata Kushtetuese e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës se ka filluar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Me këtë njoftim, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesi i kërkesës dhe Gjykata Komunale në Prishtinë që të dorëzojnë kopjen e fletëkthesës me datën e pranimit të Aktvendimit PPC. nr. 39/2011 të Gjykatës Supreme, të 5 gushtit 2011. Gjykata, gjithashtu, i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 2 mars 2015, Gjykata Komunale dorëzoi informatat e kërkuara dhe në përgjigjen e Gjykatës Komunale qëndron se parashtruesi i kërkesës e pranoi Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme të Kosovës më 13 mars 2014.

10. Më 3 korrik2015, pas shqyrtimit të raportittëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues, irekomandoiGjykatësnë përbërjen e plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 23 tetor 2003, Fondi Pensional i Korporatës Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK) mori vendimin në lidhje me kërkesën për pensionimin e parakohshëm të parashtruesit të kërkesës.

Në bazë të këtij vendimi, parashtruesit të kërkesës i aprovohet kërkesa për pension të parakohshëm të Fondit Pensional të KEK-ut.

12. I pakënaqur me vendimin e lartpërmendur, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Komitetinpër Shqyrtimin e Mospajtimeve të Fondit Pensional të KEK-ut. Ky Komitet e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi vendimin e Fondit Pensional të KEK-ut.

13. Më 8 janar 2004, i pakënaqur me vendimin e Komitetit për Shqyrtimin e Mospajtimeve të FonditPensional të KEK-ut, parashtruesi ka paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

14. Më 8 qershor 2005, Gjykata Komunale në Prishtinë [Aktvendimi C1. nr. 4/2004] refuzoi ankesën e parashtruesit si të paafatshme.

15. Më 28 shkurt 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë [Aktvendimi Ac. nr. 38/2006] aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe prishi Aktvendimin e Gjykatës Komunale, dhe të njëjtin e ktheu në Gjykatën Komunale në rigjykim.

16. Më 23 nëntor 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë pas procedurës së përsëritur [Aktgjykimi C1 nr. 102/2007] miratoi padinë e parashtruesit të kërkesës, duke e anuluar si joligjor vendimin e Fondit Pensional të KEK-ut, me të cilin parashtruesit të kërkesës i është aprovuar kërkesa për pension të parakohshëm dhe detyroi KEK-un që paditësin ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës.

17. Kundër këtij Aktgjykimi, KEK-u paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

18. Më 14 tetor 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë [Aktgjykimi Ac. nr. 392/2008] refuzoi si të pabazuar ankesën e KEK-ut dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale.

19. Kundër këtij Aktgjykimi, KEK-u parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme. Më 3 mars 2010, Gjykata Supreme e Kosovës [Aktgjykimi Rev. I. nr. 40/2009] aprovoi revizionin e KEK-ut, duke ndryshuar Aktgjykimin [C1 nr. 102/2007] të Gjykatës Komunale dhe Aktgjykimin [Ac. nr. 392/2008] të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, ashtu që kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës refuzohet si e pabazuar.

20. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, parashtruesi paraqiti kërkesë për përsëritjen e procedurës. Më 5 gusht 2011, Gjykata Supreme [Aktvendimi PPC. nr. 39/2011] refuzoi si të pabazuar propozimin e parashtruesit për përsëritjen e procedurës.

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit],nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe janë bërë shkelje thelbësore të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës.

22. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

> *"Kësaj gjykate i kërkojmë që të shpallë të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 40/2009, të 03.03.2010 dhe rivendos të drejtën e humbur sipas objektit të kërkesëpadisë* ***(për të drejtën në kompensimin e pagave)****".*

Dispozitat relevante ligjore

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27
Për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë

Neni 11

Shkëputja e kontratës së punës

Neni 11.1 Kontrata e punës shkëputet:

[...]

(b) Me marrëveshje me shkrim ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit;

[...].

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

24. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

25. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

26. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(e) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

(f) aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

(g) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

(h) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

27. Gjykata vëren se në këtë rast parashtruesi i kërkesës ankohet për faktin se Gjykata Supreme, duke vendosur sipas revizionit, ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë dhe e refuzoi kërkesën e tij si të pabazuar. Këtë vendim Gjykata Supreme e vërtetoi duke refuzuar propozimin për përsëritjen e procedurës.

28. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në vendimet e veta ka ofruar arsye të shumta për gjetjet e veta. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme i ka arsyetuar vendimet e veta dhe ka argumentuar çdo pretendim të parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin e propozimit të tij.

29. Në bazë të kësaj, Gjykata konsideron se shpjegimi i dhënë në Aktvendimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe ligjërisht i argumentuar, dhe se procedurat nuk ishin të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis,Shub kundër Lituanisë,* nr. 17064/06, vendimi i GJEDNJ-së të 30 qershorit 2009).

30. Gjykata Kushtetuese më tej thekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu Rastin: KI10/12, parashtruesi i kërkesës *Rasim Kozmaqi*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 nëntorit 2013).

31. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentuar për shkeljen e dispozitave të Kushtetutës (Shih Rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

32. Prandaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova, që tregojnë se si dhe pse të drejtat dhe liritë e tij, të mbrojtura me Kushtetutë, janë shkelur me vendimin e kontestuar.

33. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, nëpajtim me nenin48 të Ligjitdhe me rregullat36(1) (d) dhe36(2) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 24 gusht2015,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI17/15, Parashtrues Ibrahim Bajrami - Vlerësim i kushtetutshmërisë së kërkesës për përfshirje në procedurën e privatizimit

KI17/15, Vendim për heqje të kërkesës nga lista i 31 gushtit 2015, publikuar më 17 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e papranueshme, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, procesi i privatizimit*

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës u ankua në Gjykatën Kushtetuese përkitazi me të drejtën e tij për të përfituar nga një pjesë e privatizimit të ndërmarrjes shoqërore Ramiz Sadiku në Prishtinë. Parashtruesi, po ashtu, u ankua për shkelje të së drejtës në punë dhe ushtrim të profesionit.

Gjykata Kushtetuese konsideroi se kërkesa është e paplotë dhe e paqartë, prandaj nuk mund të merret për bazë pretendimi i parashtruesit të kërkesëspa dokumente mbështetëse dhe pa prova materiale. Kërkesa u refuzua në procedurë të shkurtër dhe u hoq nga lista në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 29 (2) (h) dhe 35 (2) të Rregullores së punës.

VENDIM
PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA
në
Rastin nr. KI17/15
Parashtrues
Ibrahim Bajrami
Vlerësim i kushtetutshmërisë së kërkesës për përfshirje në procedurën e privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Ibrahim Bajrami nga Gërdovci, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston asnjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik. Ai vetëm kërkon përfshirjen e tij në listën e punëtorëve që përfitojnë 20%-in nga të ardhurat e privatizimit të KNI "Ramiz Sadiku" Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: KNI "Ramiz Sadiku").

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes ka të bëjë me *"mospërfshirjen e parashtruesit në listën e punëtorëve që përfituan 20% nga të ardhurat e privatizimit të KNI Ramiz Sadiku",* që pretendohet se i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht me nenin 49[E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet nënenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 shkurt 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 mars 2015, Kryetari i Gjykatës, caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 15 prill 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin e përfaqësuesit, vendimin e fundit të cilin e konteston dhe dokumentet e tjera relevante për rastin e tij.

8. Gjykata nuk ka pranuar asnjë vendim që ndërlidhet me kërkesën e parashtruesit, apo ndonjë vendim tjetër, që mund të jetë i lidhur me rastin e parashtruesit në përgjithësi.

9. Më 1 korrik2015,Kryetarja, me Vendimin KSH. KI17/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, mandati i të cilitsigjyqtariGjykatësKushtetueseka përfunduarmë 26 qershor2015.

10. Më 8 korrik2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

11. Faktet e përshkruara si në vijim janë bazuar në deklaratat e parashtruesit të kërkesës.

12. Parashtruesi i kërkesës "*ka qenë në marrëdhënie të përhershme të punës tek KNI 'Ramiz Sadiku', i sistemuar në vendin e punës 'Gjellëbërës'*".

13. Më 31 korrik 2007, ai ka parashtruar padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, e regjistruar me numër SCC-

07/0314, ku ka kërkuar që të përfshihet në listën e punëtorëve që përfituan 20% nga të ardhurat e privatizimit të KNI "Ramiz Sadiku".

14. Parashtruesi i kërkesës "*tek gjykata e përmendur ka shkuar disa herë, por më në fund kanë thënë se 'padia është e parakohshme'*".

15. Më në fund, parashtruesi i kërkesës thekson se ai "*i drejtohet Agjensionit Kosovar të privatizimit dhe Shefi i Shërbimit Juridik thotë: Nuk ka prova se paditësi ka qenë i punësuar tek KNI 'Ramiz Sadiku'*".

16. Ndërkohë, *"Gjykata, nuk ka vendosur, siç u cek asnjëherë në mënyrë meritore, për padinë e paditësit-paditësi nuk është në listën e pagave"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"është shkelur dispozita e nenit 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës - e Drejta e Punës e garantuar. Në të njëjtën mënyrë e drejta e punës është rregulluar me Deklaratën Universale"*.

18. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata: *"Dëshiroj të mbetem në listë, për pagesën e 20 %, me që KNI Ramiz Sadiku nga Prishtina është Privatizuar"*.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje me Ligj dhe me Rregullore të punës.

20. Kësisoj, Gjykata i referohetdispozitave vijuese të Ligjit:

Neni 22.4 [Procedimi i kërkesave]

"4. Nëse kërkesa [...] nuk është e [...] kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të plotësuar kërkesën [...]".

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se [...] cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

21. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili përcakton se:

Rregulli 29 (2)

"Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

[...]".

Rregulli 32 (5)

"Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtë në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkese të mëparshme të vendosur nga Gjykata ose në qoftë se kërkesa është joserioze".

22. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi ankohet, në mënyrë të përgjithshme, për faktin se ai nuk është përfshirë në listën e punëtorëve që kanë përfituar 20% me rastin e privatizimit të KNI "Ramiz Sadiku". Ai pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 49 të Kushtetutës.

23. Gjykata, në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit, kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë vendimin e kontestuar dhe vendimet e tjera të gjykatave të rregullta si dhe, në përgjithësi, ta sqarojë dhe ta plotësojë kërkesën.

24. Megjithatë, brenda afatit të përcaktuar, Gjykata nuk ka pranuar nga parashtruesi i kërkesës asnjë vendim apo sqarim të gjykatave të rregullta që ndërlidhen me rastin e tij.

25. Gjykata konsideron se kërkesa është e paplotë dhe e paqartë dhe prandaj Gjykata nuk mund ta marrë për bazë pretendimin e parashtruesit të kërkesës pa dokumente mbështetëse dhe pa prova materiale.

26. Përveç kësaj, Gjykatathekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e kërkesës.

27. Në të vërtetë, Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar rast *prima facie*, në mënyrë që Gjykata të vlerësojë me procedurë të shkurtër përmbushjen e të gjitha kritereve procedurale të pranueshmërisë, siç kërkohet me nenin 22.4 të Ligjit dhe me rregullat 29 (2) (h) dhe 32 (5) të Rregullores së punës.

28. Prandaj, Gjykata gjen se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër dhe, si e tillë, duhet të hiqet nga lista.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 29 (2) (h), 32 (5) (c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 31 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA HEQË kërkesën nga lista;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI24/15, Parashtrues Enver Basholli - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, GSP-KPA-A-158/13, të 19 marsit 2014

KI24/15, Aktvendim për papranueshmëri i 31 gushtit 2015, publikuar më 17 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, res judicata*

Kolegji i Apelit të Gjykatës Supreme kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të pabazuar dhe kishte vërtetuar vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës përkitazi me titullin pronësor të një banese të kontestuar. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar në shkelje të të drejtës në gjykim të drejtë dhe të së drejtës në pronë.

Gjykata Kushtetuese konsideroi se procedurat nëKomisionin për Kërkesa Pronësore KKPK, si dhe në Kolegjin e Apelit të Gjykatës Supreme ishin të drejta dhe se vendimet ishin tërësisht të justifikuara dhe të arsyetuara plotësisht dhe se parashtruesit në përgjithësi i është dhënë gjykim i drejtë. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI24/15
Parashtrues
Enver Basholli
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
GSP-KPA-A-158/13, të 19 marsit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Enver Basholli nga Samadrexha, komuna e Vushtrrisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin (GSP-KPA-A-158/13, të 19 marsit 2014) e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), i cili i është dorëzuar atij më 3 nëntor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet t'i jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë:

KEDNJ), me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 mars 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 21 prill 2015, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 12 maj 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe ua dërgoi nga një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit dhe Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejmë: AKP).

8. Më 1 korrik2015,Kryetarja caktoi vetenanëtare të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, mandati i të cilit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka përfunduar më 26 qershor 2015.

9. Më 8 korrik2015,Kolegji shqyrtues e aprovoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Banesa në Prishtinë, në pronësitë NSH „Elektrokosova“, është uzurpuar që nga viti 1986 nga punëtorja (në tekstin e mëtejmë: punëtorja e parë) e NSH “Elektrokosova”.

11. Më 23 nëntor 1990, punëtores së parë i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës me NSH “Elektrokosova” dhe, rrjedhimisht, banesa ishte liruar.

12. Më 28 nëntor 1993, NSH "Elektrokosova" ia ndau banesën për shfrytëzim një punëtori tjetër (në tekstin e mëtejmë: punëtori i dytë).

13. Më 18 mars 1994, punëtori i dytë u bë pronar i banesës në bazë të kontratës së shitblerjes, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

14. Në një datë të pacaktuar, punëtorja e parë paraqiti kërkesë në Komisionin për Kërkesa Pronësore Banesore (në tekstin mëtejmë: KKPB) për vërtetimin e të drejtave të pronësisë së banesës.

15. Më 13 maj 2004, parashtruesi i kërkesës përfundimisht bleu banesën nga punëtori i dytë, me kontratën e shitblerjes OV. nr. 2616/2004, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

16. Më 22 tetor 2005, KKPB-ja (Vendimi HPCC/D/226/2005/A&C), aprovoi kërkesën e punëtores së parë, duke ia njohur të drejtën e banimit që e kishte humbur *"si pasojë e diskriminimit gjatë periudhës prej 23 marsit 1989 deri më 24 mars 1999"*.

17. VendimiiKKPB-sëishtenxjerrësinjë vendimgrupor lidhur me disakërkesa, ku, inter alia, kërkesa epunëtoressë parëishte kontestuarngapunëtori i dytë, ndërsakërkesaepunëtorit të dytëishte kontestuar ngapunëtorjae parë. Të dyjakërkesat kishin të bënin mebanesënnë fjalë. Kërkesaepunëtores së parë ishte pranuar si e bazuar, ndërsakërkesaepunëtorit të dytëishte refuzuar.

18. Për më tepër, KKPB-ja vendosi që kontrata e shitblerjes Ov. nr. 2616/2004, e 13 majit 2004, e lidhur ndërmjet punëtorit të dytë dhe parashtruesit të kërkesës *"ishte në kundërshtim me nenet 5.1 dhe 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, prandaj edhe ajo edhe ishte e pavlefshme"*.

19. Më 19 dhjetor 2005, punëtori i dytë dhe parashtruesi i kërkesës parashtruan kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit HPCC/D/226/2005/A&C. Punëtorja e parë ishte palë e kundërshtuar në këtë procedurë.

20. Më 31 mars 2006, kërkesa për rishqyrtim u hodh poshtë si e pabazuar, sepse "*Palët kërkuese nuk kanë paraqitur ndonjë dëshmi të re relevante ligjore e cila nuk është shqyrtuar nga Komisioni gjate vendosjes së kërkesave. Gjithashtu Komisioni nuk ka gjetur ndonjë gabim material ne aplikimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/60"*.

21. Më 29 gusht 2007, parashtruesikërkoi nga AKP-ja konfirmimin e të drejtës së tij pronësore mbi të njëjtën banesë, duke theksuar prapë punëtoren e parë si palë të kundërt. Punëtorja e parë parashtroi ankesë në Komisionin për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KKPK).

22. Më 22 tetor 2012, KKPK (Vendimi KPCC/D/R/175/2012) hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit me arsyetimin se kjo çështje ligjore është *res judicata,* siç ishte vendosur përfundimisht me Vendimin e KKPB-së (HPCC/REC/61/2006), të 31 marsit 2006.

23. Më 27 maj 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit kundër atij vendimi të KKPK-së.

24. Më 19 mars 2014, Kolegji i Apelit (Aktgjykimi GSP-KPA-A-158/13) hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Vendimin e KKPK (Vendimi KPCC/D/R/175/2012), të 22 tetorit 2012.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pohon se procedurat në KKPB dhe në KKPK kanë shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykimtë Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

26. Parashtruesi pretendon se "*gjykata në rrugë gjyqësore ka miratuar procesin administrativ me të cilën ankuesit i është mohuar e drejta e pronësisë të pronës, neni 46 i Kushtetutës. Kjo sepse Gjykata ka pranuar vlerësimet e organit administrativ për gjetjen se puna juridike e konstituimit të së drejtës së pronësisë ishte marr në kundërshtim me rregullat e organit administrativ".*

27. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pohon se *"mohimi i të drejtës për të marrë nga gjykata një përgjigje ligjore përfundimtare, përmban cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor të parashikuar me nenin 31 "...* dhe cenon të drejtën e tij për mbrojtje gjyqësore, të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 të Rregullores së punës.

30. Neni 48 i Ligjitparasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë*

cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

31. Përveç kësaj, rregulli 36 i Rregullores së punës parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse [...] (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e tij për barazi para ligjit, për mbrojtje të pronës dhe për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, të garantuara me Kushtetutë.

33. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës pretendon se KKPB-ja dhe KKPK-ja, si organe administrative, kanë vendosur në mënyrë arbitrare për të drejtën e tij pronësore dhe se "*gjykataka pranuar vlerësimet e organit administrativ".*

34. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë arsyetim procedural ose material në kërkesën e tij, se ai vetëm thekson pretendimet e lartpërmendura, pa shpjegime të mëtejshme rreth asaj se si dhe pse ndodhën shkeljet e pretenduara.

35. Përkitazi me këtë, Gjykata vëren se Vendimi HPCC/D/226/2005/A&C është i arsyetuar si në aspektin e njohjes së të drejtave të punëtores së parë, po ashtu edhe sa i përket kontratës së shitblerjes ndërmjet punëtorit të dytë dhe parashtruesit të kërkesës "*e cilaishte në kundërshtim me nenet 5.1 dhe 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, prandaj edhe ajo ishte e pavlefshme".*

36. Përveç kësaj, Gjykatavëren se Kolegji i Apelit e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit si të pabazuar dhe arsyetoi se:

"*Pasi qe vendimi i DÇPB-se i datës 22 tetor 2005, ishte konfirmuar me vendimin HPCC/ REC/61/2006 të datës 31 mars 2006, vendimi i DÇPB-së është bërë i plotfuqishëm (...), dhe, rrjedhimisht "nuklejohet gjykim i ri ndërmjet palëve të njëjta për një çështje ligjore për të cilën ekziston vendimi i plotfuqishëm". (...) "Pasi që lënda para DÇPB-së kishte të bënte me të njëjtën çështje -banesën, dhe pasi që ajo ishte ndërmjet palëve të njëjta, çështja është res judicata".*

37. Kolegji i Ankesave më tej arsyetoi se *"në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike".*

38. Gjykata konsideron se procedurat në KKPB dhe KKPK, si dhe në Kolegjin e Apelit ishin të drejta dhe se vendimet ishin tërësisht të justifikuara dhe të arsyetuara plotësisht, përkatësisht shpjegojnë pse "*nuklejohet gjykim i ri ndërmjet palëve të njëjta për një çështje ligjore për të cilën ekziston vendimi i plotfuqishëm".*

39. Prandaj, GjykataKushtetuese konstaton se procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesit i është ofruar gjykim i drejtë. (Shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut i 10 korrikut 1991; dhe, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Vendim i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).

40. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar si dhe pse vendimi me të cilin është hedhur poshtë kërkesa e tij për përsëritje të procedurës, në bazë të ekzistencës së *res judicata,* përbën shkelje të të drejtave dhe lirive të tij individuale.

41. Në të vërtetë, Gjykatakonsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie*, e cila do të theksonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë (Shih *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, Nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005) dhe nuk ka saktësuar se si nenet e Kushtetutës, të cilëve u referohet, mbështesin pretendimin e tij, ashtu siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 48 të Ligjit.

42. Për më tepër, GjykataKushtetuese përsërit se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt për sa i përket vendimeve të gjykatave të rregullta, apo autoriteteve të tjera publike. Është detyrë e gjykatave të rregullta ose e autoriteteve të tjera publike t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktvendim i 21 janarit 1999 para. 28;shih, gjithashtu, Rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI70/11, *ParashtruesFaik Hima, Magbule Hima, dhe Bestar Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

43. Prandaj, Gjykatakonsideron separashtruesi nukkadëshmuardhe nuk ka vërtetuarpretendiminpërshkelje tëtë drejtës së tijpërbarazi para ligjit, të së drejtës përgjykim të drejtëdhe për mbrojtjen e pronës.

44. Si përmbledhje, Gjykata gjen se, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara dhe prandaj kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, më 31 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI36/15, Parashtrues Sahit Ninaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 378/2014, i 29 dhjetorit 2014

KI36/15, Aktvendim për papranueshmëri i 4 shtatorit 2015, publikuar më 21 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kompensim, mbrojtja e pronës, mbrojtja gjyqësore e të drejtave*

Gjykata Supreme kishte refuzuar,si të pabazuar, kërkesën për revizion të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, përkitazi me të drejtën e tij për kompensim të shtëpisë së djegur gjatë luftës. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar në shkelje të të drejtës në gjykim të drejtë, mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe mbrojtje të pronës.

Gjykata Kushtetuese konsideroi se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me kualifikimin ligjor të fakteve dhe me zbatimin e dispozitave procedurale nga gjykatat e rregullta, dhe shtoi se kualifikimi ligjor i fakteve dhe ligji i aplikueshëm janë çështjetë cilat bien në sferën e ligjshmërisë. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMERI
në
Rastin nr. KI36/15
Parashtrues
Sahit Ninaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 378/2014, të 29 dhjetorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Sahit Ninaj, me vendbanim në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 378/2014, i 29 dhjetorit 2014, me të cilin kërkesa e parashtruesit për revizion kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, CA. nr. 611/2014 të 25 gushtit 2014, ishte hedhur poshtë si i palejuar. Parashtruesi pohon të ketë pranuar aktvendimin e kontestuar më 30 janar 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 378/2014, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon që i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të

Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 mars 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI36/15, caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI36/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

7. Më 28 prill 2015, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, si dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 7 korrik 2015, Kolegjishqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Mbështetur në faktet e përshkruara nga parashtruesi në kërkesën drejtuar Gjykatës, parashtruesi, në një datë të pasaktësuar, i ishte drejtuar Komunës së Prizrenit me kërkesën që kjo e fundit t'ia sigurojë dhe t'ia dorëzojë atij një truall nga fondi i paluajtshmërive të Komunës, si kompensim për shtëpinë e tij të djegur gjatë luftës. Parashtruesi më tej pohon se lokacioni ku ndodhej shtëpia e tij ishte i minuar. Sipas parashtruesit, Komuna e Prizrenit nuk i është përgjigjur asnjëherë kërkesës së tij.

10. Në vijim të kërkesës së pohuar në paragrafin paraprak, më 22 prill 2009, parashtruesi kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Prizren, nëpërmjet të cilës kishte kërkuar që Komuna e Prizrenit t'i kompensojë një paluajtshmëri në sipërfaqe prej 2 ari për ndërtimin e shtëpisë.

11. Më 18 nëntor 2010, Gjykata Komunale në Prizren (Aktvendimi C. nr. 280/09) kishte vendosur të pezullonte procedurën me arsyetimin se palë ndërgjyqëse në cilësinë e të padituës ishte Komuna e Prizrenit dhe, si rrjedhojë, për kërkesat kundër autoritetit publik me anë të së cilës kërkohet kompensimi monetar ose kompensim tjetër, parashtruesi duhej të siguronte një kopje të shkresave për Ministrinë e Drejtësisë.

12. Si rezultat i aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Komunale në Prizren, parashtruesi kishte njoftuar Ministrinë e Drejtësisë lidhur me padinë e tij.

13. Më 10 maj 2011, parashtruesi i kërkesës, në urgjencën e tij drejtuar Gjykatës Komunale në Prizren, i kishte kërkuar Gjykatës Komunale të caktojë seancë për shqyrtimin kryesor dhe njëkohësisht kishte deklaruar që vlera e kontestit është 3.100 euro, dhe jo 50 euro, siç e kishte cekur ai në padinë e tij të parashtruar më 22 prill 2009.

14. Më 12 dhjetor 2013, Gjykata Themelore në Prizren (Aktvendimi C. nr. 280/09) kishte konstatuar që padia e parashtruar ishte e mangët, sepse nuk i përmbante elementet e domosdoshme të padisë, ashtu siç kërkohet me dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK). Si rrjedhojë, Gjykata Themelore kishte kthyer padinë e parashtruesit për plotësim dhe për përmirësim, duke kërkuar nga parashtruesi që në afat prej 3 (tri) ditësh të saktësojë mënyrën e kompensimit për paluajtshmërinë për të cilën kërkohet kompensimi dhe të identifikojë paluajtshmërinë ku kishte qenë shtëpia e parashtruesit.

15. Gjykata Themelore, ndër të tjera, kishte thënë që nëse padia nuk plotësohet dhe nëse nuk korrigjohet ashtu siç është kërkuar me aktvendimin e saj, atëherë padia do të hidhet poshtë.

16. Si rezultat i aktvendimit të lartpërmendur, më 23 dhjetor 2013, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur në Gjykatën Themelore parashtresën me plotësimin e padisë. Lidhur me mënyrën e kompensimit të paluajtshmërisë, parashtruesi kishte kërkuar që si kompensim për shtëpinë e djegur të tij, Komuna e Prizrenit t'ia sigurojë atij një truall nga fondi i paluajtshmërive të Komunës, duke mos identifikuar paluajtshmërinë, të cilën e kërkonte si kompensim. Ndërsa lidhur me identifikimin e paluajtshmërisë, ku kishte qenë shtëpia e tij e djegur, parashtruesi kishte deklaruar që kjo paluajtshmëri mund të identifikohet në bazë të ekspertizës.

17. Më 26 dhjetor 2013, Gjykata Themelore në Prizren (Aktvendimi C. nr. 280/2009) hodhi poshtë kërkesëpadinë e parashtruesit.

18. Në aktvendimin e saj, Gjykata Themelore në Prizren vlerësoi se, përkundër parashtresës së paraqitur nga parashtruesi më 23 dhjetor 2013, parashtruesi nuk e kishte përmirësuar dhe nuk e kishte plotësuar padinë ashtu siç ishte kërkuar me aktvendimin e 12 dhjetorit 2013. Sa i përket mënyrës së kompensimit të paluajtshmërisë, Gjykata Themelore konstatoi se parashtruesi nuk kishte saktësuar mënyrën e kompensimit të paluajtshmërisë dhe nuk kishte identifikuar paluajtshmërinë, apo ngastrën për të cilën kërkonte kompensim.

19. Më 22 janar 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të procedurës kontestimore, vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

20. Më 25 gusht 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi Ca. nr. 611/2014) refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C. nr. 280/09, të 26 dhjetorit 2013.

21. Në aktvendimin e saj, Gjykata e Apelit vlerësoi se parashtruesi nuk e ka saktësuar padinë e tij ashtu siç ishte kërkuar nga Gjykata Themelore në Prizren. Prandaj, sipas Gjykatës së Apelit, pretendimet e parashtruesit për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për zbatim të gabuar të drejtës materiale ishin të pabazuara për arsye se Gjykata Themelore në Prizren nuk ishte lëshuar në vërtetimin e gjendjes faktike dhe nuk ka pasur mundësi të zbatojë të drejtën materiale, për arsye se Gjykata Themelore aktvendimin e saj e kishte nxjerrë në zbatim të dispozitave procedurale.

22. Më 9 tetor 2014, parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit.

23. Më 29 dhjetor 2014, Gjykata Supreme (Aktvendimi Rev. Nr. 378/2014) e hodhi poshtë kërkesën për revizion si të palejuar.

24. Gjykata Supreme, duke iu referuar dispozitave të LPK-së, konstatoi se revizioni në këtë çështje juridike nuk është i lejuar, për arsye se vlera e objektit të kontestit, të cilin parashtruesi e kishte cekur në kërkesëpadinë e tij, e cila vlerë nuk ishte ndryshuar as me parashtresën për plotësimin e padisë së tij, është më e vogël se vlera e objektit të kontestit e përcaktuar në dispozitat e ligjit të lartpërmendur.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Ashtu siç është thënë më lart, parashtruesi pretendon se aktvendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

26. Parashtruesi më tej pretendon që gjykatat e rregullta, me aktvendimet e tyre, kanë shkelur po ashtu të drejtën e tij të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së, për arsye se padia e tij nuk ishte shqyrtuar fare.

27. Parashtruesi përfundon duke kërkuar nga Gjykata që *"të kthejë gjendjen e mëparshme para aktvendimeve, Rev. Nr. 378/2014 dt. 29. 12 2014, Ac. nr. 611/2014, dt. 25.08. 2014 dhe C. Nr, 280/2009 dt. 26.12.2013, sepse në një gjendje të tillë mund të shqyrtohet kërkesëpadia ime dhe të merret vendim meritor gjyqësor në Gjykatën Themelore në Prizren"*.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

29. Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj"*.

30. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...]

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

31. Në kërkesën e tij, parashtruesi ndër të tjera pretendon se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm për arsye se gjykatat e rregullta, duke hedhur poshtë padinë e tij si jo të plotë, si dhe duke hedhur poshtë kërkesën e tij për revizion si të palejuar, nuk e kanë shqyrtuar fare padinë e tij.

32. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Prizren, pas kërkesës së saj për plotësimin dhe për saktësimin e padisë së parashtruar nga parashtruesi, kishte vendosur që padinë ta hedhë poshtë për arsye se padia nuk i përmbante elementet e domosdoshme të padisë ashtu siç kërkohet me dispozitat e LPK-së. Si rezultat i ankesës së parashtruesit kundër aktvendimit të lartpërmendur, Gjykata e Apelit kishte vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore, duke konstatuar se Gjykata Themelore në Prizren e kishte nxjerrë aktvendimin e saj duke zbatuar dispozitat përkatëse të së drejtës procedurale.

33. Në vijim, Gjykata po ashtu vëren se Gjykata Supreme, duke iu referuar dispozitave përkatëse të së drejtës procedurale, kërkesën për revizion të parashtruesit e kishte hedhur poshtë si të palejuar për arsye se vlera e objektit të kontestit, të cilin parashtruesi e kishte cekur në padinë e tij dhe e cila vlerë sipas Gjykatës Supreme nuk ishte ndryshuar as me parashtresën për plotësimin e padisë së tij, është më e vogël se vlera e objektit të kontestit e përcaktuar në dispozitat e LPK-së.

34. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk shpjegon dhe nuk dëshmon se si ishin shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, në veçanti e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

35. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me kualifikimin ligjor të fakteve dhe me zbatimin e dispozitave procedurale nga gjykatat e rregullta. Kualifikimi ligjor i fakteve dhe ligji i aplikueshëm janë çështje të cilat bien në sferën e ligjshmërisë.

36. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit osetë ligjit (ligjshmëria), që

pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

37. Gjykata më tej konsideron se fakti i thjeshtë që parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurave tëpërfunduara në gjykatat e rregullta, në veçanti në Gjykatën Supreme, nuk është i mjaftueshëm që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese (Shih, *mutatis mutandis,* rastin *Mezőtúr-Tiszazugi Vízgazdálkodási Társulat kundër Hungarisë,* Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21). Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës (Shih rastin KI198/13,parashtrues i kërkesës*Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014).

38. Prandaj, Gjykata nuk vepron si gjykatëe shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima,* Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

39. Në fund, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë argument bindës që do të vërtetonte se shkeljet e pretenduara, të përmendura në kërkesë, përbëjnë shkelje të të drejtave kushtetuese (Shih rastin *Vanek kundër Republikës Sllovake*, Nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005).

40. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata përfundon se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka dështuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

41. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1), d) dhe (2), b) dhe d) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KO107/15, Parashtrues Albulena Haxhiu dhe 23 deputetë të tjerë - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 05-V-139 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Amendamentit XXIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, miratuar me 3 gusht 2015

Ko107/15, Aktvendim për papranueshmëri i 8 shtatorit 2015, publikuar më 21 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë institucionale, kërkesë qartazi e pabazuar, kontroll abstrakt, amendament kushtetues, juridiksioni ratione materiae, të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitujt II dhe III të Kushtetutës*

Në këtë rast parashtruesit e kërkesës kontestojnë Vendimin nr. 05-V-139 e Kuvendit për miratimin e Amendamentit XXIV të Kushtetutës së Republikës se Kosovës, miratuar më 3 gusht 2015.Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se vendimi i kontestuar miraton Amendamentin XXIV të Kushtetutës, që është në kundërshtim me dispozitat kushtetuese për barazinë para ligjit, marrëveshjet ndërkombëtare, të drejtat zgjedhore, sistemin e gjyqësor dhe avokatin e popullit.

Gjykata Kushtetuese e vlerësoi kërkesën e parashtruesve nga aspekti procedural dhe përmbajtjesor. Gjykata vërejti se kërkesa e parashtruesve ishte identike me rastin KO26/15, ku ishin trajtuar të njëjtat çështje kushtetuese përkitazi me pakësimin e të drejtave dhe lirive të garantuara me kapitujt II dhe III të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se nuk ka juridiksion që të vlerësoi amendamentet kushtetuese që paraprakisht janë miratuar në Kuvend në pajtim me nenin 144.4 të Kushtetutës dhe konkludoi se nuk ka pasur nevojë që amendamenti i propozuar të referohet për herë të dytë.

Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në aspektin procedural në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, kurse në aspektin përmbajtjesor kërkesa u shpall e papranueshme, për shkak se nuk është *ratione materiae* në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, nenin 42 të Ligjit dhe me rregullat 36 (3) (a) dhe 36 (3) (e) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KO107/15
Parashtrues
Albulena Haxhiu dhe 23 deputetë të tjerë
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 05-V-139 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Amendamentit XXIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, miratuar më 3 gusht 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Albulena Haxhiu, Glauk Konjufca, Puhie Demaku, Albin Kurti, Salih Salihu, Besa Baftiu, Besnik Bislimi, Faton Topalli, Shqipe Pantina, Ismajl Kurteshi, Fisnik Ismaili, Donika Kadaj-Bujupi, Time Kadrijaj, Teuta Haxhiu, Rrustem Berisha, Lahi Ibrahimaj, Daut Haradinaj, Pal Lekaj, Ramush Haradinaj, Valdete Bajrami, Shukrije Bytyqi, Haxhi Shala, Enver Hoti dhe Zafir Berisha (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), deputetë të zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi). Parashtruesit e kërkesës kanë autorizuar znj. Albulena Haxhiu për t'i përfaqësuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Vendimin nr. 05-V-139 e Kuvendit për miratimin e Amendamentit XXIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, miratuar më 3 gusht 2015.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar si në baza përmbajtjesore, ashtu edhe në baza procedurale.

4. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se vendimi i kontestuar miraton Amendamentin XXIV të Kushtetutës, që është në kundërshtim me dispozitat kushtetuese: me nenin 1, paragrafët (1) dhe (2) [Përkufizimi i Shtetit]; me nenin 3 [Barazia para Ligjit]; me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] lidhur me nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; me nenin 24 [Barazia para Ligjit]; me nenin 35 [Liria e Lëvizjes]; me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]; me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]; me nenin 103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave]; me nenin 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve]; me nenin 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] dhe me nenet 132, 134 dhe 135 [përkitazi me Avokatin e Popullit].

5. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se procedura e ndjekur, që çoi deri te votimi dhe deri te miratimi i vendimit të kontestuar, nuk ishte në pajtueshmëri me nenin 113.9 dhe me nenin 144.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta].

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.5 të Kushtetutës dhe në nenet 42 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatë

7. Më 11 gusht 2015, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.

8. Më 12 gusht 2015, znj. Albulena Haxhiu dorëzoi kopjet e letërnjoftimeve të të gjithë parashtruesve të kërkesës.

9. Më 12 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KO107/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Në të njëjtën datë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KO107/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Bekim Sejdiu.

10. Më 13 gusht 2015, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga përfaqësuesja e parashtruesve që të dorëzonin në Gjykatë një kopje të vendimit të kontestuar, duke përfshirë shtojcat e tij, me qëllim të kompletimit të kërkesës.

11. Më 14 gusht 2015, përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës i dorëzoi Gjykatës dokumentet e kërkuara, që përmbanin Vendimin nr. 05-V-139 për miratimin e Amendamentit XXIV dhe tekstin e Amendamentit të miratuar XXIV.

12. Më 14 gusht 2015, Gjykata e njoftoi Qeverinë e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Qeveria) dhe Kryetarin e Kuvendit për parashtrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ta që të dorëzonin komentet e tyre lidhur me kërkesën. Gjykata, po ashtu, kërkoi nga Qeveria dhe nga Kryetari i Kuvendit që t'i siguronin Gjykatës dosjen e plotë lidhur me projektamendamentin si dhe çdo dokument mbështetës që i ishte dërguar Kuvendit, respektivisht deputetëve të Kuvendit.

13. Të njëjtën ditë u informua Presidentja e Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejmë: Presidentja e Republikës] për kërkesën e dorëzuar në Gjykatë nga parashtruesit.

14. Më 17 gusht 2015, Kryetari i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dosjet e kërkuara që përmbanin dokumentet e mëposhtme:

    a. dosjen që i ishte dorëzuar deputetëve të Kuvendit më 31 korrik 2015 për përgatitjen e seancës plenare të 3 gushtit 2015, që përfshinte Vendimin 01/41 e Qeverisë për riprocedimin e Amendamentit XXIV në Kuvend, tekstin e Amendamentit të propozuar XXIV dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese AGJ788/15, të 14 prillit 2015, në Rastin KO26/15;

    b. transkriptin e seancës plenare të Kuvendit të 3 gushtit 2015;

    c. procesverbalin e seancës së Kuvendit të 3 gushtit 2015;

    ç. Vendimin nr. 05-V-139 për miratimin e Amendamentit XXIV;

    d. tekstin e Amendamentit të miratuar XXIV; dhe

    dh. evidencën e votimit elektronik të 3 gushtit 2015 për miratimin e Amendamentit XXIV.

15. Më 18 gusht 2015, Qeveria i dorëzoi Gjykatës dokumentet e kërkuara. Këto dokumente përfshinin: shkresën e Kryeministrit, me të cilën

Amendamenti XXIV u riprocedua për votim, Vendimin 01/41 e Qeverisë për riprocedimin e Amendamentit XXIV dhe tekstin e amendamentit të propozuar.

16. Më 19 gusht 2015, Presidentja e Republikës i dërgoi letër Kryetares së Gjykatës, në të cilën kërkonte sqarime përkitazi me implikimet e kësaj kërkese në obligimet e Presidentes nga neni 80 i Kushtetutës. Kjo kërkesë, në mënyrë specifike, kishte të bënte me nënshkrimin dhe me shpalljen e dy ligjeve që ishin miratuar nga Kuvendi në bazë të Amendamentit XXIV të Kushtetutës.

17. Më 20 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës u përgjigj në letrën e Presidentes së Republikës, duke sqaruar se kërkesa KO107/15 kishte të bënte me kontestimin e Vendimit të Kuvendit, nr. 05-V-139, për miratimin e Amendamentit XXIV të 3 gushtit 2015. Kryetarja e Gjykatës, po ashtu, e informoi Presidenten e Republikës se kushtetutshmëria e dy ligjeve të lartpërmendura nuk ishte duke u kontestuar në Gjykatën Kushtetuese.

18. Më 28 gusht 2015, Kryeministri i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryeministri) e dorëzoi një letër në Gjykatë që përmbante komentet e Qeverisë.

19. Më 8 shtator 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

20. Më 7 mars 2015, Qeveria vendosi t'i propozonte Kuvendit të Republikës së Kosovës një amendament të Kushtetutës.

21. Të njëjtën ditë, Qeveria, në bazë të nenit 144.1 të Kushtetutës, i propozoi Kryetarit të Kuvendit tekstin e amendamentit të Kushtetutës.

22. Më 9 mars 2015, Kryetari i Kuvendit e referoi në Gjykatë tekstin e amendamentit të propozuar të Kushtetutës, duke kërkuar nga Gjykata që ajo të bënte vlerësim paraprak nëse amendamenti i propozuar zvogëlonte ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Gjykata e regjistroi kërkesën me numër KO26/15.

23. Më 14 prill 2015, Gjykata mbajti këshillime për kërkesën dhe nxori Aktgjykimin AGJ788/15, me të cilin konfirmoi se Amendamenti i propozuar XXIV nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës

dhe, me shkronjën dhe frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

24. Më 26 qershor 2015, Kuvendi shqyrtoi dhe votoi për Amendamentin e propozuar XXIV dhe, me 75 vota për, me 7 vota kundër dhe me 2 abstenime, dështoi ta miratonte atë.

25. Më 31 korrik 2015, Qeveria vendosi të riprocedonte Amendamentin e propozuar XXIV në Kuvend për një votim tjetër.

26. Të njëjtën datë, Kryetari i Kuvendit i njoftoi të gjithë deputetët e Kuvendit për riprocedimin e amendamentit të propozuar. Në këtë njoftim përfshihej një kopje e Vendimit të Qeverisë, teksti i Amendamentit të propozuar XXIV dhe një kopje e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në Rastin KO26/15.

27. Të njëjtën datë, Kryetari i Kuvendit thirri mbledhje të Kryesisë së Kuvendit, gjatë së cilës u vendos që amendamenti i propozuar të vihej në votim më 3 gusht 2015.

28. Më 3 gusht 2015, Kuvendi shqyrtoi dhe votoi për amendamentin e propozuar dhe, me Vendimin nr. 05-V-139, me 82 vota për, me 5 vota kundër dhe me 1 abstenim, e miratoi atë.

29. Më 5 gusht 2015, Amendamenti XXIV u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejmë: Gazeta Zyrtare].

Argumentet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës

30. Në kërkesën e tyre, parashtruesit e kontestojnë Vendimin nr. 05-V-139, si në baza përmbajtjesore ashtu edhe në baza procedurale.

Sa i përket aspektit përmbajtjesor të kërkesës

31. Pavarësisht faktit se parashtruesit e kërkesës kontestojnë Vendimin nr. 05-V-139, Gjykata vëren se argumentet e paraqitura nga ta nuk kanë të bëjnë me përmbajtjen e atij vendimi, por ato kanë të bëjnë me përmbajtjen e tekstit të Amendamentit XXIV dhe mund të përmblidhen si në vijim:

32. Parashtruesit e kërkesës argumentojnë se "*me këtë dispozitë përmbyset i gjithë sistemi kushtetues duke pasur parasysh se dispozitat e këtij amendamenti janë në kundërshtim të plotë me karakterin dhe subjektivitetin e Republikës së Kosovës. Kështu që nisur nga dispozitat e përgjithshme të Kushtetutës së Kosovës, respektivisht Nenit 1, par. 1 dhe 2 dhe Neni 3 lidhur me Nenin 24,*

Neni 102, 103 dhe 104 mbi organizimin e sistemit gjyqësor, përmbajtja e këtij neni e zhvesh shtetin e Kosovës edhe në aspekt formal sa i përket shtetësisë dhe karakterit republikan".

33. Më tej, parashtruesit e kërkesës paraqesin argumentet e tyre përkitazi me secilin paragraf të amendamentit. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se pavarësisht faktit që paragrafi 1 i këtij amendamenti thotë se Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar do të themelohen në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës "*... sipas përmbajtjes së amendamentit, askund nuk specifikohen elementet e varësisë së këtij organizmi në raport me organet kushtetuese të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Pra, emërimi, përzgjedhja dhe përgjegjësia e bartësve të këtij organizmi nuk është sanksionuar, madje i janë njohur kompetencat e veçanta në aspektin lëndor dhe të ekzekutimit të sanksioneve penale të shqiptuara nga trupat gjykues të këtij organizimi paralel".*

34. Sipas parashtruesve të kërkesës, paragrafi 2 i Amendamentit XXIV, parashikon garancitë procedurale për personat e akuzuar potencialë në pajtim me nenet 22 dhe 55 të Kushtetutës, por ai është në kundërshtim me dispozita të tjera të këtij amendamenti. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se *"proklamimi i të drejtave elementare duke u thirrur në Kapitullin II dhe në veçanti Nenet 22 dhe 55 të Kushtetutës dhe në anën tjetër dispozitat e këtyre paragrafëve të jenë të përjashtuara nga krahasimi si dhe kolizioni me dispozitat e tjera të Kushtetutës është argumenti juridik se këto dispozita kanë edhe kolizion përmbajtjesor ndërmjet tyre dhe me pjesën tjetër të dispozitave kushtetuese".*

35. Parashtruesit e kërkesës po ashtu argumentojnë se paragrafi 3 i Amendamentit XXIV është jokushtetues. Konkretisht, kjo dispozitë përcakton që një Dhomë e Specializuar, e përbërë nga 3 (tre) gjyqtarë ndërkombëtarë, do të themelohet në kuadër të Gjykatës Kushtetuese, e cila do të vendosë ekskluzivisht për kërkesat kushtetuese që kanë të bëjnë me Dhomat e Specializuara dhe me Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Sipas parashtruesve të kërkesës, *"... Dhoma e specializuar siç është quajtur nga sponzorizuesi është në kundërshtim të plotë me dispozitat e Nenit 114 të Kushtetutës për sa i përket përbërjes së saj. Elementi tjetër sa i përket kolizionit që janë duke krijuar këto norma në këtë amendament është edhe kompetenca lëndore kësaj dhome të 'specializuar' në raport me Nenin 112 dhe 113 të Kushtetutës".*

36. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se paragrafi 4 i Amendamentit XXIV, duke i dhënë Dhomave të Specializuara dhe

Zyrës së Prokurorit të Specializuar aftësi të plotë juridike, subjektivitet juridik dhe të gjitha autorizimet e mandatin e nevojshëm për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare me shtete të treta, *"... ia jep këtij institucioni atributin e sovranitetit të jashtëm që është komponent thelbësor i kuptimit të plotë të nocionit të sovraniteti shtetëror. Për këtë kjo dispozitë përjashton madje edhe bartësin kryesor të kontrollit të sovranitetit të jashtëm e ai është Kuvendi".*

37. Ngjashëm, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se paragrafi 5 i Amendamentit XXIV *"i cenon kompetencat e Kuvendit të Kosovës siç janë paraparë me Nenin 65, pikës 4 të Kushtetutës përkitazi me kompetencën për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Pra pëlqimi për lidhje të marrëveshjeve ndërkombëtare që do t'i lidhin Dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të specializuar do të merret vetëm nga Qeveria dhe jo nga Kuvendi i Kosovës siç është paraparë me Nenin 18 të Kushtetutës".*

38. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pohojnë se kompetenca dhënë Dhomave të Specializuara, në paragrafin 6 të Amendamentit XXIV, për të përcaktuar rregulloren e tyre të punës, *"... hap mundësinë që procedimi i çështjeve pranë këtij mekanizmi gjyqësor të jetë përjashtues për qytetarët e Republikës së Kosovës në kuptim të zbatimit të së drejtës pozitive. Kjo korrespondon drejtpërdrejt në kundërshtim me Nenin 24 të Kushtetutës së Kosovës edhe me përmbajtjen e të drejtave të sanksionuara me aktet ndërkombëtare që gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë sipas Nenit 22 të Kushtetutës".*

39. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se paragrafët 7 dhe 8 të Amendamentit XXIV, që rregullojnë çështjen e selive të Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe lokacionin gjeografik ku do të vendosen personat e akuzuar dhe personat e dënuar, janë në kundërshtim me Kushtetutën. Sipas parashtruesve të kërkesës *"... kufizimi i ndërvarësisë në mes të shtetasit dhe shtetit të Kosovës e bën të diskriminuar qytetarin e Kosovës ndaj të cilit mbahet gjykimi, i shqiptohet dënimi dhe ekzekutohet në procedura të veçanta dhe në territor tjetër. Kjo çështje ndërlidhet me ekstradimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës e që sipas Nenit 35, paragrafit 4, ekstradimi i qytetarëve të Kosovës në kuadër të së drejtës themelore të njeriut përkitazi me lirinë e lëvizjes, ndalohet ekstradimi i tij, përjashtimisht kur kjo është e rregulluar me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare".*

40. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu konsiderojnë se paragrafi 10 i Amendamentit XXIV, që parashikon se do të miratohet ligj i veçantë për të rregulluar çështjet që kanë të bëjnë me emërimin, me mbikëqyrjen dhe me administrimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të

Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, është në kundërshtim me nenin 102 të Kushtetutës, pavarësisht faktit se *"... në paragrafin 1 të këtij amendamenti atyre u referohen si nën sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës"*.

41. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se paragrafi 11 i Amendamentit XXIV, që parashikon se do të themelohet një Ombudsperson i veçantë me përgjegjësi ekskluzive për Dhomat e Specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar, është në kundërshtim me Kushtetutën, sepse ai/ajo *"... nuk do të zgjidhet dhe as nuk do t'i raportojë Kuvendit të Kosovës sipas dispozitave të Neneve 132, par. 2 dhe Neneve 134 dhe 135 par. 1 dhe 2 të Kushtetutës së Kosovës"*.

42. Më tej, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se paragrafi 12 i Amendamentit XXIV, që rregullon me marrëveshje ndërkombëtare çështjet e mbikëqyrjes, të financimit, të buxhetit, të auditimit dhe aspekte të tjera të organizimit dhe të funksionimit të Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, krijon standard të dyfishtë dhe do të *"... formalizojë kundërshtimin e brendshëm kushtetues lidhur me Nenin 3 dhe Nenin 102 te Kushtetutës, dhe në aspektin e të drejtave të njeriut nga Kapitulli II, do të vijë deri tek cenimi i Nenit 24, dhe Nenit 22 përkitazi me Nenin 7 të DUDNJ-së përkitazi me të drejtën në trajtim dhe mbrojtje të barabartë para ligjit"*.

43. Parashtruesit e kërkesës po ashtu pohojnë se paragrafët 13 dhe 14 të Amendamentit XXIV, përkitazi me mandatin e Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, *"... krijojnë pasiguri juridike dhe kushtetuese dhe një normim i tillë e cenon rendin juridik në përgjithësi sepse përderisa dispozitat kushtetuese kalojnë nëpër një procedure të veçantë kushtetuese dhe miratimin sipas shumicës së dyfishtë të kualifikuar në pajtim me Nenin 144, par. 2 të Kushtetutës, akti në të cilin janë referuar këto dy paragrafë miratohen me shumicë të njëfishtë, të kualifikuar dhe i njëjti i nënshtrohet rregullimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës"*.

44. Në fund,

> *"Parashtruesit e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Amendamentit kushtetues nr. XXIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konsiderojnë se dispozitat e këtij amendamenti në aspektin përmbajtjesor janë në kundërshtim me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, respektivisht me dispozitat konkrete kushtetuese:*

Neni 1, paragrafët (1) dhe (2) - Përkufizimi i Shtetit

Neni 3 - Barazia para Ligjit

Neni 22 - Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare - lidhur me Nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut

Neni 24 - Barazia para Ligjit

Neni 35 - Liria e Lëvizjes

Neni 45 - Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes

Neni 102 - Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor

Neni 103 - Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave

Neni 104 - Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve

Neni 114 - Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese

Nenet 132, 134 dhe 135 - përkitazi me Avokatin e Popullit".

Sa i përket aspektit procedural të kërkesës

45. Në lidhje me procedurën e ndjekur për miratimin e vendimit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se kanë ndodhur edhe shkelje procedurale.

46. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës pohojnë se pas mbledhjes së jashtëzakonshme të Kryesisë së Kuvendit, të 31 korrikut 2015, ku ishte vendosur që seanca plenare për rivotimin e Amendamentit XXIV të mbahej më 3 gusht 2015, *"... nuk i është dërguar materiali përcjellës i cili do të shqyrtohej në seancën plenare".*

47. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës citojnë nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës që përcaktojnë se, para vënies në votim të një amendamenti të Kushtetutës në Kuvend, amendamenti i propozuar duhet të referohet nga Kryetari i Kuvendit në Gjykatën Kushtetuese për të konfirmuar se amendamenti i propozuar nuk zvogëlon të drejtat e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës theksojnë:

"Përkundër vendimit të Kuvendit të Kosovës, marrë në seancën plenare të datës 26 qershor 2015, Qeveria e Kosovës më datën 31

korrik 2015 e ka riproceduar në Kuvendin e Kosovës propozim-amendamentin me përmbajtje të njëjtë duke mos e marrë parasysh vendimin e marrë nga Kuvendi i Kosovës më datën 26 qershor 2015. [...] Kryetari i Kuvendit duhej që para procedimit të propozimamendamentit të Qeverisë së Kosovës ta dërgonte të njëjtin pranë Gjykatës Kushtetuese për vlerësim".

48. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës theksojnë se referimi i amendamentit të propozuar në Gjykatën Kushtetuese është obligues dhe formulimi i nenit 113.9 i Kushtetutës nuk lejon asnjë variacion. *"Në kuptim të kësaj dispozite, këtu nuk merret fare parasysh e drejta diskrecionale e Kryetarit të Kuvendit që të alternojë procedimin e një propozim-ndryshimi kushtetues pranë Gjykatës Kushtetuese".*

49. Sipas parashtruesve të kërkesës "... *Gjykata Kushtetuese është i vetmi organ shtetëror i cili ka autorizimin kushtetues që të bëjë konstatimin lidhur me cilindo propozim për ndryshimin e Kushtetutës në raport me të drejtat dhe liritë elementare të njeriut.*

[...]

Prezumimet procedurale kanë karakter qenësor për të garantuar përmbajtjen e drejtë të lëndës për të cilën zhvillohet procedura përkatëse referuar maksimës "forma data esse rei " (forma e përcakton përmbajtjen). Për këtë cenimi i prezumimeve procedurale që kanë karakter absolut, e që në rastin konkret natyra imperative e dispozitës së Nenit 113.9 është e pakontestueshme, e bën që materia e proceduar sipas deformimit procedural e konteston legjitimitetin e vetë përmbajtjes së materies, së cilës i jepet fuqia juridike pikërisht në këtë procedurë".

50. Ngjashëm, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se neni 144.3 "... *jep kuptimin e kushtit për cilindo procedim që ndërlidhet me ndryshimet kushtetuese. Pra, një amendament nuk ka mundësi të hynë në fuqi edhe pse i ka përmbushur kushtet për miratim nga shumica e kualifikuar sipas Nenit 144.2 të Kushtetutës së Kosovës".*

51. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës theksojnë rëndësinë e nenit 144.3, duke thënë: *"Nëse çështjen në fjalë e sqarojmë përmes rregullave të interpretimit sistematik, mjafton që ta kemi parasysh paragrafin 4 të Nenit 144 i cili e përcakton momentin e hyrjes në fuqi të një amendamenti kushtetues të votuar nga Kuvendi i Kosovës. Pra, renditja e paragrafit 4 pas paragrafit 3 është tregues se procesi i miratimit të një amendamenti kushtetues dhe hyrja në fuqi e tij është e kushtëzuar nga paragrafi 3 i Nenit 144 të Kushtetutës".*

52. Parashtruesit e kërkesës përmbyllin argumentet lidhur me aspektin procedural të shkeljeve të pretenduara, duke përfshirë edhe rregullin 82 të Rregullores së punës të Kuvendit, që reflekton dispozitat kushtetuese përkitazi me procedurat e miratimit të amendamenteve të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se këto procedura nuk janë respektuar.

Komentet e dorëzuara nga Kryeministri

53. Në letrën e Kryeministrit, të 28 gushtit 2015, thuhet: "... *Amendamenti XXIV i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i dorëzuar nga Qeveria në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më datën 31 Korrik 2015 dhe i miratuar nga Kuvendi në seancën plenare të datës 03 Gusht 2015, është IDENTIK me tekstin që ishte dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese dhe vlerësuar nga kjo Gjykatë në rastin K026-15, respektivisht me Aktgjykimin AGJ 788/15*".

54. Për më tepër, në letër argumentohet se "*të gjitha këto pretendime janë të pabazuara për arsye se lidhur me këtë çështje tashmë kemi një Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin ishte konstatuar se Amendamenti XXIV nuk zvogëlon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas Kapitullit II dhe III të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*".

55. Në fund, i propozohet Gjykatës: "... *ta DEKLARONI SI TË PAPRANUSHME [kërkesën KO107/15], duke qenë se kemi të bëjmë me një çështje tashmë të gjykuar (res judicata)*".

Pranueshmëria e kërkesës

56. Në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, detyrë e Gjykatës është të shqyrtojë nëse përmbajtja e vendimit të kontestuar dhe procedura e ndjekur për miratimin e tij janë në kundërshtim me Kushtetutën, siç pretendohet nga parashtruesit e kërkesës. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se vendimi i kontestuar, për nga përmbajtja, shkel nenet 1, 3, 22, 24, 35, 45, 102, 103, 104, 114, 132, 134 dhe 135 të Kushtetutës, përderisa procedura e ndjekur me rastin e miratimit të Vendimit nr. 05-V-139 ishte në kundërshtim me nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës.

57. Në mënyrë që të gjykojë lidhur me kërkesën e parashtruesve, është e nevojshme që Gjykata të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kërkesat e pranueshmërisë, siç janë përcaktuar me

Kushtetutë dhe siç janë specifikuar më tej me Ligj. Gjykata së pari duhet të përcaktojë nëse kërkesa është dorëzuar nga pala e autorizuar.

58. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës që përcakton:

"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

59. Sa i përket këtyre kërkesave, Gjykata rikujton se parashtruesit e kanë ngritur kërkesën në mbështetje të nenit 113.5 të Kushtetutës që përcakton:

"Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur".

60. Gjykata vëren se kërkesa është dorëzuar nga 24 deputetë të Kuvendit, brenda 8 (tetë) ditësh nga dita e miratimit të Vendimit nr. 05-V-139. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar për të ngritur në Gjykatë kërkesën që konteston këtë vendim.

61. Sidoqoftë, Gjykata më tej do të shqyrtojë kriteret e tjera të pranueshmërisë që janë të aplikueshme në rastin e tanishëm.

Sa i përket vendimit të kontestuar

62. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kontestojnë Vendimin nr. 05-V-139 e Kuvendit, të 3 gushtit 2015. Në këtë vendim theksohet:

"Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje te neneve 65 (2) dhe 144 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6.2 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare të mbajtur më 3 gusht 2015, pasi shqyrtoi Propozim-amendamentin nr. 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të ri-proceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, mori këtë:

VENDIM

1. Miratohet Amendamenti nr. 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i riproceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

2. Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës".

Sa i përket aspektit përmbajtjesor të kërkesës

63. Lidhur më këtë, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës] që përcakton:

"Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

a) Gjykata nuk ka juridiksion për çështjen;

b) kërkesa është anonime;

c) Gjykata konsideron që kërkesa është keqpërdorim i të drejtës për peticion;

d) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri;

e) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;

f) kërkesa nuk është ratione personae në pajtim me Kushtetutën; ose

g) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën".

64. Përkitazi me këtë, Gjykata vëren se argumentet e parashtruesve të kërkesës kryesisht ndërlidhen me përmbajtjen e Amendamentit XXIV, megjithëse ata pretendojnë se kontestojnë Vendimin nr. 05-V-139.

65. Kjo është gjithashtu e qartë nga pjesa përmbyllëse e aspektit përmbajtjesor të pretendimeve ku parashtruesit kërkojnë nga Gjykata "*... vlerësimin e kushtetutshmërisë së Amendamentit kushtetues nr. XXIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konsiderojnë se dispozitat e këtij amendamenti në aspektin përmbajtjesor janë në kundërshtim me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës".*

66. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se neni 113.9 i Kushtetutës thotë:

"Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës".

67. Gjykata po ashtu i referohet nenit 144.3 të Kushtetutës, që përcakton:

"Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës".

68. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se Kushtetuta nuk i jep Gjykatës asnjë kompetencë për vlerësimin e një amendamenti kushtetues lidhur me përmbajtjen e tij, pas miratimit të të njëjtit. Kompetenca e Gjykatës, përkitazi me substancën e një amendamenti kushtetues, është që të vlerësojë nëse amendamenti i propozuar zvogëlon ndonjë të drejtë dhe liri të përcaktuar në Kapitullin II të Kushtetutës, para se amendamenti të vihet për aprovim në Kuvend.

69. Gjithashtu, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore (Shih, *mutatis mutandis,* Aktgjykimi nr. AGJ469/13, i 9 shtatorit 2013, në rastin KO95/13, në paragrafin 97 e tutje). Ngjashëm me atë rast, Gjykata konsideron se Amendamenti XXIV i Kushtetutës dhe Vendimi nr. 05-V-139 i Kuvendit janë dy akte të ndara juridike. Secili prej këtyre akteve ndjek procedurë të ndryshme juridike, për vlerësim të kushtetutshmërisë së projektamendamentit, respektivisht për Vendimin që miraton amendamentin.

70. Gjykata rikujton se për miratimin e një amendamenti të Kushtetutës kërkohet një shumicë e veçantë votash në Kuvend, siç parashikohet në nenin 144.2. Në këtë dispozitë theksohet: *"Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës".*

71. Sa i përket miratimit të amendamentit XXIV, Gjykata vëren se Vendimi për miratim është marrë nga shumica e kërkuar, prej dy të tretave të Kuvendit, siç specifikohet me Kushtetutë. Kësisoj, Gjykata konsideron se Vendimi i Kuvendit për miratimin e Amendamentit XXIV ishte në pajtim me dispozitat procedurale të Kushtetutës.

72. Vendimi për miratimin e çdo amendamenti kushtetues, në këtë rast Amendamentit XXIV, është në substancën e tij shpallje se një amendament është miratuar me shumicën e kërkuar. Amendamenti, si i tillë, nuk mund të ndryshohet në kohën ndërmjet vlerësimit nga Gjykata dhe miratimit të tij nga Kuvendi, sepse çdo ndryshim në një dispozitë kushtetuese kërkon miratimin paraprak të Gjykatës sa i përket pajtueshmërisë së tij me dispozitat e Kapitullit II të Kushtetutës.

73. Prandaj, argumentet e parashtruesve të kërkesës përkitazi me përmbajtjen e Amendamentit XXIV nuk mund të merren parasysh në këtë fazë. Argumente të asaj natyre u adresuan në mënyrën të duhur në Gjykatë në kohën kur vlerësimi i pajtueshmërisë së amendamentit me Kapitullin II ishte duke u shqyrtuar nga Gjykata. Në të vërtetë, Gjykata rikujton se ua kishte shpërndarë kërkesën KO26/15 të gjithë deputetëve të Kuvendit, të cilëve u ishte dhënë mundësia të paraqitnin komentet e tyre për kushtetutshmërinë e Amendamentit XXIV në atë kohë (Shih Aktgjykimin AGJ 788/15, në Rastin KO26/15, të 15 prillit 2015, paragrafi 7).

74. Për më tepër, neni 144.4 i Kushtetutës thotë:

> "*Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës*".

75. Gjykata vëren se, me nenet 113.9 dhe 144.3, Kushtetuta vendos të gjitha konsideratat lidhur me vlerësimin dhe me konfirmimin e kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara kushtetuese në periudhën kohore para miratimit të një amendamenti. Për këtë arsye, në nenin 144.4, Kushtetuta autorizon hyrjen e menjëhershme në fuqi të amendamenteve kushtetuese pas miratimit të tyre. Pajtueshmëria e amendamentit, si i tillë, me Kushtetutën nuk mund të jetë më objekt i kontestimit pasi që kjo është vlerësuar dhe është miratuar para vendimit për miratim të tij.

76. Në veçanti, Gjykata vëren se kjo procedurë dallon nga ajo që aplikohet te miratimi i ligjeve nga Kuvendi. Pas miratimit të një ligji, neni 113.5 i Kushtetutës lejon një periudhë prej 8 (tetë) ditësh pas miratimit të tij, gjatë së cilës së paku 10 (dhjetë) deputetë mund të kontestojnë kushtetutshmërinë e atij ligji.

77. Në pajtim me këtë dispozitë, neni 43.1 i Ligjit parashikon: "*Një ligj apo vendim i miratuar nga ana e Kuvendit te Republikës së Kosovës i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje pas mbarimit të afatit të përcaktuar në pajtim me nenin 113, paragrafi 5 i Kushtetutës*".

78. Në raste të tilla, kushtetutshmëria vlerësohet nga Gjykata pas miratimit të ligjit ose të vendimit, e jo para miratimit, dhe shpallja nga Presidenti i Republikës është e lidhur me referimin e ligjit ose të vendimit në Gjykatë për vlerësim të kushtetutshmërisë.

79. Përveç kësaj, në raste të tilla, Kushtetuta parashikon në nenin 116.2: "*Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të paripparueshme*".

80. Kur bëhet fjalë për miratimin e një amendamenti të Kushtetutës, Gjykata gjen se hyrja në fuqi e amendamentit nuk varet nga shpallja që bën Presidenti i Republikës, por ai hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Kuvendi, siç përcaktohet në nenin 144.4.

81. Kjo gjithashtu dëshmohet nga Vendimi nr. 05-V-139 i Kuvendit, në pikën 2, ku thuhet: "*Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës*".

82. Edhe pse nuk është ngritur çështja nga parashtruesit e kërkesës, Gjykata konsideron se, në këto rrethana, parashtrimi i një kërkese sipas nenit 113.5 të Kushtetutës kundër Vendimit për miratimin e amendamentit nuk mund të pezullojë hyrjen në fuqi të vetë amendamentit, sepse hyrja e tij e menjëhershme në fuqi është drejtpërdrejt e rregulluar me dispozitë kushtetuese.

83. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës] që përcakton:

> *"1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë".*

84. Në rastin e tanishëm, Gjykata po ashtu vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kanë parashtruar ndonjë kërkesë në Gjykatë për pezullimin e Vendimit të kontestuar nr. 05-V-139. Rrjedhimisht, në këtë kërkesë, çështja e pezullimit të ndonjë veprimi ose e ndonjë ligji të kontestuar nuk paraqitet.

85. Gjykata rikujton se Amendamenti XXIV ka qenë objekt i vlerësimit paraprak nga Gjykata dhe ishte konfirmuar që ky amendament nuk zvogëlon të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të

Kushtetutës, si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe, me shkronjën dhe frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës. (Shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese AGJ788/15, të 15 prillit 2015, në Rastin KO26/15 *Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 9 mars 2015, me Shkresën Nr. 05-433/DO-318*).

86. Më 3 gusht 2015, ky amendament i njëjtë u miratua nga Kuvendi me 82 vota për, me 5 vota kundër dhe me 1 abstenim.

87. Përveç kësaj, Gjykata vëren se Amendamenti XXIV i Kushtetutës ka hyrë në fuqi në bazë të nenit 144.4 të Kushtetutës.

88. Rrjedhimisht, në kontekst të kësaj kërkese, Gjykata konkludon se nuk ka juridiksion për të vlerësuar një amendament kushtetues sapo të jetë miratuar ai.

89. Gjykata vëren se, në parashtresat e tyre, parashtruesit e kërkesës nuk kanë adresuar asnjë argument për përmbajtjen e Vendimit të kontestuar nr. 05-V-139 për miratimin e Amendamentit XXIV. Kësisoj, Gjykata gjen se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur ankesat e tyre në lidhje me këtë vendim.

90. Rrjedhimisht, në pajtim me rregullat 36 (3) (a) dhe 36 (3) (e), Gjykata i gjen të papranueshme pretendimet përkitazi me përmbajtjen e vendimit të kontestuar.

Sa i përket aspektit procedural të kërkesës

91. Gjykata vëren se, përkitazi me aspektin procedural të kërkesës, argumenti kryesor i parashtruesve të kërkesës në mbështetje të pretendimit të tyre për shkelje procedurale ndërtohet rreth faktit se Kryetari i Kuvendit e riprocedoi amendamentin e propozuar pa e referuar Amendamentin e propozuar XXIV për vlerësim në Gjykatë, sipas nenit 144.3 të Kushtetutës, para votimit për amendamentin e riproceduar.

92. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 42 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, që parashikon:

> *"1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:*

1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës se Kosovës;

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti".

93. Përkitazi me këtë, Gjykata rikujton se, para se t'i hynte vlerësimit të kësaj kërkese, ka kërkuar informacione nga të gjitha palët e përfshira: nga Qeveria, si sponsorizuese e Amendamentit XXIV, nga Kryetari i Kuvendit, i cili ua ka dërguar amendamentin e propozuar deputetëve, si dhe nga parashtruesit e kërkesës, që të dorëzonin në Gjykatë, *inter alia,* tekstin e amendamentit të propozuar dhe tekstin e amendamentit të miratuar.

94. Në kohën e duhur, Gjykata pranoi nga Qeveria: Amendamentin e propozuar XXIV, të riproceduar; nga Kryetari i Kuvendit: tekstin e Amendamentit të propozuar XXIV dhe tekstin e Amendamentit të miratuar XXIV, të riproceduar dhe të votuar; si dhe nga parashtruesit e kërkesës: tekstin e Amendamentit të miratuar XXIV.

95. Me qëllim të kontrollimit të përmbajtjes së këtij amendamenti, Gjykata krahasoi këto tekste me përmbajtjen e amendamentit të propozuar, të cilin e kishte vlerësuar më herët në Rastin KO26/15.

96. Gjykata vëren se parashtruesit gjithashtu theksojnë në kërkesën e tyre që projektamendamenti i riproceduar kishte të njëjtën përmbajtje sikurse projektamendamenti i votuar dhe i refuzuar nga Kuvendi më 26 qershor 2015, që ishte dorëzuar në Gjykatë dhe që ishte vlerësuar në aktgjykimin e saj të 14 prillit 2015.

97. Qeveria po ashtu konfirmoi, në letrat e saj të 18 dhe 28 gushtit 2015, si përgjigje në kërkesën e Gjykatës për informacione, se projektamendamenti i riproceduar në Kuvend më 31 korrik 2015 ishte identik me projektamendamentin që ishte dorëzuar më herët në Gjykatë për vlerësim nga ana e saj në Rastin KO26/15.

98. Për më tepër, Kryetari i Kuvendit, në letrën e tij të 17 gushtit 2015, si përgjigje në kërkesën e Gjykatës për informacione, theksoi:

"Qeveria e Republikës së Kosovës, më 31 korrik 2015, e ka ri-proceduar në Kuvend Amendamentin nr. 24, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të vlerësuar me Aktgjykimin e Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për Rastin KO26/15, Nr. ref.: AGJ 788115, datë 15 prill 2015".

99. Në këtë kontekst, Gjykata konkludoi se përmbajtja e Amendamentit të propozuar XXIV, siç ishte dorëzuar në Gjykatë për vlerësim paraprak më 9 mars 2015, është identike me tekstin e Amendamentit të propozuar XXIV, që ishte riproceduar nga Qeveria dhe që ishte përcjellë nga Kryetari i Kuvendit te të gjithë deputetët më 31 korrik 2015. Për më tepër, teksti i amendamentit, që u miratua më 3 gusht 2015 dhe që më pastaj u publikua në Gazetën Zyrtare pas dy ditësh, mbetet identik me tekstin fillestar që është vlerësuar më herët nga Gjykata.

100. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se nuk ka pasur nevojë që amendamenti i propozuar të referohet për herë të dytë, pasi që i njëjti tashmë ishte vlerësuar një herë dhe përmbajtja e tij nuk ka pësuar ndonjë ndryshim apo modifikim.

101. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë se janë shkelur procedurat kushtetuese pasi që, pas mbledhjes së jashtëzakonshme të Kryesisë së Kuvendit, të 31 korrikut 2015, materialet e ndërlidhura me projektamendamentin nuk iu dorëzuan deputetëve.

102. Mirëpo, Gjykata vëren se, së bashku me shkresën e saj të 17 gushtit 2015, Kryesia e Kuvendit ofroi kopjen e dosjes së plotë, ashtu siç u ishte dorëzuar më 31 korrik 2015 të gjithë deputetëve para votimit të 3 gushtit 2015. Si e tillë, kjo dosje përmbante Vendimin 01/41 e Qeverisë për riprocedimin e Amendamentit XXIV në Kuvend, tekstin e Amendamentit të propozuar XXIV dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese AGJ788/15, të 14 prillit 2015, në Rastin KO26/15.

103. Prandaj, Gjykata gjen se parashtruesit e kërkesës kanë dështuar të ofrojnë prova në mbështetje të kësaj ankese.

104. Gjykata rikujton se në bazë të nenit 42, paragrafi 1.3, të Ligjit, në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, *"ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme: [...] 1.3 paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti*".

105. Gjithashtu, rregulli 36 (2) (d) i Rregullores së punës parashikon: "*Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se (...) parashtruesi nuk dështon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij*".

106. Gjykata konkludon se parashtruesit e kërkesës dështuan të paraqesin prova për të dështmuar pretendimet e tyre në mbështetje të kontestit të tyre për shkelje të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.5 të Kushtetutës, në mbështetje të nenit 42, paragrafi 1.3, të Ligjit dhe në mbështetje të rregullave 36 (2) (d), 36 (3) (a) dhe 36 (3) (e) të Rregullores së punës, më 21 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI05/15, Parashtrues Reshat Osmani - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0061, të 5 shtatorit 2014

KI05/15, Aktvendim për papranueshmëri i 31 gushtit 2015, publikuar më 23 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, parashkrim fitues, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës*

Kolegji i Apelit i Gjykatës Supreme kishte refuzuar, si të pabazuar ankesën e parashtruesit përkitazi me pronësinë e dy ngastrave kadastrale për shkak të paqartësisë së pretendimeve të tij. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese kryesisht për shkelje të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe mbrojtje të pronës.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se pakënaqësia me vendimin nuk është e mjaftueshme që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese të së drejtës për një gjykim tëdrejtë, dhe se parashtruesi i kërkesës, duhet të paraqesë argumente bindëse dhe të padiskutueshme për të mbështetur pretendimet në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMERI
në
Rastin rr. KI05/15
Parashtrues
Reshat Osmani
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0061, të 5 shtatorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Reshat Osmani me vendbanim në Han të Elezit, i cili përfaqësohet nga z. Miftar Islami, avokat në Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave i DHPGJS), AC-I-14-0061, i 5 shtatorit 2014, me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës si e pabazuar dhe ishte vërtetuar Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar i DHPGJS), i 12 shkurtit 2014.

3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 23 shtator 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ishin shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 14 janar 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 9 shkurt 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI05/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI05/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 20 shkurt 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë autorizimin për përfaqësim në Gjykatë. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi DHPGJS-së një kopje të kërkesës.

9. Më 9 mars 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi autorizimin për përfaqësim në Gjykatë.

10. Më 23 mars 2015, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

11. Më 8 korrik 2015, Kolegjishqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në vitin 1963, i ati i parashtruesit të kërkesës i shiti një kooperative bujqësore 2 (dy) parcela të tokës, të cilat gjenden në komunën e Ferizajt.

13. Në bazë të shkresave të lëndës, pas ndryshimit të ligjit, në vitin 1996, i ati i parashtruesit parashtroi kërkesë në Gjykatën Komunale në Ferizaj që ta anulojë shitjen e këtyre 2 (dy) parcelave të tokës.

14. Më 23 mars 1998, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktgjykimi P. nr. 287/96) duket se miratoi kërkesën e babait të parashtruesit të kërkesës dhe anuloi kontratën e blerjes së vitit 1963 si të paligjshme. Përveç kësaj, Gjykata Komunale urdhëroi kooperativën bujqësore, Ndërmarrjen Shoqërore "Pasuria Bujqësore", që t'ia dorëzojë ngastrat të atit të parashtruesit të kërkesës, duke e detyruar atë që t'i paguajë një shumë të caktuar kooperativës bujqësore, si kompensim. Duket se këto dy ngastra të tokës nuk i janë transferuar asnjëherë babait të parashtruesit të kërkesës.

15. Në një moment të caktuar, i ati i parashtruesit vdiq. Si trashëgimtar legjitim, parashtruesi i kërkesës vazhdoi me padinë për kthimin e ngastrave të tokës.

16. Nga shkresat e lëndës rrjedh se ngastrat e lartpërmendura i ishin nënshtruar procesit të privatizimit nga AKP-ja.

17. Më 4 gusht 2011, parashtruesi paraqiti kërkesë në AKP për largimin e ngastrave nga procesi i privatizimit.

18. Më 17 tetor 2011, parashtruesi parashtroi padi në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së, fillimisht duke kërkuar verifikimin e pronësisë mbi 2 (dy) parcelat kadastrale, në bazë të parashkrimit fitues.

19. Më 5 dhjetor 2011, parashtruesi parashtroi një kërkesë tjetër te Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së për urdhër paraprak gjyqësor për t'i hequr ngastrat e tokës nga procesi i privatizimit.

20. Më 19 mars 2012, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së refuzoi kërkesën e parashtruesit për urdhër paraprak gjyqësor si të pabazuar.

21. Në një datë të paspecifikuar, si rezultat i procesit të privatizimit, AKP-ja ia kishte shitur ngastrat e lartpërmendura një pale të tretë.

22. Më 10 dhjetor 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së mbajti një dëgjim publik, ku ajo ia dha mundësinë parashtruesit të kërkesës të ndryshojë ose të saktësojë padinë e tij. Gjatë dëgjimit publik, parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, kërkoi ose kthimin e parcelave kadastrale, për të cilat ai pretendonte pronësinë, ose kompensimin me një tjetër ngastër të tokës për parcelat, të cilat ndërkohë i ishin shitur një pale të tretë. Sa i përket kërkesës së dytë të parashtruesit, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, gjatë dëgjimit publik kërkoi nga parashtruesi i kërkesës ta saktësojë parcelën e tokës të cilën e kërkonte si kompensim për parcelat e shitura.

23. Më 12 shkurt 2014, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së (Aktgjykimi SCC-11-0240) e refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar.

24. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për konfirmimin e pronësisë së tij mbi 2 (dy) parcelat kadastrale të sipërpërmendura në bazë të parashkrimit fitues, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së vlerësoi se ndalimi i parashkrimit fitues kundër ndërmarrjeve shoqërore u shfuqizua në vitin 1996 dhe numërimi i afateve mund të rifillonte vetëm prej asaj kohe. Prandaj, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, duke iu referuar dispozitave të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore pronësore, konstatoi se periudha për parashkrimin fitues të pronës së tokës është 20 (njëzet) vjet. Prandaj, sipas Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, edhe në qoftë se toka nuk do t'i ishte shitur palës së tretë, parashtruesi nuk do të fitonte të drejtat e pronësisë mbi bazën e lartpërmendur ligjore.

25. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për kompensim me një ngastër tjetër të tokës, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së vlerësoi se, përkundër faktit se parashtruesit i ishte dhënë mundësia për të saktësuar padinë e tij, ai nuk arriti të identifikojë tokën që ai e kërkonte si kompensim për parcelat që i ishin shitur një pale të tretë.

26. Prandaj, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së arriti në përfundim se pretendimi i parashtruesit të kërkesës duhet të refuzohet për shkak se është i pabazuar nga pikëpamja faktike dhe më tej konstatoi se edhe nëse padia do të ishte ndryshuar dhe saktësuar sipas kërkesës së Kolegjit të Specializuar, prapë do të konsiderohej e pabazuar, sepse kërkesat e parashkrimit fitues nuk ishin përmbushur në rastin e tij.

27. Më 16 shkurt 2014, parashtruesi parashtroi ankesë kundër aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, duke kërkuar nga ky i fundit ta miratojë kërkesën e tij për kompensim me një tjetër ngastër të tokës, ose ta shfuqizojë aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së dhe ta kthejë rastin për shqyrtim dhe për rigjykim. Sa i përket konkludimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së se

parashtruesi i kërkesës nuk kishte saktësuar kërkesën e tij, ai argumentoi se ishte e pamundur të identifikojë ngastrën e tokës të kërkuar si kompensim, pasi ai nuk ka pasur qasje në Shërbimin Kadastral.

28. Më 5 shtator 2014, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së (Aktgjykimi AC-I-14-0061) hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së.

29. Në Aktgjykimin e tij, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së, duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ 29/78), konstatoi se edhe në rast se Kolegji i Specializuar do t'ia kishte konfirmuar pronësinë e parcelave të pretenduara parashtruesit të kërkesës dhe AKP-ja të kishte tjetërsuar ato parcela në dëm të tij, ky i fundit do të kishte të drejtë vetëm për një kompensim në të holla. Sipas Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, parashtruesi nuk kishte kërkuar një kompensim të tillë.

30. Prandaj, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së konkludoi se ankesa e parashtruesit të kërkesës duhet të refuzohet si e pabazuar për shkak se *"mungesa e kjartësisë së mjaftueshme të kërkesës e pengon gjykatën të pranojë çfarëdo mjeti juridik"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Siç u përmend më lart, parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se me aktgjykimin e Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së ishin shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

32. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën e mëposhtme për kompensim *"ose tokë tjetër ose kompensim në të holla, sipas vlerës së përcaktuar nga ekspertët"*.

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

34. Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë*

cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

35. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

36. Siç u theksua më lart, parashtruesi pretendon shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mbrojtje të pronës, të garantuar me Kushtetutë dhe me KEDNJ.

37. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi vetëm kishte përmendur dispozitat e lartpërmendura, por nuk kishte paraqitur asnjë argument apo dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij.

38. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se pakënaqësia me vendimin nuk është e mjaftueshme që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese të së drejtës për një gjykim të drejtë.Kur pretendohen shkelje kushtetuese, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë argumente bindëse dhe të padiskutueshme për të mbështetur pretendimet, në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar (Shih rastin Nr. KI198/13, Parashtrues i kërkesës *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014).

39. Për më tepër, Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj, sipasKushtetutës, që të zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta në lidhje me vendimetqë merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta tëinterpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhematerialе (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr.30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999;shih edhe rastin KI70/11, parashtrues*Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

40. Gjykata konsideron se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së kanë kryer procedurat në mënyrë të drejtë dhe i kanë arsyetuar vendimet e tyre në bazë të padisë dhe të ankesës së parashtruesit të kërkesës. Lidhur me këtë, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së konfirmoi se parashtruesit i ishin dhënë disa mundësi për të saktësuar apo për të identifikuar parcelën e tokës së kërkuar nga ai si kompensim për parcelat e shitura nga AKP-ja dhe, për këtë arsye, Kolegji i Ankesave konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur një kërkesë të saktësuar në mënyrë të mjaftueshme që gjykata të vendosë për ndonjë kompensim.

41. Në fund, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë argument bindës që do të vërtetonte se shkeljet e pretenduara të përmendura në kërkesë përbëjnë shkelje të të drejtave kushtetuese (Shih rastin *Vanek kundër Republikës Sllovake*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005) dhe nuk ka saktësuar se si janë shkelur nenet e përmendura të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së.

42. Bazuar në atë që u tha më lart, Gjykata përfundon se parashtruesi nuk i ka dëshmuar pretendimet për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mbrojtje të pronës. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2), (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 31 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI18/15, Parashtrues "Iming" D.O.O. pronar Rrustem Zogaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0357-A0001, të 5 shkurtit 2015

KI18/15, Aktvendim për papranueshmëri i 31 gushtit 2015 publikuar, më 23 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, kërkesë e parakohshme, Masë e përkohshme, procesi i privatizimit, tërheqje e aksioneve, urdhër paraprak gjyqësor, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, parimi i barazisë*

Kolegji i Apelit i Gjykatës Supreme kishte refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruesit përkitazi me tërheqjen e aksioneve të tij në një ndërmarrje shoqërore nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, si dhe për vënien e masave të përkohshme (urdhër paraprak gjyqësor) ndaj veprimeve të mëtejme të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese, kryesisht për shkelje të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe mbrojtje të pronës. Parashtruesi, po ashtu, kërkoi vënien e Masës së përkohshme ndaj veprimeve të mëtejme tëAgjencisë Kosovare e Privatizimit.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se kërkesa e parashtruesit ndaj vendimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit është i parakohshëm, ndërsa pretendimet e tij përkitazi me refuzimin e propozimit të parashtruesit për urdhër paraprak gjyqësor është e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse ai nuk i ka arsyetuar pretendimet e tij për shkelje të parimit të barazisë, mbrojtjes së pronës dhe të drejtës se tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.Gjykata Kushtetuese, po ashtu, refuzoi kërkesën e parashtruesit për vënien e Masës së përkohshme. Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar dhe të parakohshme në pajtim me nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (b) dhe 36 (2) (b) dhe (d) dhe 56 (2) dhe (3) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI18/15
Parashtrues
"Iming" D.O.O.
pronar Rrustem Zogaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0357-A0001,
të 5 shkurtit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është kompania "Iming" D.O.O., me seli në Stobec të Republikës së Kroacisë, pronar i të cilës është z. Rrustem Zogaj. Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga z. Sahit Bibaj dhe z. Gafurr Elshani, avokatë në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i DHPGJS), AC-I-14-0357-A0001, i 5 shkurtit 2015, me të cilin vërtetohetAktvendimii Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar i DHPGJS), C-I-14-0022, i 19 nëntorit 2014 për refuzimin e propozimit të parashtruesit për nxjerrjen e urdhrit paraprak gjyqësor.

3. Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 9 shkurt 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjessë kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të lartpërmendur të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, me të cilin ankesa e parashtruesit kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së ishte refuzuar si e pabazuar.

5. Kolegji i Specializuar i DHPGJS, kishte refuzuar propozimin e parashtruesit për nxjerrjen e urdhrit paraprak gjyqësor, nëpërmjet të cilit parashtruesi kishte kërkuar pezullimin e përkohshëm të vendimeve të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për tërheqjen e aksioneve dhe vendosjen e Ndërmarrjes së Re MIM "Golesh" nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

6. Parashtruesigjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) që të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht *"NDALIM TE EKZEKUTIMIT TE VENDIMEVE TE AKP-së, me nr. Ref. BD-69/35, të dt. 31 gusht 2014, Vendimi Bd-69/36, i po të njëjtës datë, si dhe aktvendimet e Kolegjit të Specializuar te Dhomës së Veçantë te Gjykatës Supreme te Kosovës, C-I-14-0022, i dt. 19.11.2014 dhe aktvendimit te Kolegjit te ankesave të njëjtës Dhomë, me nr. AC-I-14-0357-A0001, i dt. 05.02.2015, deri në vendosje definitive nga Gjykata".*

Baza juridike

7. Kërkesa bazohetnë nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin emëtejmë: Kushtetuta), nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 si dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

8. Më 19 shkurt 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

9. Më 12 mars 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI18/15, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI18/15, caktoi Kolegjin shqyrtues,

të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

10. Më 30 mars 2015, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës DHPGJS dhe AKP-së.

11. Më 26 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI18/15 për zëvendësimin e gjyqtarit raportues të këtij rasticaktoi Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI18/15, në vend të Enver Hasanit, të cilit i ka përfunduar mandati i gjyqtarit të Gjykatës më 26 qershor 2015, caktoi Arta Rama-Hajrizin anëtare në Kolegjin shqyrtues.

12. Më 2 korrik 2015, Kolegjishqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 11 dhjetor 2007, pas përfundimit të procesit të privatizimit nëpërmjet procedurës së Spin-Off-it special, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM-ja), lidhi kontratë me parashtruesin e kërkesës për t'i shitur këtij tërë kapitalin aksionar të Ndërmarrjes së Re MIM "Golesh" SHPK (në tekstin e mëtejmë: MIM "Golesh").

14. Kontrata e lidhur në mes të AKM-së dhe parashtruesit të kërkesës, detyronte parashtruesin që të përmbushë disa kushte të caktuara, të parapara në marrëveshjen e zotimeve. Në mesin e atyre kushteve, ishin zotimet për të realizuar investime të caktuara financiare, dhe punësimin e një numri të caktuar të punëtorëve brenda një afati të caktuar kohor. Mospërmbushja e këtyre obligimeve mund të rezultonte në tërheqjen e aksioneve.

15. Sipas shkresave të lëndës del se AKP-ja, si pasardhëse ligjore e AKM-së, gjatë vitit 2009, për arsye të mospërmbushjes së zotimeve të përcaktuara në Marrëveshjen e zotimeve brenda kohës së caktuar, kishte caktuar një zgjatje të afatit për 2 (dy) vjet, afat që kishte përfunduar në vitin 2011.

16. Në vitin 2012, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me arsyetimin e mospërmbushjes së zotimeve nga ana e parashtruesit kishte nxjerrë vendim për tërheqjen e aksioneve, vendim i cili më pas ishte pezulluar duke i dhënë parashtruesit edhe një afat prej 41 muajsh, për përmbushjen e zotimeve. Ky afat do të përfundonte në muajin tetor të vitit 2015.

17. Mirëpo, para skadimit të afatit të lartpërmendur, përkatësisht më 31 gusht 2014, Bordi i Drejtorëve të AKP-së (Vendimi Nr. BD-69/35), me arsyetimin se parashtruesi nuk kishte vepruar në përputhje të plotë me zotimet që ishin të përcaktuara në Marrëveshjen e zotimeve, mori vendim për ekzekutimin e Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 16 dhjetorit 2011, për tërheqjen e aksioneve të Ndërmarrjes së Re MIM "Golesh" SHPK.

18. Të njëjtën ditë, Bordi i Drejtorëve të AKP-së (Vendimi Nr. BD-69/36) mori vendim për vënien e Ndërmarrjes së Re MIM "Golesh" SHPK nën administrimin e AKP-së.

19. Më 23 tetor 2014, Ushtruesi i detyrës së zëvendësdrejtorit menaxhues të AKP-së, nxori vendim për zbatimin e dy vendimeve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 gushtit 2014.

20. Më 30 tetor 2014, parashtruesi paraqiti në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS -së propozimin përnxjerrjen e urdhrit paraprak gjyqësor, përkatësisht pezullimin e përkohshëm të vendimeve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 gushtit 2014.

21. Më 3 nëntor 2014, parashtruesi po ashtu parashtroi padi në DHPGJS për anulimin e vendimeve të lartpërmendura të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 gushtit 2014. Bazuar në shkresat e lëndës, padia e parashtruesit është ende në shqyrtim e sipër në DHPGJS.

22. Më 19 nëntor 2014, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së (Aktvendimi, C-I-14-0022) refuzoi propozimin e parashtruesit për nxjerrjen e urdhrit paraprak gjyqësor si të pabazuar.

23. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së në Aktvendimin e tij vlerësoi se parashtruesi *"[...] nukka arritur të vërtetojë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme për të pezulluar veprimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së qe parashtruesi e konteston përmes padisë së tij"*.

24. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së më tej konstatoi se, *"Bazuar në vlerësimin e pretendimeve të pakontestuara të paditësit dhe me qëllim të vendosjes së kërkesës për urdhër paraprak gjyqësor duke lërë të hapur çfarëdo vlerësimi në cështjen kryesore, gjykata vjen në përfundim se veprimi nga ana e AKP-së për të tërhequr aksionet e paditësit në ndërmarrjen " Golesh" duket të jetë e ligjshme, duke mos shkaktuar dëm fare, prandaj nuk ka nevojë të pezullohet fare"* .

25. Si rrjedhojë, Kolegji i Specializuar përfundoi se hyrja në fuqi e vendimeve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së *"nuk shkakton ndonjë dëm që të ketë nevojë të kompensohet më vonë"*.

26. Më 25 nëntor 2014, kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së për refuzimin e nxjerrjes së urdhrit paraprak gjyqësor, parashtruesi ushtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS.

27. Në ankesën e tij, parashtruesi kërkoi që të anulohet Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar dhe Kolegji i Apelit të konstatojë që vendimet e Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 gushtit 2014 janë *"janë antiligjore dhe janë marrë në kundërshtim me procedurat ligjore në fuqi"*. Parashtruesi më tej ka pretenduar se, vendimmarrja në Bordin e Drejtorëve të AKP-së nuk është zhvilluar sipas dispozitave ligjore në fuqi.

28. Më 5 shkurt 2015, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së (Aktvendimi, AC-I-14-0357-A0001) ankesën e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar.

29. Në Aktvendimin e tij, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së vlerësoi se pretendimet ankimore të parashtruesit se vendimet e Bordit të Drejtorëve të AKP-së duhet të merren me shumicë të kualifikuar të votave, me më së paku 5 (pesë) anëtarë të Bordit, janë të pabazuara.

30. Kolegji i Apelit i DHPGJS më tej konstatoi se, vlerësimi i Kolegjit të Specializuar se *"blerësi nuk do të ketë ndonjë dëm"* është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi duke arsyetuar se një dëm financiar gjithmonë mund të kompensohet. Si rrjedhojë, Kolegji i Apelit përfundoi se:

> *"Duke u bazuar në atë që u arsyetua më lart, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa e paditësit është e pabazuar, dhe rrjedhimisht vërtetohet aktvendimi i Kolegjit të Specializuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.*
>
> *Ky Aktvendim i Kolegjit të Apelit ka të bëjë vetëm me masën e përkohshme dhe nuk mund të ketë asnjë prejudikim për zgjidhjen përfundimtare të padisë"*.

31. Bazuar në shkresat e lëndës, del se padia e parashtruar nga parashtruesi është ende në procedurë të shqyrtimit pranë Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon se me Aktvendimet e Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], paragrafi 2, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe të drejtat e tij të garantuara me nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ).

33. Parashtruesi pretendon se Bordi i Drejtorëve të AKP-së, Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit të DHPGJS-së me aktvendimet e kontestuara kanë bërë shkelje të rëndë ligjore, për arsye se Vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së për tërheqjen e aksioneve, i 31 gushtit 2014 është nxjerrë para skadimit të afatit për përmbushjen e zotimeve, afat që ishte zgjatur me vendim të Bordit të Drejtorëve deri në tetor të vitit 2015. Parashtruesi, ndër të tjera, më tej pohon se të gjitha veprimet e Bordit të Drejtorëve ndërlidhen me faktin se "*AKM-AKP-ja nuk i kanë dhënë parashtrueses së kërkesës pëlqimin për lënien në hipotekë të paluejtshmërisë për sigurimin e investimeve kapitale, që nënkupton se e drejta e fituar përmes privatizimit ishte kufizuar nga AKM-AKP-ja [...]*".

34. Lidhur me pretendimin e parashtruesit për shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, parashtruesi pohon se palët në procedurë, nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë. Parashtruesi shton më tej se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së ka konstatuar se, vendimmarrja në këtë rast duhet të zhvillohet me shumicë të kualifikuar, dhe se në rastin konkret, njëri vendim është marrë me katër vota për dhe me një abstenim, ndërsa vendimi tjetër është marrë më pesë vota pozitive.

35. Në këtë drejtim, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që t'i shfuqizojë aktvendimet e kontestuara të Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së dhe "*rasti të rigjykohet sa i përket masës së sigurisë në atë mënyrë që ankuesi* [parashtruesi] *të kthehet ne asetet e blera te cilat i janë marrë nen kontroll nga AKP[...]*".

36. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht të pezullojë ekzekutimin e Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 gushtit 2014, si dhe të Aktvendimeve të Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga DHPGJS.

Pranueshmëria e kërkesës

37. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

38. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

Pretendimet e parashtruesit lidhur me vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së

39. Ashtu siç u përmend më lart, parashtruesi pohon se Vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së për tërheqjen e aksioneve, i 31 gushtit 2014 është nxjerrë para skadimit të afatit për përmbushjen e zotimeve, dhe se vendimmarrja në Bordin e Drejtorëve të AKP-së është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të AKP-së.

40. Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës pas parashtrimit të propozimit për nxjerrjen e urdhrit paraprakgjyqësor, po ashtu ka parashtruar padi në DHPGJS për anulimin e Vendimeve të lartpërmendura të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 gushtit 2014. Padia e parashtruesit është ende në shqyrtim e sipër pranë Kolegjit të Specializuar të DHPGJS.

41. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh: "*Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*".

42. Në këtë rast, Gjykata po ashtu merr parasysh rregullin 36 (1), (b) të Rregullores së punës:

> *(1) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse*
>
> *[...]*
>
> *(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar.*
>
> *[...]*

43. Duke marrë për bazë faktin, që padia e parashtruesit është akoma në shqyrtim e sipër pranë DHPGJS-së, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës pretendimet e tij lidhur me mënyrën e vendimmarjes nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së mund t'i adresojë edhe gjatë procedurës së shqyrtimit të padisë së tij në DHPGJS. Bazuar në këtë, Gjykata vlerëson se këto pretendime janë të parakohshme, për arsye se duhet dhënë mundësia gjykatave të rregullta, përkatësisht DHPGJS-së për të përfunduar procedurat lidhur me padinë e parashtruesit që janë në vazhdim e sipër.

44. Qëllimi i rregullimit të shterimit të mjeteve juridike, është që në këtë rast t'u ofrohet gjykatave tërregullta mundësia e rregullimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se, rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete juridike kundër shklejve të të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës. (Shih rastin 41/09, parashtrues: *AAB – RIINVEST L.L.C.*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri i 21 janarit 2010, dhe shih, *Selmouni kundër Francës*, Nr. 25 803/94, GJEDNJ, Aktvendim i 28 korrikut 1999).

45. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, administrative ose gjyqësore, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka, të rregullohet shkelja e tillë e të drejtave themelore (Shih rastin Kl07/09, parashtrues: *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 19 majit 2010).

46. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të vlerësojë shkeljet e pretenduara kushtetuese, pa iu dhënë mundësia gjykatave të rregullta, përktësisht DHPGJS-së për të përfunduar procedurat lidhur me padinë e parashtruesit që janë në vazhdim e sipër dhe për t'i korrigjuar shkeljet e pretenduara.

47. Prandaj, Gjykata përfundon që pretendimet e parashtruesit lidhur me përmbajtjen dhe mënyrën e vendimmarrjes së Bordit të Drejtorëve të AKP-së janë të parakohshme.

Pretendimet lidhur me Aktvendimet e DHPGJS për refuzimin e propozimit për urdhër paraprak gjyqësor

48. Ashtu siç u përmend më lart, parashtruesi i kërkesës konteston aktvendimet e Kolegjit të Specializuar dhe të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së përkitazi me propozimin e tij për urdhër paraprak gjyqësor, duke pretenduar se i janë shkelur të drejtat e tij me nenin 3

[Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], paragrafi 2, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe të drejtat e tij të garantuara me nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së) dhe nenin 10 të DUDNJ.

49. Lidhur me këtë, Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

50. Gjykata i referohet edhe rregullit36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se*:
>
> *[...]*
>
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

51. Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS në aktvendimin e tij konstatoi që vlerësimi i Kolegjit të Specializuar se parashtruesi nuk do të ketë ndonjë dëm, është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, duke arsyetuar se një dëm financiar gjithmonë mund të kompensohet. Kolegji i Apelit, pa paragjykim ndaj vendimit lidhur me padinë e parashtruesit pranë DHPGJS-së përfundoi se ankesa e parashtruesit përkitazi me propozimin e tij për urdhër paraprak gjyqësor është e pabazuar, duke vërtetuar aktvendimin e Kolegjit të Specializuar si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

52. Gjykata konsideron se fakti i thjeshtë që parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta, nuk është i mjaftueshëm që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese (Shih, *mutatis mutandis,* rastin *Mezőtúr-Tiszazugi Vízgazdálkodási Társulat kundër Hungarisë,* Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21). Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës (Shih rastin KI198/13,parashtrues i kërkesës:*Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014).

53. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga GjykataSupreme, përveç, dhe për aq, sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund ta zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

54. Për më tepër, siç u përmend më lart, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së për refuzimin e nxjerrjes së urdhrit paraprak gjyqësor është i qartë dhe, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata ka gjetur se procedurat e përfunduara në Kolegjin e Specializuar dhe Kolegjin e Apelit të DHPGJS sa i përket urdhrit paraprak gjyqësor nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).

55. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

56. Prandaj, kërkesa e parashtruesit lidhur me pretendimet e tij përkitazi me refuzimin e propozimit të parashtruesit për urdhër paraprak gjyqësor janë qartazi të pabazuara.

57. Si përfundim, bazuar nëarsyetimet e lartpërmendura Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit:

A. Në pjesën e kërkesës së parashtruesit përkitazi me pretendimet e tij lidhur me përmbajtjen dhe mënyrën e vendimmarrjes së Bordit të Drejtorëve të AKP-së është e papranueshme si e parakohshme.

B. Ndërsa pjesa e kërkesës së parashtruesit lidhur me pretendimet e tij, përkitazi me refuzimin e propozimit të parashtruesit për urdhër paraprak gjyqësor është e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse ai nuk i ka arsyetuar pretendimet e tij për shkelje të parimit të barazisë, mbrojtjes së pronës dhe të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç referohen nga parashtruesi i kërkesës.

Kërkesa për Masë të përkohshme

58. Parashtruesi kërkonnga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, gjegjësisht të pezullojë ekzekutimin e Vendimeve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 gushtit 2014 dhe Aktvendimeve të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS (Aktvendim, C-I-14-0022, i 19 nëntorit 2014) përkitazi me refuzimin e propozimit të parashtruesit për urdhër paraprak gjyqësor dhe atij të Kolegjit të Apelit (Aktvendim, AC-I-14-0357-A0001, i 5 shkurtit 2015).

59. Parashtruesi pohon se vendosja e Masës së përkohshme është e nevojshme: *"[...] ngase është pamundësua disponimi me mjetet dha makineri e investuara me miliona, janë larguar qindra punëtor nga puna, është dëmtuar pervec interesat te investitorit të jashtem investimi i të cilit garantohet me ligjin për investimet e huaja në Kosove, ankuesi konsideron se është dëmtuar dhe dëmtohet edhe interesi publik me largim masiv të punetore nga puna për të cilët ankuesi ka investuar edhe në kualifikimet specifike të tyre pervec pagesave të pagave, dhe kemi edhe dëmtim të aseteve pasurisë e cila ka mbet pa mbikëqyrje dhe kujdes".*

60. Përveç kësaj, në mënyrë që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, duhet të gjejë që:

> *"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
>
> *(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dështuar se do të pësojë dëme të paripareueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme...".*

61. Siç u konstatua më lart, kërkesa është e papranueshme për arsye se pretendimet e parashtruesit përkitazi me mënyrën e vendimmarrjes nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së janë të parakohshme, përderisa pretendimet e tij lidhur me Aktvendimet e Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit përkitazi me nxjerrjen e urdhrit paraprak gjyqësor janë qartazi të pabazuara.

62. Për më tepër, Gjykata rithekson se kërkesa për vendosjen e Masës së përkohshme duhet argumentuar mbi baza reale të shkaktimit të rrezikut apo të dëmit të paripareueshëm, vlera e të cilit është e pakompensueshme në kuptimin material dhe në të holla (Shih rastin

KI187/13, parashtruese *N. Jovanović*, Gjykata Kushtetuese, Aktgjykim i 16 prillit 2014, paragrafi 74).

63. Prandaj, kërkesa e parashtruesit për vendosjen e Masës së parakohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 27, 47.2 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1), (b) dhe (d), 36 (2) (b) dhe (d), 55 (4), si dhe 56 (2) dhe (3) të Rregullores së punës, më 31 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI19/15, Arif Kryeziu - Vlerësim i kushtetutshmërisë së kërkesës për përfshirje në procedurën e privatizimit

KI19/15, Vendim për heqje të kërkesës nga lista i 4 shtatorit 2015, publikuar më 23 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e papranueshme, procesi i privatizimit, prima facie*

Në këtë rast, parashtruesi nuk konteston asnjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik. Ai vetëm kërkon përfshirjen e tij në listën e punëtorëve që kanë të drejtë të përfitojnë nga 20% i të ardhurave nga privatizimi i NTSH "Liria" nga Prizreni.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se nuk mund t'i marrë për bazë pretendimet e parashtruesit pa saktësim të aktit konkret të ndonjë autoriteti publik, si dhe pa dokumente dhe pa prova materiale mbështetëse dhe se parashtruesi nuk ka treguar rast *prima facie* për përmbushjen e kritereve procedurale të pranueshmërisë. Kërkesa u refuzua me procedurë të shkurtër dhe u hoq nga lista, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës.

VENDIM
PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA
në
Rastin nr. KI19/15
Parashtrues
Arif Kryeziu
Vlerësim i kushtetutshmërisë së kërkesës për përfshirje në procedurën e privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Arif Kryeziu (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), nga fshati Sapniq, komuna e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi nuk konteston asnjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik. Ai vetëm kërkon përfshirjen e tij në listën e punëtorëve që kanë të drejtë të përfitojnë nga 20%-shi i të ardhurave nga privatizimi i NTSH "Liria" nga Prizreni (në tekstin e mëtejmë: NTSH "Liria").

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes ka të bëjë me *"mospërfshirje të parashtruesit në listën e punëtorëve që përfituan nga 20%-shi i të ardhurave nga privatizimi i NTSH 'Liria'"*, gjë që pretendohet se i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht me *"nenin 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues], nenin 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], nenin 60 [Këshilli Konsultativ për Komunitete], nenin 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve], nenin 106 [Papajtueshmëria], nenin 117*

[Imuniteti] dhe nenin 159 [Pronat dhe Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore] [Neni 159 është fshirë me amendamentin 20 të Kushtetutës]."

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 shkurt 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 mars 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI19/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI19/15, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 26 mars 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë vendimin e fundit të cilin e konteston dhe dokumentet e tjera relevante.

8. Më 7 prill 2015, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë një deklaratë shtesë lidhur me rastin e tij, por nuk dorëzoi asnjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik.

9. Më 5 maj 2015, Gjykata, me një kërkesë të ripërsëritur, e njoftoi parashtruesin se në rast se brenda 7 (shtatë) ditësh nga pranimi i kësaj shkrese nuk dorëzon dokumentet e kërkuara, Gjykata do të vendosë rastin në bazë të dokumentacionit që ka në dispozicion.

10. Më 14 maj 2015, parashtruesi iu përgjigj shkresës së Gjykatës, mirëpo nuk dorëzoi dokumentet e kërkuara.

11. Më 8 korrik2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës ka qenë i punësuar në cilësinë e rojtarit në NTSH "Liria".

13. Më 9 tetor 2014, parashtruesi ka parashtruar një letër në Prokurorinë Publike në Prizren, të cilën e ka cilësuar si padi kundër palës së tretë. Në kërkesën e tij, parashtruesi kishte theksuar:

> *"[...] Vetëm pse nuk jam me kombësi shqiptare më kanë anashkaluar dhe nga privatizimi i kësaj firme nuk më kanë dhënë atë që më takon pra 20%. Vite të tëra kërkoj por jam refuzuar si nga AKP-ja* [Agjencioni Kosovar i Privatizimit] *po ashtu edhe nga [...] si person zyrtar në NTP-'Liria'".*

14. Gjykata nuk ka pranuar asnjë vendim që ndërlidhet me kërkesën e parashtruesit drejtuar Prokurorisë Publike në Prizren, apo ndonjë vendim tjetër që mund të jetë i lidhur me rastin e parashtruesit në përgjithësi.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 27, 41, 60, 78, 106, 117 dhe 159 të Kushtetutës.

16. Lidhur me këto pretendime, parashtruesi thekson: *"Pas privatizimit te kesaj firme Liria, mua me eshte cenuar e drejta njerëzore vetem pse nuk jame Kombesi Shqiptare dhe nuk jame fut ne listen e 20%, qe me takon ashtu si qdo punëtor tjeter".*

17. Në përfundim, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën si në vijim: *"Kërkoj të aprovohet lënda në favor timin dhe të gëzoj 20% që më takon".*

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë [...]".*

20. Më tutje, Gjykata i referohet dispozitave vijuese të Ligjit:

Neni 22.4 [Procedimi i kërkesave]

"4. Nëse kërkesa [...] nuk është e [...] kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të plotësuar kërkesën [...]".

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se [...] cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

21. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 29 (2) [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] dhe rregullit 32 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

"(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:
[...]
(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës."

"(5) Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është e jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose ta qartësojë kërkesën [...]."

22. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi ankohet në mënyrë të përgjithshme, për faktin se ai nuk ishte përfshirë në listën e punëtorëve që kanë përfituar nga 20%-shi i të ardhurave me rastin e privatizimit të NTSH "Liria". Lidhur me këtë, ai pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 27, 41, 60, 78, 106, 117 dhe 159 të Kushtetutës.

23. Megjithatë, Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi nuk ka saktësuar dhe nuk ka dorëzuar në Gjykatë asnjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik, i cili mund t'i ketë shkelur të drejtat e lartpërmendura.

24. Gjykata, bazuar në nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe në rregullat 29 (2) (h) dhe 32 (5) të Rregullores së punës, kërkoidyherë nga parashtruesi që të dorëzojë vendimin e fundit të kontestuar si dhe dokumentet e tjera relevante që ndërlidhen me rastin e tij.

25. Megjithatë, brendaafatit të përcaktuar, Gjykata nuk ka pranuar asnjë vendim të gjykatave të rregullta, përveç dy deklaratave shtesë të parashtruesit si dhe një aktvendim të NTSH "Liria" të vitit 1999 që kishte të bënte me punësimin e tij.

26. Duke pasur parasysh këtë që u tha më lart, Gjykata konsideron se nuk mund t'i marrë për bazë pretendimet e parashtruesit, pa saktësim të aktit konkret të ndonjë autoriteti publik, si dhe pa dokumente dhe pa prova materiale mbështetëse, ashtu siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 29 (2) (h) të Rregullores së punës.

27. Për më tepër, Gjykata thekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e kërkesës.

28. Në të vërtetë, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka treguar rast *prima facie*, në mënyrë që Gjykata të vlerësojë përmbushjen e kritereve të tjera procedurale të pranueshmërisë, siç kërkohet me nenin 22.4 të Ligjit dhe me rregullat 29 (2) (h) dhe 32 (5) të Rregullores së punës.

29. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër dhe, si e tillë, të hiqet nga lista.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim rregullat 29 (2) dhe 32 (5) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA HEQË kërkesën nga lista;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI31/15, Parashtrues Tomislav Ilić - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ka. nr. 2/111/ 2015, i 4 shkurtit 2015

KI31/15, Aktvendim për papranueshmëri i 6 korrikut 2015,të publikuar më 29 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, kundërvajtje, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shërbimi doganor, shpëlarje e parave*

Gjykata e Apelit e Kosovës, kishte hedhur poshtë të paafatshme kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, të vendimit të plotfuqishëm përkitazi me kryerjen e veprës penale të kundërvajtjes nga neni 29.4 i Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar në shkelje të së drejtës për gjykim të dejtë dhe të paanshëm dhe qasjes në Gjykatë.

Gjykata Kushtetuese vërejti senë këtë rast nuk ka asgjë që tregon se parashtruesi i kërkesës, në kohën e duhur, ka kontestuar në gjykatat e rregullta nëse ka pasur zbatimarbitrar të procedurave ligjore në dëm të parashtruesit dhe se ai nukka dëshmuar, që vendimi i kontestuar shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI31/15
Parashtrues
Tomislav Ilić
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ka. nr. 2/III/ 2015, të 4 shkurtit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Tomislav Ilić (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Nish, Republika e Serbisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ka. nr 2/III/2015, të 4 shkurtit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Ka. nr 2/III/ 2015] të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 4 shkurtit 2015.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 mars 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI31/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI31/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Enver Hasani dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 21 maj 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës. Njëkohësisht, kërkoi nga Gjykata e Apelit informata shtesë lidhur me pretendimet e parashtruesit se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, i 4 shkurtit 2015, nuk i është dorëzuar asnjëherë fizikisht.

8. Më 28 maj 2015, Gjykata e Apelit u përgjigj në kërkesën e Gjykatës.

9. Më1 korrik 2015, meVendimin GJR. KI31/15, Kryetarja e Gjykatëscaktoi gjyqtarinAltay Suroyanëtar tëKolegjit shqyrtuesnë vend të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit i përfundoi mandati në Gjykatën Kushtetuesemë 26 qershor2015.

10. Më 7 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 17 shtator 2012, zyrtarët e Doganës së Kosovës, në vendkalim kufitar, ia morën parashtruesit një shumë të caktuar të mjeteve monetare në vlerë, e cila sipas nenit 29 të Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit, nr. 03/L-196, duhet të kishte qenë e deklaruar para shërbimit kompetent doganor gjatë hyrjes apo gjatë daljes nga territori i Kosovës.

12. Më 25 qershor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, mori Aktvendim [Reg. nr. 10118/12-2], me të cilin e shpalli parashtruesin e kërkesës përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes nga neni 29.4 të Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Në konkludimin e Aktvendimit thuhet: *„Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit”*.

13. Më 18 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet përfaqësuesit të tij juridik, z. Ž. J., paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktvendimit [Reg. nr. 10118/12-2] të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, të 25 qershorit 2014.

14. Më 5 gusht 2014, Gjykata e Apelit mori Aktvendim [PO. nr. 713/2014], me të cilin e hodhi poshtë si të paafatshme ankesën e përfaqësuesit juridik të parashtruesit, z. Ž. J., në pajtim me nenin 216 të Ligjit për Kundërvajtje (në tekstin e mëtejmë: LK).

15. Më 1 dhjetor 2014, parashtruesi paraqiti kërkesë në Gjykatën e Apelit, në të cilën kërkoi rishqyrtimin e Vendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, të 25 qershorit 2014, dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, të 5 gushtit 2014.

16. Më 4 shkurt 2015, Gjykata e Apelit mori Aktvendim [KA. nr. 2/III/2015], me të cilin e hodhi poshtë si të pasafatshme kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktvendimit të plotfuqishëm, me këtë arsyetim: *"Sipas dispozitës së nenit 237 të LK-së, është paraparë se kërkesa për rishqyrtim të aktvendimit të formës së prerë mund të paraqitet brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur aktvendimi ka marrë formën e prerë, dhe duke pasur parasysh se parashtruesi përmes përfaqësuesit juridik e pranoi aktvendimin më 16 gusht 2014, i cili fakt dëshmohet me anë të librit të dërgesave postare, ndërsa kërkesën për rishqyrtim të aktvendimit e ka dërguar përmes postës më 1 dhjetor 2014, del se kërkesa për rishqyrtim të aktvendimit të formës së prerë është paraqitur pas afatit të përcaktuar, prandaj e njëjta u hodh poshtë".*

Ligji relevant

17. Ligji për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Nr. 03/L-196:

> Neni 29. Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës – Detyrimi për të deklaruar
>
> *"1. Secili person i cili hyn ose del nga Kosova dhe i cili bart mjete monetare në një vlerë që tejkalon shumën prej dhjetëmijë (10.000) euro apo më shumë duhet të paraqesë me shkrim shumën e mjeteve monetare dhe burimin e tyre në një formë e cila duhet të përcaktohet nga Doganat e Kosovës, para nëpunësit të autorizuar dhe nëse kjo kërkohet nga nëpunësi, ai duhet ti paraqesë këto mjete monetare [...]".*

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në procedurën e rregullt nuk pati mundësi t'ua parashtrojë pyetje dëshmitarëve, se gjykatat nuk ia kishin dorëzuar aktvendimet, si dhe që nuk pati mundësi për t'i paraqitur ankesat.

19. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të prishë Aktvendimin [Reg. nr. 10118/12-2] e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, të 25 qershorit 2014, dhe Aktvendimin [PO. nr. 713/2014] e Gjykatës së Apelit, të 5 gushtit 2014, apo t'i ndryshojë vendimet dhe ta pezullojë procedurën, si dhe ta lirojë parashtruesin e kërkesës nga përgjegjësia.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse kërkesa ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë kuptim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës përcakton:

> *"Individët janë autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

22. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit, përcakton:

> *„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

23. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) d) dhe (2) d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(1) "Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

24. Gjykata vëren se parashtruesi e ka ndërtuar ankesën e tij kushtetuese mbi pretendimet se ai në procedurën e rregullt është penguar t'i ndërmarrë veprimet e parashikuara me ligj, gjë e cila, siç thuhet, ka shkaktuar shkeljen e nenit 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

25. Gjykata, duke analizuar shkresat e lëndës të dorëzuara nga Gjykata e Apelit më 28 maj 2015, konstatoi se parashtruesi, më 19 shtator 2012, autorizoi përfaqësuesin juridik, i cili sipas autorizimit ka qenë i autorizuar për t'i ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale të lejuara me ligj dhe për paraqitjen e mjeteve të përcaktuara juridike brenda afatit të paraparë me ligj.

26. Gjykata vëren më tej se në bazë të fletëdorëzimit Nr. 10.118/12.2, vendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës-Dega në Podujevë, i 25 qershorit 2014, i është dorëzuar përfaqësuesit të parashtruesit më 9 korrik 2014, ndërsa, në bazë të fletëdorëzimit Nr. 10.118/12.2, vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, i 4 shkurtit 2015, i është dorëzuar përfaqësuesit të parashtruesit më 30 mars 2015.

27. Sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Ka. nr. 2/III/ 2015] të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 4 shkurtit 2015, Gjykata konsideron se në procedurën para Gjykatës së Apelit është vendosur mbi ekzistencën e kushteve ligjore për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë, dhe se nuk është vendosur mbi esencën e kontestit, respektivisht nuk është vendosur mbi meritat sipas kërkesës së parashtruesit.

28. Sipas vlerësimit të Gjykatës, Gjykata e Apelit e ka bazuar Aktvendimin e saj [KA. nr. 2/III/2015], me të cilin e kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit, të 4 shkurtit 2015, në dispozitën relevante ligjore të nenit 237 të LK, e cila parashikon:

„Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm paraqitet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm paraqitet me shkrim në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje".

29. Rrjedhimisht, në këtë rast nuk ka asgjë që tregon se parashtruesi i kërkesës, në kohën e duhur, ka kontestuar në gjykatat e rregullta nëse ka pasur zbatim arbitrar të procedurave ligjore në dëm të parashtruesit.

30. Gjykata më tej ripërsërit se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih, gjithashtu, rastin KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

31. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kërkesat për pranueshmëri, duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar që vendimi i kontestuar shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë ose me KEDNJ.

32. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI39/15, Parashtrues Fetije Haliti - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP. nr. 4/2015, i 27 shkurtit 2015

KI39/15, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shtatorit 2015, publikuar më 29 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shfrytëzim i banesës me qira, përkujdesje sociale*

Gjykata Supreme kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paraqitur nga parashtruesja e kërkesës, përkitazi me dhënien e një banese me qira për rastet sociale. Parashtruesja u ankua në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar në shkelje të së drejtës për gjykim të dejtë dhe të paanshëm.

Gjykata Kushtetuese vërejti se arsyetimi i dhënë në vendimin e kontestuar është i qartë dhe shikuar në tërësi, procedurat pranë gjykatave të rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare dhe se, parashtruesja nuk i ka mbështetur pretendimet e saj dhe nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi që*prima facie,* do t'i arsyetonte këto pretendime për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI 39/15
Parashtrues
Fetije Haliti
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP. nr. 4/2015, të 27 shkurtit 2015.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, Kryetare
Ivan Čukalović, zv. Kryetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, Gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Fetije Haliti (në tekstin në vijim: parashtruesja), nga fshati Kushevicë, Komuna e Podujevës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimit i Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP. nr. 4/2015, i 27 shkurtit 2015, të cilin parashtruesja pohon se e ka pranuar më 14 mars 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesja pretendon se i janë shkelur të drejtat kushtetuese, pa specifikuar ndonjë dispozitë konkrete të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Kushtetuta).

Baza Juridike

4. Bazë e parashtrimit të kërkesës është neni 113 (7) i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit, dhe rregulli 56 i Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 mars 2015, parashtruesja dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar.

6. Më 22 prill 2015, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin Nr. GJR. KI 39/15, caktoi Gjyqtarin Altay Suroy si Gjyqtar Raportues. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin Nr. KSH. KI 39/15, caktoi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga Gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Enver Hasani dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 18 maj 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.

8. Më1 korrik 2015, meVendimin Nr.K.SH.KI 39, Kryetarja e Gjykatëscaktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu anëtar tëKolegjit shqyrtuesnë vend të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit i ka përfunduar mandati në Gjykatën Kushtetuesemë 26 qershor2015.

9. Më 10 shtator 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 30 shtator 2010, Komisioni për dhënien e banesave të Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: Komisioni) në shfrytëzim me qira për rastet në përkujdesje sociale, përmes Njoftimit nr. 02. nr. 360-254, ka informuar parashtruesen se është refuzuar kërkesa e saj për dhënie të banesës në shfrytëzim me qira për rastet në përkujdesje sociale, me arsyetimin se nuk përbënë një rast social.

11. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja përmes padisë së parashtruar pranë Gjykatës Supreme të Kosovës për hapjen e konfliktit administrativ, kontestoi Njoftimin e lartëcekur për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të dispozitave ligjore.

12. Më 29 nëntor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas padisë së parashtrueses, me Aktgjykimin A. nr. 1074/2011, aprovoi kërkesëpadinë e parashtrueses dhe anuloi Njoftimin e Komisionit 02. nr. 360/254, të 30 shtatorit 2010. Kjo gjykatë *inter alia* arsyeton se:

"Gjykata konstaton se në rastin konkret organi i paditur [Komisioni] *ka shkelur ligjin në dëm të paditësit* [parashtrueses], *sepse vendimi-njoftimi i përmendur nuk mund të konsiderohet i drejtë dhe i bazuar në ligj.*

[...] duhet të jepen domosdoshmërisht arsye për të gjitha ato akte për të cilat pjesërisht ose plotësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë ase prekin në ndonjë mënyrë të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime [...]".

13. Më 27 dhjetor 2011, Avokatura Publike Komunale në Prishtinë parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 1074/2011, të 29 nëntorit 2011, përmes të cilës kërkoi shfuqizimin e këtij aktgjykimi.

14. Më 20 mars 2012, parashtruesja përmes përgjigjes në ankesë, kontestoi ankesën e palës së paditur [Komisionit] me pretendimin se është e pabazuar.

15. Më 10 korrik 2012, Kolegji i Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktgjykimin A.A. nr. 201/2011, refuzoi si të pabazuar ankesën e palës së paditur dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 1074/2011, të 29 nëntorit 2011, me arsyetimin se:

"[...] në kuptim të nenit 11 të LPA [Ligji për Procedurën Administrative], *e paditura ka qenë e detyruar që lidhur me kërkesën e paditëses të vendos me aktvendim[...]".*

16. Më 5 gusht 2012, Komisioni, duke vendosur në procedurën e rishqyrtimit, me Aktvendim e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtrueses 02. nr. 360-254, të 30 shtatorit 2010, me arsyetimin se parashtruesja nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara me Rregulloren për dhënien e banesave për shfrytëzim me qira për rastet në përkujdesje sociale, sepse sipas këtij Komisioni parashtruesja nuk i përket kategorisë së personave që janë raste sociale.

17. Kundër Aktvendimit të Komisionit të 5 gushtit 2012, parashtruesja më 6 nëntor 2012, ka parashtruar padi për hapjen e konfliktit administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, përmes të cilës ka kërkuar anulimin e Aktvendimit në fjalë.

18. Më 22 janar 2013, parashtruesja është ankuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor lidhur me zvarritjen e vendosjes për lëndën e tij, nga Gjykata Supreme e Kosovës (tani Gjykata Themelore në Prishtinë).

19. Më 15 prill 2013, Zyra e Prokurorit Disiplinor përmes shkresës me nr. ZPD/13/zp/290, e informoi parashtruesen se kjo zyrë nuk ka gjetur bazë ligjore për të hapur hetim disiplinor lidhur me ankesën e saj, si dhe e informoi që lënda e në fjalë është ndarë tek gjyqtari dhe është në pritje për t'u vendosur.

20. Më 3 qershor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative duke vendosur sipas padisë së parashtrueses, me Aktgjykimin A. nr. 1126/2012, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e saj. Ndër të tjera, kjo gjykatë arsyeton se:

    "[...] paditësja gjatë vitit 2010 është evidentuar si banore e Komunës së Podujevës, andaj Komisioni me të drejtë ka konstatuar se paditësja nuk e ka përmbushur kriterin e përcaktuar me nenin 7 pika (b) të Rregullores. Poashtu, Komisioni me të drejtë ka konstatuar se paditësja nuk ka qenë në listën e personave apo familjeve që marrin ndihmë sociale nga MPMS-së dhe me rastin e aplikimit nuk e ka dorëzuar Vërtetimin e lëshuar nga Qendra për Asistencë Sociale.

    [...] paditëses i është njohur e drejta në pension të Invalidëve Civil andaj nuk ka mund të marrë ndihma sociale dhe të ketë statutin e rastit social, por megjithatë gjykata vlerëson se ky fakt nuk ka ndikim në fitimin e të drejtës së paditëses për shkak se në konkursin konkret, banesat kanë qenë të dedikuara për rastet sociale e jo për invalidët e luftës[...]".

21. Me një datë të pacaktuar, parashtruesja ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me pretendimin se është bërë vërtetimi jo i plotë dhe i gabuar i gjendjes faktike dhe shkelja e dispozitave materiale e procedurale.

22. Më 7 tetor 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin AA. Nr. 327/2014, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative A. nr. 1126/2012, të 3 qershorit 2014. Kjo gjykatë *inter alia* arsyeton se nuk ka dëshmi se parashtruesja në kohën e aplikimit ka qenë banore e Komunës së Prishtinës së paku pesë vitet e fundit siç parashihet me Rregullore, si dhe e njëjta nuk ka qenë përfituese e ndihmës sociale por ka qenë përfituese e pensionit si invalid civil i luftës.

23. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesja në një datë të pacaktuar ka parashtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

24. Më 11 dhjetor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin Rev. A. nr. 16/2014, hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e parashtrueses për revizion, me arsyetimin se kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës së shkallës së dytë në çështjet administrative pala mund të parashtrojë vetëm kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit, e jo kërkesë për revizion.

25. Më një datë të pacaktuar, parashtruesja parashtroi në Gjykatën Supreme të Kosovës kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AA. nr. 327/2014, të 7 tetorit 2014, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale dhe materiale.

26. Më 27 shkurt 2015, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin ARJ-UZVP. nr. 4/2015, refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtrueses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm. Në këtë vendim, gjykata ndër të tjera arsyeton se:

> *"[...] në datën e aplikimit paditësja nuk ka dëshmi se ka qenë banore e KK Prishtinës, së paku 5 vitet e fundit dhe po ashtu e njëjta nuk ka qenë përfituese e ndihmës sociale."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesja pretendon se Aktgjykimi ARJ-UZVP. nr. 4/2015, i 27 shkurtit 2015, i Gjykatës Supreme të Kosovës shkel të drejtat e saj kushtetuese. Faktikisht, parashtruesja nuk ka precizuar ndonjë dispozitë konkrete të Kushtetutës që pretendon se i është shkelur, por nga rrethanat e rastit supozohet se bëhet fjalë për pretendimin për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.

28. Për më tepër, parashtruesja kërkon si në vijim: *"kërkoi që të më ndahet një banesë për qështje sociale-për viktimat civile të luftës, pasi që jam invalide, e papunë, e pamartuar dhe e mbaj babain tim të smur i vjetër 86 vjeqar, i sëmur dhe banojmë te djemt e tezës në Prishtinë-nga viti 2000".*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

29. Për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara me Ligj dhe me Rregulloren e punës.

30. Në këtë drejtim Gjykata i referohet nenit 113 (7) të Kushtetutës, i cili përcakton se:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

31. Përveç kësaj, neni 47 (2) i Ligjit përcakton se:

"Individi mund ta ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

32. Gjithashtu, Gjykata në këtë rast i referohet edhe rregullit 36 (1) (d) të Rregullores së punës:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]
b) Janë shteruar të gjitha mjetet efektive juridike të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar,

[...]"

33. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesja i ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion sipas ligjit të aplikueshëm, dhe se vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është vendimi i fundit në çështjen e parashtrueses, andaj në këtë kontekst parashtruesja është palë e autorizuar.

34. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh se:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar [...]".

35. Gjithashtu, Gjykata merr në konsideratë rregullat 36 (1) (d), 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, i cili përcakton se:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do ta deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...] ose

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

36. Duke pasur parasysh këtë , Gjykata konsideron se vetë fakti se parashtruesja nuk është e kënaqur me vendimin e kontestuar nuk do të thotë se ky vendim cenon të drejtat kushtetuese të saj.

37. Në këtë kontekst, Gjykata ripërsërit se nuk është detyrë e saj që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në raport me vendimet e gjykatave të rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që duke konstatuar gjendjen faktike, t'i zbatojnë dispozitat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96,* GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI 70/11, *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima,* Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

38. Mandati i Gjykatës Kushtetuese në raport me vendimet e gjykatave të rregullta dhe me vendimet e autoriteteve tjera publike, është vetëm shqyrtimi dhe vlerësimi nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në atë mënyrë që parashtrueses t'i kenë siguruar një gjykim të drejtë (Shih rastin *Edwars kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).

39. Bazuar në shkresat e lëndës së parashtrueses, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në vendimin e kontestuar është i qartë dhe shikuar në tërësi procedurat pranë gjykatave të rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (*mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).

40. Rrjedhimisht Gjykata konsideron se parashtruesja nuk i ka mbështetur pretendimet e saj dhe nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi që *prima facie* do t'i arsyetonte këto pretendime për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

41. Për arsyet e lartëcekura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesja në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e saj për shkeljen e të drejtave kushtetuese, dhe parashtruesja nuk ka dëshmuar

në mënyrë të mjaftueshme, si dhe pse Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë.

42. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtrueses nuk i përmbushë kriteret procedurale për pranueshmëri, për shkak se është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d), 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 25 shtator 2015, njëzëri:

VENDOS

I. TA SHPALLË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI08/15, Parashtrues Haki Hajdari - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, PAKR 966/2012, të 11 shtatorit 2013

KI08/15, Aktvendim për papranueshmëri i 6 korrikut 2015, publikuar më 30 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme, krime lufte, popullata civile, dënim me burgim, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore e të drejtave*

Parashtruesi i kërkesës ishte dënuar nga gjykatat e rregullta për krime lufte ndaj popullatës civile dhe ishte dënuar me 6 (gjashtë) vjet burgim. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse provat e tij nuk ishin përfillur nga gjykatat e rregullta.

Gjykata Kushtetuese vërejti se parashtruesi e dorëzoi kërkesën pas skadimit të afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh. Kërkesa u shpall e papranueshme dhe e paafatshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI08/15
Parashtrues
Haki Hajdari
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit
të Republikës së Kosovës, PAKR 966/2012,
të 11 shtatorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Haki Hajdari (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Skenderaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston aktgjykimet e mëposhtme: Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. Kzz 1/2014, të 7 majit 2014, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR 966/2012, të 11 shtatorit 2013; dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, P. nr. 45/2010, të 29 korrikut 2011. Përderisa Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 30 janar 2012, datat e dorëzimit të aktgjykimeve të tjera janë të panjohura.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së tre aktgjykimeve të lartpërmendura të kontestuara, të cilat, sipas parashtruesit të kërkesës, ishin nxjerrë në shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe të nenit 6 [E drejta për

një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 26 janar 2015, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës. Si duket, parashtruesi e ka dërguar kërkesën e tij nëpërmjet postës në Skenderaj, më 5 gusht 2014.

6. Më 9 shkurt 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI08/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI08/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta-Rama Hajrizi.

7. Më 16 mars 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

8. Mandati i gjyqtarit Kadri Kryeziu ka përfunduar më 26 qershor2015. Më 1 korrik 2015,Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI08/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalovićanëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend tëKadri Kryeziut.

9. Më 6 korrik2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 29 korrik 2011, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për një pikë të krimeve të luftës kundër popullatës civile, në pajtim me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të RSFJ-së dhe në lidhje me nenin e përbashkët 3 të Konventës së Gjenevës dhe të neneve 4 dhe 5 (1) të Protokollit Shtesë II (torturë e një të paraburgosuri civil). Ai u dënua me 6 vjet burgim. Përveç kësaj, ai u lirua nga një pikë për krime të luftës kundër popullatës civile. Ishin edhe katër të bashkakuzuar të tjerë që ishin shpallur fajtorë nga

gjykata e njëjtë për katër pika për krime të luftës kundër popullsisë civile.

11. Parashtruesi i kërkesës me kohë parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të 29 korrikut 2011. Ai pretendoi se Gjykata e Qarkut, *inter alia*, kishte shkelur normat e ligjit procedural dhe gabimisht e në mënyrë jo të plotë kishte vërtetuar gjendjen faktike. Sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Qarkut nuk kishte dhënë arsyet se pse ajo i kishte dhënë besueshmëri më të madhe disa provave në krahasim me besueshmërinë e provave të tjera pasi ato kishin të bënin me disa deklarata të dëshmitarëve.

12. Katër të bashkakuzuarit e tjerë parashtruan gjithashtu ankesat e tyre kundër Aktgjykimit të 29 korrikut 2011.

13. Më 11 shtator 2013, Gjykata e Apelit aprovoi Aktgjykimin PAKR 966/2012 dhe refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar.

14. Gjykata e Apelit nuk ishte pajtuar me parashtresat e parashtruesit në lidhje me shkeljet e pretenduara të ligjit procedural, në veçanti në lidhje me deklaratat e dëshmitarëve dhe me mungesën e arsyetimit në aktgjykim.

15. Gjykata e Apelit, gjithashtu, adresoi kërkesën e bërë nga parashtruesi (dhe nga 4 të bashkëpandehurit) se Gjykata e Qarkut kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike. Ajo deklaroi si në vijim: *"Gjykata e Apelit nuk pajtohet me kritikë të tilla dhe gjen se ankuesit kanë në shënjestër aktgjykimin për vlerësimin e provave pa pasur ndonjë argument të arsyeshëm. Është privilegj i trupave gjykuese të vlerësojnë provat që mësuan nga dora e parë gjatë shqyrtimit kryesor..."*

16. Përderisa katër të bashkakuzuarit parashtruan kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë në janar të vitit 2014, parashtruesi i kërkesës nuk e bëri një gjë të tillë.

17. Më 7 maj 2014, Gjykata Supreme aprovoi Aktgjykimin (Pml. Kzz 1/2014) dhe refuzoi kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruara për dy të bashkakuzuarit dhe aprovoi pjesërisht kërkesën e njërit prej tyre.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon që "*ne te gjitha fazat e procedures eshte kontestuar Juridikcioni apo kompetenca territoriale-zbatueshmeria e ligjit penal te RSFJ, jashte teritorit-kufirit Shteteror*

te ish-RSFJ-se per veprat e pretenduara Penale në teritorin e një shteti tjeter (ne Shqiperi)... dhe a ka baze Juridike aplikimi i Ligjeve Nderkombetare-Konventave të Gjeneves ne shtetin i cili nuk eshte i perfshire ne lufte apo konflikt te armatosur...".

19. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë ishte nxjerrë me shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë pasi që prova e tij e mbrojtjes ishte shpërfillur vazhdimisht.

20. Ai gjithashtu pretendon se "*Aktgjykimi i shkalles se pare dhe Aktgjykimi i Apelit... vepruan ne kundërshtim me nenin 31 te Kushtetutes... [të bazuara] vetëm ne nje Deklarate te dhene nga dëshmitari N. edhepse ishte ne kundërshtim te plote me provat - deklaratat e deshmitareve tjerë...*".

21. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendoi si në vijim: "*Mbështetur në Aktgjykimin e shkallës së dytë dhe të Gjykatës Supreme, konsiderojmë se ka dyshim të konsiderueshëm lidhur me saktësinë e fakteve vendimtare, të vërtetuara në vendimet kundër të cilave paraqesim Kërkesën për shkelje të kushtetutës...*".

22. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme gaboi në *"vlerësim ne konkluzione... Njeherit nuk vlerësoj fare Juridiksionin-kompetence e Gjykatave te Kosoves..."*.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës ankohet se vendimet e kontestuara janë nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

24. Neni 31 i Kushtetutës, për aq sa është relevant, parasheh si më poshtë:

> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
> *4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet".*

25. Neni 6 i KEDNJ-së, për aq sa është relevant, thekson:

> *"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...*

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

(d) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës".

26. Gjykata vëren se, nëmënyrë që të jetënë gjendje tëshqyrtojë kërkesën eparashtruesit, ajo duhet së pari tëvlerësojë nëseparashtruesii kapërmbushurkushtet epranueshmërisë,të përcaktuarame Kushtetutë dhe të specifikuaramë tejnëLigj dhe në Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7, të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

28. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të 7 majit 2014 (Pml. Kzz 1/2014).

29. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka shfrytëzuar mundësinë e paraparë me nenin 418 të Kodit të Procedurës Penale për të parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

30. Prandaj, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ishte nxjerrë në bazë të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë së tre personave të tjerë të bashkakuzuar, të cilët e kanë ushtruar të drejtën e tyre ligjore për mbrojtjen e ligjshmërisë.

31. Prandaj, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk mund të argumentojë se të drejtat e tij për gjykim të drejtë janë shkelur me aktgjykimin në fjalë të Gjykatës Supreme, kur ai nuk ishte palë në procedurën e lartpërmendur.

32. Sa i përket ankesave të parashtruesit të kërkesës në lidhje me aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, aktgjykimi i fundit, i cili ishte nxjerrë në rastin e parashtruesit të kërkesës, ishte Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit më 11 shtator 2013 (PAKR 966/2012).

33. Gjykata më tej vëren se shumica e ankesave të parashtruesit të kërkesës kishin të bënin me Gjykatën e Apelit dhe me aktgjykimin e

shkallës së parë, veçanërisht me vërtetimin e gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë në këtë drejtim.

34. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton nenin 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)".*

35. Gjykata gjithashtumerr parasysh rregullin36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> ...
>
> *c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi...".*

36. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata konstaton se parashtruesi parashtroi kërkesën e tij më 5 gusht 2014, ndërsa vendimi i fundit, PAKR 966/2012, i Gjykatës së Apelit u nxor më 11 shtator 2013. Nuk dihet se kur ky aktgjykim i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës, por megjithatë kjo datë e panjohur ishte me siguri para janarit të vitit 2014, kur të tre të bashkakuzuarit e tjerë kishin paraqitur kërkesat e tyre për mbrojtje të ligjshmërisë.

37. Rrjedhimisht, është e qartë se parashtruesi parashtroi kërkesën e tij në këtë Gjykatë pas skadimit të afatit kohor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

38. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është të promovojë siguri ligjore, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme si dhe vendimet e kaluara të mos jenë vazhdimisht të hapura për kontestim (Shih rastin *O'LOUGHLIN dhe të tjerët kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* Nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendim i 25 gushtit 2005).

39. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 6 korrik 2015, njëzëri:

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI33/15, Parashtrues Mihane Ismajli - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-ll-0065-C0068, i 13 majit 2014

KI33/15, Aktvendim për papranueshmëri i 4 shtatorit 2015, publikuar më 30 shtator 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme, procesi i privatizimit,barazia para ligjit*

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme kishte refuzuar të pabazuar ankesën e parashtrueses për përfshirje në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta, realizim të përfitimit nga shitja e një ndërmarrje shoqërore. Parashtruesja u ankua në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar në shkelje të parimit të barazisë para ligjit.

Gjykata Kushtetuese vërejti se parashtruesja e dorëzoi kërkesën pas skadimit të afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh. Kërkesa u shpall e papranueshme si e paafatshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI33/15
Parashtrues
Mihane Ismajli
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-11-0065-C0068,
të 13 majit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesaështë dorëzuar nga znj. Mihane Ismajli, me vendbanim në Gjilan (në tekstin e mëtejmë:parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-11-0065-C0068 (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së), të 13 majit 2014.

3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 27 tetor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtën parashtrueses të garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit],

paragrafi 1, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin113.7të Kushtetutës, në nenin 47tëLigjit përGjykatënKushtetuese të Republikëssë Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji)dhe në rregullin56tëRregullores së punëssë GjykatësKushtetuese të RepublikëssëKosovës(në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 13 mars 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 21 prill2015,KryetariiGjykatës, me Vendimin nr.GJR. KI33/15, caktoigjyqtaren Snezhana Botusharovagjyqtare raportuese dhe me, Vendiminnr.KSH. KI33/15,caktoiKolegjin shqyrtues,të përbërënga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 28 prill 2015, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të ofrojë disa informata shtesë, përkatësisht të sqarojë se në emër të kujt ishte dorëzuar kërkesa, se cili është vendimi i kontestuar dhe se cili është vendimi i fundit.

9. Më 7 maj 2015, parashtruesja i dorëzoi informatat e kërkuara në Gjykatë.

10. Më 14 maj 2015, Gjykata e njoftoi Kolegjin e Specializuar të DHPGJS për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës. Përveç kësaj, Gjykata kërkoi që ata të dorëzojnë një kopje të fletëkthesës që tregon datën se kur i është dorëzuar vendimi i kontestuar parashtrueses të kërkesës.

11. Më 25 maj 2015, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së i dorëzoi informatat e kërkuara në Gjykatë.

12. Më 1 korrik2015,Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI33/15,caktoi gjyqtarin Ivan Čukalovićanëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Enver Hasani.

13. Më 3 korrik2015,Kolegji shqyrtues e aprovoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Parashtruesja e kërkesës ishte e punësuar si referente juridike në Ndërmarrjen Shoqërore "Integji", më vonë e njohur si "Industria e Tekstilit Integj", në Gjilan (në tekstin e mëtejmë: NSH Integji).

15. Më 2 mars 2006, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) që kishte kompetencë për NSH Integji, vendosi ta shesë atë.

16. AKP-ja pastaj përcaktoi se kush ka të drejtë të përfitojë 20% nga të ardhurat e shitjes së ndërmarrjes duke publikuar një listë përfundimtare të punëtorëve të cilët kanë të drejtë për një përfitim të tillë. Parashtruesja e kërkesës nuk është përfshirë në atë listë përfundimtare.

17. Më 2 dhjetor 2011, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë kundër AKP-së në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së duke pretenduar se ajo ishte dashur të përfshihej në listën përfundimtare, pasi ajo ishte e punësuar nga NSH-ja Integji në kohën e privatizimit.

18. Më 13 maj 2014, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së (Aktgjykimi SCEL-11-0065-C0068), e refuzoi ankesën e parashtruese së kërkesës, duke konstatuar që:

    "[...] Kërkesa është e pranueshme, por e pabazuar.

    [...] Ankuesja [parashtruesja e kërkesës], e cila nuk ishte në listën e pagave të ndërmarrjes në kohën e privatizimit, pretendon se ajo është kthyer në vendin e punës në NSH si e punësuar pas luftës, dhe pasi që nuk i është caktuar vendi i punës, i tërë stafi është dërguar në "pushim pa pagesë".

    [...] përfshirja e punëtorëve të mëparshëm nuk ka të bëjë me ata që në të vërtetë– pa marrë parasysh shkëputjen formale të kontratës së punës – nuk kanë qenë të punësuar në momentin e caktuar kohor, gjegj. momentin e privatizimit. [...] Prandaj, fakti se ankuesja nuk ishte punësuar në NSH në momentin e caktuar të privatizimit nuk është theksuar, e lëre më dëshmuar, që të bazohej në arsyet diskriminuese [...] Prandaj, ankuesja nuk ka të drejtë të gjendet në listën e personave me të drejtë në 20% të spin-off-it të NSH-së [...]."

19. Parashtruesja e kërkesës parashtroi në Gjykatë kopjen e një teksti, të dedikuar për ankesë ndaj vendimit të kontestuar në Kolegjin e

Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave të DHPGJS-së).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesja e kërkesës pretendon se AKP-ja dhe Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së kanë shkelur të drejtën për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës.

21. Lidhur me këtë pretendim, parashtruesja e kërkesës pohon se *"[...] Punëtorët të cilët kanë pasur status të njëjtë nga marrëdhënia e punës, ndërsa sa i përket ndarjes së 20% janë trajtuar ndryshe dhe se për disa punëtor ka vlejtur parimi I legjitimitetit e për disa jo [...]."*

22. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës deklaron që *"[...] me rastin e publikimit të listëspërfundimtarë tëpunëtorëve për realizimin e të drejtës së 20% të publikuar [...] unë nuk jam përfshir, ndërsajanë përfshir personat të cilët fare nuk nuk janë lajmruar në punë që nga qershori I vitit 1999 [...]".*

23. Parashtruesja e kërkesës konkludon, duke kërkuar nga Gjykata:

> *"[...] që kërkesa ime të aprovohet dhe të detyrohet pala kundërshtare gjegjësisht Agjencioni Kosovar I Privatizimit që të më njef të drejtën për ndarjen e 20% të kapitalit me rastin e privatizimit të ndërmarrjes[...]".*

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata vlerëson nëseparashtruesjae kërkesës i kapërmbushurkriteret epranueshmërisëtë përcaktuarame Kushtetutë dhe të specifikuaramë tejnëLigj dhe në Rregullore të punës.

25. Në këtë drejtim.Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, të cilët parashohin:

Neni 49 [Afatet] i Ligjit:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]."*

Rregulli 36 (1) (c) i Rregullores së punës:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

[...]

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi [...]"

26. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin (SCEL-11-0065-C0068, të 13 majit 2015) e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, duke pretenduar se ky është vendimi përfundimtar në rastin e saj. Parashtruesja konfirmon më tej deklaratën e fundit kur ajo kishte dorëzuar informata shtesë në lidhje me sqarimet e kërkuara nga Gjykata lidhur me atë se cili është vendimi i fundit dhe cili është vendimi i kontestuar.

27. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesja e dorëzoi kërkesën më 13 mars 2015. Ajo pretendon se vendimi i kontestuar i ishte dorëzuar asaj më 10 janar 2015.

28. Megjithatë, Gjykata vëren se vendimi i kontestuar i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 27 tetor 2014. Kjo dëshmi ishte paraqitur nga Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së pas kërkesës së Gjykatës për një kopje të fletëkthesës, që tregon ditën kur parashtrueses i ishte dorëzuar vendimi i kontestuar. Gjykata kishte kërkuar prova të tilla pas deklaratës së parashtrueses së kërkesës se ajo nuk mund ta sigurojë atë.

29. Duke pasur parasysh faktet e përmendura më sipër, rrjedh se parashtruesja e parashtroi kërkesën në Gjykatë pas skadimit të afatit ligjor prej katër muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

30. Gjykata përkujton se qëllimi i afatit ligjor prej katër muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit si dhe sipas rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë sigurinë juridike, duke siguruar që rastet të cilat paraqesin çështje kushtetuese të shqyrtohen brenda afateve të arsyeshme, si dhe që vendimet e nxjerra më herët të mos jenë pafundësisht të hapura për kontestim (Shih rastin *O'LOUGHLIN dhe të tjerët kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* Nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendim i 25 gushtit 2005).

31. Gjithsesi, siç u tha më lart, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesja ka dorëzuar një kopje të tekstit të dedikuar për ankesë ndaj vendimit të kontestuar. Kopja nuk ka ndonjë numër të regjistrimit dhe as ndonjë shenjë për të dëshmuar se ajo ishte dorëzuar.

32. Në këtë drejtim, duke supozuar se parashtruesja e kërkesës ka parashtruar ankesë në Kolegjin e Ankesave të DHPGJS-së, kërkesa do të ishte e parakohshme, pasi që ajo është ende në pritje.

33. Gjykata nuk mund të marrë parasysh pretendimet e parashtrueses së kërkesës se e drejta e saj për barazi para ligjit, siç garantohet me Kushtetutë, është shkelur me vendimin e kontestuar para se parashtruesja e kërkesës t'i ketë shterur të gjitha mjetet efektive juridike dhe pa përmbushjen e kërkesave të tjera procedurale për parashtrimin e një kërkese.

34. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesja e kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore.

35. Arsyetimi i parimit të shterimit është që t'u ofrohet autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësia e rregullimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike, kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Gjykatës (Shih Aktvendimin për papranueshmëri, *AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, i 21 janarit 2010, dhe shih, *mutatis mutandis,* GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Aktvendim i 28 korrikut 1999).

36. Prandaj, Gjykata konsideron që, në rast se parashtruesja e kërkesës ka parashtruar ankesë në Kolegjin e ankesave të DHPGJS-së, kërkesa do të ishte e parakohshme, pasi që procedura e parashtrueses pas ankesës së saj ende nuk ka përfunduar.

37. Për arsyet e mësipërme, rrjedh se kërkesa është e paafatshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI185/14, Parashtrues Zoran Kolić - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PML 125/14, i 8 korrikut 2014

KI185/14, Aktvendim për papranueshmëri i 8 korrikut 2015, publikuar më 20 tetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, procedurë penale, dënim me burgim, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm*

Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit përkitazi me dënimin me burgim. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese me pretendimet për shkelje të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar me saktësi se si dhe pse një vendim i tillë i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat dhe liritë e tij, të cilat ai pretendon se i janë shkelur si dhe, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave dhe lirive të tij sipas Kushtetutës, janë të paargumentuara dhe të padëshmuara.Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 29 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI185/14
Parashtrues
Zoran Kolić
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PML 125/14, të 8 korrikut 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Zoran Kolić nga Lipjani (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga z. Miodrag Brkljać, avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme,PML 125/14, të 8 korrikut 2014, me të cilin ishin refuzuar kërkesat e tij për mbrojtje të ligjshmërisë. Aktgjykimi i ishte dorëzuar parashtruesit më 20 gusht 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) si dhe me nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] (1) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe Konventës kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata *"që në kuptim të nenit 39 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të mbajë një seancë dëgjimore publike, pasi që besoj se mbajtja e saj është e nevojshme për t'i qartësuar provat"*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe me rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 22 dhjetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 13 janar 2015, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 30 janar 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI185/14, e caktoi zëvendëskryetarin Ivan Čukalovićanëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, të cilit mandati në Gjykatën Kushtetuese i përfundoi më 26 qershor 2015.

10. Më 8 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 11 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale dhe e dënoi atë me dënim me burgim dhe me gjobë.

12. Më 25 shtator 2013, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR 1121/12) aprovoi pjesërisht ankesat e parashtruara nga parashtruesi i kërkesës dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, duke i bashkuar dy vepra penale në një.

13. Pas kësaj, më 8 maj 2014, avokatët e tij mbrojtës parashtruan kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu parashtroi një kërkesë të tij.

14. Të dy avokatët mbrojtës dhe parashtruesi i kërkesës pretenduan se *"një sërë arsyesh janë paraqitur nga avokatët mbrojtës dhe i akuzuari (...), dhe të cilat kanë të bëjnë vetëm me vlerësimin faktik të rastit"*.

15. Në të vërtetë, mbrojtja bazoi ankesën në atë se *"provat nuk kualifikohen si krime lufte; nuk kishte asnjë provë për bashkëkryerje: Aktgjykimi bazohet në prova të papranueshme dhe gjykata e shkallës së parë ka tejkaluar aktakuzën*".

16. Më 24 qershor 2014, Prokurori i Shtetit konstatoi se parashtresat e mbrojtjes nuk ishin të bazuara dhe se kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë duhet të refuzohen.

17. Më 8 korrik 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi PML 125/2014) refuzoi kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës dhe të mbrojtësve të tij dhe vërtetoi aktgjykimet e gjykatave më të ulëta.

18. Gjykata Supreme u kujtoi avokatëve mbrojtës dhe të akuzuarit se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, në pajtim me paragrafin 2 të nenit 432 të KPPK-së, nuk është e lejueshme *"kur bazohet në 'vërtetim të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike' dhe se "nuk duhet të përdoret si një metodë indirekte për ankesë të mëtejshme"*.

19. Gjykata Supremekonsideron se *"çdo parashtresë nga avokatët mbrojtës apo nga i akuzuari, lidhur vetëm me vërtetimin e gjendjes faktike nuk do të shqyrtohet*". Përveç kësaj, Gjykata Supreme "*nuk ka gjetur asnjë shkelje të ligjit penal apo të drejtës procedurale"* në lidhje me arsyet e tjera të paraqitura nga mbrojtja.

20. Në fund, Gjykata Supreme arriti në përfundimin se *"Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është i arsyetuar mirë, i hollësishëm dhe vjen deri te një rezultat i drejtë";* se nuk kishte *"arsye për përsëritje të gjetjeve të Gjykatës së Apelit*" dhe "*plotësisht pajtohet me vlerësimin e nxjerrë nga kolegji i ankesave"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuara janë shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 6 [E drejta për proces të rregullt] të KEDNJ-së dhe me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë "*për shkak të mënyrës se si janë kryer këto gjykime*".

23. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës pretendon se "*Prova tërësisht të pabesueshme, të pasigurta dhe kontradiktore që nuk kanë asnjë rëndësi apo peshë, u vlerësuan si të mjaftueshme për të marrë vendimin për fajësinë e një njeriu krejtësisht të pafajshëm*".

24. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se parimi i prezumimit të pafajësisë është shkelur në mënyrë drastike dhe se Gjykata Kushtetuese duhet ta konfirmojë këtë parim.

25. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ankohet se, gjatë paraburgimit të tij, ai ishte shënjuar në mënyrë të tillë që të gjithë e dinin se ai ishte një kriminel lufte. Si pasojë, ai kishte vuajtur trauma të rënda psikologjike që e pengonin atë të përqendrohej në mbrojtjen e tij për gjykimet e ardhshme. Ai konsideron se veprimi i përshkruar është në kundërshtim me Konventën kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

26. Parashtruesi i kërkesës, në fund, kërkon nga Gjykata "*që tëdëshmohet se të dënuarit i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë si dhe të drejtat tjera të njeriut, të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës*".

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

28. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

29. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kërkoi që të mbrojë të drejtat e tij në Gjykatën e Qarkut dhe Gjykatën e Apelit dhe se ai parashtroi

kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Prandaj, ai duhet të konsiderohet se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të Kosovës.

30. Përveç kësaj, neni 49 [Afatet] i Ligjit, parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".*

31. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se dita e fundit e periudhës katërmuajshe për parashtruesin bie të shtunën, më 20 dhjetor. Megjithatë, rregulli 27 (f) i Rregullores së punës parasheh që *"nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj"*. Prandaj, parashtruesi i kërkesës ka mundur ta dorëzojë kërkesën në mënyrën e duhur të hënën, më 22 dhjetor.

32. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi dhe se ai parashtroi në kohë kërkesën në Gjykatë.

33. Megjithatë, Gjykata gjithashtu duhet të marrë parasysh nenin 48 [Saktësia e kërkesës] të Ligjit dhe rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës.

34. Neni 48 i Ligjit parasheh si në vijim:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

35. Rregulli 36 i Rregullores së punës parasheh si në vijim:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".*
>
> *"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] (d) parashtruesi nuk dështon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

36. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P 408/11, të 11 majit 2012, dhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR 1121/12, të 25 shtatorit 2013, është shkelur e

drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me Kushtetutë dhe me KEDNJ.

37. Parashtruesi i kërkesës thekson që Gjykata e Qarkut dhe Gjykata e Apelit kishin vlerësuar gabimisht se provat krejtësisht të pasigurta dhe jo të besueshme ishin të mjaftueshme për ta shpallur fajtor atë.

38. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta apo nga autoritetet e tjera publike, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

39. Prandaj, Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta apo nga autoritetet e tjera publike, pasi që është roli i tyre, kur kjo është e mundshme, të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima,* Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

40. Gjykata Kushtetuesemundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi dhe të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, 10 korrik 1991).

41. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ishte ndihmuar nga avokatët e tij mbrojtës në procedurë dhe se gjykatat me kujdes i kanë shikuar të gjitha provat dhe tërësisht i kanë arsyetuar vendimet e tyre.

42. Për më tepër, Gjykata Supreme konsideroi se nuk mund t'i marrë parasysh kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë në lidhje me situatën faktike dhe se nuk ka mundur të gjejë shkelje të së drejtës penale apo procedurale në lidhje me arsyet e tjera të paraqitura nga mbrojtja.

43. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konkludoi se vendimi i Gjykatës së Apelit ishte i arsyetuar mirë, i detajuar dhe solli një rezultat të drejtë dhe se plotësisht u pajtua me arsyetimin e dhënë nga ajo gjykatë.

44. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese konsideron se procedurat në Gjykatën e Qarkut, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme kanë qenë të drejta dhe të kryera mirë (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub*

kundër Lituanisë, Nr. 17064/06, KEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009) dhe se parashtruesi i kërkesës nuk kishte saktësuar se si ishin shkelur nenet e Kushtetutës, të cilave ai u referohet, siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 48 të Ligjit.

45. Përveç kësaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës, për shkak se, në pajtim me paragrafin 2 të nenit 432 të KPPK-së, një kërkesë e tillë nuk është e lejueshme *"kur bazohet në konstatimin e gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike"*.

46. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar me saktësi se si dhe pse një vendim i tillë i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat dhe liritë e tij, të cilat ai pretendon se i janë shkelur.

47. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka ndërtuar dhe nuk ka dëshmuar një rast në lidhje me *"ndonjë shkelje të së drejtës penale apo procedurale"* të dorëzuar nga ai apo nga mbrojtësit e tij në Gjykatën Supreme.

48. Për më tepër, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se ai ishte shënjuar si një kriminel lufte gjatë paraburgimit të tij, që e pengonte atë të përqendrohej në përgatitjen e mbrojtjes së tij.

49. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka treguarseai e ka ngritur atë pretendimparagjykatave të rregulltaosesekëto rrethana e kanë penguar atëpër tëpërgatitur mbrojtjen e tijnë procedurën penale.

50. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk e ka dëshmuar pretendimin për keqtrajtim, të cilin e kishte vuajtur derisa ishte në paraburgim dhe nuk ka paraqitur asnjë provë që mund ta dëshmojë pretendimin e tij.

51. Si përmbledhje, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave dhe lirive të tij sipas Kushtetutës dhe KEDNJ-së janë të paargumentuara dhe të padëshmuara dhe, prandaj, janë qartazi të pabazuara.

52. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi që, në pajtim me rregullin 39 [E Drejta në dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së punës, Gjykata duhet të mbajë një dëgjim publik për të sqaruar provat.

53. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit të kërkesës për të mbajtur një dëgjim publik nuk përmbush asnjë nga

kushtet e parapara me rregullin 39 [E Drejta në dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së punës.

54. Për më tepër, mbajtja e një dëgjimi publik për të sqaruar provat e çështjes do të binte nën juridiksionin e një "gjykate të shkallës së katërt". Siç u tha më lart, Gjykata Kushtetuese nuk është një "gjykatë e shkallës së katërt".

55. Në fund, Gjykata tashmë konkludoi se kërkesa është e papranueshme, si qartazi e pabazuar. Në këtë mënyrë, Gjykata merr parasysh se rregulli 39 i Rregullores së punës parasheh që *"Vetëm kërkesat e përcaktuara si të pranueshme mund të dëgjohen para Gjykatës"*. Prandaj, kërkesa e parashtruesit për mbajtjen e seancës dëgjimore refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 29 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) dhe 56 të Rregullores së punës, më 8 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI46/15, Parashtrues Zejna Qosaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 17/2015, i 4 shkurtit 2015

KI46/15, Aktvendim për papranueshmëri i 9 tetorit 2015 publikuar, më 20 tetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, legjitimiteti pasiv, ndërprerje e marrëdhënies së punës, e drejta në punë dhe ushtrim të profesionit, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm*

Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar kërkesën për revizion të parashtrueses, përkitazi me ndërprerjen e marrëdhënies së punës sepse pala e paditur nuk kishte legjitimitet pasiv. Parashtruesja, u ankua në Gjykatën Kushtetuese me pretendimet për shkelje të së drejtës për mbrojtje gjyqësore dhe të drejtës në punë.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi, se pretendimi i parashtrueses për shkeljen e të drejtave kushtetuese nukpërmban bazë kushtetuese të argumentueshmepër faktin se, parashtrueses i është mundësuar qasja në Gjykatë dhe mbrojtja e të drejtave të saj përgjatë gjithë procesit gjyqësor në të gjitha instancat gjyqësore.Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI46/15
Parashtrues
Zejna Qosaj
Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 17/2015, të 4 shkurtit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Zejna Qosaj, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, e cila përfaqësohet nga z. Ali Qosaj, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 17/2015, të 4 shkurtit 2015 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), me të cilin është refuzuar revizioni i saj si i pabazuar, për shkak se pala e paditur nuk ka pasur legjitimitet pasiv në këtë çështje juridike.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar Rev. nr. 17/2015, për shkak të shkeljeve të pretenduara të të drejtave të garantuara me nenin 49 [E drejta në Punë dhe Ushtrim të Profesionit] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji*)*.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 17 prill 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 2 qershor 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI46/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI46/15, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu (anëtar) dhe Bekim Sejdiu (anëtar).

7. Më 15 qershor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kësaj kërkese iu dërgua Gjykatës Supreme.

8. Më 10 shtator 2015, Kolegjishqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesja para vitit 1990 ka punuar si juriste në Klinikën Interne të Spitalit të Prishtinës, që më pas është emërtuar si Organizatë Punuese e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës me klinikat përbërëse (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi).

10. Më 23 shtator 1990, punëdhënësi mori vendim (Vendimi nr. 183) që parashtrueses t'ia ndërpresë marrëdhënien e punës, për shkak se kishte konsideruar se ajo nuk përfilli detyrat e punës.

11. Më 4 dhjetor 1990, parashtruesja ushtroi padi në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë kundër Vendimit nr. 183, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, duke kërkuar që vendimi në fjalë të anulohet si i jashtëligjshëm.

12. Për shkak të rrethanave të luftës, lënda e parashtrueses është transferuar për gjykim në Kragujevc, të Republikës së Serbisë. Mirëpo, për shkak të pamundësisë së marrjes pjesë në seanca gjyqësore, kontesti i saj nuk ishte zgjidhur. Pas përfundimit të luftës, parashtruesja ushtroi kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (në tekstin e

mëtejmë: QKUK), duke konsideruar se QKUK-ja është trashëgimtare e punëdhënësit.

13. Më 27 dhjetor 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi, C. nr. 1042/10), e refuzoi kërkesëpadinë e parashtrueses, me arsyetimin se QKUK-ja nuk ka legjitimitet pasiv në këtë çështje juridike, pasi që e njëjta është themeluar dhe ka filluar të funksionojë nga qershori i vitit 1999, respektivisht nga themelimi i Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës.

14. Kundër këtij aktgjykimi, parashtruesja ushtroi të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të ligjit material.

15. Më 17 korrik 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi, Ac. nr. 633/2013), refuzoi, si të pabazuar ankesën e parashtrueses dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës, C. nr. 1042/10.

16. Kundër këtij aktgjykimi, parashtruesja në afat ligjor ushtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme.

17. Më 4 shkurt 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Rev. nr. 17/2015), refuzoi, si të pabazuar revizionin e ushtruar nga parashtruesja, duke i lënë në fuqi vendimet e gjykatave të instancës më të ulët.

18. Për më tepër, Gjykata Supreme konsideroi se aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta që do ta vinin në pyetje ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur me revizion sa i përket aplikimit të ligjit material. Gjykata Supreme, gjithashtu, konsideroi se QKUK-ja në këtë rast nuk kishte legjitimitet pasiv, gjegjësisht nuk është palë në marrëdhëniet materiale juridike. Më tutje, në arsyetim thuhet se QKUK-ja është subjekt juridik i themeluar nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht nga Ministria e Shëndetësisë, e cila funksionon nga qershori i vitit 1999.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesja pretendon se me aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin49 të Kushtetutës, nga shkaku se asaj, nuk i është njohur statusi i punëtores si juriste, nga QKUK-ja.

20. Për më tepër, parashtruesja pretendon se gjykatat e rregullta gabuan kur e refuzuan kërkesëpadinë e saj. Kjo për faktin, se në kohën kur punëdhënësi i saj mori vendimin për largimin e saj nga puna, asaj nuk i kishte pushuar marrëdhënia e punës si juriste në Klinikën Interne,

sepse kontesti nuk ishte zgjidhur ende nga gjykata për shkak të rrethanave të luftës. Për këtë arsye, parashtruesja pretendon se gjykatat e rregullta, duke refuzuar kërkesëpadinë e saj, nuk i ofruan mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata Kushtetuese, para se ta shqyrtojë një kërkesë, së pari vlerëson nëse ajo i ka përmbushur kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Për këtë kërkesë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

23. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) d) i Rregullores së punës, parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".*

24. Për më tepër, rregulli 36 (2) i Rregullores së punës parasheh:

> *"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*
>
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*
>
> *[...]*
>
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

25. Gjykata shqyrtoi në tërësi shkresat e bashkëngjitura në kërkesë dhe vëren se aktgjykimi i kontestuar, Rev. nr. 17/2015, i 4 shkurtit 2015, i

Gjykatës Supreme, nuk shkel të drejtat e garantuara me nenin 49 të Kushtetutës, ashtu siç pretendohet nga parashtruesja.

26. Përkitazi me këtë, Gjykata thekson se kuptimi i nenit 49 të Kushtetutës [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] është një përkufizim standard që përcakton garancitë dhe të drejtat për të punuar, mundësitë e punësimit dhe të sigurimit të kushteve të barabarta pa diskriminim, si dhe të drejtën e zgjedhjes së vendit të punës dhe ushtrimit të profesionit në mënyrë të lirë, pa detyrime të dhunshme. Këto të drejta në mënyrë specifike janë të rregulluara me ligj.

27. Në këtë kontest, Gjykata konsideron se parashtruesja nuk ka dëshmuar dhe nuk ka provuar se gjykatat e rregullta, me vendimet e tyre, shkelën të drejtat e saj të garantuara me dispozitat e nenit 49 të Kushtetutës.

28. Përkitazi me pretendimin se parashtrueses i është mohuar e drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, Gjykata konsideron se *e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është e drejtë themelore e çdo individi, për të ngritur një padi në një gjykatë, që ka juridiksion të plotë për ta zgjidhur një çështje civile apo penale. Kjo e drejtë, në veçanti, përfshin të drejtën për të hapur dhe për të ngritur një proces para një Gjykate dhe të drejtën për të pasur një zgjidhje përfundimtare në lidhje me kontestin e ngritur*.

29. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtrueses për shkeljen e kësaj të drejte, e cila garantohet me nenin 54 të Kushtetutës, nuk përmban bazë kushtetuese të argumentueshme për shkeljen e kësaj dispozite konkrete, për faktin se parashtrueses i është mundësuar qasja në gjykatë dhe mbrojtja e të drejtave të saj përgjatë gjithë procesit gjyqësor, në të gjitha instancat gjyqësore.

30. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta, respektivisht Gjykata Supreme, kanë respektuar parimet dhe kriteret që kërkohen me nenin 54 të Kushtetutës, për të cilat parashtruesja pretendon se i janë cenuar.

31. Në tërësi, Gjykata konsideron se parashtruesja nuk ka paraqitur prova bindëse, të argumentuara që tregojnë se pretendimet e saj janë të bazuara dhe përbëjnë shkelje të të drejtave të saj të garantuara me Kushtetutë (Shih, *Vanek kundër Republikës Sllovake*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

32. Prandaj, Gjykata, në rastin e parashtrueses, nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse të zhvilluara në Gjykatën Supreme kanë qenë

në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub vs. Lithuania*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

33. Nga të gjitha arsyet e shtjelluara më lart, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses duhet deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) c), 36 (2) b) dhe d) si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 9 tetor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI29/15, Parashtrues Bardhyl Kameri - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 9/2015, i 12 shkurtit 2015

KI29/15, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shtatorit 2015,të publikuar më 28 tetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, barazia para ligjit, të drejtat e të akuzuarit, parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dënim me kusht, vjedhje e rëndë*

Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit përkitazi me dënimin e tij me kusht, për shkak të veprës penale, vjedhje e rëndë. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese me pretendimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të drejtave të akuzuarit.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie,* e cila do të theksonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese dhe fakti,se ai nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës në rastin e tij, nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e Kushtetutës.Kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e pa pranueshme, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI29/15
Parashtrues
Bardhyl Kameri
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Pml. nr. 9/2015, të 12 shkurtit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Bardhyl Kameri(në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) nga fshati Koretin, komuna e Kamenicës, i cili përfaqësohet nga z. Halit Azemi.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 9/2015, i 12 shkurtit 2015. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 3 mars 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartpërmendurtë Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat e rregullta me vendimet e tyre, gjatë caktimit të dënimit me burgim, kanë shkelur nenin 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], neni 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 mars 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI29/15, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI29/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

7. Më 29 prill 2015, Gjykata informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.

8. Më 1 korrik 2015, Kryetarja, me Vendimin GJR. KI29/15 caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues, në vend të gjyqtares Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 1 korrik 2015, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI29/15 caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi anëtare të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Enver Hasani, mandati i të cilit si gjyqtar kushtetues kishte përfunduar më 26 qershor 2015.

10. Më 10 shtator2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 19 qershor 2014, Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, me Aktgjykimin, P. nr. 193/2011, shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale, vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 i Kodit Penal të Kosovës, duke i shqiptuar dënimin me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh.

12. Më 18 gusht 2014, Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vepruar sipas ankesës së Prokurorit Publik në Gjilan, me Aktgjykimin PAI. nr. 997/2014, aprovoi kërkesën e Prokurorit Publik përkitazi me vendimin për dënim, duke i shqiptuar parashtruesit të kërkesës masën e burgimit efektiv në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh. Më tej, në Aktgjykim theksohet "*Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorit janë të bazuara, sepse rrethanat lehtësuese në rastin konkret janë mbivlerësuar ndërsa rrethanat rënduese nuk janë vlerësuar fare, se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore dhe pasojat e veprës së kryer*".

13. Më 6 nëntor 2014, Gjykata Themelore në Gjilan, duke vepruar sipas kërkesës së parashtruesit për zëvendësimin e dënimit me burg me masën e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme, nxori Aktvendimin P. nr. 193/11, duke hedhur poshtë si të palejuar ankesën e parashtruesit.

14. Më 16 dhjetor 2014, Gjykata e Apelit të Kosovës, me Aktvendimin PN. nr. 645/2014, refuzoi, si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës ndaj Aktvendimit, P. nr. 193/11 të Gjykatës Themelore në Gjilan.

15. Më 12 shkurt 2015, Gjykata Supreme, duke vepruar në bazë të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P. nr. 193/11, të 11 qershorit 2014, dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 645/2014, të 16 dhjetorit 2014, nxori Aktgjykimin, Pml. nr. 9/2015, nëpërmjet të cilit refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit. Gjykata Supreme konstatoi se Gjykata e shkallës së dytë kishte shqiptuar dënimin në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi në kohën e shqiptimit të dënimit ndaj parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me shqiptimin e dënimit me burgim janë shkelur nenet 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës.

17. Parashtruesi i kërkesëskërkon nga Gjykata që të prishë vendimet e gjykatave të rregullta dhe ta kthejë lëndën në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

19. Gjykata i referohetnenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

20. Gjykata, gjithashtu, thekson nenin 48 të Ligjit, i cili përcakton se:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

21. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *„(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> > *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

22. Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale nga ana e gjykatave të rregullta, Gjykata ripërsërit se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu Rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima* dhe *Bestar Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

23. Edhe pse parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat e tij janë shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe me zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta, ai nuk ka treguar se si këto vendime kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie*e cila do të theksonte shkeljen e

të drejtave të tij kushtetuese (Shih rastin *Vanek kundër Republikës Sllovake*, Nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005).

24. Gjykata në vazhdimthekson se fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës në rastin e tij, nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e Kushtetutës (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* nr. 5503/02, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

25. Parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që të paraqesë rastin e tij në Gjykatën Themelore në Gjilan, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës.

26. Siç u përmend më lart, Gjykata vëren se arsyetimet e dhëna në Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P. nr. 193/11, të 11 qershorit 2014, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PN. nr. 645/2014, të 16 dhjetorit 2014, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 9/2015, të 12 shkurtit 2015, janë të plota dhe të qarta. Prandaj, Gjykata gjeti se procedurat pranë gjykatave të rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

27. Si përmbledhje, parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të mbështesë me prova, se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese.

28. Nga sa u tha më lart, Gjykata konsideron se faktete paraqitura ngaparashtruesi i kërkesësnë asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës dhe se ai nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij

29. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI38/15, Parashtrues Kolë Puka - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PML.-KZZ. nr. 170/2014, i 19 shkurtit 2015

KI38/15, Aktvendim për papranueshmëri i 11 shtatorit 2015, publikuar më 3 nëntor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, prezumimi i pafajësisë, dënim me burgim, shpërdorim i detyrës zyrtare, nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, rrethanat lehtësuese dhe rënduese*

Gjykata Supreme kishte aprovuar pjesërisht kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit përkitazi me dënimin e tij me burgim, për shkak të veprës penale,nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese me pretendimet për shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi sepërshkrimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës dhe
pretendimi se ato janë shkelur pa paraqitur fakte për mënyrën e shkeljes, papërcaktuar rrethanat e shkeljeve të pretenduara, ose pa specifikuar veprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me gjykimin e drejtë e të paanshëm, nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur Gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo tëKonventës lidhur me një proces të rregullt dhe të paanshëm. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI38/15
Parashtrues
Kolë Puka
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML.-KZZ. nr. 170/2014, të 19 shkurtit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Kolë Puka aktualisht në vuajtje të dënimit me burg në burgun e Dubravës, të cilin e përfaqëson djali i tij z. Driton Puka nga fshati Renoc, komuna e Klinës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, PML.-KZZ. nr. 170/2014, të 19 shkurtit 2015, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 2 mars 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, për të cilin, parashtruesi i kërkesës pretendon se i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), sipas nenit 31, pika 1.3 dhe 5 (E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 mars 2015, përfaqësuesi i parashtruesit e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 22 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI38/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 1 korrik 2015, nga vendimi i Kryetares së Gjykatës, gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi ishte caktuar si anëtare e Kolegjit shqyrtues, duke zëvendësuar Kadri Kryeziun, të cilit i përfundoi mandati i gjyqtarit më 26 qershor 2015.

8. Më 29 korrik 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, si dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.

9. Me 11 shtator 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 24 maj 2012, parashtruesi i kërkesës si njëri nga 4 (katër) të akuzuarit me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 477/11, është shpallur fajtor për veprën penale "të shpërdorimit të detyrës zyrtare dhe autoritetit" dhe me këtë rast, atij i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjetësh, njëkohësisht, me këtë Aktgjykim, i është shqiptuar edhe dënimi plotësues "ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik" në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetësh.

11. Gjykata e Qarkut si gjykatë e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit, ndërmjet të tjerash, ka theksuar se ishte dëshmuar se ndërmjet 12 shtatorit 2007 dhe 8 prillit 2008, në Klinë, parashtruesi, në cilësinë e gjykatësit të Gjykatës Komunale, së bashku me një avokat nga Klina, kanë sajuar dhe kanë ekzekutuar një plan për të ngritur një parashtresë për kompensim të dëmit të shkaktuar në një aksident komunikacioni pa dijeninë e personit të dëmtuar. Pastaj, parashtruesi,

si gjyqtar duke kryer detyrën zyrtare, lëshoi vendim gjyqësor që ka vendosur të caktojë kompensimin material të një personi të caktuar pa asnjë dëshmi për të mbështetur këtë çmim të kompensimit në dëm të fondit të garancisë së sigurimeve.

12. Më 15 korrik 2012, parashtruesi ka ushtruar ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë të përmendur si më lart.

13. Më 25 prill 2013, Gjykata e Apelit ka nxjerrë Aktgjykimin PAKR 1122/2012, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit, ndërsa sipas detyrës zyrtare pjesën e aktgjykimit që kishte të bëjë me parashtruesin, e ka modifikuar duke e ricilësuar veprën penale. Ashtu që në vend të veprës penale *"Shpërdorim i pozitës zyrtare apo autoriteti"* parashtruesi ishte shpallur fajtor për veprën penale të "*Nxjerrjes së vendimit të kundërligjshëm gjyqësor"* Gjykata e Apelit pastaj i ka shqiptuar dënimin me burg në kohëzgjatje të njëjtë kohore sikur edhe Gjykata e Qarkut në Pejë, por duke e përdorur ligjin më të favorshëm për parashtruesin atij i ka hequr dënimin plotësues të shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë.

14. Gjykata e Apelit e ka arsyetuar aktgjykimin si vijon: "*Sipas mendimit të Kolegjit të Apelit, i kundërt me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë, krahasimi i elementeve ligjore të veprave penale të Shpërdorim i pozitës zyrtar apo autorizimit dhe nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore qojnë në konkluzionin se ky i* fundit *është krim-më specifik që përfshin veprën penale të Shpërdorim i pozitës zyrtar apo autorizimit me zbatimin e parimit lex specialis derogate lex generali".*

15. Gjykata, më tej, ka arsyetuar se "*Ky keqaplikim i Ligjit penal nga trupi gjykues është në dëm të të akuzuarit sepse ka* mundur *të ketë ndikim në caktimin e dënimit pasi që të dy dispozitat penale parashohin dënime të ndryshme: për veprën penale të Shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimit parashihet dënimi prej një deri në tetë vjet burgim, ndërsa për veprën penale te nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, parashihet dënimi prej gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim. Dhe "Për këto arsye Kolegji i apelit modifikon Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe të akuzuarin Kolë Puka e shpall fajtor për veprën penale te nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore".*

16. Më 4 shkurt 2014, parashtruesiparaqiti një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

17. Më 19 shkurt 2015, Gjykata Supreme vendosi sipas kërkesës së parashtruesit dhe pas marrjes së mendimit nga zyra e Kryeprokurorit

të Shtetit nxori Aktgjykimin, PML.-KZZ. nr. 170/2014. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur nga parashtruesi, është gjetur si pjesërisht e bazuar,ashtu që aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe të Apelit ndryshohen sa i përket sanksionit penal, në atë mënyrë që parashtruesi, dënohet me 6 (gjashtë) muaj më pak vuajtje të dënimit me burg.

18. Gjykata Supreme ndryshimin e aktgjykimit, e kishte bazuar kryesisht, në vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për parashtruesin nga ana e gjykatave të rregullta, dhe me at rast, ndërmjet të tjerash ka arsyetuar: *"Prandaj, Gjykata Supreme konsideron se Gjykata e Apelit ka bërë shkelje të Ligjit penal gjatë shqiptimit të dënimit maksimal të aplikueshëm për veprën penale duke nxjerrë vendimin gjyqësor të kundërligjshëm. Sipas nenit 438 paragrafit 1 nën-paragrafit 1.1 Gjykata Supreme, duke u pajtuar me të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të përmendura në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ndryshon aktgjykimin dhe përcakton se dënimi prej 4 (katër) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj është proporcional".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Kosovës për Gjykim të drejtë dhe Gjykim të Paanshëm (neni 31 i Kushtetutës), rasti i tij penal kishte qenë i ndarë në 5 (pesë) raste penale edhe pse të gjitha rastet ishin për të njëjtën çështje. Parashtruesi i kërkesës pretendon se procedura rezulton shkeljen e nenit 31.5 të Kushtetutës, që i referohet prezumimit të pafajësisë.

20. Parashtruesi më tej, ka pretenduar, se përbërja e panelit gjyqësor në Gjykatën Supreme nuk ka qenë e përcaktuar në përputhje me Ligjin për kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, Nr. 03/L-053.

21. Parashtruesi ka kërkuar nga Gjykata që të anulojë të gjitha aktgjykimet e gjykatave të rregullta dhe lëndën ta kthejë në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Për të gjykuar lidhur me kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

24. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese që përcakton:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".

25. Gjykata vë në dukje se parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me vendimin e kontestuar është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31.1, 2 dhe 3 të Kushtetutës.

26. Gjykata me këtë rast përkujton se Kushtetuta e Kosovës, në dispozitat e kontestuara nga parashtruesi përcakton:

Neni 31 i Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm, lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij, brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

27. Për të vendosur në mënyrë meritore lidhur me kërkesën, Gjykata gjithashtu merr parasysh dispozitat e Ligjit për gjykatat 2010/03-L-199,tëdekretuar më 9 gusht 2010, ku është përcaktuar:

Neni 21 Gjykata Supreme

1. Gjykata Supreme e Kosovës është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë dhe ka jurisdikcion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

[...]

dhe

Neni 22 Kompetencat e Gjykatës Supreme

1.3. përcakton qëndrimet parimore dhe mendimet juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës;

[...]

28. Duke vlerësuar kushtetutshmërinë e aktgjykimit të kontestuar në prizmën e pretendimeve për shkelje kushtetuese, dhe fakteve që kanë mbështetur këto pretendime, duke i krahasuar këto fakte me përmbajtjen e dispozitave si më lart Gjykata konstaton, se nuk gjen argumente të kenë ndodhur shkelje të dispozitave kushtetuese aq më tepër, kur këto pretendime kanë qenë të karakterit thjesht ligjor dhe jokushtetues, dhe se Gjykata jep përgjigje efektive ndaj këtyre pohimeve. Kjo Gjykatë nuk mund të veprojë si Gjykatë e shkallës së katërt duke respektuar interpretimin e saktë të ligjit.

29. Gjykata rikujton se parashtruesi beson se ndarja e një rasti penal në disa të tjerë sipas tij rezulton me shkelje substanciale të procedurës penale, Ligjit penal dhe të të drejtave të pandehurit, por që këtë pohim Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj në paragrafin 60 e ka refuzuar si të pabazuar.

30. Lidhur me pretendimin për përbërjen joligjore të panelit gjyqësor të Gjykatës Supreme, që ka vendosur për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata thekson se kjo çështje ka të bëjë me aplikimin e drejtë të ligjit, e që është kompetencë ekskluzive e gjykatave të rregullta.

31. Për më tepër, vet Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj, në paragrafët 50-57 në mënyrë ekstensive dhe bindëse ka shpjeguar kompozicionin e panelit gjyqësor duke marrë parasysh të gjitha aktet juridike vendore, Marrëveshjen Ndërkombëtare me Misionin e Bashkimit Evropian të ratifikuar me Ligjin, 04 L-274, të shpallur nga Presidentja më 7 maj 2014, dhe Konventën e Vjenës.

32. Për t'u trajtuar si çështje kushtetuese në relacion me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), kompozicioni i panelit gjyqësor do të duhej të ishte tregues i qartë i anshmërisë në gjykim. Por në këtë rast anshmëria e Kolegjit gjyqësor, as është kontestuar e as është dëshmuar nga parashtruesi andaj në këto rrethana nuk ka ndonjë dëshmi se mund të konstatohet shkelje e nenit 31 të Kushtetutës apo nenit 6 të KEDNJ-së.

33. Gjykata thekson se përshkrimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës dhe pretendimi, se ato janë shkelur pa paraqitur fakte për mënyrën e shkeljes, pa përcaktuar rrethanat e shkeljeve të pretenduara, ose, pa specifikuar veprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me gjykimin e drejtë e të paanshëm, nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së, lidhur me një proces të rregullt dhe të paanshëm.

34. Gjykata më tej konstaton se aktgjykimet e gjykatave të rregullta të cilat i konteston parashtruesi, në respektimin substancial të të drejtave të njeriut duke i ofruar të gjitha mundësitë procedurale e përmbajtjesore parashtruesit, të jetë palë e barabartë dhe aktive në të gjitha fazat e procesit gjyqësor. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit në mënyrë specifike mbështetet mbi praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të gjykatave të tjera ndërkombëtare, si dhe raste nga praktika gjyqësore vendore duke shqyrtuar ankesën e parashtruesit.

35. Si përfundim, Gjykata thekson se ajo nuk është gjykatë e faktit, nuk gjykon si gjykatë e shkallës së katërt dhe nuk është thjeshtë një instancë gjyqësore më tepër. Për Gjykatën janë thelbësore çështjet prej ekzistimit të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të së drejtave kushtetuese, dhe jo çështjet qartazi ligjore. (Shih*, mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65). Në këtë rast, parashtruesi kryesisht ka paraqitur pretendimet për shkeljet ligjore, jo shkeljet kushtetuese.

36. Gjykata thekson se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të rregullt të vendosin për renditjen e rëndësisë së provave, dhe të çmojnë se cila provë në vështrim të zbatimit të drejtë të ligjit në fuqi mbizotëron. Në rastin konkret padyshim, se i ka takuar Gjykatës Supreme të vendosë sa është i drejtë qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë apo i asaj të Apelit, dhe këtë ta sanksionojë me vendim të saj përfundimtar gjyqësor.

37. Duhet të theksohet se Kushtetuta e Kosovës në nenin 103.2 ka përcaktuar se Gjykata Supreme është autoriteti më i lartë gjyqësor, ndërsa ligji për gjykatat, Gjykatës Supreme i ka dhënë kompetencë "*zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës"* dhe

rrjedhimisht, edhe unifikimin e praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta.

38. Në këtë drejtim, Gjykata nuk gjen se arsyetimet e ndryshme të gjykatave të dy instancave gjyqësore kanë rezultuar me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, sepse Aktgjykimi përfundimtar i Gjykatës Supreme ka përmbyllur vlerësimin edhe të gjendjes faktike edhe të aplikimit të ligjshmërisë, dhe në asnjë mënyrë parashtruesi nuk ka provuar që Aktgjykimi i kontestuar të jetë tregues i ndonjë arbitrariteti të dukshëm që kërkon anulimin e tij në baza kushtetuese.

39. Në këto rrethana të rastit, Gjykata nuk ka mundur të gjejë se është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm (Shih gjithashtu Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, Rasti KI128/12, i 12 korrikut 2013, të parashtruesit *Shaban Hoxha*, në kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 316/2011).

40. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e tij të drejtë kushtetuese apo të të drejtave të garantuara me KEDNJ, andaj me vendimin e kontestuar nuk ka shkelur të drejtat e njeriut të parashtruesit. Prandaj, Gjykata gjen se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 48 të Ligjit, dhe me rregullat 36.1 (c), 36 (2) b) dhe d) si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 11 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI47/15 dhe KI48/15, Parashtrues Beqir Koskoviku dhe Mustafë Lutolli - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I1-14-0057, i 12 marsit 2015

KI47/15 dhe KI48/15, Aktvendim për papranueshmëri i 11 shtatorit 2015, publikuar më 4 nëntor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, arondimi i tokës, mbrojtja e pronës*

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme kishte refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruesve përkitazi me të drejtën pronësore ndaj disa sipërfaqeve të aronduara të tokës. Parashtruesit u ankuan në Gjykatën Kushtetuese me pretendimet për shkelje të së drejtës në pronë.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi sepretendimet e paraqitura në kërkesë vetëm kanë potencuar shkeljen e dispozitave kushtetuese, por nuk kanë ofruar asnjë provë të vetme për mënyrën dhe natyrën e shkeljes, për rrethanat eventuale në të cilat shkelja e pretenduar ka ndodhur, si dhe nuk kanë shpjeguar cilat janë pasojat kushtetuese të shkeljeve të pretenduara.Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI47/15 dhe KI48/15
Parashtrues
Beqir Koskoviku dhe Mustafë Lutolli
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-II-14-0057,
të 12 marsit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: z. Beqir Koskoviku nga fshati Barilevë, komuna e Prishtinës, dhe z. Mustafë Lutolli nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-II-14-0057 (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave i DHPGJS), i 12 marsit 2015, të cilin parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar më 8 prill 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, për të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) sipas nenit 46 (Mbrojtja e Pronës).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregulloja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 17 prill 2015, parashtruesit i dorëzuan kërkesat në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 2 qershor 2015, me Vendimin GJR. KI47/15, Kryetari i Gjykatës, caktoi gjyqtarin Altay Suroygjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 15 qershor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin e parë për regjistrimin e kërkesës, si dhe një kopje të kërkesës i dërgoi Gjykatës Supreme.

8. Më 10 shtator 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin e dytë për regjistrimin e kërkesës, dhetë njëjtën ditë në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetarja urdhëroi që kërkesat KI47/15 dhe KI48/15 të bashkohen në një të vetme, dhe që gjyqtari raportues dhe Kolegji shqyrtues për të dy rastet (KI47 dhe KI48/15) të jenë të njëjtë ashtu siç ishte vendosur për kërkesën KI47/15.

9. Më 10 shtator 2015, Gjykata njoftoi palët për bashkimin e kërkesës, dhe Gjykatës Supreme i dërgoi kopjet e kërkesave.

10. Më 11 shtator 2015, Kolegjishqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

11. Më 21 mars 2006, prindërit e parashtruesve B. K. dhe A. L. (tani të ndjerë) kishin parashtruar padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për njohjen e të drejtës së pronësisë mbi parcelat e tokës të cilat gjenden në Fushë-Kosovë. Në të gjitha procedurat e mëtejme gjyqësore, statusi i trashëgimtarit dhe legjitimiteti i palës për përfaqësim në procedurë lidhur me interesin për parcelën objekt i të cilës ishte padia i është njohur parashtruesve të kërkesës.

12. Parashtruesit pretendonin se në bazë të një marrëveshje mbi arondimin që kishte lidhur me KBI ”Kosova Export” (në tekstin e

mëtejmë: KBI) në vitin 1981, atyre u ishte dhënë më pak sipërfaqe toke se sa që ata i kishin dhënë KBI-së, dhe nëpërmjet padisë synonin të përmbushnin marrëveshjen në tërësi, duke kërkuar të përfitojnë edhe pjesën e mbetur të sipërfaqes tokësore që, sipas tyre, KBI nuk ua kishte dhënë.

13. Më 24 tetor 2006, DHPGJ-ja me Aktvendimin SCC-06-0117 lëndën e ka referuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

14. Më 7 tetor 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë ka nxjerrë Aktgjykimin C. nr. 2272/06, me të cilin ka refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit, dhe me atë rast ndër të tjera ka konstatuar: "*Sipas vlerësimit të Gjykatës, posedimi i paluajtshmërisë lëndore me vite dhe ndërtimi i objekteve në paluajtshmëri lëndore, nuk mund të paraqet bazë të vlefshme juridike për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi bazën e arondimit, në kuptim të dispozitës së nenit 20 par. 2 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore pronësore juridike*".

15. Gjykata më tej ka arsyetuar se *"Kjo formë e fitimit të së drejtës së pronësisë mbi bazën e cituar më lart, do të ishte e pranueshme për gjykatën, nëse palët paditëse do t'i prezantonin gjykatës vendime përkatëse të organit mbi arondimin e paluajtshmërive lëndore. Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata gjen se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar dhe të njëjtën si të tillë edhe e refuzoi në tërësi"*.

16. Më 22 janar 2009, parashtruesit bashkërisht kanë paraqitur ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

17. Më 8 maj 2013, Gjykata e Apelit në Prishtinë e kishte pranuar dosjen nga Gjykata Komunale dhe nëpërmjet një parashtrese, dosjen së bashku me ankesë e ka dërguar në DHPGJS për kompetencë të mëtejme.

18. Më 16 dhjetor 2014, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së me Aktvendimin C-III-13-0323 e ka mbyllur dosjen dhe ka urdhëruar Zyrën e Regjistrimit që ankesën ta regjistrojë si lëndë për Kolegjin e Apelit, e cila pastaj mori numrin AC-II-14-0057.

19. Më 12 mars 2015, Kolegji i Apelit i DHPGJS me Aktgjykimin AC-II-14-0057, ankesën e parashtruesit e ka refuzuar si të pabazuar dhe ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 2272/06, të 7 tetorit 2008.

20. Kolegji i Apelit i DHPGJSnë Aktgjykimin e lartpërmendur ndërmjet të tjerave kishte arsyetuar: "*Kolegji i Apelit vlerëson se me Aktgjykimin e ankimuar nuk janë shkelur dispozitat procedurale apo se është vërtetuar gabim gjendja faktike siç pohojnë ankuesit në ankesë*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesit e kërkesës kanë pretenduar se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe në mënyrë specifike të drejtën e pronës sepse, gjithmonë sipas tyre, pas një procesi të rregullt të arondimit, atyre u është marrë më shumë sipërfaqe toke se sa që u është dhënë.

22. Parashtruesit kanë kërkuar nga Gjykata që të anulojë Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS, dhe lëndën ta kthejë në rivendosje.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Për të gjykuar lidhur me kërkesën e parashtruesve, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

25. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".*

dhe rregullin 36 (2) të Rregullores i cili parasheh:

> *"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

26. Ashtu siç u përmend më lart, Gjykata konstaton se parashtruesit pohojnë se me Aktgjykimin e kontestuar, u është shkelur e drejta në mbrojtje të pronës (neni 46 i Kushtetutës) i cili ka këtë përmbajtje:

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.

4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë eksproprijimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

27. Duke vlerësuar pretendimet e paraqitura në kërkesë Gjykata thekson se parashtruesit vetëm kanë potencuar shkeljen e këtyre dispozitave kushtetuese, por nuk kanë ofruar asnjë provë të vetme për mënyrën dhe natyrën e shkeljes, për rrethanat eventuale në të cilat shkelja e pretenduar ka ndodhur, si dhe nuk kanë shpjeguar cilat janë pasojat kushtetuese të shkeljeve të pretenduara.

28. Gjykata konsideron se vetëm përshkrimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës, si dhe pretendimi se ato janë shkelur pa paraqitur fakte

për mënyrën e shkeljes, pa përcaktuar rrethanat, pa specifikuar dhe mbështetur me fakte valide veprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me normat kushtetuese, nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur Gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së.

29. Gjykata duke bërë shqyrtimin e kërkesës së parashtruesve dhe të fakteve të paraqitura me kërkesën, gjen se në të gjitha fazat e procesit gjyqësor ankesat e parashtruesve kanë qenë të karakterit ligjor, dhe se gjykatat e rregullta u kanë dhënë përgjigjeje adekuate këtyre ankimeve. Pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë, për herë të parë janë ngritur në Gjykatën Kushtetuese.

30. Gjykata më tej konstaton se ajo nuk është gjykatë e faktit, nuk gjykon si gjykatë e shkallës së katërt dhe nuk është thjeshtë një instancë më tepër gjyqësore. Gjykata në parim nuk gjykon faktin nëse gjykatat e rregullta në mënyrë të drejtë dhe të plotë e kanë konstatuar gjendjen faktike, apo nëse si në rastin konkret, nëse arondimi ka qenë proces i rregullt dhe i përmbushur në tërësi sepse kjo është kompetencë e gjykatës së rregullt dhe në fakt, edhe Gjykata Komunale edhe Kolegji i Apelit i DHPGJS këtyre pretendimeve të ngritura u kishin dhënë përgjigje adekuate në aktgjykimet e lartpërmendura.

31. Për Gjykatën janë thelbësore çështjet prej ekzistimit të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të së drejtave kushtetuese, dhe jo çështjet qartazi ligjore që kryesisht kanë qenë fakte të paraqitura nga parashtruesi (Shih, *mutatis mutandis*, i.a., *Akdivar kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

32. Në këto rrethana, Gjykata nuk gjen fakte të jetë shkelur neni 46 i Kushtetutës (Mbrojtja e Pronës)ose që Aktgjykimi i kontestuar të jetë tregues i ndonjë arbitrariteti të dukshëm (ShihAktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, Rasti KI128/12, i 12 korrikut 2013,parashtrues *Shaban Hoxha*, kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 316/2011).

33. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesit në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtës kushtetuese për mbrojtjen e pronës, andaj gjen se kërkesa duhet refuzuar si qartazi e pabazuar dhe të deklarohet si e papranueshme

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) c), 36 (2) b) dhe d) si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 11 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI79/15, Parashtruese Loresa Fetahu - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Pml. nr. 83/2015 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës i 30 prillit 2015

KI79/15, Aktvendim për papranueshmëri i 11 shtatorit 2015 publikuar më 4 nëntor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, Masë e përkohshme, moszbulim i identitetit, barazia para ligjit, ekzekutim i dënimit, dënim me burgim, vepra penale e grabitjes*

Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtrueses përkitazi me dënimin me burg, për shkak të kryerjes së veprës penale të grabitjes. Parashtruesja u ankua në Gjykatën Kushtetuese me pretendimet për shkelje të parimit të barazisë para ligjit. Parashtruesja, po ashtu, kërkoi vënien e Masës së përkohshme dhe moszbulimin e identitetit të saj.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi separashtruesja e kërkesës nuk ka sqaruar me saktësi se si dhe pse vendimet e kontestuara, me të cilat ishte refuzuar kërkesa e saj për mbrojtje te ligjshmërisë përbëjnë shkelje të të drejtave dhe lirive të saj individuale, të garantuara me Kushtetutë, dhe as nuk ka paraqitur dëshmi për të arsyetuar pretendimin për një shkelje të tillë. Gjykata, po ashtu, refuzoi vënien e Masës së përkohshme dhe kërkesën për mos zbulim të identitetit. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me nenet 27 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI79/15
Parashtrues
Loresa Fetahu
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Pml. nr. 83/2015, të 30 prillit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Loresa Fetahu, nga Lupçi i Poshtëm, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (Pml. nr. 83/2015), të 30 prillit 2015, me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtrueses për mbrojtje të ligjshmërisë. Aktgjykimi i kontestuar i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili, pretendohet të ketë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht neni 24, paragrafi 1 dhe 2 [Barazia para Ligjit].

4. Parashtruesja e kërkesës, gjithashtu, kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vendosë Masë të përkohshme, gjegjësisht, të parandalojë ekzekutimin e dënimit ndaj saj, e cila, me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR. nr. 247/14, të 1 tetorit 2014, ishte dënuar me burgim prej 1 (një) viti.

5. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata të mos e zbulojë identitetin e saj.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 17 qershor 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 29 qershor 2015, Kryetarja caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 10 korrik 2015, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

10. Më 11 shtator 2015, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës, në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 1 tetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi PKR. nr. 247/14), shpalli parashtruesen e kërkesës dhe A.C. fajtore për veprën penale të grabitjes, në pajtim me nenin 329, paragrafi 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së dhe u dënuan me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

12. Parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke pretenduar që: "... *gjykata nuk ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë*

që dënimi të jetë adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarës".

13. Më 26 shkurt 2015, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR. nr. 18/2015) e refuzoi, si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke konstatuar që:

> *"[...] duke shqyrtuar aktgjykimin e kundërshtuar përkitazi me të akuzuarën Loresa Fetahu, kjo* Gjykatë *vlerëson se pretendimet e mbrojtjes për një dënim më të butë nuk janë të bazuara. Në fakt, qëndrojnë rrethanat lehtësuese në të cilat thirret mbrojtësja e të akuzuarës, por nuk janë të asaj natyre që justifikojnë një dënim më të butë me burg sesa ai i shqiptuar nga shkalla e parë. Pra, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarës Loresa Fetahu nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është adekuat me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarës dhe me të do të mund të ndikohet në parandalimin e saj nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe në rehabilitimin e saj, respektivisht do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së".*

14. Me të njëjtin vendim, Gjykata e Apelit e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në lidhje me A. C. duke konstatuar se:

> *"Gjykata e Apelit vlerëson se ankesa e mbrojtëses së të akuzuarës A.C. për një dënim më të butë është e bazuar për këtë arsye: e akuzuara është e moshës së re, e gjendjes së dobët ekonomike, ka pasur sjellje korrekte gjatë zhvillimit të procedurës penale, e ka pranuar fajësinë, ka shprehur pendim të thellë për veprën e kryer, gjë që e theksoj edhe në seancën e Kolegjit të kësaj gjykate. Duke pasur parasysh këto rrethana veçanërisht faktin se e akuzuara është viktimë e trafikimit me qenie njerëzore në lëndën penale për të cilën çështje janë duke u zhvilluar hetimet dhe gjendjen e saj jo të mirë shëndetësore, gjë që vërtetohet nga dokumentet mjekësore por është vërejtur edhe në seancën e Kolegjit – pengesa në të folur, shikim dhe shtangim të fytyrës, kjo Gjykatë vlerëson se edhe me kërcënimin për dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj, të akuzuarës dënimin e shqiptuar me burg në kohëzgjatje prej një viti ia kushtëzoj me bindje se ky dënim është adekuat me peshën dhe rrezikshmërisë shoqërore dhe do të ndikohet tek e njëjta në të ardhmen që të mos kryejë vepër penale".*

15. Parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore, duke pretenduar: *"shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së Ligjit penal në dëmin*

e të gjykuarës. Pasi që janë shkelur dispozitat e përmendura më sipër në këtë kërkesë janë shkelur kundër saj, fakte të cilat kanë ndikuar që Kodi Penal të zbatohet gabimisht ndaj saj".

16. Më 30 prill 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 83/2015) refuzoi kërkesën e parashtrueses për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke konstatuar se *"aktgjykimet e kundërshtuara janë të qarta dhe dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë përmban të gjitha elementet të cilat përbëjnë figurën e veprës penale, për të cilën e dënuara është shpallur fajtore".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta, duke refuzuar kërkesën e saj për mbrojtje të ligjshmërisë, kanë shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht të drejtat që kanë të bëjnë me *"barazi para ligjit".*

18. Parashtruesja e kërkesës pretendon se *"[...] Gjykata Supreme duke refuzuar ankesën e parashtrueses së kërkesës, ndërsa ka aprovuar ankesën e personit tjetër të akuzuar (bashkë-kryerësja A. C.) dhe ka ndryshuar dënimin me burg në dënim me kusht, ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë".*

19. Parashtruesja e kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata: *"që të sigurojë që të gjitha palët të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe në këtë mënyrë të shqiptojë dënimin me kusht edhe për parashtruesen e kërkesës".*

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

22. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(1) Gjykata mundt'ishqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e *pabazuar.*

(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin
për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

23. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (Pml. nr. 83/2015), duke pretenduar se është shkelur e drejta e saj për barazi para ligjit.

24. Gjykata vëren se Gjykata Supreme i është përgjigjur këtij pretendimi, duke konstatuar që: "*nuk ka shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarës nga ana a e gjykatës së shkallës së dytë gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin, sa i përket të dënuarës A.C., në dëm të të dënuarës Loresa Fetahu, meqenëse përgjegjësia është individuale, andaj edhe dënimet janë individuale dhe rrethanat qofshin ato rënduese apo lehtësuese vlerësohen individualisht për secilin të dënuar, ashtu siç ka vepruar në këtë rast edhe gjykata e shkallës se dytë kur ka vendosur lidhur me pretendimet ankimore për të dënuarat...".*

25. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës nuk ka sqaruar me saktësi se si dhe pse vendimet e kontestuara, me të cilat ishte refuzuar kërkesa e saj për mbrojtje të ligjshmërisë, përbëjnë shkelje të të drejtave dhe lirive të saj individuale, të garantuara me Kushtetutë, dhe as nuk ka paraqitur dëshmi për të arsyetuar pretendimin për një shkelje të tillë.

26. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të Ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga autoritetet publike, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).

27. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta apo nga autoritetet tjera publike. Është roli i gjykatave të rregullta apo autoriteteve të tjera publike, kur kjo është e mundur, që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28, shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese KI70/11, *parashtrues të kërkesës:Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

28. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me Kushtetutë (Shih, *Vanek kundër Republikës* së *Sllovakisë,* nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005) dhe nuk ka saktësuar se si nenet e përmendura të Kushtetutës e mbështesin pretendimin e saj, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 48 të Ligjit.

29. Prandaj, Gjykata konkludon se, në pajtim me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës kërkesa është e papranueshme.

Kërkesa për Masë të përkohshme

30. Siç u theksua më lart, parashtruesja gjithashtu kërkon nga Gjykata që të merr *"vendim me të cilin do të caktohet masa e sigurisë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR. nr. 247/14, për mosekzekutim të dënimit [...]".*

31. Siç është përmendur më lart, parashtruesja nuk ka treguar rast *prima facie* mbi pranueshmërinë e kërkesës. Prandaj, në bazë të rregullit 55 të Rregullores së punës, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.

Kërkesa për moszbulimin e identitetit

32. Sa i përket kërkesës së parashtrueses për të mos zbuluar identitetin e saj, Gjykata e refuzon kërkesën e saj si të pabazuar, sepse nuk është paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës dhe informatë lidhur me arsyet që parashtrueses së kërkesës të mos i zbulohet identiteti i saj. Përveç kësaj, Gjykata vëren se identiteti i parashtrueses së kërkesës tashmë është zbuluar në procedurat e gjykatave të rregullta.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, neneve 27 dhe 47 të Ligjit, rregullit 36 (2) (b) dhe (d), 55 (4) dhe (5), si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 11 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. TA REFUZOJË kërkesën e parashtrueses për moszbulim të identitetit;

IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

V. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI44/15, Parashtrues Hava Bajgora, Alban Bajgora dhe Sylejman Bajgora - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit nr. 356-65493 të Drejtorisë së Inspekcionit, Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, i 20 marsit 2015

KI44/15, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shtatorit 2015, publikuar më 9 nëntor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kontratë shitblerjeje, mosshterim i mjeteve juridike, barazia para ligjit, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, mbrojtja e pronës, shëndeti publik*

Drejtoria e Inspekcionit në Prishtinë, kishte marrë vendim për rrënimin e objektit në pronësi të parashtruesve, për shkak se paraqiste rrezik për shëndetin publik. Parashtruesit u ankuan në Gjykatën Kushtetuese me pretendimet për shkelje të parimit të barazisë para ligjit dhe të drejtës në pronë.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se ekzistojnë mjete tjera juridike që parashtruesit mund t'i shterin, lidhur me ankesat e tyre dhe se është përgjegjësi e tyre që të shfrytëzojnë të gjitha mjetet e efektshme juridike para se të parashtrojnë kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së ndonjë akti të autoritetit publik në Gjykatën Kushtetuese. Kërkesa u shpall e papranueshme për mosshterim të mjeteve juridike në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI44/15
Parashtrues
Hava Bajgora, Alban Bajgora dhe Sylejman Bajgora
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Drejtorisë së Inspekcionit, Sektori i Ndërtimit iKomunës së Prishtinës, nr. 356-65493, të 20 marsit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: znj. Hava Bajgora, z. Alban Bajgora dhe z. Sylejman Bajgora nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit), të cilët përfaqësohen nga z. Fatbardh Makolli, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit kontestojnë Aktvendimin (nr. 356-65493, të 20 marsit 2015) e Drejtorisë sëInspekcionit, Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: Drejtoria e Inspekcionit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesësështë vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e parashtruesve të garantuara me nenin 24 [Barazia Para Ligjit]; nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës]; nenin 54 [Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 15 prill 2015, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 2 qershor 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI44/15, caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI44/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

7. Më 5 qershor 2015, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ata që të specifikojnë vendimin e fundit të kontestuar, si dhe të dorëzojnë dokumente të tjera relevante lidhur me rastin.

8. Më 17 qershor 2015, parashtruesit iu përgjigjën kërkesës së Gjykatës.

9. Më 24 qershor 2015, kopja e kërkesës iu dërgua Drejtorisë së Inspekcionit.

10. Më 10 shtator2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin e gjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në vitin 2001, z. Shefqet Bajgora, bashkëshorti tashmë i ndjerë i parashtrueses znj. Hava Bajgora dhe baba i parashtruesve z. Alban dhe z. Sylejman Bajgora, kishte lidhur një kontratë të shitblerjes për një objekt në Prishtinë.

12. Më 20 mars 2015, Drejtoria e Inspekcionit (Aktvendimi nr. 356-65493) urdhëroi rrënimin e objektit të z. Shefqet Bajgora, bashkëshortit, përkatësisht babait të ndjerë të parashtruesve, të cilët në bazë të certifikatës të bashkësisë familjare që i është bashkëngjitur dokumentacionit të rastit, supozohen të jenë trashëgimtarët e tij. Në arsyetim të këtij aktvendimi u theksua:

"[...] Inspektori i ndërtimit i Drejtorisë së Inspekcionit të Komunës së Prishtinës, pas kontrollit të bërë me procesverbal të dt. 20.03.2015, konstatoi se: objekti [...] ka pësuar dëmtime serioze dhe është i pambrojtur prandaj si i tillë përbën rrezik për shëndetin publik, ambientin dhe banorët e zonës.

Në bazë të nenit 34 paragrafi 1.2 dhe 3 të Ligjit nr. 04/L-110 për ndërtim, neni 17 pika 1 dhe 2, neni 39 pika 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit nenin 4 dhe neni 19 paragrafi 6 pika 6.1, 6.2 të udhëzimit administrativ MMPH Nr. 18/2013 për standardet minimale dhe procedurat për mbikëqyrje inspektive dhe lëshim të certifikatës së përdorimit, Inspektori i ndërtimit konstaton se objekti në fjalë paraqet rrezik për ambientin, rrezikon pronën e tjetrit dhe jetën e personave [...]".

13. Në fund të aktvendimit të lartpërmendur theksohet me sa vijon:

"[...] UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi. Ankesa i ushtrohet Komisionit për shqyrtimin e ankesave në Komunën e Prishtinës".

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesit pohojnë se Drejtorati i Inspekcionit ka rrënuar objektin e tyre pa dijen dhe njoftimin e tyreparaprak, vetëm një ditë pas nxjerrjes së aktvendimit të kontestuar, dhe në këtë mënyrë u ka shkelur atyre të drejtën për barazi para ligjit, të drejtën për mjete juridike, të drejtën për mbrojtjen e pronës si dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, siç garantohen me Kushtetutë.

15. Më tutje, parashtruesit pretendojnë se mosdorëzimi i njoftimit për rrënim të objektit të tyre *"ju ka pamundësuar të drejtën në parashtrimin e provave dhe fakteve apo të drejtën e ankesës dhe të pjesëmarrjes në procedurat administrative në Komunë".*

16. Në fund, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të anulojë vendimin e kontestuar si *"kundërkushtetues"* si dhe të *"sanojë gjendjen e shkaktuar nga organet e komunale",* pa specifikuar se çfarë nënkuptojnë me sanim të gjendjes së shkaktuar.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit i kanë përmbushur kushtet e nevojshme të pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës i cili parasheh:

> *"[...] 7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

19. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"[...] Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

20. Më tutje, Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë vetëm nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(b) janështeruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar".*

21. Siç u tha më lart, parashtruesit kontestojnë Aktvendimin (nr. 356-65493, të 20 marsit 2015) e Drejtorisë së Inspekcionit, nëpërmjet të cilit ishte urdhëruar rrënimi i objektit të tyre. Parashtruesit pretendojnë se Drejtoria e Inspekcionit, me këtë rast, u ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 24, 32, 46 dhe 54 të Kushtetutës.

22. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se vendimi i kontestuar është vendim i shkallës së parë në procedurë administrative pranë Komunës së Prishtinës, dhe se ndaj të njëjtit ishte e lejuar ankesa, e cila do të shqyrtohej nga Komisioni për shqyrtim të ankesave të Komunës së Prishtinës.

23. Parashtruesit nuk kanë dorëzuar në Gjykatë ndonjë provë që dëshmon se ata janë ankuar kundër vendimit të kontestuar. Përveç kësaj, parashtruesit nuk kanë treguar nëse ata kanë bërë ndonjë përpjekje

tjetër nëpërmjet mjeteve të tjera juridike për t'i siguruar të drejtat ligjore dhe kushtetuese, të cilat pretendojnë se u janë shkelur.

24. Prandaj, Gjykata konsideron se në këtë rast, kërkesa e parashtruesve është e parakohshme, pasi që procedura për ankesë para organit të shkallës së dytë të Komunës së Prishtinës është ende në pritje, apo nuk është iniciuar fare nga parashtruesit.

25. Përveç kësaj, Gjykata vëren se ekzistojnë mjete të tjera juridike të cilat parashtruesit mund t'i shterin lidhur me ankesat e tyre, dhe se është përgjegjësi e tyre, që të shfrytëzojnë të gjitha mjetet e efektshme juridike para se të parashtrojnë kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së ndonjë akti, të ndonjë autoriteti publik në Gjykatën Kushtetuese.

26. Gjykata thekson se parimi i subsidiaritetit kërkon që para se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, parashtruesit duhet t'i shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalojnë shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë, apo të korrigjojnë shkeljet eventuale të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

27. Arsyetimi mbi kërkesën e shterimitështë që t'iu ofrojnë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat e rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës. (Shih, Aktvendimi për papranueshmëri: *AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës,* KI41/ 09, të 21 janarit 2010, dhe shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, vendim i 29 korrikut 1999).

28. Në përfundim, Gjykata konsideron se në këtë rast nuk ka vendim përfundimtar nga organi kompetent, i cili në këtë fazë do të mund të ishte objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesve është e parakohshme, për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 47 të Ligjit si dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, më 10 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI53/15, Heset Neziri- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 223/2014, i 26 nëntorit 2014

KI53/15, Aktvendim për papranueshmëri i 11 shtatorit 2015, publikuar më 10 nëntor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, barazia para ligjit, e drejta në gjykim të drejtë, dënim me burgim, pjesëmarrje në rrahje, posedim i paautorizuar i armëve*

Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi përkitazi me dënimin e tij për kryerjen e veprës penale, pjesëmarrje në rrahje. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm,për shkak se gjykatat nuk kishin marrë në pyetje dëshmitarin e propozuar nga ai.

Gjykata Kushtetuese vërejti se parashtruesinuk pajtohet me vlerësimin e fakteve dhe me zbatimin e dispozitave procedurale dhe ligjore nga gjykatat e rregullta, dhe se ai nuk ofron argumente të qëndrueshme përkatësisht, nuk dëshmon se si i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me Kushtetutë dhe Konventë. Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI53/15
Parashtrues
Heset Neziri
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. Nr. 223/2014, të 26 nëntorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Heset Neziri nga fshati Burnik, komuna e Ferizajt, të cilin e përfaqëson z. Bahtir Troshupa, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. Nr. 223/2014, i 26 nëntorit 2014, nëpërmjet të cilit kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (PAKR. Nr. 63/2014, të 19 marsit 2014) dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, (PKR 6/2013, të 3 tetorit 2013) ishte refuzuar si e pabazuar.

3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e ka pranuar më 24 dhjetor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, për të cilin parashtruesi pretendon, se i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 6 [E Drejta për një

Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), si dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 24 prill 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 2 qershor 2015, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR. KI53/15, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI53/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 10 qershor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.

9. Më 10 qershor 2015, Gjykata i dërgoi një kërkesë Gjykatës Themelore në Ferizaj që të dorëzojë një kopje të fletëkthesës, që tregon se kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. Nr. 223/2014 të 26 nëntorit 2014.

10. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI53/15 për zëvendësimin e gjyqtarit raportues, caktoi Bekim Sejdiun gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin KSH. KI53/15 për zëvendësimin e anëtarit në Kolegjin shqyrtues, caktoi gjyqtarin Altay Suroy anëtar të Kolegjit shqyrtues.

11. Më 9 korrik 2015, Gjykata Themelore në Ferizaj i dorëzoi Gjykatës kopjen e fletëkthesës, e cila tregon se parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 223/2014, më 24 dhjetor 2014.

12. Më 11 shtator 2015, Kolegjishqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 10 tetor 2011, Prokuroria e Qarkut në Prishtinë kundër parashtruesit të kërkesësngriti Aktakuzën (PP. Nr. 111-7/2010) për kryerjen e veprës penale, vrasje e rëndë të paraparë me nenin 147, paragrafi 1, nënparagrafi 9, dhe veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve të paraparë me nenin 328, paragrafi 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK).

14. Më 19 tetor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktvendimi, KA. Nr. 687/2011) e vërtetoi aktakuzën kundër parashtruesit të kërkesës dhe filloi shqyrtimin gjyqësor. Si rrjedhojë e riorganizimit të gjykatave, lënda u dërgua më tej për shqyrtim në Gjykatën Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda.

15. Më 3 tetor 2013, Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda pas shqyrtimit gjyqësor, nxori Aktgjykimin, PKR. Nr. 6/13, me të cilin parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor, për veprën penale pjesëmarrje në rrahje të paraparë me nenin 155, paragrafi 1 i KPPK-së, dhe e dënoi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

16. Gjykata Themelore lidhur me vendimin e saj, për shpalljen fajtor të parashtruesit për veprën penale pjesëmarrje në rrahje, vlerësoi si në vijim:

> *[...]*
>
> [Gjykata] *analizoi, po ashtu dëshmitëe dëshmitarëve [...] në tërësi dhe në drejtim të këtyre të akuzuarve, vlerësoi mbrojtjet e tëakuzuarve, provat materiale dhe duke çmuar të gjitha këto prova në njëndërlidhje njëra me tjetrën erdhi deri te përfundimi konkret i cekur si në dispozitiv të aktakuzës që kanë tëbëjnë me të akuzuarin Heset Neziri [...].*

17. Parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit, PKR. Nr. 6/13 të Gjykatës Themelore në Ferizaj ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, me pretendimin për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të Ligjit penal, dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.

18. Përkitazi me pretendimin për vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike, në ankesën e tij, parashtruesi ndër të tjera pohoi, se Gjykata Themelore kishte refuzuar kërkesën e tij për dëgjimin e dëshmitares së

tij, gjegjësisht bashkëshortes së tij për të vërtetuar alibinë e tij në ditën e ngjarjes dhe po ashtu pohoi se atij i ishte mohuar e drejta që gjatë procesit gjyqësor të vazhdojë të marrë në pyetje dëshmitarin kryesor të rastit, njëherazi edhe palën e dëmtuar.

19. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Ferizaj, ankesë kishte parashtruar edhe Prokurori Themelor në Ferizaj, me pretendimin për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Prokurori Themelor në Ferizaj në ankesën e tij kishte kërkuar që Gjykata e Apelit të ndryshojë Aktgjykimin dhe parashtruesin e kërkesës ta shpallë fajtor për kryerjen e veprës penale, vrasje e rëndë, të paraparë me nenin 147, paragrafi 1, nënparagrafi 9, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve të paraparë me nenin 328, paragrafi 2 të KPPK-së.

20. Më 19 mars 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi, PAKR. Nr. 63/2014) refuzoi ankesat e parashtruesit dhe të Prokurorit Themelor në Ferizaj si të pa bazuara, dhe vërtetoi Aktgjykimin, PKR. Nr. 6/13 të Gjykatës Themelore në Ferizaj të 3 tetorit 2013. Gjykata e Apelit gjeti se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

21. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Themelore në Ferizaj kishte refuzuar kërkesën e tij për dëgjimin e dëshmitarit të tij, Gjykata e Apelit konstatoi se *"[...]dëshmitë e palëve të dëmtuara i rrëzojnë këto pretendime [...], të cilët ndër të tjera kanë deklaruar dhe përshkruar veprimet e tyre e që arsyetimin e dhënë në këtë drejtim nga ana e gjykatës së shkallës së parë e pranon edhe kjo gjykatë"*.

22. Ndërsa, sa i përket ankesave të parashtruesit të kërkesës dhe Prokurorit Themelor në Ferizaj lidhur me lartësinë e dënimit, Gjykata e Apelit konstatoi se pretendimet e tyre ankimore ishin të pabazuara. Në lidhje me këtë, Gjykata e Apelit vlerësoi se: *"[...] dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve [...] nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor, dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 34 të KPK"*.

23. Më 8 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit (PKR 6/2013, të 3 tetorit 2013) të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe Aktgjykimit (PAKR. Nr. 63/2014, të 19 marsit 2014) të Gjykatës së Apelit, me pretendimin për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe Ligjit penal. Në kërkesën e tij për mbrojtje të

ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera pretendoi se gjykata në mënyrë arbitrare kishte refuzuar propozimin e tij për dëgjimin e bashkëshortes së tij për të vërtetuar alibinë e tij për mosprezencë në vendin e ngjarjes, dhe i kishte mohuar të drejtën për vazhdimin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve kryesorë, njëherazi edhe palë të dëmtuara në procedurë.

24. Më 17 nëntor 2014, Prokurori i Shtetit (Parashtresa KMLP II, Nr. 164/2014) propozoi që kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet.

25. Më 26 nëntor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi, Pml. Nr. 223/2014) e refuzoi, si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës.

26. Përkitazi me pretendimin e lartcekur të parashtruesit për refuzimin e kërkesës së tij për dëgjimin e bashkëshortes së tij, në cilësi të dëshmitares, Gjykata Supreme konstatoi se:

> *"[...] lidhur me propozimin e refuzuar që nëcilesi të dëshmitares të dëgjohet bashkëshortja e të denuarit janëdhënë arsye edhe në aktgjykimet e kundërshtuara, meqë në provat e administruara është vërtetuar kryerja e veprës penale nga idënuari i cili për njëperiudhë kohore edhe ka qenë nëarrati.*
>
> *[...]*
>
> *[ ].... arsyet e theksuara janë vlerësuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë e cila ka gjetur se provat e administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë reflektojnë vlerësim të drejtëtë provave dhe si të tilla edhe Gjykata Supreme i aprovon si tëdrejta dhe të ligjshme, për çka kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e refuzon si të pabazuar".*

27. Si përfundim, Gjykata vërtetoi se pretendimet e parashtruesit të vlerësuara nga Gjykata e Apelit dhe provat e administruara nga Gjykata e shkallës së parë reflektojnë vlerësim të drejtë të provave, dhe po ashtu, konstatoi se pretendimet e parashtruesit *"[...] përkitazi me shkeljen e Ligjit penal janë të paqarta, për faktin se shkeljet e Ligjit Penal për të cilat mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të përshkruara me dispozitën e nenit 385 e cila dispozitë ligjore në mënyrë taksative parasheh rastet se kur një vendim gjyqësor konsiderohet se është përfshirë në këto shkelje".*

Pretendimet e parashtruesit

28. Ashtu siç u cek më lart, parashtruesi në kërkesën e tij pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së, si dhe nenit 10 të DUDNJ-së.

29. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykata i ka refuzuar propozimet e tij për të dëgjuar si dëshmitar bashkëshorten e tij dhe i është mohuar e drejta që të marrë në pyetje dëshmitarin kryesor.

30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të :

> *"Shpall të pranueshëm kërkesën e parashtruesit Heset Neziri,*
> *Shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. Nr. 223/2014, të 26 nëntorit 2014 .*
> *Të kthej në shqyrtim Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pml. Nr. 223/2014, të 26 nëntorit 2014".*

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

32. Gjykata merr parasyshnenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

33. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...]

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

34. Ashtu siç u cek më lart, në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për arsye se Gjykata i ka refuzuar propozimin e tij për të dëgjuar si dëshmitar bashkëshorten e tij dhe se atij i është mohuar e drejta që të vazhdojë marrjen në pyetje të dëshmitarit kryesor.

35. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit kishte vlerësuar se dëshmitë e palëve të dëmtuara i rrëzojnë pretendimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës, dhe si rrjedhojë, e kishte vërtetuar arsyetimin e dhënë nga Gjykata Themelore në Ferizaj.

36. Në vijim, Gjykata po ashtu vëren se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj kishte vërtetuar se bazuar në administrimin e provave nga gjykata e shkallës së parë dhe arsyetimet e dhëna në aktgjykimet e kundërshtuara, ishte vërtetuar kryerja e veprës penale nga parashtruesi i kërkesës. Ndërsa, sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës lidhur me marrjen në pyetje të dëshmitar kryesor, Gjykata Supreme konstatoi se në bazë të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor, rezulton se procesi gjyqësor ishte zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore.

37. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me vlerësimin e fakteve dhe me zbatimin e dispozitave procedurale dhe ligjore nga gjykatat e rregullta. Vlerësimi i fakteve dhe ligji i aplikueshëm janë çështje të cilat bien në sferën e ligjshmërisë.

38. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit osetë ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

39. Prandaj, Gjykata nuk vepron si gjykatëe shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër*

Spanjës, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima,* Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

40. Gjykata vëren se në kërkesën e tij parashtruesi nuk ofron argumente të qëndrueshme, përkatësisht nuk dëshmon se si i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me Kushtetutë dhe KEDNJ.

41. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se fakti i thjeshtë që parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurave tëpërfunduara në gjykatat e rregullta nuk është i mjaftueshëm që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese (Shih, *mutatis mutandis,* rastin *Mezőtúr-Tiszazugi Vízgazdálkodási Társulat kundër Hungarisë,* Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21). Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës (Shih Rastin KI198/13,parashtrues i kërkesës*Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014).

42. Përveç kësaj, siç u cek më lart, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjeti se procedurat në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe në Gjykatën e Apelit nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

43. Në fund, Gjykata rithekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë argument bindës që do të vërtetonte se shkeljet e pretenduara, të përmendura në kërkesë, përbëjnë shkelje të së drejtës së tij të garantuar me Kushtetutë (Shih rastin *Vanek kundër Republikës Sllovake*, Nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005).

44. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata përfundon se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tij për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

45. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1), d) dhe (2), b) dhe d) të Rregullores së punës, më 5 nëntor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI61/15, Islam Krasniqi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, A. A. nr. 2/2014, i 21 shkurtit 2014

KI61/15, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shtatorit 2015, publikuar më 10 nëntor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme, komisioni disiplinor, ndërprerje e marrëdhënies së punës, barazia para ligjit, e drejta në punë, e drejta në gjykim të drejtë, përgjegjësia e avokatit*

Gjykata e Apelit të Kosovës kishte refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruesit përkitazi me ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të së drejtës në punë, gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe barazi para ligjit, dhe për papërgjegjshmërinë e avokatit të tij.

Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi kishte dorëzuar kërkesën pas kalimit të afatit ligjor katër mujor dhe shtoi se sjellja e avokatit është po ashtu, përgjegjësi e vet parashtruesit të kërkesës. Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme për shkak se ishte e paafatshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI61/15
Parashtrues
Islam Krasniqi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, A. A. nr. 2/2014, të 21 shkurtit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Islam Krasniqi nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, A. A. nr. 2/2014, të 21 shkurtit 2014. Aktgjykimi i kontestuar është pranuar nga parashtruesi më 14 mars 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimittë Gjykatës së Apelit të Kosovës, A. A. nr. 2/2014, të 21 shkurtit 2014.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 maj 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI61/15, caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI61/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

7. Më 23 korrik 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Nga një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjykata, po ashtu, kërkoi nga parashtruesi dhe nga Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojnë dëshmi për datën e pranimit të vendimit të kontestuar nga parashtruesi.

8. Më 24 korrik 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë dëshminë (fletëkthesën) që tregon datën e pranimit nga parashtruesi të aktgjykimit të kontestuar.

9. Më 10 shtator2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin e gjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 8 shkurt 2010, parashtruesi kishte themeluar marrëdhënie pune me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës. Ndërkohë, parashtruesi ishte akuzuar nga eprorët dhe nga kolegët e tij për moskryerje të detyrave të punës dhe për sjellje të këqija. Nga shkresat e lëndës rezulton se atij i ishin shqiptuar edhe disa vërejtje gojore dhe me shkrim (Nr. 574/03, më 4 qershor 2010, dhe Nr. 136/2012, më 9 mars 2012) nga eprorët e tij.

11. Më 10 maj 2012, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme mori Vendimin, Nr. 313/12 për ndërprerje të marrëdhënies së punës ndërmjet parashtruesit, si punonjës, dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme si punëdhënëse. Komisioni Disiplinor arsyetoi se parashtruesi, edhe përkundër vërejtjeve me shkrim nga eprorët e tij, kishte vazhduar me sjellje të këqija, me moskryerje të detyrave të punës, me shantazhe dhe me kërcënime fizike.

12. Komisioni Disiplinor, ndër të tjera, kishte arsyetuar:

"Në bazë të deklaratave dhe shkresave të ndryshme të dërguara në adresime të ndryshme shihet se (parashtruesi) ka bërë: shpifje, fyerje, etiketime, shantazhe ndaj kolegëve të punës, eprorëve dhe institucionit ku punon dhe nuk ka pasur asnjë argument për ta bindur Komisionin Disiplinor lidhur me pretendimet e tij".

13. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi u ankua te Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

14. Më 13 qershor 2012, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me Vendimin, Nr. 422/2012, refuzoi ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi vendimin e Komisionit Disiplinor.

15. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi u ankua te Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK). Parashtruesi, ndër të tjera, kishte pretenduar se eprorët e tij janë marrë me shantazhe dhe me shpifje, kishte kërkuar kthim pa diskriminim në vendin e tij të punës dhe kishte kërkuar kompensim për kushtet e vështira dhe për rrezikshmërinë që karakterizonte vendin e tij të punës.

16. Më 12 korrik, 2012 KPMK-ja, me Vendimin Nr. 1166 - 02/159/2012 refuzoi ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi vendimet e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe të Komisionit Disiplinor. KPMK-ja, ndër të tjera, arsyetoi se parashtruesi ishte graduar në pozitë dhe pagë si masë stimuluese porse, edhe përkundër këtij avancimi ai kishte vazhduar me sjellje të këqija dhe me moskryerje të detyrave të punës.

17. KPMK-ja në vendimin e lartpërmendur, ndër të tjera, arsyetoi:

"Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesit i është ngritur koeficienti nga 5 në 6, por i njëjti në vazhdimësi ka bërë shkelje të detyrave të punës dhe për sjelljet e tija disa herë i është dhënë vërejtje me gojë dhe me shkrim nga mbikëqyrësit, prandaj SP duke u bazuar Ligjin, Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 51 paragr. 4, kërkon që ankuesi të ju nënshtrohet masave disiplinore, për shkak të shkeljes të dispozitës të nenit 56 paragr. 1.4, dhe duke u bazuar në nenin 66 paragr. 4.3 Komisioni Disiplinor i shqipton masën disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, pasi që masat më të lehta të dhëna nga mbikëqyrësit nuk kanë pasur efekt përmirësues .

18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi u ankua kundër vendimit të KPMK-së në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative. Parashtruesi kishte pretenduar se KMPK-ja kishte marrë vendim të kundërligjshëm pa praninë e tij, se janë shqyrtuar vetëm provat e palës kundërshtare dhe se atij nuk i ishte dhënë mundësia për të paraqitur prova të reja.

19. Më 22 tetor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin, A. nr. 892/2012 refuzoi, si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit. Gjykata Themelore, ndër të tjera, arsyetoi se KPMK-ja nuk është e detyruar të mbajë seancë publike, përveç në rastet kur palët e kërkojnë me shkrim.

20. Gjykata Themelore në Prishtinë në vendimin e lartpërmendur, ndër të tjera, arsyetoi:

> *"... Gjykata iu referua edhe Rregullores nr. 02/2011, për rregullat dhe procedurat e ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës se Kosovës, nenit 4.2.6, i cili përcakton se "kolegji do të shqyrtoj ankesën dhe do të marrë vendim në bazë të materialit me shkrim. Nëse aty ka konflikt të faktit material, apo nëse një palë e kërkon atë, këshilli do të autorizojë sekretariatin e tij që të organizojë seancë publike".*
>
> *Sipas dispozitave të lart cituara ligjore, i padituri KPMSHCK, nuk ka qenë i detyruar të mbajë seancë publike, përjashtimisht vetëm atëherë kur palët kërkojnë një gjë të tillë me shkrim".*

21. Më 22 nëntor 2013, parashtruesi u ankua në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Parashtruesi, në thelb, u ankua se Gjykata e faktit ka qenë e njëanshme në pranimin e provave dhe se ai nuk kishte shkelur rregullat e punës siç përcaktohet me vendimet e komisioneve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe KPMK-së.

22. Më 21 shkurt 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin A. A. nr. 2/2014, refuzoi, si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjykata e Apelit i karakterizoi pretendimet e parashtruesit të pabazuara, të përgjithësuara dhe jokonkrete.

Pretendimet e parashtruesit

23. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që vendimet e gjykatave të rregullta, të KPMK-së dhe të komisioneve disiplinore, t'i shpallë jokushtetuese dhe të jashtëligjshme, sepse ndërprerja e marrëdhënies së punës përbën shkelje të të drejtave të njeriut, diskriminim, gjykim të

padrejtë, ndalim të shprehjes së lirë, ndalim të qasjes në dokumente publike dhe cenim të së drejtës në karrierë. Parashtruesi i referohet nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 40 [Liria e Shprehjes], nenit 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.

24. Parashtruesi pretendon se nuk është ankuar në Gjykatën Supreme të Kosovës për shkak të gabimeve të avokatit të tij dhe për shkak të papërgjegjësisë së Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

27. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".*

28. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 36 1 (c) të Rregullores së punës, që përcakton:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> > *(c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi...".*

29. Gjykata konsideron se parashtruesi për realizimin e të drejtave të tij kushtetuese duhet t'i shterojë mjetet juridike tek organet kompetente,

dhe vetëm pas kryerjes së këtyre veprimeve, gjegjësisht pas shterjes së mjeteve juridike, ai mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese brenda afatit prej 4 (katër) muajsh të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, dhe të specifikuar më tej me Rregullin 36 1 (c) të Rregullores së punës. (Shih rastin Nr. KI91/13, parashtrues të kërkesës *Shpend Zajmi, Avni Kryeziu dhe 19 të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 tetorit 2013).

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi ka pranuar vendimin e fundit të kontestuar më 14 mars 2014, derisa kërkesa është dorëzuar më 13 maj 2015, përkatësisht 10 (dhjetë) muaj pas afatit të përcaktuar me ligj.

31. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri ligjore duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendim i 25 gushtit 2005 dhe shih, *mutatis mutandis,* Rastin nr. KI140/13, parashtrues *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 marsit 2014).

32. Gjykata, po ashtu vëren se parashtruesi fajëson avokatin e tij për mosrespektim të afatit ligjor, dhe m'u për këtë arsye është ankuar në Odën e Avokatëve, çka në të vërtetë nuk përbën argument të vlefshëm për shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese; aq më tepër, kur Komisioni i Ankesave i Odës së Avokatëve kishte konstatuar se avokati i parashtruesit nuk kishte shkelur detyrat apo kodin e etikës që ndërlidhen me punën e tij si avokat.

33. Gjykata thekson, se sjellja para gjykatave e avokatit apo e përfaqësuesit të autorizuar nga vetë parashtruesi është përgjegjësi e parashtruesit. Çfarëdo veprimi ose mosveprimi procedural nga përfaqësuesi i atribuohet parashtruesit të kërkesës (Shih *Bekauri kundër Gjeorgjisë,* Nr. 14102/02 GJEDNJ, aktgjykimi 10 prillit 2012, paragrafët 22-25; dhe shih, *mutatis mutandis,* Rasti nr. KI02/10, Aktvendim për papranueshmëri, *Roland Bartezko,* paragrafët 25-28, 21 mars 2011 dhe *Migliore dhe të tjerët kundër Italisë,* Nr. 58511/13 GJEDNJ,aktvendim i 27 janarit 2014).

34. Në përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa është e paafatshme dhe duhet shpallur e papranueshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit si dhe në pajtim me Rregullin 36 1 (c) të Rregullores së punës, më 10 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KO130/15, Presidentja e Republikës së Kosovës - Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, neni 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

KO130-15, Vendim për masë të përkohshme, miratuar dhe publikuar më 10 nëntor 2015

Fjalët kyç: *kërkesë institucionale, kërkesë për masë të përkohshme, juridiksioni dhe palët e autorizuara, interesi publik, juridiksioni ratione materiae, Kapitulli II dhe Kapitulli III të Kushtetutës.*

Në këtë rast, Presidentja e Republikës së Kosovës kishte kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që të vërë masë të përkohshme dhe të pezullojë – deri në marrjen e vendimit përfundimtar – të gjitha efektet juridike që mund të shkaktohen nga zbatimi i marrëveshjes për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Kërkesa u bazua në nenet 84.9, 113.2 dhe 116.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
Gjykata pranoi argumentet e paraqitura për referim dhe vlerësoi se Presidentja kishte mandat kushtetues që të referojë çështje kushtetuese në Gjykatë dhe se kërkesa e parashtruar përbën objekt për shqyrtim kushtetues.
Duke vlerësuar një sërë faktorësh juridiko- kushtetues, të ndërlidhur me themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, Gjykata konstatoi se ka kompetencë lëndore për shqyrtim të kësaj kërkese dhe se vënia e masës së përkohshme, ndër të tjera, ishte e nevojshme mbi bazën e interesit publik. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi ta miratojë masën e përkohshme deri më 12 janar 2016.

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME
në
Rastin nr. KO130/15
Parashtrues
Presidentja e Republikës së Kosovës
Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë -Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafin 1, Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Saj, Atifete Jahjaga (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Objekti i çështjes

2. Parashtresa përmban kërkesën për vlerësimin e përputhshmërisë së "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafin 1, Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

3. Konkretisht, parashtruesjakërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të përgjigjet në pyetjen vijuese:

   "Duke marrë parasysh se Parimet e Asociacionit rregullojnë krijimin dhe funksionimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë, a janë në përputhshmëri këto parime dhe elemente me frymën e Kushtetutës, nenin 3, paragrafin 1 (natyra shumë-etnike), Kapitullin II (të drejtat dhe liritë themelore) dhe Kapitullin III (të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtareve të tyre) të Kushtetutës së Republikës se Kosovës?".

4. Gjithashtu, parashtruesja kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, konkretisht që *"çdo veprim dhe efekt që prodhon Parimet e Asociacionit të pezullohet, [parashtruesja] kërkon nga Gjykata Kushtetuese të vendosë Masë të përkohshme ndaj çështjes së ngritur, deri në vendimin përfundimtarë [të Gjykatës]".*

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 84.9, 113.2 dhe 116.2 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 29 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 (c) të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 31 tetor 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 2 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KO130/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Në të njëjtën datë, me Vendimin KSH. KO130/15, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 3 nëntor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga parashtruesja të dorëzojë një kopje të tekstit të "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

9. Më 4 nëntor 2015, parashtruesja e dorëzoi tekstin e "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" në gjuhët zyrtare të

Republikës së Kosovës, duke përfshirë një kopje të parafuar në gjuhën angleze.

10. Më 5 nëntor 2015, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Kryetarit të Kuvendit të Kosovës me kërkesën eksplicite që e njëjta t'i dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit, Kryeministrit të Republikës së Kosovës, dhe Avokatit të Popullit, dhe i ftoi ata që të dorëzonin komentet e tyre lidhur me kërkesën, brenda afatit të caktuar.

11. Më 10 nëntor 2015, pas dëgjimit të gjyqtarit raportues dhe pas diskutimit lidhur me kërkesën për masë të përkohshme të paraqitur nga parashtruesi kërkesës, Gjykata vendosi të miratojë kërkesën për masë të përkohshme deri më 12 janar 2016.

Përmbledhje e shkurtër e fakteve

12. Më 19 prill 2013, Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Serbisë nënshkruan "Marrëveshjen e Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë" (në tekstin e mëtejmë: Marrëveshja e parë ndërkombëtare).

13. Më 22 prill 2013, gjatë një seance të jashtëzakonshme të kërkuar nga Kryeministri, Kuvendi miratoi Rezolutën nr. 04-R-10 për dhënien e pëlqimit për nënshkrim të Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. (E publikuar në ueb-faqen e Kuvendit). Siç thuhet, sipas kësaj Rezolute:

    a. *"Kuvendi i Kosovës shpreh përkrahje dhe jep pëlqimin për nënshkrimin e Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë […]";*
    b. *"[…] Kuvendi i Kosovës mbështet zotimet e përmbajtura në këtë Marrëveshje […]".*

14. Më 28 maj 2013, Qeveria miratoi Vendimin Nr. 01/132, me të cilin "*Aprovohet Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje*". Përveç kësaj, në pajtim me këtë vendim, Qeveria e procedoi projektligjin për shqyrtim dhe për miratim nga Kuvendi.

15. Më 27 qershor 2013, Kuvendi mbajti seancë plenare ku u votua dhe u miratua Ligji për ratifikimin, nr. 04/L-199. Nga deputetët e

pranishëm, 84 votuan për, 3 ishin kundër dhe 1 deputet abstenoi. Në të njëjtën ditë, Ligji për ratifikimin iu dërgua Presidentes së Republikës së Kosovës për shpallje.

16. Më 12 shtator 2013, me Dekretin nr. DL-050-2013, Presidentja e Republikës së Kosovës shpalli Ligjin për ratifikimin.

17. Marrëveshja e Parë Ndërkombëtare përmbante, *inter alia*, këto dispozita:

    1. *"Do të krijohet një Asociacion/Bashkësi e komunave me shumicë serbe në Kosovë. Anëtarësimi do të jetë i hapur për çdo komunë tjetër me kusht që anëtarët janë në pajtim.*
    2. *Bashkësia/Asociacioni do të krijohet përmes statutit. Shpërbërja e Bashkësisë/Asociacionit mund të bëhet vetëm me vendim të komunave pjesëmarrëse. Do të ofrohen garanci ligjore përmes ligjit të zbatueshëm dhe të drejtës kushtetuese (përfshirë rregullën për shumicën prej 2/3).*
    3. *Struktura e Asociacionit/Bashkësisë do të themelohet mbi të njëjtën bazë sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të komunave të Kosovës, p.sh. Kryetari, Nënkryetari, Kuvendi, Këshilli.*
    4. *Në përputhje me kompetencat e parapara me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjin e Kosovës komunat pjesëmarrëse do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre përmes Asociacionit/Bashkësisë në mënyrë kolektive. Asociacioni/Bashkësia do të ketë mbikëqyrje të plotë mbi fushat e zhvillimit ekonomik, arsimin, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural.*
    5. *Asociacioni/Bashkësia do të ushtroj kompetenca të tjera shtesë siç mund të delegohen nga autoritetet qendrore.*
    6. *Bashkësia/Asociacioni do të ketë rol përfaqësues te autoritetet qendrore dhe do të ketë një ulëse në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve për këtë qëllim. Në përmbushje të këtij roli është paraparë funksioni monitorues."*

18. Në kërkesë theksohet se, më 25 gusht 2015, Kryeministri i Republikës së Kosovës u pajtua me "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore".

Kërkesa e parashtrueses dhe kërkesa për Masë të përkohshme

19. Parashtruesja kërkon nga Gjykata që të përgjigjet në pyetjen vijuese:

"Duke marrë parasysh se Parimet e Asociacionit rregullojnë krijimin dhe funksionimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë, a janë në përputhshmëri këto parime dhe elemente me frymën e Kushtetutës, nenin 3, paragrafin 1 (natyra shumë-etnike), Kapitullin II (të drejtat dhe liritë themelore) dhe Kapitullin III (të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtareve të tyre) të Kushtetutës së Republikës se Kosovës?"

20. Parashtruesjaargumenton:

"Parimet e Asociacionit, në formën e një akti juridik të miratuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, rregullojnë çështje që hyjnë në gamën e çështjeve që prekin frymën e Kushtetutës dhe çështjeve të përcaktuara me Nenin 3 (1), Kapitullin II dhe III, si në kuptim të natyrës shumetnike, të drejtave dhe lirive themelore, të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe gjithashtu edhe në kuptim të natyrës së institucioneve që rrjedhin nga Kushtetuta. Prandaj, zbatimi i detyrimeve të Parimeve të Asociacionit prodhon efekt juridik në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës. Me zotimin e Parimeve të Asociacionit, kjo çështje është e qartë se përbën ratione materie pasi që çështja e ngritur hyn në gamën e çështjeve kushtetuese duke reflektuar edhe nga [aktgjykimet] e Gjykatës Kushtetuese respektivisht rastet Nr. KO80/10 dhe Nr. KO103/14. Karakteristikë e kriterit të 'çështjes kushtetuese', tashmë e përcaktuar edhe me rastet e lartpërmendura, është që çështja të hyjë në fushëveprimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës si në kuptimin e shkronjës ashtu edhe të frymës.

Parimet e Asociacionit janë një dokument i nënshkruar nga Kryeministri dhe paraqesin zotimin e Qeverisë për të krijuar një entitet juridik që prodhon efekte juridike në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës. Parimet e Asociacionit rrjedhin nga 'Marrëveshja e parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve [...]' të ratifikuar nga [Kuvendi] i Republikës së Kosovës me Ligjin Nr. 04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë [...].
[...]
Nga autorizimi kushtetues i [parashtrueses] buron edhe e drejta e Kreut të Shtetit për të referuar çështje kushtetuese të cilat përndryshe nuk mund të referohen në bazë të nenit 113 paragrafët 2 dhe 3 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës. Kjo për arsye se ka akte juridike dhe rrethana që konsiderohen 'çështjet kushtetuese' por që formalisht nuk mund të referohen

pranë Gjykatës Kushtetuese sepse nuk e kanë formën e ligjit, dekretit, rregulloreve apo statutit të komunës (sipas nenit 113 paragrafi 2 i Kushtetutës). I tillë është rasti me 'Parimet e Asociacionit', dokument i cili nuk është marrëveshje ndërkombëtare por legjislacion zbatues i një marrëveshjeje ndërkombëtare. 'Marrëveshja e parë ndërkombëtare' nuk është e ekzekutueshme vetvetiu dhe kërkon legjislacion shtese për zbatim.
[...]
Parimet e Asociacionit si akt i ndërmjetëm juridik, i cili rrjedh nga 'Marrëveshja e parë ndërkombëtare', shton elemente tjera në procesin e krijimit dhe vetë entitetin juridik (Asociacionin) dhe paraprin aktin themelues (dekretin e Qeverisë së Kosovës për themelim, sipas nenit 2 të Parimeve të Asociacionit), pra duke shërbyer si kushtëzim i aktit themelues. Duke marrë parasysh këto fakte, lind nevoja për një shqyrtim kushtetues të vet Parimeve të Asociacionit dhe përputhshmërisë së tyre me Kushtetutën".

21. Përveç dhënies së përgjigjes në këtë pyetje, parashtruesja kërkon që Gjykata të vendosë Masë të përkohshme. Parashtruesja konsideron se do të ishte në interes të publikut që*"çdo veprim dhe efekt që prodhon Parimet e Asociacionit të pezullohet, [prandaj parashtruesja] kërkon nga Gjykata Kushtetuese të vendosë Masë të përkohshme ndaj çështjes së ngritur, deri në vendimin përfundimtarë [të Gjykatës]".*

22. Në mbështetje të kësaj kërkese, parashtruesja argumenton:

"Njëra nga arsyet e pengesës fizike të mbajtjes së seancave plenare të Kuvendit të Kosovës janë pretendimet e partive opozitare për mospërputhshmërinë kushtetuese të përmbajtjes së Parimeve të Asociacionit. Për shkak të situatës së krijuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe pamundësisë që puna e Kuvendit të zhvillohet normalisht, [parashtruesja] konsideron që duhet të pezullohet efekti i Parimeve të Asociacionit pasi që është në ***interesin publik*** *të evitohet përshkallëzimi i jo-normalitetit. [Parashtruesja] në ushtrim të kompetencave të saj që dalin nga nenet 83 dhe 84 ka për detyrë që të mundësojë funksionimin e shtetit duke i dhënë kështu kredibilitet institucional kërkesave që kanë bërë bllokadën, me ngritje të çështjes në Gjykatën Kushtetuese".*

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

23. Në mënyrë qëGjykata të lejojë Masë të përkohshme, në pajtim me nenin 27 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 55 (4), (5) dhe (6) të Rregullores së punës, duhet të konstatohet:

Neni 27 i Ligjit

"1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik".

Rregulli 55 (4) i Rregullores së punës

[...]
"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të
pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; dhe

(c) Masa e përkohshme është me interes publik".

Rregulli 55 (5) i Rregullores së punës

"Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

[...] Nuk mund të merret vendim për Masë të përkohshme, përveç nëse specifikohet data e skadimit të tij. Sidoqoftë, data e skadimit mund të zgjatet me vendim tjetër të Gjykatës. Nëse ende nuk është vendosur për pranueshmëri, vendimi do të përcaktojë se Masa e përkohshme do të skadojë menjëherë nëse Gjykata vendos se kërkesa është e papranueshme".

24. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesja ka paraqitur argument të detajuar lidhur me nevojën për vlerësim të pajtueshmërisë së "Parimeve të Asociacionit" me Kushtetutën, dhe që kjo të konsiderohet nën emërtimin "çështje kushtetuese" në kuptim të nenit 84.9 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, hyn në fushëveprimin e juridiksionit *ratione materiae* të Gjykatës nga neni 113.2 i Kushtetutës.

25. Kësisoj, Gjykata konsideron se parashtruesja ka paraqitur rast *prima facie* për meritat e kërkesës, në kuptim të rregullit 55, paragrafi 4, pika (a), të Rregullores së punës.

26. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesja argumenton që vendosja e Masës së përkohshme është e nevojshme mbi bazën e interesit publik. Parashtruesja argumenton se funksionimi i institucioneve shtetërore, posaçërisht i seancave plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, është bllokuar si pasojë e kontestit ndërmjet partive politike në qeveri dhe partive politike të opozitës përkitazi me këto Parime të Asociacionit.

27. Parashtruesja pohon se ky kontest ka të bëjë *inter alia* me pajtueshmërinë e këtyre "Parimeve të Asociacionit" me Kushtetutën.

28. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesja është në pozitën kushtetuese të Kreut të Shtetit të Republikës së Kosovës, përfaqëson unitetit e popullit të Kosovës dhe është garantuese e funksionimit kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës, siç përcaktohet me nenet 83 dhe 84 të Kushtetutës.

29. Gjykata ka njoftuar Qeverinë e Kosovës, deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe Avokatin e Popullit për regjistrimin e kërkesës dhe u ka ofruar atyre mundësinë të japin komente.

30. Duke marrë parasysh këto rrethana, Gjykata konsideron se ka arsye substanciale të natyrës së interesit publik në kuptim të rregullit 55, paragrafi 4, pika c, të Rregullores së punës që kërkojnë pezullim të implementimit të çfarëdo veprimi të mëtejmë juridik mbi bazën e këtyre Parimeve të Asociacionit, derisa Gjykata të vlerësojë përputhshmërinë e këtyre Parimeve me Kushtetutën.

31. Rrjedhimisht, Gjykata, pa paragjykim të çfarëdo vendimi të mëtejmë që do të nxirret nga Gjykata, përkitazi me pranueshmërinë ose me meritat e kërkesës në të ardhmen, konkludon se kërkesa për Masë të përkohshme duhet të miratohet si e bazuar me qëllim të mbrojtjes së interesit publik.

32. Përveç kësaj, Gjykata vëren se Ligji nuk parasheh ndonjë afat brenda të cilit Gjykata duhet të nxjerrë vendim përkitazi me kërkesat e ngritura në bazë të nenit 84.9 në lidhje me nenin 113.2 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, duke marrë këtë parasysh, Gjykata vendos ta miratojë masën e përkohshme deri më 12 janar 2016.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 27 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 55 (4), (5) dhe (6) të Rregullores së punës, më 10 nëntor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA MIRATOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

II. Kjo masë e përkohshme do të aplikohet deri më 12 janar 2016;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetarja e GjykatësKushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI121/14, Valdet Nikçi dhe të tjerët- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 21/14, i 3 prillit 2014

KI121/14, Aktvendim për papranueshmëri i 8 shtatorit 2015, publikuar më 11 nëntor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, mosshterim i mjeteve juridike, barazia para ligjit, e drejta në punë, e drejta në gjykim të drejtë, kompensim i pagave, ligji procedural dhe material, parimi i subsidiaritetit, përsëritje e procedurës*

Gjykata Themelore në Pejë kishte ndërprerë procedurën kontestimore ku ishin të përfshirë parashtruesit e kërkesës dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, me arsyetimin se duhet pritur Vendimin e Gjykatës Kushtetuese përkitazi me një Vendim të Gjykatës Supreme të Kosovës që po ashtu ishte kontestuar nga parashtruesit e kërkesës. Parashtruesit u ankuan në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtës për mjete juridike dhe parimit të barazisë para ligjit.

Gjykata Kushtetuese vërejti se kërkesa e parashtruesve ishte e parakohshme dhe se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesit e kërkesës t'i shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, administrative ose gjyqësore, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës dhe të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Gjykata Kushtetuese, shpalli kërkesën të papranueshme për shkak të mosshterjes së mjeteve juridike, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI121/14
Parashtrues
Valdet Nikçi dhe të tjerët
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 21/14, të 3 prillit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Valdet Nikçi, Nimon Dinaj, Isuf Vukli, Fazli Kuçi,Shkëlzen Morina, Sutkije Boja, Nusret Kurtaj, Shqipe Dakaj, Nimon Shala, Sejdi Camaj, Kimete R. Kastrati, Ramadan Morina, Hedije Dupa, Qazim Qavolli, Nekibe Morina, Nusret Belegu, Mybera Tigani, Hajdin Vermezi, Mevlyde Kullashi, Ferid Dupa, Hale Smakaj, Isuf Dreshaj, Kimete Kastrati, Besim Ademaj, Vjollca Kelmendi, Hazir Jonuzi, Sylejman Laja, Emin Sylejmani, Mustafë Ahmeti, Qerim Rama, Xhevat Berisha, Sejdi Durmishi, Deli Shala, Rexhë Nikçi, Sudan Krasniqi, Rifat Shala, Imer Blakaj, Xhevat Daci, Hysen Dreshaj, Shefki Seferaj, Shyqri Jashari, Rifat Zekaj, Jakup Shala, Shaban Kelmendi, Ejup Bojupi, Haki Gashi, Ali Shala, Shaban Dakaj, Rifat Kuçi, Xhevdet Shala, Bislim Lajçi, Nimon Kastrati, Lutfo Rebronja, Isa Gashi, Hazir Beqiri, Muzli Ukshinaj, Rexhep Tishuku, Bilall Durmishi, Daut Berisha, Skënder Rexhëbogaj, Skënder Krasniqi, Hajrullah Zhara, Ahmet Muriqi, Ramiz Kastrati, Dinë Kuqi, Rrustem Elshani, Bajram Bobi, Çelë Nikçi, Xhevat Gashi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës). Punëtorët përfaqësohen nga z. Valdet Nikçi, i cili është kryetar i Sindikatës së Fabrikës së Konstruksioneve Metalike (ish-UTVA) në Pejë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 21/14, i 3 prillit 2014 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme).

3. Parashtruesit e kërkesës nuk e kanë specifikuar datën se kur e kanë pranuar aktvendimin e lartpërmendur të Gjykatës Supreme.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë sëAktvendimit të lartpërmendur.

5. Parashtruesit pretendojnë se me vendimet e gjykatave të rregullta u janë shkelur: neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]dhe neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]të Kushtetutës, si dhe u janë shkelur të drejtat e garantuara me Ligjin e Procedurës Kontestimore dhe me Ligjin e punës.

6. Kërkesa e parashtrueseve ka të bëjë me kompensimin e pagave të papaguara nga ana e Fabrikës së Konstruksioneve Metalike (ish-UTVA) në Pejë, duke përfshirë periudhën kohore prej 1 qershorit 1995 e deri më 31 mars 1999.

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

8. Më 23 korrik 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata)

9. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. 121/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy, gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. 121/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

10. Më 12 shtator 2014, z. Valdet Nikçi dorëzoi autorizimin për përfaqësimin e parashtruesve në Gjykatë.

11. Më 17 shtator 2014, Gjykata informoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës KI121/14, dhe një kopje e saj iu dërgua Gjykatës Supreme.

12. Më 5 dhjetor 2014, Gjykata kërkoi disa informata shtesë nga parashtruesit e kërkesës.

13. Më 12 dhjetor 2014, parashtruesit e kërkesës i dorëzuan në Gjykatë informatat shtesë.

14. Më 25 shkurt 2015, Gjykata kërkoi nga parashtruesit që të kompletonin kërkesën dhe ta plotësonin formularin zyrtar të kërkesës.

15. Më 9 mars 2015, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë formularin e kërkesës.

16. Më 29 qershor 2015, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI121/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizianëtare të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Enver Hasani, mandati i të cilit si gjyqtar kushtetues kishte përfunduar më 26 qershor 2015.

17. Më 8 shtator 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

18. Parashtruesit e kërkesës kanë qenë në marrëdhënie pune në Fabrikën e Konstruksioneve Metalike në Pejë. Sipas parashtruesve, fabrika në fjalë nuk ua kishte kompensuar atyre pagat mujore prej 1 qershorit 1995 e deri më 31 mars 1999, periudhë kjo kur ata u larguan dhunshëm nga puna.

19. Parashtruesitngritën padinë Gjykatën Komunale në Pejë kundër Fabrikës së Konstruksioneve Metalike në Pejë (ish-UTVA).

20. Më 27 tetor 2004, Gjykata Komunale në Pejë, nxori Aktgjykimin C. nr. 133/03, me ç'rast aprovoi paditë e parashtruesve dhe e detyroi Fabrikën e Konstruksioneve Metalike në Pejë (e paditura), që t'ua paguajë atyre pagat mujore të papaguara prej 1 qershorit 1995 e deri më 31 mars 1999 . Më tej në Aktgjykim theksohet: "*Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si dhe në faktet jo kontestuese në mes pjesëmarrësve në procedurë, gjykata konstatoi se kërkesëpaditë e precizuara të paditësve kanë bazë juridike e si të tilla gjykata i aprovoi si të bazuara*".

21. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë, Fabrika e Konstruksioneve Metalike në Pejë (ish-UTVA) nuk kishte ushtruar ankesë.

22. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM), nëpërmjet Prokurorit Publik të Shtetit, parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit C. nr. 133/03, të Gjykatës Komunale të Pejës.

23. Më 22 mars 2005, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Mlc. nr. 2/2005), refuzoi, si të pabazuar, kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, me arsyetimin se Gjykata Komunale në Pejë ka pasur juridiksion për të vendosur për paditë në pajtim me Ligjin mbi Gjykatat e Rregullta (Nr. 21/1978) dhe se ka përcaktuar drejt faktet dhe në mënyrë të drejtë ka aplikuar ligjin procedural dhe atë material.

Faktet sipas kërkesës për përsëritje të procedurës

24. Në një datë të pacaktuar, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP-ja) parashtroi kërkesë për përsëritje të procedurës në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

25. Më 22 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktvendimin Ac. nr. 390/2010, hodhi poshtë kërkesën për përsëritjen e procedurës, përkitazi me lëndën C. nr. 133/03, që ishte vendosur nga Gjykata Komunale e Pejës, më 27 tetor 2004.

26. Kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës, AKP-ja ushtroi ankesë në instancën e dytë në të njëjtën gjykatë.

27. Më 21 mars 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë (instanca e dytë) nxori Aktvendimin K. Ac. nr. 4/10, me të cilin prishi aktvendimin e instancës së parë të Gjykatës së Qarkut të Pejës dhe vendosi që lëndën t'ia kthejë instancës së parë për rishqyrtim dhe për rivendosje.

28. Më 20 prill 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë (instanca e parë) nxori Aktvendimin AC. nr. 141/2011, me të cilin lejoi përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin (C. nr. 133/03, e 27 tetorit 2004) e formës së prerë të Gjykatës Komunale në Pejë, duke e anuluar në tërësi aktgjykimin.

29. Parashtruesit, kundër Aktvendimit (Ac. nr. 141/2011) të Gjykatës së Qarkut të Pejës, me të cilin ishte lejuar kërkesa për përsëritjen e procedurës, kishin ushtruar revizion në Gjykatën Supreme.

30. Më 3 prill 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktvendimi, Rev. nr. 21/2014), hodhi poshtë, si të palejuar, revizionin e ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Faktet sipas procedurës kontestimore

31. Pas lejimit të përsëritjes së procedurës nga Gjykata e Qarkut në Pejë (instanca e dytë), Gjykata Themelore në Pejë *ex officio* filloi rishqyrtimin e lëndës, e cila u regjistrua me nr. C. nr. 254/11.

32. Më 2 qershor 2014, AKP-ja kërkoi ndërprerjen e procedurës kontestimore përkitazi me lëndën C. nr. 254/11, e cila pritej të shqyrtohej nga Gjykata Themelore në Pejë.

33. Më 23 korrik 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për të cilin fakt parashtruesit e njoftuan edhe Gjykatën Themelore në Pejë.

34. Më 3 shtator 2014, Gjykata Themelore në Pejë vendosi për ndërprerjen e procedurës kontestimore. Në bazë të procesverbalit të gjykatës në fjalë thuhet: "S*htyhet seanca për kohë të pacaktuar ndërsa data e seancës së ardhshme do të caktohet pasi që Gjykata Kushtetuese të vendos lidhur me ligjshmërinë e aktvendimit të Gjykatës Supreme…".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

35. Parashtruesit pretendojnë se me vendimet e gjykatave të rregullta u janë shkelur: neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]dhe neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]të Kushtetutës, si dhe u janë shkelur të drejtat e garantuara me Ligjin e Procedurës Kontestimore dhe me Ligjin e punës.

36. Parashtruesit në Gjykatë ngritën edhe çështjet si në vijim:

- *A është palë në procedurë në rastin konkret AKM, përkatësisht AKP-ja?*
- *A ka pasur të drejtë Gjykata e Qarkut ta pranon kërkesën për përsëritjen e procedurës, sipas kërkesës së AKP-së, pas kalimit të afatit 5 vjeçar pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit C. Nr. 133/03 dhe atë në kohën e likuidimit të ndërmarrjes, ndërsa tani vet kërkon ndërprerjen e procedurës për shkak të likuidimit-ndërmarrja gjendet në procedurën e likuidimit?*
- *Sipas të gjitha provave të parashtruara a kanë të drejtë punëtorët të iu bëhet kompensimi i pagave të papaguara për*

punën e bërë për periudhën e cekur në padi dhe Aktgjykimin e GJK. C. nr. 133/03.

Pranueshmëria e kërkesës

37. Për të shqyrtuarkërkesën e parashtruesve, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

38. Gjykata, në këtë rast, i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, që përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

39. Përveç kësaj, neni 47.2 i Ligjit, parasheh:

"Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi ti ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

40. Për më tepër, rregulli 36 (1) (b) i Rregullores së punës parasheh:

"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar".

41. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Pejë, më 3 shtator 2014, me kërkesë të AKP-së, vendosi për pezullimin e procedurës kontestimore përkitazi me lëndën C. nr. 254/11, derisa Gjykata Kushtetuese të nxjerrë vendim, sipas kërkesës së parashtruar nga parashtruesit.

42. Gjykata, duke u bazuar në faktin që rasti i parashtruesve të kërkesës është ende në shqyrtim e sipër në procedurë të rregullt gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Pejë, konsideron se kërkesa e parashtruesve është e parakohshme.

43. Në këtë rast, Gjykata rithekson se gjykatat e rregullta janë të pavarura në ushtrimin e pushtetit të tyre gjyqësor dhe se është obligim i tyre kushtetues që të interpretojnë çështjet faktike dhe të ligjit që janë relevante për rastet e ngritura para tyre.

44. Parimi i shterimit të mjeteve efektive juridike, si në rastin konkret, është që t'u ofrohet gjykatave të rregullta mundësia e rregullimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (Shih Aktvendimin për papranueshmëri, *AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, të 21 janarit 2010, dhe shih *mutatis mutandis,* GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25 803/94, Aktvendim i 28 korrikut 1999).

45. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, administrative ose gjyqësore, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. (Shih Aktvendimin në Rastin KI07/09, *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18).

46. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të vlerësojë shkeljet e pretenduara kushtetuese, para se gjykatat e rregullta që t'i përfundojnë procedurat që janë shtruar para tyre.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, në përputhje me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, 8 shtator 2015, njëzëri:

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI35/15, Parashtrues Sami Omura - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 341/2014, i 6 janarit 2015

KI35/15, Aktvendim për papranueshmëri i 30 tetorit 2015, publikuar më 11 nëntor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, kujdestari ligjor, barazia para ligjit, e drejta e martesës dhe familjes, të drejtat e fëmijës, e drejta në gjykim të drejtë, marrëdhënia e adoptimit*

Gjykata Supreme kishte refuzuar,si të pabazuar, kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës përkitazi me adoptimin e një të mituri të gjinisë mashkullore. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të së drejtës së tij për themelimin e marrëdhënies së adoptimit.

Gjykata Kushtetuese theksoi, se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta apo nga autoritet tjera publike. Është roli i gjykatave të rregullta apo autoriteteve tjera publike, që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale, dhe shtoi se procedurat në gjykatat e rregulltakanë qenë të drejta dhe të arsyetuara. Gjykata Kushtetuese, shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI35/15
Parashtrues
Sami Omura
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 341/2014, të 6 janarit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Sami Omura, me vendbanim në fshatin Greme, komuna e Ferizajt, i përfaqësuar nga z. Sabri Kryeziu, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 341/2014, (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) të 6 janarit 2015, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 16 shkurt 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit (Rev. nr. 341/2014, të 6 janarit 2015) të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 1, paragrafi 2 [Përkufizimi i Shtetit]; nenin 22 pika (7) [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëvejshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 37, paragrafët 1 dhe 2 [E Drejta e Martesës dhe Familjes] dhe nenin 50, paragrafi 1 dhe 2 [Të Drejatat e Fëmijës] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me

nenin 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejmë: KDF).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 mars 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI35/15, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI35/15 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova, dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 7 maj 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai dokumentacion shtesë. Një kopje të kërkeses iu dërgua Gjykatës Supreme.

8. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI35/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues, në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, të cilit i ka përfunduar mandati i gjyqtarit më 26 qershor 2015 dhe, me Vendimin nr. KSH. KI35/15, zëvendëskryetari Ivan Čukalović zëvendësoi gjyqtarin Altay Suroy në përbërjen e Kolegjit shqyrtues.

9. Më 11 shtator 2015, Kolegjishqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues, dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve në procedurë administrative

10. Më 2 gusht 2010, parashtruesi i kërkesës së bashku me bashkëshorten e tij parashtruan kërkesë për adoptimin e një fëmije të gjinisë mashkullore (lënda, nr. 25-2337) në Qendrën për Punë Sociale në Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: QPS në Ferizaj).

11. Më 13 maj 2011, QPS në Ferizaj i drejtohet me një kërkesë QPS në Malishevë, nëse kjo e fundit ka një fëmijë të gjinisë mashkullore në pritje për adoptim, pasi që QPS në Ferizaj nuk ka fëmijë për adoptim.

12. Më 24 prill 2012, QPS në Malishevë njofton (Njoftim nr. 30/1197) QPS në Ferizaj se kanë një fëmijë të gjinisë mashkullore për adoptim.

Përmbledhja e fakteve në procedurë civile

13. Më 21 shtator 2012, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Komunale në Ferizaj, parashtroi propozim për adoptimin e fëmijës A. Z., i cili është në përkujdesjen e QPS në Malishevë.

14. Më 30 maj 2013, Gjykata Komunale në Ferizaj me Aktvendimin Nd. nr. 366/12 caktoi periudhën provuese prej 3 (tre) muajsh për themelimin e marëdhënies së adoptimit, dhe obligoi QPS në Ferizaj që të mbikqyrë periudhën provuese prej 31 majit 2013 deri më 31 gusht 2013, pastaj t'i dorëzoi gjykatës në fjalë një raport të vlerësimit me shkrim.

Përmbledhja e fakteve në procedurë përmbarimore

15. Më 31 maj 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi propozim në Gjykatën Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë, për përmbarimin e Aktvendimit Nd. nr. 366/12, të Gjykatës Komunale të Ferizajt, pasi që QPS në Ferizaj nuk ia kishte dorëzuar fëmijën parashtruesit të kërkesës, për t'u realizuar periudha provuese sipas urdhërit të Gjykatës Komunale në Ferizaj.

16. Më 3 qershor 2013, Gjykata Themelore e Gjakovës - Dega në Malishevë nxori Aktvendimin E. nr. 724, me të cilin lejoi përmbarimin e propozuar nga parashtruesi i kërkesës.

17. Më 7 qershor 2013, QPS në Malishevë, ushtroi kundërshtim në Gjykatën Themelore të Gjakovës - Dega në Malishevë, kundër përmbarimit të Aktvendimit Nd. nr. 366/12 të Gjykatës Komunale të Ferizajt, me pretendimin se aktvendimi në fjalë është nxjerrë pa pëlqimin e kujdestarit ligjor dhe në kundërshtim me vlerësimet e QPS në Ferizaj dhe QPS në Malishevë.

18. Më 10 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore të Gjakovës - Dega në Malishevë, ushtroi përgjigje në kundërshtim dhe propozoi që kundërshtimin e ushtruar nga QPS-të ta shpall të pabazuar, si dhe kërkoi zbatimin e përmbarimit të Aktvendimit Nd. nr. 366/12, të Gjykatës Komunale të Ferizajt.

19. Më 12 qershor 2013, Gjykata Themelore e Gjakovës - Dega në Malishevë (Aktvendimi E. nr. 724/13), aprovoi kundërshtimin e ushtruar nga QPS në Malishevë dhe vendosi të anuloi Aktvendimin E. nr. 724/13 të 3 qershorit 2013, me të cilin ishte lejuar përmbarimi i

Akvendimit Nd. nr. 366/12 të Gjykatës Themelore të Gjakovës - Dega në Malishevë.

20. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), kundër Aktvendimit E. nr. 724/13, të 12 qershorit 2013, të Gjykatës Themelore të Gjakovës - Dega në Malishevë, për shkak të shkeljeve të pretenduara të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

21. Më 9 korrik 2013, Gjykata e Apelit (Aktvendimi, Ac. nr. 1802/2013) refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin E. nr. 724/13, të 12 qershorit 2013, të Gjykatës Themelore të Gjakovës - Dega në Malishevë.

22. Më 16 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi propozim për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë te Prokurori i Shtetit, kundër Aktvendimit Ac. nr. 1802 të Gjykatës së Apelit.

23. Më 26 korrik 2013, Prokurori i Shtetit (Njoftimi KMLC. nr. 73/13) refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak se nuk kishte bazë ligjore të argumentueshme për ushtrimin e këtij mjeti juridik.

24. Më 19 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për rishikimin e propozimit për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë te Kryeprokurori i Shtetit.

25. Më 26 gusht 2013, Kryeprokurori i Shtetit njoftoi se qëndron pranë njoftimit të Prokurorit të Shtetit KMLC. nr. 72/13, të 26 korrikut 2013.

Përmbledhja e fakteve përkitazi me përsëritjen e procedurës gjyqësore

26. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për përsëritjen e themelimit të marrëdhënies së adoptimit në Gjykatën Themelore të Ferizajt.

27. Më 27 shtator 2013, Gjykata Themelore në Ferizaj (Aktvendimi Nd. nr. 366/12), refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për themelimin e marrëdhënies së adoptimit përkitazi me fëmijën.

28. Më 11 tetor 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit Nd. nr. 366/12 të Gjykatës Themelore të Ferizajt për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

29. Më 12 shtator 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi Ac. nr. 3423/2013), refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin Nd. nr. 366/12, të 27 shtatorit 2013, të Gjykatës Themelore të Ferizajt.

30. Në Aktvendimin e saj, Gjykata e Apelit arsyetoi se "*... me dispozitën e nenit 179 par. 1 dhe 3 të Ligjit për Familjen i Kosovës, ku i referohet banimit të përhershëm, në par 1 të tij, decidivisht thuhet: adoptues mund të jetë vetëm banori i përhershëm, pra fjala është për banorin rezident në Kosovë, (sepse asnjë person nuk mund të ketë banim të përhershëm në dy shtete në të njëjtën kohë), ndërkaq, në paragrafin 3 të të njëjtit nen thuhet: për adoptimin e fëmijës nga shtetasi i huaj nevojitet pëlqimi paraprak nga organi administrativ kompetent për punë e politikë sociale. [...] ndërsa edhe sikur propozuesit të jenë edhe shtetas të Kosovës, përsëri pëlqimi i kujdestarit, por edhe inicimi i procedurës, nëpërmjet tij, gjithsesi duhet të bëhet, ndërsa në rastin konkret as njëra nga këto nuk është zbatuar [...]*" .

31. Më 24 tetor 2014, parashtruesi i kërkesës ushtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktvendimit Ac. nr. 3423/2013 të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

32. Më 6 janar 2015, Gjykata Supreme (Aktvendimi, Rev. nr. 341/2014), refuzoi kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës, si të pabazuar, dhe vërtetoi se në bazë të gjendjes faktike, gjykatat e instancës më të ulët kanë vepruar drejt kur kanë refuzuar propozimin e parashtruesit të kërkesës për adoptimin e të miturit.

33. Për më tepër, Gjykata Supreme arsyetoi:

> *"Qendra për punë sociale në Malishevë në raportin e saj... me shkrim nuk ka dhënë rekomandim gjykatës për adoptimin e të miturit. Me këtë nuk është plotësuar kushti i domosdoshëm nga neni 169.1 lidhur me nenin 171 të Ligjit për Familjen i Kosovës, pasi që mungon pëlqimi i kujdestarit të miturit.*
>
> *Propozuesit kërkesën e kanë bërë në bazë të procedurave për adoptim si qytetarë të Kosovës e jo si persona jashtë Kosovës. Sipas dispozitave në fjalë ky Panel është formuar për adoptim jashtë Kosovës me qëllim të zbatimit edhe të Konventës së Hagës për të Drejtat e Fëmijëve me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve.*
>
> *Thëniet në revizion se propozuesit janë shtetas të Kosovës janë të pabazuara nga fakti jo kontestues se propozuesit ... janë me*

qëndrim të përhershëm në RF të Gjermanisë që nga viti 1993, nga kjo del se fëmiu duhet të adoptohet jashtë Kosovës dhe se në rastin konkret adoptimi duhet t'i nënshtrohet procedurës së veçantë dhe është e domosdoshme mendimi i Panelit të veçantë për adoptim jashtë Kosovës e cila funksionon pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ...".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin, Rev. nr. 341/2014 të Gjykatës Supreme, dhe me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e garantuara sikurse janë përmendur në paragrafin 3, të këtij dokumenti.

35. Parashtruesi i kërkesës, për më tepër kërkon nga Gjykata që të zbatohet Aktvendimi, Nd. nr. 366/12, i 30 shatorit 2013, i Gjykatës Komunale në Ferizaj, me të cilin ishte aprovuar periudha provuese për themelimin e marrëdhënies së adoptimit.

Pranueshmëria e kërkesës

36. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa e parashtruesit i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

38. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) Gjykata mund t'ishqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e *pabazuar.*

(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendiminpër shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

39. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 341/2014, të 6 janarit 2015, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 1, 22, 37 dhe 50 të Kushtetutës, si dhe me nenin 3 të KDF-së.

40. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës pretendon se me procedurat e përfunduara në gjykatat e rregullta, i janë shkelur dispozitat ligjore që e rregullojnë lëmin e familjes në Republikën e Kosovës.

41. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të dispozitave kushtetuese të lartpërmendura, Gjykata,konsideronse parashtruesi i kërkesës thjeshtdeklaron seka pasur shkelje tëtë drejtavedhe të lirive të tij, pashpjeguar si dhe psefaktetqë aiparaqitipërbëjnë shkelje të atyre të drejtave.

42. Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 3 të KDF-së, i cili përcakton:

"1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.

2. Shtetet palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin enevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ata marrin të gjitha masat legjislative dhe administrative përkatëse.

3. Shtetet palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur".

43. Megjithatë, Gjykata konsideron se, pavarësisht se parashtruesi i kërkesës i ngriti pretendimet për shkeljen e nenit 3 të KDF-së, ai më tutje nuk argumenton si dhe pse gjykatat e rregullta ia shkelën këtë të drejtë, duke ditur se ky nen është mjaft i përgjithësuar dhe përfshin një varg obligimesh dhe të drejtash që dalin nga konventa për shtetet kontraktuese.

44. Gjykata vëren se, Gjykata Supreme shqyrtoi secilin pretendim të parashtruesit të kërkesës duke shpjeguar në mënyrë të detajuar, se përse është dashur që kërkesa e parashtruesit për revizion të refuzohet si e pabazuar, dhe të vërtetohet aktvendimi i gjykatës së instancës më të ulët.

45. Gjykata bazuar në shkresat e lëndës, konsideron se Aktvendimi i Gjykatës Supreme nuk ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare, ashtu siç pretendon parashtruesi i kësaj kërkese.

46. Përkitazi me pretendimet tjera që i takojnë gjendjes faktike dhe interpretimit të dispozitave të ligjit, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj tëmerret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat apo autoritetet publike, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

47. Gjykata gjithashtu thekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta apo nga autoritet tjera publike. Është roli i gjykatave të rregullta apo autoriteteve tjera publike, që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis,Garcia Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, para. 28, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, para. 28).

48. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia, Edwards kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

49. Gjykata më tej konsideron se procedurat në gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe ato në Gjykatën Supreme, kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (Shih, *mutatismutandis, Shub kundër Lituanisë,* Nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).

50. Gjykata gjithashtu vëren se, parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar asnjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të

drejtave të tij sipas Kushtetutës (Shih, *Vanek kundër Republikës* së *Sllovakisë,* nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005) dhe nuk ka saktësuar se si nenet e përmendura të Kushtetutës e mbështesin pretendimin e tij, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 48 të Ligjit.

51. Si përmbledhje, Gjykata përfundon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive të tij janë të padëshmuara dhe të pabazuara, prandaj kërkesa e tij duhet deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) c), 36 (2) b) dhe d), si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 30 tetor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI28/15, Parashtrues Naser Dragusha dhe 4 punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës – Kërkesë për rivlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 25/2012, i 10 majit 2013

KI28/15, Vendim për refuzim të kërkesës i 30 tetorit 2015,të publikuar më 25 nëntor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e papranueshme, efekti juridik i vendimeve, e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, mbrojtja gjyqësore e të drejtave*

Në këtë rast, parashtruesit e kërkesën kërkuan nga Gjykata Kushtetuese që të rivlerësojë një Aktgjykim të Gjykatës Supreme që njëherë ishte vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese, në Rastin KI163/13, dhe që ishte shpallur i papranueshëm si qartazi i pabazuar. Parashtruesit u ankuan sërish në Gjykatën Kushtetuese, për shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

Gjykata Kushtetuese vërejti se kërkesa e tanishme është përsëritje e kërkesave tëmëparshme, të cilat janë vendosur më parë dhe shtoi sevendimet e saj janë vendime të formës së prerë dhe të detyrueshme për gjyqësorin, për të gjithë personat, dhe për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme në pajtim me rregullin 35 (2) të Rregullores së punës

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS
në
Rastin nr. KI28/15
Parashtrues
Naser Dragusha dhe 4 punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës
Kërkesë për rivlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 25/2012, të 10 majit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: z. Naser Dragusha, z. Bajram Ahmeti, z. Mehmet Shaqiri, z. Shasivar Hashani dhe znj. Selvete Preniqi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit), të përfaqësuar nga z. Ilaz Çerkinaj, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit kontestojnë Aktgjykimin, Rev. 25/2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), të 10 majit 2013, i cili atyre u është dorëzuar më 10 korrik 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për rivlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit, Rev. nr. 25/2012 të Gjykatës Supreme, të 10 majit 2013, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesve të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushteuese

5. Më 10 mars 2015, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI28/15 caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI28/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

7. Më 6 maj 2015, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga të njëjtit plotësimin e formularit të kërkesës, duke ia bashkëngjitur kërkesës vendimin e fundit të cilin e kontestojnë, si dhe dokumentet të tjera relevante.

8. Më 21 maj 2015, parashtruesit dorëzuan dokumentacionin shtesë të kërkuar nga Gjykata.

9. Më 11 shtator 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi njëzëri Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Përkitazi me pretendimet e njëjta, të ngritura nga parashtruesit, Gjykata tashmë ka vendosur në Rastin KI163/13, të 23 qershorit 2014 dhe në Rastin KI165/14, të 9 korrikut 2015.

Përmbledhja e fakteve përkitazi me Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese në Rastin KI163/13, të 23 qershorit 2014

11. Më 18 tetor 2013, parashtruesit e kërkesës z. Naser Dragusha, Mehmet Shaqiri, z. Bajram Ahmeti, z. Shasivar Hashani, z. Qazim Igrishta, z. Fahri Asllani dhe znj. Selvete Preniqi dorëzuan kërkesën në Gjykatë, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 25/2012, të Gjykatës Supreme, të 10 majit 2013.

12. Parashtruuesit, në Rastin KI163/13, pretendonin se u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe me nenin 54 [Mbrojtja gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

13. Gjykata në Rastin KI163/13 vlerësoi se Gjykata Supreme, përkitazi me pretendimet e parashtruesve, qartë e ka shpjeguar raportin ndërmjet parashtruesve si punëtorë dhe KEK-ut si punëdhënës, bazuar në kontratën e themeluar me pëlqimin e dy palëve, si dhe të drejtat dhe detyrimet që dalin nga kontrata e tillë; dhe për më tepër, Gjykata Supreme po ashtu ka dhënë vlerësim të qartë të vendimeve të gjykatave të instancës më të ulët.

14. Përveç kësaj, Gjykata vlerësoi se fakti që parashtruesit nuk pajtohen me rezultatin e rastit nuk mund të ngrenë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës (Shih rastin *Mezotur-Tiszazuki Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

15. Rrjedhimisht, Gjykata nuk gjeti shkelje të të drejtave të parashtruesve, të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 25/2012, të 10 majit 2013.

16. Në bazë të fakteve dhe rrethanave që janë paraqitur në kërkesën nr. KI163/13, Gjykata më 23 qershor 2014 përfundoi se kërkesa e parashtruesve ishte deklaruar e papranueshme si qartazi e pabazuar.

Përmbledhja e fakteve përkitazi me Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, në Rastin KI165/14, të 9 korrikut 2015

17. Më 10 nëntor 2014, parashtruesi Bajram Ahmeti dorëzoi kërkesën në Gjykatë, e cila u regjistrua me nr. KI165/14. Nëpërmjet kësaj kërkese parashtruesi kontestoi Aktgjykimin e njëjtë të Gjykatës Supreme (Rev. nr. 25/2012, të 10 majit 2013), të cilin i njëjti e kontestoi në Rastin KI163/13, të 23 qershorit 2014.

18. Parashtruesi në kërkesën KI165/14 pretendoi se me Aktgjykimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

19. Duke pasur parasysh të gjitha faktet e shtjelluara, në Rastin KI165/14, Gjykata erdhi në përfundim se kërkesa e parashtruesit për objekt të shqyrtimit kishte të njëjtin aktgjykim për kushtetushmërinë e të cilit kishte vendosur në Rastin KI163/14, më 23 qershor 2014. Andaj, kërkesa e parashtruesit u deklarua e papranueshme në bazë të rregullit 36 (3) d) të Rregullores së punës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Në kërkesën e tanishme KI28/15, parashtruesit pretendojnë se me Aktgjykimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata, para se ta shqyrtojë një kërkesë, së pari vlerëson nëse ajo i ka përmbushur kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Përkitazi me këtë kërkesë, Gjykata i referohet rregullit 32 (5) të Rregullores së punës, që përcakton:

> *"Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është [...] përsëritje e një kërkese të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze".*

23. Gjykata vëren se parashtruesit, në rastin konkret, në fakt kërkojnë rivlerësimin e Aktgjykimit Rev. nr. 25/2012 të Gjykatës Supreme, të 10 majit 2013, kushtetushmërinë e të cilit Gjykata Kushtetuese e kishte vlerësuar në rastin KI163/13, të 23 qershorit 2014, dhe në Rastin KI165/14 të 9 korrikut 2015, ku parashtrues ishte z. Bajram Ahmeti njëri nga parashtruesit e Rastit KI163/13 dhe të rastit të tanishëm KI28/15. Kërkesa e tanishme, në fakt, nuk përmban asnjë provë të re, në bazë të së cilës do të trajtohej një çështje e cila nuk është trajtuar, ose është anashkaluar të trajtohet në procedurat e mëhershme në Gjykatë.

24. Prandaj, kërkesa e tanishme është përsëritje e kërkesave të mëparshme të vendosura nga Gjykata. Gjykata nuk ka juridiksion të vendosë për çështjet e njëjta juridike për të cilat një herë ka vendosur. Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese, përkitazi me kërkesat individuale, është përcaktuar qartë me nenin 113.7 të Kushtetutës. Me akte

individuale të autoriteteve publike në kuptim të nenit 113.7, duhet nënkuptuar të gjitha aktet individuale të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës, që paraqesin objekt të vlerësimit të kushtetutshmërisë sipas kuptimit të këtij neni, përveç atyre të vetë Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, duhet kuptuar qartë dhe drejtë se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion t'i rihapë dhe t'i rigjykojë vendimet e saj për të cilat ka vendosur.

25. Për më tepër, Gjykata rikujton se vendimet e saj janë vendime të formës së prerë dhe të detyrueshme për gjyqësorin, për të gjithë personat dhe për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

26. Përkitazi me këtë, neni 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] i Kushtetutës, përcakton: "*Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës*".

27. Si përfundim, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesve, në fakt, është përsëritje e kërkesave të mëparshme të vendosura nga Gjykata. Prandaj, në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores, kërkesa duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, më 30 tetor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA REFUZOJË kërkesën;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI56/15, Parashtrues Qamil Haxhibeqiri - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 367/2014, i 20 shkurtit 2015

KI56/15, Aktvendim për papranueshmëri i 13 nëntorit 2015, publikuar më 25 nëntor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kontrata e shitblerjes, përparësia e blerjes, mbrojtja e pronës*

Gjykata Supreme kishte aprovuar kërkesën për revizion të palës kundërshtare përkitazi me të drejtën e parashtruesit për përparësinë e blerjes së një patundshmërie. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të së drejtës së tij në pronë.

Gjykata Kushtetuese vërejti se Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj arsyetoi në mënyrë gjithëpërfshirëse, se përse është dashur që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen dhe kërkesëpadia e parashtruesit të refuzohet dhe shtoi, se procedura e zhvilluar në Gjykatën Supreme ka qenë e drejtë dhe e arsyetuar. Gjykata Kushtetuese, shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI56/15
Parashtrues
Qamil Haxhibeqiri
Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 367/2014, të 20 shkurtit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Qamil Haxhibeqiri, me vendbanim të përhershëm në Rahovec, i përfaqësuar nga z. Gazmend Haxhibeqiri.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 367/2014, të 20 shkurtit 2015 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) me të cilin u refuzua kërkesëpadia e aprovuar nga gjykata e instancës më të ulët, që kishte të bënte me vërtetimin e të drejtës së përparësisë së blerjes së një paluajtshmërie.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar Rev. nr. 367/2014, me të cilin pretendohen shkeljet e të drejtave kushtetuese, për shkak të interpretimit të gabuar të nenit 20 të Ligjit mbi qarkullimin e pasurive të paluajtshme (Gazeta Zyrtare e KSAK, nr. 45/81, 29/86 dhe 28/88) nga Gjykata Supreme.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji*)*.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 7 maj 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI56/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin nr. KSH. KI56/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi (anëtare) dhe Bekim Sejdiu (anëtar).

7. Më 22 korrik 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kësaj kërkese, sipas nenit 22.2 të Ligjit, iu dërgua Gjykatës Supreme.

8. Më 15 tetor 2015, Kolegjishqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Kërkesa ka të bëjë me të drejtën e përparësisë së blerjes së paluajtshmërisë (lokal afarist-depo), e përshkruar si parcelë në sipërfaqe prej 0.09,03 hektar, e regjistruar në librat kadastrale me nr. 2695/1 dhe e evidentuar si FP nr. 139 ZK, Rahovec. Kjo parcelë i ishte shitur Sh. I. (blerësi) nga Rahoveci nga T. V. (shitësi) dhe kontrata e shitblerjes është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Mitrovicë.

10. Parashtruesi i kërkesës pohon se paluajtshmërinë në fjalë e kishte marrë me qira nga T. V. dhe nuk është pajtuar që e njëjta t'i shitej Sh. I. në mënyrë të ligjshme. Prandaj, parashtruesi pretendonte se përparësia e blerjes i takonte atij, sipas ligjit në fuqi. Parashtruesi më pas ushtroi kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Rahovec.

11. Më 12 shtator 2012, Gjykata Komunale në Rahovec, me Aktgjykimin, C. nr. 183/08, aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit, vërtetoi se parashtruesi ka përparësinë e blerjes së paluajtshmërisë, anuloi kontratën e shitblerjes së paluajtshmërisë në fjalë të vërtetuar nga Gjykata Komunale në Mitrovicë dhe obligoi të paditurin e parë T. V., që të lidhë kontratë me parashtruesin e kërkesës sipas kushteve të njëjta, siç ia kishte shitur të paditurit të dytë SH. I.

12. Të paditurit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Rahovec ushtruan ankesë në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), duke pretenduar shkeljet thelbësore të dispozitave të ligjit.

13. Më 4 shtator 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi, Ac. nr. 5032/12), refuzoi, si të pabazuara ankesat e të padituve, dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Rahovecit, C. nr. 183/08, të 12 shtatorit 2008.

14. Të paditurit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit ushtruan kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të pretendimit të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

15. Më 20 shkurt 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Rev. nr. 367/2014), aprovoi, si të bazuar, kërkesën e të padituve për revizion, dhe ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, të cilat ishin në favor të parashtruesit të kërkesës.

16. Për më tepër, Gjykata Supreme arsyetoi:

> "*... duke marrë parasysh se ngastra kontestuese edhe pse me kulturë është arë, sipas vërtetimit të lartpërmendur të Komunës së Rahovecit, e njëjta është tokë ndërtimore e përfshirë me planin urbanistik të qytetit, gjykatat e shkallës më të ulët gabimisht kanë zbatuar nenin 22 dhe 23 të këtij ligji duke gjetur se paditësi ka të drejtën e përparësisë së blerjes së kësaj depoje-lokali. Ky lokal-depo, nga i padituri i parë është i ndërtuar pa leje, i pa legalizuar, kështu që si tërësi së bashku me tokën që përfshinë kjo ngastër është shitur nga ana e të paditurit të parë.*
> *Për më tepër, i padituri i parë, edhe pse në kuptim të nenit 20 të Ligjit të lartpërmendur nuk e ka pasur për obligim, i njëjti siç rezulton edhe nga dëshmia e dëshmitarit G.H., i biri i paditësit (parashtruesit), paraprakisht paditësit i kishte bërë ofertë me gojë për blerjen e kësaj patundshmërie si tërësi, përfundimisht për shumën prej 160.000,00 DM, të cilën pala paditëse nuk e kishte pranuar duke i ofruar si çmim shitblerës vetëm shumën prej 120.000,00 DM, dhe pastaj i padituri i parë këtë patundshmëri për çmimin e shitblerjes prej 140.000,00 ia kishte shitur të paditurit të dytë. Kështu që sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme edhe ky fakt vërteton se i padituri i parë nuk ia ka cenuar paditësit të drejtën e përparësisë së blerjes së kësaj patundshmërie*".

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi i kërkesës, pretendon se "*Gjykata Supreme në mënyrë të gabuar bën interpretimin e nenit 20 të Ligjit mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme duke cekur se përparësi për blerje ka vetëm Komuna pa e shpjeguar dispozitën e nenit 20, prandaj nga ky fakt në këtë kërkesë në tërësi po e përshkruajmë nenin 20 të Ligjit:*

Neni 20

Bartësi i të drejtave të pronësisë i cili dëshiron ta shes tokën në rajonin e ndërtimit ka për detyrë që së pari t'ia ofrojë për shitje Komunës në territorin e së cilës gjendet toka.
Dispozitat e nenit 19 të këtij Ligji aplikohen edhe në qarkullimin e pyjeve dhe të tokës pyjore në rajonin e ndërtimit.
Dispozita e paragrafit 1 të këtij neni ka të bëjë me tokën për ndërtim të përfshirë me planin urbanistik, si dhe me tokën për ndërtimin në kufijtë e rajonit ndërtimorë, të cilën me Vendim e ka përcaktuar Kuvendi i Komunës.
Për ofertën e paraqitjes me shkrim për shitjen e tokave deklarohetorgani ose organizata të cilën e cakton Kuvendi i Komunës".

18. Për më tepër, parashtruesi pretendon: *"Nga provat e paraqitura shihet qartë se është zbatuar neni 20 i Ligjit mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme dhe se Komuna nëpërmjet organit të vet të caktuar është përgjigjur se nuk është e interesuar për blerjen e pronës e cila i ofrohet për shitje. Prandaj në rastin konkret nuk kemi kurrfarë zbatimi të gabuar të drejtës materiale".*

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Në rastin konkret, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

21. Përveç kësaj, rregulli36 (1) d) i Rregullores së punës, parasheh:

(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

22. Për më tepër, rregulli 36 (2) i Rregullores së punës parasheh:

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...]

23. Në këtë rast, Gjykata vëren se objekt i çështjes para gjykatave të rregullta ishte kërkesa e parashtruesit të kërkesës për vërtetimin e të drejtës së përparësisë së blerjes së paluajtshmërisë së lartpërmendur, e cila i është njohur parashtruesit të kërkesës me Aktgjykimin, C. nr. 183/08 të Gjykatës Komunale në Rahovec. Aktgjykimi i kësaj të fundit u vërtetua nga Gjykata e Apelit. Mirëpo, Gjykata Supreme, duke vendosur sipas kërkesës për revizion të ushtruar nga të paditurit, kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit, si të pabazuar, duke i ndryshuar kështu aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, për shkak të aplikimit të gabuar të ligjit material.

24. Gjykata, bazuar në shkresat lëndës, vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë me çështjen e interpretimit të dispozitave të ligjit material (ligjshmërinë) nga ana e Gjykatës Supreme.

25. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit nuk janë ngritur mbi bazën e shkeljeve të të drejtave të garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Në fakt, parashtruesi i kërkesës argumenton se si Gjykata Supreme refuzoi kërkesëpadinë e tij, duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitat e ligjit material dhe sipas tij kjo përbën shkelje të të drejtave të garantuara me Ligj dhe me Kushtetutë.

26. Përkitazi me këtë, Gjykata rithekson se çështja e gjetjes së fakteve dhe e interpretimit të dispozitave të ligjit material dhe atij procedural janë detyrë e gjykatave të rregullta dhe bie nën juridiksionin e tyre.

27. Gjykata, gjithashtu thekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta apo nga autoritetet tjera publike. Është roli i gjykatave të rregullta apo autoriteteve tjera publike, që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis,Garcia Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, para. 28, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, para. 28).

28. Gjykata, vetëm mund të shqyrtojë nëse provat, para gjykatave dhe organeve tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë, saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur një gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 13071/87*,* i miratuar më 10 korrik 1991).

29. Gjykata konsideron se, Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj arsyetoi në mënyrë gjithëpërfshirëse, se përse është dashur që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen dhe kërkesëpadia e parashtruesit të refuzohet.

30. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih*, mutatis mutandis, Shub vs. Lithuania*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

31. Nga të gjitha arsyet e shtjelluara më lart, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit në pajtim me nenin 48 të Ligjit, dhe me rregullin 36 (1) d) të Rregullores së punës, duhet të deklarohet si qartazi e pabazuar dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) d), 36 (2) b), si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 13 nëntor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI86/15, Parashtrues Armond Morina - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 57/2014, i 17 nëntorit 2014

KI86/15, Aktvendim për papranueshmëri i 7 korrikut 2015, publikuar më 25 nëntor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, subvencionim i projektit filmik, pezullim i financimit*

Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës përkitazi me obligimin për kthimin e financimit të një projekti filmik. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Gjykata Kushtetuese vërejti se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë arsyetim procedural ose material në kërkesën e tij, sepse ai vetëm përmend dispozitat kushtetuese pa dhënë sqarime të mëtejshme se si erdhi deri te shkeljet, dhe shtoi, se vendimet e gjykatave të rregulltakanë qenë të drejta dhe të arsyetuara. Gjykata Kushtetuese, shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI86/15
Parashtrues
Armond Morina
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
E. Rev. nr. 57/2014, të 17 nëntorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Armond Morina me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 57/2014, i 17 nëntorit 2014, me të cilin Gjykata Supreme e refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit.

3. Ky Aktvendim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 26 shkurt 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin, pretendohet të jetë shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 25 qershor 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI86/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KI86/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 17 gusht 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 14 tetor 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës është pronar dhe drejtor i shtëpisë filmike "Morina Films".

11. Parashtruesi i kërkesës, përkatësisht shtëpia e tij filmike, në vitin 2006, nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: MKRS) ka kërkuar ndihmë financiare për realizimin e projektit filmik "*Mysafir në sofër*".

12. Më 19 shtator 2008, MKRS-ja ka nënshkruar kontratë me parashtruesin e kërkesës. Në bazë të kësaj kontrate, MKRS-ja, si donator, u zotua për të subvencionuar projektin filmik "*Mysafir në sofër*".

13. Më 20 tetor 2008, MKRS-ja i transferoi mjetet financiare të dedikuara për realizimin e fazës së parë të projektit filmik "*Mysafir në sofër*".

14. Më 27 gusht 2010, MKRS-ja e informoi parashtruesin e kërkesës se në bazë të dhënave të marra nga auditimi i MKRS-së, si dhe nga raporti i komisionit të MKRS-së, ishte konstatuar se mjetet financiare të

miratuara për realizimin e projektit filmik "*Mysafir në sofër*" nuk janë shpenzuar në pajtim me kontratën, dhe si rrjedhojë e pezullon financimin e mëtejshëm të këtij projekti dhe kërkon nga parashtruesi që t'i kthejë mjetet financiare në buxhetin e Kosovës, të cilat paraprakisht ishin paguar për realizimin e fazës së parë të këtij projekti.

15. Pasi që njoftimi i lartcekur i është dorëzuar parashtruesit, MKRS-ja ka paraqitur padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë me kërkesëpadi që parashtruesi (Morina Films) t'i kthej mjetet financiare, të marra për realizimin e fazës së parë të projektit filmik "*Mysafir në sofër*".

16. Më 28 shkurt 2012, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë [Aktgjykimi II. C. nr. 13/2011] e miratoi si të bazuar, kërkesën e MKRS-së dhe e obligoi parashtruesin e kërkesës që MKRS-së t'ia kthejë mjetet e fituara financiare, duke përfshirë kamatën e përcaktuar ligjore dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

17. Më 21 maj 2012, parashtruesi i kërkesës, i pakënaqur me Aktgjykimin e lartcekur ushtroi ankesë në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

18. Më 22 gusht 2012, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë e refuzoi, ankesën e parashtruesit të kërkesës, si të paafatshme.

19. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.

20. Më 20 shtator 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë. Kjo kërkesë është regjistruar me numrin e regjistrimit KI16/13.

21. Më 16 prill 2013, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata që të pezullojë procedurën në Rastin KI16/13 deri në vendimin përfundimtar të gjykatave të rregullta.

22. Më 14 qershor 2014, Gjykata merr vendim për heqjen nga lista KI16/13, duke marrë parasysh që në rrethanat e lartcekura, nuk kishte gjetur ndonjë arsye për të vendosur përkitazi me kërkesën.

23. Më 18 korrik 2014, Gjykata e Apelit [Aktvendimi Ae. nr. 412/2012] e refuzoi, si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

24. I pakënaqur me vendimin e Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës ushtroi revizion në Gjykatën Supreme.

25. Më 17 nëntor 2014, Gjykata Supreme [Aktvendimi E. Rev. nr. 57/2014] e refuzoi, si të pabazuar, kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

27. Parashtruesi kërkon nga Gjykata:

> *"Anulimi i vendimeve të gjykatave, respektivisht Gjykatës Supreme dhe kthimin e çështjes juridike për rigjykim dhe rivendosje për shkak të shkeljeve të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë [...]".*

Pranueshmëria e kërkesës

28. Para së gjithash, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 të Rregullores së punës.

> Neni 48 i Ligjit
>
> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*
>
> Rregulli 36 i Rregullores së punës
>
> *"[...] (1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> > *[...] (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

[...] (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

30. Siç u cek më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut janë marrë në kundërshtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

31. Në fakt, parashtruesi i kërkesës pretendon, në përgjithësi, duke iu referuar vendimeve të gjykatave të rregullta, se nuk i ishte ofruar "*gjykim i drejtë dhe i paanshëm*" në gjykatat e rregullta.

32. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë arsyetim procedural ose material në kërkesën e tij. Ai vetëm përmend nenet e lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, pa dhënë sqarime të mëtejshme se si erdhi deri te shkeljet.

33. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Ekonomike e Qarkut e refuzoi ankesën e parashtruesit kundër aktgjykimit të shkallës së parë, duke konsideruar se afati për paraqitjen e ankesës së tillë kishte skaduar. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij.

34. Gjykata, gjithashtu vëren se Gjykata e Apelit e ka arsyetuar aktvendimin e saj në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës: *"Për faktin se aktgjykimi C. nr. 13/11 i datës 28.02.2012, është pranuar nga i autorizuari itë paditurit me datën 11.05.2012, ndërsa ankesa është ushtruar me datën 21.05.2012, passkadimit të afatit prej 7 ditëve, të paraparë me nenin 509.1 nen c) të LPK, Gjykata e Apelit eKosovës, gjen se me aktvendimin e atakuar nuk është shkelur ligji në dëm të paditurës dhe se injëjti është i drejtë dhe i bazuar në ligj",* duke vërtetuar se Gjykata Ekonomike e Qarkut drejt ka zbatuar të drejtën materiale, kur e refuzoi ankesën e parashtruesit kundër aktgjykimit të shkallës së parë.

35. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtruesit për revizion, si të pabazuar, dhe në tërësi e mbështeti arsyetimin e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës së Apelit.

36. Gjykata konsideron se procedurat para Gjykatës së Qarkut, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme ishin të drejta dhe se vendimet ishin në detaje të arsyetuara dhe justifikuara.

37. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konkludon, se procedurat në përgjithësi, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur

gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut të 10 korrikut 1991, dhe, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, vendimi i 30 qershorit 2009).

38. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar saktësisht si dhe pse vendimet e kontestuara përbëjnë shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, dhe as nuk ka paraqitur prova për ta arsyetuar pretendimin për një shkelje të tillë.

39. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga autoritete publike, përveç nëse ato kanë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

40. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta ose nga autoritet tjera publike. Roli i gjykatave të rregullta apo autoriteteve të tjera publike është, aty ku është e mundur, t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, paragrafi 28; shih gjithashtu: Gjykata Kushtetuese në Rastin KI70/11, parashtrues *Faik Hima Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

41. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij në bazë të Kushtetutës (Shih *Vanek kundër Republikës Sllovake*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005) dhe nuk ka saktësuar se si neni i Kushtetutës dhe neni i KEDNJ-së, në të cilët ai ishte referuar, e mbështesin pretendimin e tij, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

42. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm janë të pabazuara, nuk janë provuar, dhe rrjedhimisht, janë qartazi të pabazuara.

43. Në bazë të arsyeve të lartcekura, Gjykata konsideron se, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, nëpajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat36(1) (d) dhe 36(2) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 7 korrik2015,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama – Hajrizi

KI25/15, Parashtrues Faik Azemi - Kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme të Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese në Rastin nr. KI129/14, i 25 nëntorit 2014

KI25/15, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shtatorit 2015, publikuar më 2 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, kthim në gjendjen e mëparshme*

Në Rastin KI129/14, Gjykata Kushtetuese kishte vendosur se kërkesa e parashtruesit ishte e papranueshme për shkak se ishte e paafatshme. Parashtruesi dorëzoi kërkesë sërish në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar kthim në gjendjen e mëparshme me pretendimin se kërkesa e tij ishte e paafatshme për fajin e gjykatave të rregullta dhe jo për fajin e tij.

Gjykata Kushtetuese vërejti senë rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për kthim në gjendje të mëparshme, siç është përcaktuar në nenin 50 të Ligjit, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur ta arsyetojë kërkesën e tij, dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se si dhe pse pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar me ligj.Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim nenin 50 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI25/15
Parashtrues
Faik Azemi
Kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme të Aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese për papranueshmëri KI129/14, të 25 nëntorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Faik Azemi nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi në kërkesë kërkon kthimin në gjendjen e mëparshme në kuptim të afatit të paraparë, të Aktvendimit për papranueshmëri KI129/14, të Gjykatës Kushtetuese, të 25 nëntorit 2014.

3. Kësaj kërkese, parashtruesi ia ka bashkangjitur disa kërkesa të tij të drejtuara gjykatave të rregullta për qasje në dosjen e lëndës. Dokumentet e përmendura, parashtruesi i kërkesës ia kishte bashkangjitur edhe kërkesës së tij të mëparshme, KI129/14.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është kërkesa për kthim në gjendjen e mëparshme të Kërkesës KI129/14, të 25 nëntorit 2014.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 9 mars 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI25/15, e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI25/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin KI25/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit më 26 qershor 2015 i përfundoi mandati në Gjykatën Kushtetuese.

9. Më 21 korrik 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 10 shtator 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 9 mars 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë, në të cilën kërkoi nga Gjykata kthimin në gjendjen e mëparshme në kuptim të afatit të paraparë të Aktvendimit për papranueshmëri KI129/14, të 25 nëntorit 2014, në të cilin ai paraqitet si parashtrues i kërkesës.

12. Parashtruesi i kërkesës, në shtojcë të kërkesës së re bashkëngjiti dokumentacionin e njëjtë i cili ka qenë i bashkangjitur me kërkesën KI129/14, të 25 nëntorit 2014.

Përmbledhja e fakteve lidhur me Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese për papranueshmëri, KI129/14, të 25 nëntorit 2014

13. Më 29 dhjetor 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C1. nr. 515/2007) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës se marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë në mënyrë të paligjshme dhe urdhëroi Komunën e Prishtinës që t'ia pranojë parashtruesit të kërkesës të gjitha të drejtat që i kishte pasur për periudhën prej 1 tetorit 2003 deri më 31 dhjetor 2007.

14. *[...]*

15. Më 12 gusht 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktvendimi CA. nr. 3581/2012) e refuzoi si të pabazuar ankesën e të paditurës – Komunës së Prishtinës dhe vërtetoi Aktvendimin (C. nr. 1816/09) e Gjykatës Komunale në Prishtinë.

16. *[...]*

17. Më 4 shkurt 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktvendimi Rev. nr. 270/2013) pranoi revizionin e paraqitur nga Komuna e Prishtinës, anuloi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe e ktheu lëndën në rigjykim. Parashtruesi i kërkesës e pranoi këtë vendim më 20 mars 2014.

18. Më 8 prill 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin AC. nr. 3779/13 e refuzoi ankesën e debitorit – Komunës së Prishtinës, dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, E. nr. 1220/13, të 12 nëntorit 2013.

19. Më 13 gusht 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese në të cilën e konteston Aktvendimin [Rev. nr. 270/2013] e Gjykatës Supreme, të 4 shkurtit 2014, të cilin e ka pranuar më 20 mars 2014.

20. Në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të paraqitura në kërkesë, Gjykata më 25 nëntor 2014, konstatoi se kërkesa e parashtruesit, në pajtim me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, deklarohet e papranueshme sepse është e paafatshme.

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se:

> *„Tek pastaj kur më është mundësuar shiqimi i lëndës pas 10 kërkesave disaditëshe, e kam parë se Gjykata Supreme me procedura kryeneçe, arbitrare dhe të padrejta ka nxjerr vendimin kundërligjor, të cilin e kam kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese".*

22. Parashtruesi i kërkesës, më tej, pretendon se në kërkesën e tij të mëparshme KI129/14 ka kërkuar në mënyrë plotësuese që kërkesa e tij të shqyrtohet si e pranueshme në kuptim të afatit të paraparë, por kjo kërkesë nuk është protokolluar dhe shqyrtuar nga Gjykata.

23. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

> *„që në bazë të nenit 50 të Ligjit për GJK ta aprovoni kërkesën time për kthim dhe të merrni vendim meritor, gjegjësisht ta anuloni Vendimin e Gjykatës Supreme, sfiduar me nr. KI129/14."*

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata Kushtetuese, para se ta shqyrtojë kërkesën e parashtruar, së pari vlerëson nëse kërkesa e parashtruesit i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) d) dhe (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"36 (1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*
>
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*
>
> *[...]*
>
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

26. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 50 të Ligjit, i cili përcakton:

"Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj."

27. Gjykata i ka shqyrtuar në tërësi shkresat e bashkangjitura me këtë kërkesë dhe me kërkesën KI129/14. Gjykata vëren se është fakti që parashtruesi në kërkesën e tij të mëparshmeKI129/14 ka kërkuar në mënyrë plotësuese që kërkesa e tij të shqyrtohet si e pranueshme në kuptim të afatit të paraparë dhe në mbështetje të kësaj, ai tre herë (më 25 shtator 2014, 22 tetor 2014 dhe 30 tetor 2014) kishte dorëzuar në Gjykatë dokumentet e caktuara, të cilat janë regjistruar nga Gjykata.

28. Gjykata, gjithashtu, vëren se parashtruesi më 20 mars 2014 e pranoi Aktvendimin [Rev. nr. 270/2013] e Gjykatës Supreme, të 4 shkurtit 2014. Këtë fakt e ka konfirmuar Gjykata Themelore në Prishtinë duke e dorëzuar kopjen e fletëkthesës. Parashtruesi i kërkesës duke paraqitur dokumentacion shtesë, pretendon se nuk ka pasur qasje në shkresat e lëndës para gjykatave të rregullta, e në fakt, Aktvendimi i Gjykatës Supreme i ishte dorëzuar parashtruesit më 20 mars 2014, domethënë parashtruesi ka qenë i njoftuar me përmbajtjen e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, por thjesht nuk arriti të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar.

29. Përkitazi me këtë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për kthim në gjendje të mëparshme, siç është përcaktuar në nenin 50 të Ligjit, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur ta arsyetojë kërkesën e tij dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se si dhe pse pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar.

30. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 50 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 50 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtare raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI77/15, Parashtrues Naser Foniqi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK/nr. 18/2015, i 11 marsit 2015

KI77/15, Aktvendim për papranueshmëri i 12 nëntorit 2015, publikuar më 2 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, mosshterim i mjeteve juridike, e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parimet e sistemit gjyqësor, parimi i subsidiaritetit, procedurë disiplinore, kodi i etikës, keqpërdorim i funksioneve gjyqësore*

Komisioni disiplinor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës kishte refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, përkitazi me qortimin për keqpërdorim të funksionit gjyqësor. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Gjykata Kushtetuese vërejti separashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe shtoi, se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi kërkesës të shterojë të gjitha mjetetjuridike të parapara me ligj.Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI77/15
Parashtrues
Naser Foniqi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK/nr. 18/2015, të 11 marsit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Naser Foniqi me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Vendimi [KGJK/nr. 18/2015] i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KGJK), i 11 marsit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin, siç pretendohet, është bërë shkelja e nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor],nenit 107 [Imuniteti] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe shkeljet thelbësore të Ligjit për Gjykatat dhe Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm të Gjykatave.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 47 të Ligjit për

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 qershor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 15 tetor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dheKGJK-në për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 12 nëntor 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës është gjyqtar i Gjykatës Themelore në Prishtinë. Më 11 prill 2014, Zyra e Prokurorit Disiplinor (në tekstin e mëtejmë: ZPD), inicioi procedurën disiplinore kundër parashtruesit të kërkesës para KGJK-së për shkak të sjelljes joprofesionale, keqpërdorimit të funksioneve gjyqësore dhe shkeljes së Kodit të zbatueshëm të Etikës.

10. Më 1 gusht 2014, KGJK-së, pas procedurës së zbatuar [me Vendimin KD. nr. 10/2014], vendosi që të qortojë parashtruesin e kërkesës për shkak të sjelljes joprofesionale, keqpërdorimit të funksioneve gjyqësore dhe shkeljes së Kodit të zbatueshëm të Etikës.

11. Më 8 shtator 2014, i pakënaqur me vendimin e lartpërmendur, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Komisionin e shkallës së dytë të KGJK-së. Përveç parashtruesit të kërkesës, edhe ZPD-ja paraqiti ankesë ndaj vendimit të përmendur.

12. Më 11 mars 2015, Komisioni i shkallës së dytë i KGJK-së [me Vendimin KGJK/ nr. 18/2015] refuzoi ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe ZPD-së si të pabazuara dhe vërtetoi vendimin e Komisionit Disiplinor të KGJK-së.

Pretendimet e parashtruesit

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se KGJK-ja me vendimin e kontestuar i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe nenin 107 [Imuniteti] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

14. Parashtruesi kërkon nga Gjykata:

> *„Me këtë kërkesë dua që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të anuloj vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK. nr. 18/15, të datës 11.03.2015 [...]".*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *„Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

17. Gjithashtu, Gjykata i referohet edhe nenit 47. 2 të Ligjit, i cili përcakton:

> *„Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

18. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së Punës, i cili parasheh:

> *„Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar."*

19. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës deklaroi se KGJK-ja me vendimin e kundërshtuar i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

20. Në këtë rast mund të vërehet se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të

Kushtetutës, pasi që parashtruesi i kërkesës e ka pasur të drejtën e ankesës ndaj vendimit të kontestuar të KGJK-së para Departamentit për Kontestet Administrative të Gjykatës Themelore.

21. Gjykata më tej rikujtonse parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës të shterojë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

22. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih Aktvendimin për papranueshmëri: *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës,* KI41/09, të 21 janarit 2010, dhe shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës,* nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

23. Prandaj, Gjykata është e mendimit që kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

24. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 12 nëntor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI132/15, Parashtrues Manastiri i Deçanit - Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

KI132/15, Vendim për Masë të përkohshme i 12 nëntorit 2015, publikuar më 3 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, Masë e përkohshme, dëm i pariparueshëm, interes publik, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, mbrojtja e pronës, interesi publik*

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Kushtetuese vënien e Masës së përkohshme përkitazi me disa ngastra të kontestuara kadastrale me pretendimin se do të pësonte dëm të pariparueshëm. Parashtruesi, po ashtu, u ankua për zvarritje të procedurave gjyqësore që kishin zgjatur për 15 (pesëmbëdhjetë) vite dhe për më tepër, kontesti pronësorë ishte zhvendosur nga gjykatat e rregullta tek Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për t'u kthyer sërish për rivendosje tek gjykatat e rregullta.

Gjykata Kushtetuese vlerësoise duke marrë parasysh kompleksitetin e rastit dhe nevojën për analizë të hollësishme të shkeljeve të pretenduara të të drejtave themelore, ka arsye substanciale të natyrës së interesit publik për të justifikuar miratimin e Masës sëpërkohshme. Gjykata Kushtetuese vendosi që ta miratojë kërkesën përvënien e Masës së përkohshme, në pajtim me nenin 27 të Ligjit dhe rregullit 55 (4), (5) dhe (6) të Rregullores së punës.

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME
në
Rastin nr. KI132/15
Parashtrues
Manastiri i Deçanit
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Manastiri i Deçanit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Dragutin (Sava) Janjić, kryemurg i Manastirit të Deçanit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston dy vendime, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-13-0009, që të dyja të 12 qershorit 2015, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave), vendime këto që parashtruesit i janë dorëzuar më 9 korrik 2015.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të lartpërmendura, me të cilat pretendohet se parashtruesit i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia Para Ligjit], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin

32 [E Drejta për Mjete Juridike], me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë:Kushtetuta), dhe me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, respektivisht të pezullohet çdo procedurë gjyqësore, çdo veprim apo çdo vendim i autoriteteve publike në lidhje me këtë ankesë kushtetuese deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) përkitazi me këtë kërkesë.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 54 dhe 55 të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 3 nëntor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 4 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI132/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Në të njëjtën datë, me Vendimin KSH. KI132/15, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova (anëtare) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).

8. Më 4 nëntor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Po të njëjtën datë, Gjykata e njoftoi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme) për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga Dhoma e Posaçme t'i sigurojë Gjykatës një listë të caktuar të dokumenteve shtesë.

9. Më 5 nëntor 2015, Dhoma e Posaçme dorëzoi dokumentet e kërkuara në Gjykatë.

10. Më 9 nëntor 2015, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

11. Më 12 nëntor 2015, gjyqtari raportues i rekomandoi Gjykatës miratimin e Masës së përkohshme. Në të njëjtën datë, Gjykata vendosi njëzëri ta miratojë Masën e përkohshme deri më 29 shkurt 2016.

Përmbledhje e shkurtër e fakteve

12. Në parashtresat e tij, parashtruesi thekson se ka qenë pronar i ngastrave të konsiderueshme të tokës që i ishin konfiskuar dhe nacionalizuar nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë në vitin 1946.

13. Parashtruesi i kërkesës më tej pohon se në vitin 1997, Qeveria e Republikës së Serbisë ia dhuroi një pjesë të kësaj toke parashtruesit. Kjo dhuratë konsistonte në një ngastër prej 23,5 hektarësh në afërsi të objektit të parashtruesit dhe një ngastër tjetër prej 2 hektarësh që gjendej në qendër të komunës së Deçanit.

14. Më 26 prill 2000, dy ndërmarrje shoqërore të quajtura Iliria dhe Apiko ushtruan padi në Gjykatën Komunale të Deçan kundër parashtruesit të kërkesës, Komunës së Deçanit dhe Republikës së Serbisë, duke kërkuar anulimin e dhurimit të tokës parashtruesit, të kryer në vitin 1997.

15. Pasuan procedura të ndryshme gjyqësore deri më 7 dhjetor 2007, kur Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM) aplikoi për heqjen e rastit nga Gjykata Komunale në pajtim me nenin 4.5 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13, bazuar në juridiksionin ekskluziv të AKM-së mbi ndërmarrjet shoqërore dhe asetet e tyre.

16. Procedura të ndryshme pasuan pranë Dhomës së Posaçme. Më 27 dhjetor 2011, në një ankesë të përkohshme, Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme konstatoi se AKM-ja, e përfaqësuar nga Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut, dhe parashtruesi i kërkesës ishin palët e vetme të autorizuara në këtë rast.

17. Më 27 dhjetor 2012, Kolegji i specializuar i Dhomës së Posaçme vendosi në dy aktgjykimet, nr. SCC-0226 dhe nr. SCC-0227, me tekst identik, me të cilin paditë e ndërmarrjeve shoqërore u refuzuan si të pabazuara. Kolegji Pronësor konfirmoi se aktvendimi i përkohshëm i Kolegjit të Ankesave lidhur me përfaqësimin e autorizuar në këtë rast kishte marrë formë *res judicata*.

18. Më 23 janar 2013, respektivisht më 24 janar 2013, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) dhe dy ndërmarrjet shoqërore u ankuan në aktgjykimet nr. SCC-0226 dhe nr. SCC-0227.Më 29 janar 2013, Komuna e Deçanit iu bashkua ankesave.

19. Më 12 korrik 2015, Kolegji i Ankesave nxori vendimet përfundimtare Nr. C-I-13-0008/C-I-13-0009. Kolegji i Ankesave vendosi që: (1)

ankesat ishin të bazuara; (2) aktgjykimet e Kolegjit të specializuar nr. SCC-08-0226 dhe nr. SCC-08-0227 u anuluan; dhe, (3) Dhoma e Posaçme nuk ishte kompetente të gjykonte në këtë kontest. Në pajtueshmëri me këtë konkludim, Kolegji i Ankesave ktheu këtë çështje dhe çështjet e kontestit në Gjykatën Themelore në Pejë - Dega në Deçan.

Kërkesa e parashtruesit dhe kërkesa për Masë të përkohshme

20. Parashtruesi kërkon vlerësimin kushtetues të dy vendimeve me numra: AC-I-13-0008 dhe AC-I-13-0009, të dyja të datës 12 qershor 2015, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme. Parashtruesi pretendon se këto vendime kanë shkelur të drejtat e parashtruesit të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe me nenin 13 [E drejta për mjete juridike] të KEDNJ-së.

21. Lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë, parashtruesi argumenton se kjo e drejtë është cenuar në dy mënyra, konkretisht:

(1) e drejta për siguri juridike është cenuar në dy mënyra për shkak se:

(a) Kolegji i Ankesave ka lejuar palë të caktuara që të parashtrojnë ankesë ku më herët Kolegji i Ankesave kishte vendosur që vetëm parashtruesi dhe AKM-ja ishin palë të autorizuara në këtë rast. Kolegji i Ankesave e ka lejuar këtë ankesë dhe ka gjykuar në meritat e saj, përkundër faktit që këto palë nuk ishin të autorizuara të parashtrojnë ankesa; dhe

(b) sepse Kolegji i Ankesave ka aplikuar një interpretim të ri të ligjeve të zbatueshme me ç'rast vendosi që Dhoma e Posaçme kurrë nuk kishte juridiksion për rastin, përkundër faktit që Dhoma e Posaçme, në të gjitha nivelet (në Trupin gjykues, në Kolegj të Specializuar dhe në Kolegj të Ankesave), më herët kishte pranuar juridiksionin e saj dhe kishte nxjerrë vendime lidhur me rastin që nga viti 2008.

(2) është cenuar e drejta për përcaktim të të drejtave dhe detyrimeve civile brenda një afati të arsyeshëm, pasi që procedurat tashmë kanë zgjatur më shumë se 15 vjet dhe tani Dhoma e Posaçme e ka referuar rastin në Gjykatën Themelore ku duhet të fillojë *de novo*.

22. Parashtruesi po ashtu kërkon nga Gjykata që:

> *"Miratohet masa e përkohshme në këtë lëndë dhe ndalohet çfarëdo procedure e cilësdo gjykatë apo organi publik në lëndët e lidhura me këtë ankesë kushtetuese, deri në përfundimin e procedurës para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës."*

23. Në mbështetje të kësaj kërkese për Masë të përkohshme, parashtruesi pretendon se zyrtarët e Zyrës Kadastrale në Komunën e Deçanit, pa ndonjë bazë juridike apo pa autorizim, paraprakisht kanë ndryshuar të dhënat në kadastrën komunale lidhur me parcelat e kontestueshme të tokës dhe i kanë regjistruar ato në emra të ndërmarrjeve të reja shoqërore: Apiko dhe Iliria. Parashtruesi po ashtu pretendon se kjo zyrë kadastrale ka refuzuar të implementojë Vendimin Ekzekutiv të PSSP të 22 gushtit 2008 (UNMIK/ED/2008/16) për të kthyer regjistrin kadastral në gjendjen e mëparshme, duke regjistruar pronat përsëri në emër të Manastirit të Deçanit, deri në përmbylljen e procedurave gjyqësore.

24. Për më tepër, parashtruesi pretendon:

> *"Ekziston rreziku real se me aktet e reja të gjykatës në Deçan, dhe në veçanti me caktimin e masave të përkohshme [nga gjykata në Deçan], të cilat tashmë janë kërkuar në procedurën para [Dhomës së Posaçme] të Gjykatës Supreme, apo se me veprimet e reja të kadastrës në Deçan në dëm të Manastirit të Deçanit, të cilat do të zbatohen përmes Gjykatës Themelore në Deçan, parashtruesi i ankesës kushtetuese do të pëson dëme të pariparueshme [...]"*

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

25. Në mënyrë qëGjykata të lejojë Masë të përkohshme, në pajtim me nenin 27 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 55 (4), (5) dhe (6) të Rregullores së punës, duhet të konstatohet:

> *Neni 27 i Ligjit*
>
> *"1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik".*
>
> *Rregulli 55 (4) i Rregullores së punës*

[...]

"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të
paripërueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; dhe

(c) Masa e përkohshme është me interes publik".

Rregulli 55 (5) i Rregullores së punës

"Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

Rregulli 55 (5) i Rregullores së punës (ekstrakt)

[...] Nuk mund të merret vendim për Masë të përkohshme, përveç nëse specifikohet data e skadimit të tij. Sidoqoftë, data e skadimit mund të zgjatet me vendim tjetër të Gjykatës. [...]

26. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi ka paraqitur argumente të gjera lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave të tij themelore.

27. Gjykata po ashtu vëren se faktet e këtij rasti zbulojnë një sërë procedurash ligjore dhe gjyqësore që shtrihen në një periudhë prej më shumë se 15 vjetësh, që shfaqin kompleksitet të konsiderueshëm në vlerësimin dhe në interpretimin e ligjeve nga ana e autoriteteve përkatëse publike dhe gjyqësore.

28. Kësisoj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur rast *prima facie* përkitazi me meritat e kërkesës në kuptim të rregullit 55, paragrafi 4, pika (a) e Rregullores.

29. Gjykata vëren se parashtruesi pohon që është i varur nga mundësia për kultivimin e ngastrave kontestuese të tokës si mjet jetese. Parashtruesi po ashtu pohon se është i brengosur për dëmin potencial që mund t'i shkaktohet mirëqenies së tij ekonomike si rezultat i veprimeve që mund të ndërmerren nga Gjykata Themelore ose nga autoritetet e tjera publike përkitazi me këtë tokë.

30. Duke pasur parasysh rrethanat, Gjykata konsideron se ka arsye të konsiderueshme të pranojë se parashtruesi do të pësonte dëm të pariparueshëm në kuptim të Rregullit 55, paragrafi 4, pika b, të Rregullores së punës që kërkon shtyrje në zbatimin e çfarëdo procedure të mëtutjeshme gjyqësore në lidhje me parcelat kontestuese të tokës deri në vendosjen përfundimtare të kërkesës nga ana e Gjykatës.

31. Përveç kësaj, Gjykata është e vetëdijshme se parashtruesi i kërkesës është i pranuar si Objekt i Trashëgimisë Botërore nga UNESCO. Për më tepër, Gjykata vëren se janë disa autoritete publike dhe organe gjysmëpublike të përfshira në këtë rast, dhe çfarëdo vendimi i mëtejmë në këtë rast do të mund të çonte në më shumë komplikime dhe në dëme të mëtejmë të pariparueshme për palët e ndryshme të interesuara në këtë rast.

32. Në dritën e kësaj dhe duke marrë parasysh kompleksitetin e rastit dhe nevojën për analizë të hollësishme të shkeljeve të pretenduara të të drejtave themelore, Gjykata konsideron se po ashtu ka arsye substanciale të natyrës së interesit publik në kuptim të rregullit 55, paragrafi 4, pika (c), për të justifikuar miratimin e Masës së përkohshme.

33. Rrjedhimisht, Gjykata, pa paragjykim të çfarëdo vendimi të mëtejmë që do të nxirret nga Gjykata, përkitazi me pranueshmërinë ose me meritat e kërkesës në të ardhmen, konkludon se kërkesa për Masë të përkohshme duhet të miratohet si e bazuar me qëllim të parandalimit të dëmeve të pariparueshme për parashtruesin dhe me qëllim të mbrojtjes së interesit publik.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 27 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 55 (4), (5) dhe (6) dhe të rregullit 56 (c) Rregullores së punës, më 12 nëntor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA MIRATOJË kërkesën për Masë të përkohshme, respektivisht të pezullojë çdo procedurë gjyqësore, çdo veprim ose çdo vendim të autoriteteve publike lidhur me këtë ankesë kushtetuese;

II. Kjo masë e përkohshme do të aplikohet deri më 29 shkurt 2016;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI21/15, Parashtrues Halim Ibrahimi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 179/2014, i 8 tetorit 2014

KI21/15, Aktvendim për papranueshmëri i 11 shtatorit 2015 publikuar, më 7 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, masat disiplinore, marrëdhënie pune, pritje legjitime*

Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar kërkesën për revizion të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës përkitazi me kthimin e tij në vendin e punës "referent në sektorin privat". Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar në shkelje të së drejtës në punë dhe ushtrim të profesionit.

Gjykata Kushtetuese vërejti se parashtruesi i kërkesës, faktikisht dhe juridikisht, nuk ka pasur asnjë "pritje legjitime" që do të kthehet në vendin e punës në të cilin nuk ka punuar më parë, dhe i cili, as që kishte ekzistuar në skemën organizative të punëdhënësit të tij dhe shtoi se veprimet e gjykatave të rregullta nuk ishin të padrejta ose arbitrare. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI21/15
Parashtrues
Halim Ibrahimi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 179/2014, të 8 tetorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Halim Ibrahimi, i përfaqësuar nga z. Ramiz Suka, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 179/2014, të 8 tetorit 2014. Ky aktgjykim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës, më 17 nëntor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 179/2014, të 8 tetorit 2014.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin113.7të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47tëLigjit përGjykatënKushtetuese të Republikëssë Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të

Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 shkurt 2015, parashtruesi e dorëzoi nëpërmjet postës kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 mars2015,Kryetari iGjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI21/15, caktoigjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës me Vendiminnr.KSH. KI21/15,caktoiKolegjin shqyrtues,të përbërënga gjyqtarët: Altay Suroy, Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 2 prill 2015, parashtruesi u njoftua për regjistrimin e kërkesës, dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.

8. Më 27 prill 2015, parashtruesit të kërkesës i ishte kërkuar që ta dorëzojë autorizimin për përfaqësuesin e tij si dhe dëshmi për datën e dorëzimit të Aktgjykimit të kontestuar. Të njëjtën ditë, Gjykata Themelore në Prishtinë u njoftua për regjistrimin e kërkesës, dhe i ishte kërkuar që të dorëzojë dëshmi që tregon datën e dorëzimit të Aktgjykimit të kontestuar.

9. Më 26 qershor 2015, ka përfunduar mandati i gjyqtarit Kadri Kryeziu. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI21/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu.

10. Më 4 gusht 2015, parashtruesit të kërkesës i ishte kërkuar prapë që të dorëzojë autorizimin për përfaqësuesin e tij si dhe ta nënshkruajë formularin e kërkesës.

11. Më 14 gusht 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi autorizimin dhe nënshkroi formularin e kërkesës.

12. Më 11 shator2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë rrjedh se parashtruesi i kërkesës kishte krijuar marrëdhënie pune me kompaninë NPK "Higjieno-Teknika" në Prishtinë në vitin 1981 në pozitën e bartësit të bërllokut. Nga viti 1981 deri në vitin 2002 parashtruesi i kërkesës

kishte ofruar shërbimet e tij për NPK "Higjieno-Teknika" në vende të ndryshme të punës.

14. Më 14 mars 2001, NPK "Higjieno-Teknika" me Vendimin Nr. 228 e caktoi parashtruesin e kërkesës në vendin e punës rojtar i varrezave, e cila pozitë ishte pranuar zyrtarisht nga parashtruesi i kërkesës (kontrata nr. 162, e 27 shkurtit 2002). Ky vendim ishte rezultat i procedurës disiplinore kundër parashtruesit të kërkesës, sepse ai kishte refuzuar t'i kryejë obligimet që i kishte në pozitën e mëparshme të punës, për shkak se kishte kërkuar të punojë në zyrë në vendin e punës si "referent në sektorin privat".

15. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër NPK "Higjieno-Teknika", me të cilën kërkoi anulimin e Vendimit nr. 228, të 14 marsit 2001 dhe kthimin e tij në vendin dhe detyrat e punës si referent në sektorin privat.

16. Më 30 janar 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 1533/09 refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me të cilën kishte kërkuar anulimin e Vendimit Nr. 228, të 14 marsit 2001 dhe kthimin e tij në vendin dhe detyrat e punës "referent në sektorin privat". Gjykata Komunale në Prishtinë arsyetoi, *inter alia*, se parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar pozitën e rojtarit të varrezave, duke nënshkruar kontratën nr. 162 të 27 shkurtit 2002, se parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk kishte pasur kontratë me punëdhënësin e tij lidhur me vendin e punës "referent në sektorin privat", se pozita e "referentit në sektorin privat" as që kishte ekzistuar dhe se kërkesëpadia e tij për kthim në vendin e punës si "referent në sektorin privat" është në kundërshtim me dëshmitë që ai i kishte dorëzuar në Gjykatën Themelore.

17. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër vendimit të lartcekur të gjykatës së shkallës së parë. Parashtruesi i kërkesës pretendoi, *inter alia*, shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikim të gabuar të së drejtës materiale dhe propozoi që vendimi i kontestuar të prishet dhe rasti të kthehet në rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

18. Më 25 nëntor 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi Ac. nr. 4820/2012) e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, si të pabazuar, dhe vërtetoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë (Aktgjykimi C. nr. 1533/09 të 30 janarit 2012). Gjykata e Apelit e Kosovës u pajtua dhe pranoi vlerësimin juridik dhe faktik të rastit nga gjykata e shkallës së parë, duke shtuar, *inter alia*, se gjykata e shkallës

së parë ka vërtetuar drejt situatën faktike dhe ka zbatuar drejt të drejtën materiale kur ka konstatuar se kërkesëpadia e parashtruesit është e pabazuar.

19. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme. Parashtruesi pretendoi, *inter alia*, shkelje thelbësore të Ligjit për procedurën kontestimore, aplikim të gabuar të së drejtës materiale dhe propozoi që vendimet e gjykatës së shkallës së parë përkatësisht, të Gjykatës së Apelit, të kthehen për rishqyrtim.

20. Më 8 tetor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 179/2014) e refuzoi kërkesën e parashtruesit për revizion si të pabazuar. Gjykata Supreme e Kosovës u pajtua dhe pranoi vlerësimin juridik dhe faktik të rastit nga gjykata e shkallës së parë respektivisht, nga ajo e Apelit, duke shtuar, *inter alia*, se: (i) pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë të pabazuara sepse masa disiplinore e shqiptuar nga punëdhënësi kundër parashtruesit, përkatësisht ndërrimi i vendit të tij të punës ishte me kohëzgjatje të pacaktuar dhe jo me karakter të përkohshëm dhe (ii) parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk kishte themeluar marrëdhënie pune me punëdhënësin e tij për vendin e punës (referent në sektorin privat) ku ai kërkon të kthehet.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që ta kthejë në vendin e punës *"referent në sektorin privat tek NPK "Higjieno -Teknika"*.

22. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se janë bërë shkelje flagrante të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

25. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton se:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

26. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

...

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

27. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: *"të kthehet në vendin e punës referent i sektorit privat tek NPK "Higjieno-Teknika"*, dhe se, janë bërë *"shkelje flagrante të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]".*

28. Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë shpjeguar në mënyrë të mjaftueshme të drejtat dhe obligimet kontraktuale në mes të parashtruesit të kërkesës dhe punëdhënësit të tij NPK "Higjieno-Teknika" që dalin nga marrëdhënia e punës, natyrën e masës disiplinore të shqiptuar ndaj parashtruesit të kërkesës dhe gjatësinë e pasojave të asaj mase, dhe se parashtruesi i kërkesës nuk kishte provuar në gjykatat e rregullta se ai kishte punuar më parë vendin e punës së "referentit në sektorin privat" gjegjësisht, ai nuk kishte ofruar asnjë provë për ta mbështetur atë pretendim.

29. Përveç kësaj, gjykatat e rregullta kanë vërtetuar se vendi i punës së "referentit në sektorin privat" nuk ka ekzistuar në skemën organizative të punëdhënësit të tij, NPK "Higjieno-Teknika". Për këtë arsye, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, faktikisht dhe juridikisht, nuk ka pasur asnjë "pritje legjitime" që do të kthehet në vendin e punës në të cilin nuk ka punuar më parë, dhe i cili, as që kishte ekzistuar në skemën organizative të punëdhënësit të tij.

30. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve. Gjykata Kushtetuese dëshiron të ritheksojë se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojë si "gjykatë e

shkallës së katërt" (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë,* Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* në Rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

31. Përveç kësaj, kërkesa nuk tregon që gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991)

32. Fakti që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk i jep të drejtë të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

33. Duke pasur parasysh këtë që u tha më lart, Gjykata vlerëson se faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimin për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

34. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, më 11 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI34/15, Parashtrues Avdullah Kurti - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1066/13, i 24 nëntorit 2014

KI34/15, Aktvendim për papranueshmëri i 14 tetorit 2015, publikuar më 14 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, procedurë përmbarimore, kontratë pune, marrëdhënie e punës, kompensim i pagave*

Gjykata e Apelit e Kosovës kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për përmbarim të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, përkitazi me kthimin e tij në vendin e punës dhe kompensimin e pagave të papaguara. Gjykata e Apelit të Kosovës vendimin e saj e kishte bazuar në vendimin e Gjykatës Supreme që kishte miratuar kërkesën për revizion të palës kundërshtare dhe urdhëroi ndalimin e procedurës përmbarimore. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar në shkelje të të drejtave të tij kushtetuese me pretendimin se revizioni nuk mund ta ndalojë procedurën përmbarimore.

Gjykata Kushtetuese vërejti se kërkesa e parashtruesit nuk ngre çështje kushtetuese por më tepër çështjetë ligjit dhe të fakteve që kanë të bëjnë me detyrat dhe prerogativën e gjykatave të rregullta që u janë dhënë atyre me ligj dhe Kushtetutë dhe shtoi, se çështja, nëse revizioni i parashtruar e ndalon procedurën përmbarimore është çështje e ligjshmërisë që duhet të zgjidhet nga gjykatat e rregullta. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI34/15
Parashtrues
Avdullah Kurti
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1066/13, të 24 nëntorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesaështë dorëzuar nga z. Avdullah Kurti nga fshati Vllahi, në Mitrovicë (në tekstin e mëtejmë:parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr. 1066/13, të 24 nëntorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1066/13, të 24 nëntorit 2014.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin113.7të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47tëLigjit përGjykatënKushtetuese të Republikëssë Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 mars 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 21 prill2015,KryetariiGjykatës caktoigjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dheKolegjin shqyrtuestë përbërënga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 22 maj 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit të Kosovës.

8. Më 14 tetor2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se parashtruesi ishte i punësuar në Shërbimin e Kontabilitetit Shoqëror - Dega në Mitrovicë (në tekstin e mëtejmë: SHKSH), prej 1 qershorit 1973 deri më 31 gusht 2001, kur marrëdhënia e tij e punës ishte ndërprerë. SHKSH-ja ishte shpërbërë dhe Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: ABPK) është themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/20. ABPK-ja e kishte ndërprerë kontratën e punës së parashtruesit të kërkesës, sepse, *inter alia*, nuk e konsideronte veten si trashëgimtare të SHKSH-së.

10. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadi kundër ABPK-së në Gjykatën Komunale në Mitrovicë, me të cilën kërkoi kthimin në punë dhe kompensimin për të ardhurat e papaguara personale.

11. Më 25 qershor 2001, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 21/2001) e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe e obligoi të paditurën që ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe t'ia kompensojë të ardhurat personale në vlerë prej 380 DM, duke filluar nga 31 gushti 2000 në afat prej 15 ditësh. Gjykata Komunale arsyetoi, *inter alia*, se ABPK-ja kishte vazhdimësi dhe i trashëgoi të gjitha të drejtat dhe detyrimet e SHKSH-së, se ishte e padiskutueshme se parashtruesi i kërkesës ishte në marrëdhënie të përhershme të punës deri në momentin e themelimit të ABPK-së dhe se ABPK-ja

kishte punësuar punëtorë të rinj në kundërshtim me Ligjin e aplikueshëm për marrëdhënien e punës.

12. Më 28 shtator 2001, ABPK parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë duke pretenduar, *inter alia*, shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK), vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

13. Më 23 mars 2002, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Komunale në Mitrovicë propozim për përmbarimin e Aktgjykimit të saj (C. nr. 21/2001, të 25 qershorit 2001), duke kërkuar që ABPK-ja ta kthejë atë në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, dhe t'ia kompensojë atij të ardhurat personale deri në kthimin përfundimtar në vendin e punës.

14. Më 26 prill 2002, Gjykata e Qarkut (Aktgjykimi Ac. nr. 140/2001) e refuzoi ankesën e ABPK-së, si të pabazuar, dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale. Gjykata e Qarkut arsyetoi, *inter alia*, se është e padiskutueshme se ABPK-ja administron pasuritë të cilat më parë janë administruar nga SHKSH, se është e padiskutueshme se ABPK-ja është një subjekt i pavarur juridik që ka të bëjë me veprimtarinë e qarkullimit të pagesave dhe se të gjitha këto karakteristika i kishte edhe SHKSH, se ABPK-ja ka punësuar punëtorë të rinj, pa i respektuar procedurat ligjore, dhe përveç kësaj, ABPK ka ndërprerë marrëdhënien e punës së parashtruesit të kërkesës pa kryer ndonjë procedurë në pajtim me Ligjin për marrëdhënien e punës.

15. Më 20 maj 2002, ABPK parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar, *inter alia*, shkelje esenciale të dispozitave të LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Prokurori Publik i Kosovës, gjithashtu, iu bashkëngjit procedurës, duke parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimeve në fjalë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

16. Më 7 qershor 2002, Gjykata Komunale (Aktvendimi E. nr. 272/2002) lejoi ekzekutimin e Aktgjykimit të saj (C. nr. 21/2001, të 25 qershorit 2001), me të cilin urdhërohej kompensimi dhe kthimi i parashtruesit të kërkesës në vendin e punës. Gjykata Komunale në Mitrovicë më pas kishte hedhur poshtë, si të pabazuar, kundërshtimin e ABPK-së (Aktvendimi E. nr. 272/2002, i 12 korrikut 2002).

17. Më 26 nëntor 2002, Gjykata Supreme (Aktgjykimi MLC. nr. 2/2002) konstatoi:

"Pranohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e Prokurorit Publik të Kosovës dhe revizioni i të padituri; ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Mitrovicë, Ac. nr. 140/2001 datë 26.4.2002 dhe ai i Gjykatës Komunale Mitrovicë, C. nr. 21/2001 datë 25.6.2001, ashtu që refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit që të detyrohet i padituri Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës - Filiali në Mitrovicë, që paditësin ta kthejë në vendin e tij të punës, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës si dhe të bëjë shpërblimin e të ardhurave personale prej 380 DM në muaj, duke filluar prej 31.8.2000 deri në kthimin e paditësit në vendin e punës".

18. Përveç kësaj, në aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Supreme në pjesën e tij relevante theksohet:

"Vërtet, paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në ish-SHKSH dhe gjerë më 31.8.2000 i padituri ia ka paguar, në formë ndihme, stipendiumin mujor në një shumë prej 210 DM. Sipas Rregullores 1999/20 datë 15. 11.1 999, Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës (BPK) është një person juridik publik i veçantë dhe, sipas dispozitës së nenit 3.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999120, BPK-ja mund të përdorë dhe të administrojë, në emër të UNMIK-ut, pronën e Bankës Kombëtare të Kosovës, me qendër në rr. "Mareshali Tito" (tani "Nënë Tereza"), si dhe pronën e shërbimit të pagesave publike të Kosovës me qendër në rr. "Lenini" në Prishtinë. Me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/11 të datës 13. 10.1999, është parashikuar ushtrimi i kontrollit mbi pajisjet, objektet dhe shërbimet e pagesave. Ndër të tjera, me dispozitën e nenit 1 të kësaj Rregulloreje është paraparë që të gjitha pajisjet dhe objektet, duke përfshirë gjithë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, që gjendet në Kosovë dhe që janë përdorur nga Shërbimi i Pagesave Publike i Kosovës, me seli në rr. "Lenini" në Prishtinë, do të përdoren dhe do të administrohen nga UNMIK-u.

Për faktin se i padituri i administron mjetet themelore, të cilat i ka administruar ish-Shërbimi i Kontabilitetit Shoqëror, nuk mund të përfundohet për ekzistimin e ndonjë suksesioni juridik mes të padituri dhe ish-SHKSH, nga se, sipas nenit 6 të Rregullores 1999/1 UNMIK-u do të administrojë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, duke përfshirë financat, llogaritë bankare dhe pronën tjetër të çdo organi të tij që gjendet në territorin e Kosovës. Nuk ekziston asnjë bazë juridike me cilën parashikohet që i padituri ka trashëguar detyrimet nga ish-SHKSH-ja. Përveç kësaj, paditësi ka qenë i njoftuar që pagesa në formë burse nga ana e të padituri do të bëhet gjer më 31.8.2000 dhe nëse do të ekzistonte nevoja për punësim brenda organizatës, paditësi kishte të drejtë të

konkurronte për atë vend pune. Gjykata e shkallës së parë, sikurse edhe gjykata e shkallës së dytë, gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Për këtë arsye, me pranimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe revizionit, të dy aktgjykimet janë ndryshuar dhe kërkesëpadia e paditësit është refuzuar si e pabazuar".

19. Më 28 janar 2003, parashtruesi i kërkesës parashtroi propozim për përsëritje të procedurës në Gjykatën Supreme. Parashtruesi pretendonte, *inter alia*, se atij nuk i ishte dhënë mundësia që të marrë pjesë në shqyrtim pranë Gjykatës Supreme dhe se Aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës Supreme është tërësisht i pabazuar, i papranueshëm dhe i paligjshëm.

20. Më 19 korrik 2006, Gjykata e Qarkut (Aktgjykimi Ac. nr. 90/2002) refuzoi ankesën e ABPK-së dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale (E. nr. 272/2002, të 7 qershorit 2002). Gjykata e Qarkut arsyetoi, se në bazë të nenit 384 të LPK-së revizioni i parashtruar nuk mund të ndalojë ekzekutimin e aktgjykimit të plotfuqishëm dhe se në rastin konkret në bazë të aplikimit të dispozitës në fjalë, Aktgjykimi i plotfuqishëm (C. nr. 21/2001, i 25 qershorit 2001) nuk mund të pezullohet.

21. Më 14 shkurt 2007, Gjykata Supreme (Aktvendimi PPC. Nr. 3/2006) konstatoi se propozimi i parashtruesit të kërkesës për përsëritje të procedurës është i pabazuar. Gjykata Supreme, *inter alia*, arsyetoi se në pajtim me nenin 391 të LPK-së vendosi lidhur me revizion duke u bazuar vetëm në dokumentet zyrtare të rastit.

22. Më 19 shkurt 2013, Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktvendimi E. nr. 577/2009) lejoi ekzekutimin e propozimit të parashtruesit të kërkesës.

23. Më 4 mars 2013, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: BQK-ja) si trashëgimtare e ABPK-së, parashtroi kundërshtim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë kundër Aktvendimit Nr. 577/09, të 19 shkurtit 2013 për lejimin e propozimit për përmbarim. BQK-ja pretendoi, *inter alia*, se vendimi i kontestuar nuk mund të ekzekutohet, për shkak se ekzistojnë dy vendime të Gjykatës Supreme (Aktgjykimi MLC Nr. 2/2002, i 26 nëntorit 2002, dhe Aktvendimi PPC. Nr. 3/2006, i 14 shkurtit 2007), me të cilët janë anuluar vendimet e Gjykatës Komunale dhe të Qarkut në Mitrovicë (Aktgjykimi C. nr. 21/2001, i 25 qershorit 2001, dhe Ac. nr. 140/2001, i 26 prillit 2002).

24. Më 29 mars 2013, Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktvendimi E. nr. 577/2009) aprovoi kundërshtimin e BQK-së. Gjykata Themelore në Mitrovicë arsyetoi, *inter alia*, se Gjykata Supreme e ka aprovuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga Prokurori Publik dhe revizionin e BQK-së për të ndryshuar vendimet e Gjykatës Komunale dhe të Qarkut në Mitrovicë, ka refuzuar, si të pabazuar, kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për t'u kthyer në vendin e punës dhe, përveç kësaj, Gjykata Supreme më pas hodhi poshtë, si të pabazuar, propozimin e parashtruesit të kërkesës për përsëritje të procedurës.

25. Më 4 prill 2013, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër vendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Mitrovicë. Parashtruesi i kërkesës u ankua, *inter alia*, se ai ishte i privuar padrejtësisht nga e drejta për t'u kthyer në vendin e punës dhe se Gjykata Themelore kishte shkelur nenin 384 të LPK-së, i cili parasheh se revizioni nuk mund të ndalojë ekzekutimin e aktgjykimit të plotfuqishëm.

26. Më 24 nëntor 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktvendimi Ac. nr. 1066/13) konstatoi se: *"NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, E. nr. 577/09 të datës 29.03.2013, dhe gjykohet: përfundon procedura përmbarimore e lejuar në bazë të aktvendimit mbi caktimin e ekzekutimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, E nr. 577/09 të datës 19.02.2013. dhe PRISHEN veprimet e ndërmarra përmbarimore"*. Gjykata e Apelit arsyetoi, *inter alia*, se Aktgjykimi (C. nr. 21/2001, i 25 qershorit 2001) me të cilin lejohej përmbarimi ishte ndryshuar nga Gjykata Supreme, procedura përmbarimore kishte përfunduar dhe aktet e ndërmarra të përmbarimit ishin anuluar në pajtim me nenin 57.3 (Vendosja sipas prapësimit) në lidhje me nenin 73 (Marrja fund e përmbarimit) të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesëspretendon se në rastin e tij: *"...që nga fillimi deri në fund janë bërë shkelje të konsiderueshme të ligjit dhe të Kushtetutës"*.

28. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: *"... ta keni në konsideratë këtë Aktvendim Ac. nr. 90/2002 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë ku thuhet që në pajtim me nenin 384 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, revizioni i parashtruar nuk e ndalon përmbarimin e aktgjykimit të plotfuqishëm"*.

29. Parashtruesi i kërkesës, përgjithësisht, pretendon shkelje të Kushtetutës; megjithatë, ai nuk thirret në ndonjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari vlerësonnëseparashtruesii kërkesës i kapërmbushurkriteret epranueshmërisë,të përcaktuarame Kushtetutë dhe të specifikuaramë tejnëLigj dhe në Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë* të *autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

32. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

33. Gjykata më tej merrparasysh rregullin 36 (1) (d) dhe 2 (d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *(1) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *...*
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:...*
>
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

34. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: *"ta kini në konsideratë Aktvendimin Ac. nr. 90/2002 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë që thekson se sipas nenit 384 të Ligjit për Procedurën Kontestimore revizioni i parashtruar nuk mund ta ndalojë ekzekutimin e aktgjykimit të plotfuqishëm... dhe se në rastin e tij që nga fillimi deri në fund janë bërë shkelje të ligjit dhe të Kushtetutës".*

35. Gjykata konsideron se Gjykata e Apelit e Kosovës ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm, duke shpjeguar se Gjykata Supreme vërtetoi revizionin e parashtruar nga ABPK, dhe refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe se Gjykata Supreme më pas refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për përsëritje të procedurës.

36. Në të vërtetë, Gjykata e Apelit vendosi që *"përfundon procedura përmbarimore e lejuar në bazë të aktvendimit mbi caktimin e ekzekutimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, E nr. 577/09 të datës 19.02.2013 dhe PRISHEN veprimet e ndërmarra përmbarimore,"* duke shpjeguar se procedura përmbarimore ishte ndryshuar na Gjykata Supreme dhe veprimet e ndërmarra përmbarimore ishin anuluar.

37. Për më tepër, çështja nëse revizioni i parashtruar e ndalon procedurën përmbarimore ose nëse një institucion është trashëgimtar i një tjetri janë çështje të ligjshmërisë, që duhet të zgjidhen nga gjyqësori i rregullt.

38. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk ngre çështje kushtetuese por më tepër çështje të ligjit dhe të fakteve që kanë të bëjnë me detyrat dhe prerogativën e gjykatave të rregullta, që u janë dhënë atyre me ligj dhe Kushtetutë.

39. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit, që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).

40. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM],* Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

41. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve, dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë,* Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* në Rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

42. Gjykata thekson se detyrë e saj është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

43. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk tregon si dhe pse Gjykata e Apelit kishte vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë, kur kishte konkluduar se përmbarimi ishte anuluar nga Gjykata Supreme.

44. Përveç kësaj. Gjykata Kushtetuese nuk mund ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion.

45. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij për shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që Gjykata e Apelit e Kosovës ia kishte mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

46. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 tetor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI37/15, Parashtrues Rrahim Zeka - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 306/2014, i 16 dhjetorit 2014

KI37/15, Aktvendim për papranueshmëri i 14 tetorit 2015, publikuar më 14 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, ndërprerje e marrëdhënies së punës, pension invalidor*

Gjykata Supreme kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për revizion të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, përkitazi me ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe pensionit invalidor. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Gjykata Kushtetuese vërejti se në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës kurrë nuk u ankua ndaj vendimit të punëdhënësit për pensionim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe rrjedhimisht, ka pranuar ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe shtoi se,procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta ose arbitrare. Gjykata Kushtetuese,në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI37/15
Parashtrues
Rrahim Zeka
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 306/2014, të 16 dhjetorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Rrahim Zeka (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), me vendbanim në fshatin Vërnicë, komuna e Vushtrrisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 306/2014, të16dhjetorit 2014, me të cilin u refuzua, si i pabazuar, revizioni i parashtruesit përkitazi me kërkesën e tij për kthim në vendin e tij të mëparshëm të punës.

3. Aktgjykimi i kontestuar iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 29 dhjetor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë sëaktgjykimit të kontestuar, me të cilin, pretendohet se parashtruesit i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 23 mars 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Më 5 maj 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues në vend të gjyqtares Arta Rama-Hajrizi dhe gjyqtarin Altay Suroy anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Almiro Rodrigues.

10. Më 14 tetor 2015,Kolegjishqyrtues e shqyrtoiraportin e gjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës ishte në marrëdhënie pune me Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi), për një periudhë të pacaktuar kohore.

12. Në një datë të pacaktuarparashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë pranë Fondit Pensional të punëdhënësit, për t'i njohur atij të drejtën e një pagese mujore në emër të pensionit invalidor.

13. Më 29 prill 2003, punëdhënësi miratoi kërkesën e parashtruesit dhe vendosi të dërgojë parashtruesin e kërkesës në pension të parakohshëm me marrëveshje, për një pagesë mujore në vlerë prej njëqind e pesë euro (105 €) në emër të pensionit suplementar, duke filluar nga 1 prilli 2004 e deri më 31 mars 2009 (në tekstin e mëtejmë: Vendimi i punëdhënësit).

14. Pas përfundimit të periudhës prej 5 (pesë) vjetësh, të përcaktuar në Vendimin e lartpërmendur të punëdhënësit, parashtruesi parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës ose kompensim me një pagesë mujore në emër të pensionit suplementar nga 1 prilli 2009 e deri në plotësimin e kushteve ligjore për pensionimin e parashtruesit.

15. Më 27 tetor 2011, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 105/09) e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit.

16. Gjykata Komunale konstatoi se marrëdhënia e punës, në kuptimin e një marrëdhënie kontraktuese, u jep palëve të drejtën që lirisht të përcaktojnë të drejtat dhe detyrat që rrjedhin nga kjo marrëdhënie. Kështu, marrëdhënia e punës dhe e drejta e parashtruesit për pagesë mujore ishte ndërprerë pas skadimit të periudhës së përcaktuar me Vendimin e punëdhënësit dhe përmbushjes së detyrimeve financiare të punëdhënësit, ndaj parashtruesit të kërkesës.

17. Më 9 dhjetor 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit *"për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes të së drejtës materiale"*.

18. Më 3 maj 2013, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi AC. nr. 3146/2012) aprovoi ankesën duke e prishur Aktgjykimin, C. nr. 105/09 e Gjykatës Komunale dhe duke e kthyer lëndën Gjykatës Komunale për rigjykim.

19. Në aktgjykimin e saj, Gjykata e Apelit theksoi: "*Aktgjykimi i goditur përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat kjo gjykatë i shikon sipas detyrës zyrtare nga neni 182 par. 1 dhe 2 pika, si dhe gjendja faktike është vërtetuar gabimisht e si pasojë e kësaj edhe e drejta materiale gabimisht është aplikuar, prandaj aktgjykimi i goditur detyrimisht është dashur të prishet"*.

20. Më 23 korrik 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 1183/2013) refuzoi, si të pabazuar, kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës..

21. Më 8 tetor 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit *"për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*".

22. Më 29 mars 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ac. nr. 48/2014) refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

23. Gjykata e Apelit aprovoi*"në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për faktin se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore (...) dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike*".

24. Më 17 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, "*për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale*".

25. Më 16 dhjetor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 306/2014) refuzoi, si të pabazuar, revizionin e parashtruesit të kërkesës.

26. Gjykata Supreme theksoi: "*drejt kanë vepruar gjykatat e instancës më të ulët kur kanë refuzuar kërkesëpadinë paditësit*". Gjithashtu, Gjykata Supreme konsideroi se *"Me vetë faktin që paditësi nuk është ankuar kundër vendimit të paditurës për pensionim në emër të invaliditetit ka pranuar ndërprerjen e marrëdhënies së punës"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

28. Parashtruesi i kërkesës kërkon:

> *"Të vërtetohet gjendja faktike.*
> *Të shqyrtohen drejtë të gjitha shkresat e lëndës në rastin tim.*
> *Me këtë kërkoj të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra në instanca më të ulëta gjyqësore, dhe kërkesa ime të aprovohet sipas padisë së parashtruar në Gjykatën Komunale C-105/09 dt. 05.01.2009".*

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutëdhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

31. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

32. Parashtruesi pohon se aktgjykimi i kontestuar ka shkelur nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat e tij ishin shkelur për shkak të vërtetimit të gabuar të fakteve dhe të zbatimit të gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta. Megjithatë, ai nuk ka treguar se si dhe pse këto gabime ligjore kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.

34. Në fakt, parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë provë *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, të 31 majit 2015).

35. Për më tepër, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme në mënyrë të hollësishme arsyetoi se pse u refuzua kërkesëpadia e parashtruesit. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konstatoi se punëdhënësi kishte përmbushur obligimin e tij ndaj parashtruesit në përputhje me Vendimin e punëdhënësit, i cili është marrë sipas kërkesës së parashtruesit dhe i cili nuk është kontestuar nga ana e tij.

36. Për më tepër, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme konkludoi se parashtruesi i kërkesës kurrë nuk u ankua ndaj vendimit të

punëdhënësit për pensionim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe rrjedhimisht *"ka pranuar ndërprerjen e marrëdhënies së punës"*. Parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar se si dhe pse konkludimi i Gjykatës Supreme ia cenon të drejtat për barazi para ligjit, gjykim të drejtë dhe të paanshëm apo për mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

37. Gjykata më tej konsideron se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta ose arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë,* nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

38. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit osetë ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).

39. Prandaj, Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu Rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

40. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur dhe dështmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit si dhe në pajtim me Rregullin 36 (1) d) dhe (2) d) të Rregullores së punës, më 14 tetor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI69/15, Parashtrues Enver Krasniqi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 305/2014, i 8 dhjetorit 2014

KI69/15, Aktvendim për papranueshmëri i 14 tetor 2015, publikuar më 21 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, kompensim i dëmit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm,e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, ndërprerje e marrëdhënies së punës, periudhë provuese*

Gjykata Supreme kishte konkluduar se padia e parashtruesit të kërkesës për kthim në vend të punës dhe kompensim të dëmit ishte paraqitur jashtë afatit ligjor. Parashtruesiu ankua në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar shkelje të së drejtës në punë dhe ushtrim të profesionit, dhe të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Gjykata Kushtetuese vërejti se në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se kontrata e tij e punës është ndërprerë në mënyrë të paligjshme dhe se, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për aplikim të gabueshëm të së drejtës procedurale janë në kundërshtim me dokumentacionin që ai i ka dorëzuar Gjykatës. Gjykata Kushtetuese shtoi, se parashtruesi i kërkesës kryesisht nuk është i kënaqur me kualifikim juridik të ligjit dhe fakteve nga gjykatat e rregullta. Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI69/15
Parashtrues
Enver Krasniqi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 305/2014, të 8 dhjetorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Enver Krasniqi nga Peja (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 305/2014, të 8 dhjetorit 2014 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), i cili i është dorëzuar parashtruesit më 18 shkurt 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 305/2014, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit, atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 29 maj 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI69/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin nr. KSH. KI69/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 22 korrik 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 13 gusht 2015, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzimin e fletëkthesës që dëshmon datën kur parashtruesi ka pranuar Aktvendimin (Rev. nr. 305/2014) e Gjykatës Supreme, të 8 dhjetorit 2014.

9. Më 28 gusht 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi dokumentin shtesë të kërkuar nga Gjykata.

10. Më 14 tetor 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 26 prill 2005, Ministria e Shërbimeve Publike, me vendim (06/2005), emëroi parashtruesin ushtrues të detyrës së Sekretarit të Përhershëm.

12. Më 5 maj 2006, Sekretariati i Komisionit për Emërime të Larta Publike (në tekstin e mëtejmë: KELP) njoftoi parashtruesin se është zgjedhur në pozitën e Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së Shërbimeve Publike.

13. Më 3 korrik 2006, parashtruesi i kërkesës lidhi kontratë (nr. 020) të marrëdhënies së punës në pozitën e Sekretarit të Përhershëm në Ministrinë e Shërbimeve Publike. Në kontratë theksohej se *"kontrata hyn në fuqi pas kalimit të periudhës së punës provuese prej tre muajsh"*.

14. Më 4 gusht 2006, KELP, me vendim (nr. 032/2006), emëroi parashtruesin në pozitën e Sekretarit të Përhershëm në Ministrinë e Shërbimeve Publike.

15. Më 10 gusht 2006, Ministrja e Shërbimeve Publike dhe këshilltarët e saj mbajtën takim me parashtruesin e kërkesës, në të cilin parashtruesit të kërkesës i tregohen parregullsitë në punë. Në këtë takim, parashtruesi i kërkesës është njoftuar se Ministrja do t'i rekomandojë KELP-së ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës.

16. Më 17 gusht 2006, Ministria e Shërbimeve Publike me rekomandim (nr. 3111) i kërkoi KELP-it ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës.

17. Më 21 gusht 2006, KELP, me vendim (nr. 042/2006), shkëputi marrëdhënien e punës së parashtruesit në pozitën e Sekretarit të Përhershëm. Në pikën dy të këtij Vendimi konstatohet se *"kontrata e lidhur ndërmjet KELP dhe parashtruesit shkëputet gjatë periudhës provuese të cekur në kontratë"*.

18. Më 25 gusht 2006, parashtruesi ushtroi ankesë në KELP kundër Vendimit 042/2006, të 21 gushtit 2006.

19. Më 3 shkurt 2009, parashtruesi iu drejtua me një shkresë KELP-it dhe kërkoi sqarim se përse nuk ka marrë përgjigje për ankesën e tij në periudhë kohore prej 2 (dy) vjetësh.

20. Më 17 mars 2009, parashtruesi parashtroi padi për kompensimin e dëmit dhe për kthim në vend të punës në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

21. Më 25 maj 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin (C nr. 565/09) refuzoi, si të pabazuar, kërkesëpadinë e parashtruesit me arsyetimin:

> *"... Nga provat e paraqitura e paditura e ka vërtetuar bazën juridike të ndërprerjes së kontratës së punës para skadimit të afatit të paraparë në kontratë dhe mbi këtë bazë gjykata vlerëson se vendimi i KELP, si organ i të padituës, nr. 042/06 dt: 21.08.2006, mund të konsiderohet si i ligjshëm..."*.

22. Më 7 janar 2013, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktgjykimit (C nr. 565/09) të Gjykatës Komunale.

23. Më 18 prill 2014, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin (Ac. nr. 796/2013) refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin (C nr. 565/09) e Gjykatës Komunale me arsyetimin:

> "*Është vlerësim edhe i Gjykatës së Apelit se, në situatën konkrete punën e punonjësit dhe performancën e tij e vlerëson vet punëdhënësi, ndërsa një gjë e tillë në asnjë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar se e bënë gjykata. Meqë, sipas vlerësimit të vet Ministres ka rezultuar se, paditësi' që në fillim të punës së tij nuk ka kryer punën si duhet, atëherë edhe me të drejtë ka ardhur deri 'te ndërprerja' e kësaj pune, pa e pritur përfundimin e punës provuese*".

24. Më 24 qershor 2014, parashtruesiushtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit (Ac. nr. 796/2013) të Gjykatës së Apelit.

25. Më 8 dhjetor 2014, Gjykata Supreme me Aktvendimin (Rev. nr. 305/2014) pranoi si pjesërisht të bazuar kërkesën për revizion dhe ndryshoi Aktgjykimin (Ac. nr. 796/2013) e Gjykatës së Apelit, si dhe hodhi poshtë padinë e parashtruesit "*lidhur me kthimin në vend të punës dhe kompensimin e dëmit*".

26. Në Aktvendimin e saj Gjykata Supreme konstatoi se Aktgjykimi (Ac. nr. 796/2013) i Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimi (C nr. 565/09) i Gjykatës Komunale janë nxjerrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale me rastin e vlerësimit të padisë së parashtruesit lidhur me afatin e ushtrimit të padisë.

27. Për më tepër, Gjykata Supreme konkludoi se parashtruesi i kërkesës ka ushtruar padinë "*lidhur me kthimin në vend të punës dhe kompensimin e dëmit*" jashtë afatit kohor të paraparë me ligj.

Pretendimet e parashtruesit

28. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të anulohet vendimi i Gjykatës Supreme (Rev. nr. 305/2014), për arsye se ka shkelur të drejtën nga neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nga neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit].

29. Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme gabimisht ka konkluduar se "*në rastin konkret kemi rast të kontestit të punës dhe të marrëdhënies së punës*" dhe se "*baza ligjore e kërkesës ishte kompensimi i dëmit për shkak të veprimeve të kundërligjshme të zyrtarëve të organeve shtetërore apo organeve të tyre dhe*

rrjedhimisht në rastin e vendosjes është dashtë të aplikohen dispozitat e LMD-së që rregullojnë këtë lami".

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari vlerëson nëseparashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

31. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 të Rregullores së punës:

32. Neni48iLigjit,parasheh*:*

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

33. Përveç kësaj, rregulli36 i Rregullores së punës, parasheh:

> *(1) Gjykata mund t'ishqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi* e *pabazuar.*
>
> *(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*
>
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme gabimisht ka aplikuar të drejtën procedurale dhe se aktvendimi i kontestuar është nxjerrë në bazë të Ligjit të punës, dhe se kërkesëpadia e tij ishte në lidhje me kompensimin e dëmit, andaj ishte e nevojshme të aplikohej Ligji për marrëdhëniet detyrimore.

35. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës pretendon se me një aplikim të tillë të të drejtës materiale i janë shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe e drejta për punë dhe kryerje të profesionit, të garantuara me Kushtetutë.

36. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se këto pretendime të parashtruesit janë në kundërshtim me dokumentacionin që ai i ka dorëzuar Gjykatës.

37. Nga dokumentacioni i parashtruar mund të konkludohet se parashtruesit të kërkesës i është ndërprerë marrëdhënia e punës me Vendimin e KELP (nr. 042/2006) *"në periudhën e punës provuese të caktuar në kontratë"*.

38. Përveç kësaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme me Aktvendimin (Rev. br. 305/2014) hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës, si të pabazuar, dhe arsyetoi se si parashtruesi i kërkesës është dashur të mbrojë të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës:

> *"... Ligji për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës... është parashikuar që punëtori i pakënaqur... nëse ky organ nuk merr vendim në afat prej 30 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës apo kundërshtimit, punëtori ka të drejtë që në afat prej 15 ditësh të kërkojë mbrojtjen e drejtave të veta para gjykatës kompetente"*.

39. Gjykata Supreme, më tej ka konkluduar: "*Në rastin konkret nuk janë plotësuar presupozimet procedurale... për faktin se paditësi për mbrojtjen e të drejtave të cenuara nuk i është drejtuar gjykatës në afatin e përcaktuar ligjor me dispozitën e nenit 83 të Ligjit për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës. Këtë për faktin se paditësi kundër vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës ... ka paraqitur ankesë Komisionit për Emërime të Larta më dt. 25.08.2006 ... ndërsa padinë për mbrojtjen e të drejtave të cenuara ka paraqitur gjykatës më 19.03.2009 (pas 2 vite e 7 muaj pas paraqitjes së ankesës). Ky afat është prekluziv që do të thotë se me kalimin e tij humb edhe e drejta...".*

40. Nga sa u tha më lart, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit për kompensim të dëmit bazohet në të drejtat e parashtruesit që burojnë nga kontrata e tij e punës.

41. Duke marrë parasysh se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se kontrata e tij e punës është ndërprerë në mënyrë të paligjshme, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për aplikim të gabueshëm të së drejtës procedurale dhe "*veprimtarinë e paligjshme të zyrtarëve të organeve shtetërore"* janë në kundërshtim me dokumentacionin që ai i ka dorëzuar Gjykatës.

42. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur, kryesisht, me kualifikimin juridik të fakteve dhe të ligjit të aplikuar

nga gjykatat e rregullta. Kualifikimi juridik i fakteve dhe ligji i aplikueshëm janë çështje të ligjshmërisë.

43. Gjykata konsideron se procedurat para Gjykatës Komunale, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme ishin të drejta dhe se vendimet janë të justifikuara në tërësi dhe të arsyetuara në hollësi, pa marrë parasysh aplikimin e ndryshëm të të drejtës procedurale dhe asaj materiale.

44. Pra, Gjykata Kushtetuese konkludon se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur një gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 13071/87,Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991; dhe,*mutatis mutandis,Shub kundër Lituanisë,* nr. 17064/06, GJEDNJ, vendimi i 30 qershorit 2009).

45. Faktikisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur kurrfarë dëshmie *prima facie*, e cila do të tregonte për shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë (Shih *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, nr. 53363/99, GJEDNJ, vendimi i 31 majit 2005) dhe nuk ka precizuar se si nenet e Kushtetutës, të cilëve iu referohet, mbështesin pretendimet e tij, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

46. Për më tepër, Gjykata rithekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta ose organeve tjera publike. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis,García Ruiz* kundër *Spanjës,* nr. 30544/96, GJEDNJ, aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28; shih gjithashtu, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI70/11, parashtrues të kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

47. Pra, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar pretendimin për shkelje të të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtës për punë dhe kryerje të profesionit.

48. Si përfundim, Gjykata konsideron, se sipas nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 (2) (d) të Rregullores së punës, pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara, prandaj kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin36(2) d) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 14 tetor2015,njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI78/15, Parashtrues Fatime Tosuni - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 318/2014, i 19 janarit 2015

KI78/15, Aktvendim për papranueshmëri i 14 tetorit 2015, publikuar më 21 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, ndërprerje e marrëdhënies së punës, shërbimi civil*

Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar kërkesën për revizion të paraqitur nga parashtruesja e kërkesës përkitazi me ndërprerje të marrëdhënies së punës. Parashtruesjau ankua në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar shkelje të së drejtës në punë dhe ushtrim të profesionit.

Gjykata Kushtetuese vërejti se në rastin konkret,se pretendimet e parashtrueses sëkërkesës, meAktgjykimin e kontestuar, asaj i është shkelur e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës, paraqet shprehjen evlerësimit të saj subjektiv për vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, por jo edhe dëshmi tëvërtetë të shkeljes së të drejtave nga neni 49 i Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI78/15
Parashtrues
Fatime Tosuni
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 318/2014, të 19 janarit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesaështë dorëzuar nga znj. Fatime Tosuni (në tekstin e mëtejmë:parashtruesja e kërkesës) nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [Rev. nr. 318/2014], të 19 janarit 2015, i cili i është dorëzuar asaj më 8 maj 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës KI78/15 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së një Aktgjykimi, me të cilin, pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin113.7të Kushtetutës, nenin 47tëLigjit përGjykatënKushtetuese të Republikëssë Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji)dhe në rregullin56tëRregullores së punës të

GjykatësKushtetuese të RepublikëssëKosovës(në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 qershor 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 3 gusht2015,KryetarjaeGjykatës, me Vendimin nr.GJR. KI78/15, caktoigjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës meVendiminnr.KSH. KI78/15,caktoiKolegjin shqyrtues,të përbërënga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues),Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 19 gusht 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 14 tetor 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Në periudhën prej 4 majit 2006 deri më 30 prill 2007, parashtruesja e kërkesës kishte themeluar marrëdhënietë punës me Ministrinë e Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejmë: MPB) në pozitën e Koordinatorit të Qendrës Komunale të Regjistrimit Civil (në tekstin e mëtejmë: KQKRC). Në bazë të kontratës së punës nr. 02/111/38, marrëdhënia e punës ishte për një kohë të caktuar.

10. Gjatë vitit 2006, MPB-ja nxorinjë rregullore të re për ndryshimin e strukturës së brendshme organizative, në të cilën përfshihej edhe vendi i punës së parashtrueses së kërkesës. Me strukturën e re organizative parashihej që titullari i vendit të punës së KQKRC të ketë diplomë universitare, dhe kualifikime përkatëse profesionale.

11. Më 30 mars 2007, MPB-ja, në pajtim me nenin 35.1 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/2 për Shërbimin Civil, nxori Vendim [nr. prot. 290/01] për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtrueses së kërkesës.

12. Gjatë vitit 2007, MPB-ja shpalli konkurs për plotësimin e vendit të punës së KQKRC. Pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, MPB përzgjodhi kandidatin që i kishte të gjitha kualifikimet e nevojshme të përcaktuara në konkurs. Parashtruesja e kërkesës nuk kishte konkurruar për pozitën.

13. Më 17 maj 2007, parashtruesja e kërkesës iu drejtua MPB-së me shkrim, duke kërkuar shpjegim pse nuk i ishte vazhduar kontrata e saj me kohë të caktuar. Nuk ka prova në shkresat e lëndës që tregojnë nëse MPB-ja është përgjigjur në letrën e parashtrueses së kërkesës apo jo.

14. Më 6 korrik 2007, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës (në tekstin e mëtejmë: KPM), me të cilën kërkoi që të anulohet vendimi i MPB-së [nr. i prot. 290/01], i 30 marsit 2007.

15. Më 5 mars 2008, KPM-ja nxori vendimin [nr. 245/08] me të cilin e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar. KPM-ja arsyetoi se „*me nenin 35.1 (b) të UA 2003/2 në mënyrë shprehimore është paraparë "punësimi në Shërbimin civil përfundon automatikisht pas skadimit të kontratës së punësimit të nëpunësit civil[...] Nga kjo rezulton se për vazhdimin e kontratës së punës vendos Organi i Punësimit në SHCK [Shërbimi Civil i Kosovës] sikur që ka vendosur për rastin konkret. Autoriteti punëdhënës ndaj ankueses i ka përmbushur të gjitha të drejtat dy palëshe që rrjedhin nga afati i kontratës së punës. [...] Në këtë rast ankueses i mungon edhe kualifikimi adekuat për këtë vend pune...*".

16. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër Qeverisë së Kosovës dhe MPB-së, duke kërkuar anulimin e vendimit [nr. i prot. 290/01] të 30 marsit 2007 për ndërprerjen e marrëdhënies së saj të punës, si dhe kthimin e saj në vendin e punës me të gjitha privilegjet.

17. Më 14 mars 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin [C1. nr. 146/08], me të cilin ishte refuzuar kërkesëpadia e parashtrueses së kërkesës si e pabazuar, me arsyetimin se "*Gjykata ka vlerësuar si të qëndrueshëm prapsimin e të padituri me rastin e kontestimit të kërkesëpadisë sa i përket ndërprerjes së marrëdhënies së punës duke u thirrur në dispozitën e nenit 35.1 (b) të VA nr. 2003/2 si të qëndrueshëm , kështu që i padituri, pas skadimit të kontratës me paditësen ka shpallur konkurs publik për vendin kontestues të punës, ndërsa paditësja nuk ka konkurruar. Gjykata vlerëson se i padituri, ndaj paditëses në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës i ka përmbushur obligimet e veta*".

18. Parashtruesja e kërkesës parashtroiankesë në afatin ligjor në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale [C1. nr. 146/08] të 14 marsit 2012, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

19. Më 15 prill 2014, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [AC. nr. 4560/2012] me të cilin e refuzoi ankesën e parashtrueses si të pabazuar me arsyetimin se "*aktgjykimi i atakuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të LPK nga neni 182 paragrafi 1 e 2 , për të cilin kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe njëherit bazohet në gjendjen faktike plotësisht dhe drejt të vërtetuar, me ç' rast drejt është aplikuar edhe e drejta materiale*".

20. Më 12 gusht 2014, parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [AC. nr. 4560/2012] të Gjykatës së Apelit, të 15 prillit 2014.

21. Më 19 janar 2015, GjykataSupreme nxori Aktgjykimin [Rev. nr. 318/2014] me të cilin e refuzoi kërkesën e parashtrueses për revizion si të pabazuar, me arsyetimin se "*Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, kanë zbatuar drejt të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar* ".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesja e kërkesës pretendon se neni 49 i Kushtetutës së Kosovës garanton të drejtën e punës. E drejta e punës, si e drejtë themelore e njeriut, bashkë me të drejtat e tjera formon bazën për rendin juridik të Republikës së Kosovës.

23. Parashtruesja i drejtohet Gjykatës me kërkesën: *"Pres që gjykata Kushtetuese do të bie vendim për pranueshmërinë e Ankesës time në mënyrë që t'i realizoj të drejtën themelore– e drejta në punë, e garantuar me Kushtetutë të R. së Kosovës dhe instrumente të tjera ndërkombëtare"*.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Nëmënyrë që të jetënë gjendje tëshqyrtojë ankesën eparashtrueses, Gjykata së pari duhet tëvlerësojë nëseajoi kapërmbushurkushtet epranueshmërisë,të përcaktuarame Kushtetutë dhe të specifikuara më tej nëLigj dhe në Rregullore të punës.

25. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

26. Neni 48 i Ligjit gjithashtu parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

27. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

28. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës e ka ndërtuar ankesën e saj kushtetuese mbi pretendimin për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës i cili thotë:

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

29. Gjykata thekson se e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit nga neni 49 i Kushtetutës është objekt i mbrojtjes në sistemin kushtetues të Kosovës, ku këto të drejta, më tej realizohen në mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me ligj, dhe kjo nënkupton edhe të drejtën e një individi që marrëdhënia e tij e punës të mos ndërpritet në kundërshtim me atë që është përcaktuar me ligj.

30. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës Gjykata vëren se gjykatat administrative, në tri shkallë në pajtim me ligjin, kanë shqyrtuar meritat e pretendimeve ankimore të parashtrueses, me ç'rast edhe e

kanë vërtetuar gjendjen faktike me rëndësi për nxjerrjen e vendimeve, duke përfshirë edhe Vendimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 318/2014], të cilin e konteston parashtruesja e kërkesës.

31. Për më tepër, Gjykata gjen se Vendimi i Gjykatës Supreme i kontestuar nga parashtruesja e kërkesës në asnjë mënyrë nuk e parandalon atë që të punojë apo të ushtrojë profesionin. Me Vendimin e saj Rev. nr. 318/2014, Gjykata Supreme thjesht konfirmoi se marrëdhënia konkrete e punës e parashtrueses për periudhën 4 maj 2006 deri më 30 prill 2007 kishte përfunduar. Kjo në asnjë mënyrë nuk e parandalon ose ndalon parashtruesen, që ajo të fillojë një punë tjetër sipas zgjedhjes së saj. Kësisoj, nuk ka asgjë në pohimet e parashtrueses që do të arsyetonte konkluzionin se janë cenuar të drejtat e saj kushtetuese për punë (Shih, *mutatis mutandis*, Aktvendimin për papranueshmëri nr. RK734/14, në Rastin KI09/14, të 24 nëntorit 2014, paragrafi 29).

32. Përveç kësaj, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta i kanë bazuar vendimet e veta në nenin 35.1. (b) të Urdhëresës Administrative Nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi shërbimin civil, i cili thotë:

Neni 35. Përfundimi i punësimit

35.1 Punësimi në Shërbimin civil përfundon automatikisht:
[...]
(b) Pas skadimit të kontratës së punësimit të nëpunësit civil

33. Prandaj, Gjykata është e mendimit se pretendimet e parashtrueses se me Aktgjykimin e kontestuar asaj i është shkelur e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës, paraqet shprehjen e vlerësimit të saj subjektiv për vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, por jo edhe dëshmi të vërtetë të shkeljes së të drejtave nga neni 49 i Kushtetutës.

34. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtrueses me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e nenit 49 të Kushtetutës (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

35. Gjykata, më tej, rithekson që nuk është detyrë e saj, sipasKushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërtnë lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës

procedurale dhe materiale (Shih Rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu Rastin nr. KI70/11, parashtrues të kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011)

36. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sepse parashtruesja nuk ka dëshmuar se vendimi i kontestuar i shkelë të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

37. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, nëpajtim me rregullat36(1) (d) dhe(2) b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 14 tetor2015,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI99/15, Parashtrues Axhi Thaçi - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit (SCEL- 09-0009) të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i 12 nëntorit 2013

KI99/15, Aktvendim për papranueshmëri i 14 tetorit 2015, publikuar më 21 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme, barazia para ligjit, procesi i privatizimit*

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme kishte refuzuar të papranueshme ankesën e parashtruesit të kërkesës përkitazi me përfshirjen e tij në listën përfundimtare të punëtorëve, me të drejta të realizimit të një pjese të të ardhurave nga privatizimi i një ndërmarrje shoqërore. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar shkelje të parimit të barazisë para ligjit.

Gjykata Kushtetuese vërejti se në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar kërkesën jashtë afatit prej 4 (katër) muajve të përcaktuar me ligj. Gjykata Kushtetuese, shpalli kërkesën të papranueshme për shkak se ishte e paafatshme në pajtim nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI99/15
Parashtrues
AxhiThaçi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit (SCEL- 09-0009) të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
të 12 nëntorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Axhi Thaçi nga Prizreni (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin (SCEL- 09-0009 të 12 nëntorit 2013) e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar i DHPGJS), të cilin parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar më 13 nëntor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Aktgjykimi është nxjerrë "*duke mos respektuar barazinë e palëve – punëtorëve gjatëpërpilimit të listës për realizimin e 20%*" me çka është shkelur neni 24 [Barazia

para Ligjit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 korrik 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 19 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI99/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI99/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 14 shtator 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Kolegjin e Specializuar të DHPGJS për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 14 tetor 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 31 gusht 2006, NSH “Hotel Theranda” nga Prizreni ishte privatizuar.

10. Lista përfundimtare e punëtorëve të cilët i kishin plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të 20% të të hyrave nga procesi i privatizimit të NSH “Hotel Theranda” nga Prizreni është publikuar në gazetat ditore më 21, 22, 23 dhe 24 maj 2009.

11. Sipas nenit 67.6 të Udhëzimit Administrativ 2008/06 në lidhje me nenin 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, ankesa kundër listës përfundimtare duhet të dorëzohet brenda 20 (njëzet) ditëve pas publikimit të listës përfundimtare.

12. Afati i fundit për paraqitjen e ankesave në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS, kundër listës përfundimtare të punëtorëve të NSH "Hotel Theranda" ishte 13 qershori 2009.

13. Më 22 qershor 2009, parashtruesi i kërkesës (ankuesi C-0022) parashtroi ankesë në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS me të cilën kërkoi që të përfshihej në listën përfundimtare të punëtorëve të NSH "Hotel Theranda".

14. Më 12 nëntor 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS me Aktgjykimin (SCEL-09-0009) e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës (ankuesi C-0022) si *"... të pa pranueshme, pasi ishte dorëzuar jashtë afatit..."* me këshillën juridike si në vijim:

> *"Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë brenda 21 ditësh tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme. [...] Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur ankuesit i është dërguar aktgjykimi me shkrim".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Specializuar i DHPGJS kishte nxjerrë Aktgjykimin e kontestuar "*duke mos respektuar barazinë e palëve – punëtorëve gjatëpërpilimit të listës për realizimin e 20%"* me çka është shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës si në vijim:

> *"... më është mohuar e drejta në realizimin e 20% si punëtor i NSH "Hotel Theranda" nga Prizreni pas privatizimit ... pa bazë fare, dhe në listën e ankesave si në faqen e I të aktgjykimit në fjalë janë përfshi dhe kanë realizuar persona të cilët fare nuk kanë qenë aktiv në këtë ndërmarrje ... ndërsa mua edhe pse kam qenë aktiv dhe i kyçur në këtë çështje më kanë hequr nga lista e 20%...".*

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*... kam qenë i sëmurë dhe jam kuruar me një diagnozë psikiatrike dhe atë prej dt. 08. 04.2009 deri më dt. 15.09.2009, kur dhe ka qenë afati për të ushtruar ankesë, të cilën për shkaqe shëndetësore nuk kam mundur që të veprojë [...] dhe nuk është e vërtetë se e kam pranuar aktgjykimin – në fletëdërgesë nuk është nënshkrimi im".*

17. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të "*më mundëson ... futjen në listën e realizimit të të drejtës në pjesën prej 20% që më takon pas privatizimit të ndërmarrjes - NSH „Hotel Theranda".*

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmeri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

20. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".*

21. Gjykata, më tej, i referohet rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi".*

22. Gjykata vëren se Aktgjykimi (SCEL- 09-0009 të 12 nëntorit 2013) i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS i është dorëzuar parashtruesit më 13 nëntor 2013; parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë më 23 korrik 2015; kërkesa u dorëzua në Gjykatë pas skadimit të afatit prej 4 (katër) muajve nga data kur i është dorëzuar Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar DHPGJS.

23. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se afati prej 4 (katër) muajsh sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës është i natyrës prekluzive dhe është themeluar për të siguruar parimin e sigurisë juridike, duke siguruar që kërkesat të cilat dorëzohen në pajtim me Kushtetutën shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme, dhe se vendimet nga e kaluara nuk mund të jenë vazhdimisht të hapura për vlerësim kushtetues (Shih rastin: *O'Loughlin dhe të tjerët kundër*

Mbretërisë së Bashkuar, nr. 23274/04, GJEDNJ, vendimi i 25 gushtit 2005).

24. Nga kjo rrjedh se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 tetor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI131/14, Parashtrues Agron Alaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 115/2014, i 16 qershorit 2014

KI131/14, Aktvendim për papranueshmëri i 10 nëntorit 2015, publikuar më 22 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, bashkëkryerje e veprës penale, e drejta e lirisë dhe sigurisë, masa e paraburgimit, lirim në dorëzani*

Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës kundër vendimeve të gjykatave të instancës së ulët për vazhdim të paraburgimit. Parashtruesi ishte i dyshuar për bashkëkryerje të veprave penale, të mundësimit të prostitucionit dhe spastrimit të parasë. Parashtruesiu ankua në Gjykatën Kushtetuese për cenim të së drejtës për liri dhe siguri, duke pretenduar se nuk kanë ekzistuar kushtet për vazhdim të paraburgimit.

Gjykata Kushtetuese vërejti se gjykatat e rregullta kishin arsyetuar vendimet e tyre dhe kishin dhënë përgjigje ndaj të gjitha pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, dhe shtoi, se procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta nuk kishin qenë të padrejta ose arbitrare. Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI131/14
Parashtrues
Agron Alaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Pml. nr. 115/2014, të 16 qershorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Agron Alajnga fshati Drenoc, komuna e Deçanit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga z. Rifat Abdullahi.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 115/2014, i 16 qershorit 2014.

3. Parashtruesi i kërkesës nuk e ka potencuar se kur e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartpërmendurtë Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat e rregullta, në vendimet e tyre, gjatë caktimit të masës së paraburgimit, kanë shkelur nenin 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [E Drejta e Lirisë dhe e Sigurisë] dhe nenin 5 [E drejta për liri dhe siguri] të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 22 gusht 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 5 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI131/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI131/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama - Hajrizi.

8. Më 9 shtator 2014, Gjykata njoftoi parashtruesinpërregjistrimin ekërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 23 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një dokument shtesë në Gjykatë.

10. Më 12 maj 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një dokument në bazë të secilit kërkon përshpejtimin e procedurës.

11. Më 10 nëntor2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës në përbërje të plotë, ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 6 shkurt 2013, Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krimet e Rënda, në bazë të kërkesës së Prokurorisë Themelore të EULEX-it, nën dyshimin e bazuar se parashtruesi në bashkëkryerje ka kryer veprat penale krim i organizuar, mundësim i prostitucionit dhe veprën penale pastrim i paravei caktoi atij masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji.

13. Më 23 maj 2013, Gjykata Themelore në Ferizaj (Aktvendimi PPR. nr. 2/13, GJPP. nr. 180/12) aprovoi propozimin e prokurorit dhe

parashtruesit të kërkesës për ndërprerjen e paraburgimit. Gjykata arsyetoi se ishin plotësuar kushtet që parashtruesi të lirohet nga paraburgimime dorëzani.

14. Më 11 dhjetor 2013, Gjykata Themelore në Ferizaj me kërkesë të prokurorisë, parashtruesit të kërkesës i caktoi masën e paraburgimit, në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji. Kërkesën e tij për caktimin e masës së paraburgimit, prokurori e arsyetoi duke ju referuar dëshmive të reja, të nxjerra nga procedura hetimore.

15. Gjykata Themelore në Ferizaj në vendimin e saj për caktimin e masës së paraburgimit vlerësoi se ekziston rreziku konkret, që parashtruesi mund të arratiset nëse gjendet në liri, të pengojë rrjedhën e procedurës penale dhe të ndikojë në dëshmitarët dhe bashkëpjesëmarrësit. Gjykata po ashtu konstatoi se nëse parashtruesi do të qëndronte në liri ekziston rreziku i përsëritjes së veprës penale.

16. Më 4 prill 2014, GjykataThemelore në Ferizaj duke vendosur sipas kërkesës së Prokurorisë, vendosi që parashtruesit të kërkesës t'i vazhdohet paraburgimi edhe për 3 (tre) muaj.

17. Kundër Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Ferizaj, parashtruesi kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit. Në ankesën e tij, parashtruesi ndër të tjera pretendoi shkelje të procedurës penale dhe të drejtës së tij për liri dhe siguri të garantuar me Kushtetutë, dhe gjithashtu pretendoi se kushtet për vazhdimin e paraburgimit të tij nuk ekzistonin më.

18. Më 11 prill 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktvendimi, Pn1. nr. 700/2014), refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar.

19. Gjykata e Apelitvlerësoi se gjykata e shkallës së parë kishte vepruar drejt kur parashtruesit i ka vazhduar paraburgimin, sepse parashtruesi nëpërmjet avokatit "*[...] gjer tani ka ndërhyrë në rrjedhën e ndjekjes së tanishme penale i cili nga përgjimet telefonike pretendohet se ai ka mundur që të ndikoj tek të dyshuarit e tjerë, si dhe po të gjendet i pandehuri në liri nuk do të hezitoj që të pengoj rrjedhën e procedurës penale duke vazhduar ndikimin e tij në dëshmitarët e mundshëm të këtij rasti [...]*".

20. Në fund, Gjykatapërfundoi duke konstatuar se masat e tjera më të buta do të ishin të pamjaftueshme për sigurimin e pranisë së parashtruesit në procedurë dhe zbatimin e procedurës penale me sukses.

21. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj (PPR. nr. 2/13, GJPP. nr. 180/12, të 4 prillit 2014) dhe Aktvendimit të Gjykatës së

Apelit (Pn1. nr. 700/2014, të 11 prillit 2014) parashtruesi paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

22. Në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi pretendon shkelje esenciale të procedurës penale dhe vlerësim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Parashtruesi sërish pretendon se nuk ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit të tij dhe se aktvendimet e kundërshtuara nuk përmendin asnjë rrethanë konkrete apo ofrojnë prova konkrete për të dëshmuar rrezikun e ikjes, ndikimit në dëshmitarë dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale.

23. Më 16 qershor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi, Pml. nr. 115/2014) refuzoi, si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës.

24. Lidhur me pretendimin e parashtruesit për shkelje të procedurës penale, Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara, sepse aktvendimet e kundërshtuara janë të qarta, të kuptueshme dhe të bazuara në ligj.

25. Ndërsa sa i përket pretendimeve të parashtruesit për vlerësim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata konstaton se vlerësimi i gjendjes faktike [...] *pritet të shqyrtohet dhe qartësohet në fazat vijuese të procedurës penale e jo në këtë fazë ngase i pandehuri me këto aktvendime as nuk është shpallur fajtor dhe as nuk është gjykuar, por vetëm në bazë të vlerësimit të dyshimit të bazuar i është caktuar masa e paraburgimit".*

26. Në fund, lidhur me vendimet e kundërshtuara për vazhdim të paraburgimit, Gjykata Supreme gjeti se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë dhënë arsye të mjaftueshme për të vazhduar paraburgimin në pajtim me ligjin në fuqi dhe *"[...] duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe karakteristikat e tij personale, si dhe fakti se tash procedura ka filluar për një vepër penale të rëndë, ekziston rreziku se po të gjendet i pandehuri në liri, për t'ju shmangur përgjegjësisë penale do të mund të fshihet, do të mund të ndikojë në dëshmitarë të cilët ende nuk janë dëgjuar si dhe të bashkëpandehurit e tjerë që janë të involvuar në këtë çështje penale dhe në këtë mënyrë do të pengohej zhvillimi i rregullt i procedurës penale".*

27. Për qëllim të një prezantimi të plotë të fakteve, Gjykata vëren se më 17 qershor 2014, Prokuroria Themelore e EULEX-it në Ferizaj kishte ngritur aktakuzën ndaj parashtruesit të kërkesës nën dyshimin se kishte kryer veprën penale krim të organizuar dhe në bashkëkryerje, kishte kryer veprën penale mundësim i prostitucionit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjatë arrestimit dhe caktimit të masës së paraburgimit është shkelur neni 29 i Kushtetutës (E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë) dhe neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (E drejta për liri dhe siguri).

29. Parashtruesi kërkesës, më tej, pohon se aktvendimet e gjykatave të rregullta janë të kundërligjshme sepse sipas tij nuk kanë ekzistuar kushtet për caktimin dhe për vazhdimin e paraburgimit.

30. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata si në vijim:

    "I. Të shpallet kërkesa e pranueshme;

    II. të konstatohet se ka pasur shkelje të nenit 29 (e drejta e lirisë dhe sigurisë) të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 të KEDNJ.

    III. Të anulohen Aktgjykimi dhe aktvendimet e gjykatave të rregullta të përmendura më lart

    IV. të lirohet nga paraburgimi i pandehuri Agron Alaj

    V. të mbetet në fuqi Aktvendimi i GJ. Themelore në Ferizaj PPR. nr. 2/13 (GJPP. nr. 180/12 dt 23.05.2013 mbi ndërprerjen e paraburgimit me dorëzani".

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

32. Gjykata i referohetnenit 48 të Ligjit, i cili thotë se:

    "Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

33. Përveç kësaj, Gjykata merr parasyshrregullin 36 (1), d) dhe (2), b) dhe d) të Rregullores së punës, i cili thotë:

    (2) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...]

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

34. Siç u përmend më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjatë arrestimit dhe caktimit të masës së paraburgimit është shkelur e drejta e tij për liri dhe siguri e garantuar menenin 29 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së. Po ashtu, parashtruesi pretendon se të gjitha aktvendimet e gjykatave të rregullta janë të kundërligjshme sepse, sipas tij nuk kanë ekzistuar kushtet për caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit.

35. Gjykata i referohet nenit të 29 të Kushtetutës, i cili ndër të tjera, thekson se një person nën dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale mund të privohet nga liria *"vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj"*.

36. Në këtë rast, Gjykata thekson kur gjykatat e rregullta vendosin për vazhdimin e paraburgimit duhet të tregojnë "*se ka arsye relevante dhe të mjaftueshme për vazhdimin e paraburgimit"* (Shih, ndër të tjera, rastin *Piruzyan kundër Armenisë*, GJEDNJ, Nr. 33376/07, Aktgjykim i 26 qershorit 2012, par. 91).

37. Në rastin konkret, sa i përket procedurave në gjykatat e rregullta, Gjykata i referohet aktvendimeve të nxjerra nga Gjykata Themelore në Ferizaj, duke përfshirë aktvendimin e fundit të Gjykatës Themelore të 4 prillit 2014, për vazhdimin e paraburgimit. Në vendimin e saj për vazhdimin e paraburgimit, Gjykata Themelore ka vlerësuar se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit për arsye se ekziston rreziku për arratisje, se parashtruesi mund të ndikojë në dëshmitarë, si dhe

ekziston rreziku për përsëritjen e veprës penale.Ky arsyetim është konfirmuar nga Gjykata e Apelit dhe në fund edhe nga Gjykata Supreme.

38. Gjykata më tutje, vëren se Gjykata Supreme e Kosovës, në Aktgjykimin e saj (Pml. nr. 115/2014, të 16 qershorit 2014) ka hedhur poshtë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, duke konstatuar se gjykata e shkallës së parë ka ofruar arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare mbi bazën ligjore të vazhdimit të paraburgimit, si dhe ka vepruar drejt kur ka vazhduar paraburgimin e parashtruesit të kërkesës.

39. Edhe pse parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat e tij janë shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe me zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta, ai nuk ka dëshmuar se si këto vendime kanë shkelur të drejtën e tij kushtetuese për liri dhe siguri. Për më tepër, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta i janë përgjigjur pretendimeve të ngritura nga parashtruesi në ankesën e tij, respektivisht në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë.

40. Për më tepër, duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale nga ana e gjykatave të rregullta, Gjykata ripërsërit se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse ligjore (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih, gjithashtu, Rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima* dhe *Bestar Hima,* Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

41. Siç u përmend më lart, Gjykata vëren se arsyetimet e dhëna në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe në aktvendimet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore në Ferizaj, janë të plota dhe të qarta, andaj Gjykata gjeti se procedurat pranë gjykatave të rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

42. Në fakt, sa i përket kërkesës së parashtruesit për lirim nga paraburgimi, kjo Gjykatë nuk e konsideron si kompetencë të vetën që t'i ofrojë këtë mbrojtje parashtruesit (Shih rastin KI20/13, parashtrues *Rifat Osmani*, Aktvendim për papranueshmëri) .

43. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata përfundon se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tij

për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 10 nëntor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI173/14, Parashtrues Staja Savić - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit KPCC/D/C/264/2014, të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, i 21 tetorit 2014

KI173/14, Aktvendim për papranueshmëri i 10 nëntorit 2015, publikuar më 22 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, mosshterim i mjeteve juridike, pronë e hipotekuar, uzurpim i pronës, mbrojtja e pronës, parimi i subsidiaritetit*

Komisionit për Kërkesa Pronësore i Kosovës, kishte hedhur poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës për vërtetim të titullit pronësor ndaj një paluajtshmërie të kontestuar nga pala e tretë. Komisionit për Kërkesa Pronësore i Kosovës kishte arsyetuar se parashtruesi kishte humbur titullin e pronësisë ndaj paluajtshmërisë së kontestuar, si rrjedhojë e privatizimit. Parashtruesiu ankua në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar cenim të së drejtës në pronë dhe se i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se nuk mund t'i zëvendësoje me gjetjet e veta gjetjet e gjykatave të rregullta apo autoriteteve tjera publike në Republikën e Kosovës, dhe shtoi, se parimi i subsidiaritetit është shumë i rëndësishëm sepse i ofron mundësinë parashtruesit të kërkesës të ngrejë çështjet e faktit dhe të ligjit në gjykatat e rregullta. Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme për shkak të mosshterjes së mjeteve juridike, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI173/14
Parashtrues
Staja Savić
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/C/264/2014, të 21 tetorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Staja Savić nga Ferizaj, me vendbanim të tanishëm në Kralevë, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin KPCC/D/C/264/2014, të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KKPK) të 21 tetorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të KKPK-së KPCC /D/C/ 264/2014, të 21 tetorit 2014, në lidhje me kërkesën e parashtruesit për pronë private KPA 15121, të 1 shtatorit 2006.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit

për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 1 dhjetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 17 dhjetor 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 22 maj 2014, parashtruesi u njoftua në lidhje me regjistrimin e kërkesës dhe u kërkua nga ai që të plotësojë formularin e kërkesës dhe të dorëzojë dokumente shtesë relevante për pretendimet e tij.

8. Më 16 janar 2015, parashtruesi plotësoi formularin e kërkesës dhe dorëzoi dokumentet shtesë.

9. Më 19 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumentet shtesë, duke përfshirë vendimin e KKPK-së lidhur me kërkesën e tij pronësore private.

10. Më 15 shtator 2015, Gjykata i dërgoi AKP-së një kopje të kërkesës dhe kërkoi që të informohet në lidhje me statusin e kërkesës së parashtruesit.

11. Më 18 shtator 2015, AKP-ja dorëzoi dokumente dhe informata shtesë në lidhje me statusin e kërkesës së parashtruesit.

12. Më 25 shtator 2015, një kopje e kërkesës iu dërgua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme).

13. Më 30 shtator 2015, Dhoma e Posaçme njoftoi Gjykatën se parashtruesi nuk ka parashtruar ankesë tek ajo.

14. Më 10 nëntor2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 20 mars 1992, parashtruesi i kërkesës, si menaxher i ndërmarrjes "Enigma" nga Ferizaj, lidhi marrëveshje me ndërmarrjen NSHT "TRGOPROMET" gjithashtu nga Ferizaj. Marrëveshja ishte vërtetuar

në Gjykatën Komunale në Ferizaj, dhe me të përcaktohej se parashtruesi i kërkesës i huazon një shumë të caktuar të hollash NSHT "TRGOPROMET", e cila duhet t'i kthehet parashtruesit të kërkesës deri më 10 prill 1992, si garanci, se kredia do të paguhet në datën e paraparë NSHT "TRGOPROMET" do të lë hapësirën e papërdorur magazinuese në sipërfaqe prej 52 m2 në Prishtinë, që në rast se NSHT "TRGOPROMET" nuk e paguan kredinë në datën e paraparë, parashtruesi ka të drejtë të shesë objektin e magazinës së hipotekuar, dhe se, Gjykata Ekonomike në Prishtinë është autoriteti kompetent në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje midis palëve të asaj marrëveshjeje.

16. Rezulton se NSHT "TRGOPROMET" nuk ia ka paguar kredinë parashtruesit të kërkesës sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi parashtroi padi në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë, me kërkesë që të njihet si pronar i lokalit të hipotekuar-magazinës në Prishtinë.

17. Më 28 korrik 1992, Gjykata Ekonomike në Prishtinë, me Aktgjykimin VI. P. nr. 3851/92 aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, konfirmoi se parashtruesi i kërkesës është pronar i hapësirës së depos së hipotekuar, se NSHT "TRGOPROMET" është e obliguar që të transferojë pronësinë dhe përdorimin e papenguar të lokalit të hipotekuar - depo brenda 8 (tetë) ditësh nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm, dhe se, NSHT "TRGOPROMET" duhet t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës shpenzimet e procedurës gjyqësore. Gjykata Ekonomike arsyetoi, *inter alia*, se në bazë të dëshmive të paraqitura, është përtej çdo dyshimi se objekti i magazinës ishte hipotekuar, që NSH "TRGROPROMET" nuk ia ka paguar kredinë parashtruesit të kërkesës, dhe se, në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve, parashtruesi i kërkesës e ka fituar të drejtën për të transferuar objektin e kontestuar të magazinës në pronësi të tij.

18. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, del se parashtruesi i kërkesës ndërmjet viteve 1992 dhe 1999 e kishte shfrytëzuar dhe rinovuar objektin e magazinës, që i ishte dhënë atij sipas kushteve të marrëveshjes dhe vendimit të mësipërm të Gjykatës Ekonomike. Në vitet 1998-1999, shpërtheu lufta në Kosovë dhe parashtruesi i kërkesës, së bashku me familjen e tij iku në Republikën e Serbisë.

19. Më 1 shtator 2006, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për pronë private KPA15121 në AKP, duke deklaruar se prona e tij private kishte humbur si rezultat i rrethanave që u krijuan gjatë viteve 98/99 në Kosovë, se ai e ka humbur pronën e tij më 12 qershor 1999, se ai është pronar i objektit të magazinës në Prishtinë sipas marrëveshjes së 20 marsit 1992, se prona e tij aktualisht është uzurpuar nga një palë e tretë dhe se ai duhet të kompensohet, për shkak se prona e tij është

shfrytëzuar nga viti 1999 pa pëlqimin e tij. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu bashkëngjiti një vendim të Gjykatës Ekonomike në Prishtinë, të 22 gushtit 1996 për regjistrimin e pronës.

20. KKPK-ja, një organ në kuadër të AKP-së, nuk vendosi lidhur me kërkesën e parashtruesit deri më 21 tetor 2014. Gjatë kësaj periudhe kohore, parashtruesi i kërkesës u ankua për zvarritjen e procedurave në UNHCR, EULEX, Qeverinë e Kosovës, bëri ankesa të freskëta në AKP dhe përfundimisht parashtroi kërkesë në Gjykatë më 1 dhjetor 2014. AKP-ja i ishte përgjigjur parashtruesit të kërkesës që ata nuk mund të vendosin për kërkesën e tij për shkak të numrit të madh të rasteve të pazgjidhura, diku rreth 43,000 kërkesa, dhe se, kërkesa e tij do të shqyrtohet në pajtim me prioritetin e kërkesave të paraqitura në AKP.

21. Më 21 tetor 2014, KKPK-ja me Vendimin KKPK/D/C/264/2014 konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk e ka humbur mundësinë e tij për të ushtruar të drejtën e tij pronësore si rezultat i konfliktit të viteve 1998-99, por si rezultat i procesit të mëvonshëm të privatizimit, prandaj, kërkesa e parashtruesit bie jashtë juridiksionit të KKPK-së dhe për këtë arsye hidhet poshtë. Me Vendimin e KKPK-së gjithashtu përcaktohet se brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga AKP-ja me vendimin e KKPK-së lidhur me kërkesën, pala mund të parashtrojë ankesë nëpërmjet Sekretariatit Ekzekutiv të AKP-së në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër vendimit të tillë. Ankesa mund të parashtrohet për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale, si dhe për shkak të vërtetimit jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike.

22. Në vendimin e lartcekur të KKPK-së në pjesën e tij relevante, theksohet:

> *Kërkesat nr. 10676, 11322 dhe 15121, të referuara në pjesën D të listës së bashkëngjitur, janë paraqitur nga paraqitësi përkatës i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Në të gjitha këto kërkesa, paraqitësit e kërkesave kanë pretenduar se ata ose familjet e tyre kanë humbur pronat e kërkuara si rezultat i konfliktit të viteve 1998-99. Sekretaria Ekzekutive ka siguruar informatat që pronat e kërkuara janë pasuri e ndërmarrjeve të ndryshme shoqërore ("NSH") dhe si të tilla janë vendosur nën administrim të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe më vonë në vitin 2002 të pasueses së saj, Agjencisë Kosovare të Privatizimit). Sipas përfaqësuesit të AKP-së, pronat komerciale të cilat u takojnë këtyre NSH-ve tashmë janë privatizuar ose janë në procesin e likuidimit. Pastaj, Sekretaria Ekzekutive ka vërtetuar që pronat e*

kërkuara në kërkesat nr. 10676 dhe 15121 tashmë i janë shitur palës së tretë përmes procesit të privatizimit".

Dispozitat relevante ligjore

RREGULLORJA e UNMIK-ut NR. 2006/50 MBI ZGJIDHJEN E KËRKESAVE LIDHUR ME PRONËN E PALUAJTSHME PRIVATE, DUKE PËRFSHIRË PRONËN BUJQËSORE DHE ATË KOMERCIALE

Kapitulli IV
E drejta në ankesë
Neni 12

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.2 Përveç nëse me këtë Rregullore apo me ndonjë urdhëresë administrative me të cilën zbatohet kjo Rregullore parashihet ndryshe, dispozitat e Ligjit mbi procedurën civile zbatohen përshtatshmërisht në procedurën e apelit pranë Gjykatës Supreme.

12.3 Ankesa mund të paraqitet nëse:

(a) Vendimi përmban ndonjë gabim të rëndë apo moszbatim serioz të së drejtës lëndore a procedurale ose

(b) Vendimi bazohet në fakte jo të plota apo në vlerësimin e gabuar të fakteve.

Komentet e AKP-së

Në pjesën relevante të përgjigjes së AKP-së (Shih, paragrafin 12 më lart) në lidhje me statusin e kërkesës së parashtruesit theksohet: *"Komisioni pas shqyrtimit të shkresave të lëndës me vendimin KPCC/D/C/264/2014, datë 21/10/2014/ vendosi që kërkesa e parashtruar nga z, Savić të hidhet poshtë për shkak se binte jashtë juridiksionit të Komisionit. Me vendimin e Komisionit janë njoftuar palët në procedurë ndërsa parashtruesi i kërkesës z. Staja Savić ka parashtruar ankesë kundër vendimit të Komisionit. Ju lutem të jeni të informuar se ankesa e parashtruar nga z. Savić sipas procedurave standarde është në procesin e përkthimit dhe*

më pas do të dërgohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, Kolegjin e Ankesave të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vendimmarrje".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*Agjencia Kosovare e Pronës, Kërkesa për pronën private KPA 15121, e datës 01.09.2006, Dardania Kurriz 5/9, hapësira magazinuese 52 m² e rrënuar, pas rekonstruktimit është fituar një hapësirë afariste prej 104 m², lokali në katin përdhes dhe galeria në katin e parë. Deri në ditën e sotme kërkesa ime nuk është zgjidhur, ndërsa uzurpatori qe 15 vjet në mënyrë të paligjshme shfrytëzon hapësirën time afariste, të cilën e lëshon me qira, falë asaj që Agjencia Kosovare e Pronës është duke e zvarritur zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore në të cilat nuk ka asgjë kontestuese, përveç vullnetit të mirë".*

24. Përkitazi me pretendimin për zvarritjen e procedurave, parashtruesi theksoi: "*Sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe sipas Kushtetutës së Kosovës, neni 22 paragrafi 1, neni 6 (gjashtë) i KEDNJ-së janë cenuar të drejtat e mia pronësore, njerëzore dhe të drejtat e lirisë, gjithashtu është cenuar e drejta ime për shqyrtim brenda një afati të arsyeshëm".*

25. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata: *"Dëshiroj që lokali im i cili ndodhet në Prishtinë në lagjen Dardania, Kurriz 5/9 të kthehet në pronësinë time, sepse ai është e vetmja pronë nga e cila e kam mbajtur familjen time pesë anëtarshe. Ai është në pronësinë time prej vitit 1992 dhe unë kam investuar mjete shumë të mëdha në rekonstruktimin e tij. Derisa unë me familjen time pesë anëtarshe jetoj nga lëmosha dhe ndihmat dhe e kam statusin e personit të zhvendosur edhe pse jam shtetas i Kosovës dhe dëshiroj të kthehem në Kosovë, pronën time e shfrytëzon M.S. nga Prishtina".*

26. Sa i përket shterimit të mjeteve juridike, parashtruesi i kërkesës pretendon: *"Nuk ekziston ndonjë ankesë tjetër, vetëm Agjencisë Kosovare të Pronës, Kërkesa për pronë private KPA 15121, e datës 01.09.2006. Unë kam menduar se AKP është i vetmi institucion shtetëror i cili është i ngarkuar për zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore. Unë jam një njeri i paditur dhe nuk kam pasur mundësi për t'i shfrytëzuar mjetet e tjera juridike sepse nuk kam pasur mjete për këtë".*

27. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata *"të konstatojë se vendimi i KKPK është jokushtetues".*

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

30. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

31. Gjykata më tej merr parasysh rregullin 36 1 (b), i cili parasheh:

> *(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> ...
>
> *(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar...*

32. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit për pronë private, siç dëshmohet nga përgjigja e AKP-së dhe e Dhomës së Posaçme, është dërguar në Kolegjin e Apelit të AKP-së në Gjykatën Supreme për shqyrtim të mëtejshëm.

33. Nga kjo rrjedh, se kërkesa është parashtruar para kohe në këtë Gjykatë. Megjithatë, parashtruesi kërkon nga Gjykata *"të shpallë vendimin e KKPK-së si jokushtetues".*

34. Me një kërkesë të tillë parashtruesi në një mënyrë kërkon që Gjykata ta lirojë atë nga shterimi i të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligj.

35. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se në mënyrë që parashtruesi i kërkesës të lirohet nga detyrimi për të shteruar të gjitha mjetet juridike, ai duhet të tregojë se: i) mjeti juridik në të vërtetë ishte

shfrytëzuar, ii) mjeti juridik ishte i papërshtatshëm dhe joefektiv në lidhje me rastin e tij, dhe iii) kanë ekzistuar rrethanat e veçanta për shfajësimin e parashtruesit nga kërkesa për të shteruar të gjitha mjetet juridike. Nga dokumentet që gjenden në kërkesë, nuk ka asgjë që tregon se parashtruesi i kërkesës i plotëson kriteret për tu liruar nga shterimi i të gjitha mjeteve juridike në dobi të tij (Shih, për shembull, Rasti nr. KI116/14, parashtruesi i kërkesës *Fadil Selmanaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 janarit 2015).

36. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih, Rasti KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë* Aktvendimin për papranueshmëri i 21 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

37. Gjykata rithekson se nuk mund t'i zëvendësojë me gjetjet e veta gjetjet e gjykatave të rregullta apo autoriteteve tjera publike në Republikën e Kosovës; parimi i subsidiaritetit është shumë i rëndësishëm sepse i ofron mundësinë parashtruesit të kërkesës të ngrejë çështjen e faktit dhe të ligjit në gjykatat e rregullta; dhe lidhur me çështjet e faktit dhe të ligjit, gjykatat e rregullta janë të obliguara me Kushtetutë dhe me ligj të vërtetojnë çështjet e tilla (ligjshmërinë dhe faktet), të cilat, megjithatë, nuk janë brenda juridiksionit të kësaj Gjykate.

38. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk mund të shqyrtojë thelbin e kërkesës së parashtruesit pa paragjykuar rezultatin e procedurës pranë Gjykatës Supreme.

39. Duke pasur parasysh të gjitha të lartcekurat, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme.

40. Nga kjo rrjedh se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, për shkak të mosshterjes së të gjitha mjeteve juridike siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, më 10 nëntor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI177/14, Parashtrues Miodrag Janković - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, U. ZH- A. A. Dr. 6/2014, i 21 korrikut 2014

KI177/14, Aktvendim për papranueshmëri i 2 korrikut 2015, publikuar më 22 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, barazia para ligjit, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, e drejta për mjete juridike, taksat gjyqësore*

Gjykata Supreme kishte refuzuar që ta vlerësojë në themelësi ankesën e parashtruesit të kërkesës për shkak të mospagimit të taksës gjyqësore që ishte e detyrueshme për të gjitha palët, që paraqesin ankesë në Gjykatën Supreme. Ankesa e parashtruesit kishte të bënte me të drejtat e tij zgjedhore që ai pretendonte se i ishin mohuar nga Këshilli Qendror Zgjedhor dhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Parashtruesiu ankua në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar kryesisht shkelje të së drejtës zgjedhore dhe pjesëmarrjes, dhe të drejtës për mjete juridike.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parashtruesit të kërkesës nuk i ishte mohuar e drejta zgjedhore dhe e pjesëmarrjes porse, ai nuk kishte plotësuar kushtet ligjore për t'i realizuar të drejtat e tij zgjedhore, dhe për më tepër, shtoi se e drejta zgjedhore nuk është absolute dhe mund t'i nënshtrohet kufizimeve ligjore. Gjykata Kushtetuese shtoi se parashtruesi i kërkesës, po ashtu, nuk kishte paraqitur prova për lirim nga taksa gjyqësore dhe se, Vendimi i Gjykatës Supreme ishte i ligjshëm. Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI177/14
Parashtrues
Miodrag Janković
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
U.ZH-A.A. nr. 6/2014, të 21 korrikut 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Janković Miodrag nga Komorani, me vendbanim të përhershëm në Beograd, Republika e Serbisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, U.ZH.-A.A. nr. 6/2014, të 21korrikut 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të lartpërmendur. Parashtruesi gjithashtu konteston edhe vendimet e Panelit Zgjedhor për Ankesa e Parashtresa (në tekstin e mëtejmë: PZAP), A. nr. 7251/2014, të 2 qershorit 2014, dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejmë: KQZ), nr. 20140806004875, me të cilat pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës(në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) nga neni 24 [Barazia para Ligjit], nga neni 32 [E drejta për Mjete Juridike], nga neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe nga neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], si dhe nga neni 3, i Protokollit 1 [E drejta për zgjedhje të lira], nga neni

13 [E drejta për zgjedhje efektive] dhe nga neni 14 [Ndalimi i diskriminimit] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI177/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

7. Më 26 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin KSH. KI177/14, në vend të gjyqtarit Enver Hasani, mandati i të cilit kishte përfunduar, emëroi anëtare të Kolegjit gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 21 janar 2015, Gjykata Kushtetuese e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi dokumentacionin plotësues nga ai, si: autorizimin për personat e caktuar në kërkesë për dorëzim të korrespodencës zyrtare në emër të tij dhe vendimin e KQZ-së, me të cilin iu refuzua kërkesa për përfshirje në listën e votuesve.

9. Më 11 shkurt 2015, Gjykata pranoi nga parashtruesi autorizimin e kërkuar por jo edhe vendimin e KQZ-së.

10. Më 2 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës ishte banor i Kosovës me vendbanim në Fushë-Kosovë, deri në qershor të vitit 1999, kur kishte shkuar të jetojë në Beograd, Republika e Serbisë.

12. Me qëllim të realizimit të së drejtës për pjesëmarrje në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të vitit 2004 në Kosovë si votues, parashtruesi kishte paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për t'u përfshirë në listën zgjedhore.

13. Në një datë të paspecifikuar, KQZ-ja ka nxjerrë Vendimin nr. 2014080600875, me të cilin ka refuzuar kërkesën e parashtruesit për përfshirje në listat zgjedhore, me arsyetimin se parashtruesi nuk kishte plotësuar kushtet sipas nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

14. Më 30 maj 2014, parashtruesi paraqiti ankesë në PZAP duke kontestuar vendimin e KQZ-së.

15. Më 2 qershor 2014, PZAP-i, me Vendimin e vet A. nr. 7251/2014, refuzoi ankesën e parashtruesit, duke vërtetuar vendimin e KQZ-së dhe duke dhënë po të njëjtin arsyetim se parashtruesi nuk i ka plotësuar kushtet për regjistrim në listat zgjedhore sipas nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

16. Kundër vendimit të PZAP-it, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljes thelbësore të dispozitave procedurale.

17. Më 13 qershor 2014, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) i dërgoi parashtruesit një urdhërpagesë të plotësuar dhe të vulosur nga Gjykata Supreme e Kosovës, për pagesën e taksës gjyqësore në shumën prej 30 €.

18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës i kishte dërguar Gjykatës Supreme një kërkesë për lirim nga obligimi i pagesës së taksës, për shkak të gjendjes jo të mirë materiale.

19. Më 21 korrik 2014, Gjykata Supreme ka nxjerrë Aktvendimin U.ZH.-A.A.nr. 6/2014 me të cilin ka hedhur poshtë ankesën e parashtruesit.

20. Në arsyetimin e Aktvendimit, Gjykata Supreme ka theksuar: "*Me nenin 2.4 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, ndër të tjera, është përcaktuar se nocioni "parashtresë" do të thotë padi, kundërpadi, ankesë. Me nenin 6.1 të Udhëzimit në fjalë, është përcaktuar se taksa duhet të paguhet me rastin e dorëzimit të parashtresës – ankesës, ndërsa me nenin 6.5 të Udhëzimit, është përcaktuar që nëse taksat nuk paguhen nga parashtruesi i ankesës deri në datën e caktuar, gjykata do të hedh poshtë parashtresën - ankesën për të cilën nuk janë paguar taksat*".

21. Gjykata Supreme më tej kishte konstatuar se përkundër faktit që parashtruesi ka pranuar vërejtjen për pagesën e taksës, ai nuk e kishte përmbushur këtë obligim, andaj *"sipas mendimit të kësaj gjykate ankesa duhet të hidhet poshtë"*.

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, duke mos shqyrtuar ankesën e tij në meritat e saj, i ka mohuar mbrojtjen gjyqësore të drejtave të tij të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës, si dhe e ka vënë në pozitë të pabarabartë para ligjit gjë që sipas tij, për pasojë, ka rezultuar me mohimin e të drejtës së tij për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare, duke i cenuar kështu të drejtën kushtetuese të paraparë me nenin 45 të Kushtetutës dhe me nenin 3 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

23. Parashtruesi më tej ankohet se mjeti juridik i ankesës në rastin e tij nuk ka qenë efektiv, sepse nuk i ka mundësuar ta realizojë të drejtën e tij, andaj ai pretendon se ka shkelje të nenit 32 të Kushtetutës lidhur me nenin 13 të KEDNJ-së që garanton të drejtën për zgjedhje efektive.

24. Parashtruesi ka kërkuar që Gjykata t'i akordojë kompensim për dëmin material në shumën prej 30.00 € në emër të taksës gjyqësore.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Për të gjykuar lidhur me kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

27. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *(2) Gjykata do të deklarojë njëkërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

28. Ashtu siç u cek më lart, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që të vlerësojë çështjen nëse Aktvendimi i Gjykatës Supreme, i 21 korrikut 2014, dhe vendimet e KQZ-së dhe PZAP-it i kanë pamundësuar atij pjesëmarrjen në zgjedhjet parlamentare në Kosovë në vitin 2014, dhe kjo ka rezultuar me shkeljet kushtetuese dhe të KEDNJ-së të theksuara si në pikën tre të këtij raporti.

29. Gjykata më tej thekson se, përkundër kërkesës me shkrim, parashtruesi nuk i kishte dërguar vendimin e KQZ-së me të cilin atij iu refuzua aplikacioni për përfshirje në listën e votuesve, andaj Gjykata nuk mund të vlerësojë nëse ky vendim ka shkaktuar shkelje të Kushtetutës në dëm të parashtruesit.

30. Sipas rregullit 29, pika 4, të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, është detyrë e parashtruesit të bashkëngjitë dokumentacionin e nevojshëm me kërkesën e tij, që dëshmon për shkeljet e pretenduara. Nuk është detyrë e Gjykatës që të ndërtojë rastin në vend të tij apo të kërkojë dokumentacion sipas detyrës zyrtare, që eventualisht do të shkonte në favor të tij.

31. Gjykata vë në dukje se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. DL-027-2008, të 15 qershorit 2008, ka paraparë se secili person, për të ushtruar të drejtën kushtetuese për pjesëmarrje në zgjedhje, duhet t'i përmbushë kushtet si në vijim:

Neni 5 - E drejta për të votuar

5.1 Çdo person ka të drejtë për të votuar në zgjedhje në përputhje me këtë ligj nëse ika mbushur 18 (tetëmbëdhjetë) vjet në ditën kur mbahen zgjedhjet, dhe e plotëson njërin prej kritereve vijuese:

a) është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil;

b) banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që t'i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës; apo

c) ka fituar statusin e refugjatit, siç është përkufizuar në Konventën Lidhur me Statusin e Refugjatëve të 28 korrikut 1951 dhe Protokollin e saj të 16 dhjetorit 1966, në apo pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banor i Kosovës;

32. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se PZAP-i, më 2 qershor 2014, ka nxjerrë Vendimin A. nr. 7251/2014, me të cilin ka refuzuar ankesën e parashtruesit kundër Vendimit të KQZ-së duke theksuar se "*parashtruesi nuk i ka plotësuar kushtet për regjistrim në listat zgjedhore sipas nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme*" dhe nuk kishte gjetur se vendimi i KQZ-së përmban shkelje ligjore sikur pretendon parashtruesi i kërkesës.

33. Gjykata më tej konstaton se bazuar në kompetencat e PZAP-it, të cilat parashihen me Ligjin Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 87, më 16 nëntor 2010, i cili në nenin 1 ka paraparë *"PZAP do të thotë Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, një organ i pavarur përgjegjës për vendosjen për parashtresat dhe ankesat në lidhje me procesin zgjedhor"*.

34. Për më tepër, siç u tha më lart, është e qartë se KQZ-ja dhe PZAP-i janë organe të përcaktuara me ligj për të vendosur nëse parashtruesi i ka plotësuar apo jo kushtet e parapara me ligj për t'u përfshirë në listën e votuesve dhe nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese t'i verifikojë këto fakte sepse ato janë të sferës ligjore dhe jokushtetuese.

35. Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta apo në rastin konkret nga organet e pavarura. Është roli i gjykatave të rregullta ose i organeve administrative të përcaktuara me ligj, që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu Rastin nr. KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

36. Në rrethanat e rastit, Gjykata konstaton se parashtruesit iu pranua aplikacioni për pjesëmarrje në zgjedhje: Me vendim të KQZ-së u konstatua se ai nuk i plotësonte kushtet ligjore për t'u përfshirë në listën e votuesve dhe iu mundësua procesi ankimor dhe ankesa e tij u refuzua, andaj duke marrë parasysh procedurat e zhvilluara Gjykata nuk mund të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 45 të Kushtetutës

[E Drejta për Zgjedhje dhe Pjesëmarrje] dhe të nenit 3 të Protokollit 1 të KEDNJ-së [E Drejta për Zgjedhje të Lira], për faktin e vetëm se rezultati i aplikimit të parashtruesit ka qenë i pafavorshëm për të.

37. Për më tepër, Gjykata thekson se e ”drejta për zgjedhje dhe pjesëmarrje”, e paraparë me Kushtetutë, apo “e drejta për zgjedhje të lira” e paraparë me Protokollin 1 të KEDNJ-së nuk është një e drejtë absolute dhe e pa limituar por ajo mund të jetë objekt i kufizimeve ligjore në secilin shtet veç e veç.

38. Në rastin *Shindler kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) kishte konstatuar se nuk ka shkelje të nenit 3, të Protokollit 1 të KEDNJ-së me rastin e refuzimit të së drejtës për pjesëmarrje në zgjedhjet e përgjithshme në Britani, të mbajtura më 5 maj 2010, për personin që nuk ka jetuar në Britani për një kohë më të gjatë se koha e përcaktuar me ligjin në fuqi, dhe se kjo e drejtë do t’i nënshtrohet kufizimeve të parapara me ligjin britanik në atë kohë (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin ***Shindler v. the United Kingdom* të 7 majit 2013 – aplikacioni nr. 19840/09)**.

39. Sa i përket çështjes së hedhjes poshtë të ankesës së parashtruesit nga Gjykata Supreme, shkaku i mospagesës së taksës gjyqësore, Gjykata konstaton se Aktvendimi i Gjykatës Supreme është nxjerrë në mbështetje të një akti juridik (Udhëzimi Administrativ nr. 2008/02 të KGJK) që rregullon këtë materie andaj, si i tillë nuk është një akt arbitrar dhe i pabazuar.

40. Për më tepër, në arsyetimin e aktvendimit të vet Gjykata Supreme kishte cituar nenin 6.5 të Udhëzimit, ku qartë është përcaktuar *“që nëse taksat nuk paguhen nga parashtruesi i ankesës deri në datën e caktuar, gjykata do të hedh poshtë parashtresën - ankesën për të cilën nuk janë paguar taksat”*.

41. Parashtruesi nuk mundi të mbështesë pretendimet e tij me ndonjë provë që do të tregonte se persona të caktuar janë liruar nga obligimi i pagesës së taksës gjyqësore apo që ky obligim vlen vetëm për grupe të caktuara të popullatës, sikur ka pretenduar në ankesë. Është tërësisht e qartë se parashtruesi nuk paraqiti prova që do të dëshmonin se ky aktvendim është tregues i shkeljeve të pretenduara për pabarazi para ligjit, apo edhe akt juridik diskriminues.

42. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese në Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin KI121/13, të parashtrueses L. M., kishte konstatuar se aktvendimet e Gjykatës Themelore në Gjakovë, të 8 majit 2013, dhe të Gjykatës së Apelit të 12 korrikut 2013 me të cilat u refuzuan ankesat e parashtrueses për shkak të mospagesës së taksës

gjyqësore nuk ishin të papajtueshme me Kushtetutën dhe kjo Gjykatën e shpie deri te përfundimi se taksat gjyqësore janë obligim për të gjithë parashtruesit, pa marrë parasysh përkatësinë e grupit të popullatës dhe se para ligjit për çështjen e njëjtë palët janë trajtuar njëjtë.

43. Në këto rrethana, Gjykata nuk mund të gjejë shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit], të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe të neneve 14 [Ndalimi i diskriminimit] dhe 13 [E drejta për zgjedhje efektive] të KEDNJ-së.

44. Gjykata në përgjigje të kërkesës së parashtruesit për akordimin e dëmit material të pësuar thekson se bazuar në Kushtetutë dhe në Ligjin për Gjykatën ajo nuk ka kompetencë të akordimit të një dëmi të tillë.

45. Në përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij.

46. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe, si e tillë, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 2 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI83/15, Parashtrues Shefqet Mehmetukaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 49/2014, i 23 dhjetorit 2014

KI83/15, Aktvendim për papranueshmëri i 11 nëntorit 2015, publikuar më 22 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, kodi doganor dhe i akcizave, kompensim dëmi, kundërvajtje doganore*

Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar kërkesën për revizion të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës për kompensim të dëmit nga autoritet doganore të Kosovës, pasi që ishte vërtetuar pafajësia e tij për kundërvajtje doganore. Parashtruesiu ankua në Gjykatën Kushtetuese për cenim të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe të drejtës për mjete juridike.

Gjykata Kushtetuese vërejti se parashtruesi i kërkesës kryesisht nuk pajtohet me kualifikimin ligjor të fakteve dhe të ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta dhe se, ai nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese. Gjykata Kushtetuese, shpalli kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI83/15
Parashtrues
Shefqet Mehmetukaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës (E. Rev. nr. 49/2014), të 23 dhjetorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Shefqet Mehmetukaj pronar i kompanisë N.T.P. „Sinorg-Pharmaceuticals“ (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) nga Graçanica, të cilin e përfaqësojnë avokatët z. Blerim Prestreshi dhe z. Hekuran Haxhimusa, që të dy nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (E. Rev. nr. 49/2014), të 23 dhjetorit 2014, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 18 shkurt 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në gjykatat e rregullta, janë shkelur nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 18 qershor 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI83/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI83/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Harjizi.

7. Më 15 shtator 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 16 shtator 2015, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme e Kosovës që të paraqesë dëshmi se kur i është dorëzuar parashtruesit Aktvendimi (E. Rev. nr. 49/2014) i Gjykatës Supreme të Kosovës.

9. Më 23 shtator 2015, GjykataSupreme e Kosovës paraqiti dokumentacionin e kërkuar.

10. Më 11 nëntor 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 9 janar 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti një ngarkesë me mallra për eksportim në terminalin doganor në Vërmicë. Në të njëjtën datë Dogana e Kosovës - Komisioni për kundërvajtje doganore, me Aktvendimin (nr. 08/701) vendosi se parashtruesi i kërkesës është përgjegjës për kundërvajtje doganore dhe është dënuar me gjobë në vlerë prej 7,000.00 euro, për shkak se nuk kishte paraqitur drejt origjinën e mallrave të deklaruara për eksport.

12. Parashtruesi pohon se, pasi që mallrat të cilat ishin të ngarkuara në automjetin transportues, nuk mund të eksportoheshin për në

destinacionin përfundimtar pa e paguar gjobën administrative dhe pa e ndryshuar vendin e origjinës së mallrave, mallrat dhe automjeti transportues *"u lanë në terminalin doganor Vërmicë"*.

13. Më 14 janar 2009, parashtruesi ushtroi ankesë në Doganën e Kosovës – Sektorit për Rishqyrtime, kundër Aktvendimit (nr. 08/701) të Komisionit për kundërvajtje doganore.

14. Më 30 janar 2009, Dogana e Kosovës - Sektori për rishqyrtimin e vendimeve, me Aktvendimin (06.1.4. nr. 34), e refuzoi ankesën në tërësi dhe e konfirmoi Aktvendimin (nr. 08/701) të Komisionit për kundërvajtje doganore.

15. Më 28 shkurt 2009, parashtruesi ushtroi ankesë në Bordin e Pavarur për Rishqyrtime (në tekstin e mëtejmë: BPR)kundër Aktvendimit (06.1.4. nr. 34) të Doganës së Kosovës - Sektori për Rishqyrtime.

16. Më 26 mars 2012, BPR me Aktvendimin (A. nr. 76/2009 – SHD) e aprovoi ankesën e parashtruesit në tërësi dhe e liroi nga pagesa e gjobës administrative në vlerë prej 7,000 euro. BPR më tej konsideroi se:

> *"BPR nuk mund të marrë një vendim për një çështje e cila nuk ka qenë objekt i kontestit, ngase në rastin konkret ankuesi është dashur të kryej procedurën e eksportit ose në të kundërtën të kërkoj kthimin e mallit që ishte me afat skadimi, edhe në rast se kjo nuk do të ishte lejuar, atëherë ankuesi ka pasur të drejtë të kërkonte nga dogana sqarim për bazën ligjore dhe arsyen e ndalimit të mallrave në terminal.*
>
> *[...]*
>
> *Në lidhje me pretendimin ankimor për mallin e ndaluar në terminalin doganor në Vërmicë, BPR konstaton se në shkresat e lëndës, nuk ekziston asnjë vendim për ndalim të përkohshëm apo konfiskim të mallit të ndaluar".*

17. BRP konkludoi me "*këshillë juridike"* si në vijim:

> *"Ky Aktvendim është definitiv në procedurën administrative, kurse pala e pakënaqur kundër këtij Aktvendimi ka të drejtë padie në Gjykatën Supreme të Kosovës në afatin prej 30 ditësh nga dita e pranimit referuar Ligjit Nr. 03/L-109 Kodit Doganor dhe i Akcizave në Kosovë. Padia kundër këtij Aktvendimi nuk e pezullon ekzekutimin e Aktvendimit i cili është detyrues për palët deri sa nuk ndryshohet ose anulohet nga Gjykata".*

18. Më 8 nëntor 2012, parashtruesi parashtroi padi për kompensim të dëmit në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë. Parashtruesi përmes padisë kërkoi që të obligohet "*Dogana e Kosovës që paditësit t'ia paguaj kompensimin e dëmit në vlerë prej 38764.80 euro (kundërvlerën e mallit të cilit me fajin e Doganës i ka skaduar afati), si dhe t'ia kompensoj dëmin në emër të bllokimit të automjetit transportues të njëjtit, prej datës 25.12.2008 e deri në datën e ushtrimit të padisë sipas ekspertizës financiare*".

19. Më 19 nëntor 2012, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë me Aktvendimin (I. C. nr. 258/2012) "*është shpallur jokompetente për këtë çështje kontestimore*" dhe e hedh poshtë padinë e parashtruesit.

20. Më 21 janar 2013, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktvendimit (I. C. nr. 258/2012) të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

21. Më 10 korrik 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës me Vendimin (Ae. nr. 30/2013) refuzoi ankesën si të pabazuar, dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë (I. C. nr. 258/2012), të 19 nëntorit 2012.

22. Më 1 tetor 2014, parashtruesi parashtroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë (Ae. nr. 30/2013), të 10 korrikut 2014.

23. Më 23 dhjetor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin (E. Rev. nr. 49/2014) refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për revizion me arsyetimin si në vijim:

> "*... Çështja në mes palëve ndërgjyqëse është zgjidhur sipas Kodit Doganor dhe të Akcizave Nr. 03/L-109 si ligj special, i cili parasheh obligimet e Doganës kur çështja zgjidhet përfundimisht në instancë të fundit, për mallrat dhe detyrimet në shumën ekuivalente me vlerën e tregut për mallin kontestues në momentin e shkaktimit, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat ligjore kur kanë vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të kundërshtuar, në bazë të cilës u vlerësua se pretendimet e cekura në revizion për zbatimin e gabuar të dispozitave të procedurës kontestimore janë të pabazuara.*
> *Gjykata shqyrtoi pretendimin se çështja administrative ka përfunduar në favor të paditësit dhe i njëjti nuk ka pasur interes që të kundërshtoi vendimin e organit administrativ, por e njëjta nuk pat ndikim për të vendosur ndryshe, ngase me ligjin e cekur*

është paraparë edhe detyrimi i palëve për pagesë, të shkaktuar me veprimet e palëve në procedurë...".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi së pari pretendon se në procedurat e rregullta gjyqësore janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

25. Parashtruesi konsideron se me Aktvendimin e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime (A. Nr. 76/2009 - SHD) të 26 marsit 2012, u vendos në formën e prerë kontesti administrativ dhe parashtruesi e ka fituar rastin, sepse "*është vërtetuar se gjoba është shqiptuar pa bazë dhe njëkohësisht është hequr gjoba e shqiptuar*".

26. Parashtruesi, me tej, pretendon se ai është pala që e ka fituar këtë kontest dhe se nuk kishte nevojë të veprojë sipas këshillës për mjetin juridik të dhënë në Aktvendimin e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime, që të vazhdonte më tej procedurën në Gjykatën Supreme në kontestin administrativ.

27. Parashtruesi pretendon se në procedurën administrative ai nuk ka mundur të kërkojë kompensim për dëmin, për shkak se nuk dinte se çfarë do të jetë rezultati i kontestit deri në shkallën e fundit kur është vërtetuar se i kishte deklaruar drejt mallrat.

28. Parashtruesi konsideron se dëmin e shkaktuar nga veprimet e paligjshme të Doganës së Kosovës ka mundur ta kërkojë vetëm në procedurën kontestimore, në bazë të nenit 136 të Ligjit, Nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve.

29. Parashtruesi më tej, konsideron, se me Aktvendimin me të cilin Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë u shpall jokompetente, dhe pastaj me vërtetimin e këtij Aktvendimi nga Gjykata e Apelit të Kosovës dhe Gjykata Supreme e Kosovës, atij i është pamundësuar që përmes gjykatës të kërkojë mbrojtjen e të drejtës së tij, dhe njëkohësisht i është mohuar e drejta për mjet juridik.

30. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që: *"pas konstatimit të shkeljeve të dispozitave kushtetuese çështjen ta kthej në rigjykim te Gjykata Supreme e Kosovës dhe kështu palës t'i mundësohet realizimi dhe shfrytëzimi i të drejtave të garantuara me anë të pikës 1 të nenit 31, E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm dhe sipas nenit 32 E Drejta për Mjete juridike, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".*

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrtonnëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

32. Gjykata thekson nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

33. Për më tepër, Gjykata përkujton rregullin 36 (2) (b) të Rregullores, i cili përcakton:

> *(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> ...
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*

34. Parashtruesi i kërkesës pohon se me aktgjykimin e kontestuar i është shkelur e drejta për barazi para ligjit dhe e drejta për mjet juridik, sepse gjykatat e rregullta në mënyrë të gabuar kanë zbatuar Ligjin për Dogana dhe Akcizë lidhur me padinë e tij për kompensimin e dëmit në vend të Ligjit për marrëdhënie detyrimore.

35. Gjykata vëren se parashtruesi i përsërit të njëjtat pretendime të cilat i ka paraqitur edhe në procedurën me rastin e kërkesës për revizion para Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila me Vendimin (E. Rev. 49/2014) e 23 dhjetorit 2014, dha një përgjigje të arsyetuar në të gjitha pretendimet e parashtruesit, përkitazi me arsyet e zbatimit të rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.

36. Çështja e ligjit të zbatueshëm i është bërë e ditur në mënyrë të qartë parashtruesit edhe në Vendimin (A. nr. 76/2009 - SHD) e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime të 26 marsit 2012, i cili në këshillën juridike ka theksuar:

> *"Pala e pakënaqur kundër këtij Aktvendimi ka të drejtë padie në Gjykatën Supreme të Kosovës në afatin prej 30 ditësh nga dita e pranimit, duke iu referuar Ligjit Nr. 03/L-109 Kodit Doganor dhe i Akcizave në Kosovë".*

37. Gjykata vëren se parashtruesi, kryesisht, nuk pajtohet me kualifikimin ligjor të fakteve dhe të ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta. Kualifikimi ligjor i fakteve dhe ligji i zbatueshëm janë çështje të cilat bien në sferën e ligjshmërisë.

38. Gjykata përsëritë se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatëe shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, shih gjithashtu Rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima,* Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

39. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (Shih *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, Vendimi i GJEDNJ-së për papranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99 të 31 majit 2005).

40. Edhe pse parashtruesi pretendon se të drejtat e tij janë shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe zbatimin e gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, ai nuk ka treguar se si vendimet e përmendura kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.

41. Gjykata në vazhdim, ka theksuar se fakti i thjeshtë që parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'i japë të drejtë të ngrejë një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese (Shih, *mutatis mutandis,* Aktgjykimi i GJEDNJ-së, Kërkesa nr. 5503/02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

42. Parashtruesit të kërkesës i është dhënë mundësia që ta paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit, si të interpretuar në mënyrë të gabuar, para Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Gjykatës Supreme të Kosovës në procedurë të rregullt gjyqësore.

43. Gjykata, pas shqyrtimit të rastit në tërësi, nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub vs. Lithuani*a, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

44. Gjykata vëren se nuk janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë. Parashtruesi nuk ka arritur të paraqesë dhe të mbështesë pretendimin se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.

45. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar, dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin36(2) (b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 11 nëntor2015,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KO130/15, Presidentja e Republikës së Kosovës – Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar *"Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore"* me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

KO 130/15, Aktgjykim i 21 dhjetorit 2015, të publikuar më 23 dhjetor 2015.
Fjalët kyçe: *Kërkesë institucionale, vlerësimi abstrakt, kontrolli preventiv kushtetues, juridiksioni dhe palët e autorizuara, organizimi i njësive të vetëqeverisjes lokale, shërbimi civil, Kapitujt II dhe III të Kushtetutës.*

Presidentja e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 84 (9) parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kërkesa përmban kërkesën për vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/ Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, Neni 3 [Barazia para Ligjit], Paragrafi 1, Kapitulli II [të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe Kapitulli III [të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Para se të sigurojë përgjigje thelbësore ndaj pyetjeve të veçanta kushtetuese të bëra nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata përcaktoi pozitivisht dy çështje procedurale duke deklaruar se parashtruesi është palë e autorizuar dhe se dokumenti që përmban kërkesa mund të jetë objekt i shqyrtimit kushtetues.

Gjykata shtjelloi historikun e dokumentit në shqyrtim, përkatësisht duke iu referuar Marrëveshjes së Parë për Normalizimin e Marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe për më tepër kërkoi mendimin e dy ekspertëve ligjor me anë të parashtresave të *amicus curiae*.

Sa i përket aspektit material të kërkesës, Gjykata Kushtetuese gjeti se disa parime të përgjithshme të përfshira në dokumentin në shqyrtim kushtetues nuk i plotësojnë në tërësi standardet kushtetuese të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Gjykata deklaroi se çdo legjislacion apo dokument që rrjedh nga dokumenti në shqyrtim kushtetues duhet të jetë në përputhje të plotë me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht: (i) Kapitujt II dhe III të Kushtetutës në lidhje me të drejtat themelore të njeriut dhe të drejtat e komuniteteve, (ii) çështje të vetëqeverisjes lokale dhe çështjet që lidhen me statusin e Shërbimit Civil në Republikën e Kosovës. Gjykata mbështeti arsyetimin e saj duke u bazuar kryesisht në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, respektivisht në legjislacionin për çështje të vetëqeverisjes lokale dhe të shërbimit civil, instrumente të ndryshme juridike ndërkombëtare, praktikën gjyqësore të

Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

AKTGJYKIM
në
Rastin nr. KO130/15
Parashtrues
Presidentja e Republikës së Kosovës
Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar *"Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore"* me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Saj, Atifete Jahjaga (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Objekti i çështjes

2. Parashtresa përmban kërkesën për vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar *"Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore"* (në tekstin e mëtejmë: Parimet) me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

3. Konkretisht, parashtruesjakërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të përgjigjet në pyetjen vijuese:

   "Duke marrë parasysh se Parimet e Asociacionit rregullojnë krijimin dhe funksionimin e Asociacionit së komunave me shumicë serbe në Kosovë, a janë në përputhshmëri këto parime dhe elemente me frymën e Kushtetutës, nenin 3, paragrafin 1 (natyra shumë-etnike), Kapitullin II (të drejtat dhe liritë themelore) dhe Kapitullin III (të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtareve të tyre) të Kushtetutës së Republikës se Kosovës?".

4. Gjithashtu, parashtruesja kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, konkretisht që *"çdo veprim dhe efekt që prodhon Parimet e Asociacionit të pezullohet, [parashtruesja] kërkon nga Gjykata të vendosë Masë të përkohshme ndaj çështjes së ngritur, deri në vendimin përfundimtar [të Gjykatës]".*

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 84 (9) në lidhje me nenin 112.1 të Kushtetutës, në nenin 16.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 56 (a) të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 31 tetor 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 2 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KO130/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Në të njëjtën datë, me Vendimin KSH. KO130/15, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 3 nëntor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga parashtruesja të dorëzojë kopje të tekstit të dokumentit të titulluar "*Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore*" në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

9. Më 4 nëntor 2015, parashtruesja e dorëzoi tekstin e dokumentit të titulluar "*Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore*" në gjuhët

zyrtare të Republikës së Kosovës, duke përfshirë një kopje të parafuar në gjuhën angleze.

10. Më 5 nëntor 2015, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Kryetarit të Kuvendit të Kosovës me kërkesën eksplicite që e njëjta t'i dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe i ftoi deputetët që të dorëzojnë komentet e tyre lidhur me kërkesën deri më 19 nëntor 2015. Gjykata nuk ka pranuar ndonjë koment.

11. Më 5 nëntor 2015, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Avokatit të Popullit dhe i ftoi ata që të dorëzonin komentet e tyre lidhur me kërkesën deri më 19 janar 2015. Gjykata nuk ka pranuar ndonjë koment.

12. Më 10 nëntor 2015, pas dëgjimit të gjyqtarit raportues dhe pas diskutimit të kërkesës për Masë të përkohshme, të parashtruar nga parashtruesja e kërkesës, Gjykata vendosi të miratojë kërkesën për Masë të përkohshme deri më 12 janar 2016 (shih KO130/15, Vendim për Masë të përkohshme, i 10 nëntorit 2015).

13. Më 13 nëntor 2015, në pajtim me rregullin 53 të Rregullores së punës dhe me Udhëzimin mbi praktikat nr. 01/2012 mbi udhëzimet dhe proceduratpër paraqitjen e parashtresave të *Amicus Curiae*, Gjykata ftoi z. Dastid Pallaska dhe z. Kushtrim Istrefi që të përgatisin deri më 26 nëntor 2015, me shkrim, parashtresën *Amicus Curiae*.

14. Më 13 nëntor 2015, përkatësisht më 16 nëntor 2015, z. Kushtrim Istrefi dhe z. Dastid Pallaska informuan Gjykatën për pranimin e letrës dhe gjithashtu njoftuan Gjykatën se ata do të përgatisin dhe do të dorëzojnë parashtresat *Amicus Curiae* brenda afatit të kërkuar nga Gjykata.

15. Më 16 nëntor 2015, Gjykata i dërgoi letër Kryeministrit, duke i kërkuar që të sigurojë për Gjykatën informatat në vijim:

> *"Brenda kërkesës, Gjykata Kushtetuese ka pranuar kopjet e "Parimeve të përgjithshme/elementeve kryesore të Asociacionit/Bashkësisë të komunave me shumicë serbe" në tri gjuhë. Luteni që të informoni Gjykatën se cili prej këtyre versioneve gjuhësore është origjinali dhe autentiku. Konkretisht, a është versioni anglisht versioni autentik? Apo, a janë versionet shqip dhe serbisht njësoj autentike? Apo, a janë të tri versionet njësoj autentike?"*

16. Në 19 nëntor 2015, Gjykata mori përgjigjen në vijim të paraqitur nga Kryeministri:

"[...]

- *Parimet e përgjithshme/elementet kryesore të Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe, janë nënshkruar nga palet në Gjuhën Angleze.*

- *Delegacioni i Republikës së Kosovës, gjatë tërë punës përgatitore dhe konsultative, si dhe gjatë tërë kohës së diskutimeve dhe negociatave në Bruksel, lidhur me parimet e dakorduara, është shërbyer me Gjuhën Shqipe, duke e konsideruar si gjuhë autentike dhe origjinale, me rastin e zbatimit në praktikë të këtyre parimeve.*

- *Teksti dhe të gjitha nocionet e përfshira dhe dakorduara nga palët në "Parimet e përgjithshme/elementet kryesore të Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe", gjatë tërë procesit të negociatave, para dakordimit, në vazhdimësi janë përkthyer në Gjuhën Shqipe, të njëjtat janë vlerësuar, krahasuar dhe mbështetur në kuptimin e nocioneve të njëjta nga Kushtetuta dhe Ligjet e Republikës së Kosovës.*

- *Për delegacionin e Republikës së Kosovës, versioni gjuhësor origjinal dhe autentik, gjatë tërë procesit të negociatave, është konsideruar dhe pranuar versioni i parimeve, përkthyer në Gjuhën Shqipe, si gjuha e parë zyrtare e listuar në Republikën e Kosovës".*

17. Më 26 nëntor 2015, Gjykata pranoi parashtresën *Amicus Curiae* të paraqitur nga z. Kushtrim Istrefi. Të njëjtën ditë, Gjykata miratoi për z. Dastid Pallaska një zgjatje të afatit deri më 1 dhjetor 2015 për paraqitjen e parashtresës *Amicus Curiae*.

18. Më 1 dhjetor 2015, Gjykata pranoi parashtresën *Amicus Curiae,* të paraqitur nga z. Dastid Pallaska.

19. Më 3 dhjetor 2015, Gjykata i dërgoi parashtrueses të dy parashtresat *Amicus Curiae* për komente dhe ftoi parashtruesen që të paraqesë komentet për parashtresat deri më 9 dhjetor 2015.

20. Më 18 dhjetor 2015, Gjykata pranoi një letër nga Grupi parlamentar Lista Srpska, ku njoftohet Gjykata se ata do t'i paraqesin komentet e tyre lidhur me kërkesën deri 21 dhjetor 2015.

21. Në të njëjtën datë, Gjykata e njoftoi Grupin parlamentar Lista Srpska se afati për dorëzimin e komenteve ka skaduar më 19 nëntor 2015 dhe,

pasi nuk kishte asnjë kërkesë për zgjatjen e afatit, Gjykata nuk do të merrte parasysh komentet e tyre.

22. Më 21 dhjetor 2015, Gjykata shqyrtoi dhe vendosi për rastin.

Ftesë për dorëzimin e parashtresës *Amicus Curiae*

23. Në ftesën për të paraqitur parashtresë *Amicus Curiae* drejtuar z. Pallaska dhe z. Istrefi, Gjykata kërkoi opinionet e tyre përkatëse për objektin e çështjes së kësaj kërkese, si dhe për të marrë përgjigje për një numër pyetjesh specifike. Konkretisht:

1. *"Kërkesa është dorëzuar në bazë të kompetencave të Presidentit të Republikës së Kosovës për të referuar çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese sipas nenit 84 (9) të Kushtetutës. Cila është domethënia dhe fushëveprimi i termit 'çështje kushtetuese' që përmban kjo dispozitë sipas teorisë dhe sipas praktikës kushtetuese të Kosovës? Ju lutemi të jepni një opinion bazuar në ekspertizën tuaj dhe në perspektivën kushtetuese krahasimtare.*

2. *Në bazë të "Parimeve të përgjithshme/elementeve kryesore të Asociacionit të komunave me shumicë serbe" (në tekstin e mëtejmë: Parimet e përgjithshme), sipas mendimit tuaj, a është Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në përputhje me kornizën institucionale kushtetuese dhe legjislative të Kosovës? Konkretisht,*

    a. *Cila është natyra juridike e një asociacioni të komunave?*
    b. *Përkitazi me asociacionin e komunave, çfarë rregullohet zakonisht në mënyrë normative dhe deri në çfarë mase?*
    c. *Cili është statusi i të punësuarve në administratën e asociacioneve të tilla?*

Ju lutemi, jepni opinionin tuaj të bazuar në ekspertizën tuaj dhe në perspektivën kushtetuese krahasimtare.

3. *Në bazë të Parimeve të përgjithshme, më konkretisht pjesës që rregullon raportet e Asociacionit/Bashkësisë me autoritetet qendrore, sipas mendimit tuaj, a janë aranzhimet e tilla në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës?*

4. *Sipas mendimit tuaj, a i japin Parimet e përgjithshme Asociacionit/Bashkësisë kompetenca ekzekutive? Çfarë është kompetenca ekzekutive vis-à-vis një asociacioni të komunave?*

5. *Cili është komenti juaj lidhur me procedurat e përcaktuara në "Parimet e përgjithshme/elementeve kryesore të Asociacionit të komunave me shumicë serbe" për implementimin e këtyre parimeve në statut nëpërmjet një dekreti qeveritar?"*

Parashtresat *Amicus Curiae*

Amicus Curiae e paraqitur nga z. Kushtrim Istrefi

24. Më 26 nëntor 2015, z. Kushtrim Istrefi (në tekstin e mëtejmë: *Amicus Curiae* Istrefi) ka dorëzuar parashtresën e tij *Amicus Curiae*, duke dhënë përgjigje për pyetjet që ishin ngritur nga Gjykata në ftesën e 13 nëntorit 2015.

25. *Amicus Curiae* Istrefi fillimisht identifikon çështjet kushtetuese në rastin konkret, duke iu referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës, përkatësisht rastit nr. KO80/10 dhe rastit nr. KO97/10, ku Gjykata e deklaron veten kompetente për të interpretuar dispozitat kushtetuese sipas kërkesës së Presidentit të Republikës, përkatësisht Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës. Konkretisht Gjykata vuri në dukje se:

"Në përputhje me Nenin 112.1 të Kushtetutës, 'Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës' dhe për shkak të kësaj, nuk ekziston asnjë organ tjetër nga i cili parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë përgjigje në këto çështje kushtetuese. Gjykata është e mendimit se çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës janë 'çështje kushtetuese' të parapara në Nenin 84 (9) dhe që këto çështje të ngritura janë të përshtatshme për t'u shqyrtuar nga kjo Gjykatë".

26. Më tej, *Amicus Curiae* Istrefi, pas një analize dhe krahasimi të rastit të tanishëm me rastet e mëhershme të dorëzuara nga Presidenti i Republikës, konstatoi se:

"Kjo formë e vlerësimit, e njohur si vlerësim abstrakt, i lejon "një gjykate ... që të ekzaminojë veprimet e organeve legjislative dhe ekzekutive të qeverisë para ose pas shpalljes dhe të përcaktojë nëse këto veprime janë në pajtim me Kushtetutën e vendit". Ekzistojnë praktika të vlerësimit abstrakt, madje edhe në mungesë të rastit konkret të mosmarrëveshjes.

Kërkesa e tanishme, rrjedhimisht, mund të shihet si kërkesë për vlerësim të pajtueshmërisë së Parimeve të përgjithshme me Kushtetutën si tërësi".

27. Për më tepër *Amicus Curiae* Istrefi jep një analizë në lidhje me çështjet juridike që kanë të bëjnë me asociacionet e komunave, duke u fokusuar në të drejtën e komunave për të formuar apo për t'iu bashkuar asociacioneve dhe në çështjen e bashkëpunimit ndërkomunal.

28. Në këtë drejtim, *Amicus Curiae* Istrefi ka vlerësuar dispozitat juridike të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë, i cili rregullon çështjen e asociacioneve të komunave, parashikon që ato "*mund t'u ofrojnë anëtarëve të tyre një numër shërbimesh, duke përfshirë trajnimin, ngritjen e kapaciteteve, ndihmën teknike dhe hulumtimin në kompetencat komunale dhe rekomandimet politike, në pajtim me ligjin*".

29. Në lidhje me këtë, *Amicus Curiae* Istrefi ka marrë si shembull "*Asociacioni Kombëtar i Komunave në Republikën e Bullgarisë ka të drejtë '[të përfaqësojë dhe të mbrojë] interesat e pjesëtarëve të tyre pranë Kuvendit Nacional, Presidentit të Republikës së Bullgarisë, Këshillit të Ministrave, ministrive dhe agjencive të qeverisë qendrore, aktivitetet e të cilave kanë ndikim në qeverinë lokale*". Megjithatë, sipas *Amicus Curiae* Istrefi, "*një rol i tillë përfaqësimi i këtyre llojeve të asociacioneve megjithatë nuk shtrihet aq sa të ketë të drejtë të themelojë njësi të vetëqeverisjes të autorizuara për të kryer funksione publike*".

30. Për më tepër, *Amicus Curiae* Istrefi thekson se "*aktivitetet e asociacionit të komunave pra nuk reduktojnë ose nuk zëvendësojnë aranzhimet kushtetuese dhe ligjore të bashkëpunimit dhe të mbikëqyrjes së komunave nga ana e autoritetit qendror*".

31. Përkitazi me çështjen e bashkëpunimit ndërkomunal, *Amicus Curiae* Istrefi i referohet Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, e cila në nenin e saj 10.1 parashikon se *"bashkësitë vendore kanë të drejtë gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre të bashkëpunojnë dhe, brenda ligjit, të bashkohen me bashkësi të tjera vendore për të realizuar detyrat me interes të përbashkët"*.

32. Në këtë drejtim, *Amicus Curiae* Istrefi është i mendimit se "*bashkëpunimi ndërkomunal ka 'detyra operacionale dhe bashkërendimi... Detyrat operacionale i referohen prodhimit të përbashkët të shërbimeve publike... Detyrat e bashkërendimit i referohen rregullimit të aspekteve të jashtme të politikave lokale dhe alokimit të resurseve dhe shpenzimeve që është racionale nga perspektiva supralokale'*".

33. Më tej, në parashtresën e tij, *Amicus Curiae* Istrefi i referohet Kushtetutës së Belgjikës, që në nenin 162.4 *"... parashikon mundësinë për autoritetet lokale që, nëse dëshirojnë, të ushtrojnë bashkërisht funksionet publike në fusha të caktuara me interes të përbashkët. Mbi këtë bazë, komunat belge kanë themeluar një entitet që quhet Intercommunale për kryerjen e shërbimeve të caktuara publike në fushat që përfshijnë por që nuk kufizohen në mbledhjen e mbeturinave, në distribuimin e ujit dhe të gazit. Kjo formë e bashkëpunimit ndërkomunal mund të shtrihet në fusha të tjera të shërbimit publik nëse nuk është e kufizuar me Kushtetutë ose me ligj"*. Kësisoj, *"bashkëpunimi ndërkomunal mund të ushtrojë funksione të caktuara ekzekutive"*. Megjithatë, *"nuk shtrihet deri te krijimi i një njësie të re të vetëqeverisjes që ushtron funksione publike në mënyrë të pavarur dhe pa qenë e kontrolluar nga anëtarët e saj"*.

34. Si përfundim, *Amicus Curiae* Istrefi thekson se *"një organ i themeluar për qëllime të bashkëpunimit ndërkomunal është i formuar nga komunat dhe operon për to. Kësisoj, komunat ia delegojnë kompetencat dhe resurset e tyre këtij organi. Për më tepër, komunat nuk mund të delegojnë kompetenca që me Kushtetutë dhe me ligj duhet të ushtrohen vetëm nga organe komunale të zgjedhura në mënyrë demokratike"*. Përveç kësaj, *"... pasi që organet ndërkomunale formohen për të kryer funksione dhe shërbime të caktuara komunale, qeveria qendrore vazhdon të monitorojë dhe të rishikojë punën e organeve të tilla përmes ligjeve dhe parimeve të vetëqeverisjes lokale"*.

35. Më tej, në parashtresë, *Amicus Curiae* Istrefi jep mendimin e tij lidhur me dispozitat që janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

36. Në këtë drejtim, në parashtresën e tij theksohet se Kushtetuta njeh të drejtën e bashkëpunimit ndërkomunal dhe kjo garantohet me nenin 123.3 të Kushtetutës, që përveç kësaj *"... merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale"*.

37. Për më tepër, *Amicus Curiae* Istrefi i referohet nenit 123.4 që parashikon se *"vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke i kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre"*.

38. Në lidhje me këtë, *Amicus Curiae* Istrefi thekson: *"Përmes formës së bashkëpunimit ndërkomunal, Asociacioni/Bashkësia mund të kryejë së paku funksionet sipas paragrafëve a, g, h, i, j, k, l, m të nenit 4 për Parimet e përgjithshme"*.

39. Sidoqoftë, ai thekson se *"kjo nuk do të thotë se organi ndërkomunal mund të ushtrojë kontroll mbi ato fusha në formën e njësisë së veçantë të vetëqeverisjes. Siç u tha më lart, e drejta për bashkëpunim ndërkomunal nuk përfshin transferim të përhershëm apo humbje të kompetencave"*.

40. *Amicus Curiae* Istrefivazhdon parashtresën e tij duke dhënë mendimin e tij lidhur me dispozitat që nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

41. Në këtë kuptim, *Amicus Curiae* Istrefi thekson se disa "*nga dispozitat e Parimeve të përgjithshme, në formulimet e tyre eksplicite ose të dykuptimshme, ngrenë shqetësime kushtetuese dhe nuk janë në harmoni, inter alia, me nenin 12, me Kapitullin X, me nenin 113 dhe me frymën e Kushtetutës së Kosovës"*.

42. Në lidhje me këtë, *Amicus Curiae* Istrefi është i mendimit se termi 'entitet ligjor' i 'karakterit të veçantë', i paraparë në pikën 2, po ashtu mund të nënkuptojë njësi të veçantë vetëqeverisëse të autorizuar për të ushtruar funksione publike. Rrjedhimisht, *"një dallim i tillë dhe formë më e lartë e vetëqeverisjes tejkalon kufijtë e konceptit të asociacionit apo të bashkëpunimit ndërkomunal, të paraparë me Kushtetutën e Kosovës"*.

43. Më tej, *Amicus Curiae* Istrefi thekson se pikat 2 dhe 15 të Parimeve të Përgjithshme mund të jenë në mospërputhje me nenet 124.4 dhe 12.2 të Kushtetutës, pasi që, sipas këtyre dispozitave kushtetuese, *"... vetëm ligji mund të rregullojë çështjet e bashkëpunimit ndërkomunal"*.

44. Gjithashtu, *Amicus Curiae* Istrefi shpreh vërejtjet e tij lidhur me terminologjinë e përdorur në pikën 4 të Parimeve të Përgjithshme, posaçërisht me frazën "ushtron vështrim të plotë" (exercise full overview), që, sipas tij, është i paqartë dhe nuk mund të gjendet në literaturën juridike, apo në jurisprudencë, dhe *"nuk paraqitet në bazën e të dhënave të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian apo në ndonjë tekst tjetër ligjor në internet"*.

45. *Amicus Curiae* Istrefivazhdon parashtresën e tij duke theksuar se pika 8 e Parimeve të Përgjithshme *"... në Asociacionin/Bashkësinë në një nivel horizontal bashkëpunimi me qeverinë qendrore. Kjo nga ana e saj i ngjan një forme konfederate ku njësitë territoriale bashkëpunojnë në nivel horizontal në bazë të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe ndarjes së informatave. Asnjë formë e vetëqeverisjes lokale apo edhe e vetëqeverisjes rajonale nuk njeh një marrëdhënie të*

tillë horizontale me autoritetet qendrore". Rrjedhimisht, sipas mendimit të tij, kjo mund të jetë në mospërputhje me nenin 93.6 që i jep mandatin Qeverisë së Kosovës *"... për të udhëzuar dhe për të mbikëqyrur punën e organeve të administratës"*.

46. Më tej, *Amicus Curiae* Istrefi shpjegon se pika 11 e Parimeve të Përgjithshme është në kundërshtim me nenin 113 të Kushtetutës, që rregullon çështjen e palëve të autorizuara për parashtrimin e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese. Kështu, sipas mendimit të tij, *"Asociacioni/Bashkësia si organ që ushtron funksione publike nuk kualifikohet as si individ për të iniciuar raste para Gjykatës Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës"*.

47. Përveç kësaj, *Amicus Curiae* Istrefi nënvizon se pamundësia për ta lënë Asociacionin/Bashkësinë, siç është përcaktuar në pikën 17 të Parimeve të Përgjithshme, mund *"të ngre një brengë kushtetuese të vetëqeverisjes rajonale duke qenë se komuna të caktuara mund të jenë të parapërcaktuara t'i përkasin një strukture të tillë"*.

48. Përfundimisht, *Amicus Curiae* Istrefi konkludon parashtresën duke theksuar se *"vlerësimi i kushtetutshmërisë së Parimeve të Përgjithshme nuk do duhej të rezultonte me vlerësim indirekt të Marrëveshjes së Parë për normalizimin e marrëdhënieve"*, përkundër faktit se dispozita të caktuara të Parimeve të Përgjithshme mund të mos jenë identike, por janë të ndërlidhura. Në këtë drejtim, sipas tij, *"... duhet të jetë e vetëdijshme se vlerësimi i Parimeve të Përgjithshme mund të rezultojë me vlerësim indirekt të Marrëveshjes. Kjo pastaj mund të çojë në shkelje, nga ana e Kosovës, të detyrimeve nga marrëveshja e ratifikuar"*.

49. *Amicus Curiae* Istrefie përfundon parashtresën e tij duke nënvizuar dallimet ndërmjet Marrëveshjes së Parë dhe Parimeve të Përgjithshme. Në këtë drejtim, ai thekson se *"për dallim nga Parimet e përgjithshme, Marrëveshja nuk e definon Asociacionin/Bashkësinë si një 'entitet ligjor' të 'karakterit të veçantë'; nuk parasheh themelimin e tij me dekret të Qeverisë; dhe nuk specifikon burimet, buxhetin, administratën dhe kompetencat që përmbajnë Parimet e përgjithshme. Në vend të kësaj, ajo parasheh se kompetencat e Asociacionit do të ushtrohen në pajtueshmëri me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje lokale dhe se strukturat e Asociacionit/Bashkësisë do të formohen në po të njëjtën bazë si statuti ekzistues i Asociacionit të Komunave të Kosovës"*.

Amicus Curiae e dorëzuar nga z. Dastid Pallaska

50. Më 1 dhjetor 2015, z. Dastid Pallaska (në tekstin e mëtejmë: *Amicus Curiae* Pallaska) ka dorëzuar parashtresën e tij *Amicus Curiae*, duke dhënë përgjigje në pyetjet e ngritura nga Gjykata në ftesën e 13 nëntorit 2015.

51. *Amicus Curiae* Pallaska, në parashtresën e tij, fillimisht diskuton pranueshmërinë e kërkesës, duke analizuar dispozitat kushtetuese, që sipas tij janë të aplikueshme në këtë rast, konkretisht nenin 84, paragrafi 9, nenin 112 dhe nenin 113, paragrafët 2 dhe/ose 3 të Kushtetutës.

52. Në këtë drejtim, *Amicus Curiae* Pallaska është i mendimit se *"... Presidenti nuk ka autoritet të gjerë dhe të pakufizuar për të referuar çështje në Gjykatë, siç pretendohet në Kërkesë. Limitet e autoritetit të Presidentit për të referuar pyetje/çështje në Gjykatë [...]duhet të vlerësohen në bazë të qëllimit të veprimit kushtetues të iniciuar nga Presidenti"*.

53. Sipas*Amicus Curiae* Pallaska, neni84, paragrafi 9, i Kushtetutës i jep Presidentit mundësinë të ngrehë çështje kushtetuese të dy llojeve, konkretisht *"(i) veprim kushtetues që ka për qëllim kontestimin e një akti të caktuar juridik dhe/ose të një akti të vërtetë përkitazi me përputhshmërinë e tij me Kushtetutën, dhe (ii) veprim kushtetues që ka për qëllim sqarimin ose kërkim i një interpretimi të një dispozite të caktuar kushtetuese që është e ndërlidhur ngushtë me ushtrimin e kompetencave të mandatuara me Kushtetutë që i ka Presidenti"*.

54. Pas bërjes së këtij dallimi, *Amicus Curiae* Pallaska paraqet argumente që, sipas tij, e bëjnë nenin 113, paragrafët 2 dhe 3, të Kushtetutës të aplikueshëm në kërkesën e tanishme, por jo nenin 112 të Kushtetutës.

55. *Amicus Curiae* Pallaskaështë i mendimit se *"... për të parashtruar një kërkesë sipas nenit 113, paragrafët 2 dhe/ose 3, të Kushtetutës, nga Presidenti kërkohet vetëm që të shtrojë pyetje lidhur me atë nëse akti i kontestuar është në përputhje me Kushtetutën. Në të vërtetë, sipas nenit 29 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, një kërkesë e parashtruar sipas nenit 113, paragrafi 2, të Kushtetutës, duhet vetëm (i) të specifikojë nëse çështja e përputhshmërisë ka të bëjë me tërë aktin apo me një pjesë të tij; dhe, (ii) të identifikojë dispozitat e Kushtetutës me të cilat akti i kontestuar mund të mos jetë në përputhje. Rrjedhimisht, mund të arrihet në përfundimin se Presidenti – madje edhe kur vepron në bazë të nenit 113, paragrafi 2 dhe/ose 3, të Kushtetutës – mund të kontestojë një akt thjesht vetëm duke shtruar pyetje lidhur me përputhshmërinë e aktit të kontestuar me Kushtetutën dhe duke identifikuar dispozitat kushtetuese me të cilat akti i kontestuar mund të mos jetë në përputhje"*.

56. Nga ana tjetër, sipas *Amicus Curiae* Pallaska, neni 112 i Kushtetutës bëhet relevant atëherë kur Presidenti ngreh çështje kushtetuese në Gjykatë *"... me qëllim të sigurimit që veprimet e Presidentit, gjatë ushtrimit të fuqive të mandatuara me Kushtetutë, janë në përputhje dhe në harmoni me Kushtetutën. Duke kërkuar udhëzim lidhur 'çështje kushtetuese' sipas dispozitave të mësipërme kushtetuese, Presidenti është jo vetëm në gjendje të parandalojë çfarëdo shkelje të Kushtetutës gjatë ushtrimit të detyrave por edhe të demonstrojë që çfarëdo shkelje e paqëllimtë e Kushtetutës të mos rezultojë me 'shkelje serioze' në kuptim të nenit 113, paragrafi 6, të Kushtetutës".*

57. Më tej, *Amicus Curiae* Pallaska përkufizon çështjen kushtetuese në kërkesën e tanishme, duke iu referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës, më konkretisht Aktgjykimit në rastin KO103/14, *"... në të cilin Gjykata vlerësoi pajtueshmërinë e nenit 84, paragrafi 14, me nenin 95 të Kushtetutës. Në këtë rast, Gjykata konstatoi se pasi që kërkesa ngrehte çështje kushtetuese lidhur me dispozita konkrete kushtetuese (neni 84, paragrafi 14, dhe neni 95 i Kushtetutës), pyetjet e parashtruara nga Presidentja 'janë të natyrës kushtetuese'".*

58. Megjithatë, *Amicus Curiae* Pallaska thekson se rasti KO103/14 është marrë vetëm si shembull, ku është vendosur testi për përkufizimin e çështjes kushtetuese, por ai *"... nuk mund të shërbejë si precedent për këtë Kërkesë pasi që, në rastin e tanishëm, Presidentja nuk ka kërkuar 'interpretim' të Kushtetutës, siç ka bërë në Kërkesën KO103/14, porse ka kërkuar vlerësim të pajtueshmërisë së Parimeve të përgjithshme, si akt specifik dhe i pavarur, me Kushtetutën. Duke u bazuar nga sa u tha më lart, mund të arrihet në përfundimin se Kërkesa nuk mund të shpallet e pranueshme në bazë të nenit 84, paragrafi 9, në lidhje me nenin 82 dhe nenin 112 të Kushtetutës".*

59. Më tej, *Amicus Curiae* Pallaska elaboron lidhur me meritat e kërkesës, duke nënvizuar se *"e drejta e komunave për të pasur bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar, në pajtim me ligjin, garantohet me nenin 124, paragrafi 4, të Kushtetutës. Kështu, pra, një bashkëpunim i tillë ndërkomunal dhe ndërkufitar bazohet në interesat e përbashkëta të komunave që kanë të bëjnë me kompetencat e tyre të mandatuara me Kushtetutë dhe me ligj".*

60. Gjithashtu, ai i referohet edhe dispozitave të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, më konkretisht nenit 10, paragrafi 1, që përcakton se "*bashkësitë vendore kanë të drejtë gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre të bashkëpunojnë dhe, brenda ligjit, të bashkohen me bashkësi të tjera vendore për të realizuar detyrat me interes të përbashkët".*

61. Megjithatë, *Amicus Curiae* Pallaska, është i mendimit se kategoria e përkatësisë etnike, siç shihet nga vetë titulli i Parimeve të Përgjithshme, nuk mund të jetë në interesin e përbashkët të komunave. *"... Kjo për faktin se 'përkatësia etnike' nuk hyn në sferën e kompetencës ose funksionit komunal mbi bazën e të cilit komunat mund të kërkojnë bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar sipas nenit 124, paragrafi 4, të Kushtetutës dhe sipas nenit 10, paragrafi 1, të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale"*. Prandaj,sipas *Amicus Curiae* Pallaska, *"...përdorimi i frazës 'komuna me shumicë serbe' në titullin dhe në tekstin e Parimeve të Përgjithshme duhet të shpallet si e papajtueshme me nenin 3, paragrafi 1, dhe me nenin 124, paragrafi 4, të Kushtetutës, si dhe me nenin 10, paragrafi 1, të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale"*.

62. Pa marrë parasysh nga sa u tha më lart, *Amicus Curiae* Pallaska thekson se Kushtetuta dhe ligji i aplikueshëm relevant, gjegjësisht Ligji për vetëqeverisjen lokale *"... ofrojnë bazë të mjaftueshme për themelimin e një asociacioni të komunave që kanë një sërë kompetencash që i dallojnë ato nga komunat tjera"*, duke ofruar një analizë se si dispozita të veçanta juridike mundësojnë themelimin dhe rregullimin e një asociacioni të tillë.

63. Më tej, *Amicus Curiae* Pallaska ofron një analizë të "*karakterit ekzekutiv të fuqive dhe kompetencave të Asociacionit/Bashkësisë",* duke ngritur çështje potenciale që mund të hasen gjatë implementimit të Parimeve të Përgjithshme.

64. Në këtë aspekt, në parashtresën e tij thuhet se *"ofrimi i funksioneve dhe shërbimeve publike nga Asociacioni/Bashkësia, siç parashihet me nenin 4 të Parimeve të Përgjithshme, përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 123 të Kushtetutës, ku parashihet: (2) 'Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë'"*.

65. Për më tepër, *Amicus Curiae* Pallaska thotë se *"neni 4 i Parimeve të Përgjithshme nuk është në pajtueshmëri me nenin 124, paragrafi 1, të Kushtetutës, pasi që përcakton Asociacionin/Bashkësinë si një njësi shtesë të vetëqeverisjes lokale, mbi komunat. Duhet gjithashtu të theksohet se themelimi i Zyrës për ankesa, sipas nenit 7, paragrafi (f), të Parimeve të përgjithshme, tejkalon fushëveprimin e vlerësimit që autoritetet qendrore mund të ushtrojnë mbi aktet komunale, duke vepruar në domenin e tyre, të paraparë me nenin 124, paragrafi 7, të Kushtetutës"*.

66. Një çështje tjetër që e ngrit *Amicus Curiae* Pallaska është *"mosnjohja e të drejtës së komunave për ta lënë Asociacionin/Bashkësinë"*, e që, sipas tij, *"... përbëjnë shkelje të nenit 44 të Kushtetutës, siç zbatohet me nenin 3, paragrafi 2, të Ligjit për Lirinë e Asociimit. Përveç kësaj, dështimi i Parimeve të Përgjithshme për t'u dhënë anëtarëve të tij në mënyrë eksplicite të drejtën për ta lënë Asociacionin/Bashkësinë sugjeron se kjo organizatë është një organ i detyrueshëm ekzekutiv dhe, si i tillë, paraqet një shtresë shtesë të vetëqeverisjes në Kosovë, mbi komunat"*.

67. Përveç kësaj, *Amicus Curiae* Pallaskaështë i mendimit se delegimi i funksioneve shtesë Asociacionit/Bashkësisë nga autoritetet qendrore, siç është paraparë me nenin 5 të Parimeve të Përgjithshme, i cili parasheh se Asociacioni/Bashkësia do të *"ushtrojë edhe kompetenca tjera shtesë, të cilat mund t'i delegohen nga autoritetet qendrore"*, është në shkelje të neneve 123 dhe 124 të Kushtetutës.

68. Për më tepër, *Amicus Curiae* Pallaska konsideron se dhënia e së drejtës për të ndërmarrë iniciativë legjislative dhe për të qenë palë para Gjykatës, siç është paraparë me nenin 10, respektivisht me nenin 11 të Parimeve të Përgjithshme, ngrit çështje kushtetuese. Sipas mendimit të tij *"... siç edhe mund të dëshmohet, neni 79 i Kushtetutës nuk e njeh Asociacionin/Bashkësinë si një palë që mund të ndërmarrë iniciativa legjislative. Rrjedhimisht, mund të konkludohet se neni 10 i Parimeve të Përgjithshme jo vetëm që paraqet shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 79 të Kushtetutës por aplikimi i tij, në fakt, kërkon amandamentimin e Kushtetutës"*. Përderisa, sa i përket të qenit palë para Gjykatës, ai thekson se *"...Kushtetuta në përgjithësi, dhe neni 113 i Kushtetutës në veçanti, nuk njeh Asociacionin/Bashkësinë si palë të autorizuar për të sjellë çështje kushtetuese/ligjore para Gjykatës. Rrjedhimisht, është e qartë se neni 11 i Parimeve të Përgjithshme jo vetëm se nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën por aplikimi i tij, në fakt, kërkon amandamentimin e Kushtetutës"*.

69. *Amicus Curiae* Pallaska, në parashtresën e vet, thekson se mundësia që Asociacioni/Bashkësia të posedojë ndërmarrje dhe të ofrojë shërbime lokale mund të ketë implikime kushtetuese dhe ligjore. Në të vërtetë, sipas mendimit të tij, *"...fakti se Parimet e Përgjithshme kërkojnë transferimin ose ndarjen e disa funksioneve kryesore komunale me Asociacionin/Bashkësinë dëshmon – më mirë se cilido argument tjetër – se Asociacioni/Bashkësia paraqet një organizatë me kompetenca ekzekutive e që është një njësi shtesë e vetëqeverisjes lokale, më e lartë se komunat. Rrjedhimisht, në bazë të analizave të lartpërmendura, mund të konkludohet se Asociacioni/Bashkësia do të pakësojë pushtetet dhe kompetencat e mandatuara me Kushtetutë të*

komunave që do t'i bashkohen asaj. Si të tilla, dispozitat e Parimeve të Përgjithshme, të specifikuara më lart, nuk janë në pajtueshmëri me dhe paraqesin shkelje të neneve 44, 79, 113, 123 dhe 124 të Kushtetutës".

70. Përveç kësaj, *Amicus Curiae* Pallaska ofron një analizë "*Shtrirja e punës së instrumenteve qeverisëse të Asociacionit të komunave sipas ligjeve të Kosovës",* duke u përqendruar në Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe në dispozitat e tij me të cilat rregullohen kompetencat dhe funksionet që ato parashohin për asociacione të tilla dhe krahasimin e Parimeve të Përgjithshme të Asociacionit/Bashkësisë me objektivat dhe me kompetencat e Asociacionit ekzistues të Komunave të Kosovës.

71. Lidhur me këtë, *Amicus Curiae* Pallaska është i mendimit se *"... Asociacioni/Bashkësia, që është paraparë të themelohet sipas Parimeve të Përgjithshme, është një njësi shtesë e vetëqeverisjes, e cila është autorizuar jo vetëm të ushtrojë mbikëqyrje ndaj komunave në ushtrimin e kompetencave të tyre të mandatuara me Kushtetutë, por, po ashtu mund t'u ofrojë funksione dhe shërbime publike banorëve të komunave që i janë bashkuar asaj. Rrjedhimisht, është e qartë se neni 4 dhe neni 7, paragrafi (f), i Asociacionit nuk janë në pajtueshmëri me nenet 123 dhe 124 të Kushtetutës".*

72. Në pjesën pasuese të kësaj parashtrese, *Amicus Curiae* Pallaska ofron analizën e statusit të të punësuarve të Asociacionit/Bashkësisë, ku ai konsideron se *"karakteri ekzekutiv i Asociacionit po ashtu konfirmohet nga fakti se neni 6, paragrafi (e), i Parimeve të Përgjithshme parasheh se statusi i punësimit të personelit të Asociacionit/Bashkësisë do të jetë në pajtueshmëri me, inter alia, Ligjin për shërbimin civil. Lidhur me këtë, duhet cekur se 'shërbimi civil' është kategori kushtetuese e mandatuar me nenin 101 të Kushtetutës... Kjo do të thotë se, sipas nenit 101 të Kushtetutës, 'shërbimi civil' është një krah ekzekutiv/administrativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes të cilit Qeveria ushtron 'pushtetin ekzekutiv në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe ligjin', siç është paraparë me nenin 92 paragrafin 2 të Kushtetutës".*

73. Rrjedhimisht, sipas*Amicus Curiae* Pallaska, dhënia e statusit të shërbyesve civil për të punësuarit e Asociacionit/Bashkësisë, është në kundërshtim me nenin 101 të Kushtetutës dhe shkel dispozitat relevante të Ligjit për shërbimin civil.

74. Më tej, A*micus Curiae* Pallaska analizon marrëdhëniet e Asociacionit/Bashkësisë me autoritetet qendrore, duke u fokusuar në nenin 8 të Parimeve të Përgjithshme, ku parashihet "*Asociacioni/Bashkësia do të punojë me autoritetet qendrore sipas*

parimit të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe shkëmbimit të informatave".

75. Lidhur me këtë, *Amicus Curiae* Pallaskaështë i mendimit se *"formulimi i dispozitës së lartcekur sugjeron se Asociacioni/Bashkësia ka marrëdhënie horizontale me autoritetet qendrore, duke përfshirë edhe Qeverinë e Kosovës. Si rezultat i kësaj, formulimi i përdorur në nenin 8 të Parimeve të Përgjithshme lë përshtypje se Asociacioni/Bashkësia është një organizatë që është e barabartë në zotësi para autoriteteve qendrore të Kosovës"*. Kësisoj, ai thekson se *"kjo formë e përfaqësimit të një komuniteti nuk parashihet me Kushtetutë. Rrjedhimisht, nenet 8 dhe 9 të Parimeve të Përgjithshme nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën"*.

76. Përfundimisht, *Amicus Curiae* Pallaska, në parashtresën e vet, përfshin vërejtjet e tij lidhur me themelimin e Asociacionit/Bashkësisë ku, sipas tij, Parimet e Përgjithshme parashohin procedurën e vlerësimit kushtetues para Gjykatës Kushtetuese, e cila është e ngjashme me procedurën e kontrollit preventiv të amendamentimeve kushtetuese.

77. *Amicus Curiae* Pallaska, në parashtresën e vet, përfundon duke ngritur çështje që kanë të bëjnë me gjuhë të dykuptimshme, e cila është përdorur në tekstin e Parimeve të Përgjithshme, e veçanërisht lidhur me versionet e gjuhës shqipe dhe serbe shprehja "kuvend themelues" që, sipas tij, nuk janë në harmoni njëra me tjetrën dhe si të tilla janë të pasakta dhe lajthitëse.

Përmbledhje e fakteve

78. Më 19 prill 2013, Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Serbisë nënshkruan "Marrëveshjen e Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë" (në tekstin e mëtejmë: Marrëveshja e parë ndërkombëtare).

79. Më 22 prill 2013, gjatë një seance të jashtëzakonshme të kërkuar nga Kryeministri, Kuvendi miratoi Rezolutën nr. 04-R-10 për dhënien e pëlqimit për nënshkrim të Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë (E publikuar në ueb-faqen e Kuvendit). Siç thuhet, sipas kësaj rezolute:

   c. *"Kuvendi i Kosovës shpreh përkrahje dhe jep pëlqimin për nënshkrimin e Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë*

Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë […]";

d. *"[…] Kuvendi i Kosovës mbështet zotimet e përmbajtura në këtë Marrëveshje […]".*

80. Më 28 maj 2013, Qeveria miratoi Vendimin Nr. 01/132, me të cilin "*aprovohet Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje*". Përveç kësaj, në pajtim me këtë vendim, Qeveria e procedoi projektligjin për shqyrtim dhe për miratim nga Kuvendi.

81. Më 27 qershor 2013, Kuvendi mbajti seancë plenare, ku u votua dhe u miratua Ligji për ratifikimin, nr. 04/L-199. Nga deputetët e pranishëm, 84 votuan për, 3 ishin kundër dhe 1 deputet abstenoi. Në të njëjtën ditë, Ligji për ratifikimin iu dërgua Presidentes së Republikës së Kosovës për shpallje.

82. Më 12 shtator 2013, me Dekretin nr. DL-050-2013, Presidentja e Republikës së Kosovës shpalli Ligjin për ratifikimin.

83. Marrëveshja e Parë Ndërkombëtare përmbante, *inter alia*, këto dispozita:

7. *"Do të krijohet një Asociacion/Bashkësi e komunave me shumicë serbe në Kosovë. Anëtarësimi do të jetë i hapur për çdo komunë tjetër me kusht që anëtarët janë në pajtim.*
8. *Bashkësia/Asociacioni do të krijohet përmes statutit. Shpërbërja e Bashkësisë/Asociacionit mund të bëhet vetëm me vendim të komunave pjesëmarrëse. Do të ofrohen garanci ligjore përmes ligjit të zbatueshëm dhe të drejtës kushtetuese (përfshirë rregullën për shumicën prej 2/3).*
9. *Struktura e Asociacionit/Bashkësisë do të themelohet mbi të njëjtën bazë sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të komunave të Kosovës, p.sh. Kryetari, Nënkryetari, Kuvendi, Këshilli.*
10. *Në përputhje me kompetencat e parapara me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjin e Kosovës komunat pjesëmarrëse do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre përmes Asociacionit/Bashkësisë në mënyrë kolektive. Asociacioni/Bashkësia do të ketë mbikëqyrje të plotë mbi fushat e zhvillimit ekonomik, arsimin, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural.*
11. *Asociacioni/Bashkësia do të ushtroj kompetenca të tjera shtesë siç mund të delegohen nga autoritetet qendrore.*

12. *Bashkësia/Asociacioni do të ketë rol përfaqësues te autoritetet qendrore dhe do të ketë një ulëse në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve për këtë qëllim. Në përmbushje të këtij roli është paraparë funksioni monitorues."*

84. Në kërkesë theksohet se, më 25 gusht 2015, Kryeministri i Republikës së Kosovës u pajtua me dokumentin e titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore".

Kërkesa e parashtrueses

85. Parashtruesja kërkon nga Gjykata që të përgjigjet në pyetjen vijuese:

"Duke marrë parasysh se Parimet e Asociacionit rregullojnë krijimin dhe funksionimin e Asociacionit së komunave me shumicë serbe në Kosovë, a janë në përputhshmëri këto parime dhe elemente me frymën e Kushtetutës, nenin 3, paragrafin 1 (natyra shumë-etnike), Kapitullin II (të drejtat dhe liritë themelore) dhe Kapitullin III (të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtareve të tyre) të Kushtetutës së Republikës se Kosovës?".

86. Parashtruesja argumenton:

"Parimet e Asociacionit, në formën e një akti juridik të miratuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, rregullojnë çështje që hyjnë në gamën e çështjeve që prekin frymën e Kushtetutës dhe çështjeve të përcaktuara me Nenin 3 (1), Kapitullin II dhe III, si në kuptim të natyrës shumetnike, të drejtave dhe lirive themelore, të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe gjithashtu edhe në kuptim të natyrës së institucioneve që rrjedhin nga Kushtetuta. Prandaj, zbatimi i detyrimeve të Parimeve të Asociacionit prodhon efekt juridik në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës. Me zotimin e Parimeve të Asociacionit, kjo çështje është e qartë se përbën ratione materie pasi që çështja e ngritur hyn në gamën e çështjeve kushtetuese duke reflektuar edhe nga [aktgjykimet] e Gjykatës Kushtetuese respektivisht rastet Nr. KO80/10 dhe Nr. KO103/14. Karakteristikë e kriterit të 'çështjes kushtetuese', tashmë e përcaktuar edhe me rastet e lartpërmendura, është që çështja të hyjë në fushëveprimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës si në kuptimin e shkronjës ashtu edhe të frymës.

Parimet e Asociacionit janë një dokument i nënshkruar nga Kryeministri dhe paraqesin zotimin e Qeverisë për të krijuar një entitet juridik që prodhon efekte juridike në rendin kushtetues të

Republikës së Kosovës. Parimet e Asociacionit rrjedhin nga 'Marrëveshja e parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve [...]' të ratifikuar nga [Kuvendi] i Republikës së Kosovës me Ligjin Nr. 04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë [...].

[...]

Nga autorizimi kushtetues i [parashtrueses] buron edhe e drejta e Kreut të Shtetit për të referuar çështje kushtetuese të cilat përndryshe nuk mund të referohen në bazë të nenit 113 paragrafët 2 dhe 3 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës. Kjo për arsye se ka akte juridike dhe rrethana që konsiderohen 'çështjet kushtetuese' por që formalisht nuk mund të referohen pranë Gjykatës Kushtetuese sepse nuk e kanë formën e ligjit, dekretit, rregulloreve apo statutit të komunës (sipas nenit 113 paragrafi 2 i Kushtetutës). I tillë është rasti me 'Parimet e Asociacionit', dokument i cili nuk është marrëveshje ndërkombëtare por legjislacion zbatues i një marrëveshjeje ndërkombëtare. 'Marrëveshja e parë ndërkombëtare' nuk është e ekzekutueshme vetvetiu dhe kërkon legjislacion shtese për zbatim.

[...]

Parimet e Asociacionit si akt i ndërmjetëm juridik, i cili rrjedh nga 'Marrëveshja e parë ndërkombëtare', shton elemente tjera në procesin e krijimit dhe vetë entitetin juridik (Asociacionin) dhe paraprin aktin themelues (dekretin e Qeverisë së Kosovës për themelim, sipas nenit 2 të Parimeve të Asociacionit), pra duke shërbyer si kushtëzim i aktit themelues. Duke marrë parasysh këto fakte, lind nevoja për një shqyrtim kushtetues të vet Parimeve të Asociacionit dhe përputhshmërisë së tyre me Kushtetutën".

Pranueshmëria e kërkesës

87. Për të qenë në gjendje të vendosë për kërkesën e parashtrueses, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

88. Neni 84 (9) i Kushtetutës [Kompetencat e Presidentit] përcakton:

"Presidenti i Republikës së Kosovës:

(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;"

89. Në përgjithësi, autoriteti i Presidentit të Republikës, nga neni 84 (9) i Kushtetutës për referim të çështjeve kushtetuese, duhet të kuptohet në lidhje me dispozitat e Kushtetutës që kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës që i përmban neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

90. Në këtë drejtim, neni 113.2 i Kushtetutës, parashikon:

"[...] Presidenti i Republikës së Kosovës [...] [është] autorizuar të ngrehë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;

(2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën".

91. Në kërkesën e tanishme, parashtruesja kërkon nga Gjykata të vlerësojë nëse parimet dhe elementet që i përmban dokumenti i quajtur *"Asociacioni/Komunat me shumicë serbe në Kosovë – Parimet e përgjithshme/elementet kryesore"* (Parimet) janë në përputhje me Kushtetutën.

92. Parashtruesja pohon se ky dokument është ose *"akt juridik i miratuar nga Kryeministri i Kosovës"* ose, alternativisht, *"një dokument i nënshkruar nga Kryeministri"*.

93. Gjykata vëren se dokumenti u draftua në tri gjuhë, prej të cilave versioni në gjuhën angleze u parafua.

94. Në përgjigje të kërkesës së Gjykatës, Kryeministri theksoi se "është nënshkruar" versioni në gjuhën angleze i dokumentit, por që Kryeministri konsideron se versioni në gjuhën shqipe është version origjinal dhe autentik i dokumentit.

95. Gjykata vëren se ky dokument (në tekstin e mëtejmë: Parimet) nuk është as ligj e as dekret i Presidentit ose i Kryeministrit, dhe as rregullore e Qeverisë, në kuptim të nenit 113.2, pika (1), të Kushtetutës. Për më tepër, ai nuk është as statut komunal, në kuptim të nenit 113.2, pika (2), të Kushtetutës.

96. Prandaj, parimet nuk hyjnë në fushëveprimin e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese siç parashihet me nenin 113.2 të Kushtetutës.

Ndaj, Gjykata nuk mund të shqyrtojë parimet si një akt juridik i renditur në nenin 113.2 të Kushtetutës.

97. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se ka praktikë gjyqësore ku asaj i ishte kërkuar nga Presidentja e Republikës që të interpretonte kuptimin e dispozitave specifike të Kushtetutës. Kjo është bërë për t'i ofruar udhëzime Presidentes në ushtrimin e detyrave të saj (shih, p. sh., rasti nr. KO103/14, *Presidentja e Republikës së Kosovës; Përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit], paragrafi 14, me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2014).

98. Gjykata vëren se Presidentja e Republikës kishte paraqitur kërkesë në Gjykatë, duke kërkuar interpretim të dispozitave të Kushtetutës. Gjykata ka vendosur se çështjet e tilla janë të natyrës kushtetuese dhe hyjnë në fushëveprimin e çështjeve kushtetuese, në kuptim të nenit 84 (9) të Kushtetutës (shih Aktgjykimin në rastin e sipërm KO103/14, paragrafët 26 dhe 27).

99. Në raste të tilla, juridiksioni i Gjykatës rrjedh nga neni 112 i Kushtetutës. Neni 112, paragrafi 1, përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën".*

100. Përderisa fushëveprimi i kërkesës së tanishme të parashtrueses përfshin një kërkesë që Gjykata të interpretojë një dispozitë specifike të Kushtetutës për vlerësimin e kushtetutshmërisë ose përputhshmërisë së Parimeve, Gjykata ka juridiksion për të shqyrtuar kërkesën. Kështu, Gjykata është autoriteti përfundimtar për të dhënë një interpretim në kuptim të nenit 112.1 të Kushtetutës.

101. Kur çështja ngrihet nga një palë e autorizuar, e cila konsideron se ajo përbën "çështje kushtetuese", kjo është çështje që i takon Gjykatës të vendosë. Gjykata vetë vendos nëse çështja e ngritur është një "çështje kushtetuese" dhe vendos për këtë nga rasti në rast. Jo çdo çështje që pretendon të ngrehë çështje kushtetuese mund të jetë *per se* çështje e tillë.

102. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton jurisprudencën e saj kur i ishte kërkuar të jepte interpretim në bazë të nenit 112.1 të Kushtetutës. Konkretisht, në kërkesën KO97/10, Gjykata shqyrtoi një çështje të ngritur sipas nenit 84 (9), që kërkonte një interpretim në bazë të nenit 112.1 të veprimeve të mundshme të Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës.

103. Në rastin e lartpërmendur, Gjykata konstatoi që, *"në përputhje me Nenin 112.1 të Kushtetutës, 'Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës' dhe për shkak të kësaj, nuk ekziston asnjë organ tjetër nga i cili parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë përgjigje në këto çështje kushtetuese. Gjykata është e mendimit se çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës janë 'çështje kushtetuese' të parapara në Nenin 84 (9) dhe që këto çështje të ngritura janë të përshtatshme për t'u shqyrtuar nga kjo Gjykatë".* (Shih rastin Nr. KO97/10, *Në çështjen e kërkesës së parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, Dr. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2010, §14).

104. Gjykata konsideron se çështjet e ngritura në kërkesën e tanishme janë të një rëndësie të madhe dhe relevante për rendin kushtetues të Kosovës. Për më tepër, nuk ka ndonjë institucion tjetër në Republikën e Kosovës ku do të mund t'i adresonte ato parashtruesja e kërkesës. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se neni 112.1 përcakton bazën e duhur kushtetuese për vlerësimin e përputhshmërisë së Parimeve me dispozitat relevante kushtetuese.

Fushëveprimi i kërkesës

105. Parashtruesja, ndër të tjera, pohon se "Parimet" përbëjnë një dokument të ndërmjetëm për implementimin e dispozitave të Marrëveshjes së Parë. Parashtruesja pohon se Parimet do të kenë efekt juridik në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës përmes akteve juridike pasuese që miratohen në bazë të Parimeve. Më tej, parashtruesja pohon se këto efekte juridike do të përfshijnë natyrën e institucioneve që burojnë nga Kushtetuta.

106. Gjykata rikujton vendimin e saj në rastin nr. KO98/11 (*Qeveria e Republikës së Kosovës, lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës*, Aktgjykimi i 20 shtatorit 2011), paragrafët 44 dhe 46, ku Gjykata ka gjetur se:

> *"44. Republika e Kosovës definohet nga Kushtetuta e vet si Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Ndarja e pushteteve është njëra prej bazave që garanton funksionim demokratik të shtetit. Esenca e funksionimit të pavarur dhe efektiv të këtyre degëve është imuniteti që u është dhënë njerëzve që i mishërojnë këto pushtete. [...]"*

> *"46. Këto çështje janë të një natyre kushtetuese pasi janë të lidhura me formën e qeverisjes së shtetit. Ato kanë të bëjnë me mekanizmat për ndarjen e pushtetit në Republikën e Kosovës."*

107. Në një mënyrë analoge, Gjykata konsideron se efektet juridike në institucione, të parapara me Marrëveshjen e Parë, kanë të bëjnë me formën e qeverisjes së shtetit, *inter alia*, në ndarjen e tij në vetëqeverisje lokale dhe qendrore. Përveç kësaj, pasojat juridike lidhur me implementimin e kësaj pjese të Marrëveshjes së Parë kanë ndikim në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, mënyra se si zbatohet Marrëveshja e Parë ka implikime për funksionimin demokratik të shtetit.

108. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se çështjet e dorëzuara nga parashtruesja janë të natyrës kushtetuese. Ato kanë për qëllim të sigurojnë që themelimi i Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe është në pajtim me shkronjën dhe me frymën e Kushtetutës.

109. Prandaj, Gjykata gjen se parashtruesja është palë e autorizuar për të dorëzuar kërkesën në kuptim të nenit 84 (9) të Kushtetutës. Gjithashtu, Gjykata gjen se ajo ka juridiksion për të shqyrtuar kërkesën si autoritet përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës në bazë të nenit 112.1 të Kushtetutës.

110. Nga sa u tha më lart, Gjykata konsideron se nuk ka baza për ta deklaruar kërkesën të papranueshme.

Meritat e kërkesës

111. Gjykata së pari do të marrë parasysh se cila është baza juridike për elaborimin e Parimeve dhe për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë.

112. Gjykata rithekson se Marrëveshja e Parë, në pikën 1, parashikon themelimin e Asociacionit/Bashkësisë, konkretisht: "*Do të krijohet një Asociacion/Bashkësi e komunave me shumicë serbe në Kosovë*". Më tej, Gjykata rikujton nenin 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], paragrafi 1, të Kushtetutës ku thuhet:

> *"Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. [...]".*

113. Marrëveshja e Parë u ratifikua si një marrëveshje ndërkombëtare më 27 qershor 2013 nga Republika e Kosovës përmes Kuvendit të saj dhe u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Kësisoj, kjo

marrëveshje ndërkombëtare, duke u bërë pjesë e sistemit të brendshëm juridik për t'u implementuar, kërkonte themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së lartpërmendur. Rrjedhimisht, themelimi i Asociacionit/Bashkësisë është në pajtueshmëri me kërkesën kushtetuese dhe, si e tillë, është pjesë e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Për më tepër, pika 2 e Marrëveshjes së Parë parashikon që Asociacioni "*të krijohet përmes statutit*".

114. Kërkesa ka të bëjë me Parimet sipas të cilave Asociacioni/Bashkësia do të themelohet siç është paraparë me pikën 1 të Marrëveshjes së Parë (shih Parimin # 1 të Parimeve).

115. Sipas fushëveprimit të kërkesës, pyetja së cilës duhet t'i përgjigjet Gjykata është nëse Parimet janë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe me kornizën e saj, më saktësisht me frymën e Kushtetutës dhe me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre]. Gjykata vëren se Parimet e parapara për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë ndërlidhen dhe ndërthuren me dispozita të tjera kushtetuese të cilat Gjykata do t'i marrë parasysh në vlerësimin e saj.

116. Gjykata do të vlerësojë Parimet, kapitull për kapitull, përkitazi me pajtueshmërinë e secilit kapitull me Kushtetutën dhe përkitazi me pajtueshmërinë e dispozitave specifike të secilit kapitull, që ndërlidhen me dispozitat kushtetuese. Në këtë mënyrë, vlerësimi i Parimeve do të bëhet në pajtim me standardet kushtetuese. Arsyetimi dhe konkluzionet e Gjykatës duhet të shërbejnë si bazë për elaborimin e aktit juridik dhe Statutit.

117. Gjykata e kupton se "*[...] Qeveria e Kosovës do të miratojë një dekret të aplikueshëm drejtpërdrejtë, i cili do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese*" (shih Parimin #2). Më pastaj, sipas Parimit #21, Statuti do të përgatitet nga një organ tjetër por do të konfirmohet me një akt juridik të Qeverisë. Për më tepër, çdo amendament në Statut do të konfirmohet me një akt juridik të Qeverisë dhe do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese. Prandaj, Gjykata konkludon se akti juridik i Qeverisë mund të inkorporojë Statutin dhe ky akt i përgjithshëm do të dorëzohet për shqyrtim nga Gjykata, do të thotë, akti juridik dhe Statuti (në tekstin e mëtejmë: akti juridik dhe Statuti).

118. Gjykata vëren se Statuti që do të elaborohet duhet të bazohet në kornizën e përcaktuar në kapitujt e Parimeve, *inter alia*, si një akt juridik i Qeverisë së Kosovës.

119. Gjykata Kushtetuese rithekson se ajo është autoriteti që interpreton Kushtetutën dhe vlerëson pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën kur i kërkohet asaj. Gjykata nuk është organ legjislativ dhe as organ për draftimin e normave ligjore dhe në këtë rast i takon Qeverisë që gjatë përgatitjes së aktit juridik për implementimin e Marrëveshjes së Parë lidhur me Asociacionin/Bashkësinë ta bëjë atë në pajtueshmëri me shkronjën dhe me frymën e Kushtetutës, *inter alia*, me dispozitat përkatëse kushtetuese.

Korniza ligjore

120. Kapitulli për Kornizën ligjore parashikon:

"(1) *Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë themelohet si një Asociacion/Bashkësi i komunave siç parashihet me Marrëveshjen e Parë, Ligjin mbi Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë dhc ligjet e Kosovës.*

(2) Në bazë të Marrëveshjes së Parë, e cila njeh karakterin e tij të veçantë Qeveria e Kosovës do të miratojë një dekret të aplikueshëm drejtpërdrejtë, i cili do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese. Bashkësia/ Asociacioni do të jetë entitet juridik, i definuar me statutin e tij, që do të përmbajë së paku elementet e mëposhtme:

3) Statuti do të aprovohet nga kuvendi themelues të cilin e përbëjnë anëtarët e zgjedhur me vota nga radhët e kuvendeve të komunave pjesëmarrëse".

121. Përkitazi me kapitullin për Kornizën ligjore të Parimeve, Gjykata vëren se ato i referohen burimeve ligjore të Asociacionit/Bashkësisë dhe përshkruajnë se themelimi i Asociacionit/Bashkësisë do të bëhet përmes një dekreti të Qeverisë së Kosovës, i cili do të vlerësohet nga Gjykata.

122. Përkitazi me miratimin e akteve të mëtejme juridike nga Qeveria, Gjykata rikujton nenin 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës, i cili ndër të tjera përcakton:

"Qeveria ka këto kompetenca:

[...]

(4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;

[...]"

123. Përkitazi me vlerësimin e pajtueshmërisë së akteve ligjore të Qeverisë së Kosovës me Kushtetutën, Gjykata rikujton nenin 113.2 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], i cili përcakton:

> *"2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:*
>
> > *(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;*
>
> *[...]"*

124. Gjykata gjen se kur kapitulli për Kornizën ligjore të Parimeve elaborohet në një akt juridik të Qeverisë së Kosovës, ai akt juridik duhet të jetë në pajtueshmëri me kompetencat e Qeverisë, siç definohet me nenin 93 të Kushtetutës. Për më tepër, ky akt juridik parashihet të jetë i aplikueshëm drejtpërdrejt dhe duhet të dorëzohet në Gjykatë për vlerësim të kushtetutshmërisë së tij. Prandaj, duhet të jetë në pajtueshmëri me juridiksionin e Gjykatës, siç definohet me nenin 113.2 të Kushtetutës.

125. Gjykata vëren më tutje se Asociacioni/Bashkësia do të definohet nga Statuti i vet. Ky statut do të miratohet nga një kuvend themelues, të cilin e përbëjnë anëtarët e zgjedhur nga kuvendet komunale të komunave pjesëmarrëse me shumicë serbe. Për më tepër, sipas dispozitave të përgjithshme dhe përfundimtare të Parimeve, Parimi #21, procedurat në drejtim të hartimit dhe të miratimit të këtij statuti janë të përcaktuara, duke përfshirë marrëdhënien ndërmjet Statutit dhe aktit juridik që do të miratohet nga Qeveria e Kosovës.

126. Nga Parimet del se akti juridik dhe Statuti do të përcaktojnë objektivat, strukturën organizative, kapacitetin ligjor, buxhetin dhe përkrahjen, dhe marrëdhëniet me autoritetet qendrore të Asociacionit/Bashkësisë.

127. Gjykata rikujton se neni 12 i Kushtetutës është bazamenti i vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës, dhe ai parashikon:

> *"1. Njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë komunat.*
>
> *2. Organizimi dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale rregullohen me ligj".*

128. Përkitazi me themelimin e asociacioneve nga komunat, Gjykata rikujton nenin 21.4 [Primet e Përgjithshme] të Kapitullit II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".*

129. Gjykata po ashtu rikujton nenin 44 [Liria e Asociimit] të Kushtetutës, i cili, ndër të tjera, përcakton:

> *"1. Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.*
>
> *[...]*
>
> *3. Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente".*

130. Gjykata më tej rikujton se Asociacioni/Bashkësia parashikohet me Marrëveshjen e Parë, *inter alia*, pika 3, që përcakton se "s*truktura e Asociacionit/Bashkësisë do të themelohet mbi të njëjtën bazë sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të Komunave të Kosovës, p.sh. Kryetari, Nënkryetari, Kuvendi, Këshilli*".

131. Kjo nënkupton që duhet të merren parasysh neni 12, neni 21.4 dhe neni 44, si dhe neni 124.4 i Kushtetutës.

132. Gjykata vëren se Asociacioni/Bashkësia, siç parashihet me Marrëveshjen e Parë dhe në Parime, duhet të jetë një organizatë në kuptim të nenit 44 të Kushtetutës.

133. Gjykata konsideron se Statuti duhet të miratohet nga një kuvend themelues, pra nga një takim themelues ose inaugurues, i përbërë nga përfaqësuesit e anëtarëve të vet, siç parashikohet në Parime.

134. Gjykata gjithashtu vëren se Asociacioni/Bashkësia parashikohet të jetë e përbërë nga komunat pjesëmarrëse me qëllim të avancimit të objektivave të caktuara.

135. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton nenin 124.4 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"4. Komunat kanë të drejtë për bashkëpunimin ndërkomunal dhe për bashkëpunimin ndërkufitar, në pajtim me ligjin."*

136. Nga sa u tha më lart, Gjykata konsideron se Parimet e përcaktuara në kapitullin mbi Kornizën ligjore nuk plotësojnë tërësisht standardet kushtetuese. Duke marrë parasysh se natyra e Asociacionit/Bashkësisë do të përcaktohet në këtë pjesë, akti juridik dhe Statuti duhen të jenë në pajtueshmëri me nenet 12, 21.4, 44, si dhe me nenin 124.4 të Kushtetutës.

Objektivat

137. Kapitulli për Objektivat parasheh:

> *"4) Në përputhje me Marrëveshjen e Parë, objektivat kryesore të Asociacionit/Bashkësisë do të jenë ofrimi i funksioneve dhe shërbimeve publike për:*
>
> *a) fuqizimin e demokracisë lokale;*
>
> *b) ushtrimin e vështrimit të plotë për zhvillimin e ekonomisë lokale;*
>
> *c) ushtrimin e vështrimit të plotë në fushën e arsimit;*
>
> *d) ushtrimin e vështrimit të plotë për përmirësimin e shëndetësisë lokale primare e sekondare dhe përkujdesjes sociale;*
>
> *e) ushtrimin e vështrimit të plotë për koordinimin e planifikimit urban dhe rural;*
>
> *(f) [nuk ka pikë f]*
>
> *g) aprovimin e masave për përmirësimin e kushteve lokale të jetesës për të kthyerit në Kosovë;*
>
> *h) zhvillimin, koordinimin, dhe lehtësimin e veprimtarive kërkimore dhe zhvillimore;*
>
> *i) promovimin, afirmimin, dhe avokimin e çështjeve me interes të përbashkët për anëtarët e tij dhe përfaqësimin e tyre, përfshirë tek autoritetet qendrore;*

j) ofrimin e shërbimeve për anëtarët e tij në përputhje me ligjet e Kosovës;

k) vlerësimin e ofrimit të shërbimeve publike për anëtarët e tij dhe për banorët e tyre me qëllim të përkrahjes së Bashkësisë/Asociacionit për formësimin e qëndrimeve me interes të përbashkët lidhur me pjesëmarrjen në Punën e autoriteteve qendrore;

l) monitorimin sipas nevojës të zbatimit të objektivave të tij;

m) vendosjen marrëdhënieve dhe hyrjen në aranzhime bashkëpunimi me asociacionet tjera të komunave, vendore dhe ndërkombëtare.

5) Bashkësia/Asociacioni [sic] do të ushtrojë edhe kompetenca tjera shtesë, të cilat mund t'i delegohen nga autoritetet qendrore".

138. Gjykata vëren se këto objektiva ngrenë çështje nga neni 12 [Pushteti Lokal] dhe nga Kapitulli X [Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial] i Kushtetutës.

139. Kapitulli X i Kushtetutës parasheh:

*"***Kapitulli X Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial**

Neni 123 [Parimet e Përgjithshme]

1. E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj.

2. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.

3. Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.

4. Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave

specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale]

1. Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

2. Themelimi i komunave, kufijtë, kompetencat dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre, rregullohen me ligj.
3. Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.

4. Komunat kanë të drejtë për bashkëpunimin ndërkomunal dhe për bashkëpunimin ndërkufitar, në pajtim me ligjin.

5. Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.

6. Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.

7. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin".

140. Gjykata konsideron se, në bazë të objektivave të definuara nga Parimet, themelimi i Asociacionit/Bashkësisë hyn në fushëveprimin e bashkëpunimit ndërkomunal në kuptim të neneve 12 dhe 124.4 Kushtetutës. Këto dispozita të Kushtetutës kërkojnë që çdo bashkëpunim ndërkomunal duhet të bëhet në pajtueshmëri me ligjin.

141. Gjykata vëren se kur Parimet të elaborohen në një akt juridik dhe Statut duhet të respektojnë dispozitat e legjislacionit me interes vital, në kuptim të nenit 81 të Kushtetutës.

142. Gjykata vëren se objektivat e Asociacionit/Bashkësisë kanë të bëjnë me *"ofrimin e funksioneve dhe shërbimeve publike"* dhe se disa objektiva të numëruara parashohin që Asociacioni/Bashkësia do të *"ushtrojë vështrimin e plotë",* posaçërisht në fushat e zhvillimit të

ekonomisë lokale, të edukimit, të kujdesit shëndetësor primar dhe sekondar, si dhe të planifikimit urban dhe rural.

143. Gjykata është e brengosur se kuptimi i termit në anglisht "ushtrimin e vështrimit të plotë" (exercise full overview) është dykuptimësh dhe nuk është konform me termat e përdorur në tekstin e Parimeve në gjuhën shqipe dhe as me ata në tekstin e Parimeve në gjuhën serbe. Gjykata vëren se termi në shqip i përdorur në Parime është "ushtrimin e vështrimit të plotë", i cili në anglisht përkthehet përafërsisht si "exercise of full view", e i cili është i ngjashëm me thjesht të observosh. Gjykata më tej vëren se termi në serbisht i përdorur në Parime është "obavljanje potpunog pregleda", i cili në anglisht përkthehet përafërsisht si "conduct a full review", e i cili është i ngjashëm me kryerjen e auditimit.

144. Gjykata vëren se Marrëveshja e Parë, në pikën 4, përdor gjuhën "*Asociacioni/Bashkësia do të ketë mbikëqyrje të plotë mbi fushat e zhvillimit ekonomik, arsimin, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural",* pra të jetë e informuar. Formulimi që do të përdoret në aktin e elaboruar juridik të Qeverisë duhet të jetë në pajtueshmëri me formulimin e Marrëveshjes së Parë, pika 4.

145. Kryeministri i Republikës së Kosovës, në letrën e tij të 19 nëntorit 2015, deklaroi se, edhe pse versioni i nënshkruar i Parimeve ishte versioni në anglisht, megjithatë, "*për delegacionin e Republikës së Kosovës, versioni gjuhësor origjinal dhe autentik, gjatë tërë procesit të negociatave, është konsideruar dhe pranuar versioni i parimeve, përkthyer në gjuhën shqipe, si gjuha e parë zyrtare e listuar në Republikën e Kosovës".*

146. Sa i përket kualitetit të gjuhës që duhet përdorur kur hartohen aktet ligjore, Gjykata kujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në Aktgjykimin në rastin e *Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Apl. Nr. 6538/74, GJEDNJ Aktgjykimi i 26 prill 1979, par. 49) Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *inter alia,* theksoi:

> *"49. Sipas mendimit të Gjykatës, këto janë dy nga kriteret që rrjedhin nga shprehja "parashikuar me ligj". Së pari, ligji duhet të jetë në mënyrë adekuate i qasshëm: qytetari duhet të ketë një tregues se ai është adekuat në rrethanat e rregullave ligjore të aplikueshme në rastin konkret. Së dyti, një normë nuk mund të konsiderohet si "ligj" përveç nëse është e formuluar me saktësi të mjaftueshme për të mundësuar qytetarin të rregullojë sjelljen e tij: ai duhet të jetë në gjendje – nëse është nevoja me këshillën e duhur*

– të parasheh, deri në një shkallë që është e arsyeshme në rrethanat, pasojat që një veprim i tillë mund të sjellë […]".

147. Ky aktgjykim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut specifikon se ligji duhet të jetë mjaftueshëm i qasshëm, preciz dhe i parashikueshëm në pasojat e tij, në mënyrë që të kualifikohet si "ligj". Prandaj, Gjykata gjen se kur elaborohen Marrëveshja e Parë dhe Kapitulli për Objektivat e Parimeve në akt juridik dhe në Statut, çfarëdo dykuptimësie në definicionin e objektivave të organizatës, të parapara me Parimet, do të qartësohen. Gjithashtu, duhet siguruar që secili version i gjuhëve zyrtare të aktit juridik dhe të Statutit të harmonizohet me versionet e tjera gjuhësore, ashtu që kuptimet e tyre të jenë identike, për aq sa është e mundur.

148. Për më tepër, Gjykata gjen se kur të elaborohen objektivat e Asociacionit/Bashkësisë në akt juridik dhe në Statut, ata duhet të ketë parasysh nenet 12, 81, 123 dhe 124 të Kushtetutës lidhur me statusin, objektivat dhe kompetencat e komunave. Konkretisht, akti juridik dhe Statuti i Asociacionit/Bashkësisë nuk duhet të zëvendësojnë ose minojnë statusin e komunave pjesëmarrëse si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale demokratike në kuptim të nenit 12 të Kapitullit X të Kushtetutës.

149. Nga sa u tha më lart, Gjykata konsideron se Parimet e përcaktuara në Objektiva nuk plotësojnë tërësisht standardet kushtetuese. Gjykata konsideron se objektivat e Asociacionit/Bashkësisë, si të definuara në aktin juridik dhe në Statut, duhet të garantojnë standardet kushtetuese për vetëqeverisje lokale lidhur me përgjegjësinë e komunave pjesëmarrëse dhe lidhur me marrëdhëniet e tyre me autoritetet qendrore në kuptim të neneve 124.6 dhe 124.7 të Kushtetutës. Objektivat duhet të sigurojnë përgjegjësinë e komunave pjesëmarrëse për ta respektuar Kushtetutën dhe ligjet dhe nuk duhet të anashkalojnë ose të shmangin rishikimin administrativ nga autoritetet qendrore.

Struktura organizative

150. Kapitulli i strukturës organizative parasheh:

6) Asociaconi/ Bashkësia do t'i ketë këto organe:

a. Kuvendin, si trup më të lartë, të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e emëruar nga kuvendet e komunave pjesëmarrëse, nga anëtarët e tyre të zgjedhur. Kuvendi do të ketë të drejtë të miratojë amendamentet e Statutit, rregulloren e punës dhe të

gjitha rregulloret dhe udhëzimet tjera administrative në pajtim me Statutin dhe ndërlidhur me objektivat e tij.

Të gjitha amendamentet e Statutit, rregullorja e punës dhe të gjitha rregulloret e nevojshme si edhe vendimet të cilat i miraton Kuvendi do të jenë të zbatueshme për anëtarët e tij, përveç në rast se ndonjëri nga anëtarët paraqet formalisht vendim tjetër.

b. Kryetari, i ciIi do ta përfaqësojë Bashkësinë/ Asociacionin, [sic] përfshirë tek autoritetet qendrore dhe jashtë Kosovës. Kryetarin do ta ndihmojë nën-kryetari. Kryetarin dhe nën-kryetarin do t'i zgjedhë Kuvendi, nga radhët e anëtarëve të Kuvendeve Komunale pjesëmarrëse, dhe te kryetarëve të komunave.

c) Këshilli i përbërë nga më së shumti 30 anëtare, banorë të komunave pjesëmarrëse, përfshirë të gjithë kryetarët e këtyre komunave; Këshilli është trup këshillëdhënës, i cili jep udhëzime për punën e Asociacionit/Bashkësisë.

d) Bordi i përbërë nga 7 anëtarë, të zgjedhur me votë nga Kuvend, nga radhët e kryetarëve dhe banorëve të komunave pjesëmarrëse, përbërja e saktë e të cilit do të definohet në Statut, do të ketë të drejtë të marrë vendime të nevojshme për menaxhimin ditor të Bashkësisë/Asociacionit [sic]. Anëtarët e Bordit gjatë punës së tyre, do te përkrahen nga kolegjiume profesionale të përbëra nga ekspertë të fushave përkatëse që përkojnë me objektivat dhe detyrat e Asociacionit/Bashkësisë. Statuti do të definojë numrin e kolegjiumeve profesionale dhe përgjegjësitë e tyre ndaj anëtarëve te Bordit.

e) Administrata, e udhëhequr nga Shefi i Administratës, i cili emërohet nga Bordi dhe i raporton Bordit për të ndihmuar punën e Bashkësisë/ Asociacionit, [sic] në veçanti Bordit dhe Kryetarit. Stafi i administratës do të përfitojë nga statusi i të punësuarve, në përputhje me ligjet e Kosovës, duke përfshirë Ligjin e Punës dhe Ligjin mbi Shërbimin Civil, të cilat ua mundësojnë të ushtrojnë detyrat e tyre administrative. Anëtarët e Asociacionit/Bashkësisë mund të vendosin të përdorin një numër të të punësuarve për të përkrahur Bashkësinë/Asociacionin në përmbushjen e objektivave të tij.

f) Zyra e ankesave, me mandat që të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me objektivat e tij.

7) Selia e Bashkësisë/Asociacionit [sic] do të përcaktohet me Statut".

151. Parimet në lidhje me strukturën organizative të Asociacionit/Bashkësisë duhet shqyrtuar sipas nenit 3 [Barazia Para Ligjit], sipas nenit 7 [Vlerat], sipas Kapitullit III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre], sipas nenit 57 [Parimet e Përgjithshme], paragrafi 1, sipas nenit 61 [Përfaqësimi në Punësim në Institucionet Publike], sipas nenit 62 [Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal], dhe sipas nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.

152. Këto nene të Kushtetutës parashohin:

"Neni 3 [Barazia para Ligjit]

1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 7 [Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

[...]

Kapitulli III Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre

Neni 57 [Parimet e Përgjithshme]

1. Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj

Kushtetute.

[...]

Neni 61 [Përfaqësimi në Punësim në Institucionet Publike]

Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë për përfaqësim të barabartë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë këtu veçanërisht në shërbimin policor në zonat e banuara me komunitetin përkatës, duke respektuar në të njëjtën kohë rregullat që kanë të bëjnë me kompetencën dhe integritetin e qeverisjes së administratës publike.

Neni 62 [Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal]

1. Në komunat në të cilat së paku dhjetë për qind (10%) të banorëve u përkasin komuniteteve, të cilat në ato komuna nuk janë shumicë, posti i zëvendëskryetarit për komunitete të kuvendit të komunës do të rezervohet për një përfaqësues nga radhët e këtyre komuniteteve.

2. Postin e zëvendëskryetarit do ta mbajë kandidati që i përket popullatës që nuk është shumicë, që ka marrë shumicën e votave në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje për kuvendin e komunës.

3. Zëvendëskryetari për komunitetet, do të promovojë dialog ndërmjet komuniteteve dhe shërben si pikë formale e kontaktit për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve që nuk janë shumicë në takimet e kuvendit të komunës dhe në punët e saj. Zëvendëskryetari gjithashtu është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave që parashtrohen nga komunitetet ose pjesëtarët e tyre, nëse aktet a vendimet e kuvendit të komunës shkelin të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë. Zëvendëskryetari këto çështje i'a referon kuvendit të komunës, për rishqyrtimin e aktit a të vendimit të marrë.

4. Në rast se kuvendi i komunës vendos që të mos rishqyrtojë aktin a vendimin e vet, ose nëse zëvendëskryetari vlerëson se, edhe pas rishqyrtimit rezultati përbën shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ai/ajo mund të parashtrojë çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, e cila mund të vendosë nëse do të pranojë ta shqyrtojë rastin përkatës.

5. Në këto komuna përfaqësimi në organin ekzekutiv për

komunitetet që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës është i garantuar.

Neni 101 [Shërbimi Civil]

1. Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.

2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës."

153. Gjykata vëren se parimet lidhur me strukturën organizative të Asociacionit/Bashkësisë ngrenë shqetësime lidhur me respektin për diversitetin e komuniteteve që banojnë në komunat pjesëmarrëse dhe reflektimin e këtij diversiteti në punësimin e stafit dhe në strukturat e Asociacionit/Bashkësisë, siç kërkohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

154. Gjykata rikujton se Marrëveshja e Parë, pika 3, përcakton strukturën e Asociacionit që do të themelohet mbi bazat e njëjta sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të Komunave të Kosovës, p. sh. Kryetari, Nënkryetari, Kuvendi, Këshilli.

155. Gjykata gjen se kur këto parime për strukturën organizative të Asociacionit/Bashkësisë të elaborohen në akt juridik dhe në Statut, ato do të sigurojnë respektimin e diversitetit të komuniteteve që banojnë në komunat pjesëmarrëse, në pajtueshmëri me nenet 3, 7, 57.1, 61, dhe 62 të Kushtetutës.

156. Gjykata vëren se Parimet definojnë që pjesëtarët e stafit në administratën e Asociacionit/Bashkësisë mund të përfitojnë nga statusi i punësimit në bazë të ligjeve të Kosovës, përfshi ose Ligjin e punës ose Ligjin për shërbimin civil.

157. Gjykata rikujton se neni 101 [Shërbimi Civil] i Kushtetutës hyn në Kapitullin VI [Qeveria e Republikës së Kosovës]. Si i tillë, shërbimi civil kuptohet si punësim në organe ose entitete qeveritare në kuptim të Kapitullit VI. Qëllimi i shërbimit civil mund të kuptohet duke iu referuar nenit 92.2 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit VI, gjegjësisht, *"2. Qeveria e Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin"*.

158. Punësimi në shërbimin civil dhe regjimi special ligjor që rregullon këtë punësim është rrjedhojë e qëllimit të shërbimit civil si organ administrativ, përmes të cilit Qeveria ushtron pushtetin ekzekutiv. Autoriteti i individëve të punësuar në shërbimin civil për të ushtruar funksione ekzekutive buron nga statusi në kuadër të organeve publike të administratës, i përcaktuar nga Qeveria.

159. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon që stafi i administratës së Asociacionit/Bashkësisë nuk duhet të konsiderohet *per se* pjesë e Shërbimit civil. Ata mund të përfitojnë nga statusi i Ligjit për shërbimin civil vetëm kur janë të punësuar në një pozitë në një organ publik të administratës së Qeverisë, në kuptim të nenit 101 të Kushtetutës.

160. Nga sa u tha më lart, Gjykata konsideron se Parimet e përcaktuara në kapitullin për Strukturën organizative nuk plotësojnë tërësisht standardet kushtetuese.

Marrëdhëniet me autoritetet qendrore

161. Kapitulli i Parimeve lidhur me marrëdhëniet me autoritetet qendrore parashikon:

> *"(8) Asociacioni/Bashkësia do të punojë me autoritetet qendrore sipas parimit të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe shkëmbimit të informatave.*
>
> *(9) Asociacioni/Bashkësia do të promovojë interesat e komunitetit serb të Kosovës ne raport me autoritetet qendrore.*
>
> *(10) Asociacioni/Bashkësia do të ketë të drejtë të propozojë, një përputhje me Ligjet e Kosovës, amendamentet e Legjislacionit dhe rregulloreve tjera relevante për përmbushjen e objektivave të tij.*
>
> *(11) Asociacioni/Bashkësia do të ketë të drejtë të iniciojë apo të marrë pjesë në procedurat gjyqësore në gjykatat kompetente, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, kundër çfarëdo akti apo vendimi të cilitdo institucion që ndikon në ushtrimin e kompetencave të Asociacionit/Bashkësisë, në përputhje me Statutin e tij.*
>
> *(12) Asociacioni/ Bashkësia do të ketë të drejtë të nominojë përfaqësues në organet/trupat kompetente të qeverisë qendrore, përfshirë Këshillin Konsultativ për Komunitete [sic]. Me qëllim të përmbushjes së funksionit monitorues, të paraparë me Marrëveshjen e Parë, përfaqësuesi i Asociacionit/Bashkësisë do të*

ketë të drejtë të ketë qasje në informatat e autoritetet qendrore, në përputhje me ligjet e Kosovës.

(13) Në emër të Asociacionit/Bashkësisë, katër kryetarët e komunave veriore do t'i ofrojnë Ministrisë së Brendshme një listë të kandidatëve për emërim si komandant i policisë rajonale, sic përcaktohet në Nenin 9 të Marrëveshjes së Parë":

162. Gjykata rikujton Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre], nenin 57 [Parimet e Përgjithshme], nenin 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre], në pikën (14), nenin 60 [Këshilli Konsultativ për Komunitete], nenin 79 [Nisma Legjislative], si dhe nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafët 4 dhe 7, të Kushtetutës.

163. Këto nene të Kushtetutës përcaktojnë:

"Kapitulli III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre]

Neni 57 [Parimet e Përgjithshme]

1. Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute.

2. Çdo pjesëtar i komunitetit do të ketë të drejtën që të zgjedhë lirisht nëse do të trajtohet ose të mos trajtohet si pjesëtar i komunitetit dhe nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që ndërlidhen me këtë zgjedhje, nuk do të rezultojë asnjë diskriminim.

3. Pjesëtarët e komuniteteve do të kenë të drejtë që të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë lirisht identitetin dhe atributet e tyre si komunitet.

4. Ushtrimi i këtyre të drejtave do të bartë me vete detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me ligjin e Republikës së Kosovës, dhe nuk i cenon të drejtat e të tjerëve.

Neni 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre]

1. Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet:

[...]

(14) të themelojnë shoqata të kulturës, artit, shkencës dhe arsimit, si dhe shoqata të studiuesve e shoqata të tjera për shprehjen, avancimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre.

Neni 60 [Këshilli Konsultativ për Komunitete]

1. Një Këshill Konsultativ për Komunitete vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës, në të të cilin përfaqësohen të gjitha komunitetet.

2. Këshilli Konsultativ për Komunitete përbëhet, përveç të tjerësh, nga përfaqësues të asociacioneve të komuniteteve.

3. Mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete përfshin:

(1) ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës;

(2) mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legjislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse;

[...]

Neni 79 [Nisma Legjislative]

Nismën për të propozuar ligje, mund ta marrë Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushëveprimtaria e saj/tij, Qeveria, deputetët e Kuvendit, ose më së paku dhjetëmijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Kapitulli VIII [Gjykata Kushtetuese]

Neni113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara

me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

164. Gjykata vëren se Kapitulli III i Kushtetutës ofron garanci specifike për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe, në nenin 57.1, definon komunitetet si "*banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës[...]*".

165. Për më tepër, Kapitulli III parashikon të drejtat specifike për të themeluar asociacione dhe ofrojnë përfaqësim në organet e qeverisë qendrore për qëllime të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve. Gjykata vëren se këto të drejta u jepen individëve dhe grupeve falë përkatësisë së tyre në një komunitet, në kuptim të nenit 57.1 të Kushtetutës. Si të tilla, Gjykata gjen se këto të drejta janë atribute të patjetërsueshme dhe të pacenueshme të këtyre komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

166. Kësisoj, Gjykata gjen se Asociacioni/Bashkësia nuk mund të vishet me autoritet të plotë dhe ekskluziv për të promovuar interesat e komunitetit serb të Kosovës në marrëdhëniet e tij/saj me autoritetet qendrore. Duhet theksuar se Asociacioni/Bashkësia hyn në fushëveprimin e përkufizimit të komunitetit, në kuptim të nenit 57.1 të Kushtetutës.

167. Gjykata gjen se kur të elaborohen Parimet përkitazi me marrëdhëniet e Asociacionit/Bashkësisë me autoritetet qendrore në një akt juridik dhe në Statut, ata duhet të sigurojnë që Asociacioni/Bashkësia të jetë në përputhje me dispozitat e Kapitullit III të Kushtetutës dhe të mos zëvendësojë ose të minojë autoritetin e cilitdo asociacion të komuniteteve të themeluar në kuptim të neneve 57, 59 (14) dhe 60.2 të Kushtetutës.

168. Gjykata vëren se neni 60.2 i Kushtetutës përcakton që *"Këshilli Konsultativ për Komunitete përbëhet, përveç të tjerësh, nga përfaqësues të asociacioneve të komuniteteve"*. Gjykata konsideron se përfshirja në këtë dispozitë e fjalëve *"përveç të tjerësh"* nënkupton që entitetet ose personat që nuk hyjnë në kuadër të përkufizimit "asociacione të komuniteteve" gjithashtu mund të bëhen anëtarë të Këshillit Konsultativ për Komunitete.

169. Gjykata po ashtu vëren se Marrëveshja e Parë, në pikën 6, i referohet anëtarësisë së Asociacionit/Bashkësisë në Këshillin Konsultativ për Komunitete, ku thuhet:

"Bashkësia/Asociacioni do të ketë rol përfaqësues te autoritetet qendrore dhe do të ketë një ulëse në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve për këtë qëllim. Në përmbushje të këtij roli është paraparë funksioni monitorues"

170. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se Asociacioni/Bashkësia mund të bëhet anëtar i Këshillit Konsultativ për Komunitete në bazë të nenit 60.2 të Kushtetutës dhe në bazë të Marrëveshjes së Parë.

171. Si anëtar i Këshillit Konsultativ për Komunitete, Asociacioni/Bashkësia mund të përfitojë nga e drejta për të sugjeruar nismë legjislative, në konsultim me komunitete të tjera, brenda fushëveprimit të mandatit të Këshillit Konsultativ për Komunitete, në kuptim të nenit 60.3 pika (2) të Kushtetutës.

172. Megjithatë, Gjykata rikujton se, në bazë të nenit 79 të Kushtetutës, e drejta për nismë legjislative i jepet ekskluzivisht Presidentit të Republikës së Kosovës, Qeverisë, deputetëve të Kuvendit ose, së paku, dhjetë mijë qytetarëve.

173. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se Asociacionit/Bashkësisë nuk mund t'i jepet e drejta të propozojë amendamente në legjislacion dhe në rregullore të tjera, siç thuhet në Parimin #10 të Parimeve.

174. Sa i përket Parimit#11 të Parimeve lidhur me të drejtat e Asociacionit/Bashkësisë për qasje në gjykatat e Republikës së Kosovës, Gjykata vëren se përkufizimi i palëve të autorizuara për të parashtruar kërkesa në Gjykatë rregullohet me nenin 113 të Kushtetutës. Autoriteti i Asociacionit/Bashkësisë për të parashtruar kërkesa duhet të jetë në përputhje me dispozitat e nenit 113 të Kushtetutës.

175. Gjykata rikujton nenin 21.4 të Kushtetutës, të cituar më lart. Neni 21.4 përcakton që personat juridikë po ashtu përfitojnë nga mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të tyre nga Kapitulli II i Kushtetutës. Gjykata gjithashtu rikujton praktikën e saj gjyqësore lidhur me qasjen në Gjykatë të personave juridikë që pretendojnë shkelje nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre të garantuara me Kushtetutë (shih, *AAB-RIINVEST kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 janarit 2010, paragrafi 14).

176. Gjykata gjen se Asociacioni/Bashkësia mund të iniciojë procedura në Gjykatën Kushtetuese vetëm kur Asociacioni/Bashkësia, si entitet me subjektivitet juridik, mund të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës.

177. Nga sa u tha më lart, Gjykata konsideron se Parimet e përcaktuara në kapitullin për Marrëdhëniet me autoritetet qendrore nuk plotësojnë tërësisht standardet kushtetuese.

Kapaciteti ligjor, buxheti dhe përkrahja dhe dispozitat e përgjithshme dhe përfundimtare

178. Kapitujt lidhur me kapacitetin ligjor, buxhetin dhe përkrahjen, dhe dispozitat e përgjithshme dhe përfundimtare parashikojnë:

"Kapaciteti ligjor

(14) Asociacionit/Bashkësisë do t'i ofrohet hapësira e nevojshme ligjore, sipas ligjeve të Kosovës, në mënyrë që të përmbushë objektivat e tij, përfshirë të drejtën e posedimit të pronës së luajtshme dhe të paluajtshme, të bashkëpronësisë së kompanive që ofrojnë shërbime lokale në kuadër të fushëveprimit të Asociacionit/Bashkësisë dhe të lidhë kontratë, përfshirë kontrata pune.

(15) Në bazë të Marrëveshjes së Parë, Asociacioni/Bashkësia konsiderohet i themeluar, pas miratimit të dekretit, për përmbushjen e objektivat e tij.

Buxheti dhe përkrahja

(16) Asociacioni/Bashkësia do ta ketë buxhetin e tij, i cili do të administrohet në përputhje me parimet e transparencës dhe llogaridhënies si dhe me dispozitat e Ligjit mbi Prokurimin Publik.
Këto parime posaçërisht do të vlejnë për dedikimin e fondeve, përfshirë ato të përshkuara në pikën 17d.
Do të ketë auditim të shpenzimeve nga autoritetet kompetente, përfshirë Auditorin e Përgjithshëm.

(17) Asociacioni/Bashkësia do të financohet nga:
a) kontributet e anëtarëve të tij;
b) të hyrat dhe të ardhurat nga shërbimet që i ofron Asociacioni/Bashkësia, kompanitë e tij, apo që do të burojnë nga asetet e tij të luajtshme dhe të paluajtshme;
c) transferet nga autoritet qendrore;
d) kontributet grantet donacionet si dhe përkrahja financiare e asociacioneve dhe organizatave tjera, vendore dhe ndërkombëtare, si edhe nga Republika e Serbisë; Bashkësia/Asociacioni do të lirohet nga detyrimet dhe taksat

për përmbushjen e objektivave të tij, sipas të njëjtit model me komunat pjesëmarrëse.

Dispozitat e përgjithshme dhe përfundimtare

(18) Asociacioni/Bashkësia do të jetë i hapur për çdo komunë tjetër, me kusht që të pajtohen anëtarët e tij.

(19) Asociacioni/Bashkësia mund të shpërbëhet vetëm me vendim të Kuvendit të tij, të miratuar me shumicë prej 2/3 e anëtarëve të tij.

(20) Asociacioni/Bashkësia do të ketë të drejtë t'i ketë simbolet zyrtare të tij (stemën dhe flamurin), në përputhje me ligjet e Kosovës.

(21) Statuti i Asociacionit/ Bashkësisë do të hartohet nga Ekipi Menaxhues dhe do të prezantohet në Dialogun e Nivelit të Lartë, brenda 4 muajve nga data e arritjes së marrëveshjes për këto parime/elemente, sipas nevojës, me lehtësimin e Ministrisë së Qeverisjes Lokale. Statuti do të konfirmohet me dekret, pas marrëveshjes në Dialog. Secili amendament do të prezantohet nga Asociacioni/Bashkësia, do të konfirmohet me dekret dhe do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.

(22) Brenda një viti nga aprovimi i Statutit te Asociacionit/Bashkësisë do të bëhet shqyrtimi i implementimit të tij, përfshirë çështjet që burojnë nga Neni 5 i Marrëveshjes së Parë".

179. Gjykata vëren se, në veçanti, Parimet lidhur me buxhetin dhe përkrahjen duhet të vlerësohen sipas neneve 124.5 dhe 137 të Kushtetutës. Këto nene parashikojnë:

"Neni124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale]

[...]

5.Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.

[...]

Neni 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës]

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës kontrollon:

(1) veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë;
(2) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal;
(3) veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të tjerë, tek të cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti".

180. Gjykata vëren se, në nenin 124.5, Kushtetuta parashikon transferet financiare nga qeveria qendrore te komunat dhe ua cakton komunave të drejtën të vendosin për shpenzimet e tyre. Mirëpo, Kushtetuta qëndron e heshtur lidhur me transferet te entitetet ose te organet e tjera të ndërlidhura me vetëqeverisjen lokale. Si të tilla, këto të drejta u takojnë ekskluzivisht komunave.

181. Gjykata gjen se kur të elaborohen Parimet përkitazi me financimin, buxhetin dhe shpenzimet e Asociacionit/Bashkësisë në një akt juridik dhe në Statut, ato duhet të sigurojnë që financimi dhe shpenzimet e Asociacionit/Bashkësisë janë në përputhje me nenin 124.5 të Kushtetutës. Kësisoj, akti juridik dhe Statuti duhet të sigurojnë financimin dhe shpenzimet e duhura të Asociacionit. Ato gjithashtu nuk duhet të zëvendësojë ose minojë të drejtat e komunave pjesëmarrëse për të pranuar dhe për të vendosur lidhur me shpenzimin e të hyrave komunale dhe financimin e duhur nga qeveria qendrore.

182. Gjykata vëren se Auditori i Përgjithshëm është i mandatuar me nenin 137 të Kushtetutës për të audituar institucionet publike dhe personat e tjerë juridikë shtetërorë, autoritetet qendrore dhe lokale, veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe të personave të tjerë juridikë, te të cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti. Prandaj, për të qenë Auditori i Përgjithshëm i mandatuar të kryejë auditime të Asociacionit/Bashkësisë, duhet të jetë brenda sferës së institucioneve, të autoriteteve ose të ndërmarrjeve të tilla publike, në kuptim të nenit 137.

183. Gjykata gjen se autoriteti i Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, për të kryer auditime të veprimtarisë ekonomike dhe të shfrytëzimit të fondeve publike nga Asociacioni/Bashkësia, është në

përputhshmëri me Kushtetutën. Ky është rasti kur auditimet e tilla janë brenda kompetencave të Auditorit të Përgjithshëm si shtrirje e natyrshme dhe logjike e auditimit të shfrytëzimit të fondeve publike nga ana e komunave pjesëmarrëse në kuptim të nenit 137 të Kushtetutës.

184. Lidhur me kapitullin e parimeve për "Dispozitat e përgjithshme dhe përfundimtare", Gjykata vëren se këto japin udhëzime të mëtejme procedurale për elaborimin dhe për implementimin e dispozitave të Marrëveshjes së Parë përkitazi me themelimin e Asociacionit/Bashkësisë. Në veçanti, parimi #21 jep detaje se si do të hartohet dhe negociohet Statuti, që Statuti do të konfirmohet me dekret, dhe se si do të propozohen amendamentet në Statut, për t'u konfirmuar pastaj me dekret dhe për t'iu nënshtruar shqyrtimit nga Gjykata.

185. Gjykata rikujton të gjeturat e saj më lart përkitazi me kapitullin e parimeve për "Kornizën ligjore". Gjykata konsideron se parimet procedurale që përmban kapitulli për "Dispozitat e përgjithshme dhe përfundimtare" duhet të harmonizohen me parimet procedurale që përmban kapitulli për "Kornizën ligjore".

186. Nga sa u tha më lart, Gjykata konsideron se Parimet e përcaktuara në kapitullin për kapacitetin ligjor, buxhetin dhe përkrahjen, dhe dispozitat e përgjithshme dhe përfundimtare nuk plotësojnë tërësisht standardet kushtetuese.

187. Për më tepër, Gjykata rithekson të gjeturën e saj se kur të elaborohen rregullat procedurale për amandamentimin e Statutit në një akt juridik dhe në Statut, ato duhet të jenë në përputhshmëri me kompetencat e Qeverisë, të përcaktuara në nenin 93 [Kompetencat e Qeverisë], pika (4), të Kushtetutës.

188. Në mënyrë që këto akte juridike të dorëzohen për shqyrtim nga Gjykata, siç parashihet me Parimet, ato duhet të jenë brenda fushëveprimit të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 2 (1), të Kushtetutës.

Përfundimet

189. Si përfundim, Gjykata gjen se

1. Parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar për të ngritur këtë kërkesë në Gjykatë në kuptim të nenit 84(9) në lidhje me nenin 112.1 të Kushtetutës;

2. Kërkesa është e pranueshme në kuptim të nenit 84 (9) në lidhje me nenin 112.1 të Kushtetutës;

3. Marrëveshja e Parë, e ratifikuar më 27 qershor 2013, parashikon themelimin e një Asociacioni/Bashkësie të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Gjithashtu ajo parashikon themelimin e këtij Asociacioni/Bashkësie me Statut. Përveç kësaj, ajo definon strukturën e Asociacionit/Bashkësisë ashtu që ajo të ndjekë të njëjtën bazë sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të Komunave të Kosovës. Për më tepër, komunat pjesëmarrëse kanë të drejtë të bashkëpunojnë përmes Asociacionit/Bashkësisë kolektivisht në bazë të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjeve të Kosovës. Asociacioni/Bashkësia do të ketë vështrim të plotë në fusha të veprimtarive të ndryshme. Gjithashtu, Asociacioni/Bashkësia do të ushtrojë kompetenca tjera të deleguara nga autoritetet qendrore. Kësisoj, themelimi i Asociacionit/Bashkësisë është bërë pjesë e sistemit të brendshëm juridik.

4. Parimet e elaboruara në "*Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore*" nuk janë tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

5. Elaborimi i Parimeve në një akt juridik dhe në Statut duhet të bëhet në pajtim me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe në veçanti me nenet 3, 7, 12, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], nenet 21 dhe 44, me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre], nenet 57, 59, 60, 61 dhe 62, si dhe me nenet 79, 81, 93, 101, 113, 123, 124 dhe 137 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kësisoj, këto Parime duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet kushtetuese të Republikës së Kosovës siç është arsyetuar në Aktgjykimin e Gjykatës.

6. Gjykata vëren se akti juridik dhe Statuti, si dhe amendamentet e tij, do të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 84 (9) në lidhje me nenin 112.1 të Kushtetutës, në mbështetje me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 56 (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 21 dhjetor 2015, me shumicë votash

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË që Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe do të themelohet, siç është paraparë me Marrëveshjen e Parë, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe shpallur nga Presidentja e Republikës së Kosovës;

III. TË KONSTATOJË që Parimet, siç janë elaboruar në "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore", nuk janë tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

IV. TË KONSTATOJË që akti juridik i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Statuti që implementon Parimet, për të qenë në pajtueshmëri me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit] paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duhet të plotësojnë standardet kushtetuese dhe duhet të jenë në pajtueshmëri posaçërisht me nenet 3, 7, 12, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], me nenet 21 dhe 44, me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre], me nenet 57, 59, 60, 61 dhe 62, si dhe me nenet 79, 81, 93, 101, 113, 123, 124 dhe 137 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, siç është arsyetuar në Aktgjykim;

V. TË VENDOSË që Masa e përkohshme, e vendosur më 10 nëntor 2015, përfundon me hyrjen në fuqi të këtij Aktgjykimi;

VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;

VII. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

VIII. TË DEKLAROJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

Mendim mospajtues i gjyqtarit Bekim Sejdiu në rastin KO130/15

I. Vërejtje të përgjithshme

Në rastin KO130/15, me shumicë votash, Gjykata vendosi:

> *A) TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;*
> *B) TË KONSTATOJË që Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe do të themelohet, siç është paraparë me Marrëveshjen e Parë, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe shpallur nga Presidentja e Republikës së Kosovës;*
> *C) TË KONSTATOJË që Parimet, siç janë elaboruar në "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore", nuk janë tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;*
> *D) TË KONSTATOJË që akti juridik i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Statuti që implementon Parimet, për të qenë në pajtueshmëri me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duhet të plotësojnë standardet kushtetuese dhe duhet të jenë në pajtueshmëri posaçërisht me nenet 3, 7, 12, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], me nenet 21 dhe 44, me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre], me nenet 57, 59, 60, 61 dhe 62, si dhe me nenet 79, 81, 93, 101, 113, 123, 124 dhe 137 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, siç është arsyetuar në Aktgjykim;*

.....

Përderisa ndaj pikëpamjen e shumicës për pranueshmërinë e kërkesës, me keqardhje dhe me gjithë respektin e duhur për shumicën e gjyqtarëve, mendimi im ndryshon rrënjësisht në arsyetim dhe në disa nga konkluzionet kyç të arritura nga Gjykata, që kanë të bëjnë me meritat e çështjes. Rrjedhimisht, nuk pajtohem me vendimin e arritur nga shumica e gjyqtarëve në rastin KO130/15. Mospajtimi im bazohet në dy arsye thelbësore. Së pari, unë jam i mendimit se me këtë vendim, Gjykata Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) nuk jep përgjigje të kuptueshme dhe të kënaqshme në pyetjen e parashtruar nga Presidentja nëpërmjet kërkesës KO130/15. Së dyti, shumica e gjyqtarëve kanë bërë disa interpretime dhe përfundime të gabuara, të cilat nuk ndihmojnë në parandalimin e konfuzionit të mëtejshëm kushtetues, përkitazi me çështjet e paqarta kushtetuese të ngritura në rastin KO130/15. Në këtë mënyrë, ky

vendim nuk jep udhëzime të domosdoshme autoritative për sqarimin e polemikave kushtetuese në lidhje me këtë rast.

II. Historiku

Kjo kërkesë është parashtruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Presidentja), në pajtim me nenin 83 dhe me nenin dhe 84, paragrafi 9, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Lënda e kësaj kërkese është interpretimi i pajtueshmërisë së Parimeve të Përgjithshme/Elementet Kryesore të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe (në tekstin e mëtejmë: Parimet e Asociacionit) me frymën e Kushtetutës, neni 3 (1), Kapitujt II dhe III të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në kërkesën e parashtruar nga Presidentja kërkohet në mënyrë specifike nga Gjykata që të adresojë çështjen e mëposhtme:

> *"Duke marrë parasysh se Parimet e Asociacionit rregullojnë krijimin dhe funksionimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë, a janë në përputhshmëri këto parime dhe elemente (sipas dokumentit origjinal të përmendur në Lëndën e këtij referimi) me frymën e Kushtetutës, nenin 3, paragrafin 1 (natyra shumë-etnike), me Kapitullin II (të drejtat dhe liritë themelore) dhe me Kapitullin III (të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtareve të tyre) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës?"*

III. Natyra juridike <u>e dokumentit</u> me titull: "Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e Përgjithshme/Elementet Kryesore"

Gjykata shmang përkufizimin e natyrës juridike të dokumentit me titull: "Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e Përgjithshme/Elementet Kryesore". Ky ngurrim formëson arsyetimin e shumicës përgjatë tërë vendimit, duke rezultuar kështu në një interpretim konfuz dhe të paqartë të natyrës së obligimeve që dalin nga ky "dokument".

Në kërkesë, parashtruesi përdor terminologji të përgjithshme për të përshkruar natyrën juridike të dokumentit me titull: "Parimet e Asociacionit". Kjo tregohet nga paragrafët e mëposhtëm, të cituar nga kërkesa:

> *"Parimet e Asociacionit, në formën e një <u>akti juridik</u> të miratuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës...*
>
> *[...]*

> *Parimet e Asociacionit janë <u>një dokument i nënshkruar nga Kryeministri</u> dhe <u>paraqesin zotimin e Qeverisë për të krijuar një entitet juridik</u> <u>që prodhon efekte juridike në rendin kushtetues</u> të Republikës së Kosovës…*
>
> *[…]*
>
> *… Parimet e Asociacionit, dokument i cili nuk është marrëveshje ndërkombëtare <u>por legjislacion zbatues i një marrëveshjeje ndërkombëtare</u>…*
>
> *[…]*
>
> *Parimet e Asociacionit, si <u>akt i ndërmjetëm juridik</u>, i cili <u>rrjedh nga Marrëveshja për normalizim</u>, <u>shton elemente të tjera</u> në procesin e krijimit dhe në vetë entitetin juridik (Asociacionin) dhe <u>paraprin aktin themelues (dekretin e Qeverisë së Kosovës për themelim</u>, sipas nenit 2 të Parimeve të Asociacionit), pra <u>duke shërbyer si kushtëzim i aktit themelues</u>".*

Përshkrimet e mësipërme shpërfaqin tri elemente për të përshkruar natyrën atipike juridike të dokumentit me titull "Parimet e Asociacionit". Së pari, dokumenti "Parimet e Asociacionit" është një akt juridik; së dyti, "Parimet e Asociacionit" është dokument që rrjedh nga "Marrëveshja e Parë" dhe ka për qëllim zbatimin e detyrimeve që përmbahen aty; dhe, së treti, "Parimet e Asociacionit" i shton element të ri obligimeve fillestare të parapara me "Marrëveshjen e Parë".

As terminologjia e përgjithshme juridike dhe as sistemi juridik i Republikës së Kosovës nuk parashohin ndonjë hapësirë konceptuale për të përkufizuar kuptimin e termit "akt i <u>ndërmjetëm</u> juridik". Por, situata qëndron ndryshe kur bëhet fjalë për përkufizimin e "aktit juridik", sepse një gjë e tillë është një përpjekje shumë e zakonshme doktrinare në teorinë dhe në praktikën juridike.

Një nga burimet më të shpeshta të përmendura doktrinare për përkufizimin e "aktit juridik" është libri i Hans Kelzen "Teoria e pastër e së drejtës".[1] Kelzen përcakton aktin juridik si "një akt me anë të të cilit nxirret një normë juridike (në kuptimin figurativ "krijohet") ose zbatohet". Më tej, Kelzen sqaron se "një akt është një akt-krijimi apo një akt-zbatimi i ligjit vetëm nëse korrespondon me normat që rregullojnë krijimin dhe zbatimin e ligjit në

[1] Hans Kelzen, *Teoria e pastër e së drejtës* (1960; Knight përkth.), Berkeley 1967, Union (N.J.) 2002.

kuadër të sistemit juridik, që është, vetëm nëse akti në fjalë bazohet në sistemin juridik".

Në këtë fazë, dokumenti Parimet e Asociacionit nuk i plotëson kriteret për t'u cilësuar si një marrëveshje ndërkombëtare - pavarësisht ngjashmërive (p. sh., teksti i dokumentit është dakorduar në një proces politik ndërkombëtar dhe është bërë autentik nëpërmjet inicialeve të kryeministrave të dy vendeve, përkatësisht të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Serbisë). Në kuptimin formal, detyrimet juridike që rrjedhin nga Parimet e Asociacionit, të cilat janë marrë përsipër nga Republika e Kosovës, prodhojnë efekte kushtetuese. Prandaj, ky "dokument" përfaqëson një akt juridik, në kuadër të sistemit të brendshëm juridik të Republikës së Kosovës, duke u mbështetur në faktin se ai krijon norma të reja formale në sistemin e brendshëm juridik.

Sipas mendimit tim, ndërlikueshmëria e sfondit politik dhe juridik mbi të cilat u krijuan Parimet e Asociacionit, si një akt juridik, dhe iu referuan Gjykatës për vlerësimin e saj, nuk duhet të pengojë Gjykatën nga adresimi gjithëpërfshirës i çështjes juridike që i është adresuar asaj nga Kreu i Shtetit, përkatësisht nga Presidentja e Republikës së Kosovës (në këtë drejtim, sjell në vëmendje se Qeveria e Kosovës po ashtu ka deklaruar në mënyrë të përsëritur se nuk do të ndërmarrë asnjë hap drejt zbatimit të Parimeve të Asociacionit para vlerësimit të kushtetutshmërisë së tij nga Gjykata dhe se do të respektojë çdo vendim të Gjykatës). Gjykata nuk duhet as të pengohet për të adresuar në një gjuhë juridike të qartë dhe të kuptueshme çështjen kushtetuese të (mos)pajtueshmërisë së Parimeve të Asociacionit, duke iu referuar argumentit se Kosova ka detyrimin për themelimin të Asociacionit/Bashkësisë, që rrjedh nga Marrëveshja e Parë, e cila është ratifikuar dhe është shpallur në mënyrë të rregullt. Është e rëndësishme të theksohet se, edhe në vendimin e arritur nga shumica (paragrafi 104), me të drejtë theksohet se "... çështjet e ngritura në kërkesën e tanishme janë <u>të një rëndësie të madhe dhe relevante për rendin kushtetues të Kosovës</u>. Për më tepër, <u>nuk ka ndonjë institucion tjetër në Republikën e Kosovës ku parashtruesja e kërkesës do të mund t'i adresonte ato".</u>

IV. Dështimi për t'iu përgjigjur thelbit të çështjes kushtetuese të dorëzuar në Gjykatë

Konsideroj se vendimi i arritur nga shumica nuk i përgjigjet thelbit të çështjes lidhur me atë nëse janë Parimet e Asociacionit në pajtim me frymën dhe me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës.

Vendimi identifikon me të drejtë disa paragrafë nga Parimet e Asociacionit, që janë në kundërshtim me Kushtetutën, por nuk arrin t'i kualifikojë ata si të

tillë, në mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje. Për më tepër, vendimi nuk jep udhëzime të qarta kushtetuese për të shmangur kundërthënien ndërmjet këtyre dispozitave të Parimeve të Asociacionit me Kushtetutën.

- **Dispozitat antikushtetuese të Parimeve të Asociacionit *të* identifikuara me vendim, por q*ë nuk janë* adresuar në mënyrë të duhur**

Vendimi i marrë nga shumica e Gjykatës tregon, me një gjuhë relative, se disa dispozita të Parimeve të Asociacionit janë në kundërshtim me Kushtetutën.

Kështu, në paragrafët 153 dhe 154 të vendimit, theksohet:

> *"153. Gjykata vëren se parimet lidhur me strukturën organizative të Asociacionit/Bashkësisë ngrenë shqetësime lidhur me respektin për diversitetin e komuniteteve që banojnë në komunat pjesëmarrëse dhe reflektimin e këtij diversiteti në punësimin e stafit dhe në strukturat e Asociacionit/Bashkësisë, siç kërkohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*
>
> *154. Gjykata rikujton se Marrëveshja e Parë, pika 3, përcakton strukturën e Asociacionit që do të themelohet mbi bazat e njëjta sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të Komunave të Kosovës, p. sh. Kryetari, Nënkryetari, Kuvendi, Këshilli".*

Gjykata përdor termin fleksibil "ngre shqetësime", në lidhje me diversitetin e komuniteteve në komuna, në vend që të përcaktojë qartë se ky fakt është në kundërshtim me frymën e Kushtetutës, dhe, në veçanti, me nenin 3.1 (siç do të shtjellohet më poshtë).

Në ndërlidhje me këtë, në paragrafin 155, shumica e Gjykatës e bën një tjetër sugjerim problematik, kur konkludon:

> *"... 155. Gjykata gjen se kur këto parime për strukturën organizative të Asociacionit/Bashkësisë të elaborohen në akt juridik dhe në Statut, ato duhet të sigurojnë respektimin e diversitetit të komuniteteve që banojnë në komunat pjesëmarrëse, në pajtueshmëri me nenet 3, 7, 57.1, 61 dhe 62 të Kushtetutës".*

Kjo linjë arsyetimi përsëritet në paragrafët e tjerë të vendimit të arritur nga shumica, ku janë "vërejtur" kundërthënie në mes të paragrafëve të caktuar të Parimeve të Asociacionit me Kushtetutën: paragrafët 137/138 (objektivat e Asociacionit); paragrafët 166/167 (E drejta e Asociacionit për të promovuar interesat e komunitetit serb të Kosovës në raport me autoritetet qendrore); paragrafët 166/1967 (nisma legjislative); paragrafët 180/181 (transfertat

financiare nga Qeveria qendrore te komunat dhe e drejta për të vendosur për shpenzimet e tyre).

Akti juridik, i cili për të përdorur gjuhën e vendimit "do të elaborojë" dispozitat e Asociacionit, është kryesisht dekreti, i cili është vetëm një akt zbatues që buron nga Parimet e Asociacionit (Gjykata në vendim përmend edhe Statutin).

Siç nënvizon në mënyrë të thuktë kërkesa e parashtruar nga Presidentja, Parimet e Asociacionit kanë efekt kushtëzues në aktin themelues, përkatësisht në dekret. Gjithashtu, duhet të theksohet se Statuti i Asociacionit do të integrohet në sistemin juridik të Kosovës vetëm nëpërmjet dekretit të Qeverisë/Kryeministrit. Pra, vetëm dekreti do të jetë i pranueshëm për shqyrtim të drejtpërdrejtë nga ana e Gjykatës – në pajtim me paragrafin 2 të Parimeve të Asociacionit. Si i tillë, dekreti nuk mund të ndryshojë Parimet e Asociacionit në mënyrë themelore, siç sugjeron vendimi i arritur nga shumica por, e kundërta, Parimet e Asociacionit përcaktojnë kufijtë e përgjithshëm ligjorë, brenda të cilëve duhet të miratohet dekreti. Kjo nënkupton se dekreti nuk mund të jetë në kundërshtim me Parimet e Asociacionit. Rrjedhimisht, dekreti nuk mund të luajë funksion korrigjues në drejtim të eliminimit të dispozitave të Parimeve të Asociacionit, të cilat nuk janë në pajtim me Kushtetutën.

Vendimi i arritur nga shumica nuk shtjellon lidhjen shkakësore juridike ndërmjet Parimeve të Asociacionit me dekretin dhe me aktet e tjera përkatëse juridike, të cilat do t'i shërbejnë qëllimit të krijimit të Asociacionit/Bashkësisë. Vlen të theksohet se, në paragrafin 114 të vendimit, parashihet që "Kërkesa ka të bëjë me Parimet sipas të cilave Asociacioni/Bashkësia do të themelohet siç është paraparë me pikën 1 të Marrëveshjes së Parë". Kjo tregon qartë se Parimet e Asociacionit sqarojnë kufijtë ligjorë për themelimin dhe për funksionimin e Asociacionit/Bashkësisë. Si të tilla, ato nuk mund të ndryshohen me dekret ose me statut, siç sugjeron gabimisht vendimi i Gjykatës.

Sipas vështrimit tim, si rezultat i kësaj linje të arsyetimit të ndjekur nga shumica, do të kemi një situatë kur në çdo fazë të rëndësishme të themelimit dhe të funksionimit të Asociacionit/Bashkësisë do të krijohet nevoja për të interpretuar dhe për të riinterpretuar mungesën e harmonisë ndërmjet parimeve kushtetuese dhe dispozitave të Parimeve të Asociacionit dhe legjislacionit përkatës.

- **Interpretime të gabuara të disa dispozitave kyç të Parimeve të Asociacionit**

Unë nuk pajtohem me disa nga përfundimet e arritura nga shumica dhe të reflektuara në vendim, në lidhje me disa nga elementet kyç të Parimeve të Asociacionit.

Kështu, në shtjellimin e bazave juridike për themelimin e Asociacionit, vendimi e mjegullon linjën mes tre kapitujve/domeneve të ndryshëm të Kushtetutës: nenit 12 [Pushteti Lokal]; Kapitullit II [Të Drejtat Njeriut dhe Liritë Themelore] dhe Kapitullit X [Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial]. Kjo çon në konkluzion të gabuar, të paktën në mënyrë të tërthortë, se baza ligjore për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë mund të nxirret nga këta tre kapituj.

Kështu, në shtjellimin e "kornizës ligjore" të Parimeve të Asociacionit, në vendim shkruhet:

> "*Gjykata më tej rikujton se Asociacioni/Bashkësia parashikohet me Marrëveshjen e Parë, inter alia, pika 3, që përcakton se 'struktura e Asociacionit/Bashkësisë do të themelohet mbi të njëjtën bazë sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të Komunave të Kosovës, p. sh. Kryetari, Nënkryetari, Kuvendi, Këshilli".*
>
> *[. . .]*
>
> *"Kjo nënkupton që duhet të merren parasysh neni 12, neni 21.4 dhe neni 44, si dhe neni 124.4 i Kushtetutës".*

Më tej, vendimi i marrë nga shumica përfundon në një gjuhë të pakuptueshme:

> *"Gjykata konsideron se në Parimet e përcaktuara në kapitullin mbi Kornizën ligjore nuk plotësojnë tërësisht standardet kushtetuese. Duke marrë parasysh se natyra e Asociacionit/Bashkësisë do të përcaktohet në këtë pjesë, akti juridik dhe Statuti duhen të jenë në pajtueshmëri me nenet 12, 21.4, 44 të Kushtetutës, si dhe me nenin 124.4 të Kushtetutës (136)".*

Neni 12 [Pushteti Lokal] ka dy paragrafë dhe ai përcakton se "komunat janë njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës dhe organizimi dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale rregullohen me ligj".

Ky nen nuk ofron asnjë hapësirë ligjore për ndonjë lloj të asociacionit të komunave që të kenë statusin e një njësie të veçantë të vetëqeverisjes.

Neni 21 i Kushtetutës [Parimet e Përgjithshme] është pjesë thelbësore e Kapitullit II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore]. Paragrafi 4 i këtij neni përcakton:

> "*Të drejtat dhe liritë themelore, të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme*".

Neni 44 garanton të drejtën e lirisë së asociimit, si një nga të drejtat themelore dhe liritë e njeriut, të cilat, duke u mbështetur në nenin 21, do të zbatohen edhe për personat juridikë, për aq sa të jetë e mundur.

Liria e asociimit është një element përbërës thelbësor i korpusit të të drejtave dhe lirive të njeriut që i përket individëve, qoftë individualisht ose për shkak të përkatësisë së tyre ndaj një kolektiviteti/grupi.

Megjithatë, në kundërshtim me arsyetimin e vendimit të marrë nga shumica, dispozitat kushtetuese që kanë të bëjnë me të drejtat themelore të njeriut nuk zbatohen për institucionet publike, të cilat kryejnë funksione publike – ku komunat janë një prej tyre.

Si një argument shtesë, neni 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre], paragrafi 14, i Kushtetutës, i referuar në vendim, parasheh të drejtën e pjesëtarëve të komuniteteve, si individë apo në komunitet:

> "*... të themelojnë shoqata të kulturës, të artit, të shkencës dhe të arsimit, si dhe shoqata të tjera* *për shprehjen, për avancimin dhe për zhvillimin* *e identitetit të tyre*".

Përsëri, kjo e drejtë i takon kategorisë së të drejtave të njeriut që u janë njohur pjesëtarëve të komuniteteve etnike, si individë ose kolektivisht, jo komunave, asociacioneve të formuara nga ana e tyre, apo organeve të tjera publike të Qeverisë.

Arsyetimi i shumicës së Gjykatës nuk arrin të bëjë dallim të qartë ndërmjet lirisë së asociimit, si një e drejtë themelore e njeriut (neni 44), dhe nenit 124.4 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës, i cili parasheh bashkëpunim ndërkomunal dhe bashkëpunim ndërkufitar në përputhje me ligjin.

Ekzistojnë tri fakte vendimtare ligjore, të papërfillura me vendimin e marrë nga shumica, që qartësojnë çështjen e bazës juridike të komunave për të formuar Asociacion/Bashkësi.

Së pari, komunat nuk mund të mbështeten në nenet 21 dhe 44 të Kushtetutës, si bazë juridike për krijimin e Asociacionit/Bashkësisë, sepse çështja e të drejtave të njeriut në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës

nuk mund t'i nënshtrohet regjimeve juridike ad-hoc të bazuara në territor. Komunat përfaqësojnë njësinë bazë të qeverisjes lokale, të cilat kanë identitet territorial.

Neni 4, paragrafi 1, i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë i definon komunat si në vijim:

> *"... njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga një komunitet i qytetarëve në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore".*

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme të Asociacionit], paragrafi 1, i Kushtetutës shpall se *"Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës".*

Si parim i përgjithshëm, "pandashmëria," si një tipar themelor i çdo regjimi modern juridik për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pengon çdo lloj "ndashmërie", duke përfshirë edhe atë të bazuar në territor.

E dyta, neni 123, paragrafi 3, i Kushtetutës përcakton:

> "*Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale".*

Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale (neni 10, paragrafi 1) përcakton se në ushtrimin e pushtetit të tyre:

> "*Bashkësitë vendore kanë të drejtë gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre të bashkëpunojnë dhe, brenda ligjit, të bashkohen me bashkësi të tjera vendore për të realizuar detyrat me interes të përbashkët".*

Sipas kësaj dispozite të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, asociacioni i komunave është i lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre (publike). Si pasojë, baza e bashkëpunimit dhe e asociimit <u>mund të jetë interes i përbashkët i komunave – jo interes i grupeve të veçanta brenda komunave</u>, qofshin ato etnike, fetare, ideologjike apo të tjera (siç është rasti me Asociacionin/Bashkësinë).

E treta, neni 31 [Të drejtat e komunave për të formuar asociacione] të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale parasheh:

> *"Për mbrojtjen dhe për promovimin e interesave të tyre të përbashkëta, komunat formojnë dhe marrin pjesë në asociacionet që funksionojnë, në pajtim me ligjin".*

Në një interpretim logjik të kësaj dispozite të këtij ligji, i cili ka karakter të Lex Specialis për këtë fushë ligjore, asociacioni i komunave duhet të formohet nga vetë komunat dhe jo nga autoritetet qendrore. Ky nuk është rasti i Asociacionit/Bashkësisë, që, në pajtim me Parimet e Asociacionit, do të krijohet me dekret të Qeverisë/Kryeministrit (sipas kësaj logjike, asgjë nuk do të pengojë Qeverinë e Republikës së Kosovës që të përdorë këtë precedent në të ardhmen për të krijuar, me dekrete, asociacione të tjera në baza etnike të komunave, të veshura me funksione publike).

Duke marrë parasysh ato që janë thënë më sipër, arsyetimi i shumicës së anëtarëve të Gjykatës lidhur me çështjen e kornizës ligjore për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë, sikurse parashihet me Parimet e Asociacionit, mbështetet në leximin e gabuar të neneve 12, 21, 44, dhe 124 të Kushtetutës. Unë jam i mendimit që as neni 12 (i cili i përcakton komunat si njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes vendore), as nenet 21 dhe 44 (të cilët kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut) dhe as neni 124 (që ka të bëjë me vetëqeverisjen lokale), nuk ofrojnë bazë ligjore për krijimin e Asociacionit/Bashkësisë brenda formatit ligjor të parashikuar me Parimet e Asociacionit.

Megjithatë, kjo nuk nënkupton se komunat nuk kanë të drejtë të formojnë asociacione. Kushtetuta dhe ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës parashikojnë gëzimin e kësaj të drejte nga komunat dhe se kjo e drejtë u përket edhe komunave të cilat mendohet t'i bashkohen Asociacionit/Bashkësisë së Komunave Serbe në Kosovë. Por, kjo duhet të bëhet brenda kufizimeve kushtetuese dhe ligjore që janë në fuqi në momentin e krijimit të tyre.

Shumica e anëtarëve kanë bërë një interpretim tjetër të gabueshëm të së drejtës së Asociacionit/Bashkësisë për të iniciuar procedura përpara Gjykatës Kushtetuese (Paragrafi 11 i Parimeve të Asociacionit). Në vendimin që është marrë nga pjesa më e madhe e anëtarëve të Gjykatës shkruhet:

> *"Gjykata gjen se Asociacioni/Bashkësia mund të iniciojë procedura në Gjykatën Kushtetuese vetëm kur Asociacioni/Bashkësia, si entitet me subjektivitet juridik, mund të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës".*

Ky përfundim, në të cilin ka arritur shumica e anëtarëve, bazohet në bashkëshoqërimin ligjor të gabueshëm ndërmjet neneve 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës.

Ky interpretim është kundërthënës në vetvete, sepse paragrafi 11 i Parimeve të Asociacionit parasheh:

> *"Asociacioni/Bashkësia do të ketë të drejtë të iniciojë apo të marrë pjesë në procedurat gjyqësore në gjykatat kompetente, përshirë Gjykatën Kushtetuese, kundër çfarëdo akti apo vendimi të cilitdo institucion që ndikon në ushtrimin e kompetencave të Asociacionit/Bashkësisë, në përputhje me Statutin e tij".*

Neni 113.7 i Kushtetutës, i cili referohet në vendimin e marrë nga shumica, parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë…".*

Edhe nëse Asociacioni/Bashkësia do të kualifikohej si person juridik, në kuptim të nenit 21.4, çka mendoj se do ishte një interpretim i pasaktë, neni 113.7 nuk do t'i jepte Asociacionit/Bashkësisë të drejtën për të referuar në Gjykatën Kushtetuese aktet ose vendimet e institucioneve publike, të cilat do të ndikonin në ushtrimin e kompetencave të Asociacionit/Bashkësive në përputhje me statusin e tij.

Autoriteti i institucioneve publike nuk mund të lidhet me të drejtat e individëve ose të bashkësive, në kuptim të qëndrimit të tyre përpara Gjykatës Kushtetuese – sikurse implikon arsyetimi i sipërpërmendur, i ndjekur nga shumica. Përveç kësaj, e drejta e Asociacionit/Bashkësisë për të iniciuar procedura përpara Gjykatës nuk bie në fushëveprimin e nenit 113.4, i cili i autorizon komunat, por jo asociacionet e komunave, që ta kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjeve apo të akteve të Qeverisë, të cilat i cenojnë përgjegjësitë e tyre apo që i zvogëlojnë të ardhurat e tyre në rastin kur komunat preken nga ligje apo nga akte të tilla.

V. Papajtueshmëria e Parimeve të Asociacionit me frymën e Kushtetutës, me nenin 3, paragrafi 1 (natyra shumetnike), me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Parimet e Asociacionit shkelin frymën e Kushtetutës, nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës.

Fryma e Kushtetutës mbrohet përmes interpretimit të integruar dhe gjithëpërfshirës të dispozitave themelore (të cilat mishërojnë parimet themelore të rendit kushtetues), si dhe leximit sistematik dhe konsistent të dispozitave operative (nëpërmjet të cilave materializohen këto parime themelore kushtetuese). Unë besoj se Parimet e Asociacionit bien në kundërshtim me parimet më themelore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.

) *Tensioni kushtetues ndërmjet paragrafit 8 të Parimeve të Asociacionit dhe parimit të sovranitetit*

Paragrafi 8 i Parimeve të Përgjithshme përcakton një vijë horizontale të ndërveprimit institucional ndërmjet Asociacionit/Bashkësisë dhe Qeverisë qendrore. Përveç se kjo është në kundërshtim me nenin 93.6 të Kushtetutës, i cili i jep mandatin Qeverisë së Kosovës që të "*... udhëzojë dhe mbikëqyrë punën e organeve të administratës*", ky paragraf shton shumë paqartësi në kuptim të vijës vertikale të shpërndarjes dhe të ushtrimit të autoritetit publik në Republikën e Kosovës. Rrjedhimisht, Parimet e Asociacionit e mjegullojnë vijën e rendit hierarkik ndërmjet autoriteteve qendrore të Republikës së Kosovës dhe Asociacionit/Bashkësisë. Ekzistenca e një vije institucionale vertikale, në pajtim me të cilën zbatohet autoriteti publik përbrenda një vendi, formon boshtin e parimit të sovranitetit.

Sovraniteti përfaqëson njërin nga parimet më thelbësore të garantuara me Kushtetutë. Në përkufizimin më të zakonshëm dhe të thjeshtëzuar, sovraniteti nënkupton që shteti është autoriteti më i lartë politik brenda kufijve të tij dhe ai është i pavarur e i barabartë, në kuptimin formal, me shtetet e tjera në sferën ndërkombëtare. Dimensioni i brendshëm i sovranitetit materializohet nëpërmjet një strukture institucionale të integruar dhe hierarkike.

Do të ishte gabim të arrihej në përfundimin se Parimet e Asociacionit cenojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë parimin e sovranitetit. Nuk është kështu. Parimet e Asociacionit parashohin se Asociacioni/Bashkësia duhet të veprojë brenda kornizave të vendosura nga ligji i Kosovës. Megjithatë, në ilustrimin më të thjeshtë, sovraniteti manifestohet nëpërmjet një procesi të dyfishtë të krijimit dhe të zbatimit të normave dhe të politikave. Fakti se paragrafi 8 i Parimeve të Asociacionit përcakton një vijë horizontale të komunikimit dhe të bashkëpunimit me Qeverinë qendrore, ka potencial për prodhimin e konfuzioneve kushtetuese për sa i përket ushtrimit të autoritetit publik. Duhet të shënohet, si faktor subjektiv shtesë, se pozicionet politike të dy aktorëve në procesin e krijimit të Asociacionit/Bashkësisë, përkatësisht Republikës së Serbisë dhe përfaqësuesve të komunave të cilët duhet ta përbëjnë Asociacionin/Bashkësinë, e rrisin tensionin ndërmjet Parimeve të Asociacionit dhe parimit të sovranitetit. Kujtoj se të dyja këto palë/të dy këta

aktorë e kanë shprehur hapur kundërshtimin e tyre ndaj shtetit të Kosovës dhe sovranitetit të tij.

- ***Parimet e Asociacionit parashikojnë një njësi të re të vetëqeverisjes – Asociacionin/Bashkësinë***

Parimet e Asociacionit parashikojnë krijimin e Asociacionit/Bashkësisë me shumë elementë dhe tipare të një njësie të veçantë të vetëqeverisjes, *inter alia*, me kompetenca të llojit ekzekutiv. Parimet e Asociacionit e përkufizojnë Asociacionin si "entitet juridik" me "karakter të veçantë" (paragrafi 2). Ndryshe nga Asociacioni/Bashkësia, Statuti i Asociacionit i Komunave të Kosovës, për shembull, e përkufizon Asociacionin si "organizatë joprofitabile, e cila është person juridik që i përfaqëson interesat e përgjithshme të anëtarëve të saj – autoritetet lokale" (Neni 2.1 i Statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës).

Në përkufizimin e objektivave të Asociacionit, neni 4 i Parimeve të Asociacionit, parasheh:

> *"Në përputhje me Marrëveshjen e Parë, objektivat kryesore të Asociacionit/Bashkësisë do të jenë ofrimi i funksioneve dhe shërbimeve publike…"*

Zbatimi i "funksioneve publike" është një atribut i organeve qeveritare, të cilat, si rregull i përgjithshëm, nuk u përkasin organizatave joqeveritare ose private. Në përputhje me këtë, interpretimi i kujdesshëm i "Objektivave" të Asociacionit të Komunave të Kosovës çon në të njëjtin përfundim, ku objektivat e këtij Asociacioni reduktohen kryesisht në ofrimin e shërbimeve për anëtarët e tij (d.m.th. komunave).

Ka elementë të tjerë të Parimeve të Asociacionit të cilat i japin Asociacionit/Bashkësisë tipare të një njësie të veçantë të vetëqeverisjes, të veshur me funksione ekzekutive, krahas atyre mbikëqyrëse dhe përfaqësuese. Disa prej këtyre elementëve janë si më poshtë:

- Komunat nuk kanë të drejtë/mundësi ligjore të largohen nga Asociacioni (paragrafi 17 i Parimeve të Asociacionit) – ndryshe nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, ku, sipas nenit 5.1.4. të Statutit, "Kuvendi Komunal mund të marrë vendim që të tërhiqet nga anëtarësimi në Asociacion";

- Stafi i administratës së Asociacionit "përfiton" nga Ligji për Shërbimin Civil (ky ligj aplikohet për punonjësit në sektorin publik);

- Parimet e Asociacionit përcaktojnë se Asociacioni/Bashkësia ka të drejtë t'i ketë në bashkëpronësi kompanitë që ofrojnë shërbime

lokale në kuadër të fushëveprimit të Asociacionit/Bashkësisë, si dhe të ketë buxhetin e tij, i cili do të administrohet në përputhje me Ligjin mbi Prokurimin Publik dhe do t'i nënshtrohet auditimeve nga Auditori i Përgjithshëm.

Të gjithë këta elementë, të parashikuar në Parimet e Asociacionit, i japin Asociacionit/Bashkësisë tiparet e një njësie të veçantë të vetëqeverisjes, të veshur me kompetenca të caktuara ekzekutive. Kjo nuk është në pajtim me nenet 12 dhe 124 të Kushtetutës [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale].

- ***Parimet e Asociacionit janë të papajtueshme me parimin e shumetnicitetit dhe të mosdiskriminimit***

Vendimi i shumicës nuk arrin të përcaktojë një kundërthënie të qartë ndërmjet Parimeve të Asociacionit dhe dy parimeve thelbësore të Kushtetutës, përkatësisht parimit të shumetnicitetit dhe të mosdiskriminimit.

Në nenin 3.1 të Kushtetutës parashikohet:

> *"Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore".*

Neni 24 [Barazia para Ligjit] parashikon:

> *"1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
> *2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
> *3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato".*

Neni 57 [Parimet e Përgjithshme], paragrafi 1, i Kapitullit III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] parashikon:

> *"Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së*

Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute".

Në neni 58n [Përgjegjësitë e Shtetit] shkruhet:

"1. Republika e Kosovës siguron kushtet e duhura, të cilat u mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre.

[…]

4. Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratojë masa adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore".

Në praktikën dhe në doktrinën e përgjithshme juridike, diskriminimi përcaktohet si praktikë e trajtimit të padrejtë të një personi apo të një grupi të njerëzve në mënyrë të ndryshme nga njerëzit apo nga grupet e tjera të njerëzve.

Në harmoni me këtë, neni 1 i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, e përkufizon kështu "diskriminimin racor":

"… çdo dallim, përjashtim, kufizim, ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare e etnike, që ka për qëllim apo për efekt të shkatërrojë ose të kompromotojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushte barazie, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore ose në çdo fushë tjetër të jetës publike".

Neni 4 i Konventës parasheh:

"Masat e veçanta që merren me të vetmin qëllim që të sigurojnë përparimin adekuat të një numri të konsiderueshëm të grupeve racore, etnike ose të individëve që kanë nevojë për mbrojtjen e nevojshme për të garantuar gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, në kushte barazie, nuk konsiderohen si masa diskriminimi racial, me kusht që këto masa të mos kenë për pasojë ruajtjen e të drejtave të veçanta për grupe racore të ndryshme dhe të mos mbeten në fuqi pasi të jenë arritur objektivat për të cilat janë marrë".

Parimet e Asociacionit mishërojnë një qasje të bazuar në territor ndaj të drejtave të një komunitetit të caktuar etnik në Republikën e Kosovës, gjegjësisht të serbëve të Kosovës. Si rrjedhojë, dy përbërësit themelorë të Parimeve të Asociacionit, domethënë parimi etnik dhe ai gjeografik, prodhojnë një realitet të ri juridik në Republikën e Kosovës, nëpërmjet të cilit, një pjese të caktuar të bashkësisë etnike serbe në Republikën e Kosovës, i njihet një status politik dhe juridik i ndryshëm, domethënë më i avancuar. Ky diferencim krijon bashkësi socio-politike "më të favorizuara" dhe "më pak të favorizuara" – të cilat përcaktohen nga elementët objektivë të etnicitetit dhe të gjeografisë. Rrjedhimisht, realiteti i ri juridik që do të krijohet me Parimet e Asociacionit dhe me aktet ligjore që dalin prej tyre janë në kundërshtim me parimet e shumetnicitetit dhe të mosdiskriminimit, të cilat janë elementë integralë të frymës së Kushtetutës, prandaj edhe përfaqësojnë një prej parimeve themelore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.

Parimet e Asociacionit krijojnë dy shtresa të diferencimit/dallimit.

Shtresa e parë e diferencimit është ndërmjet serbëve të Kosovës, të cilët jetojnë në komunat që janë përfshirë në Asociacion/Bashkësi, dhe serbëve të Kosovës, të cilët jetojnë në komunat e tjera të Republikës së Kosovës, të papërfshirë në Asociacion/Bashkësi. Qartazi, vetëm serbët e Kosovës, të cilët jetojnë në komunat ku serbët janë në shumicë, në kuptimin demografik, "kanë të drejtë" të përfitojnë nga pozita politike e avancuar, të cilën ua njeh Asociacioni/Bashkësia. Kategoria e dytë e serbëve të Kosovës, për shembull, nuk do të ketë ndonjë rol në zgjedhjen e Asamblesë, si organ kryesor i Asociacionit/Bashkësisë, dhe, në mënyrë automatike, as në organet e tjera të Asociacionit (paragrafi 6 i Parimeve).

Shtresa e dytë e diferencimit është ndërmjet serbëve të Kosovës, të cilët jetojnë në komunat e përfshira në Asociacion/Bashkësi, dhe qytetarëve të etnive të tjera, të cilët jetojnë në këto komuna.

Asociacioni/Bashkësia është etnocentrike dhe kjo shprehet edhe nga titulli: "komunat me shumicë serbe", në vend që të përdoret një terminologji tjetër e cila nuk është përjashtuese në bazë të linjave të identitetit shoqëror (p.sh., përmendja e komunave me emrat e tyre zyrtarë).

Sikurse është shtjelluar më sipër, korniza ligjore si dhe standardet e aplikueshme ndërkombëtare nuk parashikojnë që bashkëpunimi i komunave të motivohet nga objektivi i përparimit të interesave të grupeve të veçanta, etnike ose grupeve të tjera, të cilat jetojnë ose banojnë në ato komuna. E vetmja bazë legjitime dhe ligjore për bashkëpunim ndërmjet komunave, duke përfshirë edhe formimin e asociacionit, është avancimi i interesit të komunave, si një e tërë, domethënë të të gjithë qytetarëve që jetojnë ose që banojnë brenda tyre, pavarësisht përkatësisë etnike.

Nuk ndodh kështu me Asociacionin/Bashkësinë dhe kjo reflektohet edhe në Parimet e Asociacionit. Një boshnjak, i cili jeton në Leposaviq, ose një rom që jeton në Graçanicë, për shembull, edhe pse mund të paguajë taksa dhe të votojë në komunën e tij përkatëse, nuk do të ketë të drejtë të përfaqësohet nga Asociacioni/Bashkësia vetëm për shkak të përkatësisë së tij etnike. Gjithashtu, atij do t'i mohohet përdorimi i të drejtës për t'u zgjedhur apo për t'u punësuar në pozita të caktuara dhe në funksione të krijuara nga Asociacioni/Bashkësia. Kujtoj se, sipas paragrafit 9 të Parimeve, "Asociacioni/Bashkësia do të promovojë interesat e komunitetit serb të Kosovës në raport me autoritetet qendrore".

Diferencimi institucional ndërmjet grupeve, duke përfshirë grupet etnike, jo vetëm që lejohet, por ndonjëherë është i nevojshëm për të zgjidhur nevoja e veçanta dhe aspiratat socio-politike. Megjithatë, diferencimi asnjëherë nuk duhet të mishërojë apo të prodhojë pabarazi. "Të ndarë, por të barabartë" nuk është formula që aplikohet në Parimet e Asociacionit. Për rrjedhojë, diferencimi në trajtim i grupeve të ndryshme, i bazuar ekskluzivisht në elementë racialë, siç është përkatësia etnike, rezulton me diskriminim.

Është e rëndësishme të nënvizohet se Kushtetuta dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare përkatëse parashohin trajtimin e grupeve specifike në mënyrë të veçuar, në një kuptim pozitiv. Megjithatë, kjo mund t'i shërbejë vetëm dy objektivave legjitime: ruajtjes së të drejtave të caktuara specifike dhe lirive që burojnë nga identitetet sociale të ndryshme të grupeve të caktuara, ose arritjes së qëllimit të barazisë ndërmjet grupeve të ndryshme. Në rastin *SEJDIÇ DHE FINCI kundër BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), ka vërtetuar:

> "*... Diskriminimi është trajtimi i ndryshëm, pa një qëllim objektiv dhe justifikim të arsyeshëm", të personave në situata të ngjashme. "Pa një qëllim objektiv dhe justifikim të arsyeshëm" nënkupton se* dallimi *në këtë drejtim nuk ndjek një qëllim legjitim apo se nuk ekziston ndonjë marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet".*

Më tej, pas nënvizimit se "*përkatësia etnike dhe raca janë koncepte të ndërlidhura*", GJEDNJ-ja ka konstatuar:

> *"... aty ku diferencimi në trajtim mbështetet në një racë apo përkatësi etnike, nocioni i justifikimit objektiv dhe të arsyeshëm duhet të interpretohet në mënyrë sa më rigoroze të mundur".*

GJEDNJ-ja ka nënvizuar se neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

> *"... nuk i ndalon Shtetet Kontraktuese t'i trajtojnë grupet në mënyrë të ndryshme me qëllim që të korrigjojnë pabarazitë faktike midis tyre. Në fakt, në rrethana të caktuara, dështimi për t'u përpjekur për korrigjimin e pabarazive përmes trajtimit të ndryshëm mundet që, pa ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të shkaktojë shkeljen e këtij neni".*

Dokumenti i titulluar "Parimet e Asociacionit" nuk ofron as justifikim objektiv dhe as justifikim të arsyeshëm për këtë diferencim të dyfishtë në trajtimin që ai prodhon. Për rrjedhojë, unë i qëndroj mendimit se diferencimi dyshtresor, i krijuar nga Parimet e Asociacionit, shkel parimet e multietnicitetit dhe të mosdiskriminimit të Kushtetutës.

Si përfundim, unë me respekt nuk bie dakord me vendimin e nxjerrë nga shumica e gjyqtarëve në rastin KO130/15 dhe shpreh mospajtimin tim ndaj këtij vendimi, meqenëse jam i mendimit që Parimet e Asociacionit, si një akt ligjor, prodhojnë efekte të konsiderueshme për rendin kushtetues të Republikës së Kosovës. Kjo pasojë manifestohet në papajtueshmëri kushtetuese, e cila buron nga rënia ndesh e shumë dispozitave të Parimeve të Asociacionit me disa prej parimeve thelbësore të Kushtetutës. Zbatimi i plotë i Parimeve të Asociacionit brenda kuadrit të rendit kushtetues aktual të Republikës së Kosovës do të përbënte një anomali kushtetuese. Për rrjedhojë, për ta shmangur këtë, ose duhet të ndryshohet Kushtetuta, me qëllim që të krijohet një kornizë kushtetuese që lejon zbatimin e Parimeve të Asociacionit, ose duhet të ndryshohen dhe të riformulohen në mënyrë kuptimplotë Parimet e Asociacionit (së bashku me legjislacionin zbatues), me qëllim që të jenë në pajtim me Kushtetutën. Në përpjekje për të gjetur një rrugë të mesme, shumica e gjyqtarëve të Gjykatës ka marrë një vendim i cili, për mendimin tim, nuk e parandalon vazhdimin e mospajtueshmërisë kushtetuese ndërmjet Parimeve të Asociacionit dhe Kushtetutës.

Dorëzoi me respekt,
Bekim Sejdiu
Gjyqtar

KI134/14, Parashtrues Sadik Thaqi Ankesë në lidhje me mungesën e hetimit të vdekjes së djalit

KI134/14, Aktvendim për papranueshmëri i 14 tetorit 2015, publikuar më 30 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, e drejta për jetën, obligimi për zhvillim të hetimeve, prima facie, ratione temporis*

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të nenit 25 [E Drejta për Jetën] të Kushtetutës dhe me nenin 2 [E Drejta për jetën] të Konventës nga aspekti material dhe procedural. Aspekti material, ka të bëjë me përgjegjësinë e autoriteteve për vdekjen e djalit të parashtruesit, derisa aspekti procedural, ka të bëjë me obligimin e shtetit për të hetuar shkakun e vdekjes së djalit të tij.

Në aspektin material të kërkesës, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se kërkesa e parashtruesit ishte *ratione temporis* e papajtueshme me Kushtetutën, sepse bëhej fjalë për një ngjarje që kishte ndodhur para se Kushtetuta të hynte në fuqi dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk kishte juridiksion kohor. Në aspektin procedural të kërkesës, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se nuk ka dëshmi se prokurori publik nuk ka kryer hetimtë duhur,kur mori vendimin se nuk kishte asnjë person që mund të akuzohejpër incidentin që shkaktoi vdekjen e djalit të parashtruesit. Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (3) (g) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI134/14
Parashtrues
Sadik Thaqi
Ankesë në lidhje me mungesën e hetimit të vdekjes së djalit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy,gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Sadik Thaqi, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk i referohet shprehimisht një vendimi të veçantë të një autoriteti publik që do të kontestohej.

3. Ai kryesisht, ankohet për dështimin e autoriteteve publike që të përcaktojnë "*a duhet dikush të më përgjigjet për vdekjen e dhunshme*" të djalit të tij.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kërkesës së parashtruesit për mungesën e një hetimi penal rreth vdekjes së djalit të tij. Parashtruesi konsideron se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 25 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 1 shtator2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 5 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 12 shtator 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI134/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, mandati i të cilit në Gjykatën Kushtetuese ka përfunduar më 26 qershor 2015.

10. Më 14 tetor 2015, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Sipas parashtruesit të kërkesës dhe në bazë të dokumenteve të dorëzuara, faktet e rastit mund të përmblidhen si më poshtë.

12. Më 4 shtator 2003, një numër i të burgosurve në burgun e Dubravës sulmuan rojet e paarmatosura të burgut dhe morën kontrollin në pavijonin 2 të burgut të Dubravës. Të burgosurit ngritën pengesa në hyrjen e bllokut të qelisë duke përdorur dyshekë dhe pas kësaj kërkuan, *inter alia,* përmirësimin e kushteve të jetesës nga drejtoria e burgut.

13. Të njëjtën ditë, një ekip për ndërhyrje filloi t'i largojë dyshekët që ishin përdorur nga të burgosurit si pengesa. Si përgjigje ndaj kësaj, të burgosurit i vunë zjarrin këtyre dyshekëve dhe, si pasojë e kësaj, 5 (pesë) të burgosur vdiqën si pasojë e thithjes së tymit toksik dhe plagëve të marra nga zjarri që kishte pasuar. Djali i parashtruesit të

kërkesës, Ardian Thaqi, ishte njëri nga të burgosurit që vdiq në trazirat e burgut të Dubravës.

14. Më 5 shtator 2003, prokurori i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (në tekstin e mëtejmë: UNMIK) kërkoi hetimin dhe autopsinë e trupave të 5 (pesë) të burgosurve të vdekur.

15. Më 7 shtator 2003, Njësia Qendrore e Hetimeve Kriminale të UNMIK-ut (në tekstin e mëtejmë: NJQHK) publikoi raportin rreth hetimit paraprak të incidentit.

16. Më 10 shtator 2003, UNMIK-u themeloi një komision të veçantë të quajtur "Komisioni i Dubravës" në mënyrë që, *inter alia*, të vërtetojë ngjarjet e 4 shtatorit 2003, si dhe faktet dhe rrethanat që çuan deri aty.

17. Komisioni i Dubravës shqyrtoi mënyrën se si autoritetet i ishin qasur incidentit; ankesat e të burgosurve dhe arsyet e incidentit; planin emergjent për trajtimin e trazirave në burg; incidentet e mëparshme në burg; kushtet e të burgosurve, trajnimin e menaxhmentit dhe trajnimin në burg.

18. Më 22 shtator 2003, Komponenti i Policisë së UNMIK-ut filloi një hetim penal rreth incidentit të emëruar si "Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm përmes zjarrit që janë vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme dhe që ka përfunduar me vrasje".

19. Më 4 nëntor 2003, Komisioni i Dubravës përfundoi shqyrtimin e tij me publikimin e një raporti në të cilin kishte bërë 39 (tridhjetë e nëntë)rekomandime në mënyrë që të vendosen standarde të mira për menaxhim në këtë burg.

20. Më 10 gusht 2004, prokurori i UNMIK-ut kërkoi nga hetuesit që të zgjerojnë fushëveprimin e hetimit për të përfshirë sjelljen e mundshme penale apo pakujdesinë penale nga ana e Divizionit të Drejtorisë Penale apo nëpunësve të tjerë të UNMIK-ut. Sidoqoftë, ky rekomandim ishte injoruar nga autoritetet e UNMIK-ut.

21. Më 9 dhjetor 2008, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (në tekstin e mëtejmë: EULEX) mori përsipër përgjegjësitë nga UNMIK-u për rastet e pazgjidhura ligjore dhe hetimet policore dhe dokumentacioni lidhur me rastin e parashtruesit të kërkesës ishte dorëzuar zyrtarisht te EULEX-i më 23 dhjetor 2008, në pajtim me nenin 15.10 të Ligjit për Prokurorinë Speciale të

Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-052 (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Prokurorinë Speciale).

22. Më 16 korrik 2010, prokurori i EULEX-it kishte ndërprerë procedurën kundër të burgosurve në fjalë, pasi kishte gjetur se nuk kishte dyshim të bazuar se të pandehurit kishin kryer veprat penale në fjalë.

23. Parashtruesi i kërkesës ishte informuar për këtë vendim me një letër të 16 korrikut 2010. Ai kishte mundësinë ose të dorëzojë kërkesën me shkrim te gjyqtari i procedurës paraprake për vazhdimin e hetimit ose të ngre aktakuzë kundër të pandehurve në Gjykatën kompetente të Qarkut brenda 8 (tetë) ditëve nga marrja e njoftimit të pushimit të hetimit në pajtim me nenin 15.12 të Ligjit për Prokurorinë Speciale dhe nenet 62 dhe 224 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, i cili ishte në fuqi në atë kohë. Me sa duket, parashtruesi nuk ka ushtruar asnjërin opsion.

24. Më 6 shtator 2010, ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte regjistruar te Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Paneli).

25. Sa i përket ankesës kundër UNMIK-ut, Paneli vërejti se ai nuk kishte kompetencë për të shqyrtuar veprimet apo mosveprimet e UNMIK-ut, prandaj e deklaroi atë të papranueshme.

26. Përkitazi me ankesën kundër autoriteteve të burgut, Paneli vërejti se ajo nuk është *ratione temporis* në pajtim me kompetencën e tij dhe prandaj e deklaroi atë të papranueshme.

27. Lidhur me ankesën kundër të burgosurve, Paneli vërejti se ndjekja e të burgosurve ishte e pranueshme sipas mandatit të tij. Mirëpo, Paneli konstatoi se EULEX-i shkarkoi përgjegjësitë e veta në lidhje me këtë hetim dhe,prandaj, konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së.

28. Gjatë vitit 2013, parashtruesi i kërkesës ka kontaktuar organe të shumta duke kërkuar hetimin e vdekjes së djalit të tij, duke përfshirë edhe Ministrinë e Drejtësisë, Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Zyrën e Kryeprokurorit të EULEX-it dhe Gjykatën Evropiane për të Drejta të Njeriut.

29. Në një letër të 19 marsit 2013, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës e njoftoi parashtruesin e kërkesës se nuk është brenda mandatit të saj të kryejë hetime dhe se çështja e hetimeve në këtë rast është në kompetencë të organeve të tjera.

30. Në një letër të 3 majit 2013, Prokurori i Shtetit e drejtoi parashtruesin e kërkesës që ta kontaktojë Prokurorinë e EULEX-it, pasi që rasti i tijqë nga fillimi ishte udhëhequr nga ana e UNMIK-ut dhe më vonë i ishte dorëzuar EULEX-it dhe ai nuk ishte shqyrtuar nga Prokurori i Shtetit.

31. Në një letërtë 15 korrikut 2013, Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Drejtësisë njoftoi parashtruesin e kërkesës se ai duhet të ndjekë këtë kurs ligjor me autoritetet kompetente.

32. Në një letër të 7 qershorit 2013, Zyra e Kryeprokurorit të EULEX-it e njoftoi parashtruesin se një hetim mund të rihapet vetëm nëse prova të reja janë në dispozicion, që nuk ishin paraqitur dhe shqyrtuar më parë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Siç u theksua më lart, nga faktet e rastit mund të kuptohet se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 25 [E Drejta për Jetën] të Kushtetutës dhe me nenin 2 [E Drejta për jetën] të KEDNJ-së, në të dy bazat, materiale dhe procedurale. Aspekti material ka të bëjë me përgjegjësinë e autoriteteve për vdekjen e djalit të parashtruesit, derisa aspekti procedural ka të bëjë me obligimin e shtetit për të hetuar shkakun e vdekjes së djalit të tij.

Ligji relevant

34. Gjykata vëren se në kohën e këtyre ngjarjeve, dhe gjatë kohës që ishin ndërmarrë këto hetime, ligji i aplikueshëm dhe dispozitat përkatëse relevante për rastin ishin si në vijim:

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/26, të 6 korrikut 2003

Neni 62

(1) Përveç rasteve nga nenet 226 dhe 227 të këtij Kodi, kur prokurori publik çmon se nuk ka bazë të ndërmarrë hetimin a ndjekjen për vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare ose sipas propozimit, përkatësisht kur çmon se nuk ka bazë të ndërmarrë ndjekjen kundër ndonjërit prej bashkëkryerësve të paraqitur apo kur sipas këtij Kodi konsiderohet se është tërhequr nga ndjekja, prokurori publik detyrohet që brenda 8 (tetë) ditësh ta njoftojë të dëmtuarin për këtë dhe ta udhëzojë se mund të ndërmarrë vetë ndjekjen si paditës

subsidiar. Të njëjtën procedurë e ndjek edhe Gjykata nëse prokurori publik tërhiqet nga ndjekja para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

(2) I dëmtuari ka të drejtë të ndërmarrë apo të vazhdojë ndjekjen brenda 8 (tetë) ditësh nga dita e njoftimit nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Në qoftë se prokurori publik ka tërhequr aktakuzën, i dëmtuari, duke ndërmarrë ndjekjen, mund të mbetet pranë aktakuzës së ngritur ose të ngrejë aktakuzë të re.

(4) I dëmtuari i cili nuk është njoftuar se prokurori publik nuk ndërmerr ndjekjen ose se është tërhequr nga ndjekja, deklaratën e vet për vazhdimin e procedurës mund ta japë para gjykatës kompetente brenda 3 (tre) muajsh nga dita kur prokurori publik refuzon kallëzimin penal ose nga marrja e aktvendimit për pushimin e procedurës.

[...]

Neni 224

(1) Prokurori publik e pushon hetimin kurdo që është vërtetuar nga provat e mbledhura se:

1) Nuk ekziston dyshim i arsyeshëm që personi konkret e ka kryer veprën e tillë penale;
2) Vepra e kryer nuk është vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare;
3) Ka kaluar afati i parashkrimit;
4) Vepra penale është përfshirë me amnisti ose me falje; ose,
5) Ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përjashtojnë ndjekjen.

(2) Prokurori publik brenda 8 (tetë) ditësh pas pushimit të hetimit e lajmëron të dëmtuarin për këtë fakt dhe arsyen për këtë (neni 62 i këtij Kodi). Prokurori publik pa vonesë e njofton gjyqtarin e procedurës paraprake për pushimin e hetimit.

Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-052

Neni 15 - Dispozitat kalimtare

[...]

15.10 Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjitha dosjet, informatat, arkivat dhe të dhënat në formë elektronike dhe të shtypur, lidhur me

lëndët që aktualisht hetohen, ndiqen ose janë hequr nga procedura nga prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut dhe të mbajtura nga Departamenti i Drejtësisë i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) do t'i dorëzohen Kryeprokurorit të EULEX-it në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të marrëveshjeve ndërmjet UNMIK-ut dhe EULEX-it në KOSOVË.

Ligji mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, Nr. 03/L-053

Neni 7 - Kompetencat e përgjithshme të prokurorëve të EULEX-it

7.1 Prokurorët e EULEX-it do të kenë kompetenca dhe përgjegjësi që të ushtrojnë funksionet e tyre, përfshirë këtu kompetencat për të kryer hetime penale dhe për të marrë përgjegjësi për hetimet penale apo procedurat e lëndëve të reja dhe atyre të pazgjidhura në kuadër të PSRK-së apo në kuadër të zyrave prokuroriale ku ata janë caktuar nga Kryeprokurori i EULEX-it dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga Asambleja e prokurorëve të EULEX-it.

7.2 Prokurorët e EULEX-it do të bashkëpunojnë me prokurorët publikë të Kosovës që punojnë në zyra të ndryshme prokuroriale ku ata janë caktuar, në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga Asambleja e prokurorëve të EULEX-it.

7.3 Përveç ushtrimit të funksioneve të tyre hetuese dhe prokuroriale sipas dispozitave të nenit 8 të këtij Ligji, prokurorët e EULEX-it do të monitorojnë, udhëzojnë dhe këshillojnë prokurorët publikë të Kosovës, për sa i përket parimit të autonomisë së prokurorëve dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga Asambleja e prokurorëve të EULEX-it. Roli i tyre si monitorues, mentor dhe këshillues nuk do të jetë i kufizuar në lëndët për të cilat prokurorët e EULEX-it mund të ushtrojnë kompetencat e tyre.

7.4 Prokurorët e EULEX-it do t'i ushtrojnë funksionet e tyre në pajtim me ligjin në fuqi. Ata do të jenë nën autoritetin e veçantë të Kryeprokurorit të EULEX-it dhe nuk do t'i nënshtrohen autoritetit të asnjë institucioni kosovar.

Neni 8 - Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në Kosovë

8.1 Prokurorët e EULEX-it do të jenë kompetent për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë në kompetencë të veçantë të PSRK-së sipas ligjit mbi themelimin e PSRK-në dhe krimet, përfshirë këtu

tentimin dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krime, të paraqitura në të gjitha pikat e paragrafit 3, të nenit 3, të këtij Ligji.

Pranueshmëriae kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

37. Gjykata merr parasysh nenin 47 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik".*

38. Në lidhje me këtë, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i plotëson të gjitha kushtet për të qenë palë e autorizuar, në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore përkatëse.

39. Për këtë qëllim, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese i ka njohur si palë të autorizuar prindërit e të ndjerës (Shih, Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KI41/12, Aktgjykimi i 26 shkurtit 2013).

40. Përveç kësaj, Gjykata thekson se edhe Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), në raste të ngjashme ka pranuar kërkesa individuale nga individët që konsiderohen si viktima të tërthorta, kur ekziston një lidhje personale dhe specifike ndërmjet viktimës dhe parashtruesit. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja, në një rast, ka pranuar si palë të autorizuar bashkëshorten e të ndjerit *(*Shih, *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.* 18984/91, Aktgjykim i 27 shtatorit 1995*),* ndërsa, në një rast tjetër, nipit të të ndjerit i ka pranuar statusin e palës së autorizuar *(*Shih*, Yaşa kundër Turqisë,* nr. 63/1997/847/1054, Aktgjykim i 2 shtatorit 1998).

41. Prandaj, duke marrë parasysh se parashtruesi i kërkesës është prindi të ndjerit, Gjykata konkludon se parashtruesi mund të konsiderohet palë e autorizuar në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 47.1 të Ligjit.

Sa i përket aspektit material

42. Sa i përket kërkesës së parashtruesit në lidhje me përgjegjësinë e autoriteteve në ngjarjet që çuan në vdekjen e djalit të tij, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) (g) të Rregullores së punës, i cili parasheh si më poshtë:

> "*Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese*:
>
> (g) *kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën*".

43. Për ta përcaktuar juridiksionin kohor të Gjykatës është me rëndësi të identifikohet, në secilin rast të veçantë, koha e saktë e shkeljes së pretenduar. Me këtë rast, Gjykata duhet të marrë parasysh faktet për të cilat parashtruesi ankohet dhe për masën e të drejtës kushtetuese që pretendohet të jetë shkelur (Shih, *mutatis mutandis,* Aktgjykimi i Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Blečič *kundër Kroacisë,* Kërkesa Nr. 59532/0, e 8 marsit 2006, para. 82).

44. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se vdekja dhe vrasja e pretenduar e djalit të parashtruesit ndodhi më 4 shtator 2003.

45. Kjo do të thotë që shkelja e pretenduar e të drejtës së parashtruesit, e garantuar
me Kushtetutë, kishte ndodhur para 15 qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe prej të cilës datë Gjykata ka juridiksion kohor.

46. Gjykata thekson se praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese është në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duke vendosur që ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës më 15 qershor 2008 nuk janë ratione temporis në pajtim me Kushtetutën dhe në këtë mënyrë nuk bien nën juridiksionin e saj kohor. (Shih, ndër të tjera, Aktvendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KI152/11, Parashtrues Bekim Murati; në rastin nr. KI07/11, Parashtrues Vehbi Klaiqi, në rastin nr. KI128/11, Parashtrues Ismet Boshnjaku).

Sa i përket aspektit procedural

47. Përkitazi me ankesën e parashtruesit të kërkesës për mungesën e hetimit nga organet përgjegjëse, Gjykata vëren se parashtruesi nuk e ka shfrytëzuar mundësinë e tij sipas ligjit të aplikueshëm në atë kohë që ose të dorëzojë kërkesën me shkrim për vazhdimin e hetimit, ose të ngritë aktakuzë kundër të pandehurve në Gjykatën e Qarkut në kohën e duhur, në pajtim me nenin 62 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës. Prandaj, si duket ai ka humbur të drejtën e ankesës.

48. Parashtruesi i kërkesës nuk ka përmendur se çfarë hetimi shtesë do të mund të kryhej nga prokurori në këtë rast dhe nuk ka treguar nëse kishte ndonjë provë që do ta arsyetonte aktakuzën e cila tani do të ishte ngritur kundër kujtdo në lidhje me vdekjen tragjike të djalit të tij.

49. Përveç kësaj, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së ku është ftuar të trajtojë një çështje të ngjashme. Përkatësisht në rastin Hugh kundër Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ konstatoi se obligimi për të hetuar "është obligim që të ndërmerren hapat e duhur dhe nuk përbën obligim për të arritur një rezultat të caktuar. Autoritetet duhet të kenë marrë hapa të arsyeshme në dispozicionin e tyre për të siguruar dëshminë lidhur me incidentin, përfshirë interalia dëshmi të dëshmitarëve okular, prova të forenzikës dhe kur është e përshtatshme, autopsi që siguron të d*hëna të sakta dhe të plota për dëmin dhe analizë objektive të të gjeturave klinike, duke përfshirë shkakun e vdekjes*". (Shih, *Hugh Jordan kundër* Mbretërisë së Bashkuar, nr. 24746/94, Aktgjykim i 4 majit 2001).

50. Prandaj, në këtë drejtim, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kërkesat procedurale për pranueshmëri, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) të Rregullores së punës, sepse ai nuk i ka mbështetur ankesat e tij.

51. Nga kjo rrjedh se kërkesa e parashtruesit nuk është "ratione temporis" në pajtim me dispozitat e Kushtetutës në lidhje me përgjegjësinë e autoriteteve të Kosovës, përkitazi me ngjarjet që çuan në vdekjen e birit të parashtruesit. Sa i përket ankesës lidhur me mungesën e hetimeve, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar, sepse nuk ka dëshmi se prokurori publik nuk ka kryer hetim të duhur,kur mori vendimin se nuk kishte asnjë person që mund të akuzohej për incidentin që shkaktoi vdekjen e djalit të tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7, të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe 63 (3) (g) të Rregullores së punës, më 28 dhjetor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI58/15, Parashtrues Islam Çerkini - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 210/2014, i 19 shkurtit 2015

KI58/15, Aktvendim për papranueshmëri i 14 tetorit 2015, publikuar më 31 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e qartazi e pabazuar, kontratë shitblerjeje barazia para ligjit, mbrojtja e pronës, vërtetim i pronësisë*

Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar kërkesën për revizion të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës përkitazi me vërtetimin e pronësisë së disa parcelave të tokës. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese për cenim të së drejtës në pronë.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi, se Gjykata Supreme kishte shtjelluar gjerësisht konceptin e fitimit të pretenduar të të drejtave pronësore nëpërmjet kontratës së shitblerjes dhe posedimin e pronës në mirëbesim, për një periudhë të gjatë kohore dhe shtoi se, gjykatat e rregullta nuk e kanë shpallur parashtruesin e kërkesës pronar të parcelave kontestuese çka nënkuptonte, se në një situatë të tillë nuk mund të pretendohej cenimi i të drejtës në pronë. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI58/15
Parashtrues
Islam Çerkini
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 210/2014, të 19 shkurtit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Islam Çerkini nga fshati Bibaj, komuna e Ferizajt, i përfaqësuar nga znj. Zejnepe Zenuni, avokate nga Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 210/2014, i 19 shkurtit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), sipas nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenit 7 [Vlerat], nenit 24 [Barazia Para Ligjit] dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës], si dhe sipas nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 në lidhje me nenin 21.4 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 maj 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 29 korrik 2015, Gjykatanjoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 14 tetor2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 12 shtator 1979, babai i parashtruesit të kërkesës A. Ç. (tani i ndjerë) ka blerë nga pala e tretë D. M. disa parcela të tokës dhe të malit. Kontrata e shitblerjes ka mbetur e paformalizuar. Që nga atëherë kjo pasuri është në disponim, dhe shfrytëzohet pa asnjë pengesë nga babai i parashtruesit dhe më pas, nga vetë parashtruesi i kërkesës.

10. Më 26 korrik 2006, babai i parashtruesit parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Ferizaj për vërtetim të pronësisë bazuar në kontratën për shitblerje të vitit 1979 dhe për mbajtje në mirëbesim të patundshmërisë për më shumë se 30 (tridhjetë) vjet.

11. Më 24 dhjetor 2012, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktvendimi T. nr. 340/12) shpalli parashtruesin e kërkesës trashëgimtar të vetëm të gjithë pasurisë së prindërve të tij.

12. Më 28 dhjetor 2012,GjykataKomunale nëFerizajgjatë seancës përgatitore për Rastin C. nr. 433/06 me vendim kishte bërë

ndryshimin subjektiv të padisë, duke ia njohur parashtruesit të kërkesës statusin e paditësit.

13. Më 30 prill 2013, Gjykata Themelore në Ferizaj (Aktgjykimi C. nr. 433/06) aprovoi, si të bazuar, padinë e parashtruesit të kërkesës dhe e shpalli parashtruesin pronar të parcelave të tokës, që ishin objekt i padisë.

14. Gjykata Themelore theksoi se "*paditësi, me prova të besueshme, ka provuar faktin se parardhësi i paditësit dhe tani vetë paditësi, ka mbajtur në posedim me mirëbesim të plotë pronën kontestuese që nga viti 1979 e deri në vitin 2006 (kur ka ushtruar padinë), pra më shumë se 20 vjet*".

15. Gjykata Themelore konkludoi më tej se "*ekzistimi i dëshmisë së shkruar, në formën dhe nivelin juridik, aq sa akterët prezent të marrëveshjes së shitblerjes, kanë pasur nivel të njohjes së një veprimi juridik apo arsimor, por që në mënyrën e tyre, të thjeshtë, origjinale dhe autentike, kanë pasqyruar qartë se po kryejnë përkatësisht po konstatojnë me shkrim aktin e shitblerjes, për të cilën paditësi A. C. dhe paditësja D. K., gojarisht e kishin kryer*".

16. Më 17 qershor 2013, përfaqësuesi i palës së tretë D. M. ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit.

17. Më 21 mars 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi AC. nr. 1913/13)aprovoi ankesën e palës së tretë D. M. dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ashtu që padinë e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar në tërësi.

18. Gjykata e Apelit arsyetoi se kontrata e shitblerjes *"pa përshkrim të paluajtshmërisë objekt i kontratës, pa konstatim se çmimi i shitblerjes është paguar nga blerësi e sidomos ajo çka është më kryesore pa nënshkrimin e saj nga palët kontraktuese, sipas mendimit të kësaj gjykate, nuk paraqet kontratë të shitblerjes sepse kjo kontratë nuk i përmban të gjitha elementet e një kontrate dhe e njëjta nuk ka mundur të prodhojë efekte juridike ndaj palëve kontraktuese"*.

19. Gjykata e Apelit e ka vlerësuar si të pabazuar edhe qëndrimin juridik të Gjykatës Themelore për posedim të pronës në mirëbesim për një periudhë të gjatë kohore "*sepse paditësi, sipas rregullave nga e drejta pronësore me mbajtje nuk ka mundur ta fitojë të drejtën e pronësisë*".

20. Parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Supreme kërkesë për revizion për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

21. Më 19 shkurt 2015, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 210/2104) refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për revizion.

22. GjykataSupremetheksoi se *"gjykata e shkallës së dytë ka zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale, kur ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka aprovuar ankesën e të paditurve dhe se aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ngase kjo Gjykatë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka vlerësuar faktet relevante dhe në arsyetim të aktgjykimit të goditur ka dhënë arsye të mjaftueshme të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesëspretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar ai është diskriminuar në gëzimin e të drejtave pronësore dhe me të njëjtin është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe standardi i arsyetimit të vendimit.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari vlerëson nëseparashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

27. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

28. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojënjë kërkesë nëse: (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

dhe

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi tëpabazuar, nëse bindet se: (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrëtëmjaftueshme pretendimin e tij".

29. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar Gjykata Supreme "*Ka diskriminuar kërkuesin në gëzimin e të drejtës së pronës; Ka cenuar parimin e sigurisë juridike; dhe ka shkelur standardin e arsyetimit të vendimit të saj".*

30. Megjithatë, Gjykatavëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar si dhe pse me Aktgjykimin e kontestuar ai është diskriminuar dhe si dhe pse është shkelur parimi i sigurisë juridike dhe standardi i arsyetimit.

31. Përveç kësaj, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë mbështetur në*"konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe në aplikimin e gabuar të së drejtës materiale".* Në të vërtetë, këto pretendime bazohen në argumente lidhur me vërtetimin e fakteve dhe zbatimin e ligjit.

32. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të Ligjit (ligjshmërisë)që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

33. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme konsideroi se Gjykata e Apelit *"ka ofruar arsye të mjaftueshme në arsyetimin e aktgjykimit [të kontestuar], të cilat i pranon edhe kjo gjykatë".* Prandaj, Gjykata Supreme gjithashtu pranoi se *"kjo kontratë nuk i përmban të gjitha*

elementet e një kontrate dhe e njëjta nuk ka mundur të prodhojë efekte juridike ndaj palëve kontraktuese".

34. Gjykata konsideron, se Gjykata Supreme u është përgjigjur arsyeve të ankesës së parashtruesit me një arsyetim të detajuar lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë së parashtruesit.

35. Në përgjithësi, parashtruesi i kërkesës nuk ka arsyetuar si dhe pse me përfundimin e Gjykatës Supreme lidhur me pasojat juridike të mungesës së *"të gjitha elementeve të kontratës"* ai ishte diskriminuar dhe janë shkelur parimi i sigurisë juridike dhe standardi i arsyetimit.

36. Më konkretisht, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme elaboroi gjerësisht konceptin e fitimit të pretenduar të të drejtave pronësore nëpërmjet kontratës së shitblerjes dhe posedimin e pronës në mirëbesim për një periudhë të gjatë kohore.

37. Përveç kësaj, Gjykata vërense gjykatat e rregullta nuk e kanë shpallurparashtruesin e kërkesëspronartë pronavekontestuese. Nënjë situatë të tillë, nukmundtë kishte ardhur deri te shkeljae pretenduar e nenit46 të Kushtetutës[Mbrojtja e Pronës] osee nenit1 të Protokollit 1të KEDNJ-së.

38. Gjykata vëren, separashtruesinuk paraqiti asnjë provëpër të mbështeturpretendimin seështë shkelur e drejtae tij përbarazi para ligjit. Në këtë drejtim, Gjykatavëren se parashtruesi i kërkesës ka pasurmundësi të shumtapër të paraqiturpretendimet e tijnëgjykatat e rregullta. Prandaj, pretendimise parashtruesi i kërkesës ishtediskriminuarmeaktgjykimine kontestuarnukmundtë merret parasysh.

39. Në të vërtetë, Gjykatavlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk e ka ndërtuar pretendimin për diskriminim *"në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal*", në pajtim me nenin 24.2 të Kushtetutës.

40. Siçu cek më lart, Gjykata vëren se në AktgjykimineGjykatës Supremejanëanalizuar në mënyrë të detajuar argumentete parashtruesitnë revizionlidhur me vërtetimin efaktevedhezbatimin eligjit. Prandaj, e drejta përnjëvendim të arsyetuar nukështë shkelur,siçpretendohetnga parashtruesi i kërkesës.

41. Për këtë arsye, Gjykatakonsideron, nëpërgjithësidhe konkretisht, separashtruesi i kërkesës as nuk kaofruardëshmi të cilat do të tregoninshkeljen e tëdrejtave të tij kushtetuese(Shih, *Vanek kundër Republikës Sllovake,* nr. 53363/99, Vendimi i GJEDNJ-së, i 31 majit 2005); dhe as nuk e ka mbështeturpretendiminse procedurat nëGjykatën Supremekanë qenë tëpadrejtaapoarbitrare(Shih rastin *Shub kundër Lituanisë,* Nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).

42. Gjykata Kushtetuese përsërit se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga Gjykata Supreme për çështje faktike dhe juridike (ligjshmëria). Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih rastin*García Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999,shih gjithashtu Rastin nr. KI70/11, parashtrues: *Faik Hima, Magbule Hima, dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

43. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 paragrafi (1) (d) dhe (2) (b) dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat36(2) (b) dhe 56 (2) tëRregullores së punës,më 14 tetor2015,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI64/15, Parashtrues Sanija Bajrami - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 297/2014, i 16 dhjetorit 2014

KI64/15, Aktvendim për papranueshmëri i 15 tetorit 2015, publikuar më 31 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, moszbulim i identitetit, vërtetim i pronësisë*

Gjykata Supreme kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për revizion të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, përkitazi me vërtetimin e pronësisë së një ngastre kadastrale. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese për cenim të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe po ashtu kërkoi moszbulim të identitetit.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se kërkesa ishte dorëzuar pas skadimit të afatit katër mujor të përcaktuar me ligj. Gjykata, po ashtu, refuzoi kërkesën e parashtruesit për moszbulim të identitetit. Kërkesa u shpall e papranueshme për shkak se ishte e paafatshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI64/15
Parashtrues
Sanija Bajrami
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 297/2014, të 16 dhjetorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Sanija Bajrami, nga fshati Pojatishtë, komuna e Ferizajt (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati z. Fatmir Bajraktari.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 297/2014, të 16 dhjetorit 2014, me të cilin është refuzuar vërtetimi i pronësisë mbi pronën e tij si i pabazuar.

3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 20 janar 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin, pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

5. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, kërkon që identiteti i tij të mos zbulohet.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 25 maj 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 13 korrik 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

10. Më 15 tetor 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 12 korrik 2002, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Ferizaj, me të cilën kërkoi vërtetimin e pronësisë mbi ngastrën e caktuar.

12. Procedurat gjyqësore janë zhvilluar në shkallë të ndryshme deri në Gjykatën Supreme.

13. Në të vërtetë, më 16 dhjetor 2014, Gjykata Supreme [Aktgjykimi Rev. nr. 297/2014], e refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për revizion ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të 2 shtatorit 2014.

Pranueshmëria e kërkesës

14. Gjykata së pari duhet tëshqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

16. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor…".

17. Gjykata, gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[…]

(c) kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi".

18. Gjykata vëren se Aktgjykimi [Rev. nr. 297/2014] i Gjykatës Supreme është nxjerrë më 16 dhjetor 2014, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 20 janar 2015; parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë më 25 maj 2015; pra, kërkesa është dorëzuar në Gjykatë pas skadimit të afatit prej 4 (katër) muajsh nga data kur i është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme.

19. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se afati prej 4 (katër) muajsh sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është i natyrës prekluzive dhe është themeluar për të siguruar parimin e sigurisë juridike duke siguruar, që kërkesat të cilat dorëzohen në pajtim me Kushtetutën shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme, dhe se vendimet nga e kaluara nuk mund të jenë vazhdimisht të hapura për vlerësim kushtetues (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 23274/04, GJEDNJ, vendimi i 25 gushtit 2005).

20. Nga kjo rrjedh, se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

Kërkesa për moszbulim të identitetit

21. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përmendi si arsye të veçantë që identiteti i tij të mos zbulohet për faktin se palët janë vëllezër dhe se *"marrëdhëniet e tyre janë tepër të keqësuara"*.

22. Gjykata konsideron se arsyeja e paraqitur nuk e arsyeton lejimin e mbrojtjes së konfidencialitetit. Përveç kësaj, identiteti i tij tashmë është zbuluar në procedurat pranë gjykatave të rregullta.

23. Prandaj, kërkesa refuzohet, si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, nëpajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin36(1) (c) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 15 tetor2015,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për moszbulim të identitetit si të pabazuar;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI71/15, Parashtrues Miftar Ahmetaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, CML nr. 5/2014, i 23 dhjetorit 2014

KI71/15, Aktvendim për papranueshmëri i 14 tetorit 2015 publikuar, më 31 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ankand publik, garancia e kredisë, mbrojtja e pronës, mos zbulim i identitetit*

Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës i kishte propozuar Prokurorit të Shtetit që ta paraqet kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë përkitazi me një kontest pronësor. Gjykata Supreme kishte refuzuar të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga Prokurori i Shtetit. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese për cenim të së drejtës në pronë dhe po ashtu kërkoi moszbulim të identitetit.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi sevetëm përshkrimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës, si dhe pretendimi se ato janë shkelur pa paraqitur fakte për mënyrën e shkeljes, pa përcaktuar rrethanat, pa specifikuar dhe mbështetur me fakte valideveprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me normat kushtetuese nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur Gjykatën, se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të Konventës.Gjykata, gjithashtu, vlerësoi se kërkesa për mbrojtje të identitetit duhet të refuzohet, sepse parashtruesi me asnjë argument të vetëm nuk e ka mbështetur këtë kërkesë.Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI71/15
Parashtrues
Miftar Ahmetaj
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CML nr. 5/2014, të 23 dhjetorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Miftar Ahmetaj nga fshati Mushnikovë, komuna e Prizrenit, të cilin e përfaqëson z. Rexhep Hasani, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, CML nr. 5/2014, të cilin e kishte pranuar më 26 janar 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, për të cilin, parashtruesi i kërkesës pretendon se i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), sipas nenit 46 [Mbrojtja e Pronës].

4. Parashtruesi kishte kërkuar të mos i zbulohet identiteti, pa dhënë ndonjë arsyetim për këtë kërkesë.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 26 maj 2015, parashtruesi e dërgoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI71/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 21 gusht 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, si dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.

9. Më 21 gusht 2015, Gjykata, për të vërtetuar saktësisht datën e pranimit të vendimit të kontestuar nga parashtruesi, kërkoi prej Gjykatës Themelore në Prizren kopjen e fletëkthesës së dorëzimit të këtij vendimi.

10. Më 31 gusht 2015, Gjykata pranoi kopjen e fletëkthesës së kërkuar nga e cila vërtetohet se kërkesa ishte dërguar në Gjykatë brenda afatit prej 4 (katër) muajsh, të paraparë me Ligj.

11. Më 14 tetor2015,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 20 mars 2013, Gjykata Themelore në Prizren ka nxjerrë Aktvendimin për Rastin E. nr. 529/10, me të cilin ProCredit Bank - Dega në Prizren (në tekstin e mëtejmë: Banka), caktohet ofertues i vetëm i patundshmërisë e cila ka qenë objekt i hipotekës të paraqitur si garanci për kredinë e marrë nga parashtruesi. Me këtë aktvendim, kundërshtimet e palëve të treta, që pretendonin se janë bashkëpronarë të kësaj patundshmërie janë refuzuar dhe ato janë udhëzuar që të drejtat eventuale t'i realizojnë në procedurë kontestimore.

13. Më 20 mars 2013, (të njëjtën ditë), Gjykata Themelore në Prizren nxori konkluzionin me të cilin caktoiBankën blerëse të paluajtshmërive të cilat kanë qenë objekt i hipotekës, duke caktuar edhe çmimin për secilën paluajtshmëri.

14. Më 20 mars 2013, gjatë zhvillimit të të njëjtit proces, Gjykata Themelore në Prizren ka nxjerrë Aktvendimin E. nr. 529/2010, në bazë të të cilit Bankës i dorëzohen paluajtshmëritë e shitura në ankandin e tretë verbal publik. Të gjitha paluajtshmëritë janë të evidencuara në këtë aktvendim sipas të dhënave kadastrale, ndërsa sipas aktvendimit, Bankës, pas plotfuqishmërisë së aktvendimit i lejohet regjistrimi i të drejtës së pronës mbi paluajtshmëritë e dorëzuara nga gjykata.

15. Kundër këtyre dy vendimeve të Gjykatës Themelore parashtruesi, parashtroi ankesa në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve të procedurës përmbarimore, shkeljeve të së drejtës materiale dhe vendimit për dorëzimin e paluajtshmërive të parashtruesit te Banka, me pretendimin se pronat e dorëzuara me vendim gjyqësor nuk janë ekskluzivisht të parashtruesit, por janë bashkëpronësi me persona të tretë dhe me bashkëshorten e tij, andaj nuk kanë mundur të jenë objekt i tjetërsimit.

16. Më 14 korrik 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës ka nxjerrë Aktvendimin Ca. nr. 3875, me anë të cilit në pjesën e parë ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e parashtruesit kundër konkluzionit të Gjykatës Themelore, E. nr. 529/2010, të 20 marsit 2013, kurse në pjesën e dytë ka refuzuar, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të paraqitur kundër Aktvendimit E. nr. 529/10 të po kësaj gjykate, të të njëjtës datë duke e vërtetuar atë.

17. Nëarsyetimin e aktvendimit, Gjykata e Apelit kishte theksuar se "*kundër përfundimit në pajtim me nenin 12.7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nuk është e lejuar ankesa e posaçme*" ndërsa gjykata ka vlerësuar si të drejtë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë kur ka udhëzuar bashkëpronarët që të drejtat e tyre eventuale pronësore t'i realizojnë në pajtim me Ligjin në procedurë kontestimore.

18. Më 27 gusht 2014, parashtruesi ka parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për shkak të: 1) shkeljeve esenciale të procedurës përmbarimore dhe asaj kontestimore dhe 2) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

19. Më 23 dhjetor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë Aktvendimin, CML nr. 5/2014, me të cilin ka refuzuar, si të pabazuar

kërkesën e ngritur nga prokurori i shtetit për Mbrojtje të Ligjshmërisë Kundër Aktvendimit ë Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore në Prizren.

20. Gjykata Supreme, ndër të tjera, thotë: *"Ligjvënësi nuk ka paraparë mundësinë e paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë lidhur me përbërjen e trupit"* ndërsa përbërja e trupit gjykues ka qenë baza e ngritjes së kërkesës nga prokurori shtetit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se Aktvendimi Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, dhe në mënyrë specifike të drejtën e pronës, sepse prona e hipotekuar nuk ka qenë në tërësi e tij por bashkëpronësi, dhe nuk ka mundur të tjetërsohet, dhe as të jetë objekt i përmbarimit gjyqësor.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Për të gjykuar lidhur me kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

24. Ashtu siç u përmend më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi pohon se me aktgjykimin e kontestuar i është shkelur e drejta në mbrojtje të pronës (neni 46 i Kushtetutës) i cili ka këtë përmbajtje:

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i

autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.

4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

25. Lidhur me siç u përmend më lart, Gjykata thekson se parashtruesi vetëm ka potencuar shkeljen e kësaj dispozite kushtetuese por nuk ka ofruar asnjë provë të vetme për mënyrën dhe natyrën e shkeljes, për rrethanat eventuale në të cilat shkelja e pretenduar ka ndodhur, si dhe nuk ka shpjeguar cilat janë pasojat kushtetuese të shkeljeve të pretenduara.

26. Gjykata konsideron se vetëm përshkrimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës, si dhe pretendimi se ato janë shkelur pa paraqitur fakte për mënyrën e shkeljes, pa përcaktuar rrethanat, pa specifikuar dhe mbështetur me fakte valide veprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me normat kushtetuese, nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur Gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së.

27. Në këtë drejtim, edhe Gjykata për të Drejtat e Njeriut në rastin *S kundër Mbretërisë së Bashkuar,* ka theksuar se *"për t'u thirrur në mbrojtje nga neni 1 i Protokollit 1 personi duhet të gëzojë ndonjë të drejtë të paraparë me ligje vendore, që mund t'i referohet të drejtës në pronë"* (parashtresa 11716 viti 1986). Pra, nuk mjafton vetëm të paraqitet kërkesa dhe të pretendohet shkelja.

28. Gjykata duke bërë shqyrtimin e kërkesës së parashtruesit, dhe të fakteve të paraqitura me kërkesën, gjen se në të gjitha fazat e procesit gjyqësor ankesat e parashtruesit kanë qenë të karakterit ligjor, dhe se gjykatat e rregullta u kanë dhënë përgjigjeje adekuate këtyre ankimeve. Pretendimet për shkelje të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë për herë të parë janë ngritur në Gjykatën Kushtetuese.

29. Gjykata më tej konstaton se ajo nuk është gjykatë e faktit, nuk gjykon si gjykatë e shkallës së katërt dhe nuk është thjeshtë një instancë më tepër gjyqësore. Gjykata në parim nuk gjykon faktin nëse gjykatat e rregullta kanë konstatuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të

plotë apo nëse si në rastin konkret, nëse ka pasur shkelje të së drejtës materiale në kuptim të zhvillimit të procedurës përmbarimore.

30. Për Gjykatën janë thelbësore çështjet prej ekzistimit të të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të të drejtave kushtetuese, dhe jo çështjet qartazi ligjore që kryesisht kanë qenë fakte të paraqitura nga parashtruesi (Shih, *mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

31. Gjykata nuk gjen fakte të jetë shkelur neni 46 i Kushtetutës (Mbrojtja e pronës) ose që Aktvendimi i kontestuar të jetë tregues i ndonjë arbitrariteti të dukshëm. (Shih Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, Rasti KI128/12, i 12 korrikut 2013, të parashtruesit *Shaban Hoxha*, në kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 316/2011).

32. Gjykata gjithashtuvlerëson se kërkesa për mbrojtje të identitetit duhet të refuzohet, sepse parashtruesi me asnjë argument të vetëm nuk e ka mbështetur këtë kërkesë.

33. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtës kushtetuese për mbrojtjen e pronës, andaj në përputhje me rregullin 36 paragrafi 2 pika b, gjen se kërkesa duhet refuzuar, si qartazi e pabazuar, dhe ta deklarojë të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) (b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 14 tetor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

KI94/15, Parashtrues Lulzim Ramaj dhe Shahe Ramaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së një vendimi të paidentifikuar të një autoriteti të paidentifikuar

KI94/15, Aktvendim për papranueshmëri i 11 nëntorit 2015, publikuar më 31 dhjetor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e papranueshme, procedurë e shkurtër*

Në këtë rast, parashtruesit e kërkesës kanë pretendime për kompensim për shuma të tepruara financiare ndaj palëve të treta dhe një sërë pretendimesh tjera të pa mbështetura me asnjë provë. Parashtruesit edhe në të kaluarën kishin dorëzuar kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, duke ngritur pretendime të ngjashme.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se kërkesa e parashtruesve nuk e kalon pragun minimal që të konsiderohet kërkesë dhe shtoi se disa nga kërkesat e parashtruara nga këta parashtrues, tashmë janë refuzuar për shkak se kanë qenë abuzive dhe fyese për Gjykatën si institucion i drejtësisë. Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të papranueshme me procedurë të shkurtër, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës.

VENDIM PËR REFUZIMIN E KËRKESËS
në
Rastin nr. KI94/15
Parashtrues
Lulzim Ramaj dhe Shahe Ramaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së një vendimi të paidentifikuar të një autoriteti të paidentifikuar

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dh
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Lulzim Ramaj (i biri) dhe znj. Shahe Ramaj (e ëma) nga Peja (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë një vendim të paidentifikaur të një autoriteti të paidentifikuar.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit ankohen për shkak të zvarritjes së panevojshme të procedurave nga gjykatat e rregullta,dhe kjo kërkesë është në masë të madhe përsëritje e kërkesave të mëparshme të parashtruara nga parashtruesit e kërkesës, individualisht ose së bashku.

4. Objekti i çështjes së kërkesave të mëparshme kishte të bënte me njohjen e statusit të veteranit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, njoftimeve të Zyrës së Prokurorit Disiplinor dhe pretendimeve kundër zyrtarëve të caktuar të shërbimeve publike.

5. Parashtruesit e kërkesës nuk ia kanë bashkëngjitur "kërkesës" ndonjë vendim të "kontestuar", dhe as nuk i referohen ndonjë dispozite kushtetuese që pretendohet të jetë shkelur.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Në periudhën kohore ndërmjet 11 nëntorit 2014dhe24 gushtit 2015, parashtruesit e kërkesës dorëzuan nëntëmbëdhjetë herë (në data të ndryshme) në Gjykatën Kushtetuese tëRepublikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) gjithsej gjashtëqindedyzet e tetë dokumente që përbëjnë kërkesën e tanishme.

8. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 4 gusht 2015, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 15 shtator 2015, nga parashtruesit ishte kërkuar që ta sqarojnë dhe plotësojnë kërkesën e tyre.

11. Më 11 nëntor 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Përmbledhja e fakteve pasqyron veprimet e parashtruesve të kërkesës, që duke vepruar individualisht ose së bashku,synojnë një rezultat të përbashkët.

13. Më 18 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj parashtroi ankesë në Zyrën e Prokurorit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor (në tekstin e mëtejmë: Prokurori) për shkak të zvarritjes së rastit të tij (A. nr. 375/14). Ai u ankua se Gjykata Themelore në Prishtinë është duke e zvarritur dorëzimin e ankesës së tij në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

14. Më 19 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Gjykata Themelore në Prishtinë vendosi (Aktvendimi A. nr. 2544/2014, i 29 prillit 2015) të pezullojë procedurën sipas kërkesës së parashtruesit, sepse për të njëjtën çështje, ai kishte parashtruar kërkesë në GjykatënKushtetuese.

15. Më 17 nëntor 2014, parashtruesja e kërkesës Shahe Ramaj parashtroi ankesë te Prokurori për shkak të zvarritjes së lëndës të saj (C. nr. 1169/13) nga Gjykata e Apelit të Kosovës.

16. Më8janar 2015, Prokurori njoftoi(Njoftimi Nr.ZPD/14/ZP/015) parashtruesin e kërkesësLulzimRamaj,sepër shkak tëarsyeve objektive ka pasur vonesënë dërgimin e rastit në Gjykatëne Apelit. Parashtruesi i kërkesës LulzimRamaj,gjithashtu, ishte njoftuar se lënda është dërguar nëGjykatën e Apelitmë 18 shtator2014,dhese ai duhet të informojë Prokurorin nëse nuk vendoset brenda një kohe të arsyeshme.

17. Më 9 mars 2015, parashtruesi i kërkesës LulzimRamaj parashtroi ankesë te Prokurori lidhur me zvarritjen e lëndës(C. nr. 1560/11) nga GjykataThemelore në Prishtinë.

18. Më 10 mars 2015, Prokurori njoftoi (Njoftiminr.ZPD/14/ZP/148) parashtruesen e kërkesës Shahe Ramaj,që Gjykata e Apelit kishte vendosur lidhur me lëndën e saj Brenda një kohe të arsyeshme(Aktvendimi Ac. nr.903/13, 1dhjetor 2014).

19. Më 3 korrik 2015, Prokurorie njoftoi(Njoftimi Nr.ZPD/15/ZP/391) parashtruesin Lulzim Ramaj se ka pasur vonesë në zgjidhjen e lëndës së tij e cila ishte shkaktuar për shkak të numrit të madh të lëndëve të grumbulluara. Parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj ishte këshilluar që ta njoftojë Prokurorin në qoftë se lënda e tij nuk vendoset Brenda një kohe të arsyeshme.

20. Më 14 korrik 2015, Prokurori njoftoi (Njoftim nr. ZPD/15/zp/437) parashtruesen e kërkesës Shahe Ramaj se "*ZPD ka gjetur se, më 17 maj 2012, padia juaj është pranuar në Gjykatën Themelore në Pejë, ka marrë numrin C. nr. 388/12 dhe më 18 maj 2012, ju është ndarë në punë gjyqtarit AB.ZPD ka gjetur se, lënda juaj është vendosur me Aktvendim C. nr.388/12, të 9 dhjetorit 2013. Më3 korrik 2014, lënda C. nr.388/12, është dërguar me ankesë nga Gjykata Themelore nëPejë, në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Lënda në Gjykatën e Apelit të Kosovës, është pranuar më26 shkurt 2014, ka marrë numrin Ac. nr 683/14 dhe ju është ndarë në punë gjyqtarit MSH(tani i pensionuar). Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ac. nr. 683/14 të 12 janarit 2015, ka*

vendosur rastin tuaj. ZPD ka gjetur se, lënda juaj nga 29 prilli 2015, gjendet për vendosje nëGjykatën Supreme të Kosovës. Lënda juaj me revizion në Gjykatën Supreme, ka marr numrin Rev. nr.126/15 dhe pritet të vendoset sipas radhës".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesit e kërkesësankohen për shkak të zvarritjes sëlëndëve të tyrenga ana eGjykatës së Apelit dhe gjykatave themelorenë Prishtinë dhePejë.

22. Parashtruesit e kërkesës ankohen konkretisht ndaj aktvendimeve të mëparshme për papranueshmëri kundër menaxherit të Postës Rajonale në Pejë, kundër pronarit dhe gazetarit të gazetës"Express", kundër një pale të tretë për shkak të pengimit në posedim të pronës, kundër Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe kundër Policisë së Kosovës për shkak tënxitjes së vëllezërve të tij kundër tij.

23. Parashtruesit e kërkesës nuk i referohen asnjë dispozite kushtetuese e cila pretendohet të jetë shkelur.

24. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë që të kompensohen në shumë prej 2 milion eurosh nga drejtori I gazetës "Telegraf" nga Shqipëria.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

    "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

27. Gjykata i referohet rregullit 32 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] së Rregullores së punës, i cili parasheh:

    "(...)

    (5) Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër

kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkese të mëparshme të vendosur në qoftë se kërkesa është joserioze e në qoftë se kërkesa është joserioze".

28. Gjykata konsideron se parashtruesit kanë parashtruar një kërkesë që është e paqartë dhe e pakuptueshme. Përveç kësaj, kërkesa është në masë të madhe përsëritje e kërkesave të mëparshme tashmë të vendosura, edhe pse kërkesa e tanishme është parashtruar me disa ndryshime të caktuara me qëllim të ngritjes së pretendimeve të reja.

29. Megjithatë, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur, apo ngritur asnjë informatë apo pretendim të ri.

30. Për më tepër,Gjykatavëren sepërmbajtja evendimeve tëgjykatave të rregullta është e panjohur për shkak se asnjë nga vendimet nuk i është bashkëngjitur kërkesës.

31. Përveç kësaj, nuk ka asgjë në kërkesën e tanishme që tregon se parashtruesit kanë iniciuar dhe përfunduar ndonjë lloj procedure, qoftë civile, penale ose administrative para ndonjë autoriteti public të Republikës së Kosovës, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës,dhe ata nuk kishin arritur që të dëshmojnë, gjegjësisht, që kërkesa e tyre të ketë kuptim në çfarëdo mënyre qoftë.

32. Gjykata vëren më tej se parashtruesit e kërkesës nuk kanë qartësuar dhe plotësuar kërkesën e tyre, siç kërkohet nga Gjykata.

33. Gjykata rikujton lidhur me objektet e çështjeve identike tashmë është vendosur në nëntë kërkesa të tjera,të parashtruaranga parashtruesit: Aktvendimpër papranueshmërinë Rastin nr. KI126/10(parashtrues: LulzimRamaj), Aktvendimpër papranueshmërinë Rastin nr. KI32/11(parashtrues: LulzimRamaj), Aktvendim për papranueshmëri, në Rastin nr. KI102/11(parashtruese: ShaheRamaj), Aktvendim për papranueshmëri në Rastin nr.KI106/12(parashtrues: LulzimRamaj), Aktvendim për papranueshmëri në Rastin nr. KI116/12(parashtrues: LulzimRamaj) dhe Aktvendim për papranueshmëri në rastet e bashkuara nr. KI228/13, KI04/14, KI11/14, KI13/14(parashtrues të kërkesës: Lulzim Ramaj dhe Shahe Ramaj).

34. Gjykata më tej rikujton se në kërkesën KI228/13 (kërkesat e bashkuara KI04/14, KI11/14, KI13/14), parashtruesit e kërkesës Lulzim Ramaj dhe Shahe Ramaj ishin ankuar kundër Aktvendimit për papranueshmëri në Rastin nr.KI126/10, të 19 janarit 2012; Aktvendimit për papranueshmëri në Rastin nr. KI32/11, të 20 prillit

2012; dhe Aktvendimit për papranueshmërinë Rastin nr. KI102/11, të 12 dhjetorit 2011.

35. Gjykata vëren se të gjitha kërkesat e mëparshme përmbajnë objekte individuale ose të përbashkëta të çështjes, megjithatë, të gjitha ato bashkohen në kërkesën e tanishme.

36. Gjykata konsideron se kërkesa e tanishme nuk e kalon pragun minimal që të konsiderohet kërkesë. Përveç kësaj,Gjykata vëren se disa nga kërkesat e parashtruara nga këta parashtrues tashmë janërefuzuar për shkak se kanë qenë abusive dhe fyese për Gjykatën si institucioni drejtësisë (Shih Aktvendiminpër papranueshmëri, në rastet e bashkuara nr. KI228/13, KI04/14,KI11/14,KI13/14).

37. Si përmbledhje, Gjykata gjen se kërkesa nuk është e qartë dhe përkundër kërkesave nga Gjykata për ta plotësuar apo qartësuar atë, ajo është disi përsëritje e kërkesavetë mëparshme,tashmë të vendosura nga Gjykata,dhe është joserioze.

38. Prandaj, Gjykata në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, konstaton se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër dhe rrjedhimisht është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, më 11 nëntor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi

INDEKSI I SHPREHJEVE LIGJORE

TERMAT	NUMRI I FAQËS
A	
Actio popularis	40, 44,
Adoptim	483, 485, 486, 487, 488, 489,
Ankand publik	715, 718,
Aktgjykim	15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 34, 35, 36, 37, 38, 47, 48, 49, 50, 51, 53, 55, 56, 59, 60, 61, 62, 64, 65, 77, 81, 82, 85, 86, 87, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 96, 97, 98, 100, 101, 102, 103, 104, 110, 111, 112, 113, 114, 117, 118, 119, 120, 121, 126, 127, 128, 129, 130, 131, 133, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 142, 143, 144, 145, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 154, 155, 157, 158, 160, 161, 162, 163, 164, 166, 167, 169, 170, 171, 172, 174, 175, 177, 178, 179, 180, 181, 182, 183, 185, 186, 189, 190, 191, 192, 193, 194, 195, 197, 199, 200, 202, 203, 205, 209, 211, 212, 214, 215, 216, 217, 218, 223, 224, 234, 237, 238, 239, 240, 241, 242, 252, 253, 255, 257, 259, 260, 262, 264, 272, 273, 275, 276, 277, 278, 284, 285, 286, 287, 295, 296, 299, 300, 301, 310, 315, 316, 317, 323, 326, 327, 328, 330, 331, 333, 334, 335, 336, 337, 338, 339, 348, 350, 351, 353, 366, 367, 368, 369, 370, 371, 372, 373, 374, 375, 376, 377, 379, 380, 381, 382, 384, 385, 387, 389, 388, 393, 394, 395, 397, 398, 401, 402, 404, 405, 408, 409, 410, 411, 412, 413, 415, 416, 417, 418, 419, 421, 422, 423, 425, 427, 428, 429, 430, 432, 433, 434, 435, 436, 437, 438, 444, 447, 448, 449, 450, 451, 452, 453, 454, 455, 457, 458, 459, 461, 463, 478, 479, 480, 481, 482, 491, 493, 494, 495, 496, 497, 499, 500, 501, 502, 504, 505, 510, 512, 513, 518, 525, 530, 531, 536, 537, 538, 539, 540, 542, 546, 547, 548, 549, 550, 551, 552, 554, 555, 557, 559, 560,

566, 569, 571, 572, 574, 575, 577, 578, 579, 580, 582, 583, 585, 586, 589, 590, 591, 597, 601, 610, 611, 619, 620, 622, 624, 635, 641, 644, 645, 654, 655, 669, 670, 671, 672, 698, 699, 705, 706, 707, 708, 709, 710, 711, 712, 713, 719, 721,

Aktvendimi

15, 16, 20, 21, 26, 28, 29, 30, 31, 34, 35, 37, 38, 40, 41, 47, 49, 50, 51, 53, 55, 56, 59, 61, 71, 86, 87, 94, 96, 97, 99, 104, 107, 108, 111, 112, 113, 115, 116, 123, 124, 125, 127, 128, 129, 130, 131, 132, 133, 135, 136, 137, 140, 141, 143, 144, 145, 146, 147, 152, 155, 158, 160, 161, 164, 166, 169, 170, 171, 177, 178, 179, 181, 190, 191, 193, 197, 201, 205, 214, 215, 220, 221, 226, 227, 228, 230, 231, 233, 234, 237, 238, 241, 244, 245, 248, 250, 252, 253, 254, 257, 259, 260, 266, 267, 270, 272, 273, 278, 281, 282, 283, 284, 287, 295, 296, 301, 303, 304, 306, 307, 308, 309, 310, 312, 313, 333, 334, 339, 341, 342, 343, 345, 346, 347, 349, 350, 351, 352, 359, 360, 361, 362, 363, 364, 365, 366, 367, 368, 370, 372, 374, 376, 377, 384, 385, 386, 390, 392, 393, 398, 401, 402, 408, 409, 411, 412, 413, 415, 416, 423, 424, 425, 427, 430, 432, 433, 438, 440, 441, 442, 443, 444, 445, 447, 448, 450, 455, 457, 463, 475, 476, 477, 479, 480, 482, 483, 484, 486, 487, 488, 489, 490, 491, 495, 496, 499, 500, 507, 508, 510, 511, 512, 513, 515, 516, 517, 518, 520, 522, 523, 526, 530, 536, 537, 542, 544, 545, 547, 549, 550, 551, 552, 554, 555, 560, 562, 563, 564, 566, 567, 568, 569, 571, 572, 577, 578, 579, 580, 585, 586, 587, 588, 589, 590, 591, 592, 594, 595, 602, 604, 605, 607, 609, 610, 611, 613, 614, 615, 616, 617, 618, 619, 620, 664, 690, 691, 696, 699, 702, 703, 704, 709, 710, 711, 715, 716, 717, 718, 719, 721, 722, 725, 726, 727, 728,

Amendamentim 312, 313, 314, 315, 316, 317, 318, 319, 320, 321, 322, 323, 324, 325, 326, 327, 328, 329, 330, 331, 356, 639, 647, 655, 656, 660, 664, 666, 668, 669,

Ankesë 23, 25, 28, 31, 82, 89, 90, 100, 110, 149, 154, 158, 159, 209, 212, 217, 223, 225, 227, 228, 229, 231, 239, 240, 244, 247, 272, 273, 274, 275, 276, 277, 278, 295, 298, 299, 307, 309, 329, 331, 333, 334, 335, 337, 338, 350, 362, 363, 364, 365, 381, 384, 387, 388, 389, 390, 404, 411, 422, 424, 425, 427, 428, 430, 434, 435, 436, 445, 450, 451, 479, 487, 502, 510, 512, 518, 522, 526, 527, 528, 529, 530, 531, 532, 539, 547, 549, 550, 557, 565, 566, 574, 575, 576, 575, 582, 588, 592, 594, 596, 598, 599, 600, 605, 607, 608, 610, 611, 616, 617, 636, 656, 658, 690, 691, 693, 694, 700, 705, 706, 708, 718, 720, 725,

Ankesë kushtetuese 529, 532, 535,

Avokat 16, 17, 21, 35, 48, 73, 74, 87, 116, 124, 130, 161, 170, 178, 191, 198, 253, 260, 282, 312, 314, 321, 334, 342, 370, 393, 395, 398, 402, 417, 441, 448, 457, 462, 463, 468, 473, 484, 494, 537, 588, 614, 626, 649, 703, 711, 716,

B

Baza Juridike 17, 22, 30, 36, 49, 56, 66, 88, 98, 109, 117, 125, 137, 148, 156, 162, 171, 179, 199, 210, 216, 222, 229, 239, 245, 254, 261, 268, 274, 283, 291, 297, 305, 314, 335, 343, 356, 361, 368, 378, 386, 394, 403, 410, 417, 426, 434, 442, 449, 458, 467, 477, 485, 495, 501, 509, 517, 523, 529, 537, 545, 556, 563, 572, 581, 587, 595, 606, 615, 625, 646, 692, 704, 712, 717, 724,

D

Deklarata Universale për të Drejta të Njeriut 98, 128, 163, 172, 210, 277, 291, 292, 314, 321, 347, 356, 359, 379, 380, 389, 449, 460, 702,

Dënim me burg 15, 20, 160, 169, 376, 392, 394, 415, 432, 447,

Drejtat e të akuzuarit 20, 21, 25,

Dëgjimi i dëshmitarëve 169, 173, 450, 451,

E

E drejta ndërkombëtare 188, 206, 207,

E drejta e qasjes në dokumente publike 355, 462,

E drejta e pronës 47, 83, 84, 86, 107, 177, 227, 256, 257, 295, 299, 424, 429, 440, 594, 702, 715, 720, 719,

E drejta për pension 107, 109, 110, 111, 112, 146, 147, 149, 150, 156, 157, 214, 217, 233, 281, 283, 284, 371, 554, 556, 557, 558, 560, 725,

E drejta për kompensim 68, 69, 72, 76, 79, 80, 82, 86, 88, 98, 101, 107, 108, 110, 115, 118, 120, 121, 146, 147, 149, 150, 181, 185, 192, 214, 217, 218, 230, 257, 285, 303, 305, 306, 307, 336, 337, 338, 340, 417, 418, 429, 460, 475, 477, 480, 544, 546, 547, 557, 562, 565, 566, 567, 568, 608, 613, 617, 618, 619, 720, 722,

E drejta e martesës 51, 483, 484,

Ex officio 175, 480,

F

Forma e prerë dhe zbatimi i vendimeve 64,

GJ

Gjyqtar 14, 16, 17 21, 22, 29, 30, 35, 36, 41, 42, 48, 49, 56, 57, 65, 66, 67, 87, 88, 97, 98, 108, 109, 116, 117, 124, 125, 126, 136, 138, 147, 148, 155, 156, 161, 162, 170, 171, 178, 179, 180, 189, 198, 199, 200, 210, 211, 215, 216, 221, 222, 228, 229, 238, 239, 245, 246, 253, 254, 260, 261, 266, 267, 266, 269, 273, 274, 282, 283, 290, 291, 296, 297, 304, 313, 314, 318, 319, 321, 334, 342, 344, 355, 356, 361, 362, 368, 369, 371, 377, 378, 385, 386, 393, 394, 402, 403, 409, 410, 416, 417, 418, 419, 425, 426, 433, 434, 441, 442, 448, 458, 459, 466, 467, 476, 477, 478, 484, 485, 494, 495, 500, 501, 508, 509, 516, 517, 523, 524, 528, 529, 537, 538, 545, 546, 555, 556, 563, 572, 573, 580, 581, 586, 587, 595, 596, 605, 606, 614, 615, 624, 625, 672, 689, 691, 692, 694, 696, 703, 704, 711, 712, 716, 717, 723, 724, 725,

Gjyqtari raportues 19, 27, 33, 46, 54, 95, 106, 114, 122, 134, 138, 145, 176, 196, 208, 212, 213, 219, 226, 236, 258, 265, 271, 280, 288, 292, 294, 302, 311, 340, 353, 358, 366, 375, 383, 400, 407, 414, 423, 426, 431, 439, 446, 456, 464, 482, 492, 498, 506, 514, 529, 535, 543, 553, 561, 570, 578, 584, 593, 603, 612, 701, 709, 714, 728,

I

Inter alia 26, 64, 68, 71, 79, 95, 104, 113, 134, 144, 192, 223, 224, 277, 298, 301, 330, 369, 371, 379, 398, 469, 473, 491, 513, 539, 540, 546, 547, 549, 550, 569, 597, 632, 638, 640, 646, 647, 648, 650, 654, 678, 684, 692, 693,

J

Juridiksion i Gjykatës Kushtetuese 191, 197, 207, 270, 312, 325, 329, 396, 400, 465, 470, 473, 497, 498, 649, 661, 662, 668, 699,

Juridiksion i GJEDNJ 53,

Juridiksion i gjykatave të rregullta 121, 166, 264, 314, 321, 379, 380, 406, 422, 479, 504, 531, 541, 552, 598, 602, 622, 642, 643, 644, 646, 690,

K

Kallëzim penal 20, 22, 28, 696,

Kërkesë individuale 15, 20, 28, 34, 40, 47, 55, 64, 86, 96, 107, 115, 123, 135, 146, 154, 160, 169, 177, 197, 209, 214, 220, 227, 237, 244, 252, 259, 266, 272, 281, 289, 295, 303, 333, 341, 354, 360, 367, 376, 384, 392, 401, 408, 415, 424, 432, 440, 447, 457, 475, 483, 493, 499, 507, 515, 522, 527, 436, 544, 554, 562, 571, 579, 585, 594, 604, 613, 690, 702, 710, 715, 722,

Kërkesë institucionale 312, 465, 622,

Kërkesë qartazi e pabazuar 20, 47, 55, 86, 96, 107, 115, 123, 135, 146, 160, 169, 177, 197, 227, 237, 244, 252, 259, 272, 281, 295, 303, 312, 333, 341, 360, 367, 392, 401, 408, 415, 424, 432, 481, 499, 515, 536, 544, 562, 571, 585, 604, 613, 690, 715,

Kërkesë e paafatshme 15, 28, 135, 214, 214, 376, 384, 457, 579, 710,

Kërkesë e parakohshme 341, 634,

Kërkesë e pranueshme 64,

Kërkesë e papranueshme 34, 40, 209, 220, 266, 289, 354, 493, 722,

Kundërvajtje 360, 362, 363, 365, 613, 615, 616, 617,

Krim i organizuar 135, 139, 587,

Krime lufte 376, 395,

Kontroll abstrakt	312, 622, 629,
Kujdestari ligjor	483, 486, 488, 490,
Kthim në gjendjen e mëparshme (restitutio in integrum)	515, 516, 520,
Kodi Penal i Kosovës (KPK)	22, 23, 139, 163, 239, 255, 295, 298, 299, 300, 301, 434, 451, 595, 596, 598, 600, 601,
Kodi i Procedurës Penale të Kosovës	23, 123, 124, 127, 128, 129, 130, 131, 132, 133, 135, 139, 141, 172, 239, 381, 421, 435, 450, 451, 588, 589,
Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penal i Kosovës (KPPK)	30, 127, 446, 694, 695, 700,
Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme	181, 182, 183, 186, 189, 190, 192, 193, 194, 198, 199, 200, 201, 202, 203, 206, 228, 231, 233, 234, 244, 245, 247, 248, 249, 250, 272, 273, 274, 277, 295, 296, 299, 301, 333, 334, 335, 338, 341, 342, 343, 346, 350, 351, 418, 425, 427, 428, 430, 527, 528, 530, 601,
Kolegji i Apelit i Gjykatës Supreme të Kosovës	227, 295, 370,
Kolegji shqyrtues	17, 22, 30, 36, 42, 49, 57, 66, 67, 88, 98, 99, 109, 117, 125, 126, 129, 138, 148, 156, 162, 163, 167, 177, 178, 179, 180, 211, 216, 222, 229, 235, 239, 246, 254, 261, 268, 279, 291, 297, 314, 344, 345, 356, 362, 369, 378, 386, 388, 394, 401, 410, 417, 426, 434, 442, 449, 450, 459, 472, 477, 478, 485, 495, 501, 509, 517, 524, 529, 531, 533, 538, 546, 556, 564, 573, 581, 587, 596, 606, 615, 625, 692, 704, 712, 717, 724,
Kontest pune	115, 146,

Kontrata e punës 47, 58, 62, 117, 118, 148, 150, 152, 259, 261, 262, 285, 544, 546, 557, 562, 564, 568, 573, 574, 577, 665,

Kontrata për mbajtje të përjetshme 49, 50, 52,

Kontratë për shitblerje 67, 70, 71, 75, 80, 90, 200, 201, 204, 209, 211, 246, 298, 300, 336, 344, 387, 442, 501, 702, 704, 705, 708,

Kontrabandim me emigrantë 135, 137, 139, 141,

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut 22, 23, 64, 66, 73, 74, 75, 78, 97, 109, 115, 116, 170, 179, 228, 257, 260, 263, 270, 296, 305, 335, 347, 378, 393, 449, 485, 508, 511, 529, 558, 559, 586, 600, 606, 686, 688, 691, 703, 715,

Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e denimeve tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese 393, 396,

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve 488, 491,

Konventa lidhur me Statusin e Refugjatëve 610,

Kodi i etikës 463, 522, 524,

L

Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës 15, 17, 18, 19, 22, 24, 27, 30, 31, 32, 33, 36, 37, 39, 46, 47, 49, 52, 54, 56, 63, 66, 77, 78, 79, 84, 88, 95, 96, 98, 102, 106, 107, 109, 117, 122, 125, 130, 135, 137, 142, 143, 145, 146, 148, 151, 156, 162, 163, 168, 169, 171, 173, 175, 176, 179, 188, 199, 208, 210, 211, 214, 216, 218, 220, 224, 225, 227, 232, 235, 239, 241, 243, 245, 251, 254,

	256, 261, 263, 265, 268, 269, 270, 271, 274, 278, 280, 286, 287, 289, 292, 293, 294, 295, 297, 299, 301, 302, 332, 333, 334, 340, 343, 348, 353, 354, 356, 357, 358, 359, 361, 364, 366, 367, 368, 372, 373, 374, 376, 381, 382, 383, 386, 389, 390, 394, 397, 399, 401, 403, 405, 407, 408, 410, 412, 413, 415, 417, 420, 423, 426, 428, 431, 434, 436, 438, 439, 440, 442, 444, 446, 449, 453, 456, 457, 458, 462, 463, 464, 467, 472, 482, 485, 495, 497, 498, 503, 505, 506, 509, 511, 513, 514, 517, 519, 520, 523, 524, 525, 526, 527, 529, 532, 534, 535, 536, 537, 541, 542, 543, 544, 545, 552, 553, 554, 558, 561, 562, 563, 564, 567, 569, 572, 576, 579, 581, 583, 584, 585, 587, 590, 593, 594, 596, 601, 603, 604, 606, 613, 615, 619, 621, 625, 634, 636, 657, 692, 709, 710, 712, 713, 714, 715, 717,
Ligji për Gjykatat	422, 612,
Ligji Nr 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Kosovës	40, 41, 42, 43, 44, 45,
Avokati i Popullit	74, 191, 312, 314, 320, 321, 463, 473, 649,
Ligji Nr. 03/L-079 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit	79, 182, 183, 190, 194, 195,
Ligji për Procedurën Administrative	187, 370,
Ligji për Prokurimin Publik	266, 267, 550, 685,
Ligji për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit së Terrorizmit	360, 362,
Ligji për kundërvajtje	359,

Ligji për Marrëdhëniet Detyrimore	338,
Ligji për Procedurën Kontestimore	60, 61, 90, 92, 94, 101, 111, 113, 114, 157, 202, 283, 285, 306, 308, 310, 311, 314, 477, 480, 547, 718, 721, 722, 728,
Ligji për Procedurën Përmbarimore	487,
Ligji i Punës	60, 61, 119, 120, 150, 152, 481, 659,
Lëndim i rëndë trupor	28, 30, 31,
Lëndim trupor	214,
Legjitimiteti aktiv	86, 227,
Legjitimiteti pasiv	104, 401, 402, 404,
Lirim me kusht	135, 136, 137, 140, 141, 143, 145,
Lirim me dorëzani	585, 588, 590,

M

Masa e Përkohshme	20, 27, 30, 40, 44, 45, 115, 160, 167, 227, 235, 244, 268, 279, 341, 352, 432, 472, 474, 527, 532, 533, 535, 585, 589, 671,
Mjetet Juridike (e Drejta **për Mjete Juridike)**	20, 24, 25, 32, 52, 58, 61, 66, 68, 74, 77, 78, 97, 103, 128, 160, 162, 164, 165, 166, 179, 183, 218, 224, 225, 232, 241, 249, 256, 269, 276, 286, 348, 349, 364, 365, 373, 381, 396, 397, 412, 420, 428, 441, 444, 462, 475, 477, 480, 481, 522, 525, 526, 529, 531, 540, 551, 575, 583, 601, 602, 604, 605, 608, 612, 613, 614, 618, 663, 698, 706, 713, 719, 726,
Mutatis mutandis	62, 63, 77,83, 94, 95, 104, 113, 121, 133, 134, 151, 225, 226, 234, 242, 250, 257, 264, 265, 278, 287, 301, 310, 326, 350, 374, 390, 398, 407, 422, 430, 438, 445, 455, 463, 482, 491, 505, 513, 526, 542, 552, 569, 577, 602, 620,

699, 721,

Mos zbulim i identitetit 160, 432, 438, 710,

Marrje e ryshfetit 200, 263,

N

Ndalimi i diskriminimit 66, 71, 75, 78, 102, 130, 272, 275, 277, 298, 319, 387, 406, 460, 461, 606, 611, 612, 657, 661, 685, 686, 687, 688, 689, 706, 707, 708,

Ndërmarrje shoqërore 67, 99, 104, 177, 180, 181, 185, 187, 200, 201, 220, 221, 227, 229, 230, 231, 233, 246, 272, 274, 275, 277, 289, 336, 337, 343, 344, 345, 356, 384, 387, 388, 480, 530, 532, 579, 582, 596, 598, 637, 658, 667,

O

Organizatë joqeveritare (OJQ) 115, 116, 270, 403, 503, 536, 541, 548, 573, 637, 639, 649, 650, 655, 657, 659, 660, 665, 676, 684,

P

Palë e autorizuar 45, 166, 191, 195, 270, 324, 373, 396, 397, 465, 470, 622, 642, 643, 644, 646, 649, 661, 662, 668, 669, 698, 699,

Parashtruesi i kërkesës 13, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 28, 29, 30, 31, 32, 34, 35, 36, 37, 38, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95, 96, 97, 98, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 107, 108, 109, 110, 111, 112, 113, 114, 115, 116, 117, 118, 119, 120, 121, 122, 123, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130, 131, 132, 133, 134, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 154, 155, 156, 157, 158, 159, 160, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 168,

169, 170, 171, 172, 173, 174, 175, 177, 178, 179, 180, 181, 182, 183, 184, 185, 186, 188, 189, 190, 191, 192, 193, 194, 195, 196, 197, 198, 199, 201, 203, 204, 205, 206, 207, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224, 225, 226, 227, 228, 229, 230, 231, 232, 233, 234, 235, 237, 238, 239, 240, 241, 242, 244, 245, 246, 247, 248, 249, 250, 252, 253, 254, 255, 256, 257, 258, 259, 260, 261, 262, 263, 264, 265, 267, 268, 269, 270, 272, 273, 274, 275, 276, 277, 278, 279, 281, 282, 283, 284, 285, 286, 287, 289, 290, 291, 292, 293, 294, 295, 296, 297, 298, 299, 300, 301, 302, 303, 304, 305, 306, 307, 308, 309, 310, 312, 313, 314, 315, 317, 318, 319, 320, 321, 322, 323, 324, 325, 327, 328, 329, 330, 331, 333, 334, 335, 336, 337, 338, 339, 340, 341, 342, 343, 344, 345, 346, 347, 348, 349, 350, 351, 352, 353, 354, 355, 356, 357, 358, 359, 360, 361, 362, 363, 364, 365, 366, 367, 368, 369, 370, 371, 372, 373, 374, 375, 376, 377, 378, 379, 380, 381, 382, 384, 385, 386, 387, 388, 389, 390, 392, 393, 394, 395, 396, 397, 398, 399, 400, 401, 402, 403, 404, 405, 406, 407, 408, 409, 410, 411, 412, 413, 414, 416, 417, 418, 419, 420, 421, 422, 423, 424, 425, 426, 427, 428, 429, 430, 432, 433, 434, 435, 436, 437, 438, 439, 440, 441, 442, 443, 444, 445, 447, 448, 449, 450, 451, 452, 453, 454, 455, 457, 458, 459, 460, 461, 462, 463, 466, 467, 468, 469, 470, 471, 472, 473, 475, 476, 477, 478, 479, 480, 481, 482, 483, 484, 485, 486, 487, 488, 489, 490, 491, 492, 493, 494, 495, 496, 497, 498, 499, 500, 501, 502, 503, 504, 505, 508, 509, 510, 511, 512, 513, 515, 516, 517, 518, 519, 520, 522, 523, 524, 525, 526, 527, 528, 529, 530, 531, 532, 533, 534, 536, 537, 538, 539, 540, 541, 542, 544, 545, 546, 547, 549, 550, 551, 552, 553, 554, 555, 556, 557, 558, 559, 560, 562, 563, 564, 565, 566, 567, 568, 569, 571, 572, 573,

	574, 575, 576, 577, 578, 579, 580, 581, 582, 583, 585, 586, 587, 588, 589, 590, 591, 592, 593, 594, 595, 596, 597, 598, 599, 600, 601, 602, 604, 605, 606, 607, 608, 609, 610, 611, 612, 613, 614, 615, 616, 617, 618, 619, 620, 621, 622, 624, 625, 626, 627, 629, 641, 642, 644, 645, 646, 669, 673, 675, 690, 691, 692, 693, 694, 695, 698, 699, 700, 702, 703, 704, 705, 706, 707, 708, 709, 710, 711, 712, 713, 714, 715, 716, 717, 718, 719, 720, 721, 722, 723, 724, 725, 726, 727, 728,
Pretendimet e parashtruesit	18, 20, 23, 25, 26, 31, 37, 38, 43, 51, 52, 53, 54, 60, 62, 63, 71, 74, 82, 86, 91, 93, 95, 101, 103, 105, 111, 112, 115, 116, 119, 123, 128, 129, 132, 154, 158, 164, 173, 177, 183, 184, 185, 189, 191, 192, 193, 196, 197, 203, 205, 211, 212, 213, 224, 231, 233, 235, 240, 242, 247, 250, 255, 262, 269, 276, 278, 285, 292, 299, 302, 307, 308, 329, 331, 333, 338, 339, 340, 341, 346, 347, 348, 349, 351, 352, 354, 357, 359, 362, 364, 365, 367, 372, 379, 388, 390, 395, 399, 401, 404, 408, 415, 419, 422, 424, 428, 429, 430, 432, 435, 436, 437, 440, 443, 451, 452, 453, 454, 460, 461, 471, 480, 489, 491, 492, 495, 496, 497, 503, 504, 511, 512, 513, 518, 525, 540, 550, 558, 562, 568, 569, 571, 575, 577, 582, 589, 592, 596, 600, 608, 611, 612, 617, 618, 619, 695, 706, 707, 708, 719, 720, 726,
Pranueshmëria e kërkesës	18, 24, 31, 37, 44, 51, 60, 76, 92, 102, 111, 119, 130, 141, 151, 158, 164, 188, 204, 212, 218, 232, 248, 256, 263, 269, 276, 285, 292, 299, 308, 323, 338, 348, 357, 364, 380, 388, 396, 405, 412, 419, 428, 436, 444, 453, 462, 481, 489, 497, 503, 511, 519, 540, 551, 558, 567, 575, 583, 590, 601, 608, 619, 642, 706, 712, 719, 726,
Prokurori i Shtetit	18, 22, 29, 30, 31, 123, 124, 126, 127, 128, 129, 130, 131, 132, 133, 134, 139, 163, 239, 240, 318, 319, 320, 357, 370, 371, 395, 411, 418, 419, 450,

	451, 452, 479, 487, 524, 547, 548, 550, 587, 588, 589, 690, 693, 694, 695, 696, 697, 700, 715, 718, 719, 723, 724, 725,
Procedura në Gjykatën Kushtetuese	17, 22, 30, 36, 42, 49, 57, 66, 88, 98, 109, 117, 125, 138, 148, 156, 158, 162, 171, 179, 199, 211, 216, 222, 229, 239, 246, 254, 261, 268, 274, 283, 291, 297, 305, 314, 335, 343, 356, 362, 369, 378, 386, 394, 403, 410, 417, 426, 434, 442, 449, 459, 467, 477, 485, 495, 501, 509, 517, 524, 529, 538, 546, 556, 564, 573, 581, 587, 596, 606, 615, 625, 664, 681, 692, 704, 712, 717, 724,
Prima facie	20, 25, 26, 27, 40, 45, 62, 93, 112, 113, 120, 122, 160, 165, 167, 173, 174, 188, 227, 234, 235, 237, 241, 249, 256, 263, 277, 279, 286, 294, 300, 301, 308, 352, 354, 359, 364, 367, 373, 374, 397, 405, 408, 412, 420, 428, 437, 438, 453, 472, 473, 489, 491, 504, 511, 513, 519, 533, 551, 559, 567, 569, 576, 591, 613, 620, 690, 707,
Privim i kundërligjshëm i lirisë	28,
Përsëritje e procedures penale	111, 129, 231, 282, 284, 286, 475, 479, 480, 487,
Paanshmëria e prokurorit	123,
Person i pautorizuar	177,
Procesi i privatizimit	177, 178, 179, 180, 182, 185, 186, 187, 193, 195, 197, 198, 199, 200, 205, 220, 221, 227, 230, 244, 246, 272, 273, 274, 275, 276, 277, 279, 289, 290, 292, 293, 295, 296, 310, 333, 334, 335, 336, 339, 341, 342, 343, 344, 347, 350, 354, 355, 357, 358, 384, 385, 387, 388, 455, 475, 479, 527, 528, 529, 530, 579, 580, 581, 582, 594, 596, 598, 599,

Procedurë e shkurtër 722,

Procedurë penale 15, 23, 31, 51, 123, 124, 127, 128, 129, 130, 131, 132, 133, 135, 139, 141, 160, 172, 239, 381, 392, 399, 421, 435, 450, 451, 588, 589, 694, 695, 700,

Parimi i subsidiaritetit 220, 225, 349, 390, 445, 475, 482, 522, 526, 594, 602, 706, 707, 708,

Parimi i barazisë 184, 341,

Parashkrim fitues 333, 337,

Përkujdesje sociale 367, 369, 400,

R

Ratione temporis 325, 690, 694, 699, 700,

Ratione materiae 197, 207, 266, 270, 312, 325, 465, 470, 473, 641,

Res judicata (cështje e gjykuar) 105, 123, 295, 299, 300, 301, 323, 530,

Rendi juridik i Kosovës 225, 349, 390, 445, 482, 526, 602,

Revizioni 50, 51, 59, 61, 87, 89, 90, 91, 93, 95, 96, 97, 101, 103, 107, 110, 112, 118, 146, 147, 150, 155, 157, 214, 215, 217, 259, 262, 264, 281, 282, 284, 286, 303, 304, 307, 309, 371, 372, 401, 404, 479, 480, 483, 488, 491, 499, 502, 504, 507, 508, 510, 511, 512, 518, 536, 540, 544, 547, 548, 549, 550, 551, 552, 554, 555, 566, 571, 575, 613, 617, 619, 654, 702, 706, 708, 710, 712, 726,

Rigjykim 18, 51, 59, 90, 118, 126, 157, 158, 217, 239, 284, 337, 411, 419, 511, 518, 557, 618,

Rrethana lehtësuese 163, 411, 415, 419, 435,

Rrethana rënduese 163, 411, 419,

S

Seancë	17, 19, 27, 39, 46, 63, 84, 235, 242, 250, 258, 279, 287, 306, 315, 321, 323, 324, 366, 394, 400, 403, 413, 435, 461, 468, 471, 473, 480, 514, 521, 526, 553, 570, 578, 584, 612, 621, 639, 640, 670, 704, 714,
Sistemi Gjyqësor	195, 266, 269, 314, 320, 321, 522, 523, 525,
Shërbimi Doganor	360,
Shpëlarje e parave	360, 362, 363,
Shpërdorim i detyrës zyrtare	20, 22, 415, 417, 418,
Suksedimi juridiko-ligjor	96,
Statusi i ndërhyrësit	197, 198, 202, 203, 204, 205,

T

Të drejtat e fëmijëve	140, 141, 483, 484, 485,

U

Uzurpim i pronës	594,

V

Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimit	16, 20, 34, 35, 47, 48, 55, 56, 87, 96, 97, 115, 135, 136, 146, 147, 154, 155, 160, 161, 169, 170, 177, 178, 197, 198, 209, 214, 215, 237, 238, 252, 259, 260, 295, 296, 333, 334, 367, 368, 376, 377, 384, 385, 392, 393, 401, 408, 409, 415, 424, 432, 433, 447, 448, 457, 458, 499, 536, 537, 554, 555, 571, 572, 579, 580, 585, 586, 702, 703, 710, 711,

Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit 28, 29, 107, 108, 227, 228, 244, 245, 281, 282, 303, 304, 341, 360, 361, 440, 441, 475, 476, 483, 484, 507, 508, 544, 545, 562, 563, 604, 605, 613, 614, 715,

Vendimi i kontestuar 16, 21, 29, 35, 41, 48, 56, 65, 87, 97, 108, 116, 124, 136, 147, 155, 161, 165, 170, 178, 198, 210, 215, 221, 228, 238, 245, 253, 260, 262, 263, 267, 273, 278, 282, 290, 296, 304, 308, 312, 313, 314, 323, 334, 342, 343, 355, 360, 361, 366, 368, 373, 377, 385, 386, 389, 393, 402, 409, 416, 425, 433, 441, 444, 458, 477, 484, 494, 500, 508, 516, 523, 528, 537, 539, 545, 549, 555, 567, 572, 578, 580, 586, 595, 605, 614, 691, 703, 711, 716, 721, 723,

Vepër penale 18, 20, 28, 30, 31, 50, 169, 237, 239, 240, 380, 381, 394, 420, 432, 435, 587, 589, 694, 695, 696,

Z

Zbutje e jashtëzakonshme e dënimit 135, 140,

INDEKSI I NENEVE TË KUSHTETUTËS

Neni	Titulli/Emërtimi	Vendimi/Numri i faqes
	KAPITULLI I	
	DISPOZITAT THEMELORE	
1	**Përkufizimi i Shtetit**	321,
3	**Barazia Para Ligjit**	13, 75, 317, 465, 605, 657, 673,
4	**Forma e Qeverisjes Ndarja e Pushtetit**	60,
7	**Vlerat**	199, 203, 205,
10	**Ekonomia**	42, 43,
18	**Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare**	319, 468, 469, 470, 640, 642, 648,
	KAPITULLI II	
	TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE	
21	**Parimet e Përgjithshme**	97, 103, 124, 129, 195, 199, 203, 205, 304, 314, 411, 465, 466, 467, 469, 477, 480, 523, 525, 626,
	Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe	124, 129, 262, 314, 321, 484,

	Instrumenteve Ndërkombëtare	
22		
24	**Barazia Para Ligjit**	13, 42, 43, 55, 60, 66, 74, 78, 96, 97, 123, 124, 177, 179, 183, 184, 199, 203, 205, 237, 238, 240, 244, 259, 262, 272, 274, 277, 282, 285, 314, 321, 347, 350, 384, 385, 408, 409, 411, 432, 433, 440, 441, 447, 457, 462, 465, 466, 475, 477, 480, 483, 528, 531, 554, 558, 559, 579, 582, 604, 605, 612, 622, 624, 647, 657, 669, 670, 672, 682, 685, 702, 703,
27	**Ndalimi i Torturës Trajntimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues**	355,
29	**E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë**	237, 240, 585, 590,
30	**Të Drejtat e të Akuzuarit**	21, 23, 409, 411,
32	**E Drejta për Mjete Juridike**	66, 74, 78, 97, 160, 162, 164, 166, 179, 183, 365, 441, 477, 480, 529, 531, 604, 605, 612, 613, 614, 618,
33	**Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Çështjet Penale**	408, 409, 411,
34	**E Drejta për të mos u Gjykuar dy Herë për të Njëjtën Vepër**	60,
37	**E Drejta e Martesës dhe Familjes**	484,
41	**E drejta e Qasjes në Dokuemnte Publike**	355, 381,
45	**Të drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes**	312, 314, 321, 604, 605,
49	**E Drejta e Punës Ushtrimit të Profesionit**	34, 36, 37, 42, 43, 97, 115, 116, 119, 147, 152, 259, 262, 263, 281, 282, 285, 289, 290, 292, 406, 462, 493, 494, 496, 497,

		536, 540, 541, 542, 562, 563, 566, 571, 572, 575, 576, 577,
50	**Të Drejtat e Fëmijës**	484,
53	**Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut**	26, 66, 78, 121, 179, 183, 494, 497,
55	**Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore**	462,

KAPITULLI III

TË DREJTAT E KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE

60	**Këshilli Konsultativ për Komunitete**	355, 661, 662, 663,

KAPITULLI IV

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

78	**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve**	355,
80	**Miratimi i Ligjeve**	327,

KAPITULLI VI

QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

101	**Shërbimi Civil**	90, 571, 574, 622, 638, 657, 659,

KAPITULLI VII

SISTEMI GJYQËSOR

102	**Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor**	195, 314, 523, 525,
103	**Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave**	314, 321,
106	**Papajtueshmëria**	355,

KAPITULLI VIII

GJYKATA KUSHTETUESE

113	**Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara**	166, 270, 396, 465, 470, 622, 642, 643, 649, 661, 662, 668,
114	**Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese**	314, 321,
116	**Efekti Juridik i Vendimeve**	34, 37, 44, 493, 498,

KAPITULLI XIV

DISPOZITAT KALIMTARE

159	**Pronat dhe Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore**	356,
162	**Hyrja në Fuqi**	322, 328, 346,

SHKELJE E NENEVE 31, 54 dhe 46 E KUSHTETUTES

31	**E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm**	66,
46	**Mbrojtja e Pronës**	66,
54	**Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave**	66,